

BEHGJET PACOLLI

NGA SFIDA NË SFIDË  
*JETA*, BEHGJET PACOLLI

*Këtë libër ja kushtoj të rinjve të Kosovës*

*Me parathënie të Profesor Doktor Rexhep Meidanit,  
ish President i Shqipërisë (1997-2002)  
dhe Ambasadorit Uilliam Uoker*

Redaktor letrar:            Profesor Doktor Agim Vinca


Dizajni grafik:            Vincenzo Cardone

Foto e ballinës dhe e faqes 3:    Avni Selmani

*Jetëshkrim i ndërtuar sipas intervistave, shkrimeve në shtypin kombëtar e atë botëror dhe bisedave me Agim Doçin, Xhixhi Monkalvon (Gigi Moncalvo), Baton Haxhiun, Jetlir Zyberajn dhe Mentor Nazarkon.*

Prishtinë Nëntor 2010

Copyright © Behgjet Pacolli

A close-up portrait of Behgjet Pacolli, a middle-aged man with short, light brown hair, smiling slightly. He is wearing a dark blue suit jacket, a white shirt, and a light blue patterned tie. The background is a plain, light blue color.

*Këtë libër ia dedikoj të rinjve të Kosovës dhe rinisë në përgjithësi duke ju përcjellë mesazhin se në jetë çdo gjë është e mundur aty ku investohen koha, vullneti dhe shpirti. Të mos humbin shpresën dhe besimin se me punë dhe përkushtim arrihet çdo gjë, duke respektuar njeriun me tërë vlerat dhe atributet që i ka. Mbarë botës i kemi dëshmuar se kombi ynë i vogël gjithmonë ka nxjerrë njerëz të mëdhenj. Beso gjithnjë se ti mund të jesh njeri prej tyre, mos qëndro anonim, jeta është plot sfida-sfidoji ato, por me një kusht: interesat e secilit të jenë të përfaqësuara në mënyrë të drejtë dhe harmonike.*

*me respekt  
Behgjet Pacolli*

## Përmbajtja

Një shembull, një mision, një mundësi, një realitet <i>nga Rexhep Meidani (Ish-President i Shqipërisë)</i> .....	6
Bashkëveprimet e mia me Behgjet Pacollin <i>nga William Walker</i> .....	35
Pse shkruaj për jetën time? .....	38
Fëmijëria .....	56
Jeta në Prishtinë .....	76
Ikja në botën e lirë .....	91
Ëndrrat filluan të jetësohen .....	III
Një vit i veçantë .....	130
Teknologjia ime - revolucion në industrinë tekstile .....	144
Lindja e Mabetex-it .....	166
Hyrja në Kremlin .....	182
Kazakistani, një sfidë tjetër .....	210
“Russiagate”, si filloi?.....	229
Skena dhe prapaskena .....	249
Përballë Karla del Pontes .....	266

Fundi i lojës .....	280
Unë njoh dhe dështime. Por kudo investoj besim. ....	300
Misioni i pamundur .....	308
Si e shoh unë historinë tonë të afërt.....	346
Kthimi im në Kosovë dhe kontaktet e para me politikën .....	353
Një forum i vërtetë për Kosovën.....	367
Lobimi për pavarësinë e Kosovës dhe për njohjen e saj si shtet në botë .....	381
Angazhimi im partiak në AKR dhe klasa politike e Kosovës .....	415
Forca e jetës, forca e familjes.....	436
Misioni im në Afganistan.....	456
Detajet e lirimit.....	469
Shqipëria, si vend ku marr fuqi para sfidave të reja .....	481
Manifesti im personal si politikan.....	489
Epilog: lobimi dhe punë të tjera të pakryera .....	495
Falënderime për librin.....	501

## një shembull, një mision, një mundësi, një realitet...

Nga Rexhep Meidani

**N**ë fillim të mandatit si kryetar shteti, në një nga sheshet e spitalit “Zonja e Këshillit të Mirë” u organizua një koncert sensibilizimi e bamirësie, me praninë e këngëtares italiane me origjinë shqiptare, Ana Oksa (Hoxha-Oxa). Aty, së bashku me Anën, në një transmetim të drejtpërdrejtë, iu drejtua opinionit publik italian dhe donatorëve të ndryshëm, për mbështetjen dhe përfundimin e projektit të spitalit, të nxitur edhe nga vetë Nënë Tereza. Por, dhe ky projekt, si mjaft të tjerë, u paralizua përkohësisht pas ngjarjeve të 14 shtatorit dhe luftës së Kosovës, derisa, më së fundi, më 2005, u mundësua më shumë hapja e universitetit “Zonja e Këshillit të Mirë” se vetë ndërtimi e funksionimi normal i spitalit përkatës...

Në fakt, në atë veprimtari unë kam qëndruar pranë Anës dhe nga ana tjetër e saj ishte vajza ime, Adea. Aty duhet të jem përshëndetur me Behgjet Pacollin. Por, prania e tij në atë ngjarje është e fiksuar plotësisht në librin e tij autobiografik “...nga sfida në sfidë, jeta, Behgjet Pacolli”. Pikërisht, diku në libër, ai thekson: “*në vitin 1998, mora pjesë në një ceremoni për mbledhje fondesh lidhur me këtë iniciativë, ndërtimin e spitalit, në dy qytete të ndryshme - në Tiranë dhe në Romë. Edhe me atë rast kardinali u zotua se do ta çonte në vend amanetin e Nënë Terezës, e cila kishte ndërruar jetë një vit më parë. Unë isha me Ana Oksën, në atë ceremoni dhe isha i gatshëm të merrja pjesë, të kontribuoja në ndërtimin e atij spitali, i cili nuk u ndërtua kurrë... Do të doja ta pyesja atë kardinal, nëse i ruante*

akoma monedhat që ia dhuroi Nënë Tereza. Sigurisht jam kritik dhe për qeverinë e Shqipërisë, e cila gjithashtu nuk e përmbushi këtë amanet historik, ndërsa flet për sjelljen e eshtrave të saj në atdhe"... Sidoqoftë, pa qenë shumë i sigurt, diçka më është thënë për martesën e pritshme të saj me një biznesmen shqiptar tepër të suksesshëm të Kosovës, me banim në Zvicër. Madje, pak më vonë kam mësuar dhe realizimin e kësaj lidhje martesore (1999-2002), që pengesë jo të vogël kishte edhe kohën e angazhimit të secilit. Po ashtu, aty nga fundi i asaj periudhe, kam lexuar rastësisht dhe një intervistë të dhënë prej Behgjetit, ose në shtypin zviceran ose diku tjetër, për mos funksionimin e martesës së tij me Anën. Ishte një intervistë me të vërtetë dinjitoze e qytetare, me thellësi të dukshme shpirtërore dhe përkujdesje të veçantë njerëzore. Madje, ajo, me linjën e saj tepër njerëzore, më bëri të ndryshojë mendjen për këtë person të veçantë të botës shqiptare. Ai në sytë e mi po shihej ndryshe, të paktën në finesën e tij etike dhe estetike...

Edhe pse më la mjaft përshtypje ajo intervistë, perceptimi im për të mbeti pak a shumë brenda "kornizës thashethemore" të asaj kohe. Por, leximi i librit më bindi tërësisht për atë që kisha ndjerë që në atë kohë. Ai, në këtë libër, edhe pas shumë vitesh, flet me mjaft respekt e dashuri, pse jo dhe me nostalgji, për Anën dhe jetën e tij me të. Ja çfarë shkruan ai, midis të tjerash, në këtë pjesë të librit: "...Lidhja jonë ka zgjatur shumë vjet, ndonëse periudha e jetës martesore ka qenë më e shkurtër. Me Anën jam njohur diku në fillim të viteve '90, prej kur edhe kam filluar të bashkëjetoj me të. Jemi ndarë më 27 maj të vitit 2001. 27 maji për mua do të mbesë një datë shumë e rëndësishme. Më 27 maj 2001 u ndava me Anën... Dua të them menjëherë se për mua Ana ka qenë një grua e jashtëzakonshme, e cila në mënyrë fantastike ka ditur që, nga jeta aventuroze, ta themi kështu, t'i përshatet pa asnjë vërejtje jetës familjare. Një karakter i fortë, tip i vendosur, parimore, e çiltër, shoqe e mirë dhe grua e mrekullueshme. Mbi të gjitha, një grua e bukur, një zanë e vërtetë, plot temperament, që nuk kishte komplekse dhe që nuk hezitonte të ekspozonte vlerat e saj, qofshin fizike, qofshin të karakterit. Ana nuk ishte këngëtare e zakonshme, e tillë siç perceptohen zakonisht femrat e kësaj kategorie. Ajo ishte artiste në kuptimin e plotë të fjalës. Kuptimi i saj për

jetën ishte pikërisht ai i një artisteje, e cila vë në funksion të vokacionit krejt qenien e saj. Për të arti ishte çdo gjë. Gjakimi i saj për të bukurën në jetë dhe në art i jepte energji, e bënte plot vullnet, të pae-pur. Kishte edhe një pamje fizike të mrekullueshme: e gjatë, me trup të gdhendur si në mermer. Ishte e ndjeshme dhe senzitive. I dinte përparësitë dhe avantazhet e saj, por nuk i theksonte ato. Në jetën e zakonshme ishte e shtruar, kurse në skenë, në koncerte, në festivale, shpërthente me një fuqi uragani. Kishte sharm dhe fuqi tërheqëse, të thuash magnetike. Sapo shfaqej në skenë, publikun e bënte për vete, e bënte të ndiente emocione të forta, njësoj siç i përjetonte edhe vetë ajo. Kënga e saj ishte shpirti i saj. Ana ishte mishërim i të bukurës në art dhe në jetë... Por, gjithsesi një kapitull më vete përbëjnë angazhimet e saj publike, në media dhe gjithkund tjetër, rreth çështjes së Kosovës, veçmas në periudhën e bombardimeve të NATO-s... Në këtë situatë të turbullt mediale për Kosovën në Itali, futemi në lojë Ana dhe unë, duke arritur të ushtrojmë ndikim fantastik te opinioni vendës. Ajo kishte disa avantazhe: ishte me origjinë shqiptare, këtë e dinin të gjithë italianët, por ishte italiane, madje ikonë e muzikës italiane; ishte e furnizuar me informacione të mjaftueshme dhe e njihnte problemin në thelbin e tij; kishte elokuencë dhe i argumentonte mendimet në mënyrë të shkëlqyer. Përmes këtyre debateve, përfshirë edhe emisionin Porta a porta të Bruno Vespës, në të cilin ishim disa herë, Ana Oksa arriti të nxirrte “jashtë lojë” figurat më eminente të politikanëve komunistë italianë, si Bertinoti, Kosuta (Cossuta), Oketo (Ochetto) etj.”

Po ashtu, autori edhe në këtë pjesë, për të shmangur keqinterpretimet, sqaron me mjaft sinqeritet: “...shkurorëzimi me Anën nuk erdhi si pasojë e mospajtimeve apo mosmarrëveshjeve të vazhdueshme, që realisht e bëjnë jetën bashkëshortore të pamundur. Bëhej fjalë për një ngatërresë, për një incident, madje ndoshta më shumë për një keqkuptim, i cili, me pak durim dhe mirëkuptim, do të mund të sqarohet. Ishte diçka e krijuar, e prodhuar, fryt i stilit tim të jete-sës, i bashkëjetesës me shumë njerëz, i gjerësisë sime shpirtërore, që ndikoi pastaj edhe në jetën time bashkëshortore. Por, ajo që ndodhi, ndodhi, dhe tani ishte sikur puna e perit, që këputet dhe nuk ngjitet më”..



\*\*\*

Por le të kthehem tek perceptimi i sajuar kundër B. Pacollit. Në fakt, edhe media e kishte bërë punën e saj. “Kremlingate” i skenuar i Del Pontes (Carla del Ponte), si kryeprokurore e Zvicrës e kishte lënë gjurmën e pakëndshme edhe midis nesh. Ndoshta, në radhë të parë, edhe shtypi italian, i ushqyer ose jo prej saj, me *Corriere della Sera* në krye. Madje, në fund verën e vitit 1999, sulmi mediatik arriti kulmin me përfshirjen e Behgjet Pacollit në një aferë, ku ishin përfshirë personalitete të tilla të larta si presidenti rus Jelcin, zëvendëspresidenti amerikan Al Gore apo presidenti i Bankës Botërore Camdesy! Për këtë trillim tej çdo pseudo-fantazie e përmase, B. Pacolli, në librin e tij, sqarohet thjesht e prerë.

Del Ponte, me emërimin e saj si Kryeprokurore e gjykatës për krime lufte në ish -Jugosllavi (ICTY), ja kaloi dosjen e “Kremlingate”-it për finalizim zëvendësuesit të saj. Kjo edhe pse ajo dosje ishte e mbushur me kontradikta, sajesa apo “evidenca” propagandistike-mediatike, pjesë të “hobit fantazist” të ish prokurores, të shfaqur akoma më dukshëm në librin “Gjuetia – unë dhe kriminelët e luftës”, të bllokuar në promovim nga vetë Ministria e Jashtme e Zvicrës. Për këtë, jo pa të drejtë, B. Pacolli shpreh në libër dhe dyshimet e tij: *“Mund të kenë qenë të shumta motivet që e nxitën Del Ponten të bëhej promotore e kësaj afere, por gjithsesi do të mbetet të sqarohen në të ardhmen më mirë shumë rrethana, përfshirë edhe ato që në ndonjë pikë të largët mund të lidhen me Kosovën dhe çështjen e saj, me Serbinë dhe luftën e saj në Kosovë, me Rusinë dhe me oligarkët e saj, me Italinë dhe me interesat e saj ekonomike”*. Edhe, unë, si shumë shqiptarë të tjerë që kanë pasur kontakte zyrtare me Del Ponten, kam shfaqur pakënaqësitë e mia për të, të pasqyruara në shtypin shqiptar apo në panele ndërkombëtare.

Sidoqoftë, ndryshe prej saj, pas 3 vjetësh hetimesh intensive, Bertosa (Bernard Bertossa), Prokurori i Përgjithshëm i Konfederatës Zvicerane, që zëvendësoi Del Ponten, më 6 mars 2002, e mbylli zyrtarisht procesin, në favor të plotë të Behgjet Pacollit, presidentit të *Mabetex Group*, kompani konstruksioni dhe inxhinierie civile, me

qendër në Lugano-Zvicër... Vetë Pacolli, më vonë në libër, duke analizuuar marifetet e Del Pontes mbi “Kremlingate”-in apo “Russiagate”-in e saj, shkruan: *“Satisfaksioni për paqëndrueshmërinë e të gjitha akuzave erdhi më vonë, më saktë më 8 mars 2001, kur Prokuroria zvicerane lëshoi një dokument, me të cilin saktësohej se as unë dhe as Mabetex-i, as firmat e ndërlidhura me punën dhe veprimtarinë tonë, asnjëherë nuk kishin qenë objekt i ndjekjes penale dhe se nuk kishte pasur asnjë interferim shtetëror në biznesin tim. Kjo ishte fitorja ime më e madhe, edhe e Mabetex-it gjithashtu, në aferën “Russiagate”. Nëse tani reflektoj për gjithë këtë, duhet të përmend edhe disa fakte. “Russiagate” kaloi. As unë dhe as Mabetex-i, pos humbjeve ekonomike, nuk patëm ndonjë pasojë ligjore. Nuk u ngrit dhe nuk mund të ngrihej asnjë padi, qoftë civile apo penale. Përkundër tentativave për të ndërhyrë në llogaritë e firmave të mia, ato nuk u bllokuan asnjëherë në mënyrë që biznesi im të kufizohej”...*

Në përgjithësi, nisur nga kjo ngjarje apo raste të ngjashme, krahas argumenteve të karakterit politik dhe gjeostrategjik të vetë B. Pacollit, nuk mund të harrohet se, në fund të fundit, edhe sukcesi në këtë botë ka “pagesën” e vet; ai sjell shpërthimin e xhelozisë dhe të smirës, fut në funksion ekstrem armën e shpifjes, ndyrësisë e pseudo-akuzës. Në këtë kuptim, sukcesi ka qenë dhe mbetet për fat të keq një bashkëqytetar i lakmisë dhe zilisë së të paafitit, të pazotit, të përtacit. Kush e arrin këtë sukses ndjehet jo rrallë i zhgënjyer nga kjo dobësi e ulët njerëzore, por, ama, ai që i reziston asaj me anë të punës, gatishmërisë, përfshirjes e humanizmit apo kapërcimit të pakënaqësive të vogla, kalon në një stad akoma më të lartë personaliteti, force shpirtërore e energjie njerëzore! E tillë mund të konsiderohet në libër, sjellja ndaj Maks Gygaksit, e shefit të dikurshëm të B. Pacollit, që, pasi falimentoi, vazhdoi të mbijetojë me ndihmën e Behgjetit. Apo ajo që shkruan Uokeri (William Walker) po në hyrje të këtij libri: *“Një mbrëmje , ndërsa unë isha sërish në Lugano, z. Pacolli u njoftua se disa ndërkombëtarë, në mesin e tyre një shqiptarë, ishin rrëmbyer në Afganistan. Pa hezitim, Behgjeti vendosi të udhëtojë në rajon, në përpjekje për të gjetur rrëmbyesit e tyre dhe biseduar lirim e tyre. Ai fluturoi jashtë vendit një ditë më pas. Perëndia e di atë që ai bëri për të përmbushur qëllimin e tij,*

*se në çfarë rreziku e futi veten, dhe çfarë burimesh shpenzoi - por misioni tij ishte tërësisht i suksesshëm”...Kurse diku tjetër, në fillim të librit, ai thekson: “Behgjet Pacolli ma tregoi germë për germë, ëndrrën e tij të integritit të Kosovës në një kuadër gjithnjë e më të ndërvarur të lidhjeve ekonomike dhe të tregtisë, të transportit të integruar dhe rrjeteve të tjera infrastrukturore - një proces gradual, pazarar, i cili në mënyrë të pashmangshme dhe në mënyrë paqësore, do të çonte në një ndërvarësi më të madhe ekonomike midis bashkësisë së këtyre ekonomive të vogla dhe të pambrojtura. Kështu Ballkani do të bëhej një tjetër qoshe moderne e Evropës. Behgjet Pacolli që i bindur se kjo do të ndodhte, nëse udhëheqësitë politike të vendeve të Ballkanit do të linin mënjanë interesat e tyre të vockla, dhe do të punonin për përfitime politike dhe ekonomike për të gjithë në rajon. Në vitet e mëpasme që e njoha Behgjet Pacollin, unë kam përjetuar në mënyrë të njëpasnjëshme shembuj të tjerë të shqetësimit të tij dhe pasionit për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, qofshin ato të një individi, ose të një kombi të tërë. Kur ai merret me një kauzë, me një mision, ai është i gatshëm për të investuar kohën e tij, pasurinë e tij personale, mirëqenien e gjithçka duhet për të sjellë një zgjidhje të drejtë dhe praktike”...*

\*\*\*

Para disa vjetësh, gjatë një vizite të shkurtër në Kosovë, e kam takuar për herë të parë B. Pacollin (me rezervën e vitit 1998!) në shtëpinë e Ramush Haradinajt. E kishim lënë të pinim një kafe me Ramushin dhe pastaj të shkonim së bashku në Akademinë përkujtimore kushtuar Luanit, vëllait të tij të vrrarë nga serbët, në maj të vitit 1997, jo larg kufirit me Shqipërinë. Në atë kohë, Ramushi ishte ende në arrest shtëpie, por që nga marsi 2006 Dhoma e Apelit e ICTY i kishte dhënë atij të drejtën e pjesëmarrjes në veprimtari politike publike, me autorizimin konkret të UNMIK-ut (d.m.th. dhe “skortën policore” të tij). Sidoqoftë, në momentin që hyra në shtëpinë e tij, Ramushi, me zgjuarsinë e tij natyrore, ndjeu ndonjë stepje apo hezitim timin dhe ma prezantoi menjëherë bashkëbiseduesin. “Është Behgjet Pacolli, një mik i imi. Besoj se bëra mirë që i shpreha

kërkesën dhe dëshirën për të qëndruar dhe biseduar së bashku"- tha ai me dinamizmin dhe thjeshtësinë e tij "rebele". Në fakt, kishte bërë shumë mirë! Aty bisedova gjatë me Behgjetin, bile aq sa duhej për të ndërtuar një lexim të drejtpërdrejtë, krejt tjetër, por dhe shumë më të ndryshëm nga ai i krijuar nga thashethemnat politike e mediatike. Sidomos duke pasur parasysh dhe momentin e vendimmarrjes së tij për të hyrë më konkretisht e gjerësisht në politikën kosovare fillimisht si lëvizje dhe pak më vonë si president i një partie kosovare të quajtur Aleanca Kosova e Re (AKR). Të njëjtin shikim pozitiv e bashkëkohor, të njëjtin konceptim pozitiv, etikë qytetare dhe estetikë intelektuale i kam ndeshur tek ai dhe në emisionin "Deja vu" të Mustafa Nanos në Top Chanel...

Sidoqoftë, duke qenë jo aq i lidhur sa më parë me politikën kosovare të ditës, e kuptova nga libri se marrëdhëniet e Behgjetin me Ramushin nuk ishin më si më parë. Unë vetë do të dëshiroja dhe uroja të kundërtën. Kjo, aq më tepër, se B. Pacolli për detyrat kryesore të politikës kosovare mendon pak a shumë si unë, në mënyrë më konkrete, më të fokusuar për çështjen fundamentale të anëtarësimin të Republikës së Kosovës në OKB! Të paktën këtë dëshmon ky libër. Kjo kuptohet dhe nga kompaktësia e orientimit të tij: "Mund të dukem naiv politikisht, por sipas meje Kosova nuk duhet të jetë, së paku, për një farë kohe fushëbetejë e përplasjeve të ashpra politike".

Por, për të qenë besnik në vlerësimet për librin, po citoj këtu dhe atë pjesë ku flitet për Ramushin: *"E shoh të nevojshme me këtë rast t'i them dy-tri fjalë edhe për Ramush Haradinajn, të cilin e kam njohur para se të bëhet kryeministër, sado që nuk mund të flitej për një njohje të thellë. Pas ekstradimit në Hagë, unë fillova të interesohesha për të. Ramushin e kam përkrahur jashtëzakonisht shumë, aq sa ndoshta është individ që kam përkrahur më së shumti në botë. Nëse dikujt vërtet i kam ndihmuar, ai gjithsesi ka qenë Ramush Haradinaj. Kam qenë dhe vazhdoj të jem krenar që kam pasur mundësi t'i ndihmoj, sepse ka qenë luftëtar, njeri që ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në luftën për çlirimin e Kosovës. Përveç kësaj, gjatë kohës që ka qëndruar në Hagë, unë kam shkuar rregullisht te familja e tij. Natyrisht, unë nuk kam pritur që ai të ma kthejë në ndonjë formë ndihmën që i kam ofruar, por, kam pritur që*

së paku të sillej më me respekt ndaj meje. Sidomos sulmet e ndonjë të afërmi të tij, gjatë fushatës zgjedhore i kam konsideruar një gjë të keqe, por megjithatë jam përpjekur t'i tejkaloj, duke konsideruar se bëhet fjalë për një djalë të ri, të papjekur ende. Sjelljet e pamenduara të disa pjesëtarëve të AAK-së, vijat e kuqe të Ramush Haradinajt ndaj AKR-së, konspiracioni që Ramushi e potencon etj., kanë ftohur edhe më shumë marrëdhëniet tona". Po e përsëris edhe njëherë, unë, personalisht, do të parapëlqejja dhe uroja të kundërtën. Përveç njohjes, vlerësimit dhe dinamizmit "rebel" të tij, ka ndikuar tek unë dhe Karl Bildt mbi vlerësimet e veta pozitive mbi Ramushin, të paktën në krahasim me politikanët e tjerë të Kosovës të njohur vite më parë prej tij!...

\*\*\*

Nuk ka shumë ditë, në kthimin nga Parisi në sallën VIP të aeroportit të Tiranës "Nënë Tereza", takova papritur dhe B. Pacollin. Ky ishte një takim tjetër i yni. Por, ajo që më bëri më shumë përshtypje ishte fakti që ai aty po i bënte shoqëri ministrit të Jashtëm të Maldiveve, z. Ahmed Shaheed. Më erdhi shumë mirë për këtë sjellje miqësore e "detyrë" diplomatike të Behgjetit aq më tepër që aty nuk m'u duk se kishte ndonjë përfaqësues të protokollit tonë të shtetit, ndoshta dhe nuk i njihja sepse edhe kanë ndryshuar, për arsye moshe, karriere apo "politike-partiake". Kjo sidomos, duke pasur parasysh kontributin e këtij ministri në njohjen e Republikës së Kosovës, që më 19 shkurt 2009. Madje, këto dy vende me shtysën e tij firmosën me shpejtësi marrëdhëniet diplomatike më 16 prill 2009. Dhe pjesë kryesore e këtij procesi sa të shpejtë, po aq të domosdoshëm ishte dhe vetë Pacolli, si patriot, politikan e biznesmen. Me të drejtë, edhe Uoker, në hyrje të librit, thekson midis të tjerash se ai "*ju drejtua rrjetit të tij të kontakteve në mbarë botën, duke shfaqur një talent të natyrshëm për protokollin diplomatik kur qe e nevojshme, si edhe qasje më të drejtpërdrejta kur duhej - Behgjet Pacolli ka qenë forca lëvizëse për njohjen e Kosovës nga një numër i caktuar vendesh. Kur të tjerët u përpoqën të merrnin merita për këto arritje, z. Pacolli, i la ata të mburreshin. Qëllimi i tij ishte pranimi i vendit të ri nga ana e*

*bashkësisë botërore, asgjë tjetër përtej kësaj”...*

Nga ana tjetër, edhe vetë B. Pacolli, duke qenë i ndërgjegjshëm për vlerën e shtuar të tij si deputet i Kosovës, thekson në libër se : *“...të qenit në Parlamentin e Kosovës më ka krijuar disa avantazhe në krahasim me periudhën e kaluar, sepse tani jam pjesë e një përfaqësimi legal dhe të dëshmuar me votën e elektoratit. Unë kam të drejtë t’u premtoj zgjedhësve të mi se do të angazhohem maksimalisht në procesin e njohjes së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Këtë nuk mund të ma ndalojë askush, sikundër që një angazhim i këtillë nuk mund të interpretohet si injorim i institucioneve legale të Kosovës, sepse edhe unë jam pjesë e këtyre institucioneve, madje jam ligjvënës. Prandaj, refuzoj me ındinjatë çdo spekulim që është bërë rreth angazhimeve të mia për ta çuar përpara procesin e njohjes, i cili, siç mund ta vërejnë të gjithë, ka pasur dhe vazhdon të ketë ngecje”. Dhe pak më poshtë: “... Në konferencën e Human Rights Watch të mbajtur në Gjenevë më datë 4 mars 2010, unë dhe lobuesit e mi, pothuajse vendosëm zyrat dhe punuam fuqishëm aty ku ishte e mundur: te Suazilendi (Swaziland), Mozambiku, Botsuana, Kenia, Nepali, Bangladeshi, Timori Lindor etj. U takuam, biseduam dhe prezantuam çështjen e Kosovës në mënyrë të detajuar. Efekti i këtij lobimi u pa (rasti i Suazilendit) dhe do të shihet në të ardhmen e afërt. Për këtë duhet të falënderoj pa masë shtetin mik të Kosovës, Republikën e Maldiveve, gjegjësisht mikun tim, ministrin e punëve të jashtme, Ahmed Shahid (Shaheed), i cili ka dhënë dhe është duke dhënë një kontribut të madh për promovimin e çështjes së Kosovës. Ahmed Shahid (Ahmed Shaheed) është ministri i jashtëm i Republikës së Maldiveve, shtetit ishullor më të vogël të Azisë. Shahid është një figurë e shquar e këtij shteti, me një emër të mirë si aktivist i shoqërisë së hapur në vendin e vet dhe me vlerësime ndërkombëtare nga organizata të ndryshme... Në Doha, në një mbledhje të Konferencës Islamike, unë isha mysafir i Sekretarit të Ligës Arabe, Abu Musa. Ne lobuam shumë për Bahreinin dhe për njohjen nga ky vend merita ekskluzive na takon mua dhe stafit tim”...*

Por, B. Pacolli, është i pakënaqur nga sjellja apo reagimi politik e institucional kosovar. Midis të tjerash, ai sqaron: *“... Kam hasur në heshtje dhe bojkotim. Një gjë është e sigurt: pa marrë parasysh a jemi*

*në pozitë apo opozitë, promovimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare është çështje madhore dhe obligim i çdo politikani a qytetari... Lobimi kushton shumë dhe është i vështirë. Unë i bëj, megjithatë, me dëshirë këto shpenzime si qytetar i lirë dhe jam i lumtur që kontaktet e mia nuk vijnë duke shfrytëzuar beneficet e shtetit, apo fondet e varfra të tij. Gjatë punës sime për njohje, mjerisht, në vend të vlerësimit jam rrethuar shpesh nga një mur i lartë mosmirënjohjeje, ndjenjë bezdie nga zyrtarë të lartë të Kosovës, të cilët ndihen të rivalizuar në punën e tyre. Puna e tyre, fatkeqësisht, nuk ka mundësi mbase të ketë rendiment të lartë, shkaku i disa kufizimeve të kuptueshme, por kjo s'duhet të jetë shkak që ata ta shohin me xhelozzi madje edhe ta pengojnë punën time". Por, çfarë rëndësie ka? Në fund të fundit, njeriu jep dhe llogari para vetes. Aq më tepër kur arrin rezultate që e gëzojnë atë dhe të tjerët pranë tij!...*

\*\*\*

Në sallën VIP, po atë natë, takova dhe Mentor Nazarkon, ish këshilltarin tim gjatë kryerjes së detyrës së kryetarit të shtetit. Ai, aktualisht, punon në stafin politik të B. Pacollit si një këshilltar i tij. Pikërisht këtë e thekson dhe vetë z. Pacolli, diku në fund të librit të tij, në rubrikën e falënderimeve. Por, Mentorit, përvoja si gazetar dhe këshilltar, i ka shërbyer që "goditjen" e suksesshme ta bëjë po në kohën e duhur, aq më tepër kur "shfrytëzon" apo mbështetet tek këmbëngulja e tij gati-gati "ezauruese". Sidoqoftë, në këtë takim të shkurtër në aeroport, ai duke e ndjerë mungesën e çdo dispozicioni timin në atë moment, nuk më propozoi apo nuk më kërkoi ndonjë gjë të veçantë, veçse mësoi se unë të nesërmen do të nisesha për në Madrid në një mbledhje vjetore të Asamblesë së Klubit të Madridit, dhe sapo të kthehesha në Tiranë, përsëri pas një dite, do të nisesha për në Trieste, në ICTP në Konferencën Ndërkombëtare: "ICTP after 45. Science and Development for a Changing World", ku do të drejtoja panelin: "Science within a Changing Geopolitical Framework- Science in Eastern Europe and the Balkans"...

Interesante, por ai më telefonoi nga Kosova pikërisht në mbrëmjen para nisjes për në Trieste. Sapo kisha printuar referimin tim dhe kisha

lexuar të gjitha materialet e tjera të konferencës, dhe po vishesha për të shkuar në Piacca për të pirë një kafe me bashkëshorten. Në fillim, nuk e vura re prefiksin, por në telefonimin e dytë njoha zërin e Mentorit. Ai kësaj radhe dukej si tepër i “armatosur” me atë këmbënguljen e përmendur më sipër. Po më kërkonte të përgatisja një parathënie të një libri autobiografik të B. Pacollit, për më tepër edhe në një kohë të shkurtër. Fillimisht rezistova thjesht për pamundësi kohore. Sapo të kthehesha duhet të referoja në dy aktivitete rajonale, që ende nuk i kisha përgatitur. Sidoqoftë, pa dhënë një premtim përfundimtar, ai mbeti i kënaqur me rënien time dakord për të më dërguar një version elektronik të librit. Ai e dinte që ky ishte më shumë se premtim! Dhe kështu ndodhi. Që në kafene mora e-mail-in e tij në iPhone, ndërsa kur erdha në shtëpi e kalova variantin elektronik të librit në desktop. Fillova ta lexoja librin që në atë natë dhe vendosa që të merrja me vete laptopin për të shfrytëzuar edhe kohën e transitit në aeroport, periudhat midis seancave të konferencës ose kohën e lirë aty. Mentori fitoi! Por dhe unë nuk mund të them se nuk fitova duke e lexuar këtë libër...

Pa dyshim, jo se pikëpamjet e mia janë patjetër të njëjta me ato të B. Pacollit, as pse analizat e mia politike për ngjarje kryesore mund të kenë veçime apo theksime të tjera, ndoshta dhe krejt të ndryshme, por se në këtë shumëllojshmëri e larmi fillojnë të përjetohen më mirë detajet e të vërtetës, përafrimet e mundshme apo justifikimet përkatëse. Parë me këtë sy, p.sh., në këtë libër mungon një përbërëse e rëndësishme e lidhur me kontributin e Shqipërisë, të politikës dhe familjeve shqiptare, të solidaritetit e humanizmit shqiptar, që tronditi, gjatë krizës kosovare, të gjithë botën e qytetëruar. Kjo, ndoshta, në një mënyrë apo tjetrën lidhet dhe me kontaktet e pakta apo vesh-tirësitë e z. Pacolli për të depërtuar në mjedisin politik mosbesues të Shqipërisë, pas luftës mediatike e “prokurorike” të Del Pontes ndaj tij, të ilustruara me hollësi në libër.

Ndryshe nga vlerësimi i Klintonin mbi Jelcinin, që padyshim ka pasqyruar interesa gjeopolitike shumë më globale të një presidenti amerikan dhe të vetë politikës amerikane, në rastin e interesave shqiptare nuk kemi pse ta veçojmë qëndrimin e Jelcinit si president rus, sepse ai në atë pozicion nuk kishte “arsye” që t’i mbështeste



interesat tona. Për mjaft arsye. Ndërkohë, nuk duhet të çuditemi që vetë presidenti Klinton ka arritur të bashkëpunojë jo keq, as dhe pak, me Jelcinin si president të Rosisë. Ai, në librin e tij autobiografik *My Life*, ndalon në mjaft raste në shpresën e një ecje pozitive të Rosisë nën drejtimin e Jelcinit. Kështu, p.sh., ai shkruan: “*Së bashku me Jelcinin kaluam mëngjesin duke folur mbi situatën kritike politike në Rusi. Unë ia përsërita gatishmërinë time të plotë për ta mbështetur atë. Me gjithë mos qenit dakord me të për zgjerimin e NATO-s, unë do të vazhdoja të provoja për ta bindur atë...*” (f. 675). Dhe pak më tutje : “*...përfundimisht, Borisi pranoi të dërgojë trupa, por ai tha se ata nuk do të shërbejnë nën komandën e NATO-s, megjithatë ai do të ishte i kënaqur që ata të shërbenin “nën komandën e një gjenerali amerikan”...Më erdhi keq që Jelcini pati shumë probleme kur u kthye në atdhe. Po, ai kishte pjesën e vet të gabimit por, me gjithë mosmarrëveshjet dhe pakënaqësitë e mëdha, ai kishte arritur ta mbante Rusinë në drejtimin e duhur...*” (f. 676). Kurse, diku tjetër përsëri, ai e vlerëson Jelcinin: “*Zgjedhjet ishin një ratifikim i udhëheqjes së Jelcinit në garantim të demokracisë, për modernizimin e ekonomisë dhe çuarjen e Rosisë për në Perëndim. Ajo ka ende mjaft probleme, por unë besoj se Rusia e Jelcinit po lëviz në drejtimin e duhur...*” (f. 718).

Me gjithë këtë këndvështrim të mësipërm të Klintonit, në gjykimin tim, as një president rus (qoftë ky dhe Jelcini), nuk do të mund të ndryshonte pozicionin konkret të shtetit të tij në raport me Kosovën apo popullsinë shqiptare. Sepse ndryshe, nga pozicionimet individuale, në pozicionimet shtetërore mbizotëron tradita, historia, interesat, gjeopolitika, raportet ekonomike-politike, lidhjet shpirtërore e gjuhësore, etj. Gjatë asaj kohe, një gjë të tillë ma ka ilustruar më së miri veprimtaria ime konkrete në skenën ndërkombëtare si kryetar shteti. Bile, në një shikim të shpejtë, Serbia reziston sot në mospranimin e pavarësisë së Kosovës, sidomos pas deklarimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sepse prapa saj është ende “ariu rus”, tradita historike e pseudo-patriotizmi apo “krenaria” pansllave, opinionin publik rus proserb!... Megjithatë, B. Pacolli, në takimet e shpeshta dhe intime brenda Kremlinit mund të ketë lexuar dhe pozicionime të tjera shumë më radikale, tepër më të rrezikshme për Kosovën dhe popullsinë shqiptare aty sesa ato të Jelcinit, dhe ai këtë

e demonstroi me rastin e Putinit apo qëndrimet në parlamentin rus. Prandaj, në analizën e tij në libër, ai shkruan me thjeshtësi: *“Për këtë çështje Jelcini, nisur nga vendi që drejtonte, pozicionimi i opinionit publik, i një pjese të rëndësishme të institucioneve të Rusisë, kishte një vizion realist i cili mbështetej edhe në informacione të drejtpërdrejta nga Kosova. Kurdo që binte fjala, ai më thoshte se klima politike e krijuar rreth Kosovës, ishte edhe pasojë e mediave, që krijojnë opinionin publik. Sipas tij, mediat ruse ofronin pamje të shtrembëruara të realitetit në Kosovë pasi që ata raportonin nga Beogradi. Andaj nuk do të ishte keq, më sugjeronte ai, që ti të organizosh një udhëtim me gazetarë të mediave kryesore ruse në Kosovë dhe ta shohin vetë realitetin e atjeshëm...”*. Dhe, në fakt, B. Pacolli u përpoq ta ndiqte këtë këshillë për ndikimin sado pak të opinionit publik rus. Bile, po në libër, ai thotë: *“Për këtë aksion mediatik mora komplimente nga shumë miq të mi në Rusi, të cilët e kishin ndjerë ndryshimin e dukshëm të cilësisë së informacionit që vinte nga vatra e luftës”*.

Po ashtu, B. Pacolli nuk pretendon asgjëkund në libër që e vërteta e tij është dhe e vërteta e të gjithëve. Aq më tepër kur përzihen emocionet. Ai e kupton këtë shumë më mirë se të tjerët. Aq më tepër që mbart mbi supë një përvojë të gjatë shumë të suksesshme në biznes, një përvojë jetësore të lakmueshme, por dhe kontakte të gjithanshme kudo nëpër botë, duke bashkëpunuar me njerëz të llojllojshëm me të metat dhe të mirat e tyre. Kështu, ai diku në libër thekson se: *“Jemi një shoqëri që ka nevojë për simbole dhe Rugova me gjithë gabimet e veta, është një simbol që na duhet. Unë nuk po pretendoj të shkruaj një libër shkencor, unë po përcjell veç fakteve historike, dhe mendimet e mia, dhe dijenitë e mia, dhe emocionet e mia, ku ndoshta gaboj. Emocionet nuk janë baras me të vërtetën, por janë njerëzore”*. Kurse në një vend tjetër shton se: *“Unë kam përjetuar intensivisht një histori të Kosovës, një pjesë të asaj historie, që duhet të bëhet e ditur, që duhet të shënohet diku. Me këtë nuk pretendoj t’u jap peshë bëmave të mia, as të krekosem, as të bëhem hero. Ashtu, kështu, në historinë e saj të dhembshme, Kosova ka shumë heronj, madje aq shumë, sa nuk arrin të gjejë vend për të gjithë. Rrëfimi im jetësor pikërisht synon të kundërtën: t’u bëjë njerëzve të*

ditur se historia e bërjes së Kosovës ka edhe anën e saj ndryshe, ka dramën e saj me përjetime fort të çuditshme, ndonjëherë të pabesueshme. Jeta ime nuk i ngjan historive tipike të heronjve...”. Kurse, në një vend tjetër, duke lënë mënjanë emocionet personale, ai thekson prerë: “Unë fuqishëm mbështes bindjen se bërja e Kosovës nuk ka qenë dhe nuk do të jetë vetëm një proces politik, por edhe proces ekonomik, diplomatik, zhvillimor, arsimor, kulturor, civilizues, integruar, njohës, afirmativ, pra një proces kompleks, ku të gjithë faktorët kanë rëndësinë e tyre të veçantë. Kosovës i ka rënë fati që të bëhet shtet në një rrethanë globale fort të vështirë dhe të ngatërruar. Rruga e saj nuk ka qenë dhe nuk është drejtvizore. As projeksioni i të ardhmes së saj nuk është bardh e zi. Është kjo një tablo me nuanca, ku faktorët shumëngjyrësh ndërliken mesveti dhe kushtëzojnë njëri-tjetrin. Përvoja dhe vëzhgimi im mbi këta faktorë, mendoj se e kanë peshën e vet. Pra, ndërsa kam paraqitur episode të ndryshme nga jeta ime, jo pa qëllim kam ofruar dhe mendime dhe ide të miat. Unë mendoj prandaj jam, thoshte një filozof i shquar si Dekarti, duke lidhur shkakësisht ekzistencën me mendimin e njeriut. Njeriu nuk është vetëm shfaqja e tij fizike, por tërësia e gjithë shfaqjeve të tij, thotë një filozof tjetër”.

Por, nga ana tjetër, duket se ai është i mirë informuar. Diku në libër, B. Pacolli, tregon një histori të lidhur me drekën e dhënë nga presidenti Klinton për kryetarët e delegacioneve në Samitin e NATO-s në Uashington (më 1999, disa javë para përfundimit të goditjeve ajrore mbi Serbi). Aty, kam qenë vetëm unë nga përfaqësuesit shqiptarë. Madje, këtë histori unë e kam treguar vetëm kur jam përjekur për të analizuar kapacitetet e veçanta të presidentit Klinton në komunikim e depërtim. Jam i bindur që dhe politikanëve të tjerë u ka bërë tepër përshtypje kjo lloj përgjigje, sa paqësuese po aq dhe asgjësuese. Sepse, i tillë ishte dhe mbetet vetëm Klintoni! Sidoqoftë, duke kaluar tek libri, B. Pacolli është plotësisht i saktë kur shkruan: “Italia, ndërkaq, njihej si një vend që kishte luhatjet e veta midis Perëndimit dhe Rusisë. Kur Presidenti amerikan Klinton propozoi një sërë masash për ta detyruar Milosheviqin të kapitullonte, D’Alema e ndërpreu dhe tha se paraprakisht duhej folur me Rusinë për këto hapa. Presidenti Klinton nuk replikoi në mënyrë tradicionale,

*por i tha D'Alemës dhe të ftuarve në samit se e kishte filluar ditën e tij të punës, para se të vinte në takim, me një bisedë të gjatë telefonike me Jelsinin. Ishte një bisedë shumë konstruktive, -i tha Klintoni D'Alemës,- dhe u morëm vesh për të gjitha!"...*

\*\*\*

Një vend të veçantë zënë në libër komentet dhe analiza mbi iniciativën e ndërmarrë prej tij për bisedime të politikanëve kosovarë me Millosheviçin. Ai, mesa duket, nisur dhe nga firmosja e Dejtonit apo vetë protagonizmi i Millosheviçit, po kërkonte në atë kohë rrugë gati-gati të pamundura, por gjithsesi me një dëshirë të vetme për shmangien e gjakderdhjes. Madje, dhe i ati i Pacollit e kishte kuptuar më së miri këtë pamundësi kur bisedoi me të birin. Sidoqoftë, në libër, autori thekson pa më të voglën droje se dëshironte ta provonte një mundësi apo pamundësi të tillë. Madje, ai shkruan: “*Duhet ta pranoj, unë nuk kisha përvojë politike dhe, deri atëherë, siç e kam thënë sa e sa herë, ecejaket e mia nëpër botë kishin të bënin më së shumti me biznes. Madje, nuk e kisha imagjinuar ndonjëherë, se do të vihesha në pozitë të tillë, që të bëja negociata për gjëra kaq të mëdha dhe kaq të vështira. Veçmas jo negociata, në të cilat do të vendosej për fatin e popullit tim. Unë e dija se për diçka të tillë nuk kisha as mandat. Isha nisur në këtë aventurë, i shtyrë nga ndjenjat njerëzore, si dikush që ndiente dhembje dhe vuante shpirtërisht për atë që ndodhte në Kosovë”. Dhe pak më poshtë: “*Kritikët e mi të sotëm dhe të djeshëm nuk e kuptonin se unë kisha shkuar një hap më larg se skemat e vjetra politike, historike e diplomatike. Ata është dashur ta dinin se unë vija nga bota e biznesit dhe se me këtë logjikë kisha vepruar edhe në këtë rast. Unë kisha propozuar dhe kisha marrë miratimin për një “marrëveshje kompensuese”, kuptimi i së cilës, siç e kam shpjeguar më sipër, ishte shumë i thjeshtë dhe shumë i qartë. Për mua kishte rëndësi rezultati dhe jo se nga vinte zgjidhja: a do të ndalohej gjakderdhja apo jo? Mund t'i kuptoj kritikët e djeshëm, por e kam të vështirë t'i kuptoj kritikët e sotëm. Po më vonë, cili do të ishte rezultati? - mund të pyesë dikush. Natyrisht, unë nuk kam qenë as atëherë, e nuk jam as sot magjistar apo fallxhor, por për të kuptuar**

sa e rëndësishme ishte ajo marrëveshje nëse respektohej, duhet të vendosemi në atë kohë, të arsyetojmë me rrethanat e kohës dhe jo me ato të sotmet. Por gjithsesi edhe njëherë e përsëris: ashtu si unë edhe udhëheqësia e Kosovës arsyetonim sipas një qasje të momentit...”. Por, ama, nisur nga kjo orvatje ai nxjerr dhe mësim si për vete ashtu dhe për të tjerët. Kështu, midis të tjerash, ai thekson: “...ne duhet të nxjerrim një mësim. Ne duhet tani të jemi më mbështetës të njëri-tjetrit në raport me interesat madhore të popullit dhe shtetit tonë të cilat janë dhe duhet të jenë të parat. Vështirësi të mëdha na kanë përcjellë në të kaluarën nga veprime që kanë pasur për qëllim primar vetëm përfitimet personale politike, xhelozinë, smirën, paafësinë për të parë më larg. Unë i vuajta të gjitha këto dhe nuk e pata as më vonë mbështetjen që më duhej, siç do ta shihni në këtë libër, në lobimin tim në Uashington për pavarësinë e Kosovës, por as për lobimin për njohjen e saj. Shumë liderë politikë të Kosovës, në atë periudhë, mjerisht dhe sot, ishin pa vizion, pa informacione dhe pa strategji të mjaftueshme, për të zhvilluar një diplomaci aktive, me të gjithë faktorët globalë, e cila në asnjë rrethanë nuk do të binte ndesh me luftën e armatosur, por do të bëhej krah i saj i fuqishëm në skenën ndërkombëtare”.

Por, më tej, ai reagon duke parë dhe përpjekjet politike e mediati-ke për një viktimizim të tij në lidhje me këtë orvatje, aq më tepër që ndërkohë të tjerë përfshi edhe Rugovën u takuan me Millosheviçin (bile në kushte shumë më të dramatike për popullin shqiptar të kohës, aq më tepër që asnjëherë Rugova as nuk u shfaqësua, as nuk u sqarua për këtë gabim të rëndë, qoftë dhe sikur të ishte marrë peng nga paramilitarët serbë). Kjo lloj revolte e drejtë, edhe pse tepër e brendshme, ndjehet dhe në rreshtat pasonjës të autorit: “...Unë edhe tani e them: me Milosheviçin nuk u takova vetëm unë. Pas meje u takuan edhe liderët shqiptarë të Kosovës, që kishin përgjegjësi dhe përfaqësonin popullin e Kosovës ose pretendonin se e përfaqësonin. Unë në atë takim nuk përfaqësova askënd, sepse nuk e kisha atë mandat. Fundja, unë isha një individ i vullnetit të mirë, që u përpoqa të kryeja një shërbim në të mirë të paqes dhe humanitetit, misione të cilat njihen në historinë botërore. Unë personalisht nuk përfitoja asgjë nga kjo situatë. Përkundrazi, e njihja shumë mirë rrezikun që

*më kanosej. Por e bëra, sepse ia vlente”.*

B. Pacolli, nuk e ka shfrytëzuar dhe nuk e shfrytëzon politikën si “kalë beteje”. Ai është luajal në idetë dhe vizionin e tij, pa e fyer apo diskredituar kundërshtarin, duke kritikuar në mënyrë qytetare, por dhe duke pranuar ose vlerësuar atë që, sipas tij, duhet pranuar ose vlerësuar. Kështu, ai, mbështetur në vokacionin properëndimor të shqiptarëve, jo vetëm çmon kontributin e politikës dhe të UÇK-së në këtë aspekt, por dhe kritikon në mënyrë paralele gabimet e bëra. Midis të tjerave, ai shkruan: *“Kjo ishte fitorja më e madhe strategjike e shqiptarëve - Aleanca me perëndimin. Udhëheqësia e UÇK-së, ashtu si dhe Rugova mund të kenë bërë dhe gabime dje në luftë, apo sot në qeverisje, ku gjenden në një mënyrë ose në një tjetër prej dhjetë vjetësh. Por në fazën historike që mban emrin e saj, Faza e UÇK-së, kjo udhëheqësi solli bashkë me perëndimorët njëherësh Lirinë dhe Pavarësinë. Mu për këtë ne duhet t’i nderojmë ata!”...*

Por le t’i kthehemi edhe njëherë modestisë së Pacollit, në rrafshin politik. Për mua, ajo, e mishëruar më shumë se duhet në libër; e thënë ndryshe, në gjykimin tim, ajo më duket më se e tepërt. Aq më tepër që ai është tani një pjesë e rëndësishme e saj. Prandaj, dhe u çlirova menjëherë nga ky “pezmatim” (le ta quajmë të tillë!), kur në libër ndesha dhe shprehjen e famshme të Dë Golit (de Gaulle): *“Politika është një çështje serioze, nuk mund t’ia lëmë atë politikanëve”.* Kurse, diku tjetër, shton: *“Por më në fund e bëra: mendova se kontributi im duhej edhe në këtë fushë, dhe nuk e kemi luksin për më shumë në Kosovë që politikën, këtë zanat serioz, t’ia lemë të paaftëve, dhe të papërgjegjshmëve”.* Sidoqoftë, nga ana tjetër, është fare normale që secili të shprehë si e ndjen vokacionin e tij. Por, ama, nuk duhet harruar se në shumë raste shikimi i gjërave dhe vendimmarrja përkatëse, pavarësisht fushës konkrete, ka përbërësen politike, tepër të domosdoshme. Këtë e ndjen edhe B. Pacolli, madje, me të drejtë, ai e sqaron më së miri në libër konceptin e tij politik. Për ta mishëruar atë sa më drejtë, po citojmë këtu një pjesë të vogël të perceptimit të tij: *“Në këtë rrëfim, më shumë se një herë e kam theksuar se vokacioni im nuk ka qenë politika. Mundësitë për të hyrë në politikë m’u kanë ofruar që herët, që kur pata filluar punë në Gjilan, këtu e afro tridhjetë e pesë vjet më parë, por gjithnjë e konsideroja veten të huaj*

në këtë fushë, për mua krejt të panjohur dhe në njëfarë dore edhe refuzuese. Puna e gjatë në ekonomi-biznes më mësoi të isha pragmatik dhe i drejtpërdrejtë. Kisha përshtypjen se në politikë njeriu duhej të ishte i mbaruar nga një "lëndë" tjetër, të ishte më shumë evaziv, të fliste shumë dhe të bënte pak dhe, mbi të gjitha, të kishte një kod tjetër moral, i cili nuk i përshtatej edukatës sime. Përveç kësaj, kisha përshtypjen se njerëzit merreshin me politikë për të kompensuar mungesat e ndryshme, që mund t'i kishin në fushën profesionale. Ndërsa mua më dukej se nuk kisha mungesa të tilla. Mbi të gjitha, fusha në të cilën unë kisha vepruar për një kohë të gjatë, shumë shpesh gjendej nën trysninë e politikës dhe po kaq shpesh vuan-te pasojat e saj. Ky fakt më shkaktonte refuzim ndaj politikës dhe ndaj njerëzve që merreshin me këtë aktivitet. Pra, me një fjalë, për mua politika ishte një veprimtari, në të cilën nuk kisha menduar se do të përfshiheshin ndonjëherë. Kjo nuk përjashtonte mundësinë që unë, herë pas here, të kisha konceptet e mia politike dhe të ndërtoja vizionin tim politik, varësisht nga situata dhe rrethanat, por ishte vizion që do ta mbaja përbrenda dhe jo të përpiqesha ta jetësoja me instrumente të tilla si partitë. Përvoja jetësore dhe përvoja e gjatë në fushën e biznesit, për shkak të ndërlidhjeve që biznesi kishte me politikën, ma kishin bërë të domosdoshme ndjekjen pothuajse të vazhdueshme të zhvillimeve politike në përmasa globale. Pa një sens politik do ta kisha shumë të vështirë t'i kapja trendet ekonomike, qoftë në Lindje, qoftë në Perëndim. Dinamika e zhvillimeve përgjatë tridhjetë-dyzet viteve të fundit ka qenë e tillë, sa që ishte e pamundur të mos i kuptoje gjërat në varshmëri me ngjarjet politike dhe të zhvillimeve sipas logjikës të saj". Dhe, diku më tej, bën sqarimin më të plotë të këtij orientimi më të drejtpërdrejtë: "...Unë nuk kisha ambicie politike dhe as synoja të bëhesha faktor vendimmarrës për fatin e Kosovës. Kisha vullnetin e mirë dhe një mundësi që m'u hap përpara. Isha i gatshëm të rrezikoja, madje edhe të keqkuptohesha nga bashkëkombësit e mi, vetëm e vetëm të shpëtoja jetë njerëzish. Pra, afrimi im me politikën në Kosovë në atë moment ishte rezultat i këtyre rrethanave dhe jo i ndonjë vokacioni ose i dëshirës sime për të bërë karrierë në këtë fushë. Madje, mund të them se nuk e dua politikën dhe karrierën brenda saj si qëllim në vetvete. Atë e shoh më

*shumë si një instrument për të realizuar një qëllim të rëndësishëm: zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e përgjithshëm të Kosovës, që është ideali im i vetëm në politikë. Nëse politika dikujt i shërben për të bërë mirëqenie personale dhe familjare, atë nuk e dua, sepse një të tillë e kam prej kohësh. Më duhet mirëqenie për popullin tim. Nëse politika dikujt i duhet për të bërë emër, as kjo nuk më duhet, sepse tashmë edhe atë e kam. Mua politika më duhet që Kosovën ta nxjerrim nga kjo prapambeturi dhe t'i hapim asaj perspektivë, duke e bërë kampione të rajonit në zhvillim ekonomik dhe prosperitet. Ky është ideali im dhe kjo ka qenë arsyeja e përfshirjes sime në politikë. Në këtë objektiv s'mund të arrija asgjë, nëse do të isha i vetmuar, me gjithë fuqinë time ekonomike, kështu që duhet të gjeja miq rrugës, për të ecur përpara. E dija që isha i papërshtatshëm për politikën me sinqeritetin tim që mund të lexohet si naivitet. E dija që ata që konsideroheshin si politikisht korrektë, do të keqpërdornin mendimet e mia të çiltra, siç ndodhi shpesh me mua, por isha i pajisur me durim”.*

Problemi i vetëm mbetet përfshirja e tij dhe e partisë së tij në qeverisje. Atëherë mund të vërtetohet, ashtu si më parë në veprimtarinë ekonomike private, edhe sukcesi i tij, por tani në një veprimtari publike. Bile, shumë shpesh, flitet se angazhimi në këtë veprimtari të fundit, praktika konkrete qeverisëse të jep dhe notën reale. Dhe Paçolli me përvojën e tij të jashtëzakonshme duhet të bëhet pjesë e saj, për të shpalosur dhe ndikuar me pragmatizmin e tij. Por, ama, duke hedhur poshtë dictum-in e zakonshëm elektorale: “Fushatën e bëjmë në poezi, qeverisjen e bëjmë në prozë” (“We campaign in poetry, and we govern in prose”), që diku i atribuohet dhe Mario Cuomo-s.

\*\*\*

Nuk jam shumë dakord me emërtimin e popullit kosovar apo të “kosovarëve të rinj”, kur mund të flitet pa ekuivok për popull të Kosovës, në të cilin popullsia shqiptare e kalon 90-95% . Natyrisht, B. Paçolli i qëndron larg variantit të Nexhmedinit (Spahiut) për kombin kosovar, që është tej larg hapësirë-kohës reale, i pafavorizuar apo në kundërvënie me revolucionet bazë të botës globale si: revolucioni



i informacionit dhe telekomunikimit, revolucioni biologjik dhe ai i lidhur me liritë dhe të drejtat e njeriut. Kjo sepse Pacolli e kupton shumë më mirë se të tjerët ndërvarësinë në rritje dhe sovranitetin klasik në rënie në kushtet e globalizimit. Në të vërtetë, ky proces i tillë shfaq, në thelb, rrezikun e homogjenizimit njerëzor sidomos për vende të vogla, me popullsi dhe të ardhura modeste, siç janë Shqipëria dhe Kosova, por dhe të gjitha vendet e tjera të Ballkanit. Parë me këtë sy, kjo duhet të kuptuar dhe tek vetë-integrimi i popullsisë shqiptare nëpërmjet integrimit evropian duhet të qëndrojë forca dhe e ardhmja e jonë njësuere.

Megjithatë, për të mos u shkëputur nga mendimet e autorit, po citoj këtu atë pjesë të rëndësishme të konceptimit të tij: *“Ne kemi mësuar nga historia e shtet-formimit në vende të tjera. Prandaj ne kemi folur të parët për Kosovën e re. Ne kemi folur të parët për kosovarët. Ne e dimë se kombi shqiptar është një, por një trung i shëndoshë kombëtar mund të rritet dhe të forcohet më mirë nga dy degë të forta të tij. Ne e dimë se shteti i ri i Kosovës do të krijojë një identitet të ri politik. Jo identitet të ri kombëtar, por identitet të ri të bashkësisë së kosovarëve të rinj. Ç’do të thotë kjo në përfytyrimin tim? Po e sqaroj që të mos krijohen keqkuptime. A ju duket e arsyeshme që një vend i vogël si yni, që është sa një lagje e një kryeqyteti të madh perëndimor, të funksionojë mbi baza regjionale? Kështu funksiononte feudalizmi, principatat e mesjetës, por ne jetojmë në shekullin e 21-të. Ne nuk duam që dhe fëmijët tanë të vazhdojnë t’i drejtohen njëri-tjetrit varësisht nga fshati a qyteza e babait dhe nënës së vet. Ne duam që ata të ndihen krenarë si kosovarë, si banorë të shtetit më të ri të botës, që i ka themelet e shëndosha dhe që s’guxon të gabojë në ndërtimin e së ardhmes. Ky është identiteti i ri kosovar për të cilin luftoj. Dy degët e kombit do të bashkëjetojnë me njëra-tjetrën, do të konkurrojnë njëra-tjetrën, do të përfitojnë nga njëra-tjetra sot brenda Evropës së bashkuar”. Dhe më tej ai sqaron: “Ne duam një patriotizëm të ri modern! Ne duhet të punojmë për krijimin e një tregu të madh kombëtar, që rruga e madhe e Kombit të mbushet me lëvizje mallrash, kapitalesh, njerëzish; ne duhet të punojmë për krijimin e një tregu të madh rajonal, ku shqiptarët do të jenë të bashkuar mes tyre. Evropa nuk na do ne brenda për problemet tona, por për*

*potencialin tonë ekonomik, kulturor e njerëzor të bashkuar! Kosova e re ka nevojë, pra, për një klasë të re politike. Të reformuar. Kosova e re ka nevojë për burra shteti! Burrat e shtetit vendosin interesin shtetëror mbi interesat e tyre vetjake dhe pushtetin”.*

Sidoqoftë, mjaft interesante në kuptimin e perceptimit politik vetjak të B. Pacollit, është dhe vetë-tipizimi i tij. Pa e komentuar më gjatë (lexuesi mund të qëndrojë më gjatë në këtë pjesë të librit) po rreshtoj këtu vetëm disa karakterizime vetjake të tij: “... *Ju thashë se jam politikan atipik ... Unë jam politikan modest, sepse jam njeri modest...Unë jam politikan jo konfliktual sepse jam njeri jo konfliktual, që nuk i ka borxh askujt... nuk shaj kurrë askënd, përpiqem të gjej anët e mira të gjithsecilit, veprat e mira të rivalëve apo kundërshtarëve të mi politikë, pavarësisht se kjo mund të duket se nuk më bën mirë mua dhe partisë sime, kërkoj të pajtoj palët politike dhe ndoshta në këtë qasje, më duket se jam mbi palët...Unë jam i papërlyer nga politika jo thjesht pse nuk kam qeverisur, por dhe se në biznes askush nuk ka mundur të njollosë veprën time... Unë jam opozitar atipik, pasi me bindje dhe krenari e mbështeta qeverinë në disa hapa të parë të shtet-ndërtimit...Nuk jam diktator, dhe s’kam prirje diktatoriale, diçka atipike për një politikan të viseve tona, që i pëlqen vetja sapo ngjitet lart...”. Por, akoma më pragmatik është dhe klasifikimi apo kategorizimi tjetër: “*Unë jam politikan atipik, ashtu si jam njëllor patrioti atipik. E shoh atdheun te prona, te shtëpia, te varret e të parëve, te rrugët e përbashkëta, te tregu kombëtar, te qarkullimi pa pengesa i mallrave, njerëzve, ideve, te këngët, muzika, interneti. Patriotizmi im sendërtohet në një atdhe i fortë ekonomikisht, dhe jo domosdoshmërisht me ushtri të fortë. Jam për hapjen e kufijve, që do mundësojnë bashkimin e shqiptarëve, diçka që do t’i detyrojë më në fund armiqtë tanë historikë të na kërkojnë ndjesë për krimet e tmerrshme që na kanë bërë në shekuj, dhe të na shohin si të barabartë. Jam kozmopolit, dhe kam folur që herët, që në shkollimet e mia universitare për globalizmin. Jam për hapjen e kufijve, ku duhet të lëvizë lirshëm interesi njerëzor. Unë e shoh globalizmin si respekt për vendin tënd, për origjinën tënde”...E kuptoj dhe e çmoj këtë pozicionim konkret, këtë merak dhe çlirësi të B. Pacollit. I vetmi shqetësim, në gjykimin tim, madje dhe një problem politik në**

vete, mbetet reflektimi i këtij pozicionimi e klasifikimi në mjedisin konkret, në shoqërinë konkrete, në emancipimin tërësor të saj.

\*\*\*

Po ashtu, në libër, Behgjeti shkruan me mjaft thjeshtësi, ngrohtësi e dashuri për jetën e tij, të familjes, miqve e shokëve. Ai, si njëri nga fëmijët e shumtë të familjes u rrit, si shumë të tjerë në Kosovë, pa elektricitet dhe pa ujë të rrjedhshëm. I nxitur nga babai dhe sidomos gjyshi Osman, të cilin e përmend shumë herë në libër, ai si pikësypnim qendror në jetë kishte shkollimin e karrierën. Kjo kuptohet dhe nga fakti që B. Pacolli ka qenë gjithë kohën një nxënës apo student shembullor, në çdo nivel edukimi. Në Prishtinë, ai kaloi katër vite të vështira duke jetuar në një kasolle druri, ndërkohë që udhëtonte 80 km, dy herë në javë, për t'u furnizuar nga familja me ushqime. Ndryshe nga pritshmëria e të atit, me ndihmën e gjyshit (por dhe me kursimet tepër minimale të gjyshit dhe të një të afërmi të tij) ai u nis për në Hamburg, Gjermani. Pas vështirësive të shumta dhe një pune të stërlodhshme për mbijetesë B. Pacolli mbaroi një shkollë të lartë dhe pas tre viteve me një diplomë universitare në ekonomi, një specializim në Marketing e Menaxhim dhe një mori gjuhësh të huaja ai u kthye në Kosovë. Gjatë shërbimit ushtarak, B. Pacolli kontaktoi kompani nga Austria dhe Gjermania, të cilat kërkonin punonjës. Kështu, menjëherë pas mbarimit të ushtrisë (në gardën e Titos), ai iu bashkëngjiti një kompanie austriake, në të cilën ai punoi në sektorin e shitjes për Jugosllavinë, Bullgarinë, Poloninë dhe Rusinë. Dy vite më vonë, ai shkoi në Zvicër dhe filloi punën në një kompani zvicerane me të cilën kontaktet e para i pati që në Moskë. Pak më vonë, më 1976, B. Pacolli u bë njëri nga menaxherët kryesorë të *Interplastica*- kompani inxhinierie e biznesi me aktivitet kryesor në shtetet ish sovjetike. Më 1990, ai themeloi një kompani konstruksioni me bazë në Lugano, Zvicër, që më tej u zhvillua si në një grup i fuqishëm, i quajtur *Mabetex Group*. Ky grup ka pasur një veprimtari tepër të frytshme në Rusi, në projekte nga më të ndryshmet, përfshirë dhe rinovimin e Kremlinit. Po aq i rëndësishëm mbetet aktiviteti i Mabetex-it në Kazakistan, sidomos në ndërtimin

e kryeqytetit të ri Astana, përfshirë dhe rezidencën luksoze të presidentit Nazarbayev, etj.

Më 17 mars 2006, B. Pacolli themeloi partinë politike Aleanca Kosova e Re (AKR), e cila në zgjedhjet parlamentare të vitit 2007 u radhit e treta. B. Pacolli u bë kështu përfaqësues i Kosovës në parlament si dhe anëtar i komitetit të Buxhet- Financës. Në libër, lexohet qartë edhe angazhimi familjar i Pacollit, krahas veprimtarisë intensive ekonomike, angazhimit në çështje ndërkombëtare, ku vendin kryesor e ka zënë çështja e Kosovës dhe njohja e saj. I njohur, siç u përmend më sipër, ka qenë dhe angazhimi i tij në lirim të tre pengjeve (Annette Flannigan, Angelito Nayan dhe Shqipe Hebibi) në Afganistan. Dy vjet më vonë kjo histori e ngjashme u përsërit me marrjen peng të një qytetari italian, (Gabrielle Torsello). Po aq me vlerë konsiderohet dhe aktiviteti humanitar i B. Pacollit. Ai, më 1993, themeloi *“Les Enfants du Sakha”* si një fond ndihme ndaj fëmijëve, për sa i përket kujdesit mjekësor, edukimit dhe argëtimit. Bile, vite më parë, mbi 100 fëmijë janë dërguar prej tij në qendra mjekësore të specializuara të Evropës Perëndimore. B. Pacolli, krahas kontributit humanitar gjatë konfliktit të Kosovës, ka punësuar me mijëra shqiptarë të Kosovës në projektet e tij nëpër botë. Po ashtu, siç rezultoi dhe nga libri, fondacioni humanitar *“Behgjet Pacolli”* ka dhënë një kontribut të paçmueshëm në ndërtimin e Universitetit Amerikan të Kosovës në Prishtinë. Për të gjitha këto vepra humanitare, më 3 Korrik 2010, z. Pacolli u nderua me çmimin *“Kalorësi i Paqes së Mijëvjeçarit”*, nga Unioni Ndërkombëtar për Paqe. B. Pacolli mbulon financiarisht edhe fondacionin SEED (për zhvillimin e Europës Juglindore) dhe njëkohësisht është edhe këshilltar i CSIS (*Center for Strategic and International Studies*).

Siç ndjehet edhe nga libri, në këtë veprimtari humanitare të B. Pacollit ka ndikuar dhe Nënë Tereza. Ja ç’ shkruan ai në libër: *“Unë nuk e dija për çfarë po shkonim në hotel. Në fillim madje, mendova ndoshta për të ngrënë diçka dhe për të kaluar pak kohë aty. Dy motrat e nderit dhe unë shkua në dhomën time, ku ato filluan të mbushnin valixhet e mia. “Tani do shkojmë”, më thotë ajo. E pyese ku. M’u përgjigj: “Ju do të vini te ne, në mision”. Më vendosën në një dhomë shumë të vogël, pa asnjë komoditet brenda, një dhomë*

shumë diskrete. Normalisht unë prisja t'i kisha të gjitha edhe ujin, edhe tualetin. Mbaj mend se për të kryer nevojat personale më duhej të dilja në një korridor të gjatë, ku ndodhej një tualet publik i cili ishte jashtëzakonisht i pastër. Në fund të qëndrimit tim, Nënë Tereza më tha: "Tani paguaj për qëndrimin tënd!" Praktikisht kam paguar çmimin që paguaja në hotelin "Hilton". Ishte ky leksioni im i parë i bamirësisë nga ana e saj, megjithëse prej prindërve, prej gjyshit, axhës, kisha marrë leksione të tjera. Nënë Tereza më dha të kuptoja se nuk kisha përse të harxhoja lekët në hotel kur mund të paguaja aty dhe të ndihmoja shumë njerëz në nevojë. Dua të them se disi u familjarizova me këtë bamirëse të madhe. Ndodhte që kur kisha shumë detyrime të tjera, punoja ditën dhe kthehesha natën. Shpeshherë nuk më linin brenda nëse vonohesha pak”...

\*\*\*

Para se të komentoj “thembrën e Akilit” apo shpirtin ekonomik të B. Pacollit, të prekur dhe në libër, më duhet të theksoj se më është dukur interesant pohimi i tij (pas shpalosjes së variantit të Ban Ki Mun-it) për Mitrovicën apo zonën veriore të Kosovës. Kështu, sipas autorit të librit, Ban Ki Mun-i “*ishte i bindur se e vetmja zgjidhje për Veriun e Kosovës ishte ajo e përmirësimit të gjendjes ekonomike. Unë i fola për një zonë të lirë ekonomike atje, një ide që e përsëris shpesh dhe jam i bindur në dobinë e saj*”. Nuk mund të mohohet se përmirësimi i gjendjes ekonomike është një kusht i nevojshëm, megjithatë ai nuk është i mjaftueshëm. Këtë e kanë dëshmuar shumë shembuj të tjerë në botë, përfshirë dhe atë të Irlandës së Veriut për dekada të tëra. Akoma më keq është, kur krahas të tjerave, edhe gjendja ekonomike e popullsisë është tepër shqetësuese, siç rasti i Palestinës. Në gjykimin tim, krahas zhvillimit ekonomik, paralelisht duhet investuar në rrafshin njerëzor. Pra, akoma më thjesht, duhet ndërtuar kohezioni social, kapitali social apo ai projekt ekonomik-politik dhe social-kulturor që sot tipizohet apo “zbukurohet” me togfjalëshin në anglisht: “shared society”. Parë me këtë sy, më duket shumë më e mundshme, pse jo dhe kohezive “zona e lirë ekonomike”, që thekson me bindje B. Pacolli. Sidoqoftë, kjo është forca

ekonomike e gjykimit politik të tij, të cilën politikanë të tjerë, qoftë dhe të kalibrit të lartë të Ban Ki Mun-it, mund të mos e arrijnë dot. Është eksperiencë e një të vogli që rritet e bëhet i madh, një përvojë jetësore, një “dixhestion politik me ushqim ekonomik”. Aq më tepër, kur bëhet fjalë për një person që, kur flet për tregun, duket tepër i magjepsur. Ja çfarë shkruan ai diku në libër: *“Tregu ishte magjia që më tërhiqte. Prokurimi, apo blerja, procesimi apo prodhimi, shpërndarja ose shitja, e formojnë një zinxhir treunazor procesesh të tregut që s’mund të ekzistojnë pa njëri-tjetrin. Progresi në secilën prej unazave sillte pasoja në secilin prej proceseve. Isha i mahnitur nga shpjegimet e këtyre proceseve, faktorët me ndikim në to, gjatë mësimeve të mia universitare dhe merresha shumë me to duke reflektuar mbi skemat unazore. Në komunizëm, këto procese shiheshin të shkëputur nga njëri-tjetri. Ashtu intuitivisht, apo si pasojë e atyre leximeve të kohës këtyre proceseve unë ua përngjita si faktor përcaktues, vendin ku gjendet biznesi, origjinën e mallit. Sot në kohërat moderne, origjina e mallit, prejardhja e tij, përcakton procesin e globalizmit që ka përcaktuar rregullat e mëtejshme të tregut...”*

Duke analizuar përpjekjet për depërtimin në tregun rus, B. Paccoli, dëshmon edhe qëndrueshmërinë e durimin e tij, tolerancën e gatishmërinë për ndihmë, takticitetin e pragmatizmin për zgjidhjen e problemeve. Ja çfarë thotë ai, midis të tjerash: *“Megjithatë, duheshin respektuar afatet e tyre dhe rregullat e tyre të punës, njësoj si edhe ritmin tepër të ngadaltë, për mentalitetin tonë. Të bëheshe i paduruar në këtë rrethanë, ishte e sigurt se nuk do të arrije askund, sikundër që nuk mund të kërkoje, që asaj pjese të botës t’i imponoje një logjikë pune dhe sjelljeje, e cila atëbotë nuk ishte në harmoni me mentalitetin evropian. Ishte mentaliteti i tyre. Ishte mënyra e tyre e sjelljes. Ishte bota e tyre, e cila kërkonte që të ndryshonte, jo me imponime dhe kthesa të shpejta, por duke i tërhequr ngadalë në një logjikë tjetër të ekonomizimit dhe të prodhimit. Tregu i lirë ishte një mrekulli, që ata ende nuk e kishin shijuar. Dikush nuk e njihte, dikush i frikësohej, dikush tjetër i rrinte larg, sepse e konsideronte të rrezikshëm për sistemin. Pra, ishte një situatë, të cilën, nëse pretendoje ta ndryshoje pak nga pak, duhej ta kuptoje dhe të silleshe me takt. Ndryshe rrezikoje përjashtimin”.*

Kurse në një vend tjetër shton: “*Krenaria ime ishte e ligjshme, për dy arsye kryesore. E para, që idetë e mia kishin funksionuar dhe ishin kurorëzuar me një sukses të padiskutueshëm. E dyta, koha e shkurtër e rindërtimit në një vend ku gjërat lëviznin tepër ngadalë, kishte ndryshuar konceptet e deriatëhershme të ngurta dhe burokratike, se për t’i hapur rrugë të resë, duhej të kalonte shumë kohë dhe një pritje e gjatë...Madje, mund të them me bindje të plotë se munda i investuar për të depërtuar në këtë treg ka qenë përpjesëtimisht shumë më i madh se çdo mund që mund të derdhej për të hyrë në ndonjë treg tjetër. Ishte kohë shumë e vështirë dhe situatë e trazuar, në radhë të parë politike dhe sociale. Të hysh në një treg, ku nuk ka qëndrueshmëri politike dhe ku rrethanat sociale janë kërcënuese, është baras me një aventurë. Shumicën e vështirësive i kam tejkualuar me përkushtim profesional dhe vendosmëri, përfshirë këtu edhe sensin e hulumtimit, njohjes dhe kanuneve morale, që mbështeten fuqimisht mbi vlerat njerëzore.*

... Unë u ngrita përmbi atë që bëja zakonisht, u thellova në studimin e realitetit që kërkohej të ndryshoja, me një qasje jo thjesht të ndërmarrësit, por të sociologut, apo dhe të politologut. Kuptova rëndësinë e kohës dhe të hapësirës në këtë ndërmarrje gjigande, në këtë lloj minirevolucioni shoqëror, që zuri fill me ndryshimin rrënjësor të veshjeve të një shoqërie uniformisht të veshur, një shoqërie shumëkombëshe, që duhet të ishte shumëngjyrëshe, por që mjerisht nuk ishte e tillë. Ajo që bëra, nuk pati vetëm vlera ekonomike, biznesore, që duhet të mbroheshin me një patentë për unicitetin e vet, për risitë teknologjike në atë vend, por pati dhe vlera sociale”.

Këtë e shpreh dhe në analizën për qeverisjen në rrafshin ekonomik. Nisur dhe nga eksperiencia vetjake në vende të tjera, B. Pacolli është i pakënaqur me rrugën ekonomike në të cilën po ecet aktualisht në Kosovë. Ja çfarë shkruan ai, diku në libër: “... Por ndodhi si ndodhi, dhe u zgjodh mënyra dhe modeli më i keq i privatizimit, të cilin unë e kam urreyer, sepse kam qenë i bindur se do të ndodhte pikërisht ajo që ndodhi: u degraduan objektet, u ra vlera, u shpenzuan paratë e privatëve për blerje dhe tani as ka aktivitet prodhues, as ka investime në objekte. ... Me këtë sy kritik po shoh gjithë procesin e pritshëm të kompanive publike të mëdha për të cilin po flitet sot

në Kosovë. Jam shprehur kundër këtij lloj privatizimi (PTK, KEK, Aeroport) apo koncesionimi jo transparent, që do të kryhet në vitin e fundit të mandatit të një qeverie, që shpreson se paratë do të përdoren për ndërtimin e rrugës Vërmicë-Merdare, për të cilën gjithashtu ka pasur mungesë transparence, projekti, paralogarish etj. etj. Jam shprehur gjithashtu kundër kthimit të parave nga privatizimi dhe atyre të Trustit pensional në arkat e qeverisë: ato para duhet të përdoren nëpërmjet një Agjencie të Ardhmërisë së Kosovës, apo të Brezave të kontrolluar nga parlamenti, shoqëria civile dhe prania e huaj në Kosovë dhe duhet të destinohen vetëm në projekte për të ardhmen...pra, politikat ekonomike në Kosovë, pavarësisht se prej kujt janë fuqizuar ato, kanë qenë dhe mbeten shumë të gabuara. Këtë e them pa asnjë ekuivok, sepse në këtë fushë ndihem kompetent dhe i sigurt në konstatimet e mia. Unë arrij të kuptoj shumë qartë dhe thjesht sesa realiste janë ofertat për këtë ose atë privatizim apo koncesionim, sepse unë e njoh mirë tregun ndërkombëtar, njoh parimet e biznesit. Kjo situatë më ka shkaktuar vazhdimisht pakënaqësi, e cila shpesh është kthyer në brengë për të ardhmen e vendit tim. AKR gjatë viteve 2007-2009 si në parlament e ashtu në debatet e veta publike u mundua që ta luftojë këtë fenomen, por këtu mbeti e vetmuar dhe nuk pati fuqi që të ndryshojë, gjegjësisht t`i parandalojë gjërat”. Por, kjo ndodh në politikë, në kuadër të një sistemi demokratik. Duhet të fitosh votën popullore për të qeverisur, por, ama, edhe një qeveri e mirë apo mazhorancë parlamentare realisht demokratike duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me opozitën për shumë çështje me karakter parimor e kombëtar apo, në përgjithësi, në interes të qytetarit-konsumator. Dhe vendimmarrja kryesore ekonomike është tërësisht e tillë! I tillë është dhe vetë procesi i privatizimit!...

\*\*\*

Që në fillim të librit, autori përpiqet të sqarojë, ndoshta dhe të justifikojë, shkrimin e këtij libri. Kjo ndjehet dhe tek pyetje-përgjigjet përkatëse në fillim të tij. “Pse e shkruaj një libër autobiografik?” - pyet ai dhe menjëherë përgjigjet: “Ky libër nuk është vetëm libër i fakteve, por dhe i ideve dhe gjykimeve përgjatë një jete përplot



*kthesa e të papritura. Sinqeriteti - udhërrëfyese kryesor i jetës sime. Cili është çelësi i suksesit tim në jetë?”. Dhe pak më poshtë thekson: “Pavarësisht se ç’qëndrim mund të mbajë njeriu ndaj vetes dhe pavarësisht nga konsideratat reale ose të shtira që mund t’i ketë ndaj bëmave të veta, jam plotësisht i bindur se, bashkë me vendimin për të bërë publik jetëshkrimin tënd, duhet të shpallësh edhe një kod moral të sinqeritetit dhe çiltërisë. Përse të mos jesh i sinqertë? Që ta tregosh veten ndryshe nga ç’je në të vërtetë? Aspak. Nëse përmes jetëshkrimit tënd ke vendosur të hedhësh dritë edhe mbi ato zona të errëta të bëmave tua, të cilat kanë mundur të jenë objekt dyshimesh te njerëzit, këtë nuk mund ta bësh duke vënë në lajthitje lexuesin, as duke gënjyer, as duke i heshtur gjërat”. Por, përsëri, B. Pacolli, edhe pse është i bindur për suksesin e një jete dhe veprimtarie si ajo e tij, qoftë dhe për vlerën e një libri të tillë në shtresime të ndryshme gjeneratash, nuk heziton të theksojë dilemat e veta. Ja çfarë shkruan ai: “Për një kohë të gjatë më ka munduar dilema, nëse jetëshkrimin tim duhet ta bëj të ditur për një rreth më të gjerë njerëzish, pra, që ta nxjerr në libër dhe t’u them lexuesve: Ja, ku e keni! Në dukje të parë kjo është e thjeshtë. Secili ka një jetë dhe secili ka bëmat e tij. Gjithashtu, secili ka të drejtë të rrëfejë atë që ka përjetuar, atë që ndjen. Megjithatë, ekziston një kufizim, ndoshta një urdhërim prej një kodi të pashkruar, i cili thotë se privilegjin e jetëshkrimit publik e kanë vetëm ata, bëmat e të cilëve e tejkalojnë të zakonshmen, kufizimin e të rëndomtës, ku përpëliten shumica e njerëzve të kësaj bote. Që të dalësh mbi këtë rrafsh, pra mbi rrafshin e të zakonshmes, nuk mjafton të kesh vetëm një dramë jetësore, madje as disa, madje edhe nëse kjo dramë arrin të përfshijë në vete fate të më shumë njerëzve. Nuk mjafton as që kjo dramë të jetë disi e veçantë, e papërsëritshme, e ndryshme nga dramat jetësore të njerëzve të tjerë. Dhimbja nuk mjafton, duhet dhe mesazhi. Kur bëhet publik, jetëshkrimi i një individi duhet të përcjellë një mesazh të vlefshëm për më shumë njerëz. Pra, kjo ishte dilema. Cilin mesazh do t’u përcjell unë, me jetëshkrimin tim, lexuesve të gjasshëm? Çfarë do t’u them, në mënyrë që përvoja ime jetësore, e këtyllë çfarë është, t’iu shërbejë për diçka njerëzve të tjerë? Nuk është e thjeshtë të japësh përgjigje në këto pyetje, sepse është e ditur se përvojat individuale, sado kuptimplote që*

*të jenë, ato përsëri mbesin vetanake dhe, që të bëhen “zë kolektiv”, duhet të jenë tipike për një kohë dhe për një komunitet”.*

Unë, pas leximit të librit dhe analizës së tij, pavarësisht aty-këtu pozicionimeve personale për ndonjë çështje të veçantë, ndoshta dhe për ndonjë shfaqje pragmatizmi të “induktuar”, ai pasqyron, në bindjen time, një shembull, një mision, një mundësi, një realitet. Madje, në thelb, dërgimi i këtij mesazhi të librit tek lexuesi e bën shumë më të drejtpërdrejtë detyrën e tij, si në rrafshin intelektual individual-qytetar, ashtu dhe atë shoqëror - politik. Ai jo vetëm mund të nxisë suksesin dhe të frymëzojë karrierën, sakrificën e përpjekjen në gjeneratën e re, dëshirën për shkollim e punë, por dhe mundëson nëpërmjet jetës e veprës, përpjekjeve e angazhimit të vetë autorit, prekjen dhe përjetimin realist të botës individuale e shoqërore për rreth, ashtu siç është, me të mirat dhe të këqijat e saj, me hallet e gëzimet, me dobësitë e fuqitë, me gabimet e përkujdesjet, me rastësitë e domosdoshmëritë, me hapësirat e pafundme e kufijtë e saj. Për më tepër, po e përsëris, shembulli i B. Pacollit, i pasqyruar në këtë libër autobiografik e mishëron më së miri një gjë të tillë...

*Trieste, 10 nëntor 2010*

## Bashkëveprimet e mia me Behgjet Pacollin

*Bujar, mikpritës dhe optimist për të ardhmen. Biznesmen i suksesshëm, një humanist i madh, një zgjidhës problemesh, një burrë shteti i cili dëshiron të kontribuojë me të gjitha cilësitë për një jetë më të mirë për bashkatdhetarët e tij kosovarë, dhe të gjithë popujt e Ballkanit*

*nga William Walker*

**P**ër herë të parë e takova Behgjet Pacollin në shtator 2004. Ishte koha kur udhëtova për në Lugano të Zvicrës si Kryetar i Bordit të Besimit, të të posalindurit Universitet Amerikan në Kosovë (AUK), institucion që premtonte të ishte sfidues. Duhet të shikoja nëse ky biznesmen i suksesshëm ndërkombëtar, i lindur në Kosovë, kishte interes të merrte pjesë në përpjekjet tona për të krijuar një qendër ekselence të arsimit të lartë për Kosovën, dhe rajonin. Nuk kisha asnjë ide se çfarë më priste.

Që nga momenti i paraqitjes, e kuptova se kisha të bëja me një njeri të jashtëzakonshëm.

Së pari, ngrohtësia e mirëseardhjes dhe mikpritja e tij e pakufishme gjatë tre ditëve në vijim mund të përshkruhet si e jashtëzakonshme, dhe çka është më e rëndësishmja, si e singertë. Së dyti, fill sapo unë kisha përshkruar ato çka ishin ëndrrat tona për një Universitet Amerikan në Kosovë (AUK), dhe sapo i fola atij për nevojën e ngutshme për një kampus të ri, z. Pacolli ndali prezentimin tim duke më thënë se ai ishte tërësisht në mbështetje të konceptit tonë, dhe do të donte ta dëftente mbështetjen e vet me një dhurim personal të një madhësie të mjaftueshme për të ndërtuar një strukturë, të cilësisë më të lartë ku do të strehohej universiteti i ri. Brenda disa javësh, z. Pacolli mblodhi arkitektët, inxhinierët, krahun e punës, ekipin, i cili ndërtoi një kampus të bukur, funksional, shtëpia e Universitetit Amerikan në Kosovë dhe krenaria e Prishtinës sot. Vizioni i Behgjet Pacollit, bujaria dhe standardet e larta i dhanë vendlindjes

së tij, Kosovës një strukturë mbështetëse reale për arsimim të klasit botëror. Vitet që pasuan nuk e kanë zvogëluar mbështetjen e tij për Universitetin Amerikan në Kosovë.

Gjatë këtij takimi të parë si mysafir në hotelin e tij, ne gjithashtu shkëmbyem mendime mbi gjendjen problematike të asaj kohe në Kosovë. Në 2004, Kosova ishte në vitin e saj të katërt të administrimit nga UNMIK-u, misioni ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara, i krijuar nga Këshilli i Sigurimit, menjëherë pas konfliktit të NATO / UÇK-së me Serbinë në 1999. Kishte pasiguri të madhe nga të gjitha anët, dhe mjaft ngurrim për të jetësuar plane afatgjatë - në drejtim të investimeve, të biznesit, të ndërtimit të kombit, në privatizimin e njësive joefikase të ekonomisë publike të periudhës komuniste, në rinovimin e industrisë më themelore dhe infrastrukturës, etj - duke marrë parasysh se statusi i ardhëm legal i Kosovës ishte shumë në dyshim. Ishte pavarësia në horizont, si shpresonin shqiptarët e Kosovës? Apo Kombet e Bashkuara do insistonin në një mënyrë ose në një tjetër që Kosova të mbetet pjesë integrale e Serbisë? Prej 2004-ës zhgënjimi dhe pakënaqësia ishte ulur këmbëkryq; pak ose askush prej kosovarëve ishin duke vendosur baste për të investuar në të ardhmen. Siç kam mësuar në bisedimet e para dhe të mëvonshme, Behgjet Pacolli nuk ishte në mesin e tyre. Në të kundërtën, gjatë diskutimeve tona të kahershme, mësova se ai ishte optimist ngaqë besonte se ditë më të mira paskëtaj vinin jo vetëm për Kosovën, por edhe për Evropën Qendrore dhe Jugore si një e tërë. Dhe ai kishte kushtuar kohën e tij, vëmendje dhe burime në investimet aq shumë të nevojshme në fushën e bankave, sigurimeve, projektet e infrastrukturës, dhe shumë më tepër se kaq.

Në ato bisedime të para, Behgjet Pacolli e përshkruante vizionin e tij për një Ballkan të së ardhmes, shumë të ndryshëm nga qoshja aktuale kaotike, e varfëruar e Evropës, një qoshe e shkatërruar nga lufta, që aq shpesh në të kaluarën shpërthente në konflikte të përgjakshme, ashtu siç ndodhi gjatë viteve 1990. Konfliktet në bazë etnike, dallimet gjuhësore, kulturore, fetare dhe armiqësitë, sipas mendimit të tij, nuk duhet të kenë vend në Evropën e shekullit të 21. Nëse Franca dhe Gjermania, Polonia dhe Gjermania, armiq të hidhur gjatë shekujsh, ja mbërrinë të punojnë si partnerë në ndërtimin e një Bashkimi Evropian modern, pse jo shtetet e Ballkanit?

Behgjet Pacolli ma tregoi gërmë për gërmë, ëndrrën e tij të integritit të Kosovës në një kuadër gjithnjë e më të ndërvarur të lidhjeve ekonomike dhe të tregtisë, të transportit të integruar dhe rrjeteve të tjera infrastrukturore - një proces gradual, pa zarar, i cili në mënyrë të pashmangshme dhe në mënyrë paqësore, do të çonte

në një ndërvarësi më të madhe ekonomike midis bashkësisë së këtyre ekonomive të vogla dhe të pambrojtura. Kështu Ballkani do të bëhej një tjetër qoshe moderne e Evropës. Behgjet Pacolli qe i bindur se kjo do të ndodhte, nëse udhëheqësitë politike të vendeve të Ballkanit do të linin mënjanë interesat e tyre të vockla, dhe do të punonin për përfitime politike dhe ekonomike për të gjithë në rajon.

Në vitet e mëpasme që e njoha Behgjet Pacollin, unë kam përjetuar në mënyrë të njëpasnjëshme shembuj të tjerë të shqetësimit të tij dhe pasionit për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, qofshin ato të një individi, ose të një kombi të tërë. Kur ai merret me një kauzë, me një mision, ai është i gatshëm për të investuar kohën e tij, pasurinë e tij personale, mirëqenien e gjithçka duhet për të sjellë një zgjidhje të drejtë dhe praktike. Dy shembuj:

Një mbrëmje, ndërsa unë isha sërish në Lugano, z. Pacolli u njoftua se disa ndër-kombëtarë, në mesin e tyre një shqiptare, ishin rrëmbyer në Afganistan. Pa hezitim, Behgjeti vendosi të udhëtojë në rajon, në përpjekje për të gjetur rrëmbyesit e tyre dhe biseduar lirimin e tyre. Ai fluturoi jashtë vendit një ditë më pas. Perëndia e di atë që ai bëri për të përmbushur qëllimin e tij, se në çfarë rreziku e futi veten, dhe çfarë burimesh shpenzoi - por misioni i tij ishte tërësisht i suksesshëm.

Me kalimin e kohës, në shkurt 2008, Kosova shpalli pavarësinë e saj pa pyetur Serbinë, Behgjeti u përfshi në politikën kombëtare, si kryetar i një partie të opozitës politike në Parlament. Kur qeveria e re u duk e pazonja për të avancuar kërkesat e Kosovës për njohje diplomatike, Behgjet Pacolli u vu sërish në lëvizje. Unë u privilegjova të jem pjesë e një vizite të tillë në Salvador, ku kam qenë ambasadori amerikan gjatë katër viteve të fundit të luftës civile të viteve 1980 në këtë vend të vogël. Pagoi vetë të gjitha shpenzimet, ju drejtua rrjetit të tij të kontakteve në mbarë botën, duke shfaqur një talent të natyrshëm për protokollin diplomatik kur qe e nevojshme, si edhe qasje më të drejtpërdrejta kur duhej - Behgjet Pacolli ka qenë forca lëvizëse për njohjen e Kosovës nga një numër i caktuar vendesh. Kur të tjerët u përpoqën të merrnin merita për këto arritje, z. Pacolli, i la ata të mburreshin. Qëllimi i tij ishte pranimi i vendit të ri nga ana e bashkësisë botërore, asgjë tjetër përtej kësaj.

Behgjet Pacolli është kështu një biznesmen i suksesshëm, një humanist i madh, një zgjidhës problemesh, një burrë shteti i cili dëshiron të kontribuojë me të gjitha cilësitë për një jetë më të mirë për bashkatdhetarët e tij kosovarë, dhe të gjithë popujt e Ballkanit.

## Pse shkruaj për jetën time?

*Pse e shkruaj një libër autobiografik? Ky libër nuk është vetëm libër i fakteve, por dhe i ideve dhe gjykimeve përgjatë një jete përplot kthesa e të papritura. Sinqeriteti - udhërrëfyesi kryesor i jetës sime. Pyetja- cili është çelësi i suksesit tim në jetë?- do të marrë një përgjigje. Besoj se ja vlen diçka të lexosh nga jeta ime, anipse ajo nuk është jeta tipike e një heroi. Kosova ashtu kështu ka shumë heronj. Unë kam zgjedhur ndërtimin sepse dua të lë gjurmë për brezat. Unë kam themeluar qytete dhe kjo nuk është diçka që të ndodh çdo ditë në jetë.*

**P**ër një kohë të gjatë më ka munduar dilema, nëse jetëshkrimin tim duhet ta bëj të ditur për një rreth më të gjerë njerëzish, pra, që ta nxjerr në libër dhe t'u them lexuesve: Ja, ku e keni! Në dukje të parë kjo është e thjeshtë. Secili ka një jetë dhe secili ka bëmat e tij. Gjithashtu, secili ka të drejtë të rrëfejë atë që ka përjetuar, atë që ndjen. Megjithatë, ekziston një kufizim, ndoshta një urdhërim prej një kodi të pashkruar, i cili thotë se privilegjin e jetëshkrimit publik e kanë vetëm ata, bëmat e të cilëve e tejkalojnë të zakonshmen, kufizimin e të rëndomtës, ku përpëliten shumica e njerëzve të kësaj bote. Që të dalësh mbi këtë rrafsh, pra mbi rrafshin e të zakonshmes, nuk mjafton të kesh vetëm një dramë jetësore, madje as disa, madje edhe nëse kjo dramë arrin të përfshijë në vete fate të më shumë njerëzve. Nuk mjafton as që kjo dramë të jetë disi e veçantë, e papërsëritshme, e ndryshme nga dramat jetësore të njerëzve të tjerë. Dhimbja nuk mjafton, duhet dhe mesazhi. Kur bëhet publik, jetëshkrimi i një individi duhet të përcjellë një mesazh të vlefshëm për më shumë njerëz.

Pra, kjo ishte dilema. Cilin mesazh do t'u përcjell unë, me jetëshkrimin tim, lexuesve të gjasshëm? Çfarë do t'u them, në mënyrë që përvoja ime jetësore, e këtillë çfarë është, t'iu shërbejë për diçka njerëzve të tjerë? Nuk është e thjeshtë të japësh përgjigje në këto

pyetje, sepse është e ditur se përvojat individuale, sado kuptimplote që të jenë, ato përsëri mbesin vetanake dhe, që të bëhen “zë kolektiv”, duhet të jenë tipike për një kohë dhe për një komunitet. Ose duhet të jenë interesante për atë komunitet, të ofrojnë veçantësi, të jenë shembull me dramaticitetin apo unikalitetin e tyre. A është e tillë historia ime jetësore? Pasi dikushi ta lexojë këtë libër, mbase do të shprehë skepsë dhe refuzim, dikush tjetër, mbase, do të shprehë miratim. Megjithatë, unë kam një argument, të cilin do ta vendos para lexuesit dhe do ta lë atë vetë që të gjykojë nëse kam të drejtë ose jo: Unë kam përjetuar intensivisht një histori të Kosovës, një pjesë të asaj historie, që duhet të bëhet e ditur, që duhet të shënohet diku. Me këtë nuk pretendoj t’u jap peshë bëmave të mia, as të krekosem, as të bëhem hero. Ashtu, kështu, në historinë e saj të dhembshme, Kosova ka shumë heronj, madje aq shumë, sa nuk arrin të gjejë vend për të gjithë. Rrëfimi im jetësor pikërisht synon të kundërtën: t’u bëjë njerëzve të ditur se historia e bërjes së Kosovës ka edhe anën e saj ndryshe, ka dramën e saj me përjetime fort të çuditshme, ndonjëherë të pabesueshme. Jeta ime nuk i ngjan historive tipike të heronjve.

Ky libër nuk është ama thjesht përmbledhje e fakteve të mia jetësore, të renditura sipas kronologjisë së pasur të viteve që kam jetuar deri më tani, vite të rëndësishme në historinë moderne të Kosovës për mëvetësinë e saj. Ai është dhe pasqyrë e gjykimeve të mia për faktorët që kanë ndikuar në shndërrimin e saj epokal bash në kohët që kam jetuar. Unë fuqishëm mbështes bindjen se bërja e Kosovës nuk ka qenë dhe nuk do të jetë vetëm një proces politik, por edhe proces ekonomik, diplomatik, zhvillimor, arsimor, kulturor, civilizues, integruer, njohës, afirmativ, pra një proces kompleks, ku të gjithë faktorët kanë rëndësinë e tyre të veçantë. Kosovës i ka rënë fati që të bëhet shtet në një rrethanë globale fort të vështirë dhe të ngatërruar. Rruga e saj nuk ka qenë dhe nuk është drejtvizore. As projeksioni i të ardhmes së saj nuk është bardh e zi. Është kjo një tablo me nuanca, ku faktorët shumëngjyrësh ndërlidhen mesveti dhe

kushtëzojnë njëri-tjetrin. Përvoja dhe vëzhgimi im mbi këta faktorë, mendoj se e kanë peshën e vet. Pra, ndërsa kam paraqitur episode të ndryshme nga jeta ime, jo pa qëllim kam ofruar dhe mendime dhe ide të miat. *Unë mendoj prandaj jam*, thoshte një filozof i shquar si Dekarti, duke lidhur shkakësisht ekzistencën me mendimin e njeriut. *Njeriu nuk është vetëm shfaqja e tij fizike, por tërësia e gjithë shfaqjeve të tij*, thotë një filozof tjetër.

Ndërkohë, deri sa gatitesha të përmbyll rrëfimin për jetën time, kam lexuar memoare dhe biografi njerëzish të ndryshëm. Disa syresh më kanë pëlqyer, disa të tjerë më kanë ndjellë refuzim. Por një gjë e kam vërejtur: problemi i ruajtjes së sinqeritetit të rrëfyesit është problemi më i vështirë. Dikush e shpall në krye të herës sinqeritetin si parim udhërrëfyes, fill lidhës të rrëfimit, por që në faqet e para ama bie në grackën e gënjeshtërisë dhe pozës. Dikush tjetër përdor shumë fjalë të zbrazëta, për të bindur lexuesin se rrëfimi i tij është i sinqertë. Dikush i tretë nuk e shtron fare këtë çështje, madje as tërthorazi, gjithnjë me idenë se, më besoi kush ose jo, unë e thashë atë që kisha për të thënë! Përgjithësisht shumë kujtimshkrues tregojnë veten si do të dëshironin të ishin, dhe jo si kanë qenë në të vërtetë. Disa e bëjnë duke fshehur ngjarje nga jeta e tyre, mendime apo gjykime të tyre publike, dhe duke retushuar të vërtetën. Unë si duhet të sillesha? Pavarësisht se ç'qëndrim mund të mbajë njeriu ndaj vetes dhe pavarësisht nga konsideratat reale ose të shtira që mund t'i ketë ndaj bëmave të veta, jam plotësisht i bindur se, bashkë me vendimin për të bërë publik jetëshkrimin tënd, duhet të shpallësh edhe një kod moral të sinqeritetit dhe çiltërisë. Përse të mos jesh i sinqertë? Që ta tregosh veten ndryshe nga ç'je në të vërtetë? Aspak. Nëse përmes jetëshkrimit tënd ke vendosur të hedhësh dritë edhe mbi ato zona të errëta të bëmave tua, të cilat kanë mundur të jenë objekt dyshimesh te njerëzit, këtë nuk mund ta bësh duke vënë në lajthitje lexuesin, as duke gënjyer, as duke i heshtur gjërat. Këtë e bën më së miri duke rrëfyer me sinqeritet dhe duke nxjerrë në dritë



ato argumente që kanë qenë të panjohura, ose më pak të njohura. Në botë nuk ka njeri të pagabueshëm, nuk ka njeri ideal. Përvoja e jetës më ka mësuar, se njerëzit kanë mirëkuptim për gabimet e tua, nëse ua thua të vërtetën, e tillë çfarë është, madje edhe me mundësinë që në një moment të caktuar të kesh bërë veprime të papeshuara mirë, ose krejtësisht të gabuara. Për mua të shpall një kod të tillë që në fillim të librit është diçka më e lehtë. Sepse sinqeriteti im është gati gati proverbial, i gjithënjohur kudo në Kosovë, sa dikush gabimisht apo me tepri e quan dhe naivitet. Madje bash për këtë arsye, unë nuk u bëra asnjëherë politikan tipik. E di që kam paguar kosto për shkak të sinqeritetit, por kjo nuk më dekurajon. Jam i gatshëm të paguaj përsëri, anipse sot që po e shkruaj librin, jam politikan dhe politikani në modë në Kosovë, duhet të gënjejë, duhet të zbukurojë të kaluarën, duhet të fshehë mëkatet. Unë s'dua të jem kësi politikani. Më vjen mirë që gjykimet e mia të kohëve të luftës, të paretushuara në libër përputhen me ato që kam gjetur në memoaret e Bill Klintonit, Madlen Ollbrajtit, Hillari Klintonit, etj, për personazhe të caktuara të historisë sime dhe asaj botërore. Mesa duket sinqeriteti im dhe rruga e drejtë që kam ndjekur, dikur shpërblehen. Por s'po jua zbuloj ato që tani për t'jua nxitur kuriozitetin...

Në një mënyrë ose në një tjetër, me hamendësimet që përmenda më sipër lidhet edhe çështja e objektivitetit. Pavarësisht se çfarë thotë njeriu për veten e tij, edhe atëherë kur me çdo kusht e synon paanësinë, në esencë rrëfimi i tij jo vetëm që do të quhet subjektiv, por edhe do të jetë pashmangshmërisht i tillë. Kjo është e natyrshme. Vetë njeriu është gatuar kështu dhe askush nuk mund ta ndryshojë natyrën e tij. Mirëpo, aftësia për të vërejtur në mënyrë më shumë objektive, ose më pak subjektive, është veçori e personalitetit, e formimit, pra e edukatës, e kodit moral, madje edhe e frymëzuar nga parimi i dobisë. Thënë me një fjalë, unë nuk kam asnjë interes meskin që lexuesin e këtij jetëshkrimi ta vë në lajthitje, duke ia paraqitur gjërat ndryshe nga ç'kanë qenë në të vërtetë. Megjithatë, unë do të

jem subjektiv në këtë rrëfim, por do të përpiqem maksimalisht që ky subjektivizëm të mos cenojë themelet e argumentimit, veçmas atëherë kur veprimet e mia kanë pasur (ose mund të kenë pasur) pasoja më të gjera, apo të provokojnë diskutime, edhe në dëmin tim. Në këtë pikë unë nuk heq dorë nga një parim moral i padyshimtë: të vërtetën e kam mikun tim më të mirë!

Një tjetër çështje që më ka trazuar në këtë rrëfim, mbetet ideja e suksesit që ka udhëhequr jetën time. Nga ky rrëfim lexuesi nuk duhet të krijojë bindjen se arritjet në jetë, qoftë në politikë, qoftë në biznes, ose në fusha të tjera, janë rezultat i do rrethanave të mjegullta, i pleksjes së faktorëve të pamundshëm. As të krijojë bindjen se suksesi është dhunti e mbinatyrshme. Përkundrazi. Në këtë rrugë të vështirë dhe të mundimshme, çdo gjë është tokësore, çdo gjë është brenda natyrës së njeriut, brenda aftësive, kreativitetit dhe përkushtimit të tij. Natyrisht, askush deri më sot nuk ka arritur të përcaktojë një formulë, zbatimin e së cilës e çon njeriun deri te arritja e një qëllimi. Unë mund të them se në situata të ndryshme, unë kam projektuar dikë që kam zgjedhur t'i ngjaj, ta korrigjoj, dhe me gjasë edhe ta kapërcej atë. Pra në varësi të situatës dhe individit të zgjedhur si prijës shpirtëror, unë kam vendosur dhe qëllimin apo objektivin që duhej të arrija. Por kaq nuk mjafton: njoh plot njerëz plot qëllime të mira, por vullnetpakët! Nëse ka diçka që mund të quhet si përvojë e vlefshme në këtë rast, ajo përsëri ka të bëjë me një postulat të njohur dhe të sprovuar në çdo rrethanë: me punë dhe përkushtim arrihet çdo gjë. Rrethanat objektive dhe subjektive mund të të ndihmojnë ose të të krijojnë pengesa nga më të ndryshmet. Mirëpo, ato asnjëherë nuk janë të tilla që të ta bëjnë të pamundur arritjen e një qëllimi, sikundër nuk mund të jenë aq të favorshme, sa të të çojnë vetvetiu rrugës së suksesit.

Gjatë kohëve të fundit kam hetuar një interesim të madh, në kontaktet e mia në facebook, (harxhoj kohë duke biseduar me simpatizantët e mi në të) apo gjetiu, veçanërisht në takimet me të

rinjtë, për rrugën, apo rrugët sesi unë arrita tek suksesi. Në këtë libër do të gjeni shumë prej shpjegimeve në lidhje me këtë pyetje krejt normale. Është e kuptueshme se një pjesë e mirë e tyre do të lidhet me *ndërtimin*. Pra tek *raporti im me ndërtimin*, që është *raport shpirtëror* para së gjithash gjenden shumë prej atyre arsyeve. Ky raport imi me ndërtimin nuk është ama thjesht raport shpirtëror. *Unë e kam parë dhe e shoh raportin me ndërtimin dhe si raport me kulturën*. Sigurisht unë kisha vendosur që herët një raport me kulturën, por që më pas do të konsolidohej nëpërmjet aventurës sime në ndërtim që rezultoi, pjesa më e suksesshme e aktivitetit tim ekonomik. Do mundohem që në krye të këtij libri të jap një shpjegim të plotë për pyetjen e miqve të mi, duke besuar se pasi të kenë shtënë në dorë me ndihmën time disa çelësa leximi, e pasi të kenë kuptuar më shumë rreth raportit tim me kulturën atëherë do zhyten me më shumë interes në leximin e jetës sime.

Seicili e din se unë vij nga një fshat malor dhe nuk trashëgoja asgjë materiale nga prindërit e mi, të cilët nuk kishin patur mundësi të shkolloheshin në nivele të epërme. Ndërkohë në moshën e shkollimit elementar mua më interesonte diçka përtej së përditshmes, të zakonshmes së jetës që kisha. Si fëmijë më interesonte çdo letër që gjeja në rrugë, ta merrja, ta lexoja. Të kuptoja më shumë rreth botës. Dëshira ime ishte veçanërisht të familjarizohesha, të mësoja gjuhë të huaja si mjete që do të më afronin me këtë botë, apo do të më fusnin në kontakt me të dhe njerëzit e saj. Gjuha frënge që e zhvillonim në fillore dhe Normale më interesonte shumë, aq sa që në klasë të tetë unë fillova të komunikoj me mësuesin tim në frëngjisht. Më inkurajonin komplimentet e mësuesit akoma dhe më shumë, aq sa frëngjishtja që kam sot vjen pikërisht prej atyre kohëve. Kjo që po ju them është plotësisht e vërtetë, pasi që prej atëherë unë nuk kam patur rast të studioj apo të jetoj në ndonjë mjedis frëngjishtfolës. Në qasjen time kurioze drejt botës më pëlqente edhe gjeografia, të isha në kërkim të realiteteve të tjera gjeografike, më pëlqente lundrimi

në hapësirën e madhe sferike të globit.

Ky ushqim nuk ishte i vetmi. Më duhej dhe ushqim shpirtëror. Më pëlqente dhe letërsia, dhe në mënyrë të veçantë ata shkrimtarë që përshkruanin jetën reale të kombit tim si Migjeni. Më pëlqente jashtëzakonisht shumë ky shkrimtar i talentuar, bukur i sofistikuar për moshën që kishte, metaforat e tij të forta, vizatimi i pamëshirshëm i realitetit të kohës që jetoi. Më pëlqenin dhe romantikët- ata ofronin një vizion të asaj që duhet të ishte, të një Shqipërie të dëshiruar, por më pëlqente dhe Çajupi, që ishte një njeri që kishte investuar shumë për çështjen shqiptare. Mbjaj mend përmendësh prej atëherë dhe poezitë e Esad Mekulit,-vajza e tij ka aderuar në partinë tonë tani. Këta ishin idhujt e mi në letërsinë tonë kombëtare, dhe sigurisht Naim Frashëri me vargjet e tij për atdheun dhe malet. Duke lexuar veprat e tyre, arrija të kuptoja sesa shumë nevojë kishte kombi ynë, populli im për njerëz që t'i dilnin në krah. Isha i impresionuar me udhëheqësit e kombit si Ismail Qemali apo Hasan Prishtina që lanë pas një trashëgimi të madhe në historinë e shqiptarëve.

Shkolla normale që unë kam frekuentuar nuk ishte zgjedhja ime, dëshira ime, por e prindërve të mi, për shkak se duke ndjekur atë kishte më shumë mundësi të merrja ndonjë bursë. Unë ndërkohë e dija se asnjëherë nuk do kufizohesha në mundësitë që më ofronte ajo shkollë. Për këtë shkova tre vjet dhe kalova në vitin e katërt të gjimnazit, pra në një shkollë që të ofronte formim më të përgjithshëm. Asokohe thonin se gjimnazi i Prishtinës ishte një shkollë e aristokracisë, por pikërisht diferencat shoqërore që kisha me njerëzit që takova atje, kryesisht nxënësit që ishin vërtet fëmijë të "aristokracisë së kuqe", përfaqësuan motivin më të fortë që unë ta shpërtheja rrethimin social dhe psikologjik duke dalë prej gjendjes ku isha. Gjatë gjithë vitit të katërt unë lëkundesha mes idesë që më në fund u poq: unë duhet të bëja diçka tjetër. Nuk ishte ajo që unë doja. Siç do të tregoj më vonë në libër, ajo që ndodhi, është dëshmia më e mirë e asaj që them diku se vullneti i mirë dhe dëshira janë gjysma



*Foto nga ndërtimet e tona*

e suksesit. Sot dikush në mënyrë malinje ose jo, më bën vërejtje se nuk flas mirë, apo se nuk di të flas shqipe duke e lidhur këtë cilësi të të ligjërimit tim me shkollimin. Nuk dua t'u jap një përgjigje të drejtpërdrejtë pavarësisht se ky është një paradoks i madh: kam

studimet akademike nga më të mirat në Evropë dhe vetëm punët e mëdha që kisha më penguan t'i përgjigjesha negativisht ftesës së profesorëve të Institutit Mössinger për të doktoruar. Dua të them se ka diçka të vërtetë në këtë vërejtje anipse malinje të ndokujt: ligjërimi apo formimi akademik në gjuhën shqipe tek unë nuk u plotësua. Për pasojë shqipja ime nuk është e pasur, por unë di shumë mirë gjuhën e të parëve të mi, plot me fjalë të bukura shqip. Besoj se nëse përqëndrohem arrij të flas një gjuhë konceptuale të shëndoshë. Siç do të vëreni në këtë libër, unë do shkoja në Hamburg në vitin shkollor 1969-1970 dhe mbas gjashtë muaj kurs intensiv mora certifikatën e gjuhës gjermane që të mundësonte të filloja katedrën e parë të ekonomisë ndërkombëtare pranë Universitetit të këtij qyteti. Asgjë nuk ishte e dhuruar- jeta ime ishte shumë e vështirë, sepse pos mësimit duhet të shpërbleja nëpërmjet punës miqtë që më strehonin në shtëpinë ku banoja. Gjatë atyre viteve të universitetit unë nuk dija ç'ishin diskoteka, restoranti apo dëfrimet e tjera të zakonshme për rininë e asaj kohe apo aq më shumë për rininë e sotme. Unë u ktheva në shtëpi për të kryer shërbimin e detyruar ushtarak, mbas një pune të shkurtër në Gjilan dhe ndiheshja akoma se nuk isha i plotësuar. Unë doja akoma diçka tjetër, por për realizimin e saj nuk mjaftonte vetëm dëshira e madhe, por duhej dhe stërmundim i madh. Në planin sentimental ndija dhimbje t'ja ktheja shpinën për herë të dytë njerëzve të mi. Por mundësitë relative që më ofroheshin në Kosovë nuk më mjaftonin. Puna që bëja në departamentin e zhvillimit të atij kombinati njerëzve përreth u dukej shumë atraktive, por jo mua. Sukseset e mia të para ishin të mundimshme. Në mjediset e një kompanie austriake ku punoja, ku muret ndarëse mes zyrave ishin shumë të hollë, unë dëgjoja shpotitë e kolegëve austriakë rreth meje, dhe pikërisht këto shpoti prodhuan motivim të fortë tek unë: pa një sukses të shpejtë, unë do ta kisha të vështirë të mbijetoja në një botë të ashpër si ajo kapitaliste. Fillova të studioj rreth diçkaje që do nevojitej shumë në atë zyrë ku punoja e që lidhej me vendet



*Foto nga ndërtimet e mia*

e lindjes. E dija se Polonia kishte krah të lirë pune të angazhuar intensivisht, dhe këtij vendi i duhej ofruar teknologji e re. Pata sukses në sigurimin e kontratave të reja për kompaninë time *Peter Zimmern*. Vendosa që kohën e kufizuar që kisha, ta kompensoja me dëshirën dhe investimin shpirtëror, si bazë e mirë për sukseset e mia të ardhshme që kapërcenin pritshmëritë e të tjerëve rreth meje.

Angazhimi im i parë profesional në përfundim, ishte i mbështetur tek shitjet e makinerive. Unë nuk isha ndonjë talent i madh, nuk kisha ndonjë përgatitje profesionale, sepse po tregëtoja produkte si makineritë e tekstilit që ishin shumë të komplikuara, por sukcesi im vinte prej ndjenjës së barazisë që unë i krijoja të tjerëve.

Në vitin 1977 kur udhëtoja për herë të parë në Rusi ku do firmosja kontratën e parë isha përplot kuriozitet dhe kënaqësi që po shkoja në vendin e leximeve të mia, të autorëve të mi të preferuar



Foto nga ndërtimet e mia

nga shkolla. Ne lexonim vepra të shkrimtarëve të mëdhenj rusë si Leon Tolstoj (Ana Karenina), Sergej Esenin apo Aleksandër Fadejev dhe të shkrimtarëve të mëdhenj rusë që e përshkruanin si idilikë mjedisin rus. I kam akoma në mendje vargjet e Fadejevit për *erën që*



frynte flokët e një vajze, apo ndiej akoma trishtimin dhe pesimizmin që buronte prej vargjeve të Eseninit. Po shkoja i armatosur me një epërsi në atë vend: unë shpirtërisht isha i predisponuar të flisja diçka në nivelin e tyre, për tema jashtë kontratës, duke vendosur me palën tjetër një raport njerëzor, pothuaj një miqësi. Diskutoja për problemet e tyre sikur të ishin të miat, duke u krijuar idenë se dhe unë jetoja me ato probleme, diçka që vendos besimin me tjetrin përballë. Ai të njeh kështu si një mik të sinqertë me të cilin mund të bashkëpunosh. Edhe sikur të mos ishe shumë profesional, ti i plotësoje mungesat e tua me materiale të shkruara. Por mirëkuptimi shpirtëror ishte themelor në sukseset e mia.

Kalimi im mbas një viti në Zvicër ishte një thirrje- unë kërkohesha prej të tjerëve, prej shefit tim të ardhshëm që bazohej posaçërisht në suksesin tim. Sado e vogël të jetë puna jote, kur je i suksesshëm në të, ekziston gjithnjë dikush që arrin ta vëzhgojë dhe të bëhet i vetëdijshëm për suksesin dhe meritat e tua. Edhe kalimi në funksionet më të larta të shoqërisë *Interplastica* kishte në themel të saj sinqeritetin, dhe rreth meje kishte besim të plotë. Rastësisht? Jo, sepse unë kurrë nuk abuzova me pozicionin tim, megjithëse kisha mundësi të përvetësoja shumë. Isha plotësisht i ndershëm, dhe i sinqertë sikur ajo kompani të ishte e imja..

Shndërrimi im nga punëmarrësi në punëdhënës ishte fillimi i realizimit të ëndrrës sime të kahershme. Ishte pak i imponuar, por duhet t'ja filloja një fushe tjetër që për mua ishte krejtësisht e panjohur, si ndërtimi. T'ju them të drejtën dhe sa kohë që isha në *Interplastica* shihja me kuriozitet rrënimin e pallateve të një arkitekture perandorake që dikur kishin qenë shumë të bukur dhe që sistemi i atëhershëm i kishte trajtuar në një mënyrë të papërshtatshme. Kur fillova të merresha me ndërtimtari, mendoja sesi do dukeshin sot ato pallate dikur të bukur, nëse do të ripërtëriheshin apo do të renovoheshin. Ky ishte frymëzimi im i parë që unë të merresha me ndërtim. Të krijosh diçka, jo një diçka që konsumohet dhe harrohet,

por mbetet aty duke i shërbyer njerëzimit, duke u bërë pjesë e historisë- kjo ishte diçka që ta afronte vetëm ndërtimi. Nuk më mjaftojnë vetëm fjalët, vizatimet apo paraqitjet e ndryshme teknike për ta përshkruar këtë, duhet imagjinatë, duhet shumë më shumë. Dhe me këto ide, unë u zhyta në një aktivitet të ri, jo më shitje makinerish ku kisha patur shumë suksese, por në ndërtim. Diçka krejt e re në të gjithë planet. Biseda e parë që unë bëra me Zyrën e projekteve *Biro 71* të Sllovenisë, pas formimit të *Mabetex-it*, ishte si unë mund të realizoja një projekt që jo vetëm të paraqiste dukjen e jashtme me të gjitha karakteristikat, por dhe funksionalitetin e brendshëm të një godine. Kisha ardhur tek bindja se vetëm me një vizatim dydimensionalësh nuk e jepja të plotë idenë e një ndërtimi dhe vendosa t'ja mësyja Amerikës ku kisha dëgjuar se ekzistonte një teknikë e re paraqitje të projektit në 3D (tre dimensionalësh), veçanërisht për interieret. Arrita kështu që duke punuar në një projekt të një spitali që askush nuk ma kishte kërkuar, ta paraqisja në 3 dimensione. Kisha rastin kështu që për herë të parë në vendin ku po punoja, në ministrinë e ndërtimit, në një prani të madhe të njerëzve t'ua paraqis atë projekt në 3D, diçka e pabesueshme për atë mjedis ku gjendej një njeri, një inxhinier që i njihte spitalet- ai ishte Spindler. Kjo lloj paraqitjeje përfaqësonte një revolucion për ata që gjendeshin atje, ndaj mu desh ta përsërisja dy herë prezantimin. Kudo filloi të flitej për këtë. Pikërisht ky moment, pas fitimit të një kontrate të parë në Kombinatin e Stari Oskolit, shërbeu shumë që të fitoja një kontratë të madhe në Jakutskin e largët.

3D nxiste shumë kreativitetin. Më vonë duke parë suksesin e kësaj gjetjeje, kureshtja, sadsifaksioni në këtë lëmi të re të ndërtimtarisë ishte më i madh se kurrë më parë. Fillova të punoja në Lugano në zyrat e mia, në projekte që kapërcenin brendësinë e një ndërtese dhe shkonin në projektimin e një kompleksi urban. Me kalimin e kohës dhe avancimin e teknologjisë 3 D, ne paraqisnim projekte shumë më tërheqës, me të gjithë funksionalitetet. Mbas kontratës së rindërtimit

të një institucioni të rëndësishëm, në kohën kur vendasit ishin të gatshëm të merrnin dikë që ishte në treg- unë isha aty- fillova të jem i vetëdijshëm për situatën që u krijua rreth meje dhe kompanisë sime. Mabetex-i, po faktorizohej dhe po shndërrohej në një nevojë për klientin tim, kryesisht institucionet. Falë kontakteve të mia që u krijuan gjatë rindërtimit të atij institucioni, duke dëgjuar refuzimin e të parit të vendit për trashëgiminë komuniste dhe aspiratën e tij për t'i rikthyer vlerat e dikurshme të vendit, unë fillova të realizoj idenë sesi do dukej kompleksi kryesor i institucioneve të atij vendi nëse sot do ishim ne që do ta ndërtonim. Po flitej gjithmonë e më shumë për të asokohe, një kompleks i rrënuar prej regjimit komunist 70 vjeçar. Me iniciativën time unë shkova në Bibliotekën Kombëtare ku gjeta projektet e vjetra të shekullit të 17, të arkitektit të asaj kohe. Edhe pse të dëmtuara shumë, ja arrita që pjesën më të madhe ta riprodhoja dhe ta sillja në Lugano. Në këto risi profesionale, unë gjithashtu zbatova një parim tjetër në punën time: unë ja shtija në mend klientit tim idetë që ai t'i bënte të vetat, dhe nuk isha në pritje të kërkesës së tij. Unë nuk isha vetëm kreativ, por kisha dhe iniciativë. Kështu pa kompensim, unë arrita të paraqisja një projekt ku ishte shlyer çdo gjë komuniste dhe ishte kthyer origjinaliteti dhe madhështia e projektit të vjetër. Unë e binda nomenklaturën e vjetër komuniste se kjo gjë duhej bërë prej tyre. Prej këtij prezantimi, lindi gati gati si nevojë e domosdoshme ideja e rindërtimit të kompleksit që thashë të cilën ata s'mund ta refuzonin. Kështu unë isha automatikisht i privilegjuar në raport me firmat e tjera perëndimore të cilave i duhej kohë për të studiuar atë që do të bënin.

Transferimi në Kazakistan në vitin 1996 ishte gjithashtu i shenjuar nga kreativiteti. Këtu më mungonte emri ama. Unë propozova një zgjidhje urbanistike, por duke mos qenë aq i njohur sa në vendin ku punova më parë, do ta kisha më të vështirë. Kjo më motivonte akoma më shumë, por vendosa dhe diçka tjetër. Të përfshija në projektet e mia emrin e ndonjë arkitekti të njohur botëror. Të projektoje një

qytet të shekullit 21, duhej një emër i madh si Kurakawa. Në disa raste, duhet të kesh pjekurinë e nevojshme ta kuptosh se nuk je mjaftueshëm i madh që të bësh vetëm vetë projekte të caktuara, por duhet të përfshish të tjerë, emra të mëdhenj.

Kështu ndodh në të gjithë projektet e mia, ku janë idetë e mia, të realizuara dhe të vështuara shumë bukur me teknika të përsosura të cilat të shtojnë kureshtjen ta shikosh projektin. Kur ti arrin që klienti ta mbajë projektin tënd mbi tavolinë duke mos e flakur gjëkund, praktikisht thuajse e ke arritur ta fitosh realizimin e atij projekti. Është cilësia që e veçon atë nga të tjerët që nuk gjenden para syve të klientit mbi baza ditore.

Por *estetika* është element i rëndësishëm, ama që nuk arrihet dot nëse nuk ke *sadisfaksion* në realizimin e tij. Përmbajtja e një projekti përfaqson nevojat e klientit, por përmbushja e nevojave nuk mjafton, nëse nuk dekorohet. Ky dekorim duhet të përmbajë gjurmë të historisë së atij kombi, duhet të jetë shkruar në gjuhën e atij kombi që të kuptohet prej tij, të jetë i shkruar qartë, që ai të shndërrohet në nevojë e klientit. Ti paraqet një lagje të tërë, me parqe, me shkollën, mjedise rekreative, etj, dhe nëse ti paraqet brenda tyre një pjesë të kulturës së atij shteti, projekti yt ka shumë shanse të realizohet.

Një gjë të tillë, këmbëngula ta bëj në *Pallatin e Rilindjes* në Prishtinë, megjithëse aty mu imponua realizimi i një projekti prej dikujt tjetër. Ndaj gjatë gjithë realizimit u ballafaqova shpesh me klientin, i cili nuk ishte në gjendje të kuptonte pse i propozohej diçka krejt e ndryshme nga projekti i imponuar. Përshembull ata ishin të mësuar me njëlloj klimatizimi, por unë pasi i prezantoja të gjitha llojet e klimatizimit, i propozoja diçka të re. Prezantimi ndërkohë duhet të bëhej në mënyrë të tillë, që klienti të mos ketë më asnjë pyetje.

Po ç'përfaqëson angazhimi im në një projekt të një lagjeje, apo të një qyteti ta zemë? Siç dihet unë nuk jam as inxhinier, as arkitekt. Megjithatë unë përfshihem në çdo detaj të një projekti; unë arrij të hedh çdo ide timen në letër së bashku me arkitektët e mi, çka

përfaqson një burim shtesë kënaqësie për mua. Unë investoj dashuri në një projekt, dhe ai është i suksesshëm vetëm nëse e dua atë. *Bukuria, nevoja, funksionaliteti, dhe mundësitë financiare* të klientit janë elementët bazë të projektit. Në bukuri investohet me elementë të kulturës së atij vendi.

Gjithsesi, projektimi është element thelbësor nga ku nuk duhet të heqësh dorë. Mund të ndërhysh vetëm tek dekorimi, nëse janë përsosur teknologjitë.

Unë kam ndjekur gjithmonë çdo hap të ndërtimeve të mia.

A kishte në këtë sukses timin, ndonjë ndikim të kulturës së ndërtimit të vendit nga vija? Jo dhe aq për fat të keq. Kosova praktikisht sot nuk ka elementë ndërtimesh historike që të jetë ndërtuar prej bashkëvendasve të mi, ndërsa për fat të mirë në Shqipëri gjenden akoma gjurmë të tilla. Duke ju drejtuar Kosovës mund të them se ndërtimet e sotme janë improvizime, nuk janë funksionale, nuk janë të qëndrueshme, por prej materialesh të diskutueshëm. Por kjo s'do të thotë se Kosova nuk ka fare traditë ndërtimi. Mund të thuhet se ajo u krijua gjatë viteve 60-70, por ama mbaroi shumë shpejt.

Ndërtimi i Astanasë, kryeqytetit të Kazakistanit nga e para përfaqëson një angazhim të madh në karrierën time profesionale. Diçka që u kurorëzua me sukses, sepse u punua në shumë drejtime. Ajo që ne bëmë nuk ishte thjesht vetëm ndërtim! Të projektosh një kryeqytet, duhet të lexosh histori, sociologji, demografi, etj. Të themelosh një qytet nuk është diçka e zakonit!

Për të arritur tek suksesi duhet të kesh një vizion pikësëpari. Ti do të planifikosh diçka që do të rezistojë kohës. Si munden përshembull që arkitektët e kohës së karrocave të kenë arritur të projektojnë rrugët ku sot lëvizin makinat? Kanë patur vizion: vizioni ynë në ndërtimin e Astanasë ka parashikuar ndërtimet e dyqind vjetëve. Nëse do hidhja një sy në qytetet e mëdha botërore, Uashingtoni ka vizion më të mirë ndërtimi sesa Njujorku përshembull. Rindërtimi i Londrës pas një zjarri të viteve 1660 imponoi një vizion të ri dhe të

qëndrueshëm për atë qytet.

Vizioni është një element thelbësor që të ofron mundësinë e shikimit tërësor të një projekti. Nevojat janë elementë gjithashtu të rëndësishme. Përshembull ti duhet të dish sa njerëz do banojnë në një kompleks urban në mënyrë që të projektosh mjediset e përbashkëta? Duhet të ketë hapësirë më të madhe për lëvizje dhe ti duhet ta parashikosh atë. Sot është trendi të banohet në ndërtesa të ulta, ndryshe nga një periudhë tjetër e mëparshme.

*Kultura lokale dhe tradita* e një vendi duhet marrë parasysh. Përshembull, kur ne projektonim një ndërtesë në Kazakistan, ne e dinim se në kulturën kazake, vendi i mysafirëve duhet të jetë veç nga pjesa ku jetojnë të tjerët. Gërshetimi i dy periudhave historike në një kompleks të ri urban, apo në një godinë afër një të vjetre është i rëndësishëm. Phoster, arkitekti më i famshëm anglez është i njohur për harmonizimin e të vjetrës me të renë.

*Harmonia arkitektonike* në ndërtimtari është element thelbësor. *Funksionaliteti* është gjithashtu element thelbësor. Unë lexoj shumë literaturë arkitektonike dhe veçoj si mjaft të rëndësishëm shfrytëzimin racional të hapësirës së brendshme, ndërkohë që përgjithësisht arkitektët i japin rëndësi vetëm dukjes së jashtme. Përshembull dikush ka preferencë për ndërtime trekëndëshe, ku humbet hapësirë. Në një shikim historik ndërtimet mesjetare, apo të fundit të mesjetës janë më racionale, sepse kanë shfrytëzuar çdo kënd të hapësirës së brendshme.

Sot unë jam në politikë e cila më lodh shumë, dhe shpesh kur dua të çlodhem dal prej zyrës së partisë dhe në vend të shkoj në shtëpinë time, shkoj në kantieret e mia, dhe çlodhem atje. Dua të jem pjesë e çdo lëvizje, e çdo zhvillimi të projekteve të mia. Kështu bëj me çdo punë dhe me siguri dhe në punët e shtetit do bëja të njëjtën gjë.

*Ndërtimi është krijimtari.* Ti shpenzon kohë, energji, mjete, dhe ajo që ti bën mbetet aty. Është krejt ndryshe nga çdo aktivitet tjetër, sepse ajo që ti ndërton mbetet. Ajo që ti ndërton do jetë në shërbim

të njerëzimit, njerëzit do ta prekin, do ta admirojnë, me breza të tërë. E gjitha kjo është burim i madh dhe unik i krenarisë sime për mua. Unë e kam zgjidhur prej kohësh dilemën pse nuk merrem me biznese të tjera. Përshembull pse s'merrem unë me tregëti? Do bëhesha një tregëtar i madh, por kështu unë s'do të krijoja asgjë. Unë dua të investoj në krijimtari. Shpirti investohet në krijimtari. Suksesi nuk arrihet vetëm me investim të mjeteve, të parasë, por ai është harmonizim i parave, kohës dhe shpirtit. Interesi i çdokujt duhet të jetë i përfaqësuar në një vepër. Interesi është produkt i vullnetit. Nëse nuk ke vullnet, atëherë nuk ke interes.

Çelësi i suksesit tim është dashuria e cila nga ana e vet ushqen një entuziazëm të pafund për të punuar. Sukseset i kam arritur duke investuar shpirtin dhe duke respektuar të ngjashmin tim. Gjatë rrugëtimit tim të gjatë jetësor, suksesin e kam konsideruar jo si e arritur vetjake, por si kontribut i të gjithë pjesëmarrësve në atë proces ku interesat e tyre janë përfaqësuar në mënyrë harmonike. E them këtë, për shkak se Kosova e ditëve të sotme ka një potencial të jashtëzakonshëm të fuqisë mendore dhe kreative, posaçërisht të rinjtë, i cili në një të ardhme të afërt duhet ta dëshmojë veten në të gjitha fushat. Ndryshe Kosova nuk do të quhet rrëfim i suksesshëm. Gjenerata jonë, e cila u gjend në kapërcyell të zhvillimeve historike të mëvetësisë, tani e ka për obligim ta çlirojë këtë potencial, që akoma rri disi i fjetur te brezat më të rinj. T'i japë shans secilit. T'i japë mundësi atij të riu që ka ide dhe është i përkushtuar. T'i japë shtysë suksesit. Unë po e bëj timen, duke ofruar me këtë libër shembullin tim modest drejt suksesit i cili më çoi mua prej Marecit në një angazhim të madh ndërkombëtar siç është themelimi i qyteteve, madje i kryeqyteteve botërore. Uroj shumë që dikush i gjendur në rrethanat e mia, në secilën prej etapave jetësore, të njohë veten në këtë libër dhe t'ia nisë më i përgatitur rrugën e jetës.

## Fëmijëria

*Mareci, sa shumë legjenda në një fshat që dikur më ngjante shumë i madh! Të afërmit e mi... Gjyshi Osman, udhëheqësi im i parë dhe amanetet e tij që më ndoqën gjithë jetën. Si refuzoi babai të shkonte në Turqi. Shkolla ime e parë...*

**T**ë lindësh në Marec, nuk mund të thuash se Zoti të ka privilegjuar aq shumë, megjithëqë unë e dua vendlindjen time, si çdokush tjetër dhe nuk e ndërroj me një tjetër kudo qoftë në botë. Sapo të hapësh sytë, kur gjendesh në vendin e të parëve të mi dhe të shikosh të katër anët e horizontit, çuditërisht të duket sikur qëndron mbi kurrizin e botës. Pastaj, të krijohet ideja se Krijuesit të tokës dhe gjithësisë i kanë mbetur në dorë një grusht malesh e kodrinash, të cilat nuk ka ditur ku t'i vendosë, prandaj, i shkujdesur dhe i pavëmendshëm, i ka hedhur grumbull në një vend, atje ku mbaron fusha e gjerë e Kosovës. Sipër atyre kodrinave është vendosur qielli, i cili e mbyll botën si nën një kambanë qelqi. Është një botë disi e veçantë, një peisazh që i bën përshtypje çdo vizitori, i këndshëm për t'u parë, por shumë i vështirë për të jetuar në të. Po qëndrove më gjatë në këtë vend, pamja e këtyre viseve të selit në mendje vetminë dhe nevojën e ikjes prej andej, për të provuar se bota mund të ketë edhe një dukje tjetër, larg atyre kodrinave që të duket sikur shumëzohen ndër veti dhe jashtë asaj kambane qelqi, që të duket sikur të rri mbi kokë.

Mareci, nja dyzet kilometra larg Prishtinës, rrugës që shkon për Gjilan, është një katund i madh, ndër më të mëdhenjtë në Kosovë, sa i përket territorit. Nuk e di sa e ka perimetrin, por rrezja më duket se është afro 28 kilometra. Ndërsa shkon nga Prishtina në drejtim të Gjilanit, në Llabjan ndahet një rrugë në të majtë dhe, pas nja 4 kilometrash, është një fshat i banuar me serbë, që quhet Prekoc. Që andej duhet bërë edhe 7 kilometra të tjerë, për të arritur te mëhalla ime, aty ku kam lindur unë. Këto largësi, dhe rrugët që lidhen njëra



pas tjetrës, për fëmijërinë dhe rininë time të hershme kanë pasur një domethënie, sepse i kam bërë në këmbë aq shpesh, sa që më duket se edhe sot, pas kaq vitesh, sapo i mbyll sytë, më del përpara çdo kaçubë, çdo lis, çdo gur. Janë ato pamje që nuk më hiqen kurrë nga përfytyrimet.

Mareci është një fshat i shpërndarë, me disa mëhallë, ose lagje, siç quhen tani. Dikur thuhej se kishte gjashtëqind shtëpi, me nja tre mijë banorë. Sot besoj se nuk e di njeri as sa shtëpi, as sa banorë ka. Si çdo vend tjetër, zanafilla e tij nis nga legjendat dhe pastaj në kohët më të vona, kthehet në histori. Por ne, siç ndodh zakonisht, mund të mos kemi shumë për të thënë nga historia. Nga legjendat po. Një legjendë për shembull thotë se të parët e hershëm të Marecit kanë qenë, babai Mara me të bijtë e tij, të cilët e kanë banuar dhe e kanë themeluar këtë fshat. Të bijtë e Marës ishin: Paca, Cana dhe Maka. Ata paskan pasur edhe një nip të vetin, djalin e Pacës, i cili u nda prej tyre duke themeluar Krilevën. Kjo paskësh qenë një si traditë, e cila është ndjekur për një kohë të gjatë, sepse Mareci gjithmonë e ka ndarë një prej djemve duke i thënë: Ti shko atje për të jetuar, matanë atij përroi, gjegjësisht asaj kodre! Duket se në këtë mënyrë është bërë zgjerimi i territorit. Kjo ka ndodhur edhe në periudhat e mëvonshme, sepse mbaj mend se vëllezërit e gjyshit i kanë pasur shtëpitë larg njëra-tjetrës, nga disa qindra metra, deri në dy-tre kilometra. Lozja jonë, kjo e gjyshit tim dhe prapa, ka mbetur në vendin e njëjtë, afër një përroi me ujë jashtëzakonisht të pastër dhe me tokë shumë pjellore përreth. Në këtë pikë, si të thuash, ne kemi qenë të privilegjuar, sepse kemi pasur ara të pëlleshme, kullota të mira, zabelin dhe ujin afër. Pra, çdo gjë që i duhet një jete të mirë në fshat.

Sido që të ketë qenë, nga ata paraardhës të largët, pra nga ata tre vëllezërit e hershëm, thonë se ne kemi trashëguar mbiemrat: Pacolli, Makolli dhe Canolli. Më vonë, në ato anë kanë ardhur edhe të shpërngulurit nga Toplica, nga Serbia, që janë vendosur në ato zona dhe që mbajnë mbiemrin Llapashtica.

Një legjendë tjetër thotë se Mareci është populluar në kohën romake (shek. 3-4 e. sonë). Ilirët e vjetër të Dalmacisë, të njohur si zejtarë, që shkrinin hekurin, kishin ardhur të parët dhe kishin zënë

vend në breg të lumit të Marecit. Në fakt edhe sot identifikohen mbeturinat e shkritoreve përgjatë lumit në disa vende. Një legjendë tjetër thotë se banorët e parë të Marecit ishin autoktonë edhe në mijëvjeçarin e parafundit të epokës së vjetër.

Pavarësisht se kjo është legjendë, çka mbetet e vërtetë deri në kohën time mareciane, pra deri nga vitet shtatëdhjetë kur unë e lashë Marecin, në katundin tonë nuk janë bërë martesat të brendshme, sepse të gjithë janë konsideruar mesvete si kushërinj, si një familje. Përveç kësaj, kurrë nuk ka pasur ngatërresa brenda katundit. Njerëzit gjithmonë e kanë respektuar njëri-tjetrin, janë ndihmuar mes veti dhe i janë gjetur pranë njëri-tjetrit në situata të vështira. Por edhe gazmendet i kanë pasur të përbashkëta.

Thuhet, gjithashtu, se kalimi në fenë islame i kësaj zone, ka ndodhur vonë, ndoshta jo më shumë se katërqind vjet më parë. Këtë më së miri e dëshmon një toponim, një vend, që quhet “Te Kisha”, jo fort larg prej shtëpisë tonë, prej shtëpisë ku kam lindur unë. Mbjaj mend se aty kanë qenë muret e rrënuara të një godine të vjetër. Si fëmijë, kam dëgjuar të thuhet se xhamia e katundit, e vetmja xhami në Marec, e cila ka qenë e ndërtuar në tokën e familjes tonë, gjithashtu është ndërtuar vonë, me gjasë nga fundi i shekullit XIX ose fillimi i shekullit XX. Pra, është kjo një dëshmi se islamizimi i kësaj zone, për shkaqe të ndryshme, ku duhen veçuar konfiguracioni i relievit, anashkalimi i fshatit prej rrugëve me qarkullim më të dendur, ka ndodhur në një kohë më të vonë.

Fola për fshatin dhe legjendat rreth tij, tani të kthehem te mjedisi ku u rrita. Mund të them nga fëmijëria e hershme se mbaj mend që kemi pasur një si kompleks shtëpish, sepse deri vonë kemi jetuar bashkë me dy vëllezër të gjyshit, domethënë mixhallarët e babës. Kemi qenë familje e madhe. Aty ka qenë shtëpia e zjarrit, të cilën ne fëmijët e kemi frekuentuar më shpesh, sepse aty rrinin gratë, aty gatuhej, aty futeshim për t’u ngrohur dhe për t’u terur ne fëmijët, pasi ktheheshim me bagëti, veçmas dimrit, kur bënte ftohtë dhe kur binte shi e borë. Në një anë tjetër të atij kompleksi, pak më afër shtëpisë së zjarrit, kanë qenë qilerët, dhomat e fjetjes, shumica të vogla dhe të errëta. Më tej kanë qenë stallat dhe ahuret e bagëtisë, pastaj kasollet me sanë e me ushqim bagëtish. Në këtë dhomën e zjarrit, që e kisha



*Vendlindja ime, Mareci. Shumë legjenda në një fshat të vogël*

fjalën, burrat pothuajse nuk hynin kurrë. Ata kishin vendin e tyre, odën e burrave, që ishte godinë më vete, më afër derës së oborrit. Oda e burrave mbahej gjithmonë me një kujdes të veçantë. Pastrohej rregullisht, nga oxhaku hiqej hiri i një dite më parë, shkundeshin dhe laheshin *çergat e postakitë*, furnizohej me kafe e çaj, me gota e filxhanë. Pra, si të gjitha odat e burrave të asaj kohe. Më kujtohet se ajo odë kishte një dollap më të vogël për pajisjet e çajit dhe kafes, sikundër edhe një dollap tjetër më të madh, për jastëkët, shtrojat e mbulojat, që gjithashtu mbaheshin në gjendje të rregullt, për mysafirët.

Unë i njihja këto ambiente më mirë nga të tjerët, sepse kam pasur privilegj të isha nipi i përkëdhelur i gjyshit. Si në çdo familje patriarkale, ai ka qenë autoriteti i pakundërshtueshëm, njeriu që ka marrë vendimet më të rëndësishme për familjen, por njëkohësisht edhe njeriu më i mençur, jo vetëm në rrethin tonë familjar. Meqë e kishim fjalën te oda e burrave, mbaj mend se edhe falë gjyshit, ajo ka qenë shumë mikpritëse, jo pse është zakon të thuhet kështu, por e di



*Gjyshi Osman. Prijësi im shpirtëror.*

se ardhja e mysafirëve është quajtur nder për konakun dhe familjen tonë. Dhe nuk bëhej fjalë vetëm për mysafirë, që mund të vinin qëllimshëm, por edhe për ata që rruga mund t'i nxirrte andej, ose për hallexhinj të ndryshëm. Dera e odës së tij ka qenë gjithmonë e hapur. Ai u gëzohej mysafirëve, njësoj siç gëzohej kur kishte mundësi t'i ndihmonte dikujt. Këto veti të tij i kam çmuar gjithmonë dhe mbase, kjo është pasuria më e madhe që kam trashëguar prej tij: mikpritja, bujaria dhe solidariteti me njerëzit në nevojë.

Gjyshi im Osmani, ka qenë i datëlindjes 1900. Ishte i biri i Dautit, me shumë djem, disa prej

të cilëve, siç e thashë më parë, u ndanë herët, ndërsa unë mbaj mend një xhaxha të babës, Sejdiun, sepse për një kohë të shkurtër arrita të jetoj me të. Dhe, ky Osmani, d.m.th., gjyshi im, ka pasur 6 vajza dhe 2 djem. Baba im, Isa, ka qenë djali më i madh, kurse Ruhani, axha, ka qenë djali tjetër i gjyshit. Për një kohë, gjyshi e ka trajtuar babën si djalë *hasreti*, deri sa nuk ka lindur edhe Ruhani. Baba ka qenë regjistruar si i lindur më 1926, ndonëse kjo ditëlindje mund të mos ketë qenë e saktë, sepse ka qenë e shënuar e tillë me anë të

dëshmitarëve. Duke e ditur se ai kishte vetëm gjashtë muaj diferencë me nënën, ndërsa ajo kishte lindur saktësisht më 1928, atëherë del se ditëlindja e tij e shënuar nuk ishte e saktë.

Ndërkaq, për t'i pasur më të qarta rrethanat në cilat e kam kaluar fëmijërinë e hershme, veçmas kur bëhet fjalë për raportet e mia me gjyshin tim, Osmanin, mendoj se është me rëndësi të them se ai kishte pasur një vëlla, Ruhanin, të cilin e kishin vrarë partizanët më 1944. Sipas rrëfimeve që mbaj mend, ai kishte qenë mjek popullor shumë i talentuar, për të cilin thoshin se me masazhe bënte mrekulli, shëronte shumë sëmundje. Kishte shëruar edhe disa ushtarë gjermanë, të cilët më pastaj e morën me vete nëpër Kosovë dhe Maqedoni. Gjyshi im e kishte vizituar shpesh atë dhe, me sa duket, gjatë atyre viteve edhe ai kishte pasur kontakte me gjermanët, sepse dinte disa fjalë gjermanisht. Por nuk ishte vetëm kjo. Gjyshi dinte edhe shkrim-lexim, jo qirilicë, siç kishte ndodhur me moshatarët e tij që kishin kryer ndonjë klasë fillore në kohën e Jugosllavisë së krajlit, por shkrim-lexim shqip, të cilin, me sa duket, ndonëse në moshë tashmë të shtyrë, e kishte mësuar pikërisht në kohën e Luftës së Dytë Botërore, kur u hoqën kufijtë me Shqipërinë. Më kujtohet se ai, ditën e xhumasë, vonohej shumë në xhami, sepse lexonte dhe shkruante letra për krejt katundin, madje për çdokënd që kishte nevojë për këtë. Bukurshkrimin e tij të jashtëzakonshëm ma kujton bukurshkrimi i babës tim dhe ndoshta Selimi, vëllau im ka trashëguar prej tyre një kaligrafi të mirë. Ai i vizatonte gerrat, dhe çdo detaj i germës kishte rëndësi të madhe për të. Gjyshi më thoshte shpesh: sa më bukur të shkruash, aq më shumë shtohen shanset që letra jote të lexohet dhe të kuptohet! Kjo thënie e tij, më ka udhëhequr në jetën time, jo thjesht ndërsa shkruaj, por në çdo punë.

Përveç kësaj, ai kishte një përvojë të gjatë jetësore dhe kishte mençuri të lindur. Ishte njeri i odave të burrave dhe e kishte përthithur mirë urtësinë popullore, meseletë, anekdotat dhe fjalët e urta. Kishte edhe edukim të mirë fetar, sepse herët kishte kryer mejtepin dhe më kujtohet se bënte interpretim me themel të Kuranit dhe mësimëve të tjera fetare. Në praninë e tij, hoxhallarët ose të tjerët nuk guxonin të tregonin “përralla fetare” si iu tekej, sepse ai i kundërshtonte ata



*Gjyshja Fazile*

me argumente shumë të forta logjike. Për të besimi ishte dhunti e Zotit, përkushtim ndaj të mirës dhe të drejtës dhe jo mjet për të realizuar ndonjë qëllim. Nga ana tjetër, ai ishte burrë me trup të zhvilluar dhe pamje që binte në sy.

Me gjyshin unë kam qenë i lidhur në mënyrë të veçantë. Isha nipi i tij i përkëdhelur dhe më trajtonte ndryshe nga të tjerët. Flija në odë me të, shkoja në mulli bashkë me të dhe, dikur më vonë, ndërsa ruaja bagëtinë, ai vinte me mua, më shoqëronte, më fliste gjithmonë.

Më kujtohet një situatë, kur nëpër qiellin e katundit tonë pashë aeroplanin e parë, që fluturonte ulët. Ishte diçka që ne nuk e kishim këqyrur deri atëherë. Dhe gjyshi më thotë: Një ditë edhe ti do të fluturosh me një *ballanë* si kjo. Në një mënyrë, ishte njeri që e kishte kapur me kohë progresin dhe i supozonte zhvillimet bashkëkohore, pra çfarë mund të arrinte dikush i suksesshëm, si do të duhej të udhëtonte drejt tij. Për mua, si fëmijë, tani gjykoj se thëniet e tij, përveç fantazisë, nxitnin edhe dëshira, krijonin vizione, orientonin energjitë e më të vegjëlve. Ai më thoshte gjithmonë se një ditë unë do të flas shumë gjuhë, se një ditë do të takoj burrështetas. Më vjen mirë se i doli fjala. Mund dhe të mos i dilte!

Por, ajo që më ka lënë mbresë më të madhe, ishte dashuria dhe kujdesi i tij i madh ndaj meje, më të përkëdhelurit prej tij. Kjo ishte reciproke. P.sh., më kujtohet se, kur nuk më zinte gjumi,

unë kujdesesha që të bëja sikur isha fjetur, në mënyrë që mos ta shqetësoja, sepse ai gjithmonë më shihte në isha mbuluar si duhet, mos kisha djersirë, apo jastëkun a e kisha mirë nën kokë. Unë flija me të në odën e madhe, në odën e burrave dhe ky ishte privilegj i madh, jo vetëm në krahasim me fëmijët e tjerë, por edhe në krahasim me të gjithë anëtarët e familjes. Edhe kur fillova të shkoja në shkollë, këshillat e tij përqendroheshin në një pikë: të mësoja sa më shumë, të përparoja, të bëhesha njeri sa më i aftë, për t'u përballur me sfidat e jetës.

Për mua, gjyshi ishte njeri me dhunti të jashtëzakonshme. Ai, ta zemë, gjithmonë thoshte se kishte dëshirë të vdiste atë ditë, kur nuk do të bënte shumë ftohtë, në mënyrë që në varrimin e tij të vinin sa më shumë njerëz. Ai nuk donte që ata të cilët vinin në varrimin e tij të mundoheshin dhe të kishin të ftohtë. Ndaj të tjerëve gjatë tërë jetës kishte qenë shumë bujar. Tani më kujtohet se çfarë ndodhi në orët e fundit të jetës së tij. Kishte qenë 29 janari i vitit 1979 dhe gjyshi i kishte mbushur 79 vjet. Kishte bërë i ftohtë i madh, një nga ato ditët e acarta të dimrit të Kosovës, kur dielli i jep shkëlqim prej argjendi natyrës së mbuluar me borë, por në vend që të ngrohë, të “kafshon me dhëmbë”.

Atë ditë, pasi kishte qëndruar një kohë të gjatë në oborr, qenkësh futur brenda, ishte ulur pranë stufës me dru, kishte varur kokën në një anë dhe, duke e ndjerë se po i afrohej vdekja, kishte kërkuar që të gjithë t'i shkonin pranë.

“Mu afroni edhe një herë”, tha. “Dua t’ju shoh të gjithëve.”

Pas 20 minutash kishte dhënë shpirt, krejt i qetë, sikur ta kishte zënë gjumi. Të nesërmen, ndërkaq, që ishte dita e varrimit, ishte bërë aq ngrohtë, sa ishte e pazakonshme për një stinë të tillë. Ishte bërë si një ditë pranvere, 14 gradë celsius. Në varrimin e tij, njerëzit kishin ardhur me xhaketa dhe askush nuk e kishte ndjerë të ftohtin. Gjyshit i ishte plotësuar edhe dëshira e fundit. Unë nuk arrita të marr pjesë në varrimin e tij dhe kjo më mbeti peng për tërë jetën. Duke qenë fëmijë i afruar më shumë me gjyshin, raportet e mia me “pjesën femërore” të familjes, në këtë rrëfim mbesin pak në hije të kësaj lidhjeje tepër të veçantë për mua dhe me ndikim të jashtëzakonshëm për formimin tim. Megjithatë, në atë hapësirë



*Babai Isa, nëna Nazmija. Baba vdiq në korrik 2008. Çuditërisht edhe nëna u sëmur dy vjet më vonë po në korrik duke u ndarë nga jeta një muaj më pas. Rastësishtë, për mirë dhe për keq, e kanë ndjekur familjen tonë.*

jete fëmijërore, në atë mozaik kujtimesh, është edhe një gur tjetër i ndritshëm: gjyshja ime Fazile, një grua shumë e dashur dhe bujare. Ajo kishte lindur më 1905, çka i binte të ishte më e re se gjyshi për nja pesë vjet. Jo vetëm pse ishte më e madhja ndër gratë e familjes dhe si e tillë, kishte përgjegjësi, por ajo vërtet sillej si nënëmadhe e të gjithëve. Të gjithë i donte dhe të gjithë e donin. Veçmas më ka mbetur në kujtesë mikpritja e saj, një dëshirë e madhe për t'i bërë mysafirit respektin më të madh. Të shtoj këtu se gjyshi e gjyshja, përveç babë Isës dhe mixhës Ruhan, kanë pasur edhe gjashtë vajza, domethënë se unë kam pasur gjashtë halla dhe ato janë sipas radhës: Taibja, Mihania, Ramizja, Fata, Hatixhja dhe Vahidja.

Tani vjen radha të them diçka më shumë për babanë. Ndryshe nga raportet e mia me gjyshin, me të kisha marrëdhënie disi më në



distancë. Ai ishte njeri shumë i angazhuar, me shumë punë. Ai ka punuar në zyrën e vendit në Marec, si ofiqar. Nuk ka pasur arsimim të rregullt, po ka qenë autodidakt. Kishte mësuar shkrim-lexim nga i ati, pra nga gjyshi. Kishte kryer edhe mejtepin. Por siç ju thashë ka pasur shkrim jashtëzakonisht të bukur. Zyra e vendit ka qenë aty ku ishte një si qendër e të gjitha mëhallëve të Marecit, te Flotacioni, ku ngrihej edhe shkolla tetëvjeçare. Zyra e vendit, në atë kohë, nuk ishte vetëm zyrë ofiqarie, ku mund të merreshin çertifikata të lindjes dhe të vdekjes, por ishte edhe një si njësi e pushtetit lokal.

Im atë Isa, bashkë me një tjetër punonin në atë zyrë dhe çdo ditë shkonte e vinte, nëpër shi e borë. Duket se ishte shumë i angazhuar, sepse mbaj mend se ishte gjithnjë në lëvizje. Pastaj, dukej se kishte edhe obligime të tjera, punë aktivitetesh politike, nëse mund të quhen kështu, sepse im atë pas Luftës, kishte kryer edhe kurse politike, shkolla politike, madje deri në Kumrovç kishte shkuar. Ishte i angazhuar, pra, edhe me punë politike, në punë partie, ose çfarë ishin ato, por edhe në punë zyre. Pastaj ishte edhe kryetar i këshillit të shkollave të Marecit, që, më sa kuptoj unë, kishte qenë një si organ që koordinonte punët për mbarëvajtjen e procesit mësimor në shkollat e ciklit të ulët të shpërndara nëpër fshatra dhe të shkollës së plotë tetëvjeçare, që, sikundër thashë, funksiononte te Flotacioni. Ndryshe nga gjyshi, im atë ishte njeri më i mbyllur, fjaloste më pak. Pastaj, me ne fëmijët, ai gjithnjë mbante një distancë, përfshirë edhe mua. Edhe kur ndodhte të ecnim bashkë rrugës, ai shkonte disa hapa përpara. Duket se shumë gjëra, që i ka përjetuar gjatë atyre viteve, nuk na i ka rrëfyer kurrë, i ka marrë me vete në atë botë, pa i treguar askujt. E them këtë, për shkak se kam një si dyshim se diku pas viteve gjashtëdhjetë, jo vetëm që e largojnë nga puna, por duket se edhe u keqtrajtua nga policia. Për këto gjëra ai nuk ka folur asnjëherë, mirëpo rrethanat tregojnë se diçka e papëlqyer ka ndodhur me të gjatë atyre viteve. Mua më kujtohet se diku, nga viti 1960, gjyshi blen një radio transistor dhe unë tani sikur fillova t'i marr vesh disa zhvillime politike, nëse mund të them kështu. Dikur atëherë filloi lufta në Vietnam, gjë që në fantazinë time ishte diçka e papërkufizuar, e paqartë. Por mua më kujtohet se gjatë asaj periudhe në katund shkonin e vinin policë më shpesh se zakonisht. Në një rast, në një



*Babai Isa me nipërit, Dautin në të majtë, Adnanin dhe Valmirin e vogël. Shihet qartë se prania e nipërve i jep më shumë shkëlqim fytyrës së tij*

nga ato vajtje-ardhje të shpeshta të policisë, një parambrëmje, e thërrasin babën tim te Lama, që ishte pak më largshtëpisë. Mbajmend se baba u kthye dhe u fut në odë pikë e vrer. Ne fëmijëve na qitën jashtë, sepse burrat, pra gjyshi, baba dhe axha duhej të bisedonin diçka të rëndësishme. Më vonë kam marrë vesh se atë natë njerëzit e pushtetit kishin sjellë pasaportat e të gjithë anëtarëve të familjes tonë dhe prej babait kishin kërkuar që ne të shpërnguleshim për Turqi.

Këtu më duhet të bëj një digresion dhe t'iu bëj një vërejtje historianëve tanë, të cilët

shpërnguljet në Turqi i kanë lidhur me periudha më të kufizuara kohore. Ato kanë zgjatur dhe kanë vazhduar për një kohë më të gjatë, deri në Plenumin e Brioneve në vitin 1966. Përveç kësaj, për mendimin tim, nuk janë analizuar aq mirë metodat që përdoreshin në këtë rast. Kishte forma të ndryshme të trysnisë, direkte dhe indirekte, por zakonisht goditja bëhej e menduar mirë. Në shënjestër merreshin familjet e mëdha, familjet që gëzonin autoritet në një rreth të caktuar, përfshirë edhe ato që kishin gjendje relativisht të mirë materiale. Pra, kishin tokë, pasuri, të ardhura. Kjo bëhej me qëllim të caktuar, që ato të bëheshin “shembull” për atë rreth, për atë ambient. Me një fjalë, kjo ishte afërsisht kështu: Nëse shpërngulet për Turqi familja e

Osman Pacollit, që ka tokë të mirë, që ka pasuri, ka mulli, që ka edhe djalin në punë, çka presim ne të tjerët?! Në Marec, p.sh. shpërngulja e familjes sonë do të kishte efekt të jashtëzakonshëm për një shpërngulje dhe ikje masive. Kur në një breg shkulen pemët më të mëdha, me rrënjët më të forta, atëherë, ujrat mund të marrin para gjithçka shumë lehtësisht.

Sikundër kam marrë vesh më vonë, baba kishte refuzuar në mënyrë kategorike shpërnguljen për Turqi. Në atë bisedë në odë me gjyshin dhe me mixhën ai kishte thënë: *Le t'bahet si t'bahet! Na nuk luejmë prej ktuhit!* Meqë babai, as më vonë, nuk ka pranuar të flasë me askënd për këto çështje, nga ne fëmijët ka qenë e vështirë të kuptohet nëse ky refuzim i tij u bë shkak që atë ta largojnë nga puna. Por unë e mbaj mend shumë mirë se ai u përjashtua nga puna vetëm një muaj pas asaj bisede të Lama me njerëzit e pushtetit. Që nga ai moment, babai u bë njeri i dëshpëruar me çdo gjë që kishte të bënte me shtetin dhe me pushtetin. Kishte patur angazhime intensive, për aq sa kishte ditur dhe sa kishte mundur. Kishte punuar gjatë dhe ishte lodhur për t'i vënë në rend gjërat në një ambient të vështirë, ku e reja dhe progresivja- ajo që asokohe konsiderohej si e tillë- depërtonte me vështirësi. Tanimë duket se im atë ishte zhgënjyer tej mase. Aq shumë ishte i zhgënjyer, veçmas gjatë atyre viteve, sa që kishte një lloj refuzimi kategorik ndaj gjithçkaje që vinte nga shteti dhe pushteti. Këtij sensi të tij për refuzim jam i prirë t'ia atribuoj edhe kundërshtimin e tij të fortë që motrat e mia, pas tetëvjeçares, ta vazhdonin shkollimin. Madje, po të mos ishin gjyshi dhe axha Ruhan, ato nuk do ta kryenin as tetëvjeçaren, kurse unë nuk do të shkoja në Prishtinë, për shkollim të mëtutjeshëm.

Duke e analizuar nga kjo distancë mënyrën sesi sillej im atë në atë periudhë, për mua koncepti i qëndresës së popullit tonë ndaj pushtuesve, ndaj armikut, ndaj të huajve ngjason shumë më i komplikuar, shumëformësh, ndryshe nga ç'paraqitet zakonisht. Filozofia e qëndresës së babës, për shkak të rrethanave dhe përvojës, nuk ishte e njëjtë me atë të gjyshit, për shembull. Për mendimin tim, gjyshi kishte idenë se vështirësitë e ballafaqimit me pushtetin mund të tejkaloheshin jo duke u konfrontuar me të, por duke ndjekur rrugën e dijes dhe të progresit, të shkollimit dhe të emancipimit. Babai jo.

Përsëri sipas gjykimit tim, ai, nga një njeri që e kishte njohur dhe e kishte ndihmuar pushtetin e ri të konsolidohej, mori një qëndrim shumë më radikal: ai nuk ju kundërvu pushtetit, qoftë sepse e dinte forcën e tij dhe ishte i vetëdijshëm se nuk mund të dilte i fituar; qoftë për shkak se në anën tjetër e gjykon se nuk janë pjekur kushtet për një kundërvënie të drejtpërdrejtë. Prandaj ai zgjodhi refuzimin, një formë pasive e rezistencës në dukje të parë, por shumë më radikale se e para.

Mua më kujtohet shumë mirë, se pas kësaj periudhe, përfshirë edhe kohët më të vona, çdo veprim tonin ose të çdokujt tjetër që mund të ngjante se shkonte në favor të zgjatjes së jetës të atij shteti, ai e shikonte jo vetëm me skepsë dhe dyshim, por edhe me njëfarë refuzimi të heshtur. Sa herë që rastiste të më dëgjonte duke folur serbisht për shkaqe të mësimëve, p.sh., ai më shikonte me ironi, një shikim që fliste shumë, i cili përfshinte në vete jo vetëm përvojën e tij të hidhur jetësore, por edhe botëkuptimin e tij politik. Në këtë qëndrim të tij refuzues, ai ka qenë shumë konsekuent, sepse, pavarësisht se me kohë, rrethanat kishin ndryshuar (dikur ai u kthye në punë dhe bëri jetën e një nëpunësi të vogël të administratës shtetërore), për zhgënjimin që kishte përjetuar një herë, nuk i fali më ata që i konsideronte përgjegjës dhe fajtorë për këtë.

Por, sikundër e thashë, ai asnjëherë nuk foli asgjë rreth këtyre çështjeve. A thua pse kishte frikë? Doemos që po. Ai duket se nga afër e kishte parë se çfarë ishte në gjendje të bënte ai pushtet, prandaj kundërvënien e hapur ndaj tij e konsideronte të pamundur. Më shumë se për vete, ai kishte frikë për familjen, për ne. Në atë kohën e hershme, para vitit 1966, mua më kujtohen porositë e vazhdueshme të tij, të gjyshit, të axhës, që të jemi të kujdesshëm, të mos flasim asgjë. Nga vinte e tërë kjo? Nga dijenia se familjes tonë, pushteti një herë ia kishte treguar dhëmbët. Por nuk ishte vetëm kjo. Duket se ata e dinin se, për shkak të babait, familja jonë vazhdonte të mbahej nën vëzhgim. Pse? Nuk mund ta them qartë. Njëra arsye mund të ishte refuzimi për t'u shpërngulur në Turqi. Por nuk besoj të ishte vetëm kjo. Do të kishte pasur edhe gjëra të tjera, që ne më të rinjtë nuk arritëm t'i mësonim asnjëherë.

Tani, jo pse e do radha, por një vend në këtë rrëfim duhet ta zërë



*Me mixhën Ruhan... Me të shkonim shpesh për dru...*

nëna ime, Nazmija. Ajo ishte gjashtë muaj më e re se baba dhe vinte nga Bresalci i Gjilanit. Nuk ishte vetëm babai që ishte martuar i ri, për çka kam rrëfyer më herët, por akoma më e re kishte qenë nëna. Kur kam lindur unë, më 30 gusht të vitit 1951, ajo ka qenë 23 vjeçe, ndërkohë që unë isha fëmija i tretë i saj. Para meje ishte motra e madhe dhe një tjetër motër, Mirvetja që kishte vdekur si foshnjë. Nëna ishte një grua tipike e kohës, e heshtur, e urtë, e përkushtuar ndaj familjes. Shumë e dashur dhe e dhembshur. Ne, për një kohë të gjatë, jetuam në një bashkësi të gjerë familjare dhe, në rrethana të tilla nuk kishte fërkime apo kontradikta të brendshme, për një arsye ose për një tjetër, për shkak të fëmijëve, për shkak të punëve, për shkak të marrëdhënieve etj. Unë e mbaj mend se nëna i ruante me shumë kujdes këto raporte. Na donte, por nuk na privilegjonte. Madje, kam përshtypje se edhe dashurinë prindërore kishte kujdes



**Me vëllezërit, Ismetin poshtë dhe nga e djathta në të majtë, Agimi, Selimi dhe Emini. Jemi shumë të lidhur me njëri-tjetrin dhe fotoja është bërë në ato pak çaste që arrijmë të jemi bashkë, 1996**

që ta manifestonte në një mënyrë disi të drejtpeshuar me fëmijët e tjerë të bashkësisë familjare. Në periudhat e mëvonshme, ndonëse me shumë fëmijë, mbaj mend se ajo kujdesej për gjyshin që të kishte pamje të rregullt, ashtu siç ishin kërkesat e tij dhe siç e donte niveli i tij i të parit të konakut; për babën që ishte nëpunës dhe që kishte kontakt me shumë njerëz; sikundër edhe për ne, që ishim një grumbull dhe që duhej të ishim të harrnuar, të larë dhe të krehur, veçmas kur shkonim në shkollë.

Nga kjo distancë, unë them se, ndër të tjera, ka qenë meritë e nënë Nazmijes që ne, si familje, arritëm të mbanim raporte të mira me njëri-tjetrin për një kohë të gjatë, jo vetëm ne të barkut të saj, por edhe me të tjerët, që janë “një katramë” më larg. Kjo është punë edukate dhe këtë mendoj se na e ka selitur ajo. Ishte sensi i saj për të jetuar në mënyrë të drejtpeshuar në një bashkësi të madhe familjare. Ishte prirja e saj, për t’i mbajtur afër të gjithë pjesëtarët e familjes. Kjo është një trashëgimi e vyer, të cilën e kam çmuar gjithnjë dhe ende e çmoj jashtëzakonisht shumë.

Me babë Isën ajo pat pesë djem dhe pesë vajza (dhe Mirvetja që kishte vdekur posa kishte lindur). Pas meje, sipas radhës vijnë vëllezërit: Ismeti, Agimi, Selimi dhe Emini. Dhe motrat: Mirvetja, Hasibja, Nailja, Kadirja dhe Remzija.

Nga periudhë e fëmijërisë së hershme, tani më sillen në mendje kujtime që, mesa duket, nuk do të më lenë deri në çastet e fundit të jetës. Është aty dita e parë e shkollës, që më shfaqet në përfytyrim sikur të kishte ndodhur dje. Natyrisht, gjyshi aty është i pashmangshëm, sepse, ndërsa unë mund të kisha ndjenja të përziera, pak strukje, pak tërheqje, pak frikë nga e panjohura, për gjyshin kjo ishte ditë solemne. Mbaj mend se u veshëm e u mbathëm, si për dasmë, si për Bajram, dhe me të për dore shkuam deri te shkolla. Porositë e gjyshit gjatë rrugës ishin po ato: të mësoja, të bëhesha i zellshëm, i vyer, të mësoja mirë, të bëhesha i sjellshëm, ta doja mësuesin, t’i doja shokët. Një didaktikë e përkryer.

Megjithëqë shkollë fillore e ciklit të ulët, që e kishim afër shtëpisë, sikundër e kam shpjeguar tashmë, katundi ynë ishte i shpërndarë dhe kudo që të bëhej një shkollë e tillë, dikujt përsëri do t’i binte ta kishte më larg. Pra, shkolla për mua ishte larg nja tre ose katërqind metra



*Me Afrimin, djalin e mixhës, zv.President i Mabetex-it, dhe krahun tim të djathtë*

nga shtëpia. Ajo ishte një godinë tipike e asaj kohe, shkollë fshati, me tre dhoma mësimi, me banka të gjata prej dërrasash të pagdhendura, me një dërrasë të zezë dhe pa pajisje të tjera. Shkolla kishte edhe një aneks me dy dhoma, ku banonin dy mësues. Njëri prej tyre, ai që mua më ra ta kisha mësues të parë, ishte Isak Shema, mësuesi i nderuar i letërsisë. Ishte njeri shumë i urtë dhe i sjellshëm. Na donte dhe e donim. Kishte kurajë të jashtëzakonshme për të punuar me ne, si të gjithë mësuesit e asaj kohe. Ishte nga ana e Gjilanit, pra nuk ishte i Marecit. Nuk më kujtohet nëse katundet tona kishin ndonjë mësues të kualifikuar, por edhe sikur të kishte, sistemi i arsimit ka qenë i tillë, që mësuesit i shëtiste dhe i transferonte nga një vend në tjetrin.

Sot, kur i mendoj kushtet në të cilat punonin ata mësues, në respekt dhe nderim të tyre ngrihem në këmbë. Ishin të përkushtuar dhe të duruar, me vullnet prej çeliku. Më kujtohet, shumica e nxënësve të



klasës sime nuk ishin të pajisur me gjërat e domosdoshme. Dikush nuk kishte fletore, dikush nuk kishte laps. Dikush nuk kishte as fletore as laps. Për libra as të mos flasim. Në klasën time të parë ishin gjithsej tri abetare. Unë isha i privilegjuar, sepse kisha pasur motrën një vit më parë në klasë të parë dhe ajo kishte arritur të kishte një abetare. Pra, unë kisha abetaren e saj dhe ndihesha i lumtur për këtë. Edhe një detaj tjetër. E mbaj mend veten duke shkuar në shkollë, apo në klasë, e mbaj mend veten duke bërë detyrat. Pikërisht këtu desha të ndalem. Aq shumë vullnet kishte gjyshi të merrej me mua, sa që më kujtohet se, ndërsa unë bëja detyrat në mbrëmje (ditën nuk kishim kohë, ose për shkak të vajtje-ardhjeve në shkollë, ose për shkak se ruanim bagëtinë), ai ma mbante llambën me gaz, që unë të shihja më mirë dhe detyrat t'i bëja sa më pastër. Pastaj, kur duhej të mësonim ndonjë vjershë, ose ndonjë shpjegim leximi, ishte gjyshi ai që më dëgjonte i pari. Nuk them se ai i kuptonte ato që thosha unë, qofshin vjershë ose shpjegim, por ai kishte durim të më dëgjonte me vëmendje. Kur e recitoja vjershën pa ngecur ose pa bërë ndonjë gabim, ai më shpërblente me një përkëdhelje ose përqafim.

Natyrish, ky rrëfim i fëmijërisë sime të hershme nuk do të ishte i plotë, sikur të mos rrëfej këtu se jo çdo gjë shkoi si duhet në këtë kohë dhe në këtë periudhë. Pra, ndonëse botë e fëmijërisë, kur çdo gjë, shikuar nga kjo distancë duket e bukur, në rastin tim disa zhvillime ishin larg nga të qenit të përkryera. Nuk i kam pasur më shumë se dhjetë vjet, kur mixhën tim, Ruhanin, e morën ushtar. (Gjatë ngjarjes me babain lidhur me shpërnguljen, që e përmenda më sipër, mixha Ruhan ishte në shtëpi në sylah, siç i thoshim, atëherë daljes me leje nga ushtria). Gjyshi ishte plakur dhe e kishte lënë fuqia, kurse baba ishte i zënë me shumë punë. Ai gjatë asaj periudhe, së paku katër herë në javë ishte i detyruar të shkonte në Prishtinë, në të shumtën e rasteve në këmbë, për të dorëzuar certifikata e dokumente, apo për të marrë dokumente. Ndoshta, kështu, që për një periudhë kohore unë mbeta, si i thonë një fjale, krahu më i fortë i shtëpisë. Ka qenë periudhë shumë e rëndë. Vrapo në shkollë, vrapo te bagëtia, vrapo te sana, vrapo te arat. Edhe sot çuditem si ja dilja. Ndoshta për herë të parë në katund, atëherë promovova një lloj pune kolektive. Shkonim në mënyrë të organizuar, që t'i kryenim punët herë te njëra familje,

herë te tjetra. Për familjen tonë, ishte e vetmja mënyrë që t'u dilnim mbanë punëve të arave e të livadheve, të korrjes e të fshirjes, të kositjes e të mbledhjes së sanës.

Kjo situatë zgjati deri sa e nxorën babanë prej punës. Në njërën anë, kjo ndikoi mirë në shtimin e një krahu të punës në familje, por nga ana tjetër, ne mbetëm pa të ardhura. Situata në fshat ishte pikërisht e tillë, si gjithandej Kosovës në atë periudhë: mund të kishe bukën, mund të kishe bulmetin, mund të bëje edhe veshmbathje prej zhguni, por nuk kishe nga të merrje asnjë metelik. E vërtetë që ne kishim edhe mullirin, por gjyshi nuk lejonte që të bluhej me ujem, sepse është gjynah, është haram, thoshte. Pavarësisht se gjendjen ekonomike nuk e kishim të mirë, kjo rregull e gjyshit mbeti në fuqi. Prandaj, në vitet vijuese, familja jonë të vetmet para i merrte nga shitja e drurit për ngrohje në Gjilan. Bënim prerjen e druve me mixhën Ruhan gjatë ditës, i afronim te shtëpia dhe të nesërmen, që me natë i shpinim në Gjilan, atje i shitnim, blinim ndonjë gjë të vogël, pak vaj, pak sheqer, ndonjë rrobë dhe përsëri ktheheshim në katund. Kjo ka zgjatur disa vjet, deri sa shkova në shkollë të mesme në Prishtinë.

Po shkolla fillore? Në klasë të parë unë kisha shkuar gjashtë vjeç, kështu që në ciklin e lartë të shkollës fillore, pra te Flotacioni, shkova kur isha jo më shumë se dhjetë vjeç. Pastaj, edhe aty “e fitova” një vit, sepse klasën e shtatë dhe të tetë i kreuva njëherësh. Në të vërtetë, ndodhi që unë, për të shoqëruar motrën, e cila ishte një vit më e madhe, kur isha në klasë të shtatë, shkoja në mëngjes në shkollë dhe, deri sa pritja orarin e mësimit tim, futesha në klasën e saj. Kjo bëri që unë, paralelisht me mësimet e klasës së shtatë, t'i përvetësoja pa asnjë vështirësi edhe mësimet e klasës së tetë. Aq më tepër që unë isha i shkëlqyer në lëndët e shkencave ekzakte, si matematikë, kimi, biologji etj. Dhe, në fund të atij viti shkollor, mua më japin edhe dëftesën për përfundimin e shkollës fillore.

Në të vërtetë, më sa më kujtohet mua, arsimtarët e bënë këtë, në njëfarë mënyre, si për të më “hequr qafe”, sepse kisha përparuar shumë në mësime dhe, gjatë orës, sikur i vija në siklet. Këtë ma ka bërë me dije, më vonë (madje, edhe sot ma pohon këtë), edhe ish-drejtori i asaj shkolle, Shaip Vitia, i cili më thoshte se, atëbotë, kishte

probleme me mësuesit rreth meje. Disa lëndë (siç ishte matematika, përshembull të cilën unë e kam pasur pasion), mund të them me siguri të plotë se i dija më mirë se ata. Këtë nuk duhet parë si ndonjë çudi të madhe, sepse ata mësues ishin tepër të rinj, disa madje sapo kishin kryer dy vjet të shkollës normale. Ne që i fetishizonim mësuesit, kujtonim se pale kush ishin ata, kurse në të vërtetë shumica syresh ishin vetëm 3-4 vjet më të mëdhenj se ne. Ishte mungesa e kuadrit mësuesor, që këta mësues i bënte edukatorë dhe sinonim të mësimit e të dijes, ende pa pasur as kualifikimin bazë, madje pa e kaluar as moshën e rinisë së hershme.

Pra, mësuesit ranë dakord që të m'i japin dy klasë përnjëherësh, sepse për disa prej tyre tashmë isha bërë “problematik”, siç do të ma pohojë më vonë mësuesja Sofije Kllokoçi. Më kujtohet edhe mësuesja Ajshe Govori sepse me këtë të fundit kam pasur pak më shumë probleme, jo të natyrës së sjelljes, por me shkallën e diskutimeve rreth temave të orës mësimore. Sot kam marrëdhënie të mira edhe me ish-drejtorin Shaip Vitia. Isak Shemën, arsimtaret, Sofien, Ajshen, e të tjerët. Kam marrëdhënie të mira po ashtu edhe me disa shokë të klasës. Disa prej tyre kanë vdekur, disa jetojnë në Marec, e shumica janë shpërngulur në Prishtinë e vise të tjera të Kosovës.

Që këtu, pastaj, filluan aventura të reja. Diçka kisha përfituar prej familjes, ndaj mund të zhytesha i armatosur në këto aventura. Jo duarlidhur.

## Jeta në Prishtinë

*Normalja ku mësova shumë dhe kuptova shumë; ku protestova si të gjithë bashkëmoshatarët e mi. Ishte 1968-a, viti i revolucionit rinor në Europë. Dhe Kosova s'mund të heshtte. Episodi që më mbylli dyert e Universitetit dhe ikja në Perëndim. Borxhi i parë për udhëtimin drejt të panjohurës.*

**P**ara se të bëj të ditur hyrjen time në djalëri, e shoh të nevojshme që në këtë vend të ndalem për një çast dhe të bëj një retrospektivë disi politike të asaj kohe dhe të atyre viteve. Lexuesi duhet ta ketë parasysh që në krye të herës, se pasioni im nuk ka qenë politika. Këtë e them pikërisht tani, sepse zakonisht është rinia e hershme ajo që përcakton interesimet e mëvonshme për një profesion ose vokacion. Pra, për të nuk kam pasur ndonjë interesim specifik në asnjërën fazë të jetës sime. Megjithatë, duke jetuar në një mjedis që varej shumë nga zhvillimet politike, unë nuk kam mundur të jem indiferent ndaj atyre ngjarjeve, të cilat linin gjurmë të pashlyera në secilin segment të jetës sonë.

Nga fëmijëria mbaj mend dy gjëra, që më bënë përshtypje jashtë mase: e para, ishte situata e rëndë sociale dhe ekonomike e Kosovës; dhe, e dyta, trysnia policore, e cila hetohej gjithandej. Në atë kohë, duke pasur parasysh moshën, unë mund mos të kem qenë në gjendje që këto negativitete t'i lidh me regjimin, me pushtetin dhe me statusin e Kosovës. Ama ishte një si lloj ndër dije e ngulitur në masë, te njerëzit në përgjithësi, se shteti i atëhershëm i Jugosllavisë mbante qëndrim negativ ndaj Kosovës dhe ndaj shqiptarëve.

Formimi im, duke qenë i ndikuar më së shumti nga rrëfimet dhe filozofia jetësore e gjyshit, nuk mund të realizohej pa mbresat e fuqishme që linin te unë zhvillime dhe ngjarje jo shumë të kahershme, të cilat në fantazinë e fëmijës marrin përmasa të ndodhive që shihen me sy. Pse gjyshi e lavdëronte kohën e pushtimit gjerman? Pse partizanët e kishin vranë vëllanë e tij? Madje, edhe më shumë se kaq. Ai thoshte se i kishin pëlqyer gjermanët, sepse ishin sjellë mirë me

popullsinë, nuk kishin prekur kurrë në erz të familjeve, kishin qenë të rregullt, të disiplinuar. Ndërkaq, në shkollë ne mësonim se ata kishin qenë pushtues, sinonim i së keqes. Gradualisht, pra, te unë filloi të krijohet një vetëdije “e fshehtë”, si te gjithë moshatarët e mi, se e vërteta është “e dyzuar”, se ekziston njëra syresh që është zyrtare, e jashtme, dhe një tjetër që rri strukur në brendi të secilit.

Në anë tjetër, përse ne deshën të na shpërngulnin në Turqi? Kush do të mund të imagjinonte, aq më shumë unë, një fëmijë i formuar me vetëdijen se shteti mund të duhet dhe të respektohet, që ky shtet synon të të shkulë familjarisht nga vendlindja, nga trualli yt?! Askush. Pastaj, përfytyrimi i gjithmonshëm i policëve, që sillen natën rreth shtëpive, ndërsa qentë lehin dhe nëpër rrugë dëgjohen hapa misteriozë, enigmatikë, në një kohë e gjithë shtëpia kridhet në heshtje, në pritje se mos po troket porta. Për çka mund të vinë, kënd do të marrin? Gjyshin që rrëfen tregime të çuditshme, për ndonjërin nga krajlat e Serbisë, që rri mbi kalin e bronzte në Beograd dhe që shikimin e mban të drejtuar nga Kosova? Apo babën, që është i frikësuar, që hesht dhe nuk flet asgjë? Apo mixhën që është përparimtar, i cili insiston me çdo kusht që edhe vajzat të shkojnë në shkollë? Pse, pra, kjo trysni? Pse kjo pritje në ethe?

Përveç kësaj, simundtëbëhetmikmeshtetinnjëkatërmbëdhjetëvjeçar, i cili çdo të hënë zgjohet në orën tre-katër të pas mesnatës, për të shkuar në shkollë, për t’i kaluar kodra e lugina, rrugë pa rrugë, për të arritur në Prishtinë me një strajcë të mbushur me bukë, jo për një ditë, por për tërë javën, deri sa të mykej dhe të bëhej e papërdorshme...? Pse kjo vuajtje? Pse kjo varfëri? Ku duheshin kërkuar shkaqet e gjithë kësaj? Përse ne nuk mund të ishim të lumtur si të gjithë njerëzit e tjerë të botës? Pse bota në të cilën jetoja, nuk ngjante aspak me atë që ne ëndërronim?

Nuk mund të them se në ëndrrat e rinisë së hershme unë kërkoja gjëra të mëdha. Ishin ëndrra të vogla, për gjëra krejt tokësore, që bota zakonisht nuk i ëndërron, sepse i ka afër dhe i prek me dorë. Pra, ne, gjeneratës sime, na i kishin vjedhur ëndrrat e fëmijërisë dhe të rinisë, ato ëndrrat e bukura për gjëra të paarritshme dhe na kishin lënë të përballeshim me vuajtje për gjërat më të zakonshme. Në vend që të ëndërroja pallate të bukura të mbushura dritë e shkëlqim, princesha



*Me miqtë e mi: Xhemajlin e Veliun, 1968*

të veshura me të bardha, që ngjajnë me fluturat krahëlehta të pranverës, unë isha i shtrënguar të ëndërroja kafshatën e bukës, të ëndërroja një pjatë të mbushur me gjellë, një këmishë të re ose pa harrna, apo një palë këpucë në vend të opingave prej llastiku. Apo, kur bënte dimër dhe acar, të ëndërroja një vend të ngrohtë, një shtrat të ngrohtë dhe një veshje që do të më mbronte nga thëllimi i akullit.

Të jesh i vetëdijshëm për të gjitha këto, nuk bëhet fjalë për ndonjë farë nacionalizmi fëminor, siç do të quhet më vonë çdo prirje për pakënaqësi kombëtare, por për formim normal të një njeriu, në rrethanat çfarë t'i kanë përcaktuar të tjerët. Prandaj, sipas bindjes sime, një shqiptar i Kosovës në këtë moshë fillon e bëhet i vetëdijshëm, fillon e mendon për veten e vet, si njeri normal. Kjo pjekje imja, ky maturim i imi, përputhet me maturimin shoqëror masiv të bashkëvendësve të mi. Ata filluan të kërkojnë më shumë të drejta dhe zhvillim më të shpejtë ekonomik. Të drejta shoqërore, sepse represioni i shtetit ua kishte sjellë në maje të hundës; dhe zhvillim ekonomik, sepse varfëria i kishte tejkalar përmasat e durimit njerëzor. Idetë nacionaliste dhe shkëputëse apo irredentiste do të shfaqen fuqishëm më vonë masivisht, kur u bë e qartë se në atë konstelacion politik që kishte Jugosllavia, shqiptarët e Kosovës nuk mund ta realizonin as njërën, as tjetrën.

Mbaj mend se në atë periudhë, nga të rriturit kisha dëgjuar emrin

e Adem Demaçit. Si fëmijë që ishim, natyrisht që ne nuk i kuptonim shumë gjëra që thuheshin për të. Por, sido që të jetë, ai tashmë ishte bërë pjesë e vetëdijes sonë, asaj pjesës së fshehtë dhe të mbyllur të vetëdijes, e cila nuk shfaqej, nuk artikulohej, por ishte brenda nesh. Ai kishte kërkuar dhe kishte bërë diçka që ne të gjithë e dinim se ishte e drejtë. Nëse këtë nuk e shfaqnim, kjo nuk kishte të bënte me vetëdijen, por me rrethanat, të cilat kishin bërë që secili të ngërthente në vete një personalitet të dyzuar. Shikuar nga ana psikologjike, në botën e shumë njerëzve të asaj kohe zhvillohej një luftë e brendshme, jo rreth ndonjë dileme se cila rrugë ishte e drejtë, por cila do të fitonte dhe çfarë duhej sakrifikuar për të arritur qëllimin.



*Gjithmonë në kërkim të diçkaje të re. Ishte 1968-a e revolucionit rinor në mbarë Europën. Edhe Kosova lëvizi...*

Mes dilemash të tilla të rritjes sime fizike, por dhe shoqërore, unë u regjistrova në Shkollën Normale të Prishtinës. Nga njëra anë, ky ishte vendim, të cilin e kisha marrë me ndihmën e të tjerëve, të gjyshit në radhë të parë. Nga ana tjetër, në atë kohë unë isha një katërmbëdhjetëvjeçar, jeta e të cilit duhet të merrte një rrjedhë tjetër, e ndryshme nga e prindërve dhe familjarëve të mi. Ishte një sfidë, me të cilën duhej të përballësja. Në rend të parë, duhej të sfidoja kushtet e rënda, duke mbajtur moralin dhe synimin për të arritur diçka. Së dyti, duhej të përballoja dilemën e brendshme: ku mund të arrihej kështu, deri në cilin cak, deri në çfarë pike? Së

treti, duke u shkëputur për herë të parë nga jeta patriarkale, ku deri atëherë të tjerët merrnin çdo vendim për mua, tani duhej të ruaja drejtpeshimin, që të mos humbja torruan, fillin e gjërave dhe liria e të vepruarit deri diku në mënyrë të pavarur, mos të ma errësonte mendjen dhe idenë e ecjes përpara.

Në Shkollën Normale të Prishtinës, për shkak se isha nxënës i shkëlqyer, u regjistrova pa provim pranues. Shkolla ka qenë po ajo që ka mbetur deri vonë e tillë, atëbotë në periferi të Prishtinës, rrugës për në Gërmi. Për rrethanat e atëhershme, ishte godinë prestigjioze, me enterier të rregulluar mirë, me klasa të pajisura në mënyrë korrekte dhe me mjedisin rrethues të mbajtur me kujdes. Kishte edhe konviktin aty pranë, ku sot është Universiteti Amerikan, mjediset e të cilit unë i kam financuar sot edhe me nostalgjinë e dikurshme. Konvikti shërbente kryesisht për ata që vinin nga larg, nga Maqedonia dhe Mali i Zi, ose për ata që konsideroheshin me probleme sociale. Pavarësisht se kushtet e mia ishin të rënda, unë nuk konsiderohesha i tillë, sepse për konceptin e atëhershëm vija nga një familje e kamur fshatare. Ne kishim mjaft tokë, kishim bagëti, kishim mullirin. Pra, me një fjalë, nuk ishim të varfër.

Pikërisht këtu dua të them diçka për Prishtinën e asaj kohe, ashtu siç e shihja unë, që vija për herë të parë në një qytet. Prishtina edhe atëherë i ka pasur disa nga godinat administrative-shtetërore, që i ka edhe sot, përfshirë edhe një pjesë të qytetit që edhe sot quhet qendra e tij. Ato ishin simboli i qytetit socialist, i dominimit të së resë mbi të vjetrën. Bërthama e Prishtinës së vjetër, asaj që quhet arkitekturë dhe rregullim tipik i një qendre qytetare me traditë, tashmë ishte shkatërruar, me ndërtimin e godinës së Kuvendit Popullor, të Komunës dhe të sheshit mes tyre. Pastaj aty ishte po ky Teatri që është sot, Hotel "Unioni" aty pranë, pastaj "Bozhuri" i dikurshëm, aty ku është sot Hotel "Iliria", krejt ajo rrugë, deri te sheshi i sotëm "Zahir Pajaziti". Në atë shesh dikur kishte qenë një kishë katolike, po atëherë ishte e rrënuar, sikundër edhe një nyje tjetër e qytetit të vjetër, që i binte te Hamami (përveç Xhamisë së Madhe, aty kishte qenë edhe një sinagogë e hebrenjve), ishte shpartalluar pothuajse tërësisht. Ndërkaq, midis Teatrit dhe "Unionit", që i binte në një mënyrë mes për mes Prishtinës, kalonte ajo përroska e njohur, që më shumë se përroskë,



ishte kolektor i hapur i kanalizimit. Me gjithë këto ndryshime në qendër dhe rreth saj, sapo dilje që andej dhe merrje rrugët dhe rrugicat anësore, dukej sikur koha atje kishte mbetur në vend: rrugët e pashtruara dhe me baltë, rrugicat e ngushta, me vijat e kanalizimit që shkonin anash, shtëpitë e vogla prej qerpiçi, oborret e rrethuar me mure gjithashtu prej qerpiçi, me kapixhike të ulët, që mezi futeshe dhe dilje prej tyre. Këtë e mbaj mend mirë, sepse në një shtëpi të tillë, diku në Prishtinën e vjetër, pranë asaj përroskës që mbante erë kanalizim, në një dhomë me qira kam banuar edhe unë për disa vjet. Më bënte përshtypje fakti se të zotët e shtëpisë e quanin veten turq, sikundër edhe shumica e banorëve me origjinë qytetare të Prishtinës së atëhershme. Ata ishin luajalë ndaj pushtetit dhe nuk arsimoheshin. Kryesisht merreshin me zejтари dhe me ndonjë punë sekondare në administratë. Në disa pikëpamje, duke marrë parasysh numrin e tyre të kufizuar dhe identitetin e luhatshtëm, ata mund të konsideroheshin popullsi e privilegjuar në Kosovë. Megjithatë, është kjo kohë, kur numri i tyre bie në mënyrë të shpejtë. E përmenda këtë fakt, sepse në atë kohë në Prishtinë ende ishin të diferencuara qartë shtresat e popullsisë: të ishe qytetar, duhej të dije të flisje turqisht; të ishe pjesë e asaj që quhej “borgjezi e kuqe”, duhej të ishe i veshur mirë; të ishe fshatar, si unë, e kishe të shkruar në ballë se i takoje një klase më të ulët të shoqërisë.

Këto diferenca sociale unë i hetoja mirë, sepse ngado që shkoje, përballëshe me një lloj përcëmime dhe refuzimi. Pavarësisht se shkolla ishte një vend ku bëhej një përzierje e shtresave shoqërore, ndarja e brendshme ishte e evidente. Secili jetonte në rrethin e vet social. Unë që vija nga fshati, e kisha të pamundur të integrohesh në njërin apo tjetrin shtresë. Ndoshte të pëlqente një vajzë e bukur, e veshur me fustan e me këpucë me taka, me lëkurë të bardhë e të pastër. Edhe asaj mund t'i pëlqejte ti. Por kjo duhej të përfundonte shpejt, vetëm me ndonjë shikim dhe asgjë më shumë. Sepse në mes qëndronin diferencat klasore, të cilat i kishe në vetëdije se e bënë të pamundur çdo afrim. Atëherë, cila rrugë të mbetej? Të mësoje fort, të bëheshe nxënës i mirë që së paku, për diçka të bije në sy. Ndryshe rinia të shkonte kot, i pavërejtur nga rrethi shoqëror.

Sido që të ketë qenë, në Shkollën Normale gjeta aty një rreth të

ri shoqëror dhe u njoha me djem dhe vajza që vinin nga komuna të ndryshme të Kosovës, pastaj nga Maqedonia, nga Mali i Zi, nga Presheva. Më kujtohet se shok të gjeneratës kam pasur Jakup Krasniqin, pastaj Mustafë Sopin, Musli Krasniqin, Mehdi Kelmendin dhe një numër syresh, që tashmë nuk di ku gjenden. Edhe profesorët i kemi pasur shumë të mirë, të përgatitur për mësim dhe për edukim cilësor. Ajo që më bën përshtypje edhe sot, ka qenë entuziazmi i madh i të gjithëve, i nxënësve për të thithur sa më shumë njohuri dhe i profesorëve për të ofruar sa më shumë dije. Nga profesorët, më kujtohet kujdestari i klasës, Kallaba, që na jepte bazat e arsimit teknik, i cili, më sa di, ka qenë nga Maqedonia, pastaj Nasuf Krasniqi dhe disa të tjerë. Mbaj mend Fehmi Pushkollin, e Hakif Bajramin të cilët na jepnin më shumë se një lëndë.

Në përgjithësi, ka qenë një klasë e mirë. Edhe mësimi ishte shumë i organizuar. Unë vazhdoja të isha nxënës i mirë, ndër më të mirët në shkollë. Këtë perceptim profesorët e mbajtën për mua deri në përfundim të shkollës. Në klasë kemi pasur edhe vajza, dy prej të cilave ua mbaj mend emrin, sepse unë ua bëja detyrat pothuajse rregullisht. Ka qenë një Mihane Vllahija dhe Sabahate Kokolli. Kjo Sabahatja, më vonë, u martua me kujdestarin tim të klasës, Faik Kabën, një profesor shumë energjik nga Gostivari. Ai ishte shumë i rreptë, por gjithnjë më shkelte syrin sikur donte të më thoshte se bërtitjet vlenin për të tjerët dhe jo për mua. Ai gjithnjë më ka inkurajuar të vazhdoj me atë energji që unë kisha. Nga paralelet e tjera ku jepte mësim, dëgjoja se ai shpesh më përdorte mua si shembull. Profesori tani jeton në Prishtinë dhe kam dëgjuar se ka fëmijë të zot. Mihania jeton tani në Gjermani (me këtë kam marrëdhënie shoqërore edhe në ditët tona). Ka qenë një vajzë shumë e mirë, shumë e moralshme, por ne, atëbotë, kishim një perceptim tjetër për të, sepse veshte “mini”, pra e konsideronim si femër “të lehtë”, në një kohë që pothuajse të gjithë djemtë e klasës kemi qenë të dashuruar në të. Ishin nga ato dashuritë tipike të moshës dhe të kohës, që e ndjen, por nuk e shpalos, nuk e rrëfen. Të gjithë djemtë e klasës shtyheshim se cili prej nesh do të ulej në një bankë me të. Në raport me mua ajo ka qenë shumë e sjellshme, shumë e afërt, por kush guxonte ta shprehte atë që ndjente, ndër të tjera, edhe për

shkak se ajo ishte qytetare, kurse unë vazhdoja të isha nxënësi i mirë me pantallona dhe këmishë me harrna, me opinga llastiku. Për shkak të kësaj situate, të statusit tim social, i cili identifikohet lehtë nga pamja, unë pothuajse asnjëherë nuk dilja në pushim, as të gjatë, as të shkurtër. Madje, as atëherë kur kishim ndonjë pauzë, unë përsëri rrija në klasë, në një kohë që djemtë e tjerë gjezdisnin poshtë e lart me vajza. Në një anë, kjo situatë krijonte gjendje të rëndë për mua, por, nga ana tjetër, m'ï nxishte ambiciet të mësoja shumë, të isha i rregullt në mësim dhe në secilën orë apo në secilën lëndë të shfaqesha i përgatitur, pa përjashtim.

Shkarazi, pak më herët e përmenda bukën që e merrja me vete të hënën, ndërsa kthehesha nga Mareci, dhe atë bukë e kisha për tërë javën. Deri të mërkurën ose të enjten, ajo bukë hahej disi, por pastaj mykej dhe bëhej e papërdorshme. Atëherë më duhej të blija ndonjë copë bukë, në mënyrë që ta shtyja javën deri në fund. Nëse kjo nuk ishte e mundur, sepse nuk kisha para, atëherë ishte tjetra alternativë: do të merrja rrugën këmbë për në Marec, shpesh dy herë në javë. Më kujtohet edhe tani një situatë, që ka lënë vragë të pashlyer te unë. Më duket se ka qenë pranvera e vitit 1968. Unë shkova në Marec dhe i thashë axhës se kisha nevojë për pak para, se ato më duheshin për libra, fletore dhe veshmbathje. Ishte njeriu që më kuptonte më së miri në këtë pikë. Mirë, thotë ai, *ja bajmë disi!* Shkojmë në mal me të dhe presim dru, i ngarkojmë në dy qerre dhe nisemi t'i çojmë në Gjilan. Mirëpo, ndodhi si ndodhi, dhe rrugës na zë policia dhe na i konfiskon drutë. Po tani, si t'ia bënim? Axha ma jep idenë, kurse unë e realizoj: ta marr nga tufa e bagëtisë një cjaq dhe ta çoj për ta shitur në Prishtinë. Babës dhe njerëzve të shtëpisë do t'u thoshim se cjaqi kishte humbur, se e kishte hangër ujku, ose diçka e tillë. Ishte cjaqi më i mirë që kishim. Ishte shumë i bukur dhe i dashur. Ai ishte në gjendje të vinte pas meje, kudo që t'ï prija.

Dhe kështu, zgjohem unë që me natë, siç bëja zakonisht kur doja të shkoja për Prishtinë, e ndjelli cjamin të vijë pas meje dhe nisem. Në mëngjes, kur nxënësit e Shkollës Normale shkonin në shkollë, andej nga Tauk-Bahçeja (sepse nga ana e Gërmisë e bëja rrugën për Prishtinë), mua më shihnin të gjithë, te ecja anës tjetër të rrugës me cjamin që më vinte prapa. Mundohesha të mos i shihja, por e dija se

ata më shihnin mua dhe e hetoja një tallje në shikimet e tyre, që më përcëllonte si zjarr. E çova cjapin në pazar dhe e shita. Merret vesh, e blenë kasapët dhe ata e morën ta pritnin. Unë e çoj deri te vendi, ku ata e thernin bagëtinë. Kasapët si kasapët, e rrëmbejnë cjapin tim, e shtrijnë përtokë dhe ia vënë thikën në fyt. Dhe mua më duket sikur cjapi më shikonte gjatë gjithë kësaj kohe, madje edhe atëherë kur ia prenë fytin, sikur shprehte habi me atë që i ndodhte, sikur më qortonte dhe kërkonte ndihmë prej meje. Që nga ajo rrethanë, unë kurrë më në jetë nuk do të jem në gjendje të pres asnjë bagëti, as një pulë. Dhe as ta shoh me sy aktin e prerjes së bagëtisë. Është një veprim që akoma më trishton dhe gjithmonë më sjell në mendje cjapin tim, të cilin, në një mënyrë, unë e tradhtova. Nga ana tjetër, për këtë “rreng” që ia kishim punuar familjes, pra për cjapin nuk e kishte hangër ujku, por që e kisha shitur unë, mixha dhe unë kemi heshtur për vite të tëra, deri sa shkova në Gjermani.

Afërsisht, kjo ishte situata deri në klasën e tretë të shkollës së mesme. Meqë shkolla normale bëhet pesëvjeçare, që domethënë se me të merrje kualifikimin për mësues, për mua që synoja studimet, ishte një vit i humbur kot. Atëherë vendosa të kaloj në gjimnaz, në Gjimnazin e Prishtinës, që atëherë mbante emrin “Ivo Lolla Ribar”. Pa dyshim, ishte shkolla e mesme më e mirë në Kosovë. Aty ishin fëmijët e elitës së Prishtinës, aty ishin profesorët më të mirë, shumë prej të cilëve me kohë u bënë profesorë të Universitetit. Por, që të pranohesha në gjimnaz, duhej që të jepja disa provime plotësuese, për ato lëndë që nuk i kisha mësuar në shkollën normale. Njëra nga ato ishte edhe latinishtja, të cilën unë e mësova për dy javë dhe e dhashë provimin me notë të shkëlqyer, madje duke befasuar profesorin. Ai hapte librin e latinishtes në një vend, më thoshte, bëj zgjedhimin e kësaj foljeje, unë ia thosha pa asnjë gabim. Hapte librin në një vend tjetër, bëj lakimin e këtij emri, unë përsëri ia thosha pa gabime.

Pra, edhe në gjimnaz, unë vazhdova të ruaj statusin e nxënësit shembullor. Por, në anën sociale, tani gjendja ime paraqitej edhe më e rënduar. Ndërsa në Shkollën Normale struktura e nxënësve ishte heterogjene, një konglomerat social, me dominim të hetueshëm të nxënësve me origjinë fshatare, në Gjimnaz pikë referimi ishin fëmijët e elitës pushtetare të Kosovës. Ata visheshin sipas trendit

të kohës, sepse ishin fëmijë të funksionarëve të lartë politikë dhe partiakë, fëmijë drejtorësh, gjykatësish, titullarësh të niveleve të larta. Mbiemrat e tyre, pothuajse të secilit, kishin domethënie jo vetëm për ne nxënësit, por edhe për profesorët dhe drejtorinë. Ata nuk i merrte kush në përgjegjësi për mungesa, për vonesë në orë, ose për ndonjë veprim tjetër, që mund të binte në kundërshtim me disiplinën dhe rregullat e shkollës. Në pushimin e gjatë ata dilnin dhe hanin bukë nëpër qebaptoret përreth gjimnazit, ndërkohë që unë vazhdoja të qëndroja në klasë, gjithnjë i vetmuar, njësoj si në Shkollën Normale, me një ndryshim se këtu, derisa i shikoja se çfarë bënin ata, dëshpërimi dhe lëndimi i brendshëm bëhej akoma më i madh.

Në këtë periudhë kohore ndodhin demonstratat e vjeshtës së vitit 1968. Më kujtohet çdo detaj i asaj mbrëmjeje të 27 nëntorit. Me banesë isha te “Vellusha e Epërme”, madje më kujtohet edhe numri i shtëpisë-26. Banonim në një dhomë me kushëririn tim, Sahit Pacollin dhe Gani Mjekiçin (më vonë bashkëpunëtor i afërt i imi). Tani nuk e them dot, kush na ka njoftuar se atë ditë, pra më 27 nëntor, do të kishte demonstrata. Nuk e di kush e ka shpërndarë lajmin, por ne e kemi ditur pothuajse të gjithë. Ishte e pritshme se shumica e nxënësve të Gjimnazit të Prishtinës nuk do të merrnin pjesë në atë demonstratë, veçmas jo fëmijët e elitës politike. Sa u përket nxënësve, më të shumtë kanë qenë ata të Normales dhe të Shkollës Teknike, prej të cilëve, madje, njëri edhe u vra, siç thuhej atëherë, jo nga të shtënat e policisë, por ballkonet e banesave të serbëve. Çfarë bëme ne? Dolëm, ia bashkuam turmës dhe brohoritëm njësoj si ata: Liri! Rroftë Adem Demaçi! Republikë! Universitet! Para Teatrit dikush mbajti fjalim dhe i paraqiti kërkesat e demonstruesve. Më pastaj turma shkoi në drejtim të Fakultetit Filozofik dhe, aty, në oborrin e Fakultetit, më kujtohet se demonstruesve u është drejtuar Mark Krasniqi. Mbaj mend se ka qenë një fjalim elokuent, nxitës dhe qetësues njëkohësisht. Ai tha pak a shumë se *pikërisht në këtë vend, ku jemi të mbledhur sonte, do të lindë Universiteti i Prishtinës dhe se për këtë udhëheqja politike e Kosovës kishte marrë garanci nga Titoja!* Madje dikush thoshte se Mark Krasniqi atë natë kishte folur direkt me Titon në telefon që në atë kohë ishte në Split. Kanë thënë

më vonë se ka pasur edhe parulla për Shqipërinë dhe Enver Hoxhën, por diçka e tillë mua nuk më kujtohet.

Edhe përkundër fjalimeve që u mbajtën para Fakultetit Filozofik, turma nuk u qetësua. Përkundrazi, ndodhi elektrizimi më i madh i masës, e cila në disa vende u konfrontua me policinë. Në njërin nga këto konfrontime, unë pësova një prerje në dorë, shenja e së cilës është e dallueshme edhe sot e kësaj dite. Ishte një prerje aksidentale gjatë shtyrjes me policinë. Unë e vërejta se dora më rridhte gjak dhe se prerja ishte e thellë. Megjithatë, nuk guxova të shkoj te mjeku, por kushëriri im ma lidhi plagën si diti dhe si munda. Të gjithë thoshin se ata persona të plagosur, që kërkojnë ndihmë mjekësore për shkak të plagëve të marra në demonstratat, arrestoheshin nga policia.

Dhe, kështu, ditën e nesërme Prishtina gdhiu në një gjendje shtetërrethimi. Tanke dhe polici kishte kudo. Edhe gjurmët e shkatërrimeve të një dite më parë ishin të dukshme, veçmas kishte shumë dyqane të thyera, xhama ndërtesash publike dhe shtetërore dhe gurë e gjësende të tjera të shpërndara gjithandej. Dukej qartë: kishte qenë një rebelim me përmasa të mëdha, ku ishin mbledhur në një vend nxënësit dhe studentët, sa të shtyrë nga pakënaqësia e sa të nxitur nga kërkesat politike për më shumë të drejta, për më shumë barazi, përfshirë këtu edhe kërkesën kryesore për konstituimin e Kosovës si republikë e barabartë në Jugosllavinë e atëhershme.

Nuk mund them se unë dhe shokët e mi ishim krejt të vetëdijsëm për peshën e këtyre kërkesave politike, por ne tashmë e ndjenim se diçka duhej ndryshuar, në mënyrë që jeta jonë të merrte një rrjedhë më normale, të kishim një perspektivë për të nesërmen dhe një vizion më të qartë për të ardhmen. Këto ishin kërkesa që mund të mos kishin asnjë lidhje me ndonjë program politik, qoftë edhe të organizatorëve, por ishin, si të thuash, kërkesa që buronin nga brendia, nga vetëdija e krijuar, veçmas te masa e të rinjve, të cilët, në harmoni me trendet e reja, kërkonin zgjerim të hapësirës politike, e cila në Kosovë ende u nënshtrohej shtrëngesave dhe kufizimeve të shumta.

Pavarësisht se demonstratat nuk u mirëpritën as nga udhëheqësit politikë lokalë, pra të Kosovës, dhe as nga ata qendrorë të Beogradit, disa zhvillime pozitive do të marrin hov pikërisht në atë periudhë. Me

neve që protestuam, u solidarizuan edhe studentët nga Universiteti i Beogradit. Nuk e di për çfarë arsye Kosova do të fillonte ta zgjeronte autonominë, do të fillonte të konsolidonte institucionet e veta dhe arsimimi i popullsisë, deri atëherë i lënë pas dore, do të merrte hov me një shpejtësi të paparë. Ndryshime pozitive shpresoheshin edhe në perspektivë. Por ne, veçmas gjenerata ime, që ishte në kulmin e energjisë, a kishim kohë të prisnim më? Neve na duheshin ndryshime të shpejta. Ne na duhej jetë më e mirë menjëherë. Ne na duhej e ardhme më e qartë.

Meqë jemi këtu po ju tregoj njërin prej përjetimeve të mia djaloshare për pabarazitë kombëtare në Prishtinë që ishin si kudo gjatë edhe pabarazi klasore. Kur dilnim në mbrëmje, në krah të atij që është sot restoranti *Rings*, korzoja ishte ndarë në dy anë. Nga ana e *Ringsit* shëtisnin shqiptarët, më anë tjetër, ecnin serbët. Kjo ishte diçka që më bënte përshtypje të madhe. Diku në qendër gjendej hotel *Bozhuri*, sot *Iliria*, në sallën e të cilit këndonin 5 vëllezërit Kariç që kishin dhe një motër. Ne i qaseshim sallës nga ana e xhamave ku vareshin perde të trasha dhe shikonim ç' bëhej brenda nga ndonjë rreze drite që krijohej atje ku s' shkonte perdja. Salla ishte mbushur plot me serbë të veshur me këmisha të bardha dhe asnjë shqiptar. Birrat që pinin, vinin erë deri përjashta. Shqiptarët ishin të varfër asokohe dhe as që mund të mendohej të hynin brenda në atë hotel. Ishte një kënaqësi e madhe për ne që të shihnim disa vite më vonë arrijten e autobusave me profesorë të Shqipërisë, që do të flinin për herë të parë në *Bozhur*. I ndiqnim ata duke i parë plot adhurim, dhe duke duruar shkopinj të policisë, por kjo nuk na dekurajonte. Dhe ëndërroja si do mund ta ndryshoja realitetin që më propozonte simbolikisht ajo sallë, jo vetëm unë, por gjithë gjenerata ime. Pata fat, Perëndia e desh që vitin e fundit të isha aty dhe të shihja sesi bagerat e kompanisë sime, shkatërronin pikërisht atë sallë, për të rindërtuar një hotel thuajse tërësisht të ri.

Mbase i nxitur nga atmosfera e entuziazmit të atyre viteve, në vitin shkollor në vazhdim, pra 1968/69, unë do të përfundoja dy shkolla njëkohësisht: do të merrja diplomën e Gjimnazit të Prishtinës dhe do të jepja provimet diferenciale në Mitrovicë për Shkollën Normale. Doja ta zija kohën në një mënyrë apo në një tjetër, dhe s'gjeja rrugë

më të mirë sesa të vijoja dy shkollat. Normalja ishte pesë vjet dhe më angazhonte bukur mirë. Mirëpo, i ngatërruar me këto ambicie, praktikisht më ndodhi diçka që nuk e kisha menduar. Për të marrë diplomën e shkollës normale, mua më duhej të bëja edhe dy javë punë praktike me nxënës dhe, meqë kishin filluar pushimet verore, unë nuk arrij ta bëj këtë punë praktike në afatin e paraparë. Kur u hap serish shkolla, unë shkova në Marec, i bëra dy javë të punës praktike, mora vërtetimin për këtë, por ndërkohë më kaloi afati i regjistrimit në shumicën e fakulteteve, së paku atje ku unë dëshiroja të regjistrohesh. Alternativë e vetme më mbetet gjeografia, ku ende nuk ishte plotësuar numri i studentëve. Më kujtohet shumë mirë kjo rrethanë, sepse u zhgënjeva tej mase.

Sikur të mos mjaftonte ky zhgënjim, po atë ditë më ndodhi edhe diçka tjetër që asokohe mu duk akoma më e rëndë, gati gati tragjike. Me të dalë nga fakulteti, ku tashmë isha zhgënjyer me atë që më kishte ndodhur, në rrugë e sipër, takova ish-kolegët e gjimnazit, Fatmir Rizën, më duket dy vajzat e Xhavit Nimanit, Burbuqen dhe Pranverën, dhe disa të tjerë të po kësaj kategorie. Të gjithë ishin të veshur bukur, sipas modës së fundit. Fatmiri mbante këmishë të bardhë, kravatë të zezë, pantallona të hekurosura dhe këpucë të lustruara. Ndërsa unë isha veshur ashtu si gjithmonë, me pantallona dhe këmishë me harrna, si mos më keq. Dhe ky Fatmiri me qasje krejt pozitive më thotë: shiko, ti nuk mund të vishesh më kështu, sepse tash je student, se tash për ty ka filluar një jetë tjetër, se nuk duhet të dukesh në këtë gjendje, nuk duhet të biesh në sy etj. Dhe të gjitha këto m'i thotë jo duke më tërhequr me një anë, por në sy të të gjithëve, në sy të vajzave. E kuptoni sa e rëndë është kjo për një djalë të ri, të cilin kjo bisedë, në ato rrethana i duket si poshtërim?

Kaq ishte ëndrra ime për universitet në Kosovë. Unë u largova prej tyre pikë e vrer dhe, pa i bërë tre hapa më tej, shpërtheva në vaj. Eca rrugës dhe qaja në heshtje. Lotët i fshija me mëngë. Pashë se nuk ishte koha për asnjë autobus për Marec, prandaj u nisa në këmbë, andej nga shkoja dhe vija gjithnjë, nga Shkolla Normale, nëpër Gërmi, nëpër Butoc e Mramor dhe arrij në Marec, gjithë rrugën duke qarë. Arrita te shtëpia dhe gjeta nënën duke gatuar për punëtorët që ishin duke mbledhur tërfojën nëpër livadhe. Ajo e hetoi se diçka më



kishte ndodhur, jo vetëm nga çehrja, por gjurmët e lotëve që më ishin përzier me djersë dhe me pluhurin e rrugës, që unë nuk kisha arritur t'i fshihja plotësisht. Dhe ajo më thotë:

*Eh, mor bir, e di se e ke zor. Je tuj hjekë shumë e po më dhimbesh.* Në këtë e sipër, aty, në shtëpinë e zjarrit, hyri gjyshi dhe nëna i tregoi se djalit i ka ndodhur diçka, se ka qarë gjithë rrugës. Edhe ai e kuptonte mirë gjendjen time ndaj më tha:

*Bania çaren vetes, se këtu nuk ke çka me ba. Ky vend asht i truem...* Unë e njihja mirë gjyshin dhe ai më njihte mua. Kjo donte të thoshte se ai e kishte peshuar mirë situatën time dhe e kishte parë se vërtet nuk mund të shtyhej më në atë gjendje. Një rropatje e pafund dhe në fund të ditës, asgjë.

Më pas, po atë ditë, bashkë me njëerën nga motrat, me Hasbien, marrim bukën për argatët dhe nisemi për në livadhe. Prapa na vinte qeni, një qen i madh, të cilin e kam dashur shumë dhe më ka dashur gjithashtu. Gjatë atyre viteve, sa herë që shkoja këmbë për Prishtinë, ai gjithmonë më shoqëronte deri në njëfarë vendi, deri sa binte drita, pastaj aty ndalej dhe kthehej te shtëpia, kurse unë vazhdoja rrugën time. Edhe të shtunave, ai gjithmonë më priste aty. Ishte një gjë e çuditshme. Kjo situatë kishte bërë që ne të ishim të lidhur shumë me njëri-tjetrin.

Dhe, ndërsa me motrën çonim bukën për argatët, unë i thashë asaj: Dua të ik, të largohem prej këtu, të shkoj te daja në Gjermani, në Hamburg. Ajo u step nga habia. Ju zmadhuan sytë, kur, si? Mezi arrin të shqiptojë fjalët. Që tash, i them. Nuk e shtyj për asnjë deqik. Unë e kisha pasaportën, sepse pak kohë përpara, si maturantë, ne të gjimnazit të Prishtinës kishim qenë në ekskursion, me autobus, në Sllovakia. Dhe i them: ti çoje bukën tënde dhe kthehu e merre edhe këtë timen, - sepse nuk doja të shkoja në livadhe e të përballesha me babën. - *Nëse baba të pyet, ku asht Behgjeti, ti thueji se asht vonu, se nuk ka ardhë hala nga Prishtina.* E lashë bukën e argatëve aty dhe e urdhërova qenin që ta ruante. Ishte qen i tillë, që kur i thosha rri këtu, ai nuk luante vendit. Kjo ishte edhe një mënyrë që ta shmanga atë, që mos të më vinte prapa. Në këtë e sipër, u ktheva në shtëpi ku i tregova gjyshit për vendimin që kam marrë. Dhe kërkova ndihmën e tij.

“Po, bir”, më thotë. “Ty gjyshi t’i jep ato çka ka”.

Unë e dija se gjyshi e përjetonte keq largimin tim, sepse lidhja e vjetër, që nga fëmijëria, na mbante peng me njëri-tjetrin. Por ai ishte njeri i arsyeshëm dhe i kuptonte gjërat. Ai e dinte se, sado i dhimbshëm, largimi im tashmë ishte alternativa e vetme.

Dhe, po me këtë radhë, gjyshi nxjerr e m’i jep 500 banka, siç i thoshim ne atëherë, që i binte pesë mijë dinarë. Që të dy e dinim se kaq para nuk mjaftonin as për asgjë. Prandaj gjyshi shkoi te një kushëri yni, te Sabiti, dhe prej tij i mori edhe 500 banka të tjera. Dhe, më tha: nëse rrugës për Prishtinë takon dikë që ta merr mendja se mundet të të ndihmojë, kërkoja paratë dhe thuaji se gjyshi do të t’i kthejë. Atëherë, me nguti, bëra gati gjërat e pakta që mund të merrja me vete, i fus në një çantë a valixhe, e cila më duket se ka qenë e mixhës Ruhan, që kur ishte kthyer prej ushtrisë dhe nisem përsëri për Prishtinë. Me shumicën e njerëzve të shtëpisë nuk u përshëndeta. Me gjyshin po. E mbaj mend edhe sot pamjen e tij, te më përcolli deri te Lama. I gjatë, i bëshëm, me shall, me xhamadan. Dukej sikur një lis që del mbi majën e një kodrine dhe aty rri përgjithmonë.

Në të dalë të fshatit, rruga binte nga shtëpia e Ibush Gërbeshit. Ibushi edhe sot është gjallë. Ktheva te ai dhe ia tregova hallin tim. I them, *m’i jep do pare, më duhen për rrugë, se babagyshi do të t’i kthejë.*

- *Po ku ka me i marrë ai, i shkreti, më thotë Ibushi.*

- *Atëherë, më beso mue, se unë kam me t’i kthye-* i thashë i vendosur. Dhe Ibushi m’i dha jo 500 banka, por një mijë. U gëzova pa masë.

Tani e dija se rruga ime për në botën e lirë ishte e hapur.

## Ikja në botën e lirë

*Leksioni i parë i punës në Perëndim pas 60 orësh udhëtim drejt të panjohurës. Studimet në një universitet të shkëlqyer si ai i Hamburgut dhe magjia e teorive mbi tregun. Kthimi i përkohshëm në Kosovë dhe shërbimi ushtarak pranë Titos, por duke mbajtur sytë nga Perëndimi, ku u ktheva përsëri.*

**N**ë imagjinatën time, synimi për të shkuar në Perëndim ishte si tentimi për të dalë nga një tunel i errët. Ishte viti 1969. Kosova ende ishte vend i mbyllur dhe numri i atyre që kishin provuar mundësitë që ua jepte Perëndimi, ishte tepër i vogël. Ende nuk kishte filluar punësimi jashtë në mënyrë të organizuar, gjë që do të ndodhë pas viteve '70. Udhëtimi në disa shtete të Perëndimit, nga ish-Jugosllavia, mund të bëhej pa viza, por kjo nuk ndihmonte shumë. Në Kosovë tashmë ishte krijuar një mentalitet: kurbeti ishte një tragjedi për të gjithë ata që e provonin. Në kujtesën e popullit të Kosovës ende ishin të freskëta tragjeditë e shpërnguljes me dhunë për në Turqi. Largimi nga vendi yt, për botëkuptimin e atëhershëm, ende ishte një mallkim. Regjimet e deriatëhershme, përmes trysnive të ndryshme, ishin përpjekur në vazhdimësi që ta shpërbënin identitetin dhe substancën shqiptare të Kosovës, ndër të tjera, duke përdorur shpërnguljen si mjet për realizimin e këtij qëllimi. Prandaj, të qëndroje në Kosovë, edhe përkundër trysnisë së shtetit, edhe përkundër vështirësive ekonomike, ishte pjesë e ndërgjegjes patriotike.

Edhe përkundër kësaj, që nga vitet gjashtëdhjetë, një numër shqiptarësh të Kosovës filluan të iknin në shtetet perëndimore të Europës. Por shumica syresh ishin nga ata, që për një hap të tillë i kishte detyruar shtrëngesa ekonomike. Ata që kishin një mundësi sado minimale të ekzistencës në Kosovë, nuk e merrnin këtë rrugë. Kjo do të ndodhte edhe më vonë, edhe kur bëhet punësimi në mënyrë të organizuar, por edhe kur ikja në Perëndim u bë shans i vetëm i shumë kosovarëve për jetë normale. Do të ishte kjo njëra nga arsyet

kryesore, përse në Perëndim nga Kosova u dynd një shtresë e varfër e popullsisë, më e varfra që ishte, e cila, përveç që nuk kishte mundësi të siguronte mirëqenie në Kosovë, ishte edhe më e paarsimuara. Shumica ishin punëtorë krahu, pa asnjë profesion dhe pa arsimim elementar. Ndodhte shpesh që një pjesë e tyre, pasi mbërrinin në Perëndim binin në grackat e jetës së lehtë dhe pa punë. Të vije nga varfëria ekstreme, në mes të një pasurie të madhe që vezullonte nga vitrinat e ndritshme të dyqaneve plot e përplot, ishte diçka tronditëse, dhe para saj jo të gjithë reagonin njëllor dhe arsyeshëm, pasi joshja ishte e madhe. Pasojat e kësaj "yshtjeje" do të hetoheshin për një kohë të gjatë në radhët e një pjese të emigracionit kosovar në Perëndim. Ato hetohen edhe sot e kësaj dite te një pjesë e mërgatës, kur është fjala për ndikimin e tyre në imazhin e Kosovës, sikundër edhe për integrimin e të vështirë të një pjese të tyre në asnjërën anë, as në Kosovë, as në shtetet perëndimore. Megjithatë, kjo mërgatë në pjesën dërrmuese të saj, krahas problemeve, ka dëshmuar shkallë të lartë patriotizmi: grumbullimi i fondeve për arsimin paralel, për luftën, për protesta të ndryshme, për solidaritet janë vetëm disa prej dëshmimeve të këtij integrimi mes veti. Mes saj ka shembuj bukur të mirë integrimi në shoqëritë përkatëse. Madje është mëkat i madh që kjo pjesë e shoqërisë, që mban familjet, Kosovën vetë me mbështetje financiare është jashtë rrjedhave politike dhe nuk i mundësohet të votojë.

Unë, ndërkaq, largohesha për herë të parë nga Kosova, pasi kisha kryer shkollën e mesme dhe isha regjistruar në fakultet. Pra, nuk i takoja asaj kategorie, e cila në Perëndim do të mbetej e paintegrueshme. Nga ana tjetër, isha i vetëdijshëm për vështirësitë që mund të më dilnin përpara, sepse nuk dija gjuhën dhe nuk kisha një profesion. Megjithatë, një gjë e kisha të ngulitur në mendje: sido që të shkonin punët, nuk do të mbetesh punëtor krahu, sepse kisha ambicie, kisha vullnet që të ecja përpara, ndonëse hë për hë synimi im kryesor ishte ta përmirësoja, për aq sa ishte e mundur, statusin tim social dhe atë të familjes sime. Ky ishte synimi im afatshkurtër. Në planin afatgjatë, përpara kisha një mjegull, përtej së cilës në këtë situatë nuk isha në gjendje të shihja pothuajse asgjë të qartë.

Këto më sillëshin në mendje, pak a shumë, deri sa zura vend

në njërën nga kupetë e trenit Fushë-Kosovë–Beograd, ndërkohë që matanë xhamit kalonin me shpejtësi silueta të mbuluara nga terri dhe dritat e rralla të vendbanimeve të Kosovës së mbuluar nga ajo natë shtatori. Flija dhe zgjohesha, kotesha dhe këndellesha nën rrapëllimën monotone të rrotave të trenit, ndërsa në mendje kisha gjithmonë të njëjtën dilemë: a do të mund të realizoja ëndrrat e mia? Isha i ri që të mund të kisha frikë, por isha tepër i ri që të mund të kisha një vizion plot dritë.

Në mëngjesin e ditës së nesërme arrita në Beograd, qytet që, në pamje të parë, mu duk disi i huaj dhe refuzues. Kjo ndjenjë do të më mbetet për një kohë të gjatë në raport me këtë qytet. Edhe shumë vjet më vonë, kurdo që më rastiste të kaloja andej, në mendje më sillej ai refuzim i parë, që e kisha përjetuar një herë e një kohë.

Orët që më mbetën duke pritur trenin për në Hamburg, i shfrytëzova për t'i bërë një telegram dajës tim. Ia shkrova saktësisht orën e arritjes. Përsëri hyra në tren dhe përsëri një përkundje e gjatë midis ëndrrave dhe imazheve që shfaqeshin e zhdukeshin pas xhamave të trenit. Kësaj radhe përjetova edhe një nostalgji, e cila mbase vinte nga ideja se tashmë kisha filluar të ikja larg e më larg shtëpisë. Gati tani kishte filluar të më merrte malli për ato gjëra, që, çuditërisht, nuk na duken gjë kur i kemi pranë. Mbi të gjitha, ishin njerëzit e shtëpisë, nëna që e kisha lënë me lot në sy, gjyshi, motrat... Nuk them se isha sentimental. Më shumë kisha një mllef të brendshëm. Nuk e dija kush ishte fajtor, nuk e dija kë duhej të akuzoja, të shaja, për një padrejtësi që më ishte bërë në jetë. Për mendjen time, nevoja e ikjes nga shtëpia ishte një padrejtësi tokësore dhe qiellore njëkohësisht.

Pas 60 orë udhëtimi, arrita në stacionin e Hamburgut. Ishte një vagon treni, që lidhej lokomotivë pas lokomotive dhe që çonte drejt në Hamburg. Kjo ma kishte lehtësuar punën e ndërrimit të trenave, por më kishte bërë që t'i urreja ato tërheqje zvarrë nëpër binarët sekondarë të stacioneve. Pamjet ishin refuzuese, derisa treni merrte përsëri rrugën dhe unë humbesha duke soditur peizazhet e një bote krejt të panjohur.

Tashmë isha i sigurt se daja do të më priste në stacionin e Hamburgut. Ishte natë e vonë, kur u ndal treni nën projektorët e dritave të stacionit. Dola jashtë, duke tërhequr pas vetes atë valixhen

time të vjetër. M'u bë se mushkëritë m'u mbushën me ajër, pas aq orësh që kisha qëndruar mbyllur. Ndoshta më shumë se kjo, ishte ideja e një bote të lirë, tek shkelja për herë të parë. Shikoja rreth e rrotull, shikoja secilin kalimtar që mund t'i ngjante dajës tim, por asgjë. Ora ishte 23 dhe në Hamburg bënte ftohtë, ndërkohë që unë isha i veshur hollë. Për një kohë nuk guxova të largohesha nga peroni, sepse thosha me vete, daja mund të vinte nga çasti në çast dhe ndodhte të mos më gjente aty. Dikur hyra në stacion dhe aty qëndrova deri në orën tre pas mesnate, deri sa erdh policia dhe na nxori që andej, sepse duhej të mbyllej stacioni për një kohë, që të bëhej pastrimi. Ku të shkoja?

Matanë rrugës, për të cilën më vonë e mësova se quhej *Spitalerstrasse*, pashë reklamën e kuqe të një lokali të hapur. Ishte një piceri, megjithëqë atëherë nuk dija as çka ishte pica, as piceria. Por atje pashë një frekuencë njerëzish dhe prandaj u drejtova andej. Picat u shërbeheshin në dorë klientëve. Unë isha i uritur, pa gjumë, i rraskapitur dhe shkova dhe hyra brenda, në lokal. Më bëri përshtypje fakti, se personeli i picerisë nuk ishin krejt të bardhë, pra nuk ishin si gjermanët, por brunë, ose diçka e tillë. Pas një kohë, për fatin tim, kundruall meje vjen e ulet një djalë, njëri nga punëtorët e picerisë dhe më pyeti diçka. Unë i thashë se nuk di gjermanisht, se di vetëm pak frëngjisht. E vërteta, frëngjisht dija aq sa kisha mësuar në shkollë, por kurrë nuk kisha komunikuar me njeri në atë gjuhë. Ndodhi, atëherë, që djali i ri kishte qenë student nga Siria dhe frëngjishten e fliste mirë.

I rrëfeva studentit nga Siria si e kisha punën, se nga vija, se kisha bërë rrugë të gjatë, se në stacion të trenit ishte dashur të më priste daja, se nuk kisha para, se tani nuk dija as nga të shkoja dhe çfarë të bëja. Kërkova të më jepte të haja, duke i premtuar se, sapo të takohesha me dajën, do të kthehesha t'ia paguaja. Nuk di sa më kishte kuptuar, sepse në fillim ai nuk më qasi fare, madje edhe më nxori jashtë.

“Ik, ik, mos të t'i shoh sytë”, më tha, duke më dëbuar dhe duke më ndjekur deri në trotuar. Me valixhen time të mjerë në dorë, unë nisa të largohesha. Njerëz të këqij, thashë me vete. Botë e shkërdhyer! Si mund të dëbohet një njeri në mes të natës, që është i uritur, që nuk di ku të shkojë?!

Pasi i bëra disa hapa, ktheva kokën pas dhe pashë sirianin që ma bënte me dorë. Duket se ishte penduar që më kishte dëbuar. E kishte brejtur ndërgegjja, ose mua më pëlqente të pandehja diçka të tillë. U ktheva në lokal dhe, për habinë time, ai më nxori përpara një picë të madhe dhe një koka-kola. Deri atëherë as kisha ngrënë ndonjëherë picë, as kisha pirë koka-kolë. Hëngra si i babëzitur, sepse vërtet isha i uritur tej mase. Pas një kohe ma solli edhe picën e dytë. Siriani vazhdonte të shërbente në lokal, herë pas here kthehej te unë dhe dikur m'u ul përballë. Vazhdoi të më pyeste se si e kisha punën, çfarë do të bëja dhe gjëra të këtilla. Pak nga pak klientët u larguan, pastaj edhe personeli, sepse piceria mbyllej në orën pesë të mëngjesit, ngase fillonte dita e shtunë dhe të shtunën piceria nuk punonte, as ditën as natën.

Së fundi, siriani e mbylli picerinë nga brenda dhe më thirri t'i ndihmoja për pastrimin e lokalit. Tani që kisha ngrënë mirë, kisha mbledhur fuqi dhe i hyra punës pa përtesë. Gjithnjë kam dashur që punën, çfarëdo që të jetë ajo, ta bëj mirë. I bëra një pastrim dhe rregullim të shkëlqyer picerisë. Siriani më vëzhgonte me vëmendje si punoja, pastaj më ftoi të shkoja pas tij, nëpër do shkallë që zbritnin poshtë lokalit. Atje ishte një si dhomë e vogël, me një krevat brenda, i cili, siç më thoshte siriani, shërbente për pushim ditor të personelit. "Hëpërhë mund të flesh këtu", më tha ai, "kurse më vonë shohim e bëjmë. Nesër do të bisedoj me zotin Nesi".

Zoti Nesi, me gjasë, ishte pronari ose përgjegjësi i picerisë. Më vonë e mora vesh se ai ishte aksionar dhe kontrollor në 32 restorante. Ky z. Nesi të nesërmen pranoi që unë të punoja për një kohë në atë piceri, derisa të zgjidhej statusi im, në do merrja leje pune, apo si do të shkonte puna më tej. Kur e kuptova se mund të vazhdoja të punoja, m'u duk sikur tërë bota u bë imja. Isha njeri i lumtur, njeri me fat! I harrova të gjitha peripecitë, përfshirë edhe përshtypjen e keqe, të cilën e krijova në fillim. Tani kisha një punë dhe kisha një krevat, ku mund të flija. Të gjitha këto, falë studentit sirian, Ramazanit. Pikërisht kështu e kishte emrin që unë i jam mirënjohës për tërë jetën. Ai vazhdon të jetojë në Hamburg, është pronar i një restoranti dhe unë e vizitoj sa herë që më bie puna të shkoj në atë qytet.

Pastroja, restorantin për çdo ditë, gjersa e bëja të shkëlqente i tëri.



*Me Muslinë, Bajrushin dhe Zeqirin, që më ndihmuan shumë në Hamburg*

Zoti Nesi vinte herë pas here, në mbikëqyrje, shihte çdo gjë të rregulluar, më shihte si punoja dhe m'i rrihte krahët. Qëndrova duke punuar ashtu deri në fund të tetorit, nga dy e tre turne. Ndërsa laja pjatat sytë e mi shkonin te libri i gjermanishtes që duhet të mësoja. Ende i kam vrragë në duart e mia, prej asaj kohe, për mungesë të përqëndrimit në atë punë të lodhshme dhe fluturimit në libra.

Erdh koha që të më paguanin dhe atëherë unë mora hiç më pak se katër mijë marka, madje diç më shumë se aq. Kur markat i shndërroja në dinarë, nuk i besoja vetes.

Kurrë nuk kisha parë me sy aq shumë pare. Dhe atë ditë, pas më se një muaji, unë dola për herë të parë nga restoranti, nga piceria. Pas më se një muaji pashë diellin me sy!

Punën e parë që bëra ishte që t'ua ktheja paratë që u kisha marrë borxh Ibush Gërbeshit dhe mixhës Sabit. Ia dërgova edhe gjyshit një shumë. Pastaj, babës i shkrova një letër, në të cilën ia shpjegova hollësisht ku isha, çfarë kisha bërë, ku punoja etj. Disa fjalë të asaj letre ia drejtova nënës, sepse e dija se ajo ishte mërzitur shumë nga largimi im. Dhe, natyrisht, u premtova se edhe në të ardhmen do t'u dërgoja para rregullisht. Përshtypja ime ka qenë atëherë, se për shumë kohë baba nuk i ka prekur me dorë paratë që ia dërgoja unë, sepse ka qenë shumë i hidhëruar në mua, për shkak se kisha ikur pa e pyetur, pa e bërë dert me të.

Me ato para i bleva një dhuratë edhe Ramazanit, dhuratën e parë që i kam blerë dikujt në jetë. Ishte një *Eau de Cologne* duke menduar se me përzgjedhjen e kësaj dhurate e kisha nderuar shumë mikun



tim. Kur ia dhashë, vërejtja me dëshpërim se një të tillë ai tashmë e kishte në përdorim të përditshëm dhe mu duk se dhurata ime ishte një gjë krejt kot. Por ai e mori me shumë mirënjohje dhe respekt.

Vazhdova të punoja, kështu, deri nga fundi i nëntorit dhe pastaj një ditë u ula dhe bisedova me Ramazanin. Unë, i thashë atij, nuk dua ta kaloj jetën duke punuar në këtë mënyrë, sepse synimi im janë studimet. Meqë edhe vetë ishte student, ai e dinte se çfarë mund të bëja. Gjuha, kjo ishte e para, sepse pa gjuhë s'ka studime, s'ka shkollë, ma bëri me dije ai. Ke gati një vit kohë që të



*Hamburg, 1971. Universiteti ku studiova ekonominë ishte një hap i rëndësishëm në jetën time.*

përgatitesh, më thotë. Ndaj pa e shtyrë më gjatë, u regjistrova në një kurs intensiv të gjermanishtes, kështu që për gjashtë muaj, aty nga maji i vitit 1970, e kreu provimin e gjuhës dhe fitova të drejtën e regjistrimit në fakultet. Ëndërr imja kishte qenë ekonomia, prandaj u drejtova në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Hamburgut. Në kuadër të këtij Universiteti flitej se ishte hapur një katedër e re, në një ndërtesë të re, katedra e Tregtisë së Jashtme (Aussenhandel, siç e quanin në gjermanisht). Ishte një degë eksperimentale që zgjaste 5 semestra. Dikush duke ditur se ç'bëra më vonë mund të më pyesë, nëse kisha një prirje për biznes, ndërsa zgjodha këtë degë. Jo, për mua ishte pothuajse një konfuzion, ishte një diçka e re. Unë nuk kisha bagazh ekonomik, nuk kisha eksperiencë në menaxhim, ndërsa zgjodha të kryeja këtë shkollë. Unë nuk vija si kolegët e mi nga vendet ku ekonomia e tregut funksiononte. U ballafaqova me teorinë e komplikuar, por pas një kohe gjeta formulën ose më saktë

modulin si të realizoja në praktikë ato teori të mësuara atje. Kështu e kreu këtë fakultet, i cili në atë kohë është quajtur një akademi e lartë e biznesit dhe që ekziston në Hamburg edhe tani.

Këtu mund të them se fillon karriera ime. Ndryshova mënyrën e punës dhe të jetës. Punoja jo më shumë se katër orë në ditë, në mënyrë që pjesën tjetër të ditës të kisha mundësi t'ua kushtoja studimeve. Gjeja punë të ndryshme, punë të rastit. Mjaft punëdhënës e kishin emrin tim dhe, sapo u shfaqej nevoja për punëtor që kryente punë të përkohshme, më thërrisnin shpejt e shpejt. Kështu ta zëmë, në portin e Hamburgut, kur vinte ndonjë anije e madhe, që duhej shkarkuar sa më parë, nuk pyetnin sa kërkoje, por a ishte në gjendje të punoje. Ata e kishin emrin tim dhe, sipas nevojës, më thërrisnin. Por unë tashmë gjithnjë punën e harmonizoja me mësimin në fakultet, sepse atë e kisha parësor. Koha e studimeve ka qenë për mua vërtet një kohë e jetuar intensivisht: me një sanduiç në dorë autobuseve, nga universiteti në punë të ndryshme, për t'u mbledhur në banesë rreth orës 11. I kushtoja dhe dy orë të tjera leximit. Mesatarja e gjumit ishte praktikisht 4-5 orë në ditë.

Gjatë viteve të para të qëndrimit tim në Perëndim, përshtypje të madhe më linte mundësia e madhe që i ofrohej gjithkujt. Në doje të punoje, punë gjeje dhe paguheshe në mënyrë korrekte për këtë. Në doje shkollë, shkollë gjeje, mjaftonte që të ishte i zellshëm. Në doje të ushtroje një zanat, atë kishe mundësi ta bëje. Në doje kualifikim, edhe për këtë kishe mundësi. Kjo ishte botë e mundësive të pakufishme. Unë doja të studioja dhe ta mbaja veten me punën time, dhe për këtë m'u krijua mundësia. Më dukej se në këtë pikë unë e hetoja ndryshimin ndërmjet sistemeve, atij socialist, i cili më dukej sikur të bënte të ngatërroheshe me këmbët e tua, dhe atij kapitalist, që të nxiste të ecje përpara.

Në Hamburg i kalova gati katër vjet në këto rrethana, deri në verë të vitit 1973. Ia dola të merrja diplomën e fakultetit për biznes, ekonomi dhe menaxhim, dhe të specializohesha në një fushë shumë specifike, siç është tregtia e jashtme. Atëbotë, nuk e kisha idenë se do të ishte pikërisht ky kualifikim i lartë, që do të m'i hapte të gjitha dyert në jetë, natyrisht duke i shtuar asaj që kisha mësuar në mënyrë teorike, prirjen time për të hulumtuar dhe për të vepruar

në momentin e përshtatshëm. Asokohe me mua nuk kisha askënd nga Ballkani, veç një miku nga Koprivnica, me të cilin ishim miq të ngushtë. E di se ai është vrarë në luftën e fundit serbo-kroate. Shokët e tjerë të klasës, rreth 48, ishin në një numër të madh gjermanë, veç dy francezë.

Gjeografia politike më impresiononte posaçërisht. Sikur ta dija, asokohe se udhëtimet e biznesit, më vonë edhe të politikës, të lobimit për njohjet e ardhshme të pavarësisë së Kosovës etj. do të zinin pjesën dërrmuese të jetës sime. Ama një farë sinjali e kisha nga porosia profetike e gjyshit për udhëtimet me "ballanë". Po cilat ishin dituritë, apo leximet që më kanë mbetur në mendje prej asaj kohe? Merkantilizmi më ka tërhequr shumë si teori, si fillesë e tregut të lirë, që pastaj u shndërrua në realitet dominues të perëndimit. Owen (Owen), Rikardo (Ricardo) ishin autorët më të dashur. Në mësimet e asaj kohe dëgjuam për sukseset e babait të Engelsit, mënyrën e tij origjinale të menaxhimit të manifakturave të veta. Suksesi i tij mbështetej te marrëdhëniet e shkëlqyera që ai kishte vendosur me punëtorët e këtyre manifakturave. Ka qenë ky një mesazh i rëndësishëm i shkollimit tim. Ndërkohë u fiksova dhe në disa mësimet e tjera teorike mbi tregun, të cilat i kam përpunuar shpesh në eksperiencën time praktike të mëpastajme dhe ku që në fillim pata një qasje krijuese. Madje mund të them se ishte qasje hulumtuese siç do të dukej nga zgjedhja ime për temën e magjistrimit. Sepse më vonë thellova njohuritë e mia duke magjistruar në marketingun ndërkombëtar dhe manaxhimin e prodhimit në Institutin Mösinger në Cyrih(Zürich).

Tregu ishte magjia që më tërhiqte. Prokurimi, apo blerja, procesimi apo prodhimi, shpërndarja ose shitja, e formojnë një zinxhir treunazor procesesh të tregut që s'mund të ekzistojnë pa njëri-tjetrin. Progresi në secilën prej unazave sillte pasoja në secilin prej proceseve. Isha i mahnitur nga shpjegimet e këtyre proceseve, faktorët me ndikim në to, gjatë mësimëve të mia universitare dhe merresha shumë me to duke reflektuar mbi skemat unazore. Në komunizëm, këto procese shiheshin të shkëputur nga njëri-tjetri. Ashtu intuitivisht, apo si pasojë e atyre leximeve të kohës këtyre proceseve unë ua përngjita si faktor përcaktues, vendin ku gjendet

biznesi, origjinën e mallit. Sot në kohërat moderne, origjina e mallit, prejardhja e tij, përcakton procesin e globalizmit që ka përcaktuar rregullat e mëtejshme të tregut. Le të marrim shembull një prodhues disqesh në SHBA, i cili ka mundur ta shesë mallin sipas procesit të ndërtuar sipas tri unazave. Origjina e mallit, është element përcaktues në suksesin e tij. E kundërta ndodh me produktet kineze, të cilat mund të jenë të shkëlqyera, por ama origjina e mallit prej atij vendi, nuk është diçka gjerësisht e pranuar, universalisht e pranuar. Kur dikush, fjala vjen, thotë “kam një radio gjermane”, praktikisht ai afirmon supremacinë e origjinës gjeografike në cilësinë e mallit. Siç ju thashë, gjeografia ishte një lëndë e dashur për mua, ndaj unë kisha përfytyrime hapësinore të qarta. Në temën që magjistrova flisja pikërisht për globalizimin, diçka e paimagjinueshme asokohe. S’dua të them se kisha largpamje që në atë kohë, por disa përfundime të miat, të vërtetuara më pas, të debatuar më pas në një rrafsh universal, në forume të ndryshme akademike, politike, shoqërore, me të vërtetë më impresionojnë dhe sot.

Edhe përkundër faktit se kisha kryer një degë të respektueshme, edhe përkundër faktit se në atë kohë në Gjermani po ndodhte një zhvillim i jashtëzakonshëm ekonomik dhe ky shtet filloi të ngjitet me shpejtësi në shkallën më të lartë të eksportuesve në botë, unë nuk e shihja veten të jetoja dhe punoja në Gjermani. Pra, edhe përkundër këtyre mundësive që ofronte ky vend, unë nuk mendoja ta filloja karrierën profesionale në Gjermani. Doja të qëndroja i lidhur me Kosovën.

Nuk kisha para për të siguruar një banesë të denjë, por m’u gjendën disa miq nga Kosova të cilëve u jam mirënjohës për tërë jetën. Musli dhe Bajrush Zeqiri, djemtë e plakut Rexhë, nga fshati Pasjak, ishin njerëzit që më ndihmuan. Përveç hapësirës që më lanë në dispozicion, ata shpesh herë shpiknin diçka për të më lënë të mësoj në atë shtëpi. Më kishin blerë një biçikletë të cilën e lidhja në një shtyllë, afër stacionit të autobusit, pastaj merrja tren, derisa shkoja në vendin e punës. Kujtime të dashura për këta miq të dashur! Muajve të fundit të qëndrimit tim në Hamburg, kisha punuar nga ndonjë orë në ditë në konsullatën e Jugosllavisë në Hamburg. Konsulli jugosllav në atë kohë ishte një farë Predrag Simonoviq. Një burrë i

shkurtër, interesant në bisedë dhe fati e deshi që ai ishte nga Gjilani prej ku njihete mirë gjyshin tim. S'di pse, ai kishte simpati të veçantë për mua që nga dita e parë që më kishte njohur. Bile nganjëherë ai shpikte punë për mua vetëm që të fitoja dhe të ecja përpara. Këtu bëja përkthime nga shqipja ose serbishtja në gjermanisht. Për këtë punë merrja ca para, të cilat më duheshin gjatë studimeve. Konsulli më propozoi që unë të zija punë të rregullt pranë kësaj konsullate, por për këtë më parë duhej një pëlqim nga Kosova, më saktësisht nga Sekretariati i atëhershëm Krahinor për Punë të Jashtme, ku kryesori ishte Bejta Novobërdaliu. Me sa më bëhet e ditur, ai e shkroi rekomandimin dhe, sipas rregullit të atëhershëm, shkresa kaloi në Sekretariatin e Punëve të Brendshme. Jo që ata kishin ndonjë vërejtje për mua, por atje u gjend një person i papërgjegjshëm, i cili krijoi ca vonesa burokratike. Pra, miratimi u vonua së tepërmi, disa muaj. Prandaj unë vendosa të kthehem në Kosovë, pa e shtyrë më gjatë. Tani nuk e di se cili ishte motivi kryesor për një vendim të këtillë: familja, nostalgjia, botëkuptimi, patriotizmi, ndoshta edhe ideja për të kontribuar në vendin tim, tamam nuk e di. Por vendimi ishte i prerë.

Dhe, në korrik të vitit 1973, pasi bleva një *Ford capri* me 600 marka pasi e ngarkova atë me gjësende të ndryshme, me peshqeshe e dhurata, dhe pasi mora çdo gjë që kisha, u nisa për në Kosovë. As sot nuk e di se nga më vinte gjithë ai entuziazëm. Kosova, Prishtina, Mareci, nga ajo largësi, nga ajo distancë kohore që kur isha larguar, më dukeshin si diçka ideale, një vend ku duhej të përfundonin të gjitha rrugët e mia jetësore. Atje kishin nisur, atje duhet të sosnin. Mirëpo, ndodhi si ndodhi dhe pak pas nisjes më prishet makina, jo e prishur çfarëdo, por i pëlciti motori. Pra, ishte një prishje e tillë, që nuk mund të riparohej. U përpoqa t'ia hiqja dhe ta marr me vete një timon sportiv që kishte dhe që e kisha shumë për qejfi, por as këtë nuk arrita ta bëja. Atëherë, thirra me telefon një mikun tim kosovar në Hamburg. Ai ishte Shaip Gashi i cili më bëri të ditur se qenkësh duke u nisur me makinë për Kosovë. E prita aty dhe, bashkë me të, e përfundova kthimin aq të dëshiruar te familja, në Marec.

Të gjithë të familjes u gëzuan pa masë, por gjyshi më shumë se të gjithë. Tani ai ishte plakur dhe kishin kaluar gati katër vjet pa më

parë. Ndërkohë që im atë nuk më bënte shumë çehre. Ende nuk i kishte kaluar inati që kishte me mua, për shkak se isha larguar pa lejen e tij, madje pa e njoftuar fare. Ai nuk falte lehtë.

Mareci ishte ashtu siç e kisha lënë dhe për katër vjet gjërat pothuajse nuk kishin ndryshuar fare. Nga largësia, kur nuk isha aty, atë botë kodrinash pa fund, përfshirë shtëpitë e rralla, arat, rrugicat, përroin, mullirin, pra të gjitha i kisha menduar më ndryshe, sikur kishin përmasa të tjera, më të mëdha, sikur ishin një kozmos më vete. Tani që i kisha para sysh, më dukej një botë e vogël dhe e struktur, që mezi gjallonte nën peshën e pamundësisë së vet.

Natyrisht, ideja ime nuk ishte që të qëndroja në Marec, sepse tashmë kisha filluar të mendoja për një perspektivë ndryshe. Kisha bërë një shkollë speciale në botën e jashtme, sigurisht ndër të paktët, nëse jo i vetmi atëbotë në Kosovë. Nuk prisja ndonjë privilegj të madh për këtë, por, së paku, një vlerësim korrekt. Orientim mund të ishte Prishtina, ku tjetër? Pikërisht ato ditë marr vesh për një konkurs, që ishte hapur te Ndërmarrja hoteliere *Sloga*, e cila në nivel të Kosovës, mbulonte të gjithë hotelet në pronësi shoqërore. Shkova aty ku është sot hotel *Iliria*, ku *Sloga* e kishte drejtorinë e përgjithshme. Duhet të kem takuar dikë nga udhëheqësit e kësaj ndërmarrjeje, ndonëse nuk e di kë saktësisht. Ju paraqita: jam ky e ky, kam kryer këtë shkollë, kam punuar këtu e këtu, di të flas katër gjuhë... Urdhëro? Katër gjuhë?! Vetëm kjo iu duk interesante. Një djalë i ri nga Mareci, që folka katër gjuhë! Pse të mos shkosh të bëhesh recepsionist në ndonjërin nga hotelet, sepse aty mund të vijë dikush i huaj, e kupton? Një vend i tillë i zbrazët ishte në hotelin *Kalaja* të Kaçanikut. Isha i gatshëm të shkoja edhe atje, mjafton që të punoja diku. Por babai nuk më la.

*Jo, biro, nuk ban!*, më thotë babai im. *Ma mirë rri këtu me ne në Marec, se me shkue atje, me iu shërbye atyne pijanecave.*

Më lindi ideja që t'i drejtohem Bejta Novobërdaliut, atëherë sekretar krahinor i Punëve të Jashtme, i cili ishte i anës tonë. Pra, një lloj ministri i jashtëm, që, sipas rregullit, do të duhej të mbulonte edhe sektorin e tregtisë me botën. Bejta Novobërdaliu ishte dashamirës dhe unë e kisha parasysh faktin se ai e kishte dhënë pëlqimin për të punuar në konsullatën jugosllave në Hamburg. Megjithatë, ai nuk më ofroi ndonjë punë në sekretariatën që ai drejtonte, ku, mbase,

do të hapej një perspektivë më e mirë për mua, por në Fabrikën e Tekstilit në Gjilan. Megjithatë, isha mirënjohës, sepse aty do të kisha një punë, e cila, ndonëse nuk i përshtatej kualifikimit tim, ofronte një mundësi. Dhe sot kur e arsyetoj, e falënderoj pse mundësia që më ofroi, lidhej me ekonominë dhe jo me shtetin. Me sa kisha informacion, kjo fabrikë, në atë fazë të hapjes së tregut jugosllav, synonte të bënte një depërtim në treg, qoftë të brendshëm, qoftë të jashtëm. Bejta Novobërdaliu kishte folur me drejtorin e fabrikës, njëfarë Branko Zhigan. Të



*Bejtë Novobërdaliu*

nesërmen ai më priti në zyrën e tij dhe më ofroi postin e nëpunësit të lartë në sektorin për zhvillim. Shef kisha një serb, njëfarë Vlladën, që ishte plak, me koncepte tradicionale, por shumë punëtor. Ai më merrte me vete, ngado që shkonte. Po kaluar shumë kohë, më dhanë edhe banesë në Gjilan, nga ato që quheshin banesa kuadrosh. Meqë nuk kishin në dispozicion banesë më të vogël, më japin pikërisht banesën ku kishte banuar deri pak kohë përpara Bejta Novobërdaliu. Ishte një banesë e madhe, me katër-pesë dhoma, e cila mua nuk më hynte në punë, kështu që mobilova vetëm një dhomë të saj.

Vetëm disa ditë pasi fillova punën, më bënë edhe anëtar të Lidhjes së Komunistëve, madje me insistim të udhëheqjes së fabrikës, ndoshta për shkak se quhesha kuadër udhëheqës dhe, si i tillë, duhej të isha i përfshirë në organizimin partiak. Por çudia më e madhe ndodhi, që unë qëndrova në parti jo më shumë se një ditë! U bë një mbledhje e këshillit të punëtorëve, apo udhëheqjes së fabrikës dhe në atë mbledhje unë kritikova ashpër mënyrën e organizimit, mospunën, mungesën e disiplinës, cilësinë e dobët të prodhimit etj. Thashë se “këto gjëra që ju i quani suksese, janë dështime të mëdha”. Kaq mjaftoi, që të ma kumtonin që të nesërmen se, pas një diskutimi të tillë, nuk mund të isha anëtar i organizatës partiake, sidomos pse kisha kritikuar mënyrën e organizimit vetëqeverisës dhe klasën punëtoare, që, sikundër dihet, ishin bazat e sistemit të atëhershëm

politik dhe ekonomik jugosllav.

Me këtë rast, në ato forumet e tyre të mbyllura, në nivel të fabrikës dhe të komunës, duket se ishin thënë për mua edhe gjëra të tjera, se isha person i padëshirueshëm, ose, si quhej atëherë, i papërshtatshëm politikisht dhe marrëzi të tjera. Këto thashetheme bëheshin më të besueshme për shkak se unë vija nga perëndimi dhe isha i panjohur, apo i diskutueshëm për qarqet e “sigurisë” të asaj ane. Më çuan selam të takohem me përfaqësuesit e tyre. Dhe atje më merr në pyetje Selim Broshi, për të cilin kisha dëgjuar të fliteshin fjalë të ndryshme, por unë aty e njoha për herë të parë. Unë ia përsërita atij çdo gjë që kisha thënë në mbledhje, duke argumentuar përse kisha thënë se organizimi i punës ishte i dobët dhe në përgjithësi punohej keq, pa satisfaksion të punonjësve. Selim Broshi duket se nuk i dha rëndësi asaj që kishte ndodhur dhe unë vazhdova punën si më parë, pa ndonjë telash për t’u mbajtur mend.

Puna ime në Gjilan nuk zgjati shumë, sepse dy muaj pasi kisha filluar punën, më erdhi ftesa për të shkuar ushtar. Punën e fillova në shtator, kurse në nëntor më morën ushtar. Me kaq përfundoi karriera ime në Gjilan, sepse, kur u ktheva nga ushtria, në pranverën e vitit 1975, pashë se në vendin tim të punës ishte sistemuar një serbe, një grua e divorcuar me një fëmijë. Të them të drejtën, u ndjeva disi keq, kur dëgjova prej saj të më thotë:

“Ju qenkeni shoku Pacolli?... Më vjen mirë që u njohëm. Kam dëgjuar fjalë të mira për ju... Megjithëqë, për mua do të ishte më mirë të mos ju kisha njohur kurrë.” Dhe ajo më shpjegoi, se tani i duhej “t’i mblidhte çaklat” dhe të shkonte në shtëpi, sepse vendin e punës e kishte marrë me afat të kufizuar, pra deri sa unë të kthehesha nga ushtria. E pashë se u bë pikë e vrer, sa për faktin se do të mbetej pa vend pune, po aq për arsye se unë isha kthyer nga ushtria dy muaj më parë nga ç’e kishte pritur ajo.

“Rrini ju këtu”, i them asaj, “sepse unë nuk e kam ndër mend të kthehem më.”

Atë kohë, por dhe pak më vonë, në eksperiencat e mëpasme, me ekonominë jugosllave unë pata rastin të prekja në praktikë ecurinë e ndërmarrjeve ekonomike të vetadministruara sipas teorive të Kardelit. Shikoja punëtorët që duhej të zbatonin ato



teori dhe që qartësisht kishin vetëdije profesionale të ulët. Teoritë mbi ndarjen e profitit, motivimet, premitë, dukeshin sugjeshive për dikë si unë që kishte formim teorik perëndimor, pra ishin një realitet i ndërmjetmë organizativ, as socialist, por as kapitalist, apo më mirë dhe socialist, dhe kapitalist. Demokracia në ndërmarrjet me shkallë të ulët politizimi, pavarësisht pranisë së komiteteve të partisë në ndërmarrje, ishte gjithashtu diçka interesante. Pronësia e tyre madje, ishte diçka që të paktën në letër kalohej dhe te fëmijët që sipas ligjit duhej të gëzonin trajtime të veçanta. Ndërmarrjet i paguanin taksa shtetit, por dukej se punëtorët kishin shkallë të lartë vendimmarrjeje deri në zgjedhjen e drejtorit të ndërmarrjes. Lidhja e Komunistëve tentonte t'i drejtonte proceset, por të zgjidheshe drejtor nuk ishte domosdoshmëri të ishte anëtar i Partisë. Ishin këto veçori të socializmit vetëqeverisës jugosllav, që të paktën në nivelin teorik u kanë shërbyer hulumtuesve për studime krahasuese midis sistemeve ekonomiko-politike.

Sot kur ndërmarrje të tilla privatizohen, më vjen në mend pikërisht kjo eksperiencë e ndërmarrjeve të asaj kohe. Si një njeri që e njej kapitalizmin, në të gjithë planet, në teori dhe në praktikë, edhe në eksperiencë të suksesshme të përmasave të mëdha, nuk kam asnjëlloj nostalgjie për atë kohë. Kritik i hershëm i tyre, edhe sot i shikoj nga një këndvështrim ngushtësisht i rentabilitetit, i dobisë së tyre publike që asokohe ekzistonte për një numër të madh njerëzish. Pra disa ishin rentabël dhe punësonin një numër të madh njerëzish. Do të ishte e udhës që shteti sot të mos mendonte thjesht të siguronte profitin prej shitjes a privatizimit të këtyre kompanive, por të mendonte për ringjalljen e tyre atje ku është e mundur, diçka që do të kishte dobi për të gjithë, për punëtorët, për bashkësinë, dhe si pasojë dhe për shtetin. Por kjo është një temë tjetër që do ta trajtoj më vonë dhe që realisht më ka mundur dhe vazhdon të më mendojë për një kohë të gjatë.

Vendimin për ikje nuk e mora aty për aty. Tashmë unë kisha siguruar një vend pune në Austri dhe e dija se në Gjilan mund ta kaloja edhe ndonjë muaj, por jo më shumë. Fakti se unë mund të bëhesha shkas, që një nënë e re me fëmijë ta humbiste vendin e punës dhe burimin e të ardhurave për ekzistencë, më nxitën që ta

përshpejtoja vendimin për të shkuar në Austri. Prandaj, ndodhi që një muaj pasi u ktheva nga ushtria, t'i mblidhja ato pak gjëra që kisha në Gjilan dhe t'i çoja në Marec, ta dorëzoja banesën dhe të nisesha për Austri.

Për hir të kronologjisë së rrëfimit, më duhet t'i them disa gjëra për dhjetë muajt e kaluar në shërbimin ushtarak. Mendoj se është një episod interesant i jetës sime, prandaj ia vlen ta rrëfej, sepse, në njëfarë mënyre, ishte kjo periudhë kohe dhe ky shërbim që më bënë “qytetar të botës”, pra njeri që lëviz, që qarkullon nëpër vende të ndryshme dhe botën e madhe e konsideron si “shtëpi të vet”. As sot nuk e di saktësisht se cilat rrethana kanë qenë vendimtare, që unë të caktohem ushtar në të ashtuquajturën "Gardë e Titos", sepse të sistemoheshë ushtar në një njësi të tillë, madje në njësitin që do të kryente detyra speciale dhe tepër të rezervuara, nuk ishte shaka. Jo vetëm pse Tito ishte ai që ishte; jo vetëm pse Jugosllavia ishte ajo që ishte dhe unë isha shqiptar i Kosovës; por, në përgjithësi, në çdo vend të botës, për gardën e Presidentit ushtarët përzgjidhen me një procedurë të veçantë. E them me përgjegjësi, se ndaj meje ajo procedurë nuk është zbatuar. Së paku jo legalisht dhe botërisht. Në prapaskenë sigurisht që gjërat janë analizuar mirë dhe pastaj është marrë vendimi. Ndonjëherë kam menduar se mund të kenë qenë karakteristikat e mira që kanë shkuar nga Gjilani dhe Prishtina, në të cilat mund të ketë pasur dorë, p.sh., Bejta Novobërdaliu, gjë që nuk më është thënë kurrë. Më e mundshme është se bëhej fjalë për një rastësi, në të cilën mund të jenë pleksur disa rrethana. Për të qenë i sinqertë, unë nuk kisha shfaqur deri më atëherë diçka që mund të shqetësonte veçanërisht regjimin, hiq pjesëmarrjen në protestat rinore të 68-s, apo kritikën ndaj funksionimit të ndërmarrjes në Gjilan. Edhe familja ime nuk mund të thuhet se kishte veprimtari armiqësore kundër regjimit, nëse s'mund të quhet i tillë episodi i babait tim dhe “ftesa” për t'u shpërngulur në Turqi. Historia nacionaliste e paraardhësve të tjerë të fisit gjatë Luftës së Dytë Botërore ishte diçka e largët dhe të tilla ishin thuajse të gjitha familjet e Kosovës. Diçka kam kuptuar dhe prej bisedave me Titon rreth shqiptarëve. Periudha kur unë shkova të punoja atje ishte periudha kur ai po afrohej më shumë me shqiptarët, jo pse i donte ata, por në kuadër të veprimeve të tij

strategjike për ta ruajtur Federatën të paprekur dhe mbas vdekjes së tij, pra të vendosjes së ekuilibrave, dhe dobësimit të faktorit serb. Kjo nuk është diçka që e them vetëm unë. Më kanë bërë përshtypje disa lexime të kohëve të fundit të procesverbaleve të bisedimeve të Enver Hoxhës me ambasadorin e Shqipërisë në Jugosllavi në vitet '70, Lik Seiti, botuar në *Gazetën Shqiptare* të 12 korrikut 2010. Aty Enveri vlerëson hapat e ndërmarrë nga Tito, për të shtuar të drejtat dhe liritë e shqiptarëve, megjithëse vazhdon ta quajë antimarksist. Enveri thotë në sugjerimet e veta për Fadil Hoxhën, se kosovarët duhet të bashkëpunojnë me Titon në përplasjet e tij me rankoviçianët dhe në atë periudhë Shqipëria madje bëri disa hapa për t' u afruar me Jugosllavinë. U rrit niveli i përfaqësimit diplomatik - edhe Enveri e përmend këtë si pistë të rritjes së bashkëpunimit, u shtua vëllimi i shkëmbimeve dhe Shqipëria filloi të ishte gjithmonë e më e pranishme në Kosovë.

Me një fjalë Titoja, pranë të cilit unë po kryeja shërbimin ushtarak, tregonte asokohe në publik një qasje pozitive për shqiptarët. Një prej virtyeteve që përmendte gjithmonë ishte *besa*. Thoshte se ju keni besë: kur e merrni diçka me seriozitet e mbroni deri në fund! Nuk ka qenë e rastit që në mbrojtjen e tij ka qenë një staf kosovarësh që janë kujdesur në pika kyçe të vendrojave të tij. Gjeneralët nuk kanë qenë shqiptarë, por ama ekzekutorët e vendimeve të tyre kanë qenë shqiptarë. Ka pasur madje, kontakt direkt me ta, pa vajtur te komandantët pasi ai ka qenë gjithmonë skeptik ndaj serbëve. Në vitin 1974 Tito pati problem me gjeneralët serbë, të cilët i hynë praktikisht edhe në familjen e tij duke e shtënë në dorë gruan e tij, Jovankën. Në mënyrë të heshtur Tito vetëm sa e largoi nga rrethi i afërt gruan e tij. Prej atyre momenteve, ai ishte shumë i hidhëruar me gjeneralët serbë. Kanë rrjedhur bukur do ujëra prej asaj kohe dhe mund të bëhet monotone për publikun që të dëgjojë këto histori që duken si përralla, por këtu ka diçka reale. Kjo prishje, kjo ftohje e Titos me serbët, dhe që u reflektua në sjelljen e tij me ta, provokoi pozicionimin e Akademisë serbe të Shkencave dhe Arteve kundër ideve të Titos për Jugosllavinë. Me të ashtuquajturin *Libri i kaltër*, shkruar prej akademikëve serbë, praktikisht u vunë themelet e nacionalizmit serbomadh. Ky moment koincidoi me rënien fizike të Titos, i cili vinte

duke rënë nga shëndeti, por edhe nga fuqia e tij politike e qeverisë. Kështu po i krijohet hapësirë politikës serbomadhe që të merrte hov duke iu kundërvënë politikës unifikuese jugosllave të "Mareshalit". Me pak fjalë, po hidhte themelet nacionalizmi serbomadh, që do të bëhet praktikisht platformë politike e Milosheviqit & company. Kjo politikë unifikuese, ekuilibruese, midis kombeve e kombësive e Titos, tok me idenë e krijimit të identitetit jugosllav, me gjithë pafuqinë për të frenuar shumë krime të kryera në Kosovë nga serbomëdhenjtë, veçanërisht në periudha të caktuara, me gjithë shpërnguljet masive në Turqi dhe mangësitë e tjera që kishte, krijoi, veçmas në vitet 70, një frymëmarrje më të lirë për Kosovën. Unë isha ushtar pranë Titos, pikërisht në atë periudhë, kur në Kosovë filloi të lëvizte diçka në ekonomi, në arsim, në shoqëri, proces që u frenua pas demonstratave të vitit 1981.

Këto do të kenë qenë arsytet që unë u caktova në njësinë e Gardës, e cila fillimisht ishte në Pançevë, afër Beogradit. Pastaj duket se kanë ndikuar edhe rrethana të tjera, që unë të merrja një rol specifik në këtë shërbim. Së pari, këto rrethana kanë pasur të bëjnë me mua, me përgatitjen e mirë fizike, me disiplinën, me aftësitë, me njohjen e gjuhëve të huaja etj. Së dyti, situata e brendshme politike e ushtarake në Jugosllavinë e atëhershme, pas komplotit të gjeneralëve të afërt me Titon në bashkëpunim me gruan e tij, Jovankën, ndoshta impononte një strategji tjetër të "mbrojtjes nga afër" të kryetarit. Pra, për shkak të rrezikut nga ndonjë komplot i organizuar, nga prania e afërt me Titon duket se ishin hequr njerëzit e përhershëm dhe të specializuar dhe detyrat e tilla i qenë besuar një njësi të veçantë nga përbërja e rregullt e ushtrisë. Dhe, sikundër dihet, përbërja e ushtrisë së atëhershme jugosllave ka qenë shumë heterogjene, në pikëpamje të përkatësisë nacionale. Titoja duhet të jetë ndier më i sigurt dhe më i qetë kundrejt një përbërjeje të këtillë, se sa, përshembull në afërsi të një grupi me lidhje të mundshme me ndonjërin nga gjeneralët komplotistë, kryesisht serbë.

Dhe, kështu, dy muaj e gjysmë zgjati trajnimi në shkollën speciale në Pançevë. Aty, përveç përgatitjes fizike dhe ushtrimeve të tjera, i kushtohet kujdes edhe mësimi intensiv të gjuhëve të huaja, si dhe shkathtësive të tjera që kishin të bëjnë me specifikat e detyrave.

U bë, pastaj, përzgjedhja e ekipit prej 25 personash, të cilët do të ngarkoheshin me detyra speciale për çdo gjë që kishte të bënte me Mareshalin, duke filluar nga mbrojtja fizike, e deri te përkujdesja për përditshmërinë si person protokollar, madje duke përfshirë edhe jetën e tij private. Pas kësaj përzgjedhjeje, mua më dërguan edhe dy muaj të tjerë në Sarajevë në institutin e specializuar ushtarak, për specializim të mëtejshëm. Edhe atje u vazhdua me trajnime dhe përgatitje në të gjitha aspektet. Por atje u shkua edhe një hap më tej: neve na dhanë rroba civile dhe armë, pistoleta, që domethënë se tani u bëmë një kontigjent personash i përgatitur në çdo pikëpamje, jo vetëm për përkujdesje ndaj Titos gjatë qëndrimit të tij në rezidencë, por edhe gjatë vizitave në botën e jashtme. Në këtë eksperiencë ushtarake pata rastin të njihja nga afër dhe Niksonin, Olaf Palmen, ish-kryeministrin e vranë suedez, Indira Gandin, Sirimavo Bandaranaiken, Gadaffin, e shumë burrështetas të tjerë. Më vinin në mendje fjalët e gjyshit Osman, se kur të rritesha, do të takoja burrështetas. Në fakt, fjalët e gjyshit do të më kujtoheshin dhe më vonë, kur për shkak të eksperiencës profesionale dhe politike do të takohesha me të tjerë burrështetas. Për shembull para pak muajsh (2010) isha në Tanzani, në Forumin ekonomik botëror të Dar-Es Salamit, si mysafir i Presidentit të vendit Jakakya Kikwete. Në darkën e shtruar prej tij, në pallatin e quajtur *Julius Nierere*, m'u kujtua se ai kishte qenë një burrështetas që pata rastin ta njihja gjatë shërbimit ushtarak. Gjyshi Osman m'u kujtua po ashtu gjatë vizitës sime në shtator të 2009, në pallatin presidencial dhe në tendën e Gadaffit, tendë e famshme që ishte ngritur dhe në mes të Beogradit me rastin e vizitës së tij në ish-Jugosllavi. Pra nga eksperiencia e asaj kohe, pranë një politikani e burrështetasi, përfaqësues i një vendi me peshë të madhe në të ashtuquajturën botë e tretë, që ishte bukur e madhe, mua m'u hoqën shumë komplekse në sjelljen e shtetarëve. Mësova shumë zakone që do të më shërbenin dhe më pas, për t'iu qasur drejtpërdrejt anës së tyre njerëzore, jo asaj politike. Pra gjyshi Osman më ndihmoi shumë asokohe dhe kam krijuar bindjen e palëkundur se porositë e tij do të më kujtohen dhe jetësohen shpesh dhe në të ardhmen.

Po le të kthehemi te shkuarja në rezidencën e Titos, në Dedinje, ku për disa prej nesh u bë një trajnim shtesë dhjetëditor në rolin

e adjutantit. Nga dy veta duhej të bënim roje të vazhdueshme në dhomat pranë, ku rrinte ose flinte Tito. Pastaj, duhej të dinim çfarë vishte, me cilat kostume duhej të prezantohej në pritje zyrtare, çfarë vishte në orët e pushimit, cilat rroba duheshin paketuar në valixhet e tij me rastin e udhëtimeve, kur pinte kafënë, kur e kishte kohën e çajit dhe gjëra të tilla. Eksperienca ime në gardën e Titos ishte një mësim shumëplanësh. Aty mësova shumë gjëra për protokollin, dhe mësova për mënyrat e udhëheqjes së shtetit. Si i pranonte dhe përcillte faktorët politikë, mysafirët nga shtetet e jashtme, si i përgatiste fjalimet e tij dhe çdo gjë që sillej rreth organizimit të punës së një burrështetasi. Sigurisht mund të them se Tito me stafin e afërt ishte human, komunikativ, por në tërësi ishte shumë i vendosur, njeri karizmatik dhe autoritativ.

Shërbimi im ushtarak zgjati II muaj dhe sigurisht pos "protokollit" unë aty mësova shumë mirë edhe gjuhën serbokroate.

Por unë nuk e mbajta të mbyllur horizontin tim. Gjatë shërbimit ushtarak komunikoja gjithmonë me jashtë për të gjetur mundësi punësimi, kam lexuar gazetatat e huaja, u kam shkruar firmave të ndryshme, kam konkurruar për punë përmes *Frankfurter Allgemeine Zeitung*-ut, për të siguruar ardhmërinë time. Për t'u rikthyer edhe njëherë tjetër në Perëndim. Këtë herë jo me valixhen e mjerë të padijes, skamjes sime dhe komplekseve të mia të para 1969-s, por me një barrë përvoje e dituri të dëshmuara dhe në praktikë, si dhe me një lloj bekimi të prindërve që më mungoi në udhëtimin tim të parë. Unë kisha fituar shumë energji në Lindje. Kjo energji më shërbeu në Perëndim për t'u bërë i ditur. U riktheva në Lindje me dituri dhe energji të kanalizuar drejt. Tanimë po i qasesha sërish Perëndimit. Këto ecejake do të ishin kursi im jetësor, ku energjitë potenciale tipike të një njeriu të lindjes, të përcaktuara nga ambicia, jeta e thjeshtë dhe plot sakrifica, do të shndërroheshin në energji kinetike, energji lëvizjeje, që do të prodhonte rezultate të mëdha.

## Ëndrrat filluan të jetësohen

*Njohja me Maks Gygaksin, njeriun që do të ndikonte shumë jetën time dhe puna e parë si Drejtor shitjesh. Shqipëria si stacion i udhëtimeve të mia të biznesit dhe Kosova, vendi ku nuk i prisnin mirë ata që vinin nga Perëndimi. Po nisja të zbatoja me sukses teoritë ekonomike të mësuara në universitet. Po projektoja kërcimin e rradhës, drejt suksesit, por kësaj rradhe në një biznes individual.*

**S**apo i kisha mbushur 23 vjet, kur vendosa të bëja edhe një kthesë tjetër në jetë. Ndonëse i ri, tashmë kisha bërë një përvojë jetësore, kisha kryer arsimin e lartë universitar në Gjermani, kisha kryer obligimin ushtarak, kisha parë botën, kisha njohur njerëz të ndryshëm dhe kisha vërejtur dallimet e mëdha midis dy sistemeve, atij socialist dhe kapitalist. Joshja për ta ndryshuar rrjedhën e jetës, të cilën e ëndërroja dhe e kisha synuar prej kohësh, ishte e madhe. Perëndimi ofronte shumë mundësi. Atje njeriu vlerësohej sipas aftësive të tij, sipas punës dhe përkushtimit ndaj saj. Ndoshta më e rëndësishme se kjo ishte, se atje çmohej integriteti i njeriut, iniciativa e lirë dhe zgjedhja sipas vullnetit dhe prirjeve individuale. Nuk kishte kufizime dhe kufij. Çdo gjë ishte vënë në shërbim të njeriut dhe ai ishte epiqendër e botës.

Ndryshe ishte në socializëm. Duke punuar për pak kohë në Gjilan, shumë shpejt arrita të vëreja se në këtë sistem ekonomik, sado liberal që mund të ishte, siç ishte rasti i Jugosllavisë së atëhershme, rruga drejt një karriere profesionale i ngjante përbirimit nëpër një labirint, ku pas çdo kthese të pret një e papritur. Socializmi kishte filluar të ngulfatej nga shtrëngesat burokratike, të cilat ia kishte krijuar vetvetes. Vlera e njeriut nuk qëndronte në përpjesëtim të drejtë me aftësitë e tij reale, veçanërisht kreativitetin e tij, por varej kryesisht nga aftësitë e tij spekulative dhe manipulative, çfarëdo qofshin ato. Pastaj, ajo që më bënte përshtypje, ishte se në atë shoqëri punët nuk ishin ndarë si duhej, pra nuk ishte bërë një ndarje e drejtë dhe normale e punës, që gjithkush ta kryente pjesën që i takonte. Të gjithë përzihehin në një vend, pa asnjë kriter: shteti,

politika, ekonomia, pra, ishte bërë një mishmash kompetencash dhe subordinimesh. Pastaj, dështimet në fusha të ndryshme, veçanërisht në ekonomi, mbuloheshin me fraza dhe slogane politike. Ekonomia e tregut nuk ishte ajo që i përcaktonte rregullat e lojës.

Akoma më e rëndë ishte në ato vite gjendja në Kosovë. Në krahasim me vitet pararendëse, ishte e vërtetë se Kosova kishte bërë progres të madh. Në planin politik, falë ndryshimeve kushtetuese të viteve '70, Kosova kishte arritur të bëhej pjesë deri-diku e barabartë e bashkësisë jugosllave, kishte institucionet e veta autonome të qeverisjes, kishte ente dhe institucione që kishin marrë të drejta dhe ingerenca për vendime të rëndësishme, por të gjitha këto nën monitorimin e kujdesshëm të forumeve partiake. Ashtu si dhe me një rol suspendues në potencë të Republikës së Serbisë. Nuk duhet mohuar, kishte filluar një zhvillim i hovshëm ekonomik, krahasuar me periudhën e shkuar. Ishin ngritur kapacitete prodhuese, ishin bërë përparime në infrastrukturë, në arsim, në shkencë, në kulturë. Bashkësia shqiptare, e shtypur për një kohë të gjatë, po shpërfaqte energji të jashtëzakonshme, gjithçka po lëvizte në sytë e frikësuar të palës serbe, e cila s'do ta duronte dot gjatë këtë energji që po çlirohej prej Kosovës.

Mirëpo, edhe përkundër kësaj, Kosova lëngonte nga pamundësi dhe shtrëngesa të shumta. Kishte trashëguar një prapambetje të madhe ekonomike dhe kjo, krahasuar me viset e tjera të Jugosllavisë, në vend që të zbutej gradualisht, shkonte duke u thelluar. Zhvillimi i saj mbështetej kryesisht në industrinë bazike dhe në një bujqësi ekstensive, e cila nuk arrinte të ushqente popullsinë e vet. Kapacitetet e industrisë përpunuese ishin të pakta. Fuqia punëtore, ndonëse e re si strukturë e popullsisë, ishte e pakualifikuar. Modernizimi i prodhimitarisë gjithashtu ngecte. Cilësia e prodhimeve ishte e dobët, prandaj edhe tregu ishte i kufizuar.

Por, mbi të gjitha, mbi Kosovën ende ushtroheshin trysni të mëdha politike. Vendimet e organeve dhe organizatave të Kosovës duhej të ishin të subordinuara dhe të koordinuara në dy nivele njëherësh, në nivel të Serbisë dhe të Jugosllavisë, ndërkohë që Serbia bënte lloj-lloj obstruksionesh. Në anë tjetër, edhe përkundër parimeve të proklamuar të barazisë së kombeve dhe kombësive që përbënin



ish-Jugosllavinë, shqiptarët vazhdonin të ishin qytetarë të rendit të dytë, ndaj të cilëve kishte paragjykime recidiviste, mohime, fyerje, madje edhe racizëm. Klima shoqërore ishte më e mirë se në kohët e shkuara, por megjithatë ishte larg nga të qenit ideale.

Unë mund t'i vëreja të gjitha këto, sepse për një kohë të shkurtër kisha parë si funksiononte bota e përparuar e Perëndimit dhe kisha identifikuar pengesat që e bënë jofunksional sistemin socialist në Lindje. Megjithatë, ndonëse isha i vetëdijshëm për përparësitë që më jepte Perëndimi, mund të hamendesha për ndonjë çast se cilën rrugë duhej të merrja. Ishte joshëse, atëbotë, që në një moshë të tillë të të ofronin vend të mirë pune, rrogë të mirë për kushtet e atëhershme, banesë, makinë, pra në përgjithësi privilegje që shumëkush i ëndërronte. Një ofertë kësisoj, mund të quhej grackë e këndshme, e cila t'i mjegullon synimet dhe idealet, sado të forta që të jenë ato. Por, nga ana tjetër, kur e mendoja se çfarë qëllimesh i kisha vënë vetes, nuk e kisha të vështirë ta shihja se krejt kjo që më ofrohej, ishte tepër pak. Ishte pak në planin e aspiratave të mia, të ambicieve të mia; ishte pak në planin familjar, në aspektin e statusit shoqëror; ishte pak në planin e botës sime të brendshme, e cila nuk mund të ambientehej më me trysnitë dhe kufizimet. E kisha parë nga afër botën e lirë dhe tashmë e ndjeja se vendi im ishte atje.

Këtë bindje ma përforconte kthimi i herëpashershëm në Marec. Atje pothuajse asgjë nuk kishte ndryshuar. Dukej sikur koha ishte ndalur në vend. Njerëzit rropateshin për të siguruar bukën e gojës, si gjithmonë. Deri atje të çonte po ajo rrugë e paasfaltuar, me pluhur ose baltë. Vazhdonte të mos kishte rrymë, të mos kishte ujë të pijshëm. Kushtet e jetës, sado që aty-këtu ishin përmirësuar, ende ishin të rënda për shumicën e familjeve. Mund të kishe edhe para, por prapëseprapë do ta bëje jetën në mënyrë tradicionale. Disa tashmë kishin shkuar në Perëndim, kishin arritur t'i mëkëmbnin sadopak familjet e tyre, por kjo përsëri kufizohej në gjëra të pakta. Ekonomitë familjare nuk kishin arritur të përmirësoheshin. Punohej për të mbijetuar dhe prodhohej sa për t'i plotësuar nevojat elementare. Pamja e Marecit, mënyra e jetës atje, të krijonte idenë se Kosova kishte edhe shumë rrugë për të bërë, që të mund t'u siguronte njerëzve jetë të dinjitetshme dhe të ardhme më të mirë.

Unë nuk ndieja përçmim dhe refuzim ndaj këtij realiteti. Përkundrazi, ndieja keqardhje dhe një shtytje të brendshme për ta ndryshuar atë sa më parë, së paku në familjen time, në rrethin familjar. Detyra të tjera nuk mund të merrja, sepse as kisha moshë, as kisha ambicie për këtë. Ndoshta ishte një botëkuptim i ngulitur në mua, se njeriu së pari duhej ta shpërthente atë rreth të mbyllur në mënyrë individuale, me vetiniciativë, pastaj të vinin ndryshimet sistemore. Unë nuk mund të prisja që bota të ndryshonte dhe unë pastaj të shkoja pas ndryshimeve të saj. Unë nuk mund të prisja të ndryshonte sistemi, politika, kushtet e ekonomizimit, etj., pastaj ky nuk ishte botëkuptimi im për botën. Mendimi im ishte se individi duhej të bëhej promotori i të gjitha ndryshimeve.

I shtyrë nga ky botëkuptim dhe nga ky koncept për të ardhmen, duke shfrytëzuar përvojën dhe njohjet e vjetra që kisha në Perëndim, sikundër edhe disa kontakte që kisha arritur t'i vendosja gjatë kohës së shkurtër që kisha punuar në Fabrikën e Tekstilit në Gjilan, ende pa përfunduar shërbimin ushtarak u kisha shkruar letra firmave të ndryshme, kryesisht të zonës gjermanishtfolëse, në Gjermani, Austri dhe Zvicër, duke u ofruar shërbime të ndryshme dhe duke u dhënë njoftime të përgjithshme për atë që mund të bëja. Kisha ndjekur edhe konkurset e ndryshme, siç thashë më sipër. Përgjigjet e para nuk ishin shumë inkurajuese. Por unë nuk isha nga ata që dorëzoheshin lehtë. Më vonë toni i komunikimit filloi të bëhej më shpresëdhënës. Më shumë mund të thuhej se bëhej fjalë për sinjale pozitive, sesa për oferta konkrete. Megjithatë, nuk prita më shumë. Me kursimet e pakta që më kishin mbetur, bleva biletën e trenit për Gjermani. Në krahasim me atë udhëtimin para disa vjetësh, tani kisha shumë avantazhe. E para, e dija gjuhën; e dyta, kisha arsimim të lartë në një universitet prestigjioz të Gjermanisë; e treta, tashmë e njihja botën perëndimore dhe e dija si funksiononte ajo. Prandaj, udhëtimi nuk i ngjante as për së afërmi atij të disa viteve më parë. Por, megjithatë, këto dy udhëtime kishin diçka të përbashkët, që lidheshin fatalisht në një pikë: po ikja nga vendi im, i cili nuk po m'i jepte mundësitë, së paku jo të tilla, që do të ishin në përpjesëtim sadopak të drejtë me synimet e mia. Megjithatë, tash isha më pak nostalgjik, më pak i frikësuar, më i sigurt në vete.

Ia mësyva një firmë në Gjermani, *Deutsche Babcock*, e cila bashkëpunonte me *Siemens*-in. Ata më premtuan punësim, por jo menjëherë, sepse vendet e punës, ku mund të sistemohesha unë, ishin të zëna. Pa humbur kohë, ndoqa adresën tjetër që kisha, atë të titullarit Peter Cimer (Peter Zimmer), në një lokalitet të Austrisë, në Kaufstein, një vend piktoresk pranë lumit Inn. U lashë përshtypje të mirë, kështu që vendosën të më punësonin menjëherë, pa ndonjë procedurë të ngatërruar administrative, siç ndodhte te ne. Që të nesërmen mund të filloja punën. Kjo ndodhi në fillim të vitit 1975. Megjithatë, kishte një problem, që duhej zgjidhur: leja e qëndrimit dhe leja e punës. Sipas rregullit, unë duhej të dilja një herë nga Austria, të kthehesha në Kosovë, të ndiqja procedurën e marrjes së një vize të rregullt dhe sërish të kthehesha në Austri. Në të kundërtën, organet shtetërore austriake mund t'i nxirrnin telashe firmës së Peter Cimerit. Mirëpo, kjo procedurë kërkonte aq shumë kohë, sa mua më tmerronte. Duhej të humbja disa muaj në pritje të vizës dhe në ndjekje të procedurave burokratike. Derisa unë t'i kryeja këto procedura, vendi i punës do të më dilte nga dora.

Falë mirëkuptimit të njerëzve, me të cilët vura kontaktin e parë, arrita të merrja lejen e qëndrimit në Austri, i ndihmuar në rend të parë nga inxhinieri i firmës, Manfred Sholc (Scholtz), i cili në organet e vendit paraqitet si njeri që më njihte dhe, në njëfarë mënyre, bëhej garantues për mua, ndonëse më parë nuk kisha pasur ndonjë njohje me të. Ai bëhet garantues edhe në firmë, duke thënë se dokumentet e mia ishin në rregull. Madje, më shumë se kaq: ai kërkon që tavolina ime e punës të ishte pranë tryezës së tij, në mënyrë që të punonim së bashku dhe të m'i mësonte "hiletë" e punës. Ishte një pesëdhjetëvjeçar energjik, komunikativ dhe jashtëzakonisht miqësor ndaj meje. Bashkëpunimi dhe miqësia me të janë njëri nga kapitujt më të ndritshëm të raporteve të mia me njerëzit e biznesit. Ai m'u gjend pranë në një kohë, kur unë, realisht, do të merrja njohuri të mjaftueshme për një profilizim të ardhshëm të aktivitetit tim, pikërisht në fushën ku Manfred Shulc kishte një përvojë më të gjatë.

Firma e Peter Cimerit prodhonte makineri për shtypjen e stofrave. Inkuadrimi im në atë firmë nuk ishte rastësi. Unë tashmë kisha

ofruar idetë e mia, për shitjen e makinerisë për fabrikat e tekstilit në hapësirat e Jugosllavisë së atëhershme dhe në disa shtete të tjera të Europës Lindore. Teknologjinë e prodhimit të tekstilit e njihja, nga njëra anë, kurse nga ana tjetër, kisha vërejtur se makineritë e fabrikave në këtë zonë ishin vjetruar për një prodhim modern. Në krejt Europën Lindore, pas një periudhe të gjatë të veshjes uniforme të fazës së real-socializmit dhe pas disa ndryshimeve sado minimale në mënyrën e jetës, kishte ardhur një fazë, e cila duhej të shoqërohej me prodhime të reja të tekstilit, më cilësore dhe me dizajn të ri. Fabrikat e tekstilit ekzistonin, por shumica ose kishin degraduar, ose kishin makineri që nuk mund të aplikonin programe të reja të prodhimit.

Ndonëse pa ndonjë përvojë të gjatë, sidokudo unë e njihja situatën në këtë treg, veçmas në Jugosllavi. Përveç kësaj, nga periudha e punës në Fabrikën e Tekstilit në Gjilan, kisha në dijeni një hartë të plotë të prodhuesve të tekstilit në të gjitha republikat e ish-Jugosllavisë, sikundër që kisha ruajtur edhe disa kontakte minimale me strukturat udhëheqëse të këtyre fabrikave, veçmas me ata që quheshin menaxherë të sektorit për zhvillim, sektor të cilin e kisha mbuluar për pak kohë në Gjilan. Nga ana tjetër, unë e dija se Jugosllavia e atëhershme, përveç plotësimit të nevojave të brendshme me prodhimet e veta të tekstilit, që ishin më të avancuara se të pjesës tjetër të Europës Lindore, synonte edhe një depërtim në tregun e jashtëm, përfshirë këtu edhe një numër vendesh të botës së tretë, që atëbotë quheshin shtete të painkuadruara.

Sapo u inkuadrova në firmën e Peter Cimerit, fillova të ndiqja një parim bazë, sipas të cilit, për të shitur një makinë, së pari duhej ta njihja atë në krejt strukturën e saj konstruktive dhe funksionale. Ndjekja e këtij parimi më ndihmoi të zgjeroja njohuritë e mia në pjesën teknologjike, diçka që më shërbeu veçanërisht shumë në një ndërmmarrje të jashtëzakonshme profesionale. Në këtë punë gjithsesi ishte i rëndësishëm fakti se unë punoja me inxhinierin e makinave, Manfred Sholcin, por edhe vullneti im që të njihja të gjitha detajet e makinave dhe të dija funksionin e tyre, përfshirë edhe produktin final. Kjo kishte rëndësi jo vetëm për komunikim elementar me klientët, por edhe për krijimin e besimit të tyre. Unë nuk shitja



***Me Maks Gygaksin, 1981. Jam frymëzuar shumë prej këtij njeriu, kam mësuar shumë veçanërisht prej modestisë së tij.***

makina duke i reklamuar ato me fjalë të zbrazëta, por duke treguar saktësisht avantazhet e tyre, avantazhe këto që mbështeteshin në cilësinë e prodhimit. Prandaj, për të depërtuar te kjo, duhej një njohje e teknologjisë. Këtë parim do ta ndiqja edhe më vonë, gjatë gjithë karrierës sime si menaxher i shitjes së kësaj teknologjie.

Nuk mund të them se në firmën e Peter Cimerit gjeta një atmosferë krejt miqësore, sepse të gjithë të punësuarit në atë firmë nuk i ngjanin Manfred Sholcit. Këtë e them, për shkak se nuk duhet krijuar bindja e gabuar se idetë e reja përvetësohen lehtë nga të gjithë. Aq më pak pranohet ideja se një i huaj mund të diktojë suksesin e një firme, çfarëdoqoftë ajo. Së paku jo te gjermanët, austriakët etj., të cilët nuk e kishin për gjë të nënçmonin të huajt, veçmas një të ri çfarë isha unë, që vija nga bota e lindjes dhe në sytë e tyre isha i njëjtë me masën e madhe të punëkërkuesve, të cilët viteve të fundit kishin vërshtuar me shumicë nga ajo anë. Mbi të gjitha, ata të firmës nuk ishin mësuar



*Me Sonjën, Blaser-in, asokohe pronar në minorancë i Interplastica-s dhe Kristinën*

që një menaxher i shitjes të hulumtonte dhe të interesohet për çdo detaj të konstruksionit të makinës. Prandaj, e shihja se herë pas here më shikonin shtrembër dhe më hidhnin ndonjë romuz, me një fjalë silleshin disi me ironi. Midis tyre mbaj mend veçmas njëfarë Herr (zoti) Fyrtsheler (Pfurtscheller), siç i thoshin të gjithë, i cili nuk e kishte për gjë të më fyente me qëndrimin që mbante ndaj meje dhe me romuzet që më hidhte. Edhe tash më kujtohet thënia e tij standarde: “E vështirë është jeta në Alpe”. Kjo për mua shtynte të kuptohej se aty nuk isha i mirëseardhur për të gjithë.

Për të tejkaluar një atmosferë të këtillë në firmë, më duhej suksesi i parë. Dhe atë e arrita pas një kohe jo shumë të gjatë. Ia dola të rivendosja kontaktet me Fabrikën e Tekstilit në Gjilan dhe të firmosja një kontratë për një sërë makinash, për një linjë të shtypjes së tekstilit dymbëdhjetëngjyrash. Vlera e kontratës ishte 8 milionë dollarë. Kjo ndryshoi dukshëm

qëndrimin ndaj meje, megjithëqë nuk ishin të paktë ata që këtë sukses e shihnin me skepticizëm e xhelozin njëkohësisht. Një besim më i madh do të krijohet ndaj meje pas shitjes së një makinerie në Bullgari dhe të dy linjave të kompletuara të prodhimit në Turek të Polonisë.



*Në qendër të Tiranës, 1981. Unë doja dhe besoja se Shqipëria do të ndryshonte*

Pak nga pak, sukseset filluan të shtoheshin. Për firmën, tregu i Lindjes kishte filluar të bëhej burim i të ardhurave të mëdha. Krahas kësaj, mua filluan të më zgjeroheshin kompetencat, duke më besuar mbulimin edhe të tregut të ish-Bashkimit Sovjetik. Kishte kaluar pothuajse një vit, që kur kisha filluar punë në firmën austriake. Pra, ishte viti 1975 dhe unë gjendesha në Moskë. Në një nga sallat e hotelit gjigant, *Rassia*, i vetëm, duhej të luftoja me mish e me shpirt për të negociuar një marrëveshje delikate me rusët, në konkurrencë me firmën *Interplastica*, firmë zvicerane konkurrenente me atë të Peter Cimerit. Kisha dëgjuar për këtë firmë të suksesshme zvicerane, që kur punoja në Kosovë. Zoti Çengia (Çengia), përfaqësues i *Interplastica*-s, po përpiqej t'i shpjegonte një delegacioni rus procesin e punës të makinerisë që ata shisnin, duke ngritur në qiell cilësinë e ofertës së tij. Pra, delegacioni i firmës zvicerane përpiqej me çdo kusht ta fitonte këtë kontratë. Por unë, edhe pse i vetëm, arrita ta bëja këtë, pra ta fitoja kontratën. Vlera e saj nuk ishte shaka, ishte 28 milionë dollarë. Çdo gjë përfundoi me një shtrëngim duarsh. Zoti Çengia, në vend që të nevríkosej me mua që ia mora kontratën dhe e kisha bërë të kthehej në Zvicër duarbosh, shefit të vet, Maks Gygaksit, (Max Gygax) i bën këtë propozim:

“Ky Pacolli është i zoti, gjithë energji. Nuk bëhet fjalë vetëm për



*Para portretit të Enver Hoxhës, vetëm kjo ishte e mundur më 1981. Sa e doja, aq dhe e urreja këtë njeri. E doja sepse asokohe na dukej se ai u jepte dinjitet shqiptarëve, e urreja sepse e kuptoja se Shqipëria ishte e varfër për shkak të tij.*

aspektin profesional, por ai di të sillet edhe si njeri. Nëse ndodh që rrugët tona të takohen diku përsëri, jam i sigurt se do të na mundë prapë. Një i tillë i duhet marrë konkurrencës. Ai duhet të punojë për ne.”

Gygaksi u gjend mes dy zjarresh. Dy bashkëpunëtorët e tjerë të tij, të mundur atë ditë në Moskë, përfaqësuesit italianë të *Interplastica*-s, jo vetëm që ishin kundër meje, por më urrenin për

vdekje, sepse nuk ma falnin që ua morangaduat atë kontratë. Ndërkohë që Çengia mbeti i mahnitur dhe u përpoq ta bindë Gygaksin, të tjerët të *Interplastikës*, tashmë e dinin shumë mirë se ia kishin mbyllur vetes dyert përgjithmonë në tregun rus. Këto detaje i mora vesh më vonë.

Gygaksi më në fund u bind dhe Çengia, si përgjegjës i zonës për Bashkimin Sovjetik, mori përsipër të kontaktonte me mua. Takimi u la në Kaufstein, në pranverë të vitit 1976, ku Gygaksi dhe Çengia mbërritën me avionin privat të *Interplastica*-s. Pas darkës erdhi edhe propozimi i tyre:

“Oferta jonë është kjo”, tha Gygaksi. “Trefishi i rrogës që merr aktualisht. E njëjta gjë vlen edhe për makinën, zyrën, banesën. Kërkova disa orë kohë që të mendohesha. Në firmën e Peter Cimerit më 1976 merrja 28 mijë shilinga në muaj, që i binte afërsisht katër mijë marka. Pra, krahasuar me punën që bëja dhe me suksesin që kisha arritur, nuk ishte ndonjë mrekulli. Duke marrë parasysh ofertën që më ishte bërë, në njëfarë mënyre tashmë kisha marrë një vendim në favor të propozimit. Megjithatë, doja të konsultohesha me Shulcin, të cilin e kisha mik dhe e pyesja për shumë gjëra. Ai nuk hezitoi të më inkurajonte:



“Ti e di mirë si të kanë trajtuar këtu te ne. Nisu, se ajo është rruga jote... Se, po të isha disa vjet më i ri, do të vija edhe unë me ty dhe do të punonim bashkë.”

Të nesërmen shkova në firmë, të paraqitja dorëheqjen time. Kur u mor vesh se do të largohesha, si me magji, të gjithëve iu shfaq një respekt i madh për mua. Nuk e kisha të vështirë ta



*Me Vilson Ahmetin, 1981. Sikur ta dija se një ditë ai do të bëhej kryeministër i një qeverie demokratike...*

kuptoja se kjo ishte hipokrizi, por nuk e lëshova veten. Disa prej tyre do të donin të vinin me mua. Midis të tjerëve, më i dashuri u bë ai që e quanim Herr Fyrtsheler.

“Pse nuk më merr edhe mua me vete?”, më tha ai, papritmas.

Disa muaj më vonë do të ndodhte që ai përnjëmend të shfaqet në dyert e *Interplastica-s*, në Zvicër. E kishin pushuar nga puna në Austri dhe unë, pa shumë hezitim, ia bëra një vend pune në firmën time të re. Punoj për një vit e gjysmë, duke i shkaktuar dëme të mëdha firmës dhe duke më vënë në siklet të madh. Së fundi, vetë u detyrova ta pushoja nga puna.

*Interplastica* e kishte qendrën në Vakalo (Vacallo), në Kantonin e Tiçinos, ku flitet italishtja, gjuhë të cilën e mësova për një kohë të shkurtër. Firma merrej me studimin dhe realizimin e projekteve industriale shumë të njohura në Rusi.

Ishte vera e vitit 1976. Isha vetëm 25 vjeç dhe në lëvizjet e mia nëpër Europë, kisha përvojë të pasur për moshën time, por jo bagazh mobiljesh, diçka që tregonte se nuk isha i tërhequr nga komoditeti i lartë në jetën e përditshme. Ky fakt më krijoi madje një histori të këndshme. Mbaj mend se ata të *Interplastica-s*, për t’u përkujdesur

për zhvendosjen time në Zvicër, dërguan në Austri një kamion të madh, një “trailer”, duke menduar se unë kisha shumë orendi, mobilie e gjëra të tilla. Kamioni erdhi te banesa ime në Kaufstein (Kaufshajn) dhe mezi arriti të kthehej në rrugicën ku banoja, aq i madh ishte. Ndërkohë, për çudinë e shoferit të kamionit, unë dola me dy valixhe në dorë dhe i thashë atij: ku t’i lemë bagazhet e mia? Ai mbeti i stepur. Në të vërtetë, unë kisha pasur aty një banesë të mobiluar, qiranë e së cilës e paguante firma, dhe ca gjëra të pakta personale, asgjë tjetër. Njësoj ndodhi edhe në Lugano. Firma kishte marrë për mua një banesë të madhe, 300 metra katrorë dhe kishte vënë në gjendje gatishmërie disa punëtorë, për të zbratur kamionin. Edhe ata mbetën të stepur, kur panë që kamioni erdhi i zbrazët dhe shoferi zbriti prej tij dy valixhet e mia. Ishte gjithë bagazhi im austriak. Bagazhi im i tipit material ishte i vogël, por bagazhi i përvojës dhe njohurive të mia peshonte shumë.

Natyrisht, nuk ishte e thënë që gjithçka të ecte kaq lehtë. Sërish probleme me lejeqëndrimin tim. Në Zvicër nuk mund të vepra si në Austri, sepse rregullat e saj ishin tepër strikte, që të mund të shmangeshin. Kur po e konceptoja këtë pjesë të librit, u gjenda në një lokal ku ishin të ndaluara pijet dhe cigaret, të cilat duhej t’i merrje diku jashtë lokalit, pra t’i shërbeje vetes dhe kamerieri shfaqej vetëm për të tërhequr pjatat. Diçka kontradiktore në të ashtuquajturin realitet zviceran, ku respektohen ligjet, por gjenden dhe rrugë që të shkelen ato dhe të gjithë të mbeten të kënaqur. Duke u kthyer tek fillimi i eksperiencës sime zvicerane, deri sa të merrja përgjigje për lejen e qëndrimit, u detyrova që gjashtë muaj të banoja në Itali, afër kufirit me Zvicrën, duke udhëtuar çdo ditë me makinë deri në vendin e punës dhe të kthehesha prapa nëpër të njëjtën rrugë. Jetova në Prestino, në provincën e Komos (Como), një vend i veçuar dhe i qetë, me peizazh të bukur rrëzë Alpeve, që më krijonte përshtypjen sikur aty isha për turizëm, e jo për një qëndrim më afatgjatë. Njerëzit ishin shumë të sjellshëm, të çiltër dhe dashamirës. Qëndrimi aty më ndihmoi shumë në njohjen e mentalitetit italian dhe përvetësimin e italishtes, të cilën e dija deri diku, por tani mësimin e saj e çova pothuajse në shkallë përsosmërie.

Me të mbërritur leja e qëndrimit, u vendosa përfundimisht në

Zvicër. Zoti Maks Gygaks, pronar i *Interplastica*-s, një tiçinez me mentalitet italian, pra me huqet dhe çiltërinë e tyre, më bëri përgjegjës për shitjen e impianteve në vendet e Lindjes, me përqendrim në zonën jugosllave. Në kontratën time me punëdhënësin nuk përfshihej Rusia, sepse dy rivalët e mi, nuk donin të hiqnin dorë nga ajo zonë. Duke qenë punëtorë më të vjetër në *Interplastica*, ata arritën të bindin Maks Gygaksin të vazhdonin projektet e filluara, sado që arritjet e tyre, karshi madhësisë së tregut, mund të quheshin minimale. Mirëpo, përgjegjës për Bashkimin Sovjetik edhe më tej mbetet Çengia, gjë që mund të konsiderohej veprim me mend i Gygaksit. Mua m'u caktua vendi i punës në *Textiblu*, firmë e lidhur me *Interplastica*-n për eksportin e makinerive në zonat që m'u besuan.

Vetëm gjatë dy viteve të para (1976-1978) i sigurova firmës kontratat fitimprurëse në vlerë prej 30 milionë frangash zvicerane, kryesisht në hapësirat e ish-Jugosllavisë. Fillova të gjurmoja tregun gjithandej, që nga Sllovenia e deri në Kosovë. Vendosa kontakte të shumta, krijova lidhje të forta me prodhuesit më të njohur të tekstilit, vendosa komunikim afarist me shumë firma të njohura të asaj kohe. Pra, në përgjithësi, arrita një avantazh të mirë edhe në raport me firmën ku isha punësuar, por edhe në raport me klientët dhe me tregun. Tashmë isha specializuar në këtë fushë, sepse njihja teknologjinë e prodhimit, njihja kërkesat e tregut, që nga ndryshimet që kishin ndodhur në mentalitetin e konsumatorit, në shijen e tij, e deri te alternativat që mund të ofroheshin përmes arritjeve më të reja në këtë fushë.

Duke lënë mënjanë përvojën time në Lindje, e shoh të nevojshme të tregoj për përvojën time të asaj kohe në Kosovë dhe Shqipëri. Tregu i Kosovës, kuptohet, m'u besua për shkak të përfshirjes së saj në Jugosllavinë e atëhershme, ndërsa ai i Shqipërisë për shkak se isha shqiptar dhe për firmën ky fakt ishte relevant. Kontaktet e para me Shqipërinë i vendosa aty nga viti 1981, përmes *Makinaimportit*, e cila ishte firmë shtetërore përgjegjëse për importin e teknologjisë së prodhimit në të gjithë sektorët, ashtu siç ndodhte zakonisht në të gjitha vendet e ish-bllokut socialist. Nuk ka nevojë të them këtu se gjendja në industrinë e tekstilit në Shqipëri nuk ishte e mirë. Një



*Në Gjakovë, me Silvana Haxhikadriun dhe miq të tjerë. Ajo ishte një pioniere e informatikës së zbatuar në Kosovë.*

herë me ndihmën e rusëve dhe më vonë me ndihmën e kinezëve, Shqipëria kishte ndërtuar disa fabrika të tekstilit, të cilat, për kohën kur ishin ndërtuar, kishin qenë moderne dhe të avancuara. Por çfarë kishte ndodhur ndërkohë? Prishja me rusët këto fabrika i kishte lënë në gjendje të keqe, sepse riparimi dhe zëvendësimi i makinerive të amortizuara në kuadër të një zinxhiri teknologjik, bëhej me shumë vështirësi, për shkaqe politike, ngase lidhja me prodhuesit rusë të makinerive ishte ndërprerë. Përveç kësaj, vetë Bashkimi Sovjetik në këtë fushë kishte mbetur prapa, kështu që importi i makinerive sovjetike nga vendet e treta, përveç që ishte i vështirë për shkak të pengesave politike, e bënte të papërbalueshëm edhe çmimin e tyre. Ajo që kishte ndodhur më herët me rusët, tani po ndodhte me kinezët. Përsëri politika ishte ajo që krijonte vështirësi. Gjatë viteve të idilit shqiptaro-kinez ishte bërë zëvendësimi i disa linjave të prodhimit

me makineri kineze. Tani edhe ato ishin amortizuar dhe kërkonin riparime të shpeshta, ose edhe zëvendësim. Pastaj, teknologjia ishte e vjetër dhe prodhimi nuk i përshtatej tregut. Edhe pse me nevoja të reduktuara, ky treg i Shqipërisë, në çdo pikëpamje ishte më i prapambetur se tregu kinez i asaj periudhe.

Ballafaqimi i parë me Shqipërinë nuk mund të them se ka qenë aq i këndshëm, në kuptimin e gjendjes së përgjithshme që shihja aty. Unë tashmë kisha një njohje të mirë të situatës në shtetet e Lindjes, por Shqipëria në disa segmente shkonte edhe më keq se ato, krahasuar me mundësitë dhe potencialin që kishte, përfshirë edhe afërsinë gjeografike me Perëndimin. Kjo gjendje nuk mund të mos linte mbresa tek unë, por përpiqesha të mos jepesha, të dukesh sikur nuk më bënte përshtypje prapambetja dhe varfëria. Ma lehtësonte pak punën fakti se njerëzit me të cilët kontaktoja, kishin qarkulluar aq në Perëndim, sa t'i kuptonin disa gjëra edhe pa folur, pa thënë asgjë. Ata ishin ekspertë të mirë, njerëz të zgjuar, por të rrethuar nga një sistem politik dhe ekonomik që i frenonte në çdo hap.

Shqipëria kishte një ekonomi të centralizuar shtetërore në krye të së cilës qëndronin jo ekspertët dhe profesionistët, por kuadrot partiake. Edhe cilësia e jetës, veçmas pas prishjes me Kinën, kishte pësuar rënie të dukshme. E vetmja gjë pozitive që shihja në atë kohë, ishte njëfarë rëndësie që i jepte shteti ngritjes dhe specializimit të kuadrit, si dhe arsimimit të popullatës në përgjithësi. Brenda vetë kontingjentit të ri të burokracisë shtetërore dhe partiake, kishte të tillë që nuk ishin të kënaqur me gjendjen e krijuar dhe me arsyetimin e vazhdueshëm se ngecja ekonomike vinte si rezultat i “bllokadës kapitalisto-revizioniste”, siç shprehej kreu i vendit. Zërat e tyre, megjithatë, ende ngjanin si mërmëritje e nëndheshme, pa qenë në gjendje të arrinin te klanet e mbyllura të pushtetmbajtësve fanatikë. Unë erdha në Tiranë për herë të parë në vitin 1979. Më vonë kam punuar me Makinaimportin dhe në Shqipëri kemi instaluar disa uzina. Duke filluar prej kombinatit ushqimor “Ali Kelmendi”, fabrikës së gomës në Durrës, fabrikës së qilimave në Shkodër, një fabrike për prodhimin e rakisë së rrushit në Peshkopi, një fabrike për prodhimin e çorapeve në Korçë dhe disa fabrika të tjera. Kam pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë me autoritetet

shqiptare. Dua të cek diçka të çuditshme që më ndodhte në punën time me Shqipërinë. Ka mjaftuar vetëm një kontratë e nënshkruar me *Makinainportin* e Shqipërisë dhe unë të nesërmen kam shkuar në cilëndo bankë në Zvicër, e kam deponuar atë kontratë dhe financimi është hapur. Ajo besueshmëri që ka qenë për Shqipërinë e atëhershme, ishte e paparë, përderisa për shtetet e tjera bankat nuk kanë pranuar menjëherë dhe nevojitej një periudhë shumë e gjatë parafinancimi të këtyre kontratave. Kurse për Shqipërinë kanë mjaftuar 24 orë që të hapej rruga e financimit.

Në këto rrethana, njoha Vilson Ahmetin, atëherë zëvendës drejtor i *Makinainportit*, me të cilin nënshkruam disa kontrata dhe realizuam disa projekte. Bëhej fjalë për disa fabrika, të cilat funksionuan shumë mirë. Serioziteti dhe kompetenca në punë na kanë afruar me njëri-tjetrin dhe kanë forcuar bashkëpunimin mes nesh. Këtë frymë bashkëpunimi dhe miqësie e kemi ruajtur edhe sot e kësaj dite. (Vilson Ahmeti është përfaqësues i *Mabetex-it* për Shqipëri dhe konsull nderi i Kazakistanit). Pas disa vitesh punë në *Makinainport*, ai kaloi drejtor në ministri, më pas zëvendësministër, ministër i Industrisë dhe, së fundi, kryeministër i Qeverisë Teknike më 1991/92, gjatë periudhës së tranzicionit, pas rënies së komunizmit në Shqipëri. Më vonë, me një akuzë me gjasë të stisur, u fut në burg, ku qëndroi 13 muaj dhe, në mungesë provash, u deklarua i pafajshëm. Që atëherë, Vilson Ahmeti nuk merret me politikë.

Përvoja ime me Shqipërinë ishte e jashtëzakonshme. Isha rritur me dashurinë për vendim amë. Mbaja mend se si fëmijë apo të rinj, shikonim me adhurim gjithçka vinte nga Shqipëria, madje dhe kamionët tregtarë. Por në Shqipëri situata ishte krejt ndryshe. Kishte varfëri, plot vështirësi mbijetese,urvejoheshë kudo, njëlloj si të huajt e tjerë, mbase dhe më shumë. Por kishte siguri dhe disiplinë. Po të humbje diçka, ta sillnin në dorë menjëherë. Në një prej udhëtimeve të mia në Tiranë, më ndodhi diçka e tillë në një lokal afër Sahatit, ku harrova një çakmak të shtrenjtë, bashkë me paketën e cigareve. Sapo mbërrita në hotel *Dajti*, çakmaku i dashur me gjithë cigaret kishin mbërritur para meje. Sigurisht dikush më ndiqte dhe të paktën kësaj here më ndihmoi.

Gjatë eksperiencës në Shqipëri mora një leksion të përunjësisë,

të modestisë në jetë që s'do ta harroj kurrë dhe do jua përcjell dhe fëmijëve të mi. Një mëngjez, u zgjova dhe pashë se çorapet ishin të grisura në një gisht, dhe i gjuajta në shportën e dhomës. E papritura ishte se në mbrëmje, i gjeta ato të palosura dhe të qepura mbi shtratin tim. Ishte vepër e pastrueses së dhomës, që si gjithë shqiptarët jetonte në varfëri dhe s'mund ta imagjinonte flakjen e atyre çorapeve. As marrjen e tyre për vete...

Më kujtohet momenti i vetëvrasjes së Mehmet Shehut në dhjetor 1981. Bulevardi para hotel *Dajti-t* ku isha vendosur, sikur u boshatis me urdhër dhe mbeta vetëm. Në mes të natës, si gjithë të huajt, u njoftova se duhet të largohesha nga Shqipëria urgjentisht. U trondita shumë. Më shoqëruan deri në kufirin verior, ku më priste makina ime. Kështu u mbyll eksperiencia ime me Shqipërinë.

Pak më ndryshe qëndronte situata në Kosovë. Këtu mbizotëronte një mentalitet tjetër, veçmas te drejtorët e atëhershëm burokratikë, të cilët nuk kishin asnjë besim te njerëzit tanë që punonin në botën e jashtme. E them këtë, për shkak se shumë biznesmenë të suksesshëm, të cilët punonin prej vitesh në diasporë, tentonin të futeshin në Kosovë me projekte të ndryshme, por gjithnjë hasnin në pengesa nga më absurdet. Ata ishin në gjendje të pranonin bashkëpunim me çdo të huaj, por jo me njerëzit e vet.

Diçka e tillë më ndodhi edhe mua, diku nga fillimi i viteve tetëdhjetë. Më kujtohet rasti, kur më thërrasin në Tjerrtoren *Kosovka* të Prishtinës. Me anë të një faksi, drejtori i kësaj fabrike, emri i të cilit nuk më kujtohet, më ftoi për një vizitë në këtë fabrikë. Nuk kishin kaluar shumë ditë nga aksidenti që kisha pësuar në Lubjanë (për këtë do të flas më vonë) dhe ende gjendesha në fazën e rehabilitimit. Megjithatë, udhëtova për Prishtinë, pa hezituuar shumë. Arrita në fabrikë, ku më ishte përgatitur një pritje të thuash solemne. Personeli më priti me shumë nderime dhe më priu në zyrën e drejtorit. Ky ishte Hasan Beselica. Madje, më kujtohet se edhe tavolina e zyrës së tij ishte stolitur me lule. Drejtori i fabrikës kishte marrë edhe një përkthyes.

“Nuk ka nevojë për përkthyes”, i thashë drejtorit. “Flasim shqip!”

“Pse, shqiptar qenke?!” “Po”, i thashë.

“Shqiptar i Marecit.”

“I Marecit?!” U befasua. Aty për aty thirri zëvendës drejtorin e fabrikës dhe i tha: “Bafti! Merru me këtë djalë dhe dilni në zyrën tande.”

Zëvendës drejtori, Bafti Myftari, që unë e njihja më herët, u gjend ngushtë. U përshëndeta me të dhe po atë ditë shkova në Gjakovë, ku vizitova fabrikën “Emin Duraku”, ku drejtor në atë kohë ishte një burrë shumë i kulturuar dhe i përgatitur profesionalisht. Fatmir Rexha quhej. Për të do të ruaj gjithmonë një respekt të veçantë. Mirësjellja dhe gjentilesa e tij më bënë shumë përshtypje. Në saje të tij m'u bë e mundur të angazhohesha për ndërtimin e tri fabrikave të tjera moderne në Gjakovë dhe të një tjetre në Junik. Më pastaj projektet u zgjeruan edhe në fusha të tjera të prodhimit industrial. Me Fatmir Rexhën u hapën mijëra vende të reja pune. Një shifër kolosale, gjithsesi. Bashkëpunëtorët e ngushtë të Fatmirit ishin Ismet Gjoshi (një inxhinier shumë i zoti dhe dinjitoz, me të cilin punoj dhe tani), Agë Batusha, që e takoj ende herë pas here. Ndihmëse e Fatmirit ishte Marushka, një sllovene, banore e Gjakovës, një grua që meritonte respekt të madh (viktimë e luftës në vitin 1999), e shumë të tjerë. Në Gjakovë pos “Emin Durakut” unë punoja edhe me *Metalik-un*, që udhëhiqej në mënyrë dinjitoze nga Daut Thaçi, me ndërmarrjen *Rekord* (me Afrimin dhe Ruzhdiun), me *Model-in* e Gjakovës, me Fabrikën e motorëve që e drejtonte Ali Buza, e shumë të tjerë, të cilët i ruaj për të mirë në kujtime.

E them me mburrje dhe respekt, se Gjakova është nga qytetet e Kosovës që manifeston kulturë e mikpritje si pakkush tjetër në Kosovë. Gjakovarët dinë ta vlerësojnë dhe ta çmojnë njeriun e vet. Këtë e kam parë dhe e kam provuar vetë. Unë nuk isha gjakovar dhe janë gjepura thashethemet për gjoja lokalizmin e tyre. Unë u ndjeva në Gjakovë si në shtëpinë time, më mirë se në çdo vend tjetër të Kosovës. Fatmir Rexha nuk është më ndër të gjallët, por unë vazhdoj të ruaj kujtime shumë të bukura për miqësinë tonë. Gjithashtu e di se kontributi i tij i atëhershëm për Gjakovën ka qenë i jashtëzakonshëm. Dua të them se Fatmir Rexha, Besim Hoxha, Ismet Gjoshi, Zenel Bardhi dhe shumë të tjerë që pata fatin t'i njoh në Gjakovë, për mua ishin një frymëzim për suksesin tim të mëtutjeshëm. Ngritja e repartit të ri të konfeksionit të këmishave në Gjakovë, e pajisur me makina moderne dhe sistemin e ri të planifikimit të procesit automatik të prodhimit, që



aplikohej për herë të parë në këtë rajon, do të më shërbenin shumë si dëshmi e jetësimit të një teorie që sillej për një kohë të gjatë në kokën time. Ishte kënaqësi që një vajzë shqiptare si Silvana Haxhikadriu punonte në nivele të ndërlikuara të teknologjisë informatike, që vetëm pas 20 viteve të fundit do të dominonte proceset ekonomike dhe globale.

Në vitet 81-83, unë do të magjistroja në Institutin Möisinger të Zyrihut, një eksperiencë e mrekullueshme. M'u desh të lodhesha shumë për të ndjekur studimet në atë shkollë të shtrenjtë, por ja vlejti. Dy herë në javë ne ndiqnim studimet e Masterit në Marketing Ndërkombëtar dhe Manaxhim Prodhimi. Në kurs vinin profesorë të ndryshëm nga Belgjika, Gjermania, etj. Tema e magjistrimit ishte gjithashtu e shenjuar nga kreativiteti. Zgjedhja të merresha me ndikimin e vendkryerjes në rezultatin e sondazheve të preferencave të klientëve, sondazhe që përcaktonin me probabilitet të lartë këto preferenca. Ti shkoje në një vend të caktuar, ta zemë në stacion të trenit dhe me pyetje indirekte i drejtoheshe udhëtarëve: si është jeta jote, si zhvillohet ajo, a bën gjumë të mirë, a je alergjik, etj, e pyet për marrëdhëniet familjare. Prej një grupi pyetjesh, ti arrin të gjesh me një probabilitet të lartë prej 40% preferencat e klientit për një mall të caktuar. Në gjetjen e rezultatit futej dhe një formulë matematikore. Unë afirmoja në atë studim se vendi ku bëhej sondazhi ishte përcaktues për rezultatin e tij. Të njëjtat pyetje të bëra tek udhëtarët në aeroport, do të nxirrnin rezultate të tjera, për shkak të fuqisë blerëse (KKK- Kaufs, Kraft, Klasse) të ndryshme që supozohej se kishin të intervistuarit. Shkova në provim së bashku me një gjakovar dhe ne ishim të vetmit kosovarë atje. Mbaj mend se profesorët u mrekulluan nga paraqitja ime, dhe më kërkuan të doktoroja me atë subjekt. Por unë kisha zgjedhur tashmë karrierën profesionale dhe jo atë akademike. Megjithatë formimi akademik ka ndikuar shumë në karrierën profesionale dhe i ka dhënë jetës kujtime të bukura. Më vjen të qesh ndërkohë sesi disa kritikë të mi, vënë në diskutim nisur nga thjeshtësia e fjalimeve të mia, cilësinë e shkollimit tim. Shkollimi jashtë thjesht ndikoi në cilësinë e retorikës sime në shqip.

## Një vit i veçantë

*1979-1980- vit kur takova Nënë Terezën dhe mora leksionin e parë të humanizmit prej saj. I shpëtova një aksidenti ajror mbi qiellin polak dhe mbijetova, për fije të perit, një ndeshje të rëndë automobilistike në Slloveni. Ndhima e Mahmut Bakallit. Mos vallë jam bartës i ndonjë amaneti? Kulmi i suksesit tek Interplastica.*

Viti 1979-1980 ka qenë një vit ngjarjesh të mëdha në jetën time. Ai vit ka shenjuar shumë jetën e mëpastajme me njerëzit që takova, kusuret që hoqa dhe disa "takime" me vdekjen, të cilën e injorova në mënyrë fatlume. Shpeshherë e pyes veten se si munda të shpëtoj duke i shkuar vdekjes aq pranë dhe më pas i ika pa e kthyer kokën pas. Provat dhe gjurmët që vdekja m'i la si dëshmi të takimeve me të, më kujtojnë ato momente dhe gati-gati më bëjnë të besoj se jam bartës i diçkaje të veçantë, *i një amaneti*. Edhe pse jam besimtar, nuk besoj se kjo gjë ka ndikuar, pasi di shumë besimtarë me të cilët vdekja është treguar e pamëshirshme.

Fatmirësisht në atë vit nuk u takova vetëm me vdekjen, siç do të shohim më poshtë, por edhe me Nënë Terezën, gruan e madhe shqiptare që sapo kishte marrë çmimin Nobel për paqe, diçka që e nxori në dritën e madhe të gjithësisë për ne shqiptarët. Ne në atë kohë nuk e dinim as emrin e saj, askush nuk dinte gjë për të. Në mediat e Perëndimit, emri i saj ishte shumë më i pranishëm sesa në mediat kosovare apo të Shqipërisë. Si njeri kurioz që isha, doja shumë ta takoja atë grua shtatvogël, por me zemër të madhe, që i bëri krenarë botërisht shqiptarët me origjinën e saj. Unë atë vit punoja në një fabrikë shumë të madhe, disa pjesë të së cilës prodhoheshin në Indi dhe ne kishim një bashkëpunim shumë të madh me atë vend, më saktësisht me Nju-Delhin. S'di pse, por besoj se takimi me Nënë Terezën ka ndikuar në jetën dhe fatin tim.

Një ditë, ishte e shtunë, vendosa të shkoja në Kalkutë (isha vendosur në hotelin Hilton) për ta takuar Nënë Terezën. Pata shumë vështirësi në gjetjen e rrugës, por më në fund ia dola mbanë, sepse në

atë mjedis binin në sy rreshtat e njerëzve nevojtarë, apo me aftësi të kufizuara, që prisnin nëpër shkallë. Me fjalë të tjera ishte një grumbull i madh njerëzish, çka ma vështirësoi mundësinë të kontaktoja me Nënë Terezën. Në atë mjedis unë isha një njeri i rëndomtë, i panjohur. Ndoshta atë ditë kam pritur me orë të tëra jashtë, derisa erdhi një grua e vogël që më impresionoi pa masë. Duart e saj ishin asht e lëkurë dhe sot kur e kujtoj këtë detaj, më duket se e ndiej dorën time të shtrënguar me forcën që kishte ajo. M'u deshën edhe dhjetë minuta për të treguar se isha nga Kosova. Nënë Tereza nuk e dha veten, nuk donte të shfaqte para të tjerëve ndjenja përkatësie etnike shqiptare, ndoshta mund të ketë qenë ndjenjë rezervimi e saj. Edhe në takimet e mëvonshme me të, ajo nuk deshi të më tregonte sesi kishte mbërritur në Indi, duke iu shmangur pyetjeve të mia. Më fliste vetëm për motrën e saj që kishte mbetur në Shqipëri. Mbasi më priti në një zyrë të vogël, shumë të nxehtë, më pyeti: "Në cilin hotel jeni dhe sa kushton një dhomë atje?" E bëra me dije se ndodhesha në hotelin "Hilton", një dhomë e të cilit kushtonte 200 \$ nata. Më mori për dore dhe hipëm në një makinë të vjetër të shoqëruar nga një motër që e ngiste makinën dhe shkuam së bashku drejt hotelit ku isha akomoduar. Unë nuk e dija për çfarë po shkonim në hotel. Në fillim madje, mendova ndoshta për të ngrënë diçka dhe për të kaluar pak kohë aty. Dy motrat e nderit dhe unë shkuam në dhomën time, ku ato filluan të mbushnin valixhet e mia. "Tani do shkojmë", më thotë ajo. E pyes se ku. M'u përgjigj: "Ju do të vini te ne, në mision". Më vendosën në një dhomë shumë të vogël, pa asnjë komoditet brenda, një dhomë shumë diskrete. Normalisht unë prisja t`i kisha të gjitha, edhe ujin, edhe tualetin. Mbaj mend se për të kryer nevojat personale më duhej të dilja në një korridor të gjatë, ku ndodhej një tualet publik i cili ishte jashtëzakonisht i pastër. Në fund të qëndrimit tim, Nënë Tereza më tha: "Tani paguaj për qëndrimin tënd!" Praktikisht kam paguar çmimin që paguaja në hotelin "Hilton". Ishte ky leksioni im i parë i bamirësisë nga ana e saj, megjithëse prej prindërve, prej gjyshit, axhës, kisha marrë leksione të tjera. Nënë Tereza më dha të kuptoja se nuk kisha përse të harxhoja lekët në hotel kur mund të paguaja aty dhe të ndihmoja shumë njerëz në nevojë. Dua të them se disi u familjarizova me këtë bamirëse të madhe. Ndodhte që kur



*Me Mahmud Bakallin, 1982.*

kisha shumë detyrime të tjera, punoja ditën dhe kthehesha natën. Shpeshherë nuk më linin brenda nëse vonohesha pak.

Më vonë ajo më tregoi drejt për atë që personifikonte realisht, pasi unë nuk isha shumë i informuar. Unë e ndihmova misionin edhe me pak para të tjera, pasi në atë kohë nuk isha shumë i pasur. I kam dhënë 3000 dollarë, ndihmë për të cilën as që

mora ndonjë falënderim. Më tha thjesht: "Ky është një obligim yti ndaj të varfërve!" Kaq. Ky ishte stili i saj, i thjeshtë, i drejtpërdrejtë, por edhe imponues, që nuk do ta harroj kurrë.

E kam takuar sërish në Tiranë në vitin 1993, kur Nënë Tereza i kërkoi administratës shqiptare të kohës ngritjen e një spitali. Kam qenë i pranishëm në takim të saj me një kardinal të shquar, Ruinin, më duket, kur ajo bëri diçka mbresëlënëse. I la atij në xhep tre monedha të vogla indiane dhe i tha: "Mbaji me vete këto. Kur ta ndërrosh veshjen, kaloji nga xhepi në xhep. Dhe sa herë t'i prekësh, kujtohu për ndërtimin e spitalit!"

Në vitin 1998, mora pjesë në një ceremoni për mbledhje fondesh lidhur me këtë iniciativë, ndërtimin e spitalit, në dy qytete të ndryshme - në Tiranë dhe në Romë. Edhe me atë rast kardinali u zotua se do ta çonte në vend amanetin e Nënë Terezës, e cila kishte ndërruar jetë një vit më parë. Unë isha me Ana Oksën (Oxa), në atë ceremoni dhe isha i gatshëm të merrja pjesë, të kontribuoja në ndërtimin e atij spitali, i cili nuk u ndërtua kurrë. Do të doja ta pyesja atë kardinal, nëse i ruante akoma monedhat që ia dhuroi Nënë Tereza. Sigurisht jam kritik dhe për qeverinë e Shqipërisë, e

cila gjithashtu nuk e përmbushi këtë amanet historik, ndërsa flet për sjelljen e eshtrave të saj në atdhe.

Siç e thashë në krye të herës, më 1979-n, kisha hyrë në një vit të jashtëzakonshëm për mua. Në dhjetor të 1979 ndodhesha në Meksiko Siti dhe udhëtoja për në Uashington, ku duhej të merrja një aeroplan tjetër që do të më çonte në Poloni për një takim pune në *Warimeks*-in. Një vonesë e aeroplanit prej Meksiko Sitit në Uashington bëri të mos arrija dot të kapja aeroplanin tjetër që nisej për Poloni. Çfarë ndodhi? Unë u vonova për të arritur në kohën e nisjes dhe në hyrjen e linjës sime një polic i shëndoshë e kishte mbyllur derën me një litar dhe nuk më lejoi që të hyja në bord. Ia dhashë biletën të cilën e kisha prerë për udhëtimin në fjalë, por ai m'u përgjigj shkurt: jeni vonuar! Policët amerikanë janë vërtet të ndërgjegjshëm dhe të patundur në detyrat e tyre dhe unë u ktheva mbrapsht. Tejet i hidhëruar, ngaqë të nesërmen kisha një takim shumë të rëndësishëm pune. Zura një dhomë në një hotel pranë aeroportit. Të nesërmen në mëngjes kur u zgjova mora gazetën nën derë dhe në faqen e parë lexoj me të madhe *Airplane Crash near Warsaw* (rrëzohet një aeroplan pranë Varshavës). Kishte rënë avioni në të cilin duhet të udhëtoja unë dhe kishin vdekur 220 veta. Ende sot i kam ato bileta, madje një kopje të tyre e mbaj me vete gjithmonë, si një lloj hajmalie çudibërëse.

Mirëpo, nëse vdekja donte të takohej me mua dhe më la në dorë biletën e linjës Uashington-Varshavë, një herë tjetër ajo më la gjurmë më të thella, disa prej të cilave i ndiej dhe sot në trupin tim. Vdekja gati më mori përfundimisht në prehrin e saj. Një ndodhi fatkeqe do të më nxirrte për një kohë jashtë rrjedhave të punës dhe të angazhimit. Në të vërtetë, në fatkeqësinë që më ndodhi, unë isha njeriu më me fat që është parë ndonjëherë: shpëtova gjallë në një aksident trafiku, madje në rrethana të tilla, në të cilat vdekjen e kisha pothuajse të sigurt. Ishte vërtet një mrekulli e të madhit Zot që mbeta gjallë edhe një herë!

Ishte 17 gushti i vitit 1980 dhe unë u ktheva në Kosovë, pas një shërbimi të gjatë e të lodhshëm në Bullgari. Më pastaj, po me veturë, duhej të vazhdoja rrugën për në Zvicër. Arsyeya e ndaljes për një kohë të shkurtër në Kosovë, ishte vizita që duhej t'i bëja familjes në Marec, nënës në radhë të parë, e cila mërzitej dhe e ndiente shumë

mungesën time. Pastaj, para do kohe më kishte vdekur gjyshi dhe unë nuk kisha arritur as të merrja pjesë në varrimin e tij. Tani ishte radha të tregoja pak respekt edhe për të, duke vizituar varrin e tij, gjë që e bëja sa herë më jepej rasti. Pra, në përgjithësi, atë ditë që u ktheva në Kosovë, isha i lodhur dhe i mërzhitur. Madje, më kujtohet se në qendër të Prishtinës, mbase diku afër godinës së atëhershme të Komitetit Krahinor, takova rastësisht Mahmut Bakallin (për rrethanat e njohjes me të, do të rrëfej më vonë), i cili, pasi e kuptoi se do të udhëtoja po atë mbrëmje, më sugjeroi të mos nisesha vetëm, sepse dukesh shumë i lodhur.

Ndoshta ka qenë sugjerimi i tij, që unë vendosa ta marr me vete vëllanë tim, Ismetin, megjithëqë, ç'është e vërteta, me rrugë të gjata dhe vozitje shumorëshe pa ndërprerje tashmë isha mësuar. Me makinë, mesatarisht bëja nga 150 mijë kilometra në vit. Mbaj mend se në Prishtinë atë ditë bënte vapë e madhe, prandaj menduam të niseshim në mbrëmje, për fresk. Me vëllanë, u nisëm diku nga ora shtatë e mbrëmjes dhe mbaj mend se në Zagreb arritëm diku nga ora dy e gjysmë pas mesnate.

Binte një shi i rrëmbyeshëm. U ndalëm, pushuam pak dhe hëngrëm darkë. Më pas vazhduam rrugën për Lubjanë. Voziste Ismeti. Siç bëjnë zakonisht njerëzit e lodhur nga vozitja e gjatë, unë e shtriva pak ulësen e veturës, u lidha dhe fjeta. Nuk arrita të marr vesh se ç'ndodhi ndërkohë, sepse nga gjumi kam kaluar në komë, kështu që këtë pjesë të rrëfimit po ua tregoj ashtu siç ma kanë thënë të tjerët.

Çfarë kishte ndodhur në të vërtetë? Një përplasje e fuqishme e veturës me një kamion. Nuk di si dhe nuk di në çfarë rrethane. Ismeti, meqë nuk kishte qenë i lidhur, kishte fluturuar nga dera e anës së tij dhe kishte përfunduar në asfalt, në drejtimin tjetër të rrugës, me thyerje të dorës dhe me një lëndim në kokë. Fati i tij i madh kishte qenë që, ndërkohë nga ana e kundërt nuk kishte ardhur ndonjë makinë. Atë e paskëshin çuar me një veturë urgjentisht për Lubjanë. Ndërkaq unë kisha mbetur i bllokuar në veturë, sepse makina ishte shndërruar në një grumbull hekurishtesh. Për të më nxjerrë që andej, kishin përdorur mjete teknike, leva dhe gjëra të tilla.

Më në fund, arritën të më nxirrnin krejt të gjakosur dhe dikush i qenkësh lutur një çifti gjerman, nga Freiburgu i Gjermanisë, që të më çonin në spital, po ashtu në Lubjanë. Kish qenë një *Opel Kadet* i kuq me dy dyer, kështu që gruaja del prapa, kurse mua më shtrijnë disi në ulësen pranë shoferit. Meqë kisha derdhur gjak më shumë nga plagët në kokë, në nofull, ma mbështjellin disi kokën me xhaketën time dhe nisen.

Problemi shfaqet me të hyrë në Lubjanë. Burri gjerman i paskësh thënë gruas së tij:

“Nuk e di nga të shkoj tash. Ku e di unë ku është spitali?”

Ajo që mund të quhet çudi, ndodhi pikërisht në këtë situatë, sepse unë, sipas rrëfimeve të çiftit gjerman, i paskam folur atij në gjuhën gjermane duke i treguar se nga duhej të shkonte. Shkoni drejt, i paskam thënë, deri te semafori i parë dhe pastaj kthehuni djathtas, pastaj kalojeni tunelin. Ata kishin mbetur të habitur. Pak më vonë i paskam thënë: "kalojeni urën dhe shkoni drejt." Dhe, në këtë mënyrë, i kisha orientuar, deri sa kishim arritur te spitali, madje jo te hyrja zyrtare, por atje ku pranoheshin pacientët.

Unë, natyrisht, nuk mbaja mend asgjë nga gjithë këto. Pastaj, më kishin nxjerrë nga makina dhe, në atë çast, më kishte rënë nga xhepi notesi me numrat e telefonave. Atë e merr dhe e shfleton një infermiere me emrin Nadia. Në një faqe të veçantë të atij blloku ishin shënuar disa numra të telefonit të Mahmut Bakallit. Siç më



*Pas daljes nga spitali, 1981. Këto sende të hekur-ta m'u desh t'i mbaja edhe për 17 muaj.*

ka rrëfyer më vonë, Nadia mendoj ta provonte një herë atë numër sepse emri i Mahmut Bakallit, i shënuar ndryshe nga të tjerët, i ishte dukur i rëndësishëm për mua.

Kjo ndodh diku rreth orës katër të mëngjesit. Infermierja Nadia e thërret Mahmut Bakallin në numrin e shtëpisë. Bakalli i përgjigjet dhe ajo i tregon se Behgjet Pacolli ka pësuar aksident të rëndë dhe se është në rrezik jete. Bakalli, pa vonesë, thërret homologun e tij slloven, ndërsa slloveni nga ana e vet drejtorin e spitalit. Drejtori kontakton me mjekun kryesor, prof. dr. Kushak.

Të gjitha këto thirrje zgjasin gjithsej 17 minuta, deri te ardhja e prof. dr. Kushakut në spital. Siç më ka rrëfyer infermiera Nadia më vonë, me të ardhur në spital, dr. Kushak pyet për mua. "Ku është ai, Behgjet Pacolli?" "Ai tashmë ka vdekur, - i thotë ajo. - E kanë çuar në morg". Atë ditë kishte pasur shumë të vdekur nga aksidentet në komunikacion, një familje turke prej shtatë anëtarësh, disa sllovenë etj., kështu që në urgjencën e spitalit kishte qenë rrëmujë e madhe. "Dua ta shoh", thotë dr. Kushak dhe, bashkë me infermierën, shkojnë në morg. Ma heqin çarçafin, me të cilin më kishin mbuluar dhe dr.Kushak vëren se mua ende më rridhte gjak nga goja, sepse, ndër të tjera, e kisha pasur nofullën të thyer.

Rripat e sigurisë, ashtu siç kisha qenë i shtrirë në ulëse, përveç që më kishin mbrojtur, edhe më kishin dëmtuar. Rripi i poshtëm më kishte dëmtuar në bark dhe, nga inercioni i fuqishëm, ma kishte shtyrë edhe zemrën përjetë. Rripi i epërm ma kishte thyer nofullën bashkë me dhëmbë dhe ma kishte dëmtuar qafën, sikundër edhe palcën e kurrizit. Por në morg më kishte rrjedhur gjak, siç e kanë shpjeguar mjekët, për shkak të ndryshimit të temperaturës, sepse jashtë kishte qenë nxehtë, kurse brenda, pra në morg, temperatura kishte qenë rreth 4 gradë celsius. Ky ndryshim i shpejtë i temperaturës e kish tkurrur zemrën duke e nxitur të punojë. Dhe, kuptohet gjaku kishte filluar të rrjedhë.

Prof. dr. Kushak, mjek me përvojë dhe profesionist i zoti, me një bisturi të rëndomtë, shpejt m'i bëri dy prerje, një të venës në hyrje dhe një tjetër në dalje nga zemra, në mënyrë që gjakun ta çonte në tru, sepse ekzistonte rreziku i vdekjes së trurit, për shkak të mosfunksionimit të zemrës. Aty për aty ata më bënë një bajpas të shpejtë,



duke e kaluar gjakun nëpër aparaturo dhe duke e lënë zemrën jashtë funksionit, derisa e zgjeruan koshin e kraharorit, pastaj e kthyen zemrën në vendin e vet duke i krijuar hapësirë për punë normale. Natyrisht, disa veprime u bënë me një shpejtësi të madhe, disa të tjera me operacione kaskadë, pra të njëpasnjëshme.

Kjo gjendje kishte zgjatur 28 ditë. Atëherë unë paskam dhënë shenjat e para të kthimit në jetë. Tani më kujtohet se, kur i kam hapur sytë, përballë kam parë një orë me datë. Ishte 14 shtator! Nga kjo, sikundër edhe nga prania e mjekëve, e mora vesh se me mua kishte ndodhur diçka, sepse ishte një ndërprerje e madhe në kohë. Pastaj ambienti i spitalit. Pak nga pak filloi të më kthehej kujtesa. Pyetja e parë imja ka qenë: "Ku e kam vëllanë, Ismetin?" Ata më shpjeguan se vëllanë e kisha mirë, se pas pak do të ma sillnin aty, që ta shihja vetë. Ndërkohë, nga Kosova kishte ardhur edhe baba, i cili dy javë kishte qëndruar aty. Pozita e tij ishte shumë e vështirë, sepse gjatë gjithë asaj kohe mjekët nuk i kishin dhënë shumë shpresë për kthimin tim në jetë. Përveç kësaj, nënës nuk i kishin treguar fare që unë kisha pasur aksident.

Mirëpo, kthimi im në jetë u shënuar edhe me një situatë tjetër të komplikuar. Fotografimet e ndryshme që më kishin bërë, kishin qenë të përqendruara më shumë në pjesën e përparme të trupit, kryesisht në koshin e kraharorit dhe në nofulla. Njëri nga mjekët dikur më tha t'ia shtrëngoja dorën, por unë nuk arrita ta bëj këtë. Atëbotë më bënë një fotografim të shpejtë të qafës dhe të boshtit të kurrizit dhe e shohin se unë isha në rrezik të madh të paralizës së plotë. Unazat kishin pasë lëvizur nga vendi dhe palca kurrizore për pak kishte qenë gati të dëmtohej. Kjo mund të ndodhte në çdo çast. Mjaftonte një lëvizje e vogël e kokës dhe çdo gjë mund të merrte fund.

Që të mos ndodhte kjo, mjekët më bënë një shpim pas kokës dhe vendosën dy shufra hekuri, të cilat pastaj i mobiluan në krahe, në mënyrë që koka të mos peshonte në unaza dhe çdo lëvizje e saj të ishte e pamundur. Të gjitha këto u bënë me një shpejtësi të jashtëzakonshme, madje pa anestezi, pavarësisht nga fakti se kisha dhembje të tmerrshme.

Pasi i kryen këto veprime, gjendja ime shëndetësore u qetësua paksa dhe mjekët filluan të më shpjegojnë një për një çdo gjë që

kishte ndodhur. Dy muaj qëndrova i shtrirë në spitalin e Lubjanës. Pastaj më dërguan në Amerikë, nga gjysma e tetorit, në një klinikë speciale të Klivlendit, ku përmes një sonde me laser dhe impulseve elektrike arritën të kthejnë në funksion normal palcën e kurrizit. Mirëpo, konstruksionin e metaltë vazhdova ta mbaj në qafë e në shpatulla për 17 muaj radhazi.

Ndërkohë, prof. dr. Kushak e futi në leksionet e tij të Fakultetit të Mjekësisë, “rastin Pacolli”, si një përjashtim i ligjeve të mjekësisë. Por më i veçantë nga të gjitha, ishte interesimi i çiftit gjerman, ata që më kishin sjellë në spital nga vendi i aksidentit. Ata pothuajse çdo ditë kishin pyetur me telefon, nëse më ishte kthyer vetëdija. Kur e morën vesh se kisha dalë nga koma, erdhën enkas nga Freiburgu dhe më vizituan në spital, duke qëndruar rreth një orë me mua, dhe duke ma shpjeguar fill e për pe tërë rrjedhën e ngjarjes që tashmë e rrëfeva. Ishin njerëz të jashtëzakonshëm, apo jo?

Natyrisht, një borxh të madh për çdo gjë që bënë për mua në spitalin e Lubjanës, i kisha Mahmut Bakallit, njeriut që nuk hezitoi asnjë çast të më ndihmonte, me të gjitha mënyrat, në këtë situatë tepër të rëndë për mua. Ai nuk kishte asnjë obligim që ta bënte këtë. Isha njëri nga miqtë e shumtë të tij, me një njohje relativisht të shkurtër dhe pa shumë kontakte intensive. Nuk na binte puna të takoheshim shpesh, sepse që të dy kishim angazhime të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Pra, rrugët nuk na puqeshin aq shpesh. Gjesti i tij, që të çonte në këmbë në një orë të tillë kreun politik të Sllovenisë, sepse dikush nga të njohurit e tij kishte bërë aksident në komunikacion, përveç që dëshmonte vullnetin e mirë dhe përkushtimin ndaj miqësisë, ishte edhe një gjest human i pashembullt.

Le të them këtu, se me Bakallin jam njohur në rrethana krejt të zakonshme, sa më kujtohet, në prani të Bejta Novobërdaliut, mbase në zyrën e tij, në Sekretariatit Krahinor për Marrëdhënie me Jashtë. Ka qenë një njohje e rastësishme, një takim kurtuazie, pa as më të voglën ide se ky do të ishte fillimi i një miqësie më të gjatë. Pas kësaj njohje, ka ardhur një takim tjetër, në vitin 1978, në Hotel “Jugosllavia” në Beograd. Për mua ishte një befasi e këndshme, kur ai jo vetëm që më dha të njohur dhe më bëri me dije se nuk më kishte harruar, por edhe më ftoi që të ulesha në tryezën e tij. Kemi qëndruar deri në

orët e vona të natës. Kanë pasuar edhe disa takime të tjera me të, por më shumë të rastit. Më kujtohet se interesohej për punën time, më inkurajonte të punoja, por shumë rrallë ndodhte ta sillte muhabetin te politika.

Natyrisht, të gjithë e dimë se ngjarjet e vitit 1981 nxorën si viktimë politike Bakallin dhe bashkëpunëtorët ose bashkëmendimtarët e tij. Unë ato ngjarje nuk i kam përjetuar nga afër, pra jo si shumica dërrmuese e kosovarëve të tjerë, sepse isha me angazhime larg Kosovës. Por nuk mund të them se nuk i kam ndjekur me kureshtje dhe nuk i kam ndjerë ato. Ishte e qartë për mua se rrebeshi politik mbi Bakallin, që u zhvillua në muajt vijues pas demonstratave, nuk ishte qërim hesapesh me një individ dhe as me vijën e tij politike, por ishte sulm mbi Kosovën dhe mbi shqiptarët. Ishte një agresion i pashembullt mbi autonominë e Kosovës dhe mbi ato vlera, të cilat ne shqiptarëve, përfshirë edhe mua, na bënë të ndiheshim deri diku të barabartë në hapësirën jugosllave.

Unë nuk e kam ndër mend këtu të bëj analiza çfarëdoqoftë rreth atyre zhvillimeve, por mjafton të them se me ngjarjet e vitit 1981 dhe veçmas me sulmet e paskrupulla kundër Bakallit, në forumet politike, në medie, u bë e qartë se Jugosllavia pas Titos nuk mund të qëndronte edhe për një kohë të gjatë, e tillë siç ishte menduar në vizionin e tij politik. Përveç kësaj, për mua si kosovar, nxjerrja e Bakallit nga skena politike, duke e njohur mirë autoritetin e tij në mbarë Jugosllavinë e atëhershme, kishte në prapavijë edhe një rivalitet joparimor jo vetëm në mesin e udhëheqjes politike të Kosovës, por edhe të hapësirave të tjera jugosllave. Bakalli në shumë pika ishte superior ndaj asaj klase politike, që sundonte Jugosllavinë e atëhershme. Ishte i ri, kishte koncepte të reja, ishte energjik dhe kishte dije jo vetëm më shumë se i gjithë establishmenti politik i Kosovës, por mund të matej edhe me parametra të tjerë, jugosllavë, madje edhe botërorë. Unë kam njohur shumë udhëheqës komunistë të niveleve të ndryshme, anekënd botës. Bakalli nuk ishte si ata. Ishte modern në koncepte dhe në vizion.

Pas vitit 1981, për arsye të njohura, Bakallin nuk e kam takuar për një kohë, deri në vitin 1990. Ai u izolua politikisht dhe gjithashtu bënte jetë të izoluar. E dija se i përgjohej edhe telefoni, prandaj nuk

e kam shqetësuar në asnjë formë. Nga viti 1990 e prapa, me Bakallin kemi pasur kontakte të shpeshta. Një kohë të gjatë, nën përkujdesjen time ka qëndruar në Lugano, qoftë në hotel, qoftë në shtëpinë time. Bisedonim shpesh për Kosovën dhe për mënyrën e zgjidhjes së krizës së saj. E dija se mbante lidhje me ish-ambasadorin e Amerikës në Beograd, Igëllbërgerin (Lawrenc Eagleburger) dhe atij i dërgonte raporte dhe analiza. Kishte raste kur besonte se për Kosovën, me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare, mund të gjendej një zgjidhje paqësore. Në këtë pikë ndonjëherë mbështeste Rugovën. Më pastaj zhgënjehej. Nxirrte argumente dhe kundërgargumente dhe vinte në përfundim se çështja e Kosovës mund të zgjidhej vetëm me luftë. Më vjen keq jo vetëm pse vdekja e rrëmbeu herët, kur ai ende kishte energji dhe akoma mund të kontribuonte për Kosovën, por më shumë për faktin se Kosova e viteve të pasluftës nuk ka ditur t'i shfrytëzojë aftësinë udhëheqëse dhe dijen e tij politike.

Pas këtij digresioni, do të kthehem përsëri te rrjedha e rrëfimit. Aksidenti, përveç pasojave të paevitueshme në gjendjen time shëndetësore, nuk solli ndonjë ndryshim në punën time. Madje, mund të them se, simbolikisht, shikuar në aspektin kohor, kjo ngjarje ishte njëlloj kthese. Nuk e shpjegoj dot si ndodhi kjo, por e di që atëherë, më saktë nga fillimi dhe mesi i viteve tetëdhjetë, unë do të bëja depërtime të reja shumë domethënëse në fushën e biznesit. Mbase kishte ardhur momenti. Në horizont shiheshin ndryshime të mëdha globale. Lidhur me këto ndryshime, një gjë e ndieja në mënyrë intuitive: Perëndimi do të dominonte mbi Lindjen, kapitalizmi do të verifikohet si sistem shoqëror me përparësi të mëdha karshi socializmit. Lindja, bashkë me socializmin, kishin degraduar. Por, ndryshe nga shumë të tjerë, unë e dija se shtetet e Lindjes duhej të mëkëmbeshin dhe të ringjallehin, të transformoheshin në çdo pikëpamje, përfshirë edhe teknologjinë e prodhimit. Ky ishte shans i madh për botën e biznesit. Prandaj, gara mund të fillonte dhe në atë garë unë kisha pjesën time dhe - shanset e mia.

Disa muaj pas aksidentit, unë fillova të punoja përsëri, pavarësisht nga konstruksioni i metaltë që nuk më linte as të ktheja, as të mënjanoja kokën. Arsyeja përse u futa në punë kaq shpejt, në njëfarë mënyre, ishte situata e re e krijuar në firmë. I kënaqur me

sukseset e mia të padiskutueshme në tregun jugosllav, Gygaksi e kishte zgjeruar tashmë zonën e kompetencave të mia në Bullgari, Poloni, Rumani dhe Turqi. Mirëpo, derisa në zonën e kompetencave të mia shtoheshin kontratat dhe fitimet e firmës, nga ana tjetër, në zonën e Bashkimit Sovjetik këto të ardhura kishin filluar të binin ndjeshëm. Maks Gygaksi ishte i shqetësuar. Papini e Salvatori, vetëm për të minimizuar punën e Çengias, e quanin atë fajtor përse kishte insistuar në përfshirjen time në *Interplastica*. Së fundi, ndonëse me vonesë të panevojshme, Gygaksi mori vendimin e duhur: ma besoi përgjegjësinë e zonës sovjetike, bashkë me Çengian, në vitin 1983. Duke pasur si “barrë” mungesën e suksesit në periudhën e shkuar, Çengia pak nga pak filloi të tërhiqej, për të ma lënë mua përgjegjësinë kryesore për këtë treg. Tashmë isha bërë personi numër dy i *Interplastica*-s. Gygaks m’i dha të gjitha fuqitë drejtuese, me prokurë, noter dhe aktdelegimi. Roli im në firmë ishte bërë vendimtar. Nëse do të ikja, firma do të mbetej pa punë dhe pa porosi klientësh. Këtë e dinte Gygaksi, por edhe të tjerët në firmë ishin të vetëdijshëm për rolin tim. Ku mbështetesh? Zakonisht unë tregohesha i shkathët dhe biznesin e bëja sa më praktik që ishte e mundur. Njerëzit në atë kohë nuk kishin mundësi t’i kuptonin të gjitha. Nëse ofertën tënde e paraqisje sa më të kuptueshme për klientin, fitoje. Unë e kam pasur në shpirt sensin praktik dhe nuk më kanë pëlqyer asnjëherë gjërat gjysmake pasi gjithmonë i kam dashur të përkryera. Pika ime tjetër e forcës ka qenë se unë kam ditur 6 gjuhë të huaja dhe gjithmonë kam qenë i informuar në kohën e duhur mbi tregjet, dhe arrija të kuptoja qartë prej bashkëbiseduesve çfarë kërkonin. Ndërkohë karakterizohesha nga një sens i shpejtë vendimmarrjeje. Derisa kërkesa arrinte në firmat e tjera perëndimore, derisa ato e shqyrtonin, unë kisha arritur ta kryeja punën.

Tashmë kishin kaluar pesë, gjashtë, tetë vjet nga puna e vazhdueshme në *Interplastica*. Merrja një rrogë solide dhe familjes në Kosovë vazhdoja t’i dërgoja para, duke u përpjekur jo vetëm ta laja borxhin që çdonjëri e ka ndaj familjes së vet, por edhe për t’i ngjallur ekonomikisht. Duke qenë familje e madhe, së paku të mos ndienin shtrëngesa të tilla, çfarë i kisha ndjerë unë gjatë fëmijërisë dhe rinisë së hershme.



*Jashtë mureve të Kremlinif, 1983. Atëherë nuk kisha menduar ç'do të vinte më pas... se brenda këtyre mureve do të prishja ndërtimet e komunizmit nga viti 1918 dhe do të lija gjurmë në histori. Por kisha nisur më parë me industrinë tekstile...*

Siç thashë isha në një vit fatsjellës në të gjithë kuptimet: në Poloni pata përfituar disa projekte në fabrika të mëdha. Atë vit isha dizajnuar si njeriu më i sukseshëm i biznesit europian, çmim të cilin nuk e arrita për shkak të disa problemeve të vogla të miat. Po në këtë vit shefi im në Zvicër më emëroi drejtor të firmës *Interplastica*. Kur unë e mora drejtimin e saj, kjo firmë kishte 40 persona të punësuar dhe një xhiro prej 45 milion dollarësh, ndërsa në vitin 1990 kur u shkëputa prej saj, kjo firmë numëronte 68 veta të punësuar dhe kishte një xhiro prej 360 milionë dollarësh. Kjo më shtyu të hyja në biznese të mëdha, sidomos në Rusi. Me firmën *Merloni* patëm ndërtuar një fabrikë të madhe lavatriçesh në Minsk, një tjetër fabrikë frigoriferësh, fabrikën e mikromotorave të sofistikuar të përdorur për raketat e gjithësisë Buran, në Voronezh dhe shumë projekte të tjera të cilat i

përfundova me sukses. Ky trend vazhdoi me sukses të madh deri në vitin 1986, kur u shpall Perestrojka. Në atë kohë m'u hap realisht një horizont i ri duke arritur çmimin “biznesmeni më i aftë në Europë në vitin '88”. Ky vit ka qenë kulmi i suksesit tim tek *Interplastica*: kështu, fjala vjen, vetëm për një natë kam nënshkruar 13 kontrata, prej të cilave më e ulëta ka qenë 18 milionë dollarë, me një total të përgjithshëm prej 152 milionë dollarësh, kontrata të mbështetura tërësisht në fuqitë e mia. Dëgjoja se në Moskë kishte ardhur dikush nga Urali si sekretar i parë i Komitetit Qendror të kryeqytetit dhe nga aty filloi aktivitetin e tij. Ai ishte Jelcini. Në kohën e Perestrojkës Jelcini ishte jashtë loje, pasi ishte njeriu i parë që e ktheu mbrapsht librezën partiake, duke u shprehur qartë se partia komuniste nuk i interesonte më. Këto i di për shkak të kontakteve që kisha. Ai ishte një lloj ministri i ndërtimit dhe unë isha drejtpërsëdrejti i lidhur me të, një ministër pa portofol, pasi zëvendësit e kryenin punën e tij. Zyra e tij më impresiononte sepse nuk kishte asnjë shkresë, asnjë dokument; raftet ishin gjithmonë bosh. Ai vuante nga diabeti. Ai ishte një njeri autoritar, por njëkohësisht dukej se nuk i ngjante të tjerëve, pjesë e nomenklaturës.

## Teknologjia ime - revolucion në industrinë tekstile

*Fati dhe sukcesi ndërtohet rreth ideve të ndritshme, ose ideja e mbështetur mbi një studim të hollësishëm që theu tabutë në Bashkimin Sovjetik. Përhapja e një metode të re teknologjike në industrinë tekstile në gjithë territorin sovjetik. Forca e ideve shkund edhe mjedisin e ngurtë. Tanimë të gjithë më njihnin në këtë vend.*

**P**or le të kthehemi te *Interplastica*. Siç thashë, në një periudhë të shkurtër kohore, unë arrita të shtoj dukshëm xhiron vjetore të *Interplastica*-s dhe ajo, nga një firmë e vogël me suksese të kufizuara, gradualisht u bë njëra nga firmat më konkurrenente në fushën e eksportit të makinerive, një herë të tekstilit, pastaj edhe të profileve të tjera. Në hapësirat e ish-Jugosllavisë, deri në vitet '80, kam realizuar shitjen e makinerive për shumë fabrika. Në Slloveni: *MIT* Maribor, *Primorje* në Lubjanë, *SCT* gjithashtu Lubjanë, *Lek* Novo-Mesto, pastaj në Nova-Goricë, Kranj dhe Koper. Në Zabok të Kroacisë u realizua një kontratë shumë milionëshe, sikundër që edhe *Vutex* i njohur i Vukovarit u ndërtua me kontratat e mia. Në Bosnjë e Hercegovinë po përmend *Rogatica* në Sarajevë, *Sokolac* në Zenicë, si dhe rindërtimin pothuajse të tërësishëm të fabrikës së njohur të qilimave, gjithashtu në Sarajevë. Në Serbi, pothuajse e tërë zona industriale e Gornji Mladenovacit, si dhe një fabrikë në Priboj. Pa harruar këtu edhe Kosovën, Gjilanin dhe Gjakovën, për të cilat fola më parë.

Nga fundi i vitit 1985 dhe fillimi i vitit 1986, më lindi një ide, të cilën nuk ia thashë askujt. Duhej të shkoja personalisht dhe ta hulumtoja tregun e Rusisë, të bëja sondazhe të gjithanshme dhe t'i verifikoja vetë gjërat. Vizitova shumë firma, analizova dhe studiova sistemin e tregut në atë vend të madh, mbajta shënime për çdo gjë, se çfarë kishte dhe çfarë mungonte. Fola me njerëzit e rëndomtë, me drejtuesit e shumë firmave dhe përfaqësuesit politikë të niveleve të



ndryshme. Arrita, kështu, të formoj një listë të gjërave që u mungonin më shumë njerëzve atje. Mbi të gjitha, veshjet e bukura, që nuk kanë kosto të lartë.

Kush ka qenë në atë kohë në Bashkimin Sovjetik, pra në kohën para “Perestrojkës” së Gorbaçovit, qoftë në Rusi, qoftë në ish-republikat e tjera të këtij shteti të madh, apo në përgjithësi në vendet e ish bllokut komunist, do të ketë vërejtur se njerëzit dukeshin njësoj, të gjithë pa përjashtim. Të dukej një masë gri, ku njerëzit nuk kanë individualitet dhe shkrihen në një tërësi uniforme. Madje, më keq se kaq. Të dukej sikur shikoje ndonjë nga ata filmat e vjetër bardhë e zi, ku varfëria e ngjyrave nuk reflektonte trillet e artit, por mungesën dhe varfërinë. Kjo ndodhte, për mendimin tim, kryesisht për shkak të veshjes.

Unë e dija se, prapa kësaj veshjeje të varfër, të degraduar dhe të padinjitetshme, qëndronte krenaria, inteligjenca, kultura, niveli arsimor, aftësia e padiskutueshme e një populli të madh, i cili Europës i kishte dhënë vlera të mëdha kulturore në të shkuarën dhe në të sotmen. Dija, gjithashtu, se filozofia e veshjes është pjesë e një sistemi vlerash, afirmim adekuat ose përjashtim i tyre. Veshja është fenomen social-kulturor, njësoj sikurse niveli arsimor dhe zhvillimi ekonomik, nga të cilët varet. Veshja është edhe refleks i statusit shoqëror të individit, është dëshmi e hierarkisë shoqërore, sikundër që mund të jetë edhe privilegj i pamërituar në një sistem totalitar. Pra është një fenomen kompleks. Madje edhe fenomen politik shumë specifik.

Unë shihja në Moskë dhe në qytetet e tjera të mëdha të Rusisë, veçmas në ato vende me traditë kulturore qytetare, se si të rinjtë dhe jo vetëm ata, femrat kryesisht, përpiqeshin t’i kompensonin mungesat e shumta qoftë përmes improvizimeve të ndryshme, qoftë duke kërkuar ku ishte e ku nuk ishte ndonjë stof të bukur, ose ndonjë model pak më modern. Kjo situatë nxirrte në sipërfaqe mungesa të mëdha në tregun sovjetik jo vetëm të lëndës së parë, por edhe të stofit cilësor, pra të një industrie me teknologji të përparuar. Por ishte një gjë që unë ndoshta e kisha vërejtur më mirë se të tjerët, që shkonin e vinin nga Perëndimi në Moskë dhe anasjelltas: dëshira për elegancë dhe veshje me shije te popujt e asaj hapësire nuk mungonte.

Mungonin vetëm kushtet për t'i realizuar ato.

Ishte lehtë të merrej me mend se kjo dëshirë për elegancë e hijeshi, rriste edhe kërkesat e tregut. Gjatë asaj vizite, kisha menduar sa e sa herë, se ç' inat ndrynin në vete ato femra të bukura ruse, të cilat nuk mund të tregonin hijeshinë e tyre përmes një veshjeje elegante. Ato ishin të privuara nga dëshira dhe pasioni që e cilëson çdo grua: të vishet me shije dhe të duket bukur. E njëjta gjë vlente edhe për burrat. Mund të mendoni sa e sa mjekë, inxhinierë, shkencëtarë, profesorë dhe njerëz të ndryshëm të botës intelektuale, të cilët nuk kishin pamje të dinjitetshme, konform rangut të tyre shoqëror, por dukeshin disi të ndrydhur e të përvuajtur pikërisht për shkak të dukjes së tyre të jashtme krejtësisht të papërshtatshme. Ata, njerëz që botës së dijes, të shkencës dhe të artit i jepnin vepra madhështore, nuk diferencoheshin me asgjë, karshi njerëzve të zakonshëm të një turme pa identitet. Për shkak të pamjes së jashtme, ata ndiheshin inferiorë kundrejt të huajve që vinin nga Perëndimi. Akoma më keq ndiheshin kundrejt oligarkisë politike, e cila, edhe përkundër faktit se jeta bëhej në kushtet e një barazie të dhunshme, megjithatë arrinte të diferencuhej nga turma gri, gjithsesi pa e merituar këtë.

Në përgjithësi, atëbotë, unë pashë me sytë e mi se bota ruso-sovjetike ishte një botë të dëshpëruarish. Këtë e vinin re të gjithë ata që vinin nga Perëndimi. Por atë që nuk e vërenin shumica e perëndimorëve, ishte diçka tjetër, që mua më lëndonte: shumica syresh silleshin si fodullë karshi këtij mjerimi. Kapardiseshin dhe shitnin poza. Gënjenin dhe mashtronin. Abuzonin dhe poshtëronin. Tallnin dhe fyenin. Mund t'i përfytyroni ato vajza të bukura ruse, që i pritnin në Aeroportin *Sheremetevo* këta kapadainj të Perëndimit, te merrnin si dhurata gjëra krejt pa vlerë, cikërrima të panevojshme, ndonjë kalendar muri, ose revista të vjetra të modës, të shumtën ndonjë fustan ose ndonjë palë këpucë, që bliheshin për dy pare.

Arrita të vërej gjithashtu se "Glasnosti" dhe "Perestrojka" e Gorbaçovit nuk mbërrinin të preknin esencën e gjërave. Ato i lehtësonin kontaktet e Bashkimit Sovjetik me Perëndimin, por kishin mbetur në periferi të problemeve, sepse nuk kishin arritur të identifikonin shkaktarët e kësaj gjendjeje, aq më pak t'i shmangnin ato. "Glasnosti", ta zëmë, i mëshonte shumë problemit të alkoolizmit

në shoqërinë ruse, mund të shkonte deri aty sa t'i analizonte disa nga shkaqet, por nuk ia dilte t'i shmangte shkaqet dhe ta shëronte shoqërinë nga “dëshpërimi gjenetik”.

Kësaj shtate unë iu qasa pak më ndryshe, me një realizëm dhe ndjeshmëri më të madhe. Ndieja keqardhje për gjendjen e krijuar dhe kërkoja mundësinë e daljes nga kjo gjendje me ndihmën e Perëndimit. Hapja e tregut ishte njëra nga mundësitë, ndoshta më kryesorja. Ajo krijonte leverdi të dyfishtë, si për rusët që donin të dilnin nga ky mjerim, si për perëndimorët që donin të përfitonin nga kjo gjendje. Perëndimorët duheshin futur në konkurrencë të cilësisë, për të mos i lënë që të mbushnin tregun me prodhime skarco, me të tilla prodhime që quheshin mbeturina në vendet e tyre. Kjo ishte me rrezik, sepse një treg i etur di të sillet në mënyrë të paparashikueshme. Mund të fitonin terren pikërisht ata që e nënçmonin tregun rus dhe tregun lindor në përgjithësi dhe të përfitonin shumë nga kjo shtatë, në një kohë që unë, ndërsa kërkoja të respektoja dinjitetin njerëzor dhe të ofroja cilësi, mund të mbesja në margjinë, madje edhe më keq, me gisht në gojë, siç i thonë një fjale. Respekti që ushqejta për atë konsumator, fare lehtë mund të dilte një floskulë e pavlerë, madje të më kthehej si bumerang.

Edhe përkundër këtij rreziku, unë vendosa të ndjek rrugën time. Bëra hulumtime në të gjithë sektorët, shkova nga një qytet në tjetrin, nga një fabrikë në tjetrën. U takova me shumë njerëz dhe bisedova me ta në mënyrë të çiltër. Diku prezantohesha si zvicëran, diku si shqiptar, por gjithnjë e kisha parasysh një gjë: respektin ndaj njeriut, ndaj vlerave, ndaj dinjitetit të tij. Unë isha afarist dhe kjo nuk diskutohej. Kërkoja hapësirë për biznes, edhe kjo ishte gjë e ditur. Por biznesin doja ta bëja jo duke fyer dhe duke poshtëruar, sepse e dija sa dhemb kjo për njeriun në nevojë, por duke treguar respekt për dinjitetin e tij dhe duke i ofruar zgjidhje që ishin më të përshtatshme për të. Natyrisht përfundimet e mia për Rusinë, për Bashkimin Sovjetik, mendoj se vlenin për gjithë botën e lindjes, me dallimet e kuptueshme.

Me t'u kthyer nga Bashkimi Sovjetik në Zvicër, Gygaksit i bëra një raport të gjatë. Në të, ndër të tjera, shkrova: “Është e kotë që në Rusi të synohen projekte që kanë të bëjnë me anije kozmike dhe

motorë për avionë. Duhet të drejtohem drejt iniciativave që kanë të bëjnë me projektimin dhe ndërtimin e kapaciteteve për prodhime, për të cilat ndihet nevojë e vërtetë. Këto nevoja nuk lidhen direkt me strukturat shtetërore, por me njerëzit e thjeshtë. Mjafton t'u hedhësh një sy rafteve bosh të GUM-it, magazinës shtetërore në Sheshin e Kuq, për të kuptuar se për çfarë ka nevojë ai treg. Besoj se ndër të parët sektorë fitimprurës është ai i teknologjisë së prodhimit të tekstilit...”

Gygaksi e lexoi raportin tim dhe duket se u mendua më gjatë se zakonisht. Por unë nuk kisha kohë të pritja, deri sa ai të nxirrte përfundimet e tij rreth ideve dhe projektit tim. Pa humbur kohë, unë u ktheva sërish në Rusi. *Technoproimport* ishte ndërmarrja shtetërore, e cila merrej me këtë degë të industrisë së lehtë, pra të prodhimit të tekstilit. Kisha vërejtur se, me hapjen e Bashkimit Sovjetik ishin bërë disa përparime, sidomos në fushën sociale, edhe në, njësoj sikurse në vendet e tjera të Europës Lindore.

Gorbaçovi po mendohej të gjente mënyrën e përshtatshme për të bërë reforma, të cilat, edhe përkundër suksesit relativ, megjithatë kishin efekte minimale në jetën e përditshme të njerëzve. Sido që të ishte, disa nevoja të popullsisë duhej të përmbusheshin. Nga ana tjetër, Gygaksi nuk ishte shumë i sigurt se, pa ndodhur ndonjë përmbysje e madhe, do të ishte e mundur të bëheshin ndryshime substanciale në Bashkimin Sovjetik. Megjithatë, nuk më kundërshtoi. “Provoje, po deshe,” më tha. “Po je kah rrezikon të bësh një vrimë në ujë...”

Pra, nuk ishte shumë inkurajues, por as unë nuk kërkoja më shumë prej tij. Ai nuk e njihte mentalitetin rus dhe as kërkesat reale dhe mundësitë pa fund të atij tregu të jashtëzakonshëm të konsumit të gjerë.

Duke mos i përfillur dilemat e punëdhënësit tim, kalova në fazën e dytë të projektit tim: duhej të gjeja një sistem prodhimi të përshtatshëm për kërkesat e atij tregu. Nisa kontaktet me prodhuesit e makinerive në vendet perëndimore, për të parë se çfarë novacionesh mund të futnin në teknologji, sa për fillim, në mënyrë që të aktivizohej një prodhim i suksesshëm dhe kostoja të ishte sa më e ulët. Vizitova disa firma të njohura të prodhimit të tekstilit, llojin e stofrave, endjen

e tyre, ngjyrat e kështu me radhë. Studiova me kujdes çdo gjë që kishte të bënte me këto stofra, veçmas mënyrën e shndërrimit të tyre në veshje elegante, përmes modeleve bashkëkohore. Shënoja dhe fotografoja të gjitha fazat e prodhimit, posaçërisht makinerinë që mundësonte prodhimin e tillë. Studiova edhe variacionet e ndërhyrjeve që mund të bëheshin në këto makineri.

Faza e radhës e projektit tim ishte më e vështira – bindja e autoriteteve ruse. Problemi qëndronte te mjetet e prodhimit, që mungonin tërësisht. Nuk kishte as lëndë të parë, as linja të konsoliduara të prodhimit. Megjithatë, kur u ktheva nga Spanja me dizajnët, shënimet dhe fotografitë, para se të nisesha për në Moskë, isha i bindur pothuajse njëqind për qind, se kisha në dorë çelësin e suksesit. Të gjithë në firmë, përfshirë edhe pronarin, më morën për të çmendur. Vetë Gygaksi u bë shpërfillës:

“Si, mendon se kjo do të funksionojë te rusët?!”, u shpreh ai.

Pashë edhe një ftohtësi në sytë e tij, që më bëri përshtypje më shumë se synimi për ta hedhur poshtë projektin tim. Ajo ftohtësi më duket se i shoqëroi marrëdhëniet tona deri në ndarjen përfundimtare. “Çfarë do të tregosh me këtë”, vazhdoi Gygaksi. “Duket se nuk ke kuptuar asgjë nga mentaliteti dhe psikologjia ruse. Aq më pak e ke kuptuar tregun rus dhe rregullat e lojës në atë pjesë të botës. Pse, ti mendon se autoritetet ruse do të nënshkruajnë me ty kontratat milionëshe, vetëm për t’i parë njerëzit të shëtisin rrugëve me veshje elegante...?!”

Në njëfarë dore, unë e kuptoja shqetësimin e Maks Gygaksit, sepse operacioni ishte i shtrenjtë dhe vinte në rrezik firmën. Megjithatë, unë insistova në timen dhe i kërkova shefit tim të më vinte në dispozicion një inxhinier. Ai e miratoi këtë dhe në Fabrikën *Diplomat* të Tiçinos gjeta inxhinierin që më duhej. U ktheva në Madrid dhe, bashkë me *Investronika*-n filluam të punonim mbi një sërë projektesh. Krijua pjesët e para të linjave prodhuese. Krejt eksperiencia në teknologjinë e konfeksionimit duhej të sintonizohej me arritjet e shekullit, me IT (Teknologjinë Informatike). Do të thotë futja e Informatikës në proceset e prodhimit dhe kontrollit që kishte qëllimin e rritjes së efektshmërisë, automatizimit të proceseve dhe të kontrollit më të mirë. Këtu bëhej fjalë për automatizimin e plotë

të vijave prodhuese – fenomen i parë i aplikuar në prodhimtaritë e këtij lloji (e konfeksioneve). Shikua fillim e fund të gjitha fazat e prodhimit: marrjen e stofit, magazinimin e tij, ndarjen e llojeve të ndryshme të endjes (pëlhurë, lino, pambuk, lesh), bëmë ndarjet sipas ngjyrave, transportin deri te prerja, programimin elektronik të modelimit, prerjen automatike, qepjen me transport automatik, hekurosjen, ambalazhimin dhe ndarjen nëpër seri, para shpërndarjes në treg. Të gjitha këto do të viheshin në veprim, duke u mbështetur në një sistem kompjuterik. Kjo ishte ide fikse imja dhe do të përdorej për herë të parë në proceset e këtilla.

Tani isha gati të nisesha për Moskë. Me vete mora edhe raportin, të cilin tashmë e kisha përgatitur mbi gjendjen në industrinë e tekstilit në Bashkimin Sovjetik. Në raport kisha shkruar se njëfarë ngritjeje teknologjike ekziston në këtë shtet, por nuk e kisha saktësuar deri në cilën shkallë. E vërteta ishte se unë qëllimisht kisha lënë pa e thënë se linjat ekzistuese ishin aq të vjetra, sa mund të hidheshin në plehra, nga e para deri tek e fundit. Por kisha llogaritur se përballë meje, në çastin kur të paraqitja projektin, mund të gjendeshin pikërisht ata që i kishin porositur linjat e tilla të prodhimit dhe kjo mund të krijonte situatë të pakëndshme. Prandaj, isha kujdesur që të mos merresha shumë me përshkrimin e gjendjes, sa me ofertën time.

Ishte verë dhe bënte vapë e madhe ditën që mora avionin për në Moskë. Me vete kisha një valixhe të mbushur me shkresurina dhe vizatime. Unë isha i bindur se kisha bërë gjënë më të mirë të mundshme, por asgjë nuk kisha të sigurt. Pala sovjetike, megjithëqë çdo gjë ishte përshtatur me mundësitë dhe kërkesat e tyre, mund ta refuzonte projektin. Mund të thoshte, thjeshtë: nuk e duam! Ose ta pranonte idenë time fillestare, por realizimin t'ia besonte dikujt tjetër. Të gjitha ishin të mundshme. Aq më parë, kur unë nuk kisha të caktuar asnjë agjendë dhe nuk dija nëse do të gjeja qoftë edhe një person të vetëm, që do të pranonte t'ia shpalosja projektin tim.

Mora kurajë dhe u paraqita në portinerinë e *Technoproimport-it*, entit shtetëror për importin e makinerive. Mund të quhesha njeri me fat, që nuk më përzuri askush. Aty arrita të flisja me zonjën Levlikova, sekretare e dikujt në atë institucion, të cilës ia dorëzova një zarf të madh, duke i thënë:

“Do t’ju isha mirënjohës nëse do t’ia dorëzonit projektin tim ndonjërit prej specialistëve, në mënyrë që ta lexojë atë dhe t’ua transmetojë atë industrive të tekstilit në Bashkimin Sovjetik.” Përpiqesha të isha sa më elokuent dhe sa më i sjellshëm me zonjën Levlikova. Asistentja më shikoi pak e habitur, veçmas kur më pa të nxirrja edhe shumë kopje të tjera të projektit. Që të mos ketë nevojë për fotokopjim, i thashë asaj, në mënyrë që titullarët e *Technoproimport-it* të mos humbin kohë me cikërrime të tilla. Sekretarja nisi të qeshte. Pastaj më dha një përgjigje tipike për një burokrate sovjetike:

“Këtu nuk punohet me ide”, më thotë ajo, “por duke ndjekur urdhrat e shtetit.”

Nuk ishte punë e lehtë ta bindje zonjën Levlikova që, së paku, të pranonte t’i merrte në dorëzim gjithë ato dosje. Më në fund, ajo u bind.

“Si quhet drejtori juaj?”, e pyes zonjën Levlikova.

“Është zoti Chastij”, më tha ajo nën zë, thuase zbulonte ndonjë sekret të madh.

“Është këtu në Moskë zoti Chastij”, këmbënguli unë, “apo është diku me pushime?”

“Është në Moskë”, m’u përgjigj ajo nga ana tjetër e sportelit.

U ktheva në hotel, në telefon formoj numrin 09, centralin, dhe më pas pyes për numrin e telefonit të z. Chastij. Ma dhanë numrin e shtëpisë. E solla numrin dhe u bëra kurajoz, duke e përgatitur veten të merrja çfarëdo përgjigje, veçmas në këtë kontakt të parë përmes telefonit. Mjaftonte që Chastij mos të ma mbyllte telefonin. U përgjigj një zë mashkulli.

“Mirëmbrema!”, i them unë. “Flas me zotin Chastij?”

“Po, unë jam”, më thotë zëri matanë telefonit. “Kush jeni ju?”

“Më falni që ju shqetësoj në shtëpi, në këtë orë të vonë. Quhem Pacolli, Behgjet Pacolli. Dje isha te zyrat tuaja te *Technoproimport...* Kisha frikë se Chastij do të ma mbyllte telefonin, pa më dhënë mundësi të shpjegohesha. Në Bashkimin Sovjetik telefonat e të gjithë funksionarëve të lartë të shtetit mbaheshin nën kontroll dhe të gjitha bisedat regjistroheshin nga KGB-ja. Duhej kurajë jo vetëm nga ana ime, për ta marrë në telefonin e shtëpisë, por edhe nga ana e

atij tjetrit për të më dëgjuar. Më tej unë vazhdova:

“E di që nuk duhet t’ju shqetësoj në shtëpi, por ju lutem, më dëgjoni...”

“Por ju...”, kërkon të më ndërpresë Chastij.

“Dëgjomëni, ju lutem!”, vazhdova. “Në zyrat tuaja kam sjellë një ide kolosale. Do të doja të transmetohej në fabrikat tuaja, gjithashtu...” Pikërisht këtu e mbylli telefonin zoti Chastij, pa thënë asnjë fjalë më shumë. Atë natë e kalova pa vënë gjumë në sy. Nuk e dija nëse kisha bërë mirë ose keq që i kisha telefonuar zotit Chastij. Ndoshta ai e kishte marrë për keq telefonatën time.

Nuk mund të isha i qetë, sepse në këtë projekt kisha investuar shumë mund dhe, aq më parë, kisha vënë në sprovë shumëçka, që kishte të bënte me punën time. Nëse dështoja, kjo ishte një shenjë e keqe. Në një rast të tillë, duhej ta pranoja, se analizat e mia të tregut ruso-sovjetik nuk kishin qenë të sakta. Dështimi eventual, për mua, do të kishte edhe implikime të tjera tepër të mëdha. Pozicioni im në *Interplastica* do të vështirësohej shumë.

U ktheva në Zvicër po me këto dilema dhe po aq i tendosur. Gygaksit nuk i thashë gjë, madje përpiqesha t’i shmangesha ndonjë pyetjeje a interesimi të tij për këtë çështje. Pothuajse tërë ditën e kalova në zyrën e telefaxit, në pritje të ndonjë përgjigjeje nga Moska. Ai aparat i zi, në një qoshe të tavolinës së zyrës, herë më ngjante si një përbindësh i vogël, herë si diçka magjike, nga i cili do të shfaqej një mrekulli.

Së fundi, nga zgori i atij aparati shfaqet një letër, në cepin e epërm të së cilës ishte shkruar: “Për zotin Behgjet Pacolli” dhe më tej: “Mbështetur në projektin e dorëzuar në zyrat tona, ju ftojme për bisedime me një nga drejtuesit tanë të fabrikës *“Severianka”* të Novosibirskut. Në pamundësi për t’ju pritur në Moskë, takimi do të mbahet në Sokolniki, pranë zyrave të industrisë lokale”. Letra mbante firmën e *Technoproimport-it*.

Ky teleks për mua ishte i rëndësishëm, sepse sillte dy mesazhe të njëkohshme: e para, Chastij e kishte lexuar projektin tim, ose dikush tjetër e kishte njoftuar me përmbajtjen e tij; dhe, e dyta, kopjet e projektit tim i kishte dërguar në fabrikat e tekstilit. Njëra nga këto fabrika, ajo e Novosibirskut, donte të ballafaqohej me mua për punë



argumentimi.

U nisa përsëri për në Bashkimin Sovjetik, (vjeshtë 1985), kësaj radhe më entuziast dhe më i vendosur që krejt këtë situatë ta ktheja në favor të projektit tim. Në Sokolniki, në një zyrë të madhe gjej të ulur nja pesëmbëdhjetë veta, me të cilët duhej të përballesh i vetëm. Në mes ishte ulur përfaqësuesi i *Technoproimport*, zoti Kutuzov. Nuk kam për ta harruar kurrë këtë emër dhe as fytyrën e tij. Kur flisja, atij duhej t'i drejtohesha dhe më duhej ta bindja pikërisht atë.

Fola plot gjashtë orë pa u ndalur, me përjashtim të një pauze të shkurtër për çaj e pije freskuese. Të gjithë më dëgjonin me vëmendje. Nuk thanë asnjë fjalë, nuk më bënë asnjë pyetje. Unë vazhdova të demonstroja se si duhej të dukej një industri moderne e tekstilit. Ilustroja idetë e mia, shpjegoja gjerë e gjatë, nga çanta nxirrja pa ndërprerë raporte dhe analiza. Ata mbanin shënim në heshtje. Më inkurajonte fakti se dukeshin të interesuar për sa shpjegoja unë. Ishin të gjithë të përqendruar dhe dukej sikur gjithçka shkonte mirë. Por askush nuk bënte asnjë pyetje, kështu që unë, si në një orë mësimi të oratorisë, vetë pyetja dhe vetë përgjigjesha. Dikur m'u shterën fuqitë. Në fund, mbaj mend se u thashë: "Ju faleminderit dhe mirupafshim".

Po të më pyeste njeri, si kishte kaluar takimi, nuk do të isha në gjendje të thosha asgjë. Fyti më digjte, këmbët më ishin fryrë. Përgjatë gjithë rrugës së kthimit për në Moskë, fërkoja kaviljen që më ishte enjtur dhe nxirë. U vendosa në hotel dhe aty prita një ditë. Qëndrova në pritje 24 orë rresht, pranë telefonit të dhomës. Por telefoni nuk cingërroi asnjëherë. Nuk lëviza fare nga dhoma, sepse po të ndodhte të më kërkonin, nuk do të merrej vesh se kush më kishte kërkuar. Më pastaj u ktheva në Zvicër. Kësaj radhe nuk u ngula në zyrën e teleksit si herën e parë. Kujtimi i vetëm i asaj dite që po largohesha pak nga pak, ishte këmba që vazhdonte të më dhembte. Dilemat e mia vazhdonin: a thua kisha qenë bindës? Mos kisha bërë ndonjë gabim? Sa më shumë që kalonin ditët, dyshimet shtoheshin.

Pas një jave vjen një tjetër lajm. Në *Interplastica* mbërrin një teleks i firmosur nga vetë Chastij. Ishte caktuar një takim tjetër, kësaj radhe në Moskë, në fabrikën Raduga. U nisa, por jo me aq vrull si herën e parë, sepse edhe këmbën e kisha të ënjtur e nuk më linte

rehat. Nëse herën e parë fola plot gjashtë orë, kësaj here dy ditë rresht. E shpjegova prapë projektin tim, nga fillimi deri në fund. U përpoqa të isha sa më bindës.

Kësaj radhe para meje kisha dy përfaqësues të *Technoproimport-it*. Më i rëndësishmi prej tyre quhej Sasha Romanciev. Ditën e parë fola për orë të tëra pa u ndalur, derisa desh më zuri gjumi. Romanciev e kuptoi lodhjen time dhe propozoi që biseda të vazhdonte të nesërmen. Ndërkohë, vena e këmbës më ishte fryrë, gati sa nuk pëlciste. Që atëherë kjo venë e këmbës më ka mbetur me “behane”. Ditën tjetër ndodhi si në rastin pararendës: nuk kuptova fare se ç’përshtypje u kisha lënë. Historia përsëritet: tension, pasiguri, pritje, asnjë telefonatë, kthimi në Zvicër. Ndërkohë, telashet e mia nuk vinin vetëm nga Rusia. Një “front” kundër meje ishte hapur edhe brenda *Interplastica*-s. Kishte muaj që pothuajse të gjithë ishin në dijeni të “aventurës” sime. Kishte edhe nga ata që kishin shkuar te Gygaksi dhe ishin gati të më hapnin gropën. Kishte edhe nga ata që talleshin me mua haptazi. Por unë bëja sikur nuk vëreja asgjë dhe vazhdoja me timen.

Në fund të nëntorit të vitit 1986 mbërrin një tjetër teleks, me një ftesë tjetër: “Zoti Pacolli, a dëshironi të vini direkt në Kiev, në Ukrainë, pranë fabrikës sonë ‘Junost?’” Fluturova nga gëzimi, sepse kësaj radhe përmbajtja e ftesës ishte ndryshe. Mund të takohesha direkt me klientin, pa ndërhyrjen e përfaqësuesve të *Technoproimport-it*. Kjo do të thoshte se në dy takimet e para i kisha marrë të gjitha pikat e mundshme, se përfaqësuesit e firmës shtetërore kishin dhënë vlerësimin pozitiv dhe se tani kishin autorizuar një fabrikë të kontaktonte direkt me mua. Për rrethanat e atëhershme të Rusisë, kjo nuk do të thoshte pak. Kisha fituar besimin e qendrës.

Kur arrita në Kiev, më priti një befasi tjetër e këndshme: në takimin e organizuar, merrnin pjesë pesëmbëdhjetë kolosët e ndërmarrjeve të të gjithë Ukrainës. Kjo tregonte se punët po shkonin në drejtimin e duhur dhe se mua nuk më mbetej tjetër, pos që edhe një herë ta akumuluoja gjithë energjinë dhe të bëhesha sa më bindës, duke përdorur krejt arsenalin e argumentimit tim. Takimi zgjati tri ditë. Më binte në sy fakti se askush nga të Moskës nuk ishte ftuar, që donte të thoshte se ata nuk ishin shfaqur më si dirigjues të procesit. Ky ishte sinjal i mirë.

Tri ditë punë të vazhdueshme, të ndërprera për ndonjë pauzë për të ngrënë e për të fjetur paksa. Këtu ishte pak më ndryshe, sepse mjedisi i krijuar ishte pak më i ngrohtë. Duke mos pasur ndonjë kontroll apo kushtëzim nga lart, takimi u kthye në një bashkëbisedim të vërtetë. U bënë pyetje nga më të ndryshmet dhe unë u përpoqa të jap përgjigje në të gjitha çështjet që u interesonin, duke u futur më thellë në probleme. Kjo ndodhi, kur u bindën se mund të kishin besim te unë. Atëherë, ata filluan të flisnin hapur, për çdo gjë, për problemet me të cilat përballeshin, për mënyrën e prodhimit që i kishte ikur koha, për palevërdishmërinë ekonomike të sistemit të tyre, për mospërshtatshmërinë e produkteve me kërkesat e tregut, për deficitin e tmerrshëm që sa vinte e rritej, duke qenë se kostoja e prodhimit ishte shumë më e lartë se çmimi i shitjes.

U ktheva përsëri në Zvicër. Dukej sikur ecejaket e mia nuk kishin ndonjë kuptim. Sepse, në dukje të parë nuk kishte asgjë. Asnjë lajm. Shqetësimi im ishte i natyrshëm, por jo i tillë sa të mjegulloheshin gjërat. Përpiqesha të bëhesha njeri racional, sepse unë tashmë e njihja në esencë sistemin sovjetik të vendimmarrjes, që ngjante me një mamuth kolosal burokratik, të cilin ishte shumë e vështirë ta vije në lëvizje. Procedurat e tyre ishin ndryshe nga çdo vend tjetër i botës, të komplikuar dhe të kontrolluara deri në absurditet.

Përveç kësaj, gjigantit sovjetik sikur kishte filluar t'i luhatej trualli nën këmbë, kështu që procedurave të vjetra të vendimmarrjes duhej t'u shtojte edhe neglizhencën, përtacinë, papërgjegjësinë. Pra, një përgjigje e prerë në ofertën time, për rrethanat e krijuara ishte e komplikuar dhe kërkonte kohë, madje më shumë se ç'mund të pandehte dikush.

Megjithatë, duheshin respektuar afatet e tyre dhe rregullat e tyre të punës, njësoj si edhe ritmin tepër të ngadaltë, për mentalitetin tonë. Të bëheshe i paduruar në këtë rrethanë, ishte e sigurt se nuk do të arrije askund, sikundër që nuk mund të kërkoje, që asaj pjese të botës t'i imponoje një logjikë pune dhe sjelljeje, e cila atëbotë nuk ishte në harmoni me mentalitetin evropian. Ishte mentaliteti i tyre. Ishte mënyra e tyre e sjelljes. Ishte bota e tyre, e cila kërkonte që të ndryshonte, jo me imponime dhe kthesa të shpejta, por duke i tërhequr ngadalë në një logjikë tjetër të ekonomizimit dhe të prodhimit.

Tregu i lirë ishte një mrekulli, që ata ende nuk e kishin shijuar. Dikush nuk e njihte, dikush i frikësohej, dikush tjetër i rrinte larg, sepse e konsideronte të rrezikshëm për sistemin. Pra, ishte një situatë, të cilën, nëse pretendojë ta ndryshojë pak nga pak, duhej ta kuptojë dhe të sillte me takt. Ndryshe rrezikojë përjashtimin.

Kësaj radhe teleksi i firmës *Interplastica* nuk mori përgjigje nga Moska. Kaluan shumë ditë dhe, krahasuar me herët e tjera, heshtja ishte më e gjatë. Bëja sikur isha indiferent ndaj kësaj situatë dhe, bashkë me inxhinierin dhe skuadrën e teknikëve, vazhdoja përmirësimet për realizimin final të projektit. Mbas tri javësh, si papritmas, vjen një ftesë tjetër, kësaj radhe nga Lvovi, qytet i Ukrainës që ndodhet në kufi me Poloninë. Historia përsëritet, por ajo që më bie në sy tani, ishte pritja shumë më e mirë. Edhe kureshtja ishte shtuar. Supozoja se kjo kishte ndodhur, ngase në të gjitha fabrikat e tekstilit ishin përhapur zëra për ofertën time, për komunikimin e sinqertë dhe elaborimin e detajuar.

Pastaj, përse të mos e them: unë tashmë flisja rusisht, një rusishte të pastër dhe të rrjedhshme. Rusëve nuk mund të mos u bënte përshtypje ky fakt. Kjo nuk kishte të bënte vetëm me lehtësinë e komunikimit, por edhe me besimin. Madje, me besimin në radhë të parë. Unë e vëreja se, kur flisja me përkthyesin, atmosfera dukej më e ftohtë dhe njerëzit më indiferentë. E them këtë si një përvojë që duhet bartur te menaxherët e rinj, të cilët është e nevojshme të kuptojnë se mënyra e komunikimit, përfshirë edhe njohjen e gjuhëve, përbën njëri nga fshehtësitë e suksesit.

Me sovjetikët unë arrita te kjo përvojë: ata ishin skeptikë ndaj meje, derisa nuk e kuptuan se unë vërtet besoja në atë që thosha dhe se ligjëratat e mia gjatë prezantimit të projektit nuk ishin gënjeshtër. Ata vazhduan të ishin pjesërisht skeptikë, derisa nuk arrita t'ua them në gjuhën e tyre dhe t'i bind se përpara kishin një shans historik, të cilin nuk duhej ta humbnin. Para bashkëbiseduesve të mi, unë u paraqita i sinqertë. U thashë pa asnjë ekuivok se *Interplastica* dhe unë kishim përfitimin tonë, por përfituesit më të mëdhenj do të ishin ata, sepse e kishin shansin të futeshin në procesin e begatisë teknologjike, përpara se të ishte tepër vonë.

Thënë shkurt, për një moment e braktisa rolin tim të shitësit të

makinerive dhe e përvetësova rolin e një lideri, një lloj prijësi, i cili, duke argumentuar me fakte dhe duke arsyetuar në mënyrë racionale; braktisa terminologjinë teknike dhe futa në përdorim parametra të tjerë socialë dhe botëkuptimorë, përfshirë edhe emocionet. Unë nuk flisja për politikë, së paku jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por prekja sedrën e atyre njerëzve shpresëhumbur. Unë isha aty për t'u thënë se nuk kishte marrë fund çdo gjë, se ekzistonte mundësia të përmirësoheshin gjërat, duke filluar nga fabrikat e tyre, nga përgjegjësia e tyre profesionale.

Dhe kështu, nuk mbeti pothuajse asnjë vend ku kishte një qendër të industrisë së tekstilit në Bashkimin Sovjetik, ku nuk u ftova për bisedime të gjata. Kisha përshtypjen se arsyetimi i projektit tim tashmë ishte bërë një pretekst, ndërsa prapa kësaj qëndronte dëshira e njerëzve për të dëgjuar dikë që i fton të dalin nga letargjia dhe nga rruga pa krye. Ata donin të shpresonin dhe unë ua thosha me bindje të plotë se shpresat e tyre mund të bëheshin realitet, se koha e humbur mund të kompensohej, mjaftonte që ata ta kapnin sensin e nevojave të reja që sillte koha dhe realiteti i ri.

Thënë troç, isha bërë një lloj ambasadori, që sillja ide, projekte, dizajnime, arsyetime, shpresa. Kjo nuk kishte të bënte vetëm me industrinë e tekstilit. Kishte të bënte me vetë nevojën e tyre për të pranuar ndryshimet dhe për të ecur përpara. Perestrojka në shumë pika ishte koncept abstrakt. Në fjalët që u thosha unë, ajo merrte kuptim krejt tokësor dhe të akceptueshëm për njeriun e zakonshëm. Pas Lvovit, mbërriti një tjetër ftesë, e cila nuk kishte të bënte me mbledhje e takime, çfarë kisha bërë deri atëherë, por për të vizituar dhjetë fabrika të tekstilit, të shpërndara në tërë Bashkimin Sovjetik: në Dnepropetrovsk, Cercassi, Odesa, Belzi, Kutaisi, Voronezh, Erevan, Samarkanda, Ufa, Neftekamsk. Sapo isha kthyer nga një turne në Ukrainë, Uzbekistan e Armeni dhe para Krishtlindjeve të vitit 1986 duhej të shkoja në lokalitetet e Vladimirit, Ivanovit, Leningradit, Alitusit, Rigës dhe Vilnosit.

Kishin kaluar vite që kur kisha filluar të punoja në këtë projekt, por u desh të vinte pranvera e vitit 1987 që rezultatet të bëheshin të prekshme. Kësaj radhe udhëtimi që ishte aranzhuar nga *Technoproimport-i* kishte të bënte me një destinacion të largët – në

qytetin Novosibirsk, ku bënte ende ftohtë. Edhe pse ishte pranverë, ndodhte që temperaturat e natës arrinin deri në -20 gradë celsius. Nga Moska ora zyrtare kishte katër orë diferencë.

Vetë udhëtimi në Siberi është një aventurë më vete. Gjatë udhëtimit me avion, të duket sikur toka për pak do të rrëshqasë mënjanë dhe ti do të mbetesh pezull në gjithësi. Ndërkaq, sapo zbret në aeroport, sheh se njerëzit janë një antipod i asaj bote të ftohtë. Kanë një ngrohtësi të brendshme dhe një joshje të përnjëhershme për mirëkuptim dhe miqësi.

Pas një takimi me drejtuesit e njërës prej fabrikave më të mëdha të tekstilit, “Severianka”, m'u kërkua të vizitoja linjën e tyre të prodhimit, e cila, sipas fjalëve të drejtuesve, kishte nevojë të rikonstruktohej. Pa hezitar, u bëra një kontroll makinave dhe fola me përgjegjësit e prodhimit. Pas vizitës, drejtori i fabrikës më pyeti:

“A do të ishit në gjendje ta rikonstruktioni fabrikën tonë?”


“Gjithsesi”, i them. “Jo vetëm kaq, por jam në gjendje që tani t'ua vizitohet gjithë strukturën e fabrikës së re që mund të ndërtohet, deri në hollësinë më të vogël.”

Drejtori pohoi me kokë, ndërkohë që kërkoi të shihte fabrikën e re të dizajnuar në tërësi, që nga salloni në hyrje e deri te zhyshoret e punëtorëve; që nga zyrat e administratës deri te vendi i prodhimit; që nga magazinat e deri te parkingu ku bëhej ngarkimi i prodhimit. U ktheva në Zvicër dhe për dhjetë ditë çdo gjë e bëra gati.

Sërish mora rrugën për në Siberi. Kësaj radhe kisha me vete një inxhinier, nga më të mirët që njihja unë. Bashkë me të i bëmë një inspektim të fundit fabrikës dhe, me t'u përballur me udhëheqjen e fabrikës, kësaj radhe flas hapur, pa asnjë lloj diplomacie.

“Zotërinj”, u them. “Duhet mënjanuar çdo gjë që keni këtu. Makineritë tuaja nuk bëjnë më. Duhet ta nisim gjithçka nga fillimi. Vetëm kështu mund ta fillojmë punën mbarë dhe nëse veprojmë kështu, unë mund t'ju siguroj se fabrika juaj do të jetë në gjendje të nxjerrë në treg prodhime cilësore, që do të pëlqehen nga konsumatorët.”

Diskutimet teknike vazhduan disa ditë. Në fund, projekti u pranua nga “Severinka”. U nisa për në Moskë, sepse rezultatet e diskutimeve duhej të dorëzoheshin në *Technoproimport*. Në zyrat e



*Fabrika e tekstitit Vesna, në Lvov (Ukrainë), sipas teknologjisë sime, 1989*

këtij enti shtetëror për herë të parë më thonë:

“Zoti Pacolli, mos u largoni. Qëndroni disa ditë këtu.”

Qëndrova në Moskë disa ditë, për të pritur drejtuesit siberianë të fabrikës “Severinka”. Kontrata u përgatit dhe ajo u lexua me kujdes në çdo pikë të saj. Pranë meje ishin Sergio Guadaluppo, përkthyesi dhe sekretarja e *Interplastica-s*, Ljuba Vorobjova. Kontrata kapte vlerën 16 milionë franga zvicerane. Më kujtohet shumë mirë momenti i nënshkrimit të kontratës, gëzimi që ndieja, e mbi të gjitha, padurimi për t’u kthyer në Tiçino, për t’ia treguar Gygaksit atë kontratë të parë. Kontrata ishte kurorëzim i ideve dhe përpjekjeve të mia këmbëngulëse. Nuk më kishte dalë huq dhe për mua ky ishte edhe satisfaksion profesional, edhe moral.

Ajo kontratë parashihte fillimin e menjëhershëm të punimeve, pa pritur ndonjë pagesë të formës së paradhënies. Puna nisi dhe për

gjashtë muaj u arrit që fabrika të vihej në funksion. Ishte e qartë se ajo fabrikë do të ishte test për ne, si do të punonim, sa do të ishim të besueshëm, sa do t'i respektonim detajet e kontratës, e kështu me radhë.

Punimet morën fund në tetor të vitit 1987, kur edhe u bë ceremonia e dorëzimit të fabrikës dhe e vënies në funksion të linjave të prodhimit. Kjo ishte fabrika e parë moderne në Bashkimin Sovjetik, në Rusinë e re. Këtij fakti i jepnin rëndësi edhe autoritetet politike të vendit, përfshirë edhe ministrin e industrisë dhe anëtarët e tjerë të qeverisë.

Për të parë këtë objekt të ndërtuar aq shpejt dhe aq mirë, nuk mbeti udhëheqës i fabrikave të tekstilit që nuk kërkoi ta vizitonte. Vinin nga anë e anës. Shikonin dhe mbeteshin të habitur, veçmas ata që e dinin se si ishte dukur ajo fabrikë përpara rindërtimit. Por edhe të tjerët, sepse midis objekteve industriale në mbarë Bashkimin Sovjetik, tashmë ishte krijuar një simbol i ndryshimit. Çdo gjë ishte e automatizuar dhe e racionalizuar; një teknologji që përdorej për herë të parë jo vetëm në Bashkimin Sovjetik, por edhe në Evropë. Në Bashkimin Sovjetik këtë e quanin “Primat i Pacollit”, gjegjësisht teknologjia e Pacollit. Pak më vonë e kuptova se kjo teknologji është dashur të patentohej e të mbrohej ligjërisht, sepse atje zgjoi interesim të madh dhe shumëkush fliste për të. Mund t’ju them lirisht, të nderuar miq, se kjo është periudha kur mua, tanimë çdokund më njihnin. Çdo javë isha në qendër të vëmendjes së mediave të shkruara dhe vizive ruse, në faqet e para të gazetave autoritative ruse me shumë intervista në ekranet televizive, madje edhe në *prime time*. Krenaria ime ishte e ligjshme, për dy arsye kryesore. E para, që idetë e mia kishin funksionuar dhe ishin kurorëzuar me një sukses të padiskutueshëm. E dyta, koha e shkurtër e rindërtimit në një vend ku gjërat lëviznin tepër ngadalë, kishte ndryshuar konceptet e deriatëhershme të ngurta dhe burokratike, se për t’i hapur rrugë të resë, duhej të kalonte shumë kohë dhe një pritje e gjatë.

Unë kisha dëshmuar se ndryshimet mund të ndodhnin më shpejt, se ato, përveç se ndërronin botëkuptimin e njerëzve, krijonin edhe efekte të drejtpërdrejta në jetën e tyre. Vetëm po t’i merrje kushtet e punës të punëtorëve të fabrikës, krahasuar me gjendjen



e mëparshme, e shihje se ndryshimi ishte thelbësor. Në anën tjetër, një masë njerëzish, që ishte kredhur në dëshpërim dhe apati, tani kishte përpara një simbol të së nesërme, të ardhmërisë më të mirë. Sigurisht nevojiteshin shumë simbole të ngjashme, por edhe veshja, mënyra e prodhimit të tyre, nuk ishin pa rëndësi. Pra, efekti nuk ishte vetëm ekonomik (nuk ishte vetëm një objekt industrial i rindërtuar, nuk ishte vetëm një fabrikë e tekstilit e ribërë për pak muaj), por ishte edhe psikologjik.

Po në atë kohë më lindi ideja e organizimit të një sfilate mode në Novosibirsk, e cila kujtohet edhe sot e kësaj dite. Merrej vesh se vajzat e bukura të Siberisë ende nuk mund të defilonin me fustanet e qepur në fabrikën *Severinka*, por ato shkova dhe i mora në Zvicër. Pse e bëra këtë? Për mua ishte me rëndësi që, bashkë me rindërtimin e fabrikave, të sillja te njerëzit e atjeshëm frymën e re të ndryshimit. Njerëzit duhej të besonin se një investim i ri, një fabrikë e re, sillte me vete edhe disa ndryshime esenciale në jetën e tyre, në konceptet e tyre. Diçka që ata nuk kishin mundur ta merrnin me mend, që Perestrojka vetëm sa ua kishte sinjalizuar në mënyrë të përgjithësuar, teoritikisht, tani ndodhte në rrafshin e jetës reale të tyre. Vendi i tyre, atdheu i tyre, nuk ishte më armiku i tyre më i madh. Ata mund të kishin besim se ai vend mund të fillonte të bëhej. Prandaj edhe mbështetja politike për projektet e mia nuk mungoi.

Në harkun kohor prej tre muajsh, nga tetori deri në fund të dhjetorit të vitit 1987, shkova edhe nëntëmbëdhjetë herë të tjera në Moskë, kryesisht për të nënshkruar kontrata të reja, të cilat filluan të vinin njëra pas tjetrës. Listën e tyre e mbaj mend edhe sot e kësaj dite, sepse tashmë ishin bërë pjesë jo vetëm e suksesit tim, por edhe e jetës sime: *Kutaisi* në Gjeorgji, *Samarkanda* në Uzbekistan, *Raduga* në Moskë, *Bolsheviçka* në Shën Petërburg, *Vesna* në Lvov - Ukrainë, *Ukraina* në Kiev, *Yunost* gjithashtu në Kiev, *Cercasi* në Ukrainë, *Dnjepropetrovsk* në Ukrainë, *Nikolajev* në Ukrainë, *Krivoirog* në Ukrainë, *Odesa* në Ukrainë, *Erevan* në Armeni, *Voronesh* në Rusi, *Nefteompsk* në Rusi, *Novojavorovsk* afër Lvovit, gjithashtu në Ukrainë. Për të gjitha këto fabrika, çelësat u dhanë në dorë, të gatshme për të nisur prodhimin. Përveç atyre të Erevanit dhe Leninkanit, të cilat u shkatërruan nga një tërmet i fuqishëm që goditi Armeninë,



*Me Maksin dhe Sonja Gygaksin, 1985*

duke lënë prapa mijëra të vdekur, të tjerat janë edhe sot e kësaj dite. Prodhimet e këtyre fabrikave janë nga më cilësoret dhe mbulojnë tregun e gjerë të të gjitha vendeve të ish-Bashkimit Sovjetik dhe Evropës.

Vlera e kontratave për rindërtimin e këtyre fabrikave arriti shumë prej 270 milionë frangash zvicerane. Me të firmosur kontratën e dhjetë në Ukrainë, vendosa që atyre t'u

bëja një dhuratë: një miniklinikë stomatologjike moderne, me të gjitha pajisjet e nevojshme. Në shenjë respekti për këtë dhuratë të vlefshme dhe të pëlqyer nga të gjithë, autoritetet e vendit vendosën që asaj klinike t'i vinin emrin e vajzës sime të madhe "Arbëresha". Këtë emër ajo klinikë që gjendet në Dnjepropetrovsk vazhdon ta mbajë edhe sot e kësaj dite.

Te njerëzit mund të krijohet bindja, gjithsesi e paqëndrueshme, se unë kisha gjetur çelësin e suksesit vetëm në ish-Bashkimin Sovjetik, se atje kisha kapur "trenin e përshtatshëm", se isha kapur në papafingon e tij dhe tani bëja rrugën i patrazuar, ndërkohë që në tregjet e tjera nuk kisha ndonjë sukses të dukshëm. Kjo nuk është e vërtetë. Jo pse unë dua ta paraqes gjendjen ndryshe dhe jo pse u bashkohem prirjeve për ta nënçmuar një treg nga më të mëdhenjtë në botë. Hyrja në tregun e ish-Bashkimit Sovjetik dhe më pastaj të Ruisë më ka marrë shumë vjet punë dhe një potencial të brendshëm jashtëzakonisht të madh. Asgjë nuk ka qenë e rastësishme. Madje, mund të them me bindje të plotë se munda i investuar për të depërtuar në këtë treg ka qenë përpjesëtimisht shumë më i madh se çdo



*Me Gygaksin dhe Çengjan gjatë nënshkrimit të një kontrate, 1987, një nga momentet e sukseshme të mia.*

mund që do të derdhej për të hyrë në ndonjë treg tjetër. Ishte kohë shumë e vështirë dhe situatë e trazuar, në radhë të parë politike dhe sociale. Të hysh në një treg, ku nuk ka qëndrueshmëri politike dhe ku rrethanat sociale janë kërcënuese, është baraz me një aventurë. Shumicën e vështirësive i kam tejkaluar me përkushtim profesional dhe vendosmëri, përfshirë këtu edhe sensin e hulumtimit, njohjes dhe kanuneve morale, që mbështeten fuqimisht mbi vlerat njerëzore. Po mbi këto parime jam mbështetur edhe gjatë punës në tregje dhe hapësira të tjera, krejt të pangjashme me atë të Rusisë ose ish-Bashkimit Sovjetik. Kam ditur të punoj nga 24 orë në ditë. Sot më gjeje në Gana, ditën e nesërme në Japoni. Nisesha në të gdhirë për Mauritani, pas dreke isha në Benin. Sa arrija në Afrikë, prenotoja korridorin për në brigjet e Mesdheut. Mbërrija në mesditë në Tiranë dhe po atë ditë nisesha drejt netëve polare të Siberisë. Në mëngjes në Prishtinë, në darkë gjendesha në Stamboll. Në mbrëmje

gjendesha në Bagdad, të nesërmen në Madrid. Një fabrikë shumë e njohur e përpunimit të pambukut në Nigeri, më e fuqishmja për nga kapacitetet, u pasua nga dy fabrika të plastikës në Bagdad. Po aty, në atë periudhë, u ndërtua edhe një fabrikë speciale e “ageve”, gjilpërave për shiringa të vaksinimit, që ishte njëri nga problemet më të mëdha shëndetësore në Irak dhe më gjerë. Në Turqi bëra mik timin personal ish-kryeministrin dhe Presidentin e mëvonshëm të Turqisë, Turgut Ozalin (ai e quante veten “shqiptar i Selanikut”), për të cilin edhe sot e kësaj dite ushqej respekt të veçantë. Pikërisht në Turqi, për një kohë rekorde ndërtova një impiant gjigant për pastrimin e ujërave, një fabrikë për prodhimin e letrës së plastifikuar dhe disa fabrika të tekstilit. Pra, nuk ishte vetëm Rusia, nuk ishte vetëm Bashkimi Sovjetik...

Ndërkohë, zhvillime të tjera tashmë shiheshin në horizont. Në Kosovë në anën tjetër kisha arritur që në konfeksionin e Gjakovës të instaloja pjesërisht një teknologji të tillë, që ishte e para në ish-Jugosllavi, falë bashkëpunimit që kisha me “Emin Durakun”. Që në kohën e Perestrojkës, në Bashkimin Sovjetik, pata angazhuar shumë specialistë edhe nga Kosova që punonin në instalimin e vijave të automatizuara të konfeksionit, siç ishte Besim Hoxha, Gani Mjekiqi, Ruzhdi Qata, im vëlla, Agimi dhe shumë të tjerë. Këta specialistë ishin shumë të respektuar në atë kohë në Rusi.

Suksesi im me këtë ndërmarrje ishte konfirmim i formimit tim jetësor, këmbënguljes, korrektësisë, formimit profesional, por dhe ndriçimit që të vjen ndonjëherë nga lart në formën e ideve që notojnë mbi kohën që jetojmë.

Unë u ngrita përmbi atë që bëja zakonisht, u thellova në studimin e realitetit që kërkohet të ndryshoja, me një qasje jo thjesht të ndërmarrësit, por të sociologut, apo dhe të politikologut. Kuptova rëndësinë e kohës dhe të hapësirës në këtë ndërmarrje gjigande, në këtë lloj minirevolucioni shoqëror, që zuri fill me ndryshimin rrënjësor të veshjeve të një shoqërie uniformisht të veshur, një shoqërie shumëkombëshe, që duhet të ishte shumëngjyrëshe, por që mjerisht nuk ishte e tillë. Ajo që bëra, nuk pati vetëm vlera ekonomike, biznesore, që duhet të mbroheshin me një patentë për unicitetin e vet, për risitë teknologjike në atë vend, por pati dhe vlera sociale. U

ndikova doemos nga proceset e tjera që po ndodhnin në shoqërinë e atij vendi të madh, por dhashë edhe kontributin tim modest në ato procese. Perestrojkasit kishin nevojë të visheshin mirë dhe unë bëra diçka që me siguri la gjurmë. Për një njeri si unë që vija nga Kosova, që kisha sakrifikuar shumë, që isha mbështetur vetëm te fuqitë e mia kjo ishte diçka e madhe. Ishte afirmim i forcës së individit që nuk do t'ia dijë për kufizimet e origjinës së vet, por që shpreh cilësitë më të mira të kësaj origjine në një sprovë reale suksesi.

## Lindja e Mabetex-it

*Sonja, sekretarja ime që na ndau me Gygaksin, ndarje që çoi në lindjen e Mabetex-it. Pengesat dhe sukseset e para. Jakutski, vendi ku ne ndërnuam bazën për sukseset e ardhshme. Për tre vjet Mabetex-i u bë njëra nga 74 kompanitë më të mëdha në Zvicër. Nuk kishim filluar akoma me Kremlinin.*

**K**ur e shikoj nga kjo distancë, kam përshtypjen se lindjen e Mabetex-it e përshpejtoi pleksja e disa rrethanave pak të pazakonshme, të cilat u krijuan në *Interplastica*.

Unë kisha një asistente që quhej Sonja, një 24 vjeçare ambicioze dhe e zhdërvjelltë. E hetova se Maks Gygaksi, sa herë që bënim udhëtime bashkërisht, interesohej që me ne të vinte edhe Sonja. Pashë se midis tyre lindi një marrëdhënie fillimisht e fshehtë dhe pastaj gjithnjë e më e hapur. Pra, Maks Gygaksi u dashurua në Sonjën dhe vendosi të martohej me të, me gjithë dallimin e madh në moshë. Unë nuk kisha arsye të përzihesha në këtë çështje, por kjo lidhje doemos që m'i krijonte disa shqetësime. Sonja kishte qenë për shumë vjet asistentja dhe vartësja ime, ndërsa tani, me lidhjen martesore me Gygaksin, ajo përnjëherësh bëhej shefja dhe “padronja” ime. Pra, po krijohej një situatë jo shumë e favorshme për mua. Duhej të ruheshja nga mosmarrëveshjet, nga grindjet, pse jo edhe nga çoroditja. Për më tepër që Sonja vazhdonte të punonte ngjitur me zyrën time.

Në përgjithësi isha i bindur se Gygaksi e njihte dhe e vlerësonte kontributin tim në *Interplastica*, sidomos për ato miliona franga fitim që i kisha sjellë firmës. Por, në të vërtetë, gjërat nuk ishin bash ashtu siç i mendoja unë. Gygaksi nuk e mohonte se sukseset e firmës, veçmas ato me Rusinë, ishin fryt i angazhimit tim, por anash sikur nxiste thashetheme se, po të mos kishte qenë mbështetja financiare me kapitalet e tij, unë nuk do të arrija asnjë rezultat. Pacolli ka qenë vetëm zbatues i urdhrave të mia, thoshte ai. Dhe, po të mos kishte qenë kuraja dhe intuita ime, largpamësia dhe guximi im, për të rrezikuar edhe kapitalin tim, shtonte ai, këto kontrata nuk do të ishin

firmosur kurrë.

Kjo nuk ishte vetëm krekosje e tij, ishte në një mënyrë edhe mohim i punës sime, që më lëndonte së tepërmi. Me punën dhe angazhimin tim, *Interplastica* kishte fituar mbi 400 milionë franga. Përveç kësaj, ky sukses sikur e bëri Gygaksin të sigurt dhe disi të pavëmendshëm, sa të deklaronte se fitimet e firmës i krijonin komoditet të ndihej i sigurt ndaj çfarëdo krize ekonomike, apo edhe ndonjë falimentimi eventual.

Në të vërtetë, Maks Gygaksi tashmë kishte rënë pre e kësaj vetëkënaqësie edhe nën ndikimin e djalit të tij, që kishte me gruan e parë, ndërkohë që edhe gruaja e tij e dytë, Sonja dhe i vëllai i saj ia ushqenin këtë delir. Të gjithë këta së bashku ishin futur si pykë përçarëse ndërmjet meje dhe Gygaksit.

Isha i bindur se kishte vetëm një arsye për këtë: ata u trembeshin raporteve tona të afërta dhe marrëdhënieve tona të sinqerta, sepse pandehnin se kështu mund të dilnin “jashtë loje”, sepse, po të ruheshin marrëdhëniet e mëhershme, ata e dinin se të gjitha avantazhet ishin në anën time.

Deri diku unë isha i gatshëm ta pranoja që Gygaksi t’ia njihte vetes meritat për të gjitha sukseset e firmës, përfshirë edhe ato në Rusi, ku, pa më të voglin dyshim, unë kisha pasur rolin kryesor. Ama nuk mund të pranoja që unë përnjëherësh të kthehesha në një person “të mbajtur peng” prej njerëzve rreth tij, të cilët nuk kishin asnjë meritë brenda firmës.

Sonja, në vend që të punonte për të mirën e *Interplastica-s*, e cila tani ishte edhe e saj, e kalonte tërë ditën duke më kontrolluar, duke përgjuar telefonatat e mia, duke u përpjekur të zbulonte se çfarë bëja dhe me se merresha. Madje, nuk u kursye as në ngritjen e ndonjë kurthi, gjithnjë me shpresë se një ditë do të bija në grackat e saj. Por më e keqja ishte se Gygaksi ndryshoi tërësisht. Marrëdhëniet tona, dikur thellësisht miqësore dhe të ndërtuara mbi besimin reciprok, tani kishin pësuar një ndryshim rrënjësor.

Situata u bë e vështirë. Gygaksi, ndërkohë, kishte marrë disa vendime tepër të rrezikshme për firmën, duke mbiçmuar potencialet e veta. Nga ana tjetër, disa kontrata shumëmilionëshe në Rusi, të cilat ishin në fazën e përmbylljes, ishin vënë në pikëpyetje. Pa mua,

ato nuk mund të realizoheshin.

Pikërisht ato ditë isha duke përfunduar kontratat për firmën e autoveturave *Autovaz* të Toliattigradit, për të prodhuar shtatë pjesët më të rëndësishme të automjeteve, duke filluar nga kabina e veturës, sistemi i komandimit, e deri te frenat, amortizuesit, bateritë etj. Dy nga këto kontrata të mëdha ishin firmosur gjatë vitit 1989 dhe në fillim të vitit 1990. Ishim në pritje që të futeshim në linjën e kredisë gjermane nga shoqëria *Hermes*, shoqëri e sigurimit të kredive të shtetit gjerman. Gjithçka ishte bërë gati. Pritej vetëm firmosja përfundimtare, e cila ishte parashikuar të bëhej në verën e vitit 1990. Në një rrethanë të këtillë, unë vendosa t'i hap letrat me Maks Gygaksin. E ftova në një bisedë dhe ia thashë copë atë që mendoja. Biseda ishte e vështirë, e rëndë.

“Nuk po kuptoj çfarë po ngjet me ty”, i thashë. “Nuk po të njoh më. Ti nuk je më ai që ke qenë. Unë jam duke punuar në një mjedis aspak miqësor, i rrethuar me mijëra vështirësi, të cilat, për fat të keq, burojnë nga brenda firmës. Klima e marrëdhënieve tona ka ndryshuar, jo për fajin tim.”

Në mënyrë krejt të prerë kërkoja prej tij që të vendoste përfundimisht: ose përnjëmend bashkë, ose rrugët tona këtu duhej të ndaheshin. Rruga e vetme për të qëndruar përsëri së bashku, ishte themelimi i një firme të përbashkët jashtë *Interplastica-s*, ku do të ishim të dy ortakë. Pranova që në atë firmë ai të kishte numrin më të madh të aksioneve, ndërsa unë të isha ortaku më i vogël. I sqarova, gjithashtu, se kjo nuk po ndodhte me fajin tim dhe se unë nuk isha fajtor për divorcin me *Interplastica-n*.

“A dëshiron të bashkëpunosh ende me mua?” – ishte pyetja e drejtpërdrejtë që ia bëra Maks Gygaksit.

Gygaksi nuk u duk i befasuar. As i emocionuar. Madje, kisha përshtypjen se ai prej kohësh e kishte pritur reagimin tim. Edhe përgjigja e tij ishte e shkurtër dhe e qartë:

“OK! Bëjmë një shoqëri të re, vetëm unë dhe ti. Vazhdo me procedurat për themelimin e saj.”

Pavarësisht se ushqeja shpresën se prej tij do të merrja një lloj miratimi, nuk pritja që Gygaksi të ishte kaq i prerë në pëlqimin që më dha. Unë për vete nuk kisha mjete dhe forcë financiare për të





*Në natyrë. Në këtë vend rrija shpesh për të shijuar suksesin.  
I lirë dhe i çliruar nga tensioni*

dalë më vete. Kisha ide, kisha projekte, e njihja tregun, e dija se në cilat pika duhej “sulmuar” dhe me çfarë, por kjo nuk mjaftonte për një depërtim të suksesshëm.

M’u duk se gjërat tashmë kishin filluar të lëviznin për së mbari. Kisha energji, kisha përvojë. Tani do të kisha edhe firmën time. Kisha punuar për një kohë të gjatë me rrogën e një nëpunësi, duke ua lënë të tjerëve profitin kryesor të punës sime. Me themelimin e firmës sime, e parashikoja se raportet duhej të ndryshonin rrënjësisht. Do të isha zot i punës sime. Mbi të gjitha, nuk do të isha i varur nga padronë të cilët nuk e vlerësonin këtë punë. Isha entuziast dhe optimist, natyrisht në suaza të racionalitetit.

E kisha menduar edhe emrin e shoqërisë së re: *Mabetex*, që në të vërtetë ishte bashkim i emrit të Maksit dhe emrit tim, me prapashtesën *Tex*, që do të thotë *Technique-export*. U nisa, në Lugano, te një avokat profesionist, Shioli (Scioli) dhe e ngarkova

të më përgatiste dokumentet e nevojshme për të hapur një firmë private. Gjeta edhe mjediset në rrugën Fontana 14, në Lugano. Isha bërë gati të firmosja kontratën e qirasë dhe faturën e mobiljeve për zyrë. Danielës, asistentes sime të re, e cila zëvendësoi Sonjën, i kisha premtuar se ajo do të bëhej punëtorja e parë e *Mabetex-it*, sapo firma të fillonte aktivitetin.

Pas disa ditësh, avokati Shioli më telefonoi dhe më bëri të ditur se çdo gjë ishte gati dhe se duheshin 100 mijë franga si kapital fillestar për të bërë regjistrimin e firmës.

Tani duhej t'i drejtohesha Gygaksit. Mora letrat dhe kontratat, që i kishte përgatitur avokati dhe u nisa për te Maksi. Edhe sot e kësaj dite e mbaj mend shumë mirë atë ditë. Zyra e Gygaksit ishte në fund të një korridorit, kurse në anën tjetër ishte zyra ime. Dera e zyrës së tij ishte e hapur. Ishte në zyrë, bashkë me gruan e tij të re, Sonjën. “Maks,” i thashë sapo hyra, “i kam bërë të gjitha përgatitjet, gjithçka është gati”. Hetova se Sonja më shikonte vranshëm, madje me njëfarë përçmimi.

“Çfarë është gati”?! – më pyeti Maksi dhe bëri sikur ishte i habitur. “Si?... E paske harruar çfarë kemi biseduar bashkë? Nuk e mban mend? Ne sikur ramë dakord që... A më the të përgatisja dokumentacionin për themelimin e firmës sonë të re...?”

“Firmës sonë?!...Çfarë firme?”

E humba durimin dhe fillova të flisja me zë pak të ngritur. “Dëgjomë mirë, Maks! Kur ne të dy folëm për këtë çështje, as ishe i dehur, as në gjumë. U morëm vesh mirë bashkë. I kam të regjistruara në kokën time të gjitha ato për të cilat u morëm vesh bashkë. Tani, ç'është kjo që thua?!”

Nuk më la as ta mbaroja fjalën. Mohoi çdo gjë që kishte thënë në bisedë me mua.

“Unë nuk bëhem ortak me vartësit e mi!”, ishte kategorik.

Për një çast mbeta i stepur, por e mora veten shpejt.

“Me ty ose pa ty, i thashë, kjo tani pak ka rëndësi. Por një gjë e kam të qartë: unë këtu nuk punoj më!”

Dola duke përplasur derën. Ika, pa e kthyer kokën pas, por kësaj radhe me një ndjenjë lehtësie, sepse e dija se ku do të shkoja. Shkoja drejt firmës sime. Megjithatë, nuk kishte si të mos më acaronte situata



*Zyrat qendrore të Mabetex-it në Lugano*

e krijuar. Në njëfarë mënyre e parandieja se një ditë do të ndodhte diçka, por nuk e kisha marrë me mend një fund të këtillë. Emocionet i kisha të përziera. Nuk e mohoj, midis shtytësve të tjerë, tani kisha edhe një motiv më shumë: gjakimin për sukses, si revansh ndaj atyre që më kishin përçmuar, padrejtësisht bile! Prej kur e mora drejtimin e *Interplastica*-s si drejtor i përgjithshëm unë e kisha dhjetëfishuar vëllimin e biznesit, në mos më shumë.

Koha nuk priste. Duhej vepruar shpejt. Nuk mund ta ndryshoja tani emrin e firmës dhe ta ribëja tërë dokumentacionin. Problemi kryesor ishte derdhja e 100 mijë frangave. Në bankë kisha 97 mijë franga. Këto ishin kursimet e mia, nga paga mujore, duke hequr shpenzimet e jetës dhe ato para që ia dërgoja familjes në Kosovë. Pra, më mungonin edhe tre mijë franga, që të plotësohej shuma e nevojshme. Më duhej t'i gjeja sa më shpejt, sepse nuk mund të paraqitesha keq tek avokati. Iu drejtova Ekrem Isakajt, një kosovari që punonte prej vitesh në Zvicër. M'i dha hua, pa asnjë hezitim.

Për të hapur firmën, duhej që, përveç Presidentit të këshillit drejtues, edhe një anëtar tjetër i këtij këshilli të kishte shtetësi zvicerane. I kërkova ndihmë një mikes time, Milly Sulmani, që të pranonte të nënshkruante si anëtare e këshillit të firmës së re. Pranoi. Shkuam drejt e te avokati, i nënshkruam të gjitha dokumentet, i dorëzuam 100 mijë frangat dhe çdo gjë ishte gati.

Data 28 maj 1990 u bë ditëlindja e *Mabetex*-it.

Mirëpo, me firmën e re nuk mund të filloja punë, pa dhënë shprehimisht dorëheqje nga *Interplastica*. Gygaksi krijoi pengesën e radhës. Ai, për këtë, i kërkoi ndihmë shefit të kuadrit të firmës së tij dhe shfrytëzoi klauzolën, sipas të cilës nëpunësi është i obliguar të paralajmërojë punëdhënësin tre muaj para se të japë dorëheqjen. Këtë, gjithë solemnitet e kënaqësi, ma kumtoi vetë shefi i kuadrit të firmës, madje edhe duke më kërcënuar me gjobitje, nëse bija në kundërvajtje me ligjin zviceran.

Ndërkohë, Gygaksi e shfrytëzoi këtë situatë që të kërkonte prej meje kalimin e të gjitha punëve të mbetura përgjysmë te djali i tij. E bëra edhe këtë, madje duke i dhënë shpjegime plotësuese djalit të tij, Andrea Gygaksit, rreth të gjitha detajeve lidhur me punët që duheshin kryer, sipas kontratave tashmë të firmosura.

Por kjo nuk ishte e tëra. Ditën e fundit të punës në firmën e tij, Gygaksi më zgjati një letër, me të cilën më bënte të ditur se, si kusht i prishjes së kontratës, duhej të respektoja edhe këtë paragraf: zotit Pacolli nuk i lejohet t'i bëjë konkurrencë, as direkt as indirekt, aktivitetit që përfshinte *Interplastica*, bile as të trajtojë me njerëzit që kishin ndonjë lidhje me "Interplastikën", e as tematikën e veprimtarisë që ndonjëherë kishte trajtuar *Interplastica*.

Më duhet të bëj një parantezë këtu për të shpjeguar si rrodhën ngjarjet e mëtejshme me *Interplastica*-n dhe Maks Gygaksin, sepse kjo është një dramë e vërtetë njerëzore, që nuk më hiqet mendsh. Së pari duhet të them se *Interplastica* falimentoi që në vitin 1992, pra vetëm dy vjet pasi u largova unë, ndonëse ishte një firmë e mirë dhe, gjatë punës sime në të, kishte një fitim prej qindra miliona frangash në vit.

Por çfarë ndodhi në të vërtetë? Disa muaj pasi ika nga *Interplastica*, Maksi qiti edhe shtëpinë në emër të gruas së tij, Sonjës. Një mik i Maksit nga banka, ia bëri me dije atij se gruaja tashmë ia kishte shitur shtëpinë. Një natë Maksi vjen te unë (i kishim shtëpitë afër në Lugano) me një armë në dorë dhe më rrëfen për sa i kishte ndodhur. U përpoqa ta qetësoj dhe i thashë se tani nuk mund të bënte asgjë, përveç se do t'i shtonte edhe një fund tragjik kësaj situate të rëndë. Ndërkohë, Sonja u lidh me djalin e Maksit nga gruaja e parë, Andrean dhe e braktisi Maksin. Për disa vite Maksi m'u zhduk nga sytë. Nuk e pashë dot. Iku në Gjermaninë Lindore dhe atje u përpoq të bënte diçka. Një herë, më 1991 më thirri nga Gjermania dhe m'i kërkoi 400 mijë marka hua, pasi që *Interplastica*, ishte në falimentim e sipër. Ia dhashë ato para pa hezitim, ndonëse e merrja me mend se nuk do të m'i kthente kurrë.

Ndodhi si ndodhi dhe, ndonjë vit më vonë, befasisht takohem me Maksin në Moskë, në hotelin *Penta* në dimrin e 1994-s, në ashensor. Unë shikoja titujt e gazetës që kisha në dorë, kurse ai rrinte përballë meje, kokulur. Kur ç'të shohësh: Maksi. Ishte plakur dhe kishte rënë jashtë mase.

-Çka ndodhur me ty, Maks?! - i thashë. -Si qenke katandisur kështu?

Ai nisi të më shpjegonte diçka, por unë e ndërpreva dhe i thashë:



*Firmosja e një kontrate së bashku  
me Kliuka, Margit Karner, që drejtonte Mabetex Vjenën dhe Lucina Maesani*

-Do të shkojmë në drekë bashkë, vetëm t'i kryej disa punë.

Në drekë ai m'i rrëfeu të gjitha që i kishin ndodhur, me Sonjën, me djalin, me punën. Kishte rënë në dëshpërim, nuk kishte vullnet as për punë, as për jetë. Më piku në shpirt fati i rëndë i këtij njeriu, me të cilin kishim kaluar shumë kohë bashkë, prandaj mora një nismë që t'i ndihmoja ta rregullonte disi jetën e tij të përmbysur. U martua me një zonjë nga Moska. Më 1996 u lindi djali, Philipi, dhe nga ky moment Maksi dukej të ishte njeriu më i lumtur në botë. Këtë ma konfirmoi dhe më falënderoi pak ditë para vdekjes në shtator 2004. Pas kësaj më 1997, ua mora një banesë me qira në Desenzano të Veronës, i dhashë një veturë dhe i caktova një rrogë prej dhjetë mijë frangash. Formalisht e bëra këshilltar timin dhe i thashë:

“Po arrite të punosh diçka, mirë, nëse jo, vazhdo të jetosh jetën tënde.”

Për afro dhjetë vjet, nga viti 1995 dhe deri në vitin 2004, ai nuk erdhi qoftë edhe një herë në Zvicër, ngase, për shkak të aferës dhe dramës që kishte përjetuar, kishte filluar ta urrente atë vend. Në gusht të vitit 2004 ia organizova kremtimin e ditëlindjes në Lugano.



*Komdragmet në Yakutsk. Qendra e mineraleve të çmuara, një nga ndërtimet e para të Mabetex-it*

Djali që lindi me gruan e re, ish-bashkëpunëtorja ime, tashmë i qe bërë 7 vjeç.

Gati një muaj më vonë, pas festës së ditëlindjes (ka qenë 17 shtatori i vitit 2004, më kujtohet mirë), gruaja e tij më thërret nga ora tre e mëngjesit dhe më thotë se Maksi kishte vdekur. Shkova dhe e gjeta ulur në kolltuk, me telekomandën e televizorit në dorë, me sy hapur dhe me një buzëqeshje të dëlirë në fytyrë. Vdiq ashtu si jetoi! Maksi ishte një figurë profesionale dhe njerëzore që ka ndikuar shumë tek unë, por mes cilësive të tij, ajo që veçoj ishte modestia dhe përvujtësia e tij. Fjala vjen, kur ai ishte në makinë, arrinte të ishte i sjellshëm, ta ndante kohën shkëlqyeshëm me shoferin, me atë që fliste në telefon, pa harruar askënd. E çmoja shumë këtë njeri, pranë të cilit u rrita shumë si individualitet, si profesionist. Më tërhiqte shumë pjesa e komunikimit të tij të qetë, plot respekt për bashkëbiseduesin, në makinë, në tryezën e bisedimeve, kudo, pavarësisht nivelit të atyre që kishte përballë apo pranë tij.

Thoshte se ishte me origjinë nga Janina dhe se i takonte asaj popullsie, e cila ishte dyndur që andej në shekullin XV, pas invadimit



*Me Presidentin e Yakutskit z. Nikolaev, në ditën e inaugurimit të spitalit "Nëna dhe Fëmija"*

të turqve dhe kishte marrë arratinë në drejtim të Alpeve, në rrethinat e Luganos. Thoshte se kishte origjinë të largët shqiptare dhe se paraardhësit e tij ishin quajtur Gega. Një legjendë që është e vështirë të vërtetohet historikisht. Por, sido që të jetë, këtë pjesë të rrëfimit e kisha një lloj obligimi moral ndaj Maks Gugax-it, sepse inicialet e emrit të tij qëndrojnë akoma në emrin e *Mabetex*-it.

Ndërsa tani le t'u kthehemi zhvillimeve të tjera, aty ku e lamë, para se bënim këtë parantezë. Pra, kushtëzimet e largimit tim nga *Interplastica* impononin që *Mabetex*-i të zhvillonte aktivitet në një fushë tjetër. Për këtë duheshin kërkuar rrugë të reja dhe duhej gjetur një zgjidhje.

Njeriu i parë që m'u kujtua dhe që duhej t'i drejtohesha për bashkëpunim ishte Fjodor Kliuka, drejtor i kombinatit metalurgjik të Stary Oskolit. Emri i tij më kishte ngelur në kujtesë nga koha kur punoja në *Interplastica* jo vetëm pse kishte nënshkruar kontrata për mua, por edhe për shkak se ma thoshte hapur: "Me gjithë respektin





*Spitali "Nëna dhe fëmija" në Jakutsk, 1993, ndërtuar nga Mabetex-i, më i miri në Rusi*

që kam për Gygaksin, më duhet të të them se i vetmi njeri që di të punojë në atë firmë je ti. Por e keqja është se ata as nuk dinë të të vlerësojnë sa vlen ti, or djalë!”

Ndaj, kur nisa të kërkoja klientët e parë për firmën time të sapoformuar, vendosa t’i drejtohesha zotit Kliuka (1991). Nuk u zhgënjeva. Ishte pikërisht Fjodor Kliuka që më dha punën e parë, që firmosi kontratën e parë me *Mabetex*-in. Ashtu siç ishte shkruar në “akt-divorcin” me Gygaksin, unë nuk mundja për një farë kohe ta konkurroja “*Interplastica*-n”, aktiviteti i së cilës shtrihej kryesisht në sektorin e industrisë. Atëherë, falë zotit Kliuka, unë fillova të veprojë në sektorë të tjerë.

Kontratat pasuan njëra-tjetrën. Një fabrikë për grirjen e mishit, një tjetër për konservimin dhe skremimin e qumështit, një godinë për fabrikë konfeksionesh, një fabrikë për prodhimin e birrës, tjetra për prodhimin e bukës, fabrikë për ambalazhin e lëngjeve të frutave. Dhe, në fund, një spital i madh me 240 shtretër dhe një hotel luksoz. Të gjitha këto në qytetin e Sary Oskolit.

E ndej veten krenar për atë që arriti të bënte për pak kohë *Mabetex*-i. Në një kohë rekord, arritëm ta shndërrojmë klinikën ekzistuese nga një godinë gërmadhë e plot minj, merimanga, buburreca e tartabiqe, në një nga qendrat spitalore më moderne në tërë Rusinë. Fama që fitoi ky spital për pak kohë, bëri që të niseshin nga Moska pacientë për t’u mjekuar në Sary Oskol jo vetëm për shkak të kushteve të mrekullueshme dhe mjediseve moderne e plot dritë, por edhe për kompletimin e klinikave me aparatura të kohës, që mund t’ia kishin zili edhe vendet më të zhvilluara evropiane.

Fill pas përfundimit të spitalit, *Mabetex*-i në këtë qytet ndërtoi një hotel modern me pesë yje. Më vonë ndërtoam edhe një linjë për prodhimin e të gjitha produkteve të karbonatit të kalciumit, e cila është më e madhja në të gjithë vendet e Lindjes. Ajo prodhonte 1,000,000 tonë CaCO<sub>2</sub>.

Në fillim Kliuka m’i paguante detyrimet duke shitur minerale hekuri në Poloni, ndërsa unë i importoja këto minerale dhe, me shitjen e tyre financoheshin punimet e kryera nga *Mabetex*-i. Besimin që ma dha Kliuka, duke firmosur kontratat e para me *Mabetex*-in, krijuan te unë ndjenjën e nevojës për t’ia shpague në të njëjtën mënyrë.

Ndodhi kështu që linjën e karbonatit të kalciumit e ndërtuam pa asnjë paradhënie dhe pa asnjë garanci. U përfundua puna dhe linja u vu në funksion pa asnjë pengesë dhe me sukses të plotë. Por që atëherë e deri më sot, nga Kliuka kam vetëm premtimin e tij, ndonëse bëhet fjalë për një shumë prej mbi 40 milionë dollarësh.

Sido që të jetë, pas veprave të kryera në Stary Oskol, nuk kisha më nevojë për reklamë. Serioziteti, besueshmëria e *Mabetex*-it, aftësia për të respektuar kontratat dhe afatet e parashikuara për realizimin e projekteve - ishin afishuar tashmë.

Kështu, në vitin 1992, në Jakutsk, 9 mijë kilometra larg Moskës, na u desh që në një afat rekord të montonim dy linja të prodhimit dhe ambalazhimit të qumështit. Pra, dy fabrika që u përfunduan për pak muaj.

Por, gjithsesi, momenti i kthesës ndodhi në janar të vitit 1993, kur *Mabetex*-i fitoi kontratën për rikonstruksionin e Pallatit të Kongreseve në Jakutsk. Ky objekt u krye dhe u pëlqye jashtëzakonisht shumë, madje edhe nga Presidenti Jelcin, gjatë një vizite zyrtare që i bëri kësaj republike. Duke marrë krahë nga ky sukses, vendosëm të punonim në ndërtimin e një objekti tjetër të rëndësishëm, si ai spitalit.

Në konkursin ndërkombëtar merrnin pjesë shumë firma nga Evropa e sidomos nga Gjermania dhe Austria. Por *Mabetex*-i e fitoi konkursin. Objekti kishte vlerë 140 milionë dollarë. Kontrata u nënshkrua dhe puna filloi.

Fitoren e kësaj kontrate e shihja posaçërisht në punën parapërgatitore, gjegjësisht në paraprosjektin që kishim bërë në Spitalin, me angazhimin e firmës *Biro71* nga Lubjana. Meritat e zotit Joze Pucihar, Bogdan Spindler, Juri Princez etj, ishin të mëdha. Para çdo kontrate firmat normalisht nuk investojnë, pasi që fitorja është e paqartë. Unë kisha bërë të kundërtën, kisha investuar mbi 600 mijë marka vetëm në paraqitjen e idesë (projektin ideor), pra klienti im e pati rastin të informohej si është më mirë për se bëhej fjalë. Kurse firmat e tjera, kishin sjellë vetëm disa oferta, duke i treguar çmimet dhe duke lënë klientin në konfuzion për atë që do të ndërtohej.

Kontrata e fituar filloi të ekzekutohej; tetëmbëdhjetë milionë

dollarë m'u hodhën në konto si paradhënie, në një kohë që unë nuk isha tërësisht i përgatitur. Nuk munda të flija gjithë natën, sepse duhej t'ia nisja punës. Shkova në Lubjanë të nesërmen dhe ia ofrova kontratën *Smelit*, kompani e madhe ndërtimesh sllovene.

“Ku është Jakutski?”, pyeti dikush dhe i hodhi një shikim hartës. U shpjegova se është në verilindjen ekstreme të Rusisë. U tregova vetëm për klimën. Atje kishte dy stinë dimri me 9 muaj e me temperatura -71 gradë dhe vera 3 muaj me temperaturë 48 gradë. U shpjegova po ashtu se gjatë tre muajve të verës atje mbin, rritet dhe piqet: misri, gruri, qepa, dredhëzat e çdo gjë tjetër. Mrekulli e perëndisë!

Fillimisht ata ishin të pavendosur dhe dikur u tërhoqën duke thënë se atje bënte shumë ftohtë.

Sllovenët, pra, nuk donin të shkonin në Jakutsk për të punuar, ndërkohë që mua m'i humbën tre muaj. Në Kosovë e mendova “Ramiz Sadikun”, që ndoshta mund ta merrte përsipër një punë të tillë. Por gjërat atje kishin marrë teposhtëzën dhe asnjë punë nuk mund t'i besohej një ndërmarrjeje nën masa të dhunshme. Hoqa dorë nga kjo ide. Shkova në Maqedoni dhe vura kontakt me ndërmarrjen “Mavrovo”. Me maqedonët puna shkoi më mirë. Më pastaj mora edhe “SCT-në” e Lubjanës. Paisjet medicinale i kontraktova me “Simensin”.

Puna mori të mbarën. Ndërtimi i spitalit përfundoi për 24 muaj. Gjërat u zhvilluan me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Kur spitali ishte gati, Jelcini erdhi në Jakutsk, duke mbetur i impresionuar prej cilësisë së punimeve. Ky spital, që posedonte 840 shtretër, nëntë salla operative dhe çdo gjë që lidhet me shëndetin e nënës dhe fëmijës edhe sot mund të barazohet me gjithë mend me spitalet më moderne në botë. “Kush e ka bërë këtë?” - pat pyetur Jelcini. I treguan kush. Isha unë, Pacolli, që, siç e thashë edhe më parë, kisha një njohje të mëhershme me të. Jelcini u afrua, ma dha dorën dhe tha me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë:

- Ne njihemi - tha duke u kthyer kah publiku. Unë e njoh zotin Pacolli - shtoi Presidenti rus.

Kaq u desh që kureshtja ndaj meje të rritej. Në atë kohë, me mënyrën si funksiononte pushteti në Rusi, kjo donte të thoshte

shumë. Kontratat erdhën një pas një. Disa u detyruam, madje, t'i refuzonim. Ndërkohë, vlera e punimeve, që ishte duke i kryer *Mabetex*-i, kishin kaluar shumë prej dy miliardë dollarësh. Një gjë e paparë. Vetëm për tre vjet aktivitet të *Mabetex*-it, firma e jonë u bë një ndër 74 firmat më të mëdha të Zvicrës duke realizuar një xhiro prej mbi 2 miliardë dollarësh.

Që nga ky moment, Jakutski u bë njëri nga kantieret tona më të mëdha. Kemi ndërtuar aty një qendër të madhe dhe moderne të biznesit me mbi 50 mijë metra katrorë, qendrën e Komitetit për gurë të çmuar, 33 mijë metra katrorë, një hotel me pesë yje, teatër, linjat për trajtimin dhe pastrimin e ujit të pijshëm, një spital tjetër në Pokrovsk, një fabrikë për elemente me bazë lëndën drunore, si dhe shumë linja për prodhime industriale, tërësisht moderne, ndër të cilat më e njohura është ajo e prodhimit të ushqimit të homogjenizuar për fëmijë. Për gjithçka që është bërë atje, nuk pati asnjë vërejtje nga investitorët sepse të gjitha punët u kryen në afatin e paraparë dhe me cilësi të lartë. Fabrikat dhe objektet tjera të ndërtuara nga ne janë vënë në punë që ditën e parë të përrurimit dhe vazhdojnë të punojnë me kapacitet të plotë edhe sot e kësaj dite. *Mabetex*-i vazhdon të jetë i pranishëm në këtë republikë të largët të Rusisë.

## Hyrja në Kremlin

*Rindërtimi i Kremlinit u parapri nga Shtëpia e Bardhë e Rosisë. Rinovimi i zyrës së Jelcinit në kohë rekord. Gara e madhe për rinovimin e Korpusit 1 me 40 kompani globale dhe fitorja mbi to. Në syrin e ciklonit: xhelozia dhe kundërvënia e komunistëve, oligarkëve dhe miqve të tyre të jashtëm ndaj kosovarit të Marecit që i mundi të gjithë!*

**N**ë tetor të vitit 1993 u nisa për në Moskë, i thirrur nga *Moebelintorg*, dikasteri shtetëror rus i tregtisë së jashtme, i autorizuar të lidhej me firmat e huaja që punonin për administratën publike. “Na dërgoni sa më shpejt që të jetë e mundur 60 mijë metra katrorë rrjet të gjelbër për të veshur fasadën e Shtëpisë së Bardhë në Moskë” - ishte kërkesa. Shtëpia e Bardhë, kështu quhej godina e parlamentit rus, e cila pak kohë më parë, gjatë rebelimit të komunistëve, ishte goditur me tanke me urdhër të Jelcinit. Në pak orë organizova dërgimin e materialit, pa pagesë, me aeroplan dhe vazhdova të qëndroj në kryeqytetin rus edhe për disa ditë.

Ndërkohë, më ftuan të merrja pjesë edhe në tenderin për restaurimin e Shtëpisë së Bardhë. Isha i interesuar ta fitoja këtë garë strategjike, sepse Shtëpia e Bardhë, parlamenti rus, me ato zhvillime që kishin ndodhur rreth tij, kishte marrë një kuptim simbolik. Edhe restaurimi i tij do të kishte po këtë kuptim. Përveç kësaj, vëmendja e medias vendore dhe botërore ishte e përqendruar së tepërmi rreth kësaj godine dhe për çdo firmë që do të merrte përsipër rinovimin e saj, ky ishte prestigj dhe marketing njëkohësisht. Kjo ndërtesë, e quajtur ndryshe edhe Shtëpia e Bardhë e Moskës, ishte simbol i të gjitha Rusive. Para bombardimit, ndërtesa ishte qendra e parlamentit të Federatës Ruse, atëherë Republikë në ish-Bashkimin Sovjetik. Në këtë shtëpi, “ziheshin dhe merrnin shije të gjitha supat”, jo vetëm për politikën e kësaj Republike, por edhe të gjithë Bashkimit Sovjetik. Ishte prestigjioze për çdo shtet të botës të kishte ambasadën përreth kësaj ndërtese: ambasada e SHBA-së ishte vetëm

pak metra larg. Të gjitha masat e sigurisë që ndërmerreshin në këtë ambasadë, ishin për shkak të kësaj ndërtese. Flitej se ambasada e SHBA-së ishte e konceptuar në atë masë, që të mund të përcilleshin edhe bisedat që bëheshin nëpër sallat e kësaj ndërtese, nëpërmjet dridhjes së xhamave nga kumbimi i zërit. Pra sytë e krejt botës ishin të përqendruar te kjo ndërtesë. Ishte diçka e veçantë të gjendeshe afër saj e jo më të futeshe brenda dhe të vendosje për dukjen e saj të ardhshme. Ky shans m'u dha mua!

*Mabetex*-i im, e fitoi tenderin. Erdhi çasti i firmosjes së kontratës dhe, i shoqëruar nga drejtori i *Moebelintorg-ut*, shkova në Kremlin. Ai e njihte mirë mjedisin, vendin, hierarkinë shtetërore ruse, të gjitha. Më tha thjesht: “Do të shkojmë të firmosim te Borodini.”

“Te Borodini?”, e pyeta pak me habi.

“Po. Te Pavël Pavloviç Borodini”, thotë ai.

“Je i sigurt? Shiko, ky Borodini, Pavël Pavloviçi, ka qenë në Jakutsk”, vërejta unë.

“Po, është pikërisht ai”, më thotë drejtori i *Moebelintorg-ut*. “Tani është këtu, në krye të administratës presidenciale, njeri shumë i afërt i Presidentit. Presidenti Boris Jelcin e ka marrë pranë vetes prej disa muajsh. E kishte njohur gjatë një vizite në Jakutsk dhe i kishte bërë përshtypje të mirë.”

Ishte tetori i vitit 1993. Sipas kontratës, renovimi duhej të bëhej për më pak se katër muaj, pra deri në janar të vitit vijues, saktësisht më 4 janar, datë që duhet të respektohej. Këtë urdhër e kishte dhënë kryeministri Çernomirdin, në emër të qeverisë dhe të Boris Jelcinit, pra Presidentit. Ndërsa Borodini ishte ngarkuar për operacionalizimin e punëve. Më vonë, madje, ndërsa ne tashmë kishim filluar punimet e restaurimit, na u bë me dije se vetë Jelcini kishte kërkuar që punimet të bëheshin me kualitet të ngjashëm me Pallatin e Kongreseve në Jakutsk, të cilin e kishte kryer në kohë rekord *Mabetex*-i dhe e kishte inauguruar po Jelcini.

Kontrata u nënshkrua dhe puna filloi. Kishim mungesë të madhe të infrastrukturës, të logjistikës dhe të punëtorëve. Preokupimi im për këtë më kushtoi shumë net pa gjumë. Dy firma turke punonin në atë kohë në Ukrainë dhe shumë shpejt u lidha me to. Nga Kosova mora një numër të madh inxhinierësh, mjeshtërish dhe punëtorësh.

Viza dhe leja e punës nuk ishin problem. Për çdo gjë vendosja vetë, pasi qeveria ruse m'i kishte lënë duart e lira për gjithçka, e vetëdijsme se vetëm në këtë mënyrë mund të arrihej që në 4 janar 1994 të rihapej Shtëpia e Bardhë. Pra zero burokraci! Por më duhet të them menjëherë se, përveç afatit tepër të shkurtër, me Shtëpinë e Bardhë dolën edhe një mori andrallash të tjera, që nuk i kishim menduar më herët. Rrënimet dhe shkatërrimet kishin qenë shumë më të mëdha se ç'i kishim vlerësuar ne. Edhe përkundër kësaj, bëmë çdo gjë që punët të kryheshin me cilësi të lartë dhe në afatin e paraparë. Punuan ditë e natë rreth 7 mijë veta. Por këtu më doli një problem tjetër. Ku do të banonin punëtorët e mi? Përveç që ma vunë në dispozicion kompleksin hotelier *Ismailovo* (kategoria e tretë e hoteleve), që kishte mbi 2000 dhoma, më ofruan edhe shumë kazerma ushtarake apo hotelin e atëhershëm prestigjioz *Ukraina*, që gjendej përballë "Shtëpisë së bardhë", matanë lumit Moskovia. Mijëra ushtarë gjithashtu iu nënshtruan komandës së *Mabetex*-it. Shumica e njerëzve që udhëhiqnin punët e *Mabetex*-it, ishin shqiptarë të Kosovës, dhe ata shumë shpejt u miqësuan edhe me ushtarët. U formua një komandë e re, nga njerëz ushtarakë dhe civilë, pra të përzier, por kësaj radhe të udhëhequr nga profesionistë të *Mabetex*-it. Që nga ky moment, *Mabetex*-i identifikohet si firmë shqiptare, apo më mirë të them kosovare. Në atë shtëpi historike ku dikur flitej vetëm gjuha politike e Bashkimit Sovjetik, rusishtja, tani dëgjohej pothuajse vetëm gjuha shqipe. Shumë herë edhe këngë, shaka, por edhe sharje për vartësit e tyre. Edhe ushtarët rusë, filluan të flisnin shqip.

Një gjë është e sigurt, megjithëse bëhej fjalë për një ushtri të madhe civile me uniformë, mbizotëronte një atmosferë pune dhe një vullnet i madh për të mbajtur dhe përmbushur premtimin e dhënë. Nga ana tjetër, në Evropë, Zvicër, Gjermani, Austri, Slloveni e Itali, punonte ekipi nga Luganoja që ekzekutonte porosinë e mallit. Në Rusi në atë kohë nuk mund të gjendej asgjë. Perestrojka e Gorbachovit kishte shkatërruar gjithçka. Me kompaninë shtetërore të transportit ajror, të drejtoratit të Presidentit bëra kontratën për transportin e mallit nga Evropa. Çdo ditë, nëpër aeroporte, duke filluar prej Mynihut, Gracit, Mariborit, Bergamos, Malpensës të



Milanos, Xhenovas, uleshin dhe ngriheshin aeroplanët e ngarkesave tona. Ka pasur ditë, që në Moskë, në aeroportin moskovit Vnukovo, kanë arritur nga këto aeroporte, mbi 6 aeroplanë. Atje, në një kazermë të ushtrisë, ishte i strehuar ekipi që bënte shkarkimin e aeroplanëve dhe ngarkimin e kamionëve që mallin e sillnin në Shtëpinë e Bardhë, ku priste ekipi tjetër. Pa asnjë magazinim, malli dërgohej në vendpunim, ku menjëherë futej në punë. Në Shtëpinë e Bardhë situata ndërronte çdo ditë.

Çdo ditë ndryshonte forma e saj, si e jashtme po ashtu edhe e brendshme. Punën e mbikëqyrte vetë kryeministri i Rusisë, Viktor Çernomirdin. Ai vizitonte çdo ditë Shtëpinë e Bardhë dhe i gëzohej ndryshimit. Do të doja të evokoj një rast kur Çernomirdini, i përcjellë nga unë, vizitonte punimet. Ishim duke shikuar mjediset e reja që po lindnin dhe iu afruam një grupi punëtorësh kosovarë, që punonin në shtrirjen e parketit dekorativ. Punëtorëve të përqëndruar në punë, nuk u bënë përshtypje hyrje-daljet e autoriteteve shtetërore. Duke shikuar mjediset, kryeministri i ishte afruar afër një punëtori kosovar dhe ishte habitur duke shikuar lart. Punëtori i cili as që e kishte vërejtur atë, i mëshoi Çernomirdinit në këmbë dhe pa e shikuar fare i tha: "largohu andej". Roja i tij mbeti i habitur dhe filloi të më shikonte mua. Unë iu drejtova punëtorit dhe i thashë: prit pak! Çernomirdini duke buzëqeshur, u largua dhe duke u thënë punëtorëve: "Punoni, punoni se kështu duhet!" Madje ai edhe kërkoi falje. - "Lëre,- më tha. Kështu e ka demokracia të cilën jemi duke u përpjekur ta ngremë jo vetëm në ndërtim, por edhe në aspektin e komunikimit. Ne kemi ardhur këtu dhe jemi duke i penguar punëtorët, jo ata ne. Ai ka të drejtë!" - më tha Çernomirdini.

Ky grup i punëtorëve, të cilët edhe tani punojnë nëpër kantieret e *Mabetex*-it, më duket se ishte nga Malisheva.

Dhe kështu ditë e natë, në tri ndërrime, puna mori kahjen e duhur dhe siç qemë zotuar, u krye në kohë. Shtëpia e Bardhë u dorëzua e rinovuar më 4 janar të vitit 1994, me një ceremoni, të cilën e organizoi kryeministri Çernomirdin. Përfundimi i renovimit të Shtëpisë së Bardhë, për Rusinë kishte edhe karakter simbolik: ishte një fitore e pakthyeshme mbi komunizmin dhe eksponentët e tij ekstremë. Ndonëse ceremonia ishte madhështore dhe lëvdatat për

punët e kryera ishin të mëdha, ne të *Mabetex*-it, veçanërisht unë, nuk mund të ishim aq të hareshëm në atë situatë. Me këtë kontratë, për shkak të vlerësimit joadekuat të përmasës së shkatërrimeve në Shtëpinë e Bardhë, *Mabetex*-i kishte pësuar një shtim në shpenzime, prej afro 70 milionë dollarësh, të cilët u kompensuan me pagesat e mëvonshme. Ishte e qartë se unë, me këtë rast, bëra një kontratë të ngutshme, pa vlerësuar mirë problemet që mund të dilnin, sepse Shtëpia e Bardhë jo vetëm që u renovua me fasada, xhama, dyer, dritare e enterier të ri, por çdo kënd i mbushur me teknologji të vjetër, u desh të zëvendësohej me teknologji të re. Ndërtesës iu shtuan edhe shumë detaje të dekorimeve, mobileve dhe enterierit. Pos këtyre detajeve, u vendosën edhe kompjuterat për çdo vend të punës. Njerëzit e Rosisë së re që vinin të punonin, gjenin të përgatitur çdo gjë. Gjatë inaugurimit, Çernomirdini e tha një fjalë me peshë të madhe historike. “*Mabetex*-i, për katër muaj e shkatërroi atë që komunizmi e ndërtoi për 70 vjet dhe e rindërtoi atë që perëndimi ndërtoi për shekuj me radhë”.

Me këtë rast, ai iu drejtua edhe bashkëpunëtorëve të tij, me fjalët: “Na mbetet edhe neve punë e madhe që të rikonvertohemi. Behgjeti na i ka përgatitur të gjitha”. Shtëpisë së Bardhë iu shtua edhe ndriçimi i fasadave të jashtme, që edhe tani Moskës i jep një pamje krejt tjetër, një pamje të energjisë pozitive, të ekstraverzitetit dhe sharmit të një lloj demokracie, anise alla ruse që po lindte me të. Shtesën prej 70 milionësh do ta kompensoja shpejt. Për këtë dinin edhe autoritetet ruse, të cilat prematuan se do ta kishin parasysh. Disa muaj më vonë, diku nga marsi, me Borodinin do të nënshkruaja një kontratë tjetër, kësaj radhe për renovimin e plotë (me “çelësa në dorë”) të Dumës dhe të Këshillit (Dhomës së lartë) të Federatës Ruse. Të gjitha këto për një kohë rekord dhe me cilësi të lartë punimesh. Pra, *Mabetex*-i bëri të mundur edhe një mrekulli tjetër. Krijoi ambientet moderne dhe mundësoi që edhe këto dy institucione të larta shtetërore të fillonin punën. Edhe për këtë *Mabetex*-i u lavdërua dhe u falënderua. Ishin të shpeshta intervistat e mia ekskluzive për televizionet dhe gazetat autoritative të asaj kohe. Tani *Mabetex*-i u bë faktor në Rusi. Çdokush e njihte. Të punoje në *Mabetex* për vendorët rusë, përveç sigurisë ekonomike, ishte edhe prestigj. Kështu *Mabetex*-i u kompletua edhe

me specialistë të njohur të vendit. Eksperienca ime me inxhinierët rusë, ishte më se pozitive. Tani këta specialistë kishin rastin të tregonin aftësitë e tyre, gjë që deri në këtë kohë, për shumë arsye, nuk kishin mundur ta bënin. Një fakt që duhet të vë në dukje fuqimisht është se specialistët rusë ishin njerëz të mençur, specialistë të aftë dhe të urtë. *Mabetex*-in e



*Shtëpia e Bardhë në Moskë, pas rindërtimit nga Mabetex*

konsideronin si shtëpi të tyre, e mua si zotin e shtëpisë. Respekti që kishin për shqiptarët e Kosovës dhe personalisht për mua, ishte i papërshtueshëm. Ata e mbronin me fanatizëm *Mabetex*-in në çdo mbledhje konsultative. Krenoheshin me të. *Mabetex*-i tani ishte i pranishëm çdokund në Moskë e në Rusi. Përveç institucioneve shtetërore, që tërësisht i ka renovuar apo ngritur në këmbë, *Mabetex*-i filloi edhe ndërtimin e hotelit të vet, 5 yjesh, *Golden Ring-Swiss Diamond hotel*, i cili më vonë u inaugurua në mënyrë madhështore. *Mabetex*-i filloi të ndërtonte çdo rezidencë shtetërore kudo, si në Moskë, në Subborg të Moskës, jashtë Moskës nëpër vendet kyçe të Rusisë si në Socchi, Krasnojarsk, në Volga, në Karillia, në Saint Peterburg. *Mabetex*-i shërbente si firmë prestigjioze që ndërronte ambientet dikur komuniste në mjedise të epokës së re, duke u dhënë energjinë pozitive, shpirtin dhe sharmin e kohës së re. *Mabetex*-i u bë sinonim i cilësisë dhe i respektimit të afateve. Nuk ishin të pakta rastet kur *Mabetex*-it i besoheshin edhe punë shumëmilionëshe me telefon. Ishte krijuar një besim i paparë deri më atëherë. Ndërsa te të gjitha autoritetet dhe qytetarët njerëz rusë që punonin me *Mabetex*-in, nuk hetohej asnjë dozë nacionalizmi.

Në fillim të marsit të vitit 1994 ndodhi diçka që filloi ta lërë nën hije atë që përshkrova më sipër. Një sfidë tjetër në zemrën e



*Kremlin-Korpusi 1 dhe 14, 1994. Kompleksi i Kremlinit është një dëshmi e madhe e historisë, Mabetex hyri në histori me rindërtimin e tij*



Rusisë - brenda mureve të Kremlinit! Deri në atë kohë për njerëzit e rëndomtë rusë ishte e pamundur të mendohej të gjendeshin brenda mureve të Kremlinit, e lëre më për ne shqiptarët. Brenda atyre mureve gjithçka ishte mister dhe enigmë. Me këtë kontratë ne do të ishim të parët në 70 vjetët e perandorisë komuniste të Bashkimit Sovjetik, që hynin brenda mureve të Kremlinit. Po le të bëjmë një sqarim më të hollësishëm historik së këtij kompleksi unik. Kremlini është i rrethuar me mure të larta 5 metra, diku diku edhe 10, të stolisura me elemente gotike. Ai u ndërtua shekuj me radhë dhe madhëstini e mori në shekullin e 17 në kohën e Carit Pjetër dhe gruas së tij Katerinës, që ishte gjermane. Ajo kishte urdhëruar që brenda mureve të Kremlinit të ndërtoheshin objektet që do të shërbenin më vonë si qendër e Perandorisë ruse. Aty u përqëndrua çdo gjë që kishte të bënte me perandorinë, bile edhe thesari i krejt Rusive. Ishin 14 objekte madhështore të ndërtuara në atë kohë, brenda e mureve të Kremlinit. Pallati i madh dhe pallati numër 1, ishin sinonim i forcës dhe perandorisë. Brenda Kremlinit ishte edhe salla e Kongreseve për 3500 veta. Në anën juglindore ishte kazerma e gardës, një Kishë gjysmë e shkatërruar që nuk ishte më në funksion, e disa objekte të tjera përcjellëse. Pas Revolucionit të vitit 1917, Carët u dëbuan nga Kremlini dhe gjithë ky kompleks mbeti në duart e regjimit komunist. Stalini kishte urdhëruar që nga Kremlini të zhdukej çdo gjurmë e së kaluarës. Të gjitha ato mjedise madhështore arkitektonike të ndërtuara me shekuj, të stolisura me emblemat e dekorimet fantastike, duhet të rrënoheshin. Sallat e mëdha të Kremlinit u kthyen në dhoma të vogla të byrosë politike të Partisë Komuniste. Përveç rrënimëve që u bënë në mënyrë brutale, ato ishin riveshur me mure gjipsi të thjeshta, duke mbuluar çdo gjë që për ta ishte e vjetër. Ishte një sfidë për të ardhmen, që krejt çka u modifikua brutalisht në 70 vjetët e fundit, duhet të eliminohej dhe të rikthehej shkëlqimi i arkitekturës së dikurshme.

Ishte marsi i vitit 1994. Në zyrën time në Moskë mbërrin një telefonatë: më ftonin në ndërtesën e administratës së punëve ekonomike të Presidentit të Rusisë, jashtë mureve të Kremlinit. Kjo administratë, siç thashë, më herët udhëhiqej nga Pavël Pavloviç Borodin. Kur mbërrita aty, pa formalitete më çuan në zyrën e tij të

mbledhjeve. Aty ishin mbledhur disa ekspertë të kësaj administrate që pritnin në heshtje. Për mua në tavolinë ishte i rezervuar vendi pranë Borodinit. Posa u ula më porositën çaj dhe fillon biseda. Borodini rrëfeu se Presidenti do të udhëtonte në SHBA dhe në të kthyer do të vizitonte Anglinë, por para se të kthehej në punë kishte ndërmend të pushonte disa ditë.

“Kemi në dispozicion tri javë duke nisur nga e diela e ardhshme” - tha Borodini. I binte fundi i javës së dytë të prillit 1994. Ai vijoi në mënyrë të prerë: “Behgjet a je në gjendje që për tri javë të rinovosh ambientet e një kati të korpusit 14 në mënyrë që të bëhet i mundur fillimi i punës së Presidentit deri sa të bëhet një zgjidhje tjetër për rezidencën e ardhshme të kryetarit të shtetit?” Për shkak të gjendjes së keqe të mjediseve ata nuk ishin të sigurt nëse në të ardhmen Presidenti Jelcin do të punonte brenda mureve të Kremlinit. Pra tani duhet të gjendej një zgjidhje e shpejtë dhe në të ardhmen do të shihej se si do të veprohej. Unë u njoha me vizatimet e katit të tretë të korpusit 14. Ishin mbi 3000 metra katrorë. Ky kat kishte qenë deri tani zyra e Gorbaçovit. Më thanë se Presidenti nuk e donte atë ambient.

“A mundemi t`ia kthejmë sharmin në mënyrë që Presidentit t`i pëlqejë?”, më pyeti Borodini. “Nuk ka dyshim në punën që ti e bën, por sa i përket mënyrës se si do ta bësh, të mbetet ty. Siç e sheh koha është tejte e shkurtër.” I pashë në sy. Me orë të tëra diskutuam ndarjen e mjediseve ashtu si i nevojiteshin Presidentit. Pas diskutimit të gjatë unë kërkova një pauzë prej katër orësh për të dhënë përgjigjen përfundimtare. Kjo kohë më duhej për të telefonuar nëpër fabrikat italiane, për të njoftuar për sigurimin e mobiljeve dhe stolive interne që nevojiteshin. Pa dalë nga ndërtesa, në një zyrë aty pranë me telefon dhe telefax fillova komunikimet, njëherë me qendrën e *Mabetex*-it në Lugano dhe pastaj me firmat e ndryshme më të njohura për orendi në Itali. Në këto katër orë, unë me bashkëpunëtorët e mi arrita të formuloj listën e të gjitha orendive, dyerve e dritareve që dispononin në sallat e ekspozitave të tyre fabrikat respektive, sepse për të prodhuar diçka të re ishte e pamundur. Bile arrita të merrja edhe një çmim të përafërt. Mbetej që me infrastrukturën e *Mabetex*-it në Moskë të kryheshin punimet e

vrazhdëta, ndarja e mureve, punët dekorative të gjipsit dhe punimet elektrike e sanitaro-teknike. Kurse parketi, mermeri, portalet e ndryshme, llampadarët, dyert e dritaret, bashkë me mobiljet dhe stolisjet e tjera, do të vinin nga jashtë me aeroplan, ndërsa firmat prej të cilave i bleja, do të garantonin montimin e tyre. Flitej për një çmim prej 38 milionë dollarësh. Pas katër orësh filloi konferenca për të cilën unë isha i pajisur shumë mirë, me materialet që ndërkohë sigurova me telefon dhe telefax. Konferenca zgjati shumë pak. U morëm vesh për çdo gjë. U ktheva në zyrë në Moskë dhe puna filloi. Të nesërmen realizuam hyrjen e makinave, vinçave dhe punëtorëve të *Mabetex*-it në Kremlin. Atyre iu shtua edhe një brigadë e Ushtrisë që ishte në kazermë në Kremlin. Këta të fundit bënë thyerjen e mureve dhe bartjen e materialeve. Të njëjtën mbrëmje filloi dhe projektimi i teknikës sanitare dhe elektrike. Punët këtu i udhëhiqte im vëlla, Agimi. Në të njëjtën natë unë udhëtova për Milano dhe pa fjetur fare fillova t'i vizitoj sallat e ekspozitave të fabrikave me të cilat kisha kontraktuar. Atë ditë edhe pse shumë i lodhur arrita të përzgjidhja dhe kontraktotja çdo gjë që më nevojitej. Departamenti i Transportit në *Mabetex* porositi edhe avionët që duhej të vinin, menjëherë. Ne e kishim një eksperiencë për këtë nga Shtëpia e Bardhë dhe tani e kishim më lehtë për të vepruar. Çdo gjë ndodhi siç ishte planifikuar. Ndërtimet u kryen, u stolisën. Dritaret dhe parketi u montuan dhe u varën llampadarët. Nyjet sanitare u ridizajnuan dhe u mbështollën me mermer nga Carrara. Në kuadër të këtij kati e shpalosëm korridorin e gjerë tri metra me lartësi mbi pesë metra, të para vitit 1917. Për fat dekorimet kishin mbetur ashtu siç kishin qenë, të mbuluara vetëm me mure gjipsi. Filluam restaurimin e tyre, me një grup ekspertësh nga Firenca. Në muret e korridorit dhe të kthinave u varën pikturat që vinin nga muzeu "Pushkin". Me një fjalë, pikërisht në ditën e 18-të prej fillimit të punëve, gjegjësisht në fund të javës së parë të prillit 1994, çdo gjë ishte e gatshme.

Kur u kthye nga vizita në SHBA, Boris Jelcini mbeti i mahnitur. Nuk u besonte syve. Më shumë se dy orë kaloi duke vizituar objektin, pa pushuar fare. Dhe kishte arsye të ishte i mahnitur, sepse, në fund të fundit, Boris Jelcini për nga profesioni ishte ndërtimtar arkitekt dhe e kuptonte se të rinovosh me këtë cilësi 3 mijë metra katrorë për



tri javë nuk ishte shaka.

Për këtë punë Jelcini më dekoroi me një medalje mirënjohjeje që i jepej njerëzve si një vlerësim për suksesin e tyre dhe në përfundim të ceremonisë drekuam së bashku. Gjatë drekës atij i interesonte se si kishim punuar, pasi që sipas tij çdo gjë ishte bërë me masë, edhe pse unë mendoja se dritaret nuk i përshtateshin ansamblit arkitektonik të Kremlinit, punë që u përkrye më vonë. Pas takimit me Jelcinin mora edhe shumë lëvdata dhe falënderime të tjera, u nënshkrua protokolli i kryerjes së punëve dhe u ekzekutua pagesa. Këtu kisha rikthyer edhe një pjesë të humbjes, me mirëkuptimin e klientit, kështu që u paguan gjithsej 48 milionë dollarë. Nga kjo kontratë nuk patëm ndonjë fitim të madh, por imazhi i *Mabetex*-it u ngrit në qiell.

Arritëm kështu, në verë të vitit 1994. Pikërisht atëherë Boris Jelcini kërkoi restaurimin dhe kthimin në shkëlqimin e mëparshëm të ndërtesës kryesore të Kremlinit, Korpusit I të Kremlinit, atë pjesë të Pallatit të Carit brenda mureve historike, ku ndodhej rezidenca e tij private, studioja e tij, salla e pritjeve, etj. Jelcini dëshironte që Moska të kishte një mjedis reprezentativ dhe të dinjitetshëm, për të pritur personalitetet e huaja. Një vend që do të lidhte të shkuarën historike dhe të tashmen e ndryshuar, jokomuniste, por që njëkohësisht do të ishte në harmoni me një Rusi me fuqi dhe dinjitet të ringritur siç ishte ambicia e drejtuesve të asaj kohe. Këto ide ai ia kishte shfaqur Borodinit, duke i thënë njëkohësisht se do të dëshironte diçka të ngjashme me zyrat e Korpusit 14.

“Ftojeni Behgjetin”, i thotë Pavël Borodinit. “Dua ta takoj!”.

U takuam në fillim të qershorit në Kremlin, pikërisht në zyrat e sapondërtuara të Korpusit 14. Dua të nënvizoj këtu se për anën njerëzore të këtij burrështetasi do të ruaj gjithnjë një respekt të jashtëzakonshëm. Ishte njeri popullor, shumë komunikativ, por i vendosur. Në publik kishte paraqitje të shlrirë, jokonvencionale, kurse në punët e shtetit dukej shumë i saktë. Te rrethi i tij i bashkëpunëtorëve gëzonte autoritet të madh. Madje mund të them se, përveç respektit që impononte pozita e tij, qytetarët e donin jo vetëm si udhëheqës, por edhe si njeri. Më bënte përshtypje sidomos spontaniteti i tij në komunikim dhe afërsia që krijonte me njerëzit posaçërisht. Në historinë e Ruisë, por edhe të botës, ai do të zërë

një vend të rëndësishëm, sepse ishin vendimet e tij të guximshme që i dhanë fund procesit të shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik, simbolit të komunizmit botëror dhe ky nuk është thjesht mendimi im. Të kuptohemi, unë i referohem pjesës njerëzore dhe ndoshta në gjykimin e tij politik, mbase dhe gaboj, për më shumë unë po shfaq gjykimet e mia të ndërtuara mbi bazën e njohurive që kisha atëherë për çështjet politike. Asokohe unë nuk isha politikan, nuk aspiroja të merrem me politikë, nuk kisha në dorë instrumente për ta kuptuar politikën e madhe sidomos të një vendi si Rusia. Nëse sot do të sillesha si politikan i modës, “politikan i suksesshëm”, që vendos ta retushojë biografinë e vet, do t’i hyja me të shara Jelcinit dhe do ta ngjyeja me bojë të zezë portretin e tij. Jo, po bëj diçka tjetër. Gjykimet e mia të atëhershme, apo dhe të mëvonshme për Jelcinin, Rusinë, dhe qëndrimin e saj ndaj Kosovës, do t’i plotësoj apo do t’i përballë me ato të disa figurave për të cilat populli im, ka nderim dhe respekt të palëkundur. Jam mbështetur në disa vepra të autorëve perëndimorë, por veçanërisht të disa librave biografikë si ai i Presidentit Klinton dhe i zonjës Ollbrajt (Madeleine Albright). Më vjen mirë që megjithëse politika nuk ishte fusha ime, kam arritur në të njëjtat përfundime me ta. Më bën përshtypje që Presidenti Klinton ka të njëjtat gjykime për anën njerëzore të Jelcinit, duke zhbërë shumë mite negative për të. “Siç e dinë të gjithë Jelcini kishte dobësi për vodkën, por në përgjithësi në të gjithë bisedimet tona e kishte mendjen akull, ishte i përgatitur mirë dhe i efektshëm në përfaqësimin e vendit të tij. Në krahasim me zgjidhjet e tjera të mundshme, ishte fat për Rusinë që e kishte në drejtim. E donte vendin e tij, e kishte neveri komunizmin dhe donte që Rusia t’i kishte të dyja: të ishte e fuqishme dhe e drejtë,” thotë Klintoni për Jelcinin në librin e tij autobiografik *Jeta ime*, të botuar edhe në shqip. Presidenti Klinton m’i ka shprehur edhe mua personalisht konsideratat e tij për Jelcinin gjatë qëndrimit në Moskë në fund të viteve '90 në një mjedis çlodhës, kur Jelcinit iu desh të largohej përkohësisht për një bisedë pune. “Ky është një burrë i sinqertë, edhe pse ndonjëherë e kap delli i vodkës. Por drejtimi në të cilin mund të futet Rusia e çon në dëshpërim atë. Ai gjakon t’ia ndërrojë kursin Ruisë dhe ne duhet ta ndihmojmë atë për këtë qëllim”, u shpreh Presidenti

Klinton sinqerisht. Edhe Hillari Klinton, që sot është Sekretare e Shtetit e SHBA-ve, u bashkohet konsideratave të të shoqit për Jelcinin dhe bashkëshorten e tij në një libër autobiografik të saj. Nuk më duken vlerësime kortezie, apo diplomatike, pasi Jelcini nuk është gjallë. Ajo e konsideron atë si hero të Rusisë, sepse e shpëtoi dy herë demokracinë ruse më 1991 dhe më 1993, përballë sulmit të neokomunistëve (Hillari Klinton, *Historia e jetës sime*, botimi shqip, f. 509). Por si President i *Mabetex*-it, kompanisë që hyri në histori duke rindërtuar Kremlinin, kam përfituar kënaqësi të madhe duke lexuar vlerësimet sipërore të Hillarit, qoftë për sallën Shën Katerina, qoftë për sallën Shën Vladimir, qoftë për sallën e faqeve me shumë pasqyra, që ajo e konsideron “si një nga më të bukurat që kam parë në të gjithë botën” (f. 276). Më kapi krenaria e ndërtuesit. Njeri jam dhe unë! Janë punët tona, të *Mabetex*-it.

Siç do të tregoj më vonë, edhe për Kosovën Jelcini kontribuoi aq sa mundi brenda kufizimeve të shtetit që përfaqësonte duke punuar me amerikanët, me NATO-n, në momente kyçe. Sigurisht ai nuk e donte Kosovën siç mund ta donin amerikanët dhe disa të gjëra i ka bërë në shkëmbim të atyre që amerikanët i ofruan që në fillim të përplasjeve të veta me Dumën, me oligarkët. Në zgjedhjen që ai duhet të bënte midis 200 milionë rusëve që më së shumti e urrenin Kosovën dhe miqve si unë, ai sigurisht do të zgjidhte rusët, nëse ndonjëherë e ka shtruar këtë dilemë. Më kujtohet dhe një shkrim egërsie i tij kundër Kosovës në një mbledhje të OKB.

Por marrë në tërësi, gjithë çka bëri ai, as që mund të mendohet se do të ndodhte nëse në krye të Rusisë do të ishte dikush tjetër, si p.sh. Putini. Jelcini nuk pengoi bombardimet, i legjitimoi ato me vendimet e mëpasme, por për këtë temë do të flas pak më poshtë. Sigurisht unë nuk kisha iluzione as atëherë, as sot: Jelcini ishte rus, kreu i një shteti armiqësor ndaj nesh, për arsye historike apo të zonave tradicionale të influencës që donte të ruante një vend i madh si Rusia. Por roli i tij, i administratës që udhëhoqi ai ishte paksa më pozitiv se ç’do të ishte i dikujt tjetër.

Por le të kthehemi tek takimi me Jelcinin që ndodhi menjëherë pas ristrukturimit të zyrës së tij. Biseduam gjatë dhe pas bisedës, bëmë edhe një fotografi. As ai dhe as unë atëbotë nuk mund ta merrnim



*Presidenti Jelcin hyn për herë të parë në zyrën e restauruar, së bashku me, z. Çerno-mirdin, z. Lushkov, z. Shoskovec, zv.kryeministër i parë i Rusisë dhe z. Borodin, 1996*

me mend se ishte pikërisht ajo fotografi që do t'u shërbente medieve për spekulime nga më të ndryshmet, madje edhe për rrëfime nga më të pabesueshmet.

Çështjen e rinovimit të Korpusit I të Kremlinit e mori përsëri në dorë Pavel Borodini. Më duhet të bëj edhe këtu një digresion dhe të them se edhe njohja me Borodinin paraqet një episod mbresëlënës të raporteve të mia me njerëz të rëndësishëm të nomenklaturës ruse. Jelcini kishte ditur të afronte pranë vetes një njeri vërtet të jashtëzakonshëm, një burrë të mençur dhe të urtë, organizator i mirë i punëve dhe njohës i shkëlqyer i rrethanave politike. Vlen të theksohet edhe fakti që Borodini gjatë tërë jetës së tij ishte përpjekur t'i ndihmonte të tjerët. Njerëzillëkun e tij e shpjegon më së miri fakti se ai kishte adoptuar katër fëmijë jetimë, njërin prej të cilëve e mori të sapolindur, anise fëmija ishte i sëmurë. E mbajti plot 23 vjet atë

djalë, e mjekoi, i shërbeu, derisa e mori vdekja. Me mua ka qenë gjithmonë shumë korrekt dhe i ndershëm. Kam pasur dhe vazhdoj të kem respekt për të dhe gjithnjë e kam vlerësuar për cilësitë e shumta që kishte.

Pas këtij prezantimi të njeriut me të cilin do të punoja më së shumti asokohe, dua të shpjegoj fazën e përgatitjes së *Mabetex*-it për kontratën e vërtetë të Kremlinit. Ishte e vërtetë se ne tashmë gëzonim një avantazh të madh, nga punët cilësore që kishim kryer deri atëherë, e pse jo dhe nga njohjet, që ishin garanci se të paktën do të trajtoheshim mirë dhe drejtësisht. Por, megjithatë, prezantimi sa më cilësor, sa më i plotë, sa më i saktë kishte rëndësi vendimtare. Sepse bëhej fjalë për një projekt shumë të madh. Dhe unë e dija se do të kishte shumë konkurrentë. Tani nuk është sekret të them se kontrata e Kremlinit, në tërësinë e saj, kishte vlerë miliardëshe, pra, një shumë fantastike.

Por, si i bëme përgatitjet? Kisha dëgjuar se Jelcini donte kthimin e pamjes së Kremlinit si në kohën e Carit, se këtë çështje ai e shihte jo vetëm si prestigj të Rusisë, siç e thamë më parë, por edhe si një kundërvënie të hapur komunistëve, të cilët i kërcënoheshin nga të gjitha anët. Pa i thënë kujt asgjë, shkova në Bibliotekë, në arkiv dhe atje e gjeta projektin e Kremlinit të vitit 1720. E mora projektin duke lënë një kaucion të majmë dhe e solla në Lugano. Pastaj thirra një grup ekspertësh nga Italia dhe një nga Shën Peterburgu, të njohur për punë restaurimesh, ndërsa këta të fundit për vlerat historike. E morëm atë projekt, krijuam vizatime tredimensionale, saktësuam se çfarë duhej rinovuar, duke kthyer çdo gjë në pamjen e dikurshme. U bënë më tepër se 500 kilogramë letra, të cilat unë i çova në Moskë. Atje hapa një ekspozitë, në të cilën erdhi edhe Jelcini. Unë i bëra shpjegimet e nevojshme, se çfarë synohej, si do të dukej çdo gjë. Jelcini, kureshtar dhe i kënaqur, tundte kokën në shenjë miratimi. Por kjo gjithsesi, nuk mjaftonte. Tenderi megjithatë do të shpallej, sepse kështu e kërkonin rregullat.

Tenderi u hap me një afat prej 30 ditësh për t'u përgatitur. U paraqitën shumë firma të interesuara nga e tërë bota. Në fazën e parë u eliminuan gati gjysma e tyre, sepse nuk i plotësonin kushtet elementare. Komisioni u mblodh sërish dhe përzgjedhi përfundimisht katër

firma: *Filip Hofmann* nga Gjermania, *Mabetex* nga Zvicra, *Impregilo* nga Italia dhe, me sa më kujtohet, edhe *Beuige* nga Franca. Tani, pasi seleksionimi kishte arritur në këtë fazë, duhej bërë edhe prezantimi përfundimtar, me dokumente, me kalkulime, me të gjitha elementet. Më kujtohet si sot, ka qenë fundvera e vitit 1994. Atëbotë ndodhi diçka shumë interesante, që pastaj do të kishte implikime në zhvillimet e mëvonshme. I ftuar prej tij, një mëngjes unë shkova në një pritje te Jelcini. Nuk më kujtohet saktësisht data. Sekretari i tij, në hyrje, i tha Borodinit se takimin duhej ta kryenim sa më shpejt, sepse Presidenti kishte caktuar një takim tjetër. Këtë Borodini e mori si me humor dhe vazhdoi t'i tregonte batuta sekretarit. Unë e shikoja dhe e kuptoja se sekretarit nuk i interesonin batutat e Borodinit, por i interesonte që ne të hynim dhe të dilnim sa më shpejt te Presidenti. Në zyrën e Jelcinit, rreth filxhanave të çajit, zhvilluam një bisedë të këndshme. Jelcini vazhdimisht pyeste për shëndetin e prindërve të mi dhe dëgjonte me interes përgjigjeten time. Ashtu ndodhi dhe atë ditë. Por në anën tjetër, në tavolinën ku ishim ulur dëgjohej një zile që binte lehtë, shumë lehtë. Ishte sinjal për Presidentin se 20 minutat protokollare kishin kaluar, por ai e injoronte atë sinjal sikur të mos ekzistonte. Bëmë edhe disa fotografi te portalet e zyrës së tij të “improvizuar” nga *Mabetex*-i për tri javë. Në këtë e sipër, sekretari i tij hyri dhe në një mënyrë fine i dha shenjë Presidentit për një delegacion tjetër që po e priste. Por biseda jonë vazhdoi edhe shumë kohë. Ai rrëfeu se do të donte një Kremlin krejtësisht ndryshe dhe se asgjë nuk duhej të mbeste nga e kaluara. Ambientet duhet të rimerrnin shkëlqimin e dikurshëm, sikurse edhe zyra në të cilën ishim. Pasi e përfunduam bisedën, dolëm nga zyra, ndërsa unë i kërkova falje sekretarit.

“S’ka gjë, jo”, më thotë. “Çdo gjë në rregull”, por në sytë e tij shihej një nervozizëm sikur donte të thoshte diçka. Duke dalë nga zyra në koridor m’u bë se dikush përmendi edhe emrin e Anjelit (Gianni Agnelli).

Dukej se vërtet ashtu ishte, sepse, me t’u kthyer në hotel, pashë anëtarët e delegacionit italian që ecnin nëpër holl, nervozë dhe të shqetësuar. M’u dukën shumë, dhe njëri prej tyre i përngjante Anjelit. Po bëheshin gati të shkonin në aeroport dhe të iknin nga Moska. Si



*Me Presidentin e SHBA-ve Klinton, Presidentin rus Jelcin dhe z. Borodin, 1996*

duket Presidenti Jelcin nuk e kishte pranuar këtë delegacion. Oferta e *Mabetex*-it, kërkesat e kontratës, raporti i çmimeve me cilësinë etj., u konsideruan më të mirat dhe më me leverdi se të gjitha ofertat e tjera. Kontratën e firmosa unë me drejtorin e *Technoproimport*-it dhe mund të them se ajo ishte ditë e shënuar për *Mabetex*-in, qoftë për shkak të vlerës së kontratës, qoftë për prestigjin që firma do ta arrinte me këtë projekt.

Duke shikuar nga kjo distancë kohore dhjetëra e qindra fotografi të procesit të punës, të specialistëve të talentuar të palodhur kosovarë, me një ndjenjë respekti të thellë përsëris me vete për të satën herë: askush nuk mund ta imagjinojë se me ç'zell kanë punuar shqiptarët e Kosovës ato ditë. Ishin të ndarë në katër turne dhe as bukë nuk



*Hoteli me 5 yje Golden Rings në Moskë, 1997,  
hoteli i parë, pronë e Mabetex-it*

*dorë është punëtor. Kush punon me dorë dhe mendje, është artizan. Kush punon me dorë, mendje dhe zemër është artist. Shqiptarët e Mabetex-it janë artistë!*

Kështu shqiptarët e Mabetex-it u bënë të rëndësishëm në Kremlin. Më bente përshtypje se as rojet speciale nuk i ndalnin ata për kontroll. Fjala Mabetex ishte një lloj lejekalimi për të gjithë ata, kudo që hynin.

Në të vërtetë, kishte dy qëndrime ndaj nesh në Moskë. Në njërin anë ishin mbështetësit e Jelcinit, te të cilit gëzonim respekt të madh, kurse në anën tjetër ishin komunistët e Dumas ruse, të cilët

kishin kohë të hahnin. Në ato sallone, ku në të ardhmen do të vinin kryetarë të shteteve të mbarë globit, ata hapnin projektet, bënin analizat, shqyrtonin zgjidhjet dhe me një vrull që zor që mund të përshekruhet, ia nisnin sërish punës. Ishte një afirmim i shqiptarësisë në nivelin më të lartë, i kreativitetit të tyre, i aftësive të tyre profesionale, i korrektesisë. Dhe ku? Në zemër të perandorisë së dikurshme ruse, Kremlin. Më kujtohej një thënie e Shën Françeskut: *kush punon me*



më dukej se nuk e fshihnin mosdurimin ndaj nesh. Kishte edhe një lidhje të çuditshme ndërmjet tyre, KGB-së së pareformuar akoma dhe Ministrisë së Jashtme të Rusisë. Ishte kjo një “eminencë” politiko-administrative, e cila mbahej ende nëpër institucione, organe politike dhe shtetërore, të cilat nuk dihej nëse i lidhte mes tyre ideja e pansllavizmit, apo i nacional-komunizmit. Apo që të dyja.



*Në Kremlin, me Presidentin rus, Boris Jelcin,  
pas dekorimit, 1997*

Pavarësisht se cila nga këto mbizotëronte, për ta prania e shqiptarëve në Kremlin ishte halë në sy, madje diçka që i irritonte dhe i frustronte pa masë. Nuk do mend, në këtë mes hynte edhe njëfarë xhelozie e smire, sepse ata nuk mund ta shikonin me indiferencë faktin se, dhjetë minuta pasi arrija në Aeroportin e Moskës, fillonin telefonatat e mia me atë rang njerëzish që ata do të donin të ishte i tyre. Në mesin e deputetëve të Duma`s, p. sh., kishte edhe të tillë që i kalonin katër vjet të mandatit të deputetit, pa arritur ta takonin qoftë edhe një herë Presidentin Jelcin. Ndoshta edhe kjo i frustronte ata.

Duhet të shtoj këtu se atmosfera politike në Rusi, në përgjithësi, në atë periudhë ishte mjaft konfuzë e me zhvillime të paparashikueshme. Në njërën anë, kishte ndodhur zhbërja e Bashkimit Sovjetik dhe, bashkë me të, edhe fundi i një perandorie, diçka që kishte lënduar ndjenjat dhe krenarinë kombëtare të nacional-komunistëve. Ndërsa në anën tjetër, ende nuk ishte ndërtuar një demokraci funksionale, e cila do ta zëvendësonte jo vetëm sistemin e kaluar, por edhe do të ndërtonte një sistem të ri vlerash të një shoqërie demokratike.

Në sfond të gjithë kësaj, bëhej një luftë e ashpër e oligarkive politike dhe ekonomike për të shfrytëzuar situatën e re kaotike, për zënien e pozicioneve sa më të favorshme. Pastaj, aty ishte ushtria, e cila tashmë kishte humbur jo vetëm forcën dhe shkëlqimin e dikurshëm, por edhe privilegjet dhe statusin shoqëror. Aty ishte KGB-ja e pareformuar, por me pretendime shumë të qarta për të ruajtur interesat e veta dhe të oligarkëve të asaj prejardhjeje.

Përveç kësaj, një administratë e madhe qendrore burokratike ishte shpërbërë dhe tani duhej të ndërtohej një tjetër, shumë më funksionale dhe e racionalizuar në raport me shtetin e ri, brenda të cilit nuk ishin më 15 republika sovjetike, që ishin kthyer në shtete sovraane, por të tjera njësi territoriale-politike me subordinim shtetëror të tjetër lloji dhe tjetër natyre. Megjithatë, mënyra e qeverisjes në pushtetin qendror ende nuk kishte ndryshuar tërësisht. Punohej me një formë mikse të qeverisjes, me vendime qeverie dhe të dikastereve përkatëse, por më shumë me urdhra dhe dekrete.

Në planin ekonomik, gjendja ishte edhe më e keqe. Periudha e gjatë e socializmit kishte lënë prapa gjigantë të rrëzuar përtokë dhe mijëra e mijëra ndërmarrje të vogla e të mëdha, të cilat ose duhej të mbylleshin, duke lënë në rrugë qindra mijëra punëtorë, ose duhej të rivitalizoheshin, duke riprogramuar prodhimin e tyre sipas standardeve të reja dhe sipas kërkesave të tregut. Ekonomia e centralizuar nuk funksiononte më, por as ekonomia e tregut nuk kishte arritur ende të konsolidohej. Në shumë sektorë, kapacitetet prodhuese duhej të ribëheshin nga e para. Infrastruktura gjithashtu. Kjo gjendje e rëndë ekonomike kishte lënë prapa pasoja të mëdha sociale. Kishte rënie të standardit, të cilësisë së jetës, sikundër edhe mungesa të mëdha të produkteve elementare të jetës së përditshme. Kur t'i shtosh gjithë kësaj tabloje edhe luftën e ashpër për pushtet midis ideologjive tashmë kundërshtarë, mes pikëpamjeve dhe koncepteve të ndryshme politike, por, mbi të gjitha, midis klaneve dhe oligarkive jashtëzakonisht të fuqishme, pasqyra e Rusisë dukej mjaft e turbullt, veçmas në pikëpamje të zhvillimit ekonomik e të biznesit.

A kishte kjo situatë pasoja në punën tonë? Gjithsesi. Nuk ishte e lehtë ta njihje dhe ta pranoje këtë ambient ekonomik-politik, nga

njëra anë, sikundër që ishte po aq e vështirë të veproje pa shkaktuar fërkime e përplasje. Sikundër e thamë më sipër, kundërshtarët më të egër të angazhimeve tona, veçmas në Kremlin, ishin komunistët. Por nuk ishin vetëm ata. Atëherë, si duhej vepruar, çfarë duhej bërë? Duhej ecur me kujdes, duke iu përmbajtur gjithmonë një parimi: biznesi ynë nuk duhej të kishte asnjë lidhje me zhvillimet politike, me kontradiktat e brendshme ose konfliktet e hapura ose të fshehta politike. Nuk duhej të përziheshim në asnjë skemë dhe në asnjë prapaskenë. Duhej të mbështeteshim kryekëput në parimet dhe rregullat e biznesit, gjithnjë me një respektim rigoroz të ligjit dhe të autoritetit shtetëror, respektivisht institucional. Më kujtohet se sapo mbërrija në aeroportin Vnukovo, dhe merrja makinën për në qytet, ishte e pamundur të mos dëgjoja komente kritike të së majtës (Partisë Komuniste të Zhuganovit (Ziuganov), asaj Agrare të Luzhkovit (Lushkov) dhe grupimeve të tjera që në Dumën e Ruisë kishin krijuar një shumicë të qëndrueshme) ndaj Presidentit Jelcin, i cili, sipas tyre, po e rrëronte krenarinë kombëtare të Ruisë, me egon e dikurshme perandorake. Rusia, vazhdonin ata, nuk po mbron vëllezërit e vet serbë, kurse ai, Jelcini, ka lejuar që punët e Serbisë, fatin e saj ta trajtonin të tjerët dhe jo Rusia. Po ky grup parlamentar erdhi para bombardimeve në Beograd dhe kontaktoi me homologët e vet serbë, pikërisht për të diskutuar bashkimin institucional të Serbisë, me Rusinë, njëlloj mase për t'i shmangur bombardimet. Pas kthimit ata propozuan një rezolutë, ku i kërkonin Ruisë të punonte në këtë qëllim. Jelcini e refuzoi kategorikisht këtë ide. Në vigjilje të bombardimeve të NATO-s në Serbi, kur parlamenti rus po diskutonte idenë e dërgimit të vullnetarëve në ndihmë të Serbisë, Presidenti i Tatarstanit Gantimir Shumaev e bëri të heshtë sallën kur tha: "Nëse ju doni të dërgoni vullnetarë në krah të serbëve, çfarë duhet t'u them unë 22 mijë bashkëkombasve të mi që po presin të shkojnë në ndihmë vëllezërve të tyre shqiptarë në Kosovë?" Qëndrim të ngjashëm mbajti dhe Presidenti i një republike tjetër myslimane, ai i Bashkortostanit, Murtazai Rakhimov.

Kritikat ndaj Jelcinit intensifikoheshin pikërisht prej lëshimeve të tij ndaj Perëndimit për çështjen e Kosovës. Këtë presion ndaj Jelcinit grupimi komunist e ushqente dhe me një argument tjetër- roli

im në ndërtimet e Kremlinit. Sipas tyre, Jelcini toleron një individ të maskuar me pasaportë zvicerane, por në fakt një shqiptar Kosove, që vinte prej atij vendi ku "terrorizoheshin vëllezërit serbë". Presidenti ynë - thoshin ata - i hap dyert dikujt që vjen nga Kosova, i jep paratë e Ruisë këtij individ, para që përdoreshin për të ndihmuar UÇK-në, për të vrarë serbë, dhunuar varrezat, gratë serbe. Këto sulme Jelcinit nuk i bënë ndonjë përshtypje të madhe, ndërsa mua më krijonin një lloj shqetësimi. Për shkak të këtij presion ai më porosiste vazhdimisht që të kujdesesha për sigurinë time.

Për këtë çështje Jelcini, nisur nga vendi që drejtonte, pozicionimi i opinionit publik, i një pjese të rëndësishme të institucioneve të Ruisë, kishte një vizion realist i cili mbështetej edhe në informacione të drejtpërdrejta nga Kosova. Kurdo që binte fjala, ai më thoshte se klima politike e krijuar rreth Kosovës, ishte edhe pasojë e mediave, që krijojnë opinionin publik. Sipas tij, mediat ruse ofronin pamje të shtrembëruara të realitetit në Kosovë pasi që ata raportonin nga Beogradi. Andaj nuk do të ishte keq, më sugjeronte ai, që ti të organizosh një udhëtim me gazetarë të mediave kryesore ruse në Kosovë dhe ta shohin vetë realitetin e atjeshëm. Unë e bëra këtë në vitin 1997, kur me logjistikën e kompanisë sime solla një grup të madh gazetarësh të Ruisë, të cilët takuan të gjitha palët në Kosovë. Ata shkuan edhe në Drenicë e në Malishevë, ku kontaktuan me njerëzit e UÇK-së. Policia serbe i pengonte shpesh këto kontakte, madje siç më njoftuan, dikush nga ata që shkruante për Pravdën, u rrah prej policëve, ngaqë u kishte thënë serbëve se "UÇK-ja i kishte trajtuar mirë". Një pjesë e tyre filloi të raportonte në mënyrë të drejtë, dhe këtu do veçuar korrespondenti i radios *Evropa e Lirë*, Soloviev, i cili për 20 ditë raportoi saktë nga terreni. Për këtë aksion mediatik mora komplimente nga shumë miq të mi në Rusi, të cilët e kishin ndjerë ndryshimin e dukshëm të cilësisë së informacionit që vinte nga vatra e luftës.

Sidoqoftë, punimet për restaurimin e Kremlinit përfunduan në afat rekord. Data e dorëzimit ishte caktuar më 2 shkurt 1996, që ishte njëkohësisht edhe ditëlindja e Boris Jelcinit. Korpusi 1 i Kremlinit përfshinte zyrat e Presidentit, sallat e shumta të mbledhjeve, rezidencën dhe apartamentin privat dhe të mysafirëve, një bibliotekë

madhështore. Në bodrumin e gjithë ndërtesës ishte e ashtuquajtura “salla e situatave”, sallë kjo ku ishte e përqendruar e gjithë forca e Presidentit të Rusisë. Nga këtu kontrollohej në mënyrë satelitore çdo kënd i Rusisë dhe bëhej telekomunikimi me gjithë Rusinë. Ishin lidhjet si quheshin dikur të “teletajpit të kuq”. Nga kjo sallë mund të jepeshin edhe urdhrat e garantuara me kushtetutë, si fillimi i luftës dhe lansimi i raketave bërthamore. Kishte lidhje të drejtpërdrejta satelitore tredimensionale me çdo poligon të rëndësishëm ushtarak. Nuk kishte asgjë të nevojshme për Presidentin e që nuk e kishte ky pallat. Aty gjendeshin gjithë ambientet presidenciale, vendi prej nga drejtohej shteti. Së këndejmi, e tërë kjo kishte edhe një karakter simbolik për Rusinë, për qeverinë, për vetë Jelcinin. Për mua nuk ishte vetëm një frymëzim në planin e suksesit individual, por edhe një sfidë në aspektin profesional. Kur e shihja tërë atë që ishte bërë, ndihesha krenar. Ishte vërtet një kryevepër jo vetëm në planin arkitonik, por edhe në atë artistik.

Më kujtohet se Pavël Borodini ishte ai që i bënte prezantimet në ditën e inagurimit.

“Zoti President, iu drejtua ai Jelcinit, më lejoni t’ua prezantoj zotin Pacolli, Presidentin e *Mabetex*-it, i cili me punëtorët e tij bëri këtë mrekulli.”

Jelcini, që shihej qartë se ishte tejet i kënaqur, iu kthye Borodinit:

“Po, Pavel Paveliç, unë e njoh zotin Pacolli. Ai është i njohuri im i vjetër... Isha unë ai që jua propozova firmën e tij. Ju kujtohet kur ju thashë: drejtohuni atij që ka ndërtuar Pallatin e Kongreseve të Jakutskit. Kur ju propozova edhe juve që të vinit në Moskë të punonit me mua.”

Jelcini vazhdoi të fliste me entuziazëm, me një qëndrim miqësor dhe me çiltëri, ndaj meje dhe ndaj bashkëpunëtorëve të tij.

“Ju mbaj mend mirë, zoti Pacolli. Më kujtohet edhe kur u takuam në zyrën time, me rastin e dorëzimit të punimeve të Korpusit 14, dy vjet më parë...” Sigurisht që ai më kujtonte mirë, pasi që ishim takuar shpesh, por para të tjerëve e ndiente nevojën ta arsyetonte propozimin që kishte bërë për të më zgjedhur mua.

Pastaj u kthye nga bashkëpunëtorët e tij:

“Tani, ejani të shohim se çfarë është bërë këtu. Nuk kemi gabuar

që këtë punë ia besuam këtij njeriu. Nuk besoj se do të zhgënjehem, sepse edhe herë të tjera zoti Pacolli ka punuar në mënyrë të shkëlqyer. Me partnerë të tillë ne duhet të punojmë...”

Nuk ishte vështirë të kuptohej se Jelcini, dhe bashkëpunëtorët e tij, ishin shumë të kënaqur me atë që shihnin. Shikonin të entuziazmuar. I kishin bërë sytë katër. Nuk ishte vetëm fakti se që shihnin diçka vërtet të bukur, që mund t'i linte mbresa çdo vizitori, por ata bënë krahasime me atë që ishin mësuar të shihnin prej shumë vitesh, në ato mjedise të errëta e të ngrysur, pa dritë, pa gjallëri, pa asgjë artistike dhe funksionale. Tani çdo gjë ishte ndryshe! Shkëlqente.

Unë e kuptoja entuziazmin e tyre. Ruisë së rrënuar dhe të plagosur aq gjatë nga komunizimi, kishte filluar t'i kthehej shkëlqimi i dikurshëm. Ata ndiheshin krenarë për këtë. E quanin meritë të tyre, që kishin arritur, në një situatë ende të turbullt, t'i jepnin shkëlqim Kremlinit, simbolit të një shteti të madh e të fuqishëm, i cili sikur kishte filluar të rilindte pikërisht nga ato ambiente, nga ato salla, nga ato zyra.

Dhe jo vetëm kaq. Rusia synonte të ridimensiononte rolin e saj ndërkombëtar. Për këtë rol të ri ndërkombëtar, duhej edhe një pamje e re, një prezantim i ri, i dinjitetshëm, ekuivalent me forcën, rolin dhe madhësinë e saj. Kremli me imazh të ri, ndryshe nga ai i dikurshmi, përcillte pikërisht këtë mesazh, veçmas te burrështetasit e huaj, të cilët për një kohë të gjatë e kishin anashkaluar Rusinë.

Për mendimin tim, Rusia kishte ndryshuar jo me Gorbaçovin, por më pas me Jelcinin. Jelcini ishte bërë sinonim i marrëdhënieve të shtensionuara Lindje-Perëndim. Ai ishte bërë njeri i dashur dhe i respektuar për burrështetasit perëndimorë. Por nacionalistët rusë hungëronin në shenjë pakënaqësie, duke thënë se Jelcini nuk e përfaqësonte Rusinë në mënyrë të dinjitetshme dhe se vetë Rusia shfaqej me krenari të lënduar para të huajve.

Kremlini i rinovuar nuk shfaqte një pamje të mrekullueshme vetëm për establishmentin shtetëror rus, që pas një jete të gjatë në socializëm, mund të “verboheshin” edhe nga një shkëlqim i rremë; Kremli i rinovuar ishte një befasi edhe për burrat e shteteve më të fuqishme të botës. Se ishte kështu, më bindën xhirimet nga takimi G7+1, siç quhej atëherë Grupi G8, pra i shtatë vendeve më të zhvilluara të botës plus Ruisë, i cili në Moskë u mbajt për herë

të parë, në pranverën e vitit 1996. Në ato xhirime shihen Shiraku, Koli, Klintoni etj., që shikojnë të mrekulluar mjediset e Kremlinit të rinovuara, ndërkohë që Jelcini, i kënaqur e i buzëqeshur, u printe nga një sallë në tjetrën.

Pra, thënë ndryshe, fjala ishte për një vepër mbresëlënëse në përmasa botërore. Nga ana tjetër, supozimi se restaurimi mund të ishte bërë sa për t'u dhënë një shkëlqim të çastit atyre ambienteve, bie poshtë me faktin se edhe sot e kësaj dite, sikundër mund të shihet gjatë ceremonive të ndryshme në Kremlin, çdo gjë në ato ambiente ka të njëjtën pamje madhështore.

Dikush mund të pyesë, si e arriti këtë *Mabetex*-i? Me punë dhe me përkushtim të jashtëzakonshëm, madje duke shkurtuar afatet e dorëzimit të objektit në 14 muaj. Punuan këtu ditë e natë, dy dimra të ftohtë rusë dhe një verë të nxehtë moskovite, rreth tre mijë punëtorë, shumica nga Kosova, pastaj specialistët më të mirë italianë, kosovarë dhe shqiptarë nga Shqipëria. Unë personalisht mora përsipër rrezikun më të madh, jo vetëm pse në njëfarë mënyre vura në bast reputacionin e firmës sime, e cila deri atëherë kishte fituar nam të mirë, por bëra edhe veprime të tjera tepër të guximshme: urdhërova fillimin e punëve që të nesërmen e nënshkruajtë kontratës, pa paradhënie dhe pa pritur depozitim të garancisë bankare, që do të ishte kërkesë themelore e çdo sipërmarrësi në një punë kaq të kushtueshme.

Më pastaj, çova në Moskë firmat më të rëndësishme dhe më të njohura të Europës, veçanërisht ato italiane, të specializuara për dekor, për patinim, për punimet me dru, për dyert, kolltukët, mobiljet përgjithësisht, pajisjet elektrike, artin e ndriçimit, llambadarët etj. Zgjidhëm firmat më prestigjioze në sektorë të veçantë dhe i furnizua ato me materialet më të shtrenjta dhe më të rralla. Pastaj, specialistët më të mirë ditë e natë bënë mbikëqyrjen e punimeve, pa lejuar që në asnjë segment të kishte firo ose dështime, qoftë edhe të vogla.

Duhet të theksoj këtu se edhe përkundër rrethanave të vështirësuar në vitet në vijim, në Moskë arrita të realizoja edhe projekte të tjera të rëndësishme, nga të cilat duhet veçuar hoteli *Golden Rings*, që është hoteli më luksoz dhe më reprezentativ në

Moskë. Ai ishte një ndërtesë e vjetër, *Belgrad I* quhej dhe unë, përveç që e rinovova në tërësi, duke i dhënë pamje krejt tjetër, arrita edhe ta privatizoja. Hoteli *Golden Rings* është pjesë e *Swiss Diamond Hotels*.

Ky hotel shumë shpejt u bë i frekuentuar nga shumë delegacione të huaja që vinin për vizitë në Rusi, përfshirë edhe presidentët e vendeve të ndryshme. Nga delegacionet e para në hotel, ishin edhe ato të Kazakistanit që shumë shpejt u familjarizuan me të. Por më vonë me këtë hotel pata telashe jo të vogla, të paimagjinueshme. Pagesat nuk rridhnin si duhet. Kështu bënte vizitë shtetërore në Moskë një president nga kontinenti amerikan dhe nuk paguante. Njësoj vepronte edhe pala ruse si mikpritëse. U detyrova të kërkoja përsëri ndërhyrjen e Borodinit, me të cilin gjetëm një zgjidhje: ia dhashë hotelin qeverisë ruse me qira, me një kontratë afatgjatë. Në këto kondita funksionon edhe sot .

Pos objekteve që përmendëm në Moskë, *Mabetex*-i kishte rregulluar edhe shtëpinë ku jetonte Presidenti i Ruisë, hotelin për mysafirët Vatutinki, që shërbente për delegacionet shtetërore, i cili u shndërrua në një rezidencë të bukur, diçka e krahasueshme me një hotel 7 yjesh, i cili përveç infrastrukturës së nivelit të lartë kishte dhe 320 apartamente luksoze. Në vitin 1997, *Mabetex*-i, në rrethinat e Moskës, bëri dhe rindërtimin e rezidencës shtetërore verore, që quhej Borë. Ai ishte një kompleks mbi 60 mijë metra katrorë, me tërë infrastrukturën rekreative, fusha të golfit, të futbollit, të tenisit etj. Këtu pata takuar dhe Presidentin Klinton, të cilit i pëlqente shumë ky mjedis larg qytetit, me pisha të larta. *Mabetex*-i pati kryer dhe shumë punë të tjera, specifike, siç ishte projekti dhe modernizimi i interierit të brendshëm të avionit, të trenit, të helikopterëve të Presidentit dhe disa rezidencave zyrtare anembanë Ruisë.

Por puna më e rëndësishme ishte ajo që përmenda - rinovimi i Kremlinit. Presidenti Jelcin, bashkëpunëtorët e tij, pastaj qeveria me Çernomirdinin në krye, të gjithë pa përjashtim, mbetën jashtëzakonisht të kënaqur me cilësinë e punimeve, me realizimin e projektit, me veprën. Mirënjohja e tyre ishte e madhe dhe në shenjë falënderimi për çdo gjë që kishim bërë, për pamjen e re që kishim filluar t'ia jepnim Ruisë në ditë aq të vështira, për shpresat e një



rizgjimi jo thjesht arkitekturor nga agonia vizive komuniste, më bënë nderin më të madh që mund t'i bëhet një sipërmarrësi: më dekoruan me “Çmimin Kombëtar për Literaturën dhe Artet (Arkitekturë)”, të cilin ma akordoi Presidenti Jelcin, më 23 maj të vitit 1997.

Isha i pari qytetar zviceran që merrja një dekoratë kaq të lartë, por, siç më thoshin, isha i dyti nga të huajt që nderohej me këtë çmim, pas Armand Hamër -it (Hammer), i cili, në kohën e Leninit, i kishte dhënë ushqim Bashkimit Sovjetik, të përfshirë nga kriza e thellë dhe uria. Kjo figurë vërtet më ka frymëzuar shumë në jetën time, veçanërisht pas leximit të dy-tre librave të tij. Ishte model i njeriut të suksesshëm e human, që me një rëndësi dorë merr kurse me tjetrën jep me dëshirë e vullnet. Pas meje këtë dekoratë më duket se e ka marrë edhe Presidenti francez Zhak Shirak.

## Kazakistani, një sfidë tjetër

*Njohja me Nazarbajevin, njeriun numër një të Kazakistanit. Si i bëmë utopitë realitet në një nga vendet më të mëdha të botës, me një popull të mrekullueshëm! Provimi i financës së lartë ndërkombëtare në Azinë e largët, një mrekulli e fshehtë e një bote të re. Mabetex-i funksiononte kudo!*

Ishte e kuptueshme, që pas suksesit të madh në Kremlin, rrethanat për mua dhe *Mabetex*-in të bëheshin më të favorshme në tregun rus dhe më gjerë. Rinovimi i Kremlinit ishte një kartë identiteti, një pasaportë, e cila duhej të hapte rrugë për depërtime të reja në treg, për kontrata të reja. Kjo edhe ndodhi, për fatin e mirë timin dhe të firmës. Por unë, i përfshirë në ethet e punëve dhe në terrenin e ashpër të konkurrencës nuk isha shumë i vetëdijshëm se suksesi dhe përparësitë e mia dhe të firmës që përfaqësoja do të zgjonin edhe njëfarë xhelozie dhe smire. Nuk ishte e lehtë të përballonem pikërisht kjo luftë e ashpër e konkurrencës, sepse me efikasitetin dhe cilësitë e punëve në Kremlin kisha lënë “pas dere” firma me reputacion të madh ndërkombëtar, të cilat nuk e përballonin lehtë faktin se një firmë e re, e pasprovuar në projekte të këtilla, u kishte dhënë lëksion shumë gjigantëve të kësaj fushe. Ishte pikërisht ky fakt, bashkë me zhvillimet e tjera (politike në rend të parë) në Rusi, që më bënë objekt të sulmeve dhe intrigave të paparimta, duke synuar që me një goditje të arrinin disa efekte njëkohësisht. Ndër të tjera edhe errësimin e shkëlqimit të *Mabetex*-it dhe nxjerrjen e tij jashtë konkurrencës.

Mirëpo, siç do shihet, Kremlini më hapi një rrugë tjetër shumë të rëndësishme, atë të Kazakistanit dhe, më vonë, edhe të shteteve të rajonit të Azisë qendrore. Ishte diku vjeshta e vitit 1995 dhe punët rreth rinovimit të Kremlinit ishin në vllugun më të madh. Me ftesë të Jelcinit, atëbotë erdhi në Moskë kryetari i Kazakistanit, Nursultan Nazarbajevi. Jelcini i sugjeroi atij të shohë se çfarë është duke u bërë me rinovimin e Kremlinit, ndoshta me idenë se diçka të tillë duhej të bënte edhe ai në Kazakistan, ose thjesht për t'i treguar atij

se Rusia tashmë kishte filluar të ngrihej sërish. Më thirrën të shkoja urgjentisht në kantier, pra në Kremlin, dhe aty takova Presidentin Nazarbajev. Atij i tregova vetëm disa prej sallave prestigjioze që ishin kryer deri në atë moment. Presidenti Nazarbajev ishte njeri shumë i drejpërdrejtë e spontan. I bënë përshtypje të madhe punimet në Kremlin dhe i tha shefit të departamentit të ndërtimeve të tij, zotit Sasdik (tashmë të ndjerë), i cili udhëhiqte edhe punët e Presidentit, që të vazhdonte kontaktet me mua. Ndërsa ai vetë më tha: “Eja në Kazakistan. Edhe ne jemi duke ndërtuar një shtet të fortë!”

I ndjeri Sasdik, më dha kartëvizitën e tij dhe unë shpejt udhëtova në Kazakistan, në Almaty. Atje pata fatin të njihesha më mirë me Presidentin Nazarbajev. Takimin në Almaty me kreun e shtetit kazak e bëri të mundur miku Askar Kulibajev. Në atë takim, Presidenti Nazarbajev m’u duk krejtësisht ndryshe nga cilido President tjetër. Pragmatizmi i tij dhe dëshira e madhe për të ndërtuar një shtet të fortë, ishin pjesë e bisedës. Më kujtohet ende diçka që më tha në takimin e parë në Almaty: “Pas largimit të Jelcinit nga pushteti, ose pas vdekjes së tij, punët e tua në Moskë mund të marrin një kahje tjetër. Ke bërë shumë armiq. Sa të jetë Jelcini, nuk mund të të bëjnë asgjë, por një ditë do të të hakmerren. Prandaj, të jesh i kujdesshëm.” Fjalët e tij më ranë në mend më vonë, atëherë kur u ballafaqova me rastin e ashtuquajtur “Kremlingate”.

Presidenti Nazarbajev nuk ma fshehu situatën e keqe, në të cilën gjendej shteti i tij. "Jemi në gjendje të vështirë, fabrikat nuk punojnë, kemi probleme me ujin e pijshëm dhe energjinë elektrike. Na duhet një investitor me paratë e tij që të vijë e t’ia fillojë punës. Nëse ke para, mund të fillosh menjëherë. Kazakistani nuk do të mbetet borxh". Afërsisht, këto ishin fjalët e Presidentit Nazarbajev. Më impresionoi edhe një fjali e tij: “Miq të mi do të jenë ata që tani kontribuojnë për popullin tim”.

Po çfarë donin të bënin ata, në të vërtetë? Kazakistani sapo ishte shpallur shtet, pas shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe duhej të ndërtonte institucionet, qeverinë, parlamentin, ministritë, etj. Almaty, kryeqyteti, kishte godina të vjetra, kryesisht të kohës së komunizmit dhe të periudhës sovjetike, të cilat kishin qenë të shëmtuara që në kohën e ndërtimit, ndërsa tani kishin degraduar tërësisht.



*Me Presidentin e Kazakistanit, z. Nursultan Nazarbayev. Në sfond piktura e Gjeshosh Gjokajt në zyrat e Mabetex*

Me idenë e marrjes së një kredie, u ktheva në Lugano dhe nisa të kontaktoj bankat. As që donin të dëgjonin. Çfarë Kazakistani!? Nuk kishte njeri që mund t'i bindte, me asnjë argument. Tani, si t'i thosha Presidentit Nazarbajev që bankat nuk i besonin Kazakistani? Bëra një veprim që mund të më kushtonte shtrenjtë: i futa si garanci asetet e mia dhe mora një kredi nga *Deutsche*



*Babai, Isa, me Presidentin Nazarbajev në shtëpinë time në Montanjola, 1998*

*Morgan Greenfield Bank* në Londër, një këst të parë prej 80 milionësh dollarë. U ktheva në Almaty dhe i thashë Presidentit Nazarbajev: “Bankat i besojnë Kazakistani, të cilin e quajnë dhe e trajtojnë si të vetmin shtet të vërtetë, nga shtetet e dala nga ish-Bashkimi Sovjetik”. Ai më herët kishte thirrur mbledhjen e parlamentit, ku kishte mbajtur një fjalim, nëpërmjet të cilit kërkonte miratimin e projektit e tij: transferimin e kryeqytetit nga Almaty në një qytezë në veriperëndim të Almaty (1300 km larg), mu në qendër të shtetit. Ky qytet quhej Akmolë. Unë u informova për këtë fjalim dhe kuptova



*Me Presidentin e Kazakistanit, z. Nursultan Nazarbajev dhe Islam Pacollin, drejtor i Mabetex Kosovës, 1999*



*Kryeqyteti Astana 2, ndërtuar në tërësi nga Mabetex Group. Kështu duket sot qyteti ndërtuar nga kompania jonë*





*Qendra e vjetër Astana 1 ndërtuar në tërësi nga Mabetex. Këtu gjendet kompleksi tregtar Sine Tempore, pronë e Mabetex-it*

se bëhej fjalë për ndërtimin e kryeqytetit të ri, Akmola. Parlamenti kishte miratuar vendimin e Presidentit që të transferohej kryeqyteti dhe mu për këtë kredia ime prej 80 milionësh ishte e mirëseardhur.

Çfarë duhej të bëja unë tani në Akmola? Të rinovoja godinat e vjetra dhe t'i bëja funksionale për institucionet e shtetit. Kontratat nuk kishin një vlerë fikse, por punohej duke faturuar. Pas një kohe, u shpenzuan ato 80 milionë dhe u detyrova të merrja edhe një kredi tjetër prej 40 milionësh, në mënyrë që të mund t'i përfundoja disa projekte. Por situata tani ndryshoi, sepse Kazakistani nisi të eksportonte naftë. Po ato banka që dikur refuzonin të flisnin për Kazakistanin, tani pritnin në radhë me javë për t'u takuar, përfshirë edhe një bankë si *Deutsche Bank*. Kazakistani tani ishte bërë atraktiv, sepse kishte kapital "live".

Më 10 tetor 1997 *Mabetex*-i në Akmola kreu ndërtimin dhe rindërtimin e strukturës së parë shtetërore, pra përfundoi ndërtimin e dy Dhomave të parlamentit të Kazakistanit - 32 mijë metra katrorë, sallën e parlamentit me 600 vende, ministrinë e punëve të jashtme





*Vëllai, Agim Pacolli, zv.president dhe drejtor i Mabetex, Kazakistan, me Mbretin e Spanjës, Huan Karlos (Juan Carlos) I gjatë një vizite të tij në Astana*

- 14 mijë metra katrorë, kryeministrinë dhe administratën e tij - 28 mijë metra katrorë, rezidencën presidenciale - 11 mijë metra katrorë, sallën e kongreseve me 1600 vende dhe fazën e parë të aeroportit ndërkombëtar të Akmolës. Krejt këto objekte u kryen brenda një periudhe njëvjeçare. Mu ashtu siç ishte paraparë në kontratë, stema e Presidentit të Republikës së Kazakistanit, më 10 tetor 1997 transferohej prej Almaty në Akmola. Për Kazakistanin, por edhe për *Mabetex*-in, 10 tetori 1997 ishte një festë e madhe. Edhe këtu *Mabetex*-i e dha provimin e vet me sukses të plotë. Me më tepër se 2000 punëtorë, në tri ndërrime, në afat prej një viti, e bëri të mundur vendosjen e administratës së një shteti të madh (i nënti në botë për nga sipërfaqja), në objektet e reja. Ato ishin ndërtuar sipas sistemit “çelësin në dorë”.

Me ngritjen e kryeqytetit të ri filloi të dilte në shesh fuqia e Kazakistanit. Çdo gjë shkoi si duhet në këtë projekt madhështor, për çka u jam mirënjohës në rend të parë punëtorëve të mi, të cilët me vullnet shumë të madh e kryen këtë mrekulli. Edhe këtu, sikurse

*Akkorda-Rezidenca e Presidentit të Kazakistanit në Astana. Historia e Mabetex-it pasurohet me një simbol të ri*







*Nderimi me titullin "Qytetar nderi" i Kazakistanit*

kryeqytetit në Akmola (Akmola në gjuhën kazake do të thotë "varrezat e bardha"), lindi edhe emri i ri, Astana, që në përkthim në gjuhën kazake do të thotë thjesht "kryeqyteti".

Pas përfundimit të fazës së parë të projektit, Presidentit Nazarbayev i lindi ideja të ndërtonte qytetin e ri, sepse Astana e vjetër nuk mjaftonte më. Duhej një zgjerim i kryeqytetit. Kjo mund të bëhej matanë lumit Ishim, saktësisht në bregun e majtë të lumit, i cili kalonte nga lindja, në periferi. Aty kishte një baltinë të shkretë, pa asgjë. Këtu do të jetë rezidenca, këtu selia e qeverisë, këtu parlamenti, këtu qyteti diplomatik! - thoshte Presidenti Nazarbayev. Ai kërkonte ndërtimin e një qyteti të ri, jashtë qytetit të vjetër, që tashmë ishte ngushtuar së tepërmi. Natyrisht që për këtë projekt duhej edhe ekipi i *Mabetex*-it. Ishte Karakawa, një arkitekt japonez me famë botërore, i cili zgjodhi vendin ku do të ishte qendra e kryeqytetit të ri. Dhe filloi ndërtimi i tij.

Gjithçka nisi me projektin e rezidencës zyrtare të Presidentit të Kazakistanit "Akkorda", ndërtesë që sipas idesë së Presidentit Nazarbayev, u projektua 100% nga ne. Pala kazake nuk preku asgjë nga ajo që kishim projektuar. Filluan punimet në këtë ndërtesë madhështore


në Moskë, të parët ishin shqiptarët. Për *Mabetex*-in ishte shumë me rëndësi që edhe në këtë shtet të ri u dha me sukses provimi me rëndësi të posaçme për zhvillimet e ardhshme. Puna jonë u vlerësua lart. Unë, inxhinierët dhe vëllezërit e mi, u dekoruam me çmime dhe medalje të ndryshme shtetërore.

Me shpërnguljen e



*Teatri dhe salla e koncerteve në Astana, më e madhja në botë*

prej 50 mijë metrash katrorë, e cila sot dominon krejt qytetin e ri, e veshur me mermere të gravuara nga Sicilia (me një trashësi mesatare 20 cm) dhe me çdo gjë tjetër që i përket selisë së njeriut të parë të shtetit. Shtëpia e Bardhë e Kazakistanit u konceptua ngjashëm me Kremlinin, por në një objekt krejtësisht të ri, shumë funksional dhe në hapësira më të gjera. Nëse doni të dini ku qëndron suksesi i këtij projekti, më duhet t'ju them se aty është punuar me mend, me forcë dhe me shpirt. Ai objekt i dedikohet njeriut të parë të shtetit të ri,




*Velodromi në Kazakistan*



*Dita e inaugurimit të Teatrit dhe Sallës së koncerteve në Astana, 2009*








*Kërcimorja e skive dhe fshati olimpik në Kazakistan - Projekti avangard  
i Mabetex-it*







*Presidenti i Kazakistanit, z. Nursultan Nazarbayev dhuron mirënjohje për punimet e jashtëzakonshme të ekzekutuara nga Mabetex Group*

që unë e respektoja shumë. Zoti Nazarbayev ishte Presidenti i parë i Republikës së pavarur të Kazakistanit, dhe ideja për ndërtimin e presidencës dhe kryeqytetit të ri ishte e tij. Ditën që vumë gurthemelin, sipas traditës së vendit premë një kurban. Puna shkoi mbarë nga fillimi deri në fund. Nuk patëm humbje në njerëz dhe askush nuk u lëndua, gjë që sipas statistikave, ndodh rrallë në ndërtimin e objekteve të tilla. Me këtë vepër madhështore sot krenohet Kazakistani. Natyrisht edhe *Mabetex*-i, i cili mori shumë lavdata, madje edhe çmimin e parë të arkitekturës dhënë nga Unioni i Arkitektëve. Me ngritjen e kantierit të Akkordas, *Mabetex*-i filloi punimet në ndërtimin e

ministrisë së re të punëve të jashtme, kompleksit mjekësor prej nëntë spitaleve, që sot njihen si më modernët në botë, kompleksit banesor *Arman* me apartamente luksoze, hotelit *Radison*, qendrës më prestigjioze të biznesit në Kazakistan etj. Krahas këtyre objekteve *Mabetexi* filloi ndërtimin e qendrës olimpike në Suchinsk, stadiumeve dhe objekteve sportive mahnitëse, rezidencave të ndryshme qeveritare e shumë të tjera. Në dhjetor të vitit 2009 *Mabetex-i* kreu ndër-



*Me Presidentin e Kazakistanit, z. Nursultan Nazarbayev*

timin e qendrës së koncerteve dhe të filmit me 4500 vende, diçka që për nga kapaciteti mund të hyjë në librin e Guinness-it. Është objekti më avangard i këtij lloji ndërtuar deri më sot në botë. Punët e *Mabetex-it* në Kazakistan tani vazhdojnë, me 17 kantiere të hapura dhe me mbi 6000 punëtorë që garantojnë vëllim të madh biznesi, si kompensim të punës që ata e bënin me vullnet të madh. Në Kazakistan, *Mabetex-i* tani ka vënë themelet e ndërtimit të Teatrit të Operas dhe Baletit, sipas idesë dhe projektit tim. Teatri po ashtu mendohet të jetë objekti më unikal i këtij lloji me një sipërfaqe të ndërtuar prej mbi 44 mijë metra katrorë dhe kosto prej mbi 300 milionë euro. Në Kazakistan punët vazhdojnë. Aty ideja për të ardhmen bëhet shumë shpejt realitet.

Në Kazakistan, *Mabetex*-i ka pasur sukses të madh dhe për këtë falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët e mi, që i shërbejnë me krenari emrit *Mabetex*, që është bërë tanimë botërisht i njohur si sinonim i cilësisë dhe seriozitetit. Falënderimi u shkon dhe qytetarëve të Kazakistanit, tek të cilët gëzojmë emër të mirë, aq sa ndodh të ndalojnë rrugës dhe punëtorin më të thjeshtë të *Mabetex*-it. Bashkëpunëtorët dhe inxhinierët vendorë që punojnë për kompaninë tonë, shihen me zili nga të tjerët. Ata çdokund mbrojnë me fanatizëm emrin e *Mabetex*-it. Klientët, partnerët tanë kontraktualë, gjejnë te ne po ashtu respekt reciprok. Ky respekt ka qenë dhe mbetet bazë e suksesit tonë. Edhe në Uzbekistan *Mabetex*-i ka një përfaqësi të vetën, e cila kryen po ashtu punë të rëndësishme. Në 15 vitet e fundit *Mabetex*-i ndërtoi godinën e bashkisë së Tashkentit, por edhe banka e hotele që konsiderohen krenaria e Uzbekistanit. Ndërkaq, në Tashikistan, *Mabetex*-i ka ndërtuar ambasadën e Gjermanisë dhe një objekt tjetër.

Për shumë njerëz, Azia qendrore është një botë e largët, si thuhet përtej diellit. Si të tillë, bota e njeh fare pak. Por, për bindjen time, ajo është e panjohura e një bote të re, e cila ka filluar të rilindë duke mahnitur të gjithë.

## “Russiagate”, si filloi?

*Analizë e shkaqeve të një afere planetare. Si u bënë bashkë miqtë e oligarkëve, armiqtë e Kosovës, rivalët e mi në biznes? Pse më zgjodhën mua si hallkën e dobët ku duhej goditur? Të mirat dhe të këqiat e kësaj afere planetare.*

**P**ara se të hyj në detajet e këtij “skandali”, duhet t’ju them se në këtë aferë, pos njerëzve të shquar të politikës botërore, si Jelcini, Al Gore, Kamdesy (Camdessus), bankave si *Credit Suisse*, *Banca del Gottardo* (Gottard), *UBS*, *Bank of America* etj., firmave si *Aeroflot*-i, *Autovaz* etj., isha i përfshirë edhe unë me *Mabetex*-in tim.

Kjo aferë e kurdisur zgjati plot dy vjet, për mua dhe *Mabetex*-in, kurse për të tjerët edhe më shumë. Çka është e sigurt - as unë e as firma ime - dhe çdo aktivitet i lidhur me mua e firmën time - nuk kanë pasur asnjëherë konto të bllokuara dhe as kufizime të tjera legale, pos tentativave të disa prokurorëve, që vepronin në bazë të dëshirave të tyre pa kurrfarë baze ligjore, e që tentonin të hapnin një hetim por pa mundur asnjëherë të arrinin asgjë. Megjithëkëtë përpjekjet e tyre patën jehonë të madhe mediatike. “Afera” u zhvillua vetëm në suaza të shkrimeve nëpër gazeta dhe të kronikave nëpër televizione. Asgjë më tepër. Asnjëherë në jetën time nuk kam pasur kufizime ligjore, përveç për ndonjë parkim të gabuar të makinës. Asnjëherë s`kam rënë ndesh me ligjin, as gjatë studimeve të mia, dhe as gjatë karrierës sime të gjatë profesionale. Ashtu si unë, as *Mabetex*-i dhe subjektet e tjera që kanë të bëjnë me mua, nuk kanë rënë ndesh me ligjin.

Rrëfimin për këtë hetim më tepër e bëj për shkak të përshtypjeve që ka lënë tek unë, por druaj dhe tek të tjerë. Por edhe për shkak se dëmet e kësaj afere ishin mjaft të rënda. Më bëri përshtypje sidomos fakti se për herë të parë në jetë, pas plot 48 vitesh, e kuptova ndoshta se si ngjarjet dhe ligjet mund të instrumentalizohen në një shkallë aq

të lartë, në favor të arritjes së synimeve të caktuara. Po t'i përjetonte apo t'i dinte këto një regjisor i mirë, mbase do të mund të krijonte filmin më të shikuar në botë.

Në të vërtetë, çfarë ishte kjo aferë? Ku qëndronte thelbi i saj? Kush e filloi dhe çfarë synohej të arrihej? Si ndodhi që, për katërqind ditë me radhë, “Russiagate”, ose “Kremlingate”, siç u quajt ndonjëherë, të mos zbriste nga shtyllat e gazetave anekënd botës, ndërsa për 49 ditë të zinte faqet e para të gazetave dhe lajmet kryesore të medias elektronike? Përse bëhej kjo zhurmë mediale? Kur filloi dhe si u zhvillua e gjithë kjo? Kush u implikua në të dhe cilat ishin skenat dhe prapaskenat e saj?

Edhe tani, pas kaq vitesh, është vështirë të përcaktohet një datë e saktë e fillimit të kësaj afere. Madje edhe kronologjia e zhvillimeve është e vështirë, për shkak të ngjarjeve të shumta paralele dhe për shkak se në skenë shihet diçka, kurse në prapaskenë ndodh diçka krejt tjetër. Për dy gjëra mund të jem i sigurt. E para, se afera kundër meje kishte objektiva të tjerë, se sa shkatërrimin e një biznesi të suksesshëm, apo të një personi, siç ishte rasti im, që gjendesha në krye të *Mabetex-it*. E dyta, se në këtë aferë kishte një përzierje të madhe faktorësh, në rend të parë politikë, pastaj ekonomikë, medialë e kështu me radhë. Ashtu sikundër mund të supozohet, faktori politik ishte dominues, por edhe ai ishte kompleks, i përbërë nga disa nënfaktorë.

Për shkak se në fokus të zhvillimeve ishte vënë Rusia, superfuqia që kishte humbur forcën dhe shkëlqimin e saj, por që ende kishte ndikime të mëdha në zhvillimet botërore (sepse ende ishte forcë e madhe nukleare), ngjarjet në këtë aferë morën përmasa planetare. Nga ana tjetër, nuk ishte aspak e rastit që afera ndodhi pothuajse në të njëjtën kohë dhe u zhvillua paralelisht me kulmin e ngjarjeve në Kosovë, para, gjatë dhe pas bombardimeve të NATO-s. Në anën tjetër, duhet pasur parasysh faktin se afera “Russiagate”, përveç që ishte e parapërgatitur në disa aspekte të saj, kalonte nëpër faza të ndryshme, duke iu përshtatur rrethanave dhe duke njohur gjithnjë situata të reja. Kështu, derisa në fillim ajo kishte një interferencë politike ndërmjet Ruisë dhe Kosovës, më pas në objektiv të saj kaloi vetëm Kosova dhe zhvillimet rreth saj. Ndonjëherë, madje,

ndodhte që ajo e braktiste objektivin e saj themelor dhe kalonte në zhvillime sekondare, duke u futur nëpër prapaskenat e biznesit dhe të interesave ngushtësisht të lidhura me konkurrencën dhe tregun.

Dhe, kështu, njerëzit që u përfshinë në këtë aferë, ose që, në ndonjë mënyrë u bënë objekt spekulimesh, ishin të shumtë, që nga Presidenti i atëhershëm i Rusisë, Boris Jelcin, e deri te nënpresidenti amerikan Al Gore; që nga prokurori i Federatës Ruse, Skuratov, i Konfederatës Helvetike, Karla del Ponte, e deri te kryetari i Bankës Botërore, Mishel Kamdesy. Në zhvillime paralele u përfshinë politikanë, bankierë, institucione financiare, firma të njohura dhe me reputacion botëror, biznesmenë, redaksi të gazetave, dëshmitarë të rastit, madje edhe spekulantë ordinerë. Pra, afëra ngjante me një si gjeratore, ku sillëshin në rreth, të shtyrë nga inercia, njerëz të të gjitha kategorive, nga ata me fuqi vendimmarrëse, e deri te ata me mundësi sado të vogla për të ushtruar ndikim në zhvillimin e ngjarjeve.

Megjithatë, edhe përkundër një shtrirjeje të këtillë, të thuash planetare, në zhvillimet e saj kryesore ajo u përqendrua në relacionin Moskë-Bernë, ose, thënë më mirë, Rusi-Zvicër. Mirëpo, duke e ditur se në botën e sotme asnjë zhvillim nuk kalon pa interferenca më të gjera, atëherë nuk mund të përjashtohen edhe implikime të tjera, që nuk ishin vetëm mediale, siç ishte Italia, Serbia dhe ndonjë vend tjetër. Por, mbi të gjitha, për mendimin tim, në fokus të ngjarjeve ishte Rusia, dhe Kosova në prapavijë.

Pse Rusia? Sepse në fund të vitit 1999, në Rusi duhej të bëheshin zgjedhjet dhe atëherë do të dihej më saktë se cilën rrugë do të merrte Rusia. Jelcini, njeriu më meritor për shpërbërjen e ish-Bashkimit Sovjetik dhe konstituimin e Federatës Ruse; njeriu që i sulmoi me tanke komunistët e rebeluar, kur ata u mbyllën në Shtëpinë e Bardhë dhe synuan grusht-shtetin; pra, Boris Jelcini, për shkak të rrethanave të brendshme, për shkak të shëndetit të rrënuar, në këto zgjedhje do të merrte një përgjigje historike: Do ta vazhdonte Rusia rrugën e tij, apo do të bënte një kthim prapa? Nuk ishte fjala vetëm për Jelcinin si person, por për një kurs politik me rrezatime shumë të gjera. Rusia, e ridefinuar, kishte mbetur fuqi e madhe botërore, veçmas ushtarake, por e rrënuar ekonomikisht. Kriza e shoqërisë

ishte e thellë. Ishte krizë jo vetëm ekonomike dhe sociale, por edhe krizë morale. Nacionalistët rusë, sikundër edhe njerëzit e rëndomtë, e ndienin të fyer. Ishte lënduar sedra dhe krenaria rusomadhe e tyre. Në krah të tyre qëndronin forca politike recidiviste, të cilat tashmë kishin filluar të rigrupoheshin. Ata kërkonin që Ruisë t'i kthehej jo vetëm reputacioni i dikurshëm, por synonin edhe restaurimin e sistemit. Në anën tjetër, duke kaluar nëpër një fazë të tranzicionit të rrëmujshtëm, në skenë ishin shfaqur oligarkët e rinj, të cilët, pasi kishin shfrytëzuar rrethanat e turbullta për të bërë pasuri përrallore, kishin pretendime të hapura për të ushtruar ndikim në jetën politike të vendit. Ndërkaq, në prapavijë, me një rol krejt të paqartë, ishin ushtria dhe KGB-ja të paristrukturuara dhe të pareformuara. Në të kaluarën jo të largët, ato kishin pasur pushtet dhe privilegje të mëdha në ish-Bashkimin Sovjetik. Askush nuk e dinte saktësisht, si ia kishte dalë Jelcini t'i mbante nën kontroll në këtë fazë kaq të ndjeshme të tranzicionit.

Prandaj, ishte krejt e qartë se afëra "Russiagate" ishte paramenduar dhe konstruktuar si sulm ndaj Jelcinit, që pozitat e tij të dobësosheshin sa më shumë në zgjedhjet e vitit 1999. Për këtë nuk ka asnjë dyshim. Natyrisht, u fillua në një mënyrë të tillë, që opinioni të mund të përgatitej për një kohë më të gjatë, sepse edhe kthesa konsiderohej e rëndësishme. U fillua gjatë vitit 1998 dhe kulmin e arriti në vitin vijues, për t'u shtrirë pastaj në një periudhë më të gjatë kohore, sikundër thamë, duke ndryshuar herë pas here edhe kahen e zhvillimeve dhe të ngjarjeve.

Mirëpo, nëse Rusia dhe forcat e saj politike kishin llogaritë e veta për t'i dhënë krah një afere të tillë, ç'hynje në këtë mes një shtet si Zvicra, e cila e kishte të deklaruar neutralitetin ndërkombëtar? Pa dashur të merrem me konspiracione, do të them vetëm një gjë: në politikë dhe në marrëdhënie ndërkombëtare zakonisht ndiqet një parim – tjetër gjë thuhet dhe tjetër gjë bëhet. Ndërkohë duhet të supozohet se qarqeve të caktuara në Europë, për shkak të baraspeshës me SHBA-në, u duhej akoma në fund të viteve '80 një Bashkim Sovjetik, që do të mbahej në këmbë. Dhe më pas: shpërbërja e Bashkimit Sovjetik kishte qenë e rrëmujshtëm dhe e rrezikshme për stabilitetin botëror. Një shpërbërje eventuale e Ruisë, që dukej



sikur do të mund të ndodhte nën drejtimin e mëtejshëm të Jelcinit, mund të nxiste kërkimin e një alternative në dukje morbide: të braktiseshin të gjitha parimet demokratike për hir të një stabiliteti brendar, që mund të garantonte siguri planetare. Ende është shumë e vështirë të depërtohet në të gjitha prapaskenat e atyre ngjarjeve, sepse shumica janë të mbuluara me një vello misteri. Mirëpo, në kuadër të spekulimeve të ndryshme me prapavijë politike, gjë që e them me siguri të plotë, zë vend të rëndësishëm edhe lufta e ashpër e kompanive perëndimore për të pushtuar dhe dominuar tregun e madh rus. Askush nuk mund ta kontestojë se investitorët perëndimorë dhe të tjerët në përgjithësi ndiqnin interesat e tyre, pavarësisht nëse në rrugë e sipër shkelnin mbi parime që aq shumë i proklamonin në shtetet e origjinës. Aq u bënte atyre për demokracinë në Rusi. Mjaftonte që të gjenin një mënyrë për t'u lidhur me njerëz të rëndësishëm të hierarkisë shtetërore, në mënyrë që investimet e tyre të gjenin hapësirë të përshtatshme. Se kush mund të ishin këta njerëz të hierarkisë, çfarë të kaluare kishin, për cilat bindje politike luftonin, kjo kishte pak rëndësi. Me këtë dua të them se në krah të atyre që kërkonin rrënimin e Jelcinit dhe një kthesë prapa në Rusi, ashtu si papandehur ose me qëllim, mund të jenë vendosur edhe qarqe me ndikim në shtetet perëndimore. Po, si mendohej, pra, të dëmtohej Jelcini në zgjedhjet e pritshme të vjeshtës së vitit 1999? Shumë thjesht. Përmes një afere korruptive. Dhe pse pikërisht aferë korruptive? Sepse në këtë pikë opinioni rus ishte jashtëzakonisht i ndjeshëm. Ata shihnin me sy se çfarë ndodhte çdo ditë në Rusi dhe donin të besonin se vendi i tyre kishte një shpresë. Kjo shpresë mund të ishte një President i pakorruptuar dhe i papërfshirë në krim të organizuar. Nëse u dëshmoje të kundërtën, atëherë mllefi i tyre ndaj kreut shumëvjeçar të shtetit do të ishte i madh, i pafund.

Po përse, atëherë, u zgjodha pikërisht unë dhe *Mabetex*-i të përfshiheshim në këtë aferë, kur Jelcini kishte raporte me aq shumë njerëz të politikës dhe të biznesit nga mbarë bota? Përsëri shpjegimi është i thjeshtë. Sepse unë kisha dy pika kontakti me Kremlinin: e para, kisha bërë restaurimin e pothuajse shumicës së objekteve qeveritare, përfshirë edhe rezidencën private të Presidentit, gjë që doemos kishte çuar në raporte të afërta me kreun e shtetit; dhe,



*Me ish-Kryeministrin e Shqipërisë, z. Pandeli Majko, 2001*

e dyta, në Kremlin, më saktë në krah të Jelcinit, ishte një person, i cili jo vetëm që kishte një njohje të vjetër me mua, por ai ishte edhe pengesë e madhe për ta marrë nëpër këmbë Presidentin e lodhur dhe të sëmurë. Ky ishte Pavel Borodini, shef i administratës presidenciale. Lexuesit mund t'i kujtohet se Jelcini e kishte sjellë Borodinin në Moskë nga Jakutski, pas promovimit të restaurimit të Pallatit të Kongreseve në atë republikë të Siberisë, që ishte kryer nga *Mabetex*-i. Në të vërtetë, Borodini ishte shumë meritore që Jakutski kishte marrë një pamje krejt të re, nga ndërtimet dhe restaurimet e shumta që kishim bërë ne. Tani Borodini ishte bërë njeriu më i afërt i Jelcinit.

Atëherë, cili mund të ishte konspiracioni? Pacolli kishte bërë restaurimin e Kremlinit, tenderët i kishte fituar përmes Borodinit, duke e mitosur atë. Por edhe Jelcini, përfshirë edhe vajzat e tij,

duhet të kishin marrë hisen e tyre - kjo ishte ajo që donin të besohej ideatorët e aferës!

Se unë kisha krijuar marrëdhënie të afërta me Borodinin dhe Jelcinin, nuk kishte asnjë dyshim, sepse ishte një gjë që mund të vërtetohej fare lehtë. Kontaktet dhe takimet kishin qenë legale, sepse kishin të bënë me natyrën e punës. Si mund të merret me mend që një kryes i punimeve të rezidencës presidenciale të mos takohej qoftë edhe një herë me njeriun që do t'i shërbente pikërisht ajo rezidencë? Por edhe më shumë se kaq: Jelcini publikisht kishte qenë shumë mirënjohës për cilësinë e punëve të kryera në Kremlin. Pastaj, aty ishte edhe dekorata e akorduar prej tij.

Po Kosova, përse duhej të futej në këtë kuadër? Nuk është e panjohur se zhvillimet në Kosovë dhe rreth saj, ishin një test i pashembullt i qëndrueshmërisë ose paqëndrueshmërisë së raporteve ndërkombëtare, veçmas në relacionin Rusi-Perëndim dhe NATO-Rusi. Tashmë këto janë zhvillime të njohura, të verifikuara dhe nuk përbëjnë asnjë enigmë. Në të vërtetë, nuk ishte problem Rusia zyrtare dhe qëndrimi i saj si mbështetëse tradicionale e Serbisë. Më shumë problem paraqitnin forcat e caktuara brenda Ruisë, të cilat duhehin pasur në konsideratë pas çdo lëvizjeje që bëhej rreth Kosovës, në mënyrë që të mos provokohej jo vetëm dobësimi eventual i pozicionit të Jelcinit, por edhe ndonjë e papritur më e madhe. Sepse këtu bëhej fjalë për ushtrinë, të cilën askush nuk e dinte nëse Jelcini arrinte ta kontrollonte ose jo me autoritet të plotë.

Pra, në njërën anë ishin forcat brenda Ruisë, kryesisht nacionalistët dhe komunistët, të bashkuar rreth Zhirinovskit dhe Zhuganovit, që kërkonin një mbështetje më të qartë dhe më të prerë për Serbinë dhe Milosheviqin. Në anën tjetër ishte opinionioni publik, i cili, sado mendjekthjellët që të ishte, për shkak të traditës, nuk e priste mirë një zbrapsje të Ruisë në raport me Perëndimin, veçmas jo me NATO-n, sepse ky fakt lëndonte sedrën dhe krenarinë e superfuqisë së dikurshme.

Në një rrethanë të këtillë, qarku i konspiracionit ishte pothuajse vicioz: Jelcini i korruptuar, Jelcini i paaftë, Jelcini i shitur! Te kush, pale! Te një biznesmen i Zvicrës me prejardhje kosovare! Ai kishte arritur deri aty, sa të hynte dhe të dilte në Kremlin kur t'ia



*Me Presidentin e Tatarstanit z. Gantimir Schumaev. Ky mik i madh i shqiptarëve ka mbajtur qëndrime të jashtëzakonshme, siç kam shpjeguar më sipër. Ai ndali disa iniciativa antishqiptare të Dumës.*

Primakovi, kryeministri në detyrë, nuk e kishte aq të vështirë ta sabotonte punën e tij, sepse Jelcini, që duhej të ishte mbështetësi i tij kryesor, sikur e kishte humbur torruan dhe nuk ishte shumë i qartë në qëndrimet e tij.

Por, nuk ishte vetëm kjo. Në situatën kur Kosova duhej të ishte në qendër të medias botërore, për shkak të zhvillimeve dramatike dhe tragjike, shpiket një aferë përmasash planetare jo vetëm për të zbehur imazhet e tragjedisë kosovare, por edhe për t'i krijuar asaj një kundërpeshë. Ju që e mbështetni Kosovën, ja ku e keni modelin e njeriut të saj të suksesshëm: korruptues dhe hallkë e rëndësishme e krimit të organizuar! Ky mesazh nisët nga Moska, shumëfishohet në Serbi dhe shpërndahet në anë të ndryshme të planetit. Të mos harrojmë: Serbia kishte vendosur që luftën e mirëfilltë me NATO-n ta zhvillonte vetëm në një pikë: në atë të propagandës dhe të anti-propagandës. Besoj se pjesë e projektit të saj ishte edhe trumbetimi sa më i madh i aferës, e cila kishte në qendër të saj një kosovar. Pra dhe ata kanë dorë në shumëfishimin e jehonës mediatike të kësaj

donte qejfi! Nuk ishte e mundur që Kosova mos të kishte qenë objekt i ndonjë marrëveshje të fshehtë, e cila gjithsesi do të bëhej në dëm të Serbisë! Kësaj shtate i shkonte në favor edhe paqëndrueshmëria e qeverisë ruse. Çernomirdini, njeri i matur dhe bashkëpunëtor lojal i Jelcinit, kishte humbur votëbesimin në parlament. Rënia e tij kishte forcuar krahun kundër Jelcinit. Ai ishte caktuar nga vetë Jelcini si ndër-mjetës për Kosovën. Por



*Me Presidentin e Republikës së Sakha, z. Nikolayev dhe delegacionin e tij, mysafirë të kryetarit të komunës së Luganos, z. Giorgio Xhudici (Giudici) (ceremonia e dekorimit)*

çështjeje apo në hapjen e pistave të reja, goftë me lobimin e tyre negativ në disa qendra të mëdha mediatike botërore, goftë me forma të tjera.

Edhe sikur të mos ishte Serbia, opsioni amerikan i zgjidhjes së çështjes së Kosovës kishte kundërshtarë të mëdhenj në Europë, siç tregon me delikatesë sekretarja amerikane e shtetit, zonja Ollbrajt, në librin e saj me kujtime *Zonja sekretare* për kolegët e saj europianë, italianin Dini dhe francezin Vedrin. Kishte shtete me interesa të drejtpërdrejta në Serbi, si Italia. Kishte shtete me interesa të drejtpërdrejta në Rusi, siç ishte Gjermania e udhëhequr prej Shrëderit, të cilët megjithëse pro variantit interventist amerikan nuk donin që raportet me Rusinë t'i prishnin për shkak të Kosovës. Kishte shtete



*Me Presidentin e Bashkortostanit, z. Murtazai Rakhimov. Edhe ky kishte simpati për shqiptarët*

të tjera që nuk e donin kujdestarinë amerikane në Evropë. Kishte akoma më shumë shtete me çështje të brendshme të parregulluara, të ngjashme me Kosovën. Të gjitha këto motive së bashku inkurajonin një terren të përshtatshëm ku Kosova duhet të fitonte imazh negativ, falë një afere që në fokus kishte një kosovar.

Por, mbi të gjitha, enigmë e të gjitha enigmave për mua mbetet angazhimi i prokurores së përgjithshme të Konfederatës Helvetike, Karla del Ponte, më vonë prokurore e Gjykatës së

Hagës. Vullneti i saj jo vetëm për të hetuar, sepse, fundja, këtë e ka pasur detyrë, por, mbi të gjitha, për të trilluar fakte në këtë aferë, për të shkelur ligjin, për të nxitur dëshmitarë të rrejshëm etj., mbetet i pashpjegueshëm dhe mahnitës. Angazhimet e saj tejkalonin çdo lloj angazhimi tjetër të kësaj natyre.

Shikuar parimisht, ajo mund të ketë pasur synim të ndalonte, ose së paku të krijonte pengesa (për aq sa mund t'ia arrinte kësaj) për krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, fenomene këto që kishin marrë hov pas rënies së socializmit në Bllokun e Lindjes, veçmas në Rusi. Krimi i organizuar filloi të lulëzonte në fillim të viteve të tranzicionit, në Lindje përgjithësisht dhe se në të ishin të përfshirë titullarë të lartë të hierarkive shtetërore. Kriminelë ordinerë ishin lidhur me strukturat e shtetit dhe bënë lloj-lloj malverzimesh ekonomike, që nga shitja e aseteve e deri te zhvatjet

përmes shantazheve. Në këtë mënyrë u fituan shumë para dhe ato, pastaj, morën rrugën drejt bankave perëndimore, që atje të ndryshonin destinacion, të “pastroheshin” dhe të futeshin pastaj në tregun financiar pa asnjë pengesë.

Po të ndiqte me korrektësi këtë motiv edhe në rastin tim, Karla del Ponte do të mbetej zonjë e nderuar. Por, çfarë bëri ajo në të vërtetë? Në pikëpamje juridike, ajo u bë promotor i shkeljes së ligjeve zvicerane. Ndërkaq, në pikëpamje politike ajo dashur pa dashur, u vendos në anën e atyre forcave politike në Rusi, të cilat u quajtën dhe do të quhen mbeturina të sistemit të kaluar. Ajo u bë shërbëtoresh e bindur dhe ndihmëse e devotshme e një Skuratovi (ish-prokuror i përgjithshëm i Rusisë) ose Lushkovi (asokohe kryebashkiak i Moskës), që nuk linin gur pa lëvizur për të rrëzuar Jelcinin dhe që tashmë kishin bërë figurë të keqe te populli rus. A nuk e dinte këtë Karla del Ponte? Nuk më besohet të ketë qenë aq naive, sa të mos e kuptonte këtë. Nga ana tjetër, ajo e dinte se përzjerja e institucioneve të hetimit në procese që kanë prapavijë politike, instrumentalizim ky që nuk e nderon asnjë prokuror, asnjë zbatues të ligjit, asnjë institucion të judikaturës dhe asnjë vend në botë, kudo dhe kurdo që mund të ndodhë diçka e tillë.

Për të kuptuar më mirë atë që ndodhi është me interes të tregohet si u kurdis një dokument që u përdor në hetim, nga një i ashtuquajtur njohës i realitetit në Rusi. Fjala është për një të ri zviceran, për mua diletant, që kishte bërë një studim për situatën politike në Rusi - *Due Diligence*, për mua dhe *Mabetex*-in. Kur e lexova këtë dokument, i cili në mbarim të aferës më ra në dorë, më bëri të qesh, sepse ishte me të vërtetë qesharak, por nga ana tjetër kryeprokurorja zvicerane, e kishte përdorur si “Joker” për aktivitetin e saj. Sipas atij dokumenti, Jelcini kishte vetëm tetë muaj ekzistencë politike deri në zgjedhjet e 1999-s, sepse Jelcini do t'i humbte zgjedhjet dhe pala tjetër (e Skuratovit, homologut të Del Pontes,) do të vinte në pushtet. Siç dihet kjo nuk ndodhi. Jelcini i fitoi zgjedhjet me 74 për qind. Për mua dhe *Mabetex*-in, diletanti shkruante se unë isha vetëm grumbullues i parave të cilat i angazhoja në armatime për UÇK-në. Ky dokument ishte shkak, pse në të vetmen seancë pyetjesh që kisha me Karla del Ponten në mars të vitit 1999 ajo këmbëngulte: “Thuaj për Jelcinin

çka të dish, se ai edhe ashtu nuk do të jetë më në pushtet dhe ti nuk do të rrezikosh kthimin e kredive tua!”. Sa naive u tregua ajo këtu. Sidoqoftë materiali ku bazohej ajo ishte për t’u shqetësuar.

Edhe përkundër të gjithave, Karla Del Ponte veproi si amatore (e jo profesioniste) e drejtësisë, duke shkelur në mënyrë flagrante një numër parimesh, të cilat e nderonin shtetin që përfaqësonte, pra Zvicrën. Ajo, madje, cenoi edhe parimin bazë të Konfederatës Helvetike, neutralitetin politik, duke u vendosur në krah të atyre që synonin ta merrnin pushtetin në Rusi. Ajo, në të gjitha rastet, më ftonte të bashkëpunojë me të, në mënyrë që t’i bënim gjëmën Borodinit dhe Jelcinit, kështu që më pastaj nuk do të kisha më telashe me kthimin e kredive. Cilët, pra, ishin motivet e saj? Të futej në analet e drejtësisë ndërkombëtare, se kishte arritur të rrëzonte Presidentin e njërës nga shtetet më të rëndësishme të botës? Të fitonte popullaritet? Të bënte karrierë? Të ushqente karizmën e saj? Të gjitha këto mund t’i bënte fare lehtë, duke ndjekur rrugë të tjera, të tilla që ia ofronte ligji dhe kushtetuta. Atëherë, përse vepronte kështu?

Mund të kenë qenë të shumta motivet që e nxitën Karla del Ponten të bëhej promotore e kësaj afere, por gjithsesi do të mbetet të sqarohen në të ardhmë më mirë shumë rrethana, përfshirë edhe ato që në ndonjë pikë të largët mund të lidhen me Kosovën dhe çështjen e saj, me Serbinë dhe luftën e saj në Kosovë, me Rusinë dhe me oligarkët e saj, me Italinë dhe me interesat e saj ekonomike.

Të gjitha këto tani për tani mund të quhen vetëm supozime, sepse duhet një kohë tjetër për t’u futur në të gjitha detajet e këtyre zhvillimeve. Tash për tash mjafton të themi vetëm një gjë: se qëllimet dhe synimet kontraverse të kryeprokurores së Zvicrës, mania e saj e protagonizmit, përfshirë edhe motivet e saj krejt të paqarta dhe të mjegullta, u bënë faktori i tretë i rëndësishëm, që ushtroi ndikim të madh në rrjedhat e aferës “Russiagate”.

Faktori tjetër i radhës, ishte ai ekonomik. Këtu llogaritë ishin të thjeshta: me hapjen e një afere për një firmë që kishte arritur majat e tregut rus të rindërtimit dhe të investimeve, pasojat do ishin të mëdha për firmën dhe për reputacionin e saj. Pra, ishte e qartë se kjo ishte mënyra më e ulët dhe më e pandershme e mënjanimit të *Mabetex*-it nga konkurrenca në këtë treg dhe jo vetëm aty. Kush e



dëshironte këtë? Të gjithë ata që e konsideronin *Mabetex*-in rival në sektorët përkatës, veçanërisht në fushën e ndërtimeve dhe të rindërtimeve. Ajo që kishte arritur *Mabetex*-i në rindërtimin e Kremlinit, por edhe të objekteve të tjera social-ekonomike në Moskë dhe në mbarë Rusinë, nuk kishte si të mos binte në sy dhe nuk kishte si të mos ishte pengesë për shumë rivalë. Le të kujtojmë këtu vetëm firmën italiane, e cila ishte konkurrenente për të hyrë në Kremlin dhe që mbeti pas dere. Unë e dija se nuk do të ma falte kurrë disfatën që pësuan me këtë rast dhe e dija, gjithashtu, se ajo nuk do të linte gur pa lëvizur për të më dëmtuar, kur t'i vinte rasti për këtë. Dhe këtë e provoi, përmes filtrimit të lajmeve apo komenteve tek gazeta *Corriere della Sera*, e cila pati rol nxitës e destruktiv në fushatën kundër meje.



*Në Lugano Paradiso, Zvicër. Një nga momentet relaksuese - një shëtitje në këmbë*

Kjo aferë përbënte edhe një interes të drejtpërdrejtë ekonomik për vetë Rusinë dhe institucionet e shtetit rus. Që nga momenti i shpërthimit të aferës, ishte e pritshme se do të ndërpritej pagesa e kredive. Kjo i leverdiste Ruisë, po të kihet parasysh se shumica të mëdha parash tashmë konsideroheshin të humbura, sidomos ato që


u investuan në periudhën e rënies së Bashkimit Sovjetik, borxhi i të cilit iu la barrë Rosisë.

Ndërprerja e pagesës së kredive doemos që e vu në situatë të vështirë *Mabetex*-in, sepse bëhej fjalë për qindra milionë dollarë. Por më e keqe se kjo, ishte humbja e besimit të klientët dhe të kooperuesit e shumtë. Të përmend vetëm një rast: ditën kur filloi hulumtimi i dokumenteve bankare të *Mabetex*-it në Lugano nga Karla del Ponte, duhej të zhvilloja një takim pune me disa klientë. Ata erdhën në kohën e caktuar, panë atë që po ndodhte dhe ikën pa u kthyer kurrë më. Dhe bëhej fjalë për një marrëveshje me vlerë prej qindra miliona dollarësh.

Shikuar po nga ky aspekt, pra nga aspekti ekonomik, afera, veçmas në fazën e saj të fundit, përsëri kishte në prapavijë Kosovën. Kjo ka mundur të vërtetohet që në momentin, kur u bë e qartë se cilën rrugë do të merrnin zhvillimet në Kosovë. Detajet e planit dhe të skenarit për Kosovën ishin hartuar që në kohën e bombardimeve të NATO-s, madje më herët. Dihej se Kosova e pasluftës do të kishte nevojë për rindërtim, për ngritje kapacitetesh të institucioneve publike dhe për një furnizim të madh me të gjitha të mirat materiale. Tërheqja zvarrë e aferës ndaj *Mabetex*-it, edhe atëherë kur ajo mund të quhej e përfunduar, synonte të më pengonte me çdo kusht të hyja në Kosovë dhe të mos lejohesha të bëhesha pjesë e rindërtimit të saj. Segmentet e administratës së UNMIK-ut, përfshirë edhe përfaqësuesit e njëpasnjëshëm të sekretarit të OKB-së, që nga Kushneri e këndeji, thjesht më vunë embargo. Arsyetim ishte afera, por në prapavijë qëndronin interesa ekonomike shumë pragmatike të segmenteve të caktuara të administratës ndërkombëtare, të cilët e njihnin shumë mirë përvojën dhe forcën e *Mabetex*-it, si dhe aftësinë time për të ndryshuar rrjedhën e ngadalshme të rindërtimit të Kosovës. Me kosovarët e mi unë kisha bërë mrekulli në Jakutsk, Moskë e Astana. Përse këtë të mos e bëja në Kosovë, ku leverdisë ekonomike do t'i shtohet edhe entuziazmi i frymëzuar nga dashuria për vendin dhe nevoja për të zhvilluar atë? Fushata e Karla del Pontes ndaj meje nuk mbeti vetëm në kufijtë e Zvicrës ose te mediat ndërkombëtare, e as vetëm në Rusi, por ajo arriti edhe në Prishtinë. Në vizitën e saj menjëherë pas luftës në Kosovë, qëllimi kryesor ishte të mbledhte

## Behgjet PACOLLI

Président de Mabetex monde  
à Lugano



**A** 46 ans, cet Albanais d'origine, aujourd'hui naturalisé Suisse brasse les affaires et les dollars sur l'ensemble de la planète. Sa société à buts multiples, Mabetex, lancée en 1991 à Lugano enregistre des ventes pour 1,5 milliard de Dollars. Mais que fait donc Behgjet Pacolli?

### Tout et partout!

A Moscou par exemple, il a complètement remeublé les 234 chambres du Kremlin ainsi que l'ensemble de la «Maison Blanche» de Moscou. Actuellement il s'occupe de relooker l'ensemble du palais présidentiel du Kazakhstan tout en supervisant la construction à Moscou, d'un hôtel de 400 chambres sur 23 étages. Entre les deux endroits, il se fait transporter par sa propre compagnie aérienne «Diamond Air» qui, bientôt proposera également des vols intercontinentaux. C'est que, sur ce point du globe, l'homme qui parle une dizaine de langues dont le russe, à de précieux commanditaires. Tout a commencé pour lui par un coup de fil du cabinet présidentiel russe. Boris Yeltsine qui, au cours d'un voyage a spécialement apprécié une salle de congrès a voulu rencontrer son concepteur. Quelques coups de fils plus tard, Pacolli était dans un avion pour Moscou. Les mandats ont suivi ainsi qu'une amitié personnelle qui lie désormais les deux hommes. Les amis des amis étant des amis, Pacolli est également devenu l'un des amis très

chers du président Nursultan A. Nazarbaev du Kazakhstan qui lui a, entre autres, confié l'ouverture du «Ishim», un hôtel moderne construit dans la capitale Akmola.

Palais, hôtels, banques, fabriques, hôpitaux, maisons de congrès, nourriture pour bébés, Pacolli est partout et dans tout. Son personnel fixe est de plus de 800 personnes et le chiffre peut monter jusqu'à 6000 dépendant des chantiers en

cours. Pacolli ne n'a pas de partenaires. Il s'intéresse à tout et est même arrivé parmi les finalistes pour la construction de la Fenice à Venise. Il a des chantiers en Amérique du Sud et en Chine, ainsi que des projets touristiques en Amérique Centrale et en Floride. Récemment, il a acquis le Centre Thermale d'Acquarossa en Val Blenio avec la participation du canton du Tessin. Mario Botta a été mandaté comme architecte du futur centre de remise en forme ainsi qu'un hôtel de 256 lits, restaurants et salles de congrès. Autant dire que les heures de Behgjet Pacolli sont précieuses. Aussi habite-t-il tout simplement dans son jet personnel un Challenger, décoré naturellement, selon les goûts de Behgjet Pacolli. Quant à ses voyages, c'est Diamond Agencies qui s'en occupe, une autre compagnie de l'homme pressé.

COUPS D'OEIL N° 56 JUIN - JUILLET 1998

**Revista zvicerane Coup d'oeil u bëri vend ideve dhe projekteve të mia në mbarë botën. Nuk mungonin lajmet e mira për mua.**

ndonjë fakt për atë që “i kishte treguar”, kolegu i saj rus se me paratë që fitoja në Rusi, unë kam financuar UÇK-në. Mund ta marr se si e ka ndier veten kur e ka parë si qëndronte puna. Siç më më ka thënë Gerhard Fisher, ish-zëvendës i Kryeadministratorit në UNMIK, gjatë vizitës së saj në Prishtinë - tani ajo ishte bërë prokurore në Hagë - ka këmbëngulur te Kushneri, që *Mabetex*-it dhe Pacollit t'i mbyllën dyert në Kosovë. Ajo i kaloi caqet e kompetencave të veta, duke u sjellë edhe si prokurore e Kosovës, kinse si shpëtimtare e Kosovës. As sot e kësaj dite nuk mund ta kuptoj këtë qëndrim të saj. Kam dëshmi të fuqishme se del Ponte po punonte që të më implikonte me diçka që lidhej me Hagën, pasi në rastin tim në Zvicër kishte dështuar.

Nga kjo distancë kohore, mund të them vetëm një gjë: sikur të më kishin lejuar të hyja në Kosovë në vitin 1999 me krejt kapacitetet e mia, me përvojën dhe vullnetin që kisha, e them pa hezitim se sot Kosova do të kishte një pamje krejt tjetër, në çdo pikëpamje.

Ndër faktorët që patën ndikimin e vet në këtë aferë, ishte gjithsesi dhe media. Nuk ka rëndësi nëse media ishte ajo që e nxiti aferën, apo afera ishte ajo që e nxiti median. Në fakt, fjala është për një lidhje të pashkëputshme mes tyre, pa e përcaktuar dot saktë raportin shkak-pasojë.

Deri në fillimin e kësaj afere, raportet e mia me median kanë qenë gjithmonë korrekte. Profesionin e gazetarit e kam konsideruar profesion të nderuar me funksion të rëndësishëm shoqëror. Nuk më kishte shkuar mendja se gazetaria mund të instrumentalizohej aq lehtë dhe se mund të vihet në funksion të intrigave politike deri në atë shkallë, sa të shkelë mbi çdo parim etik e profesional.

Këtë nuk e them as me mllëf dhe as për farë hakmarrjeje, sepse, fundja, kur të kihet parasysh epilogu i aferës “Russiagate”, unë dola i fituar në dy plane: në planin moral, sepse e vërteta, sado e vonuar, doli në shesh, dhe, e dyta, sulmet e media më krijuan favorin e një popullariteti të jashtëzakonshëm, që mund ta ëndërrojë çdo biznesmen a njeri i politikës. Dhe ky nuk mund të quhej popullaritet negativ, sepse, në përgjithësi, megjithëse mbizotëronin notat negative, shumica e gazetarëve nuk mund të mos e shtronin dilemën: Kush kishte të drejtë? Cila ishte e vërteta? Duke e njohur psikologjinë e

lexuesit, i cili gjithmonë është i prirë të mos i besojë njëqind për qind asnjë medie dhe asnjë gazetari, kjo dilemë, edhe kur nuk thuhej fare, por edhe kur mund të thuhej shkarazi, sugjeronte mbylljen në favorin tim. Aq më tepër që unë nuk kisha folur akoma. Ende nuk e kisha thënë fjalën time të fundit.

Qindra shënime u botuan në gazetatat ordinere apo edhe prestigjioze anemabnë botës, nga Moska në Nju-Jork, nga Tokio në Paris, nga Frankfurti në Meksikë, nga Lugano në Prishtinë e Tiranë. Emisione pa fund në kanalet televizive më të njohura të botës. Lajmet e radiove dhe të agjencive as që ka marrë mundimin t'i numërojë kush. Mbase të gjitha këto i kishte parasysh njëri nga shefat e redaksisë së lajmeve të BBC, kur në Lugano, pas një konference për shtyp, më tha vendosmërisht:

- Mos u brengosni, zoti Pacolli. Edhe sikur gjysmën e Zvicrës ta kishit shitur, nuk do të arrinit ta paguanit këtë reklamë që ju ka bërë media!

Unë e kuptoja këtë, por nuk isha në gjendje të kuptoja diçka tjetër: si mund të shpifej aq paturpësisht? Si mund të shtrembëroheshin ose të manipuloheshin faktet deri në atë shkallë, sa gënjeshtër të pretendonte të dukej si e vërtetë e vetme, pa asnjë alternativë? Nga edukata që kisha marrë në atë Marecin tim të humbur – kisha ardhur në përfundim se gënjeshtër nuk është virtyt, por një ves nga më të këqijtë, që nuk i bën nder askujt. Si mund ta honepsja faktin që dy gazetarë rusë (tani që të dy në burg), Oleg Lurie dhe Vladimir Ivanidze, pasi nuk kishin lënë gjë pa shpifur kundër Pavel Borodinit, njeriut më të afërt të Jelcinit, m'u vërsulën mua, duke thënë se projektet e *Mabetex*-it në Rusi ekzistonin, por jo edhe ato të *Interplastica*-s, të cilën në vitet '80 e kishte drejtuar Behgjet Pacolli. Sipas tyre ato ekzistonin vetëm në letër. E kisha të vështirë ta pranoja gënjeshtërën kolosale, sepse fabrikat ishin kudo, në tërë Rusinë dhe mund të shiheshin me sy e të prekeshin me dorë. Madje, për t'i vërtetuar gjërat, nuk kishte nevojë as të shkonin në Jakutsk, ose diku tjetër. Mjaftonte të bënin një telefonatë dhe çdo gjë mund të vërtetohej. Ja dhe një shpifje monstruoze: po këta gazetarë rusë, duke pretenduar se tashmë kishin në dorë një rrëfim tronditës e shpallin Max Gygaksin të humbur, në një kohë që ai bënte jetë të qetë në Itali,

pas martesës së tij të tretë, pikërisht me ish-bashkëpunëtoren time. Pra, një shkallë të këtillë të papërgjegjësisë publike nuk mund ta kuptoja, sikundër që e kisha të vështirë ta pranoja një funksion tepër spekulativ të medias së lirë. Unë e dija se çfarë kishte qenë media në sistemin e ish-Bashkimit Sovjetik, apo në Lindje në përgjithësi. Por tani, që kontrolli politik ishte hequr, nuk e kuptoja si mund të zëvendësohej kaq shpejt kontrolli politik me atë të bosëve të rinj, që ishte shkatërrues për shtypin e lirë. Nga ana tjetër, unë nuk e kisha arritur atë shkallë indiferencë ndaj medias, që do të ma sugjeronte Ana Oksa (Oksa) më vonë: të kaloje pranë kioskave dhe të mos e blije gazetën edhe kur e dije se shkruante për ty, ose, madje, edhe kur e dije se një emision në TV të kushtohet ty, kurse ti të shikoje një kanal tjetër, ta zëmë, ndonjë reportazh për kafshët në savanat e Afrikës. Ndjeshmëria ime ndaj shtypit ishte rezultat edhe i faktit që deri atëherë mediet kishin pasur qëndrim kryesisht pozitiv ndaj meje. Deri atëherë ato kishin transmetuar kryesisht gjërat që ua kisha thënë unë vetë në intervista etj. Nuk më kishte ndodhur më parë që gazetarët të nxirrnin në gazetë gjërat që s'i kishin biseduar fare me mua.

Pra, kjo ishte një fushatë tipike mediale, e cila nuk kishte të bënte drejtpërdrejtë as me nevojën për të zbuluar të vërtetën e as me nevojën e prodhimit të sensacioneve, shumë herë të nevojshme për tirazhin e gazetave dhe shikueshmërinë e televizioneve. Kishim të bëjmë me një kombinim faktorësh si ato që i përmendëm më sipër, të pleksur mes tyre, ku mediet kishin pjesën e vet jo pak të rëndësishme.

Shumë medie u përdorën dhe u keqpërdorën, u bënë objekt manipulimi, Për llogari të mbështetësve politikë ose të bosëve të tyre, manipuluan faktet, bënë seleksionimin e tyre, trilluan dhe spekuluan, në mënyrat nga më të çuditshmet, duke shkelur çdo parim moral e profesional. Mjaftonte që të arrinin aty ku synonin. Pati, natyrisht, edhe raste të kundërta.

Siç e theksova më sipër, deri në shpërthimin e kësaj afere, tekstet e botuara nëpër gazeta a revista kishin pasur qëndrim kryesisht pozitiv. Më kishin quajtur “bos i ndërtimeve”- *New York Times*, “mbreti i punëve të Lindjes”- *La Stampa*; “Berluskoni shqiptar”;

“padroni i madh i shoqërisë tiçineze *Mabetex*, njeriu që ndërtoi dhe restauroi gjysmën e Moskës, përfshirë Kremlinin e Shtëpinë e Bardhë të shkatërruar në vitin 1993 nga goditjet e Jelcinit” - *L'Espresso*; “një eminencë gri në gjirin e komunitetit shqiptar” - *Le temps*; “mik i Boris Jelcinit dhe i gjithë nomenklaturës ruse” - *Panorama*, ndërsa dikush tjetër shkruante: “Origjinë kosovare, i mbajtur shumë mirë, 48 vjeç, shtetësi zvicerane, njohës i nja 12 gjuhëve, baba i dy vajzave.” E përditshmja e Komos (Como), *La Provincia*, sillte vlerësimin e dhjetëra sipërmarrësve dhe artizanëve të kësaj zone të Italisë, që kanë “një adhurim për të”, për shkak të punëve të shumta që u ka dhënë atyre dhe milionave të fituara nga firmat e tyre. “Pacollit nuk i mungon fantazia. As në sektorin e afarizmit, as në botën e politikës”, shkruante e përjavshmja *Panorama* në një rast tjetër.

Tekste me intonim kryekëput pozitiv u botuan edhe pasi filloi afera, madje edhe atëherë kur ajo ishte në kulmin e saj. Kështu, Zhak Alaman (Jacques Allaman), korrespondent nga Moska i ditoreve zvicerane *24 Heures* dhe *Le Temps*, shkruante se “Pacolli ka një paraqitje të bukur dhe flet një rusishte të shkëlqyer, me një aksent të lehtë italian”, duke shtuar më poshtë: “Qytetari zviceran me origjinë kosovare, Behgjet Pacolli, ka tejkaluar popullaritetin e Karla del Pontes”. Ndërkaq, sipas gazetës *Il Giorno* “Pacolli ka hirin misterioz të çapkënëve të adhuruar” dhe suksesin e ka arritur “falë fatit dhe talentit”. Ndërkaq, “mënyra e tij e komunikimit”, thekson *Panorama* “është direkte dhe me një buzëqeshje të çiltër”. Antjenë Dybiy (Entiene Dubius) në *Le Temps* vëren: “Historia e tij është ajo e një emigranti të varfër, që bëhet tejet i pasur”. E përjavshmja londineze *The Economist* thekson: “Mund të jetë, pa dyshim, më i pasuri në botë i etnisë shqiptare. Suksesi i tij buron nga aftësia e tij për të ndërtuar. Ai mund të rindërtojë lehtësisht atdheun e tij, bile të financojë një lëvizje të re politike. Megjithatë, në botën e zyrtë të politikanëve kosovarë, gjithmonë të ndrojtur ndaj yjeve të rinj që duken në horizont, ai ka tashmë armiq që e sulmojnë nëpër gazeta. Halli është se shqiptarët e Kosovës kanë shumë liderë, shumica e të cilëve janë të përfolur dhe të parëndësishëm.”

I vura në pah këto theksime të gazetave për një arsye të vetme: për të kuptuar se mediet në masë më të kufizuar ishin marrë me

mua edhe përpara se të fillonte afëra, kush për mirë, kush për keq, madje kishin nënvizuar ndonjë gjë, që më pastaj do të përdoret si “argument” politik për të më mënjanuar nga skena. Nuk e kam lodhur mendjen ndonjëherë për të kuptuar nëse kjo ishte fantazi e gazetarëve apo kuzhinat okulte e kishin përgatitur shumë herët mënyrën se si duhej të “përfshihesh” në një aferë kryekrejt politike. Tani, nga kjo distancë, mund të them me siguri se mënyra si u konstruktua “Russiagate” ngjante me një “lëvizje planetare” të faktorëve politikë nga më kontradiktorët. Media ishte pjesë e këtij konstruksioni. Ajo kishte rolin e vet, sepse të mbash 49 ditë një çështje në faqet e para të gazetave dhe në lajmet kryesore të medias elektronike, është e pamundur të mos synosh ushtrimin e një farë roli në këtë histori. A mund të shpjegohen vetëm me idenë e kërkimit të lajmit apo të sensacionit këto shifra të ofruara nga zyra ime e shtypit: rreth afërsisht “Russiagate” patën shkruar 63 gazetarë rusë, 30 gazetarë italianë, 51 gazetarë të Zvicrës, 21 gazetarë amerikanë, 18 gazetarë gjermanë, 6 francezë, 22 nga vendet e tjera të Europës, 123 gazetarë nga vende të tjera të botës, përfshirë edhe 13 gazetarë shqiptarë...? Përgjigja ime është: Jo, në asnjë mënyrë.



## Skena dhe prapaskena

*Kombinacionet e dy prokurorëve rusë dhe zviceranë Skuratov dhe Del Ponte, kundër Jelcinin, ku unë konsiderohesha hallka më e dobët. Roli qendror në akuzat kundër meje i një spanjollit të dyshimtë, i hetuar për mashtrime, i dyshuar si njeri i KGB-së. Shkeljet e ligjit vetëm që unë të pranoja kombinacionet e denja për literaturën e verdhë*

**A**fera kundër meje dhe *Mabetex*-it filloi pikërisht atëherë kur kisha arritur kulmin e suksesit. Sipas klasifikimit vjetor të *Handelszeitung*, në janar të vitit 1998, *Mabetex* zinte vendin e 72-të ndër firmat më të suksesshme të Zvicrës, duke pasur filiale në 16 vende të botës dhe duke realizuar gjatë vitit 1997 qarkullimin vjetor prej 1.6 miliardë frangash zvicerane. Sipas regjistrimit zviceran të tregtisë, përveç *Mabetex*-it, administroja edhe 12 shoqëri të tjera aktive në fushën e mjekësisë, të turizmit, të medieeve, të komunikacionit ajror etj. Në të vërtetë, *Mabetex*-i tashmë kishte, përveç qendrës në Zvicër dhe asaj në Rusi, 16 përfaqësi në vende të ndryshme të botës, Austri, Spanjë, Greqi, SHBA, Gjermani, Itali, Kazakistan, pastaj në Kosovë, në Shqipëri, në Bosnjë, në Slloveni, në Çeki, në Ukrainë dhe Uzbekistan.

Bëhej fjalë për një arritje të jashtëzakonshme, aq më shumë kur të merret parasysh koha e shkurtër prejse kishte filluar të funksiononte *Mabetex*-i. Nga ana tjetër, me gjithë faktin që afera kishte zgjuar një interesim të jashtëzakonshëm në medie, megjithatë, shumë të vërteta mbetën pa u thënë dhe pa u sqaruar deri në fund. Ishte e nevojshme, mbi të gjitha, një distancë kohore që gjërat të merrnin përgjigje adekuate, nëse jo për zhvillimet dhe prapaskenat, atëherë për shkaqet që i nxitën ato, duke pasur në fokus *Mabetex*-in dhe personin tim.

Kronologjia e ngjarjeve të çon së pari në Lugano, te një bankë që quhet *Banca del Gottardo*, të cilën në të ardhmen, për lehtësi, do ta quajmë *Banca del Gottardo*. Me këtë bankë kisha filluar të punoja që herët, ndonëse më vonë ishte pikërisht kjo bankë që u soll në

mënyrë të pandershme ndaj meje, duke thyer njërin nga ligjet themelore te shtetit zviceran të sektorit bankar, që është nxjerrja e sekretit bankar. Ndoshta ishte një lloj inercie, që më çoi në dyert e kësaj banke, sepse edhe *Interplastica*, gjatë kohës që punoja atje, shumicën e transaksioneve financiare i bënte pikërisht përmes *Banca del Gottardo*, përfshirë këtu edhe një numër kredish që lidheshin me investimet në Rusi dhe në ish-Bashkimin Sovjetik.

Mu për këtë, tre njerëzit më të rëndësishëm të kësaj banke, Generalin, Feninin dhe Mordasinin, drejtorin, zëvendësdrejtorin dhe një zyrtar të saj të lartë, që në vitin 1995, me avionin tim privat, i çova në Moskë dhe i prezantova me Borodinin.

Gjatë qëndrimit në Moskë, Franko Fenini u njoh me një person, për mendjen e tij shumë interesant, që ishte Felipe Turover. Ai ishte një djalosh i shkathët, që hynte e dilte nëpër zyrat dhe rezidencat e njerëzve më të rëndësishëm të Moskës, me prejardhje ishte hebre, ndërsa kishte shtetësi spanjolle dhe fliste pesë gjuhë. Ishte biri i një spanjollit që në Rusi kishte emër kumbues, sepse ishte autor i një fjalori të madh spanjisht-rusisht.

Fenini, zëvendësdrejtor i *Banca del Gottardo* në Lugano, do të binte shpejt në grackën e Turoverit, qoftë për shkak të ndihmës që i jepte ai për arkëtimin e kredive, qoftë edhe për shkak të dhuratave të majme që merrte prej tij. Por edhe *Banca del Gottardo* duket ishte e kënaqur me punën e këtij tandemi, sepse, përveç arkës që filloi të mbushej, edhe fama e saj filloi të rritej.

Dhe kështu, pa ditur se ç'do ta priste më vonë, Fenini ua prezantoi Turoverin autoriteteve të *Banca del Gottardo*, të cilët pas një kohe e marrin në punë, pa e ditur ose duke e anashkaluar qëllimisht faktin që Turoveri, siç do të dilte më vonë, jo vetëm që kishte një dosje të madhe mashtrimesh të të gjitha llojeve, por, sipas të gjitha gjasave, ishte edhe një eksponent i disa segmenteve të shërbimit sekret rus, KGB-së.

Por, mbi të gjitha, Turoveri në Spanjë kishte një proces gjyqësor në ngarkim, sepse kishte bërë një mashtrim me një dërgesë kompjuterësh në Rusi. Nuk thuhej përse, por as Izraeli nuk i kishte dhënë vizë. Ndonjë vit më vonë, ai do të bënte mashtrimin e radhës me prodhuesit e raketave balistike, në një republikë të vogël pranë

Volgës, duke shkaktuar skandal ndërkombëtar. Gazeta prestigjioze spanjolle, *El Pais* tashmë kishte bërë një portret të hollësishëm të Turoverit, duke e cilësuar atë me epitete nga më denigrueset.

Mirëpo, në Rusi punët qëndronin ndryshe: ai ishte mik i ngushtë me prokurorin e përgjithshëm rus, Skuratovin dhe ishte parë shumë shpesh në zyrat dhe mjediset që frekuentoheshin nga kjo sërë e zyrtarëve të lartë rusë. Ndërkaq, vetë Turoveri do të përsëriste vazhdimisht se aferat ndaj tij i shpikte shërbimi sekret rus, duke akuzuar për këtë vetë Putinin, i cili në atë kohë ishte shef i këtij shërbimi.

Gjatë vizitës së delegacionit të funksionarëve të lartë të *Banca del Gottardo* në Moskë, ata kishin rënë dakord me Turoverin që ky i fundit të punonte “part time” për *Banca del Gottardo* në Moskë, në mënyrë që t’i ndihmonte asaj t’i kthente kreditë e vjetra që nga koha e Bashkimit Sovjetik.

Me t’u futur në *Banca del Gottardo*, Turoveri e ktheu shumë shpejt situatën në dobi të vet, duke përdorur gjithnjë metodën e tij të njohur të dhuratave të shtrenjta për shefat e bankës dhe zonjat e tyre. Gjatë kohës sa zgjati afëra afëra “Russiagate”, disa medie zvicerane do të ngrenë me të madhe çështjen e sojit të njerëzve që punonin në institucionet financiare të këtij vendi. Ata, thoshin mediet, ishin kthyer në një kastë njerëzish pa moral dhe ishin bërë shkelësit më të mëdhenj të normave shoqërore dhe të ligjeve të shtetit.

Në këtë situatë, Turoveri gjeti hapësirë për veprime të paligjshme të të gjitha formave. Dihej se ai, ndër të tjera, u hapte konto oligarkëve rusë në *Banca del Gottardo*, ndonëse kjo ishte e ndaluar me ligjet e Ruisë. Për një konto dhe për shumën e depozituar, ta zëmë, prej një milion dollarësh, ai merrte si kompensim 10 për qind të asaj shume. Dhe jo vetëm kaq. Meqenëse ky ishte një veprim i ndaluar me ligjet ruse, Turoveri i shantazhonte ata, duke i detyruar t’i kryenin shërbime të ndryshme dhe duke u krijuar lloj-lloj privilegjesh.

Historia e Turoverit, i cili më pas do të përdorej si “dëshmitar” kyç në aferën “Russiagate” nga Karla del Ponte dhe Skuratovi, është tepër e gjatë dhe tepër e ndotur për të zënë më shumë hapësirë në këtë rrëfim. Mjafton të themi këtu se në tetor të vitit 1995 ai erdhi nga Moska në Lugano dhe, para shefave të *Banca del Gottardo*, e rrëfeu

në mënyrën e vet historinë e lidhjeve të tij me Feninin. Ai nuk tregoi se midis tij dhe Feninit kishte ekzistuar një marrëveshje, që fitimi për arkëtimin e kredive të ndahej përgjysmë, por do të deklarajoë se Fenini e kishte gënjyer, e kishte mashtruar dhe shantazhuar. Shefat e *Banca del Gottardo*, duke qenë tashmë të korrumpuar nga “dhuratat” e tij, u vunë në anën e Turoverit, ndërsa Feninin e përjashtuan nga Banka.

Pas kësaj ngjarjeje, Fenini erdhi në zyrën time, në selinë e *Mabetex-it* në Lugano. Kishte kohë që njiheshim dhe më erdhi keq për gjendjen e tij. Jo vetëm që kishte mbetur në rrugë, por ishte i zhgënjyer thellësisht me *Banca del Gottardo*, me njerëzit të cilët kishte punuar aq gjatë, me gjithçka. Unë e dija se ai ishte financier i zoti, por më shumë nga keqardhja, vendosa ta punësoja menjëherë në “*Mabetex Medical*”. Mbi të gjitha, unë nuk kisha asnjë arsye të mos e punësoja Feninin, aq më pak ndonjë pengesë ligjore, sepse përjashtimi i tij nga *Banca del Gottardo* ishte bërë për shkaqe marrëdhëniesh të brendshme ndërnjerëzore.

Por, pa kaluar as një javë nga punësimi i Feninit, diku në nëntor të vitit 1995, një zyrtar i lartë i *Banca del Gottardo*, me të cilin gjithashtu njihesha mirë prej vitesh, Nikola Mordasini, më thërret në një drekë kortezie dhe, në ndejë e sipër, më thotë: “Feninin duhej ta pushoni nga puna menjëherë!”

Kjo kërkesë për mua ishte tepër arrogante, jo vetëm e paarsyeshme, por edhe fyese, prandaj e refuzova në mënyrë kategorike. Si pasojë e refuzimit tim, *Banca del Gottardo* do të ndërmernte veprime të menjëhershme ndëshkuese, kështu që disa ditë më vonë ajo do të ndërpresë të gjitha marrëdhëniet me *Mabetex-in*. Mbylla të gjitha llogaritë, me përjashtim të kontos DEAN nr. 182605, (konto kjo, që për disa vjet radhazi do të bëhet shumë e përfolur në medie), si dhe kontoja ime personale. Llogaria DEAN ishte një llogari prej ku financoheshin shpenzimet e delegacioneve që vizitonin *Mabetex-in*. Prej saj paguheshin faturat e hoteleve, por edhe shumë herë në bazë të cash-it që kishte kjo llogari u jepeshin edhe kartat e përkohshme të kreditit udhëheqësve të delegacioneve, që qëndronin për më shumë se dy javë, e që vizitonin nënkontraktuesit e mi, përkatësisht materialet që prodhoheshin atje. Kështu që, në vend që unë të shkoja

me delegacionin, shkonin njerëzit e mi, kurse pagesat për hotele dhe ushqim bëheshin me kart-kredinë e përkohshme që e kishte udhëheqësi i delegacionit. Në momentin që delegacionet largoheshin për në shtetet e tyre, kart-kredia lihej këtu, gjegjësisht i dilte afati dhe ishte e papërdorshme më. Për mua një gjë e tillë ishte shumë normale dhe praktike. Kurrë nuk do të mendoja se dikush, lëshimin e këtyre kart-kredive do ta keqpërdorte për afera mediatike. Banka e dinte këtë dhe pothuajse me qëllim të keq e kishte mbajtur të hapur këtë konto gjë që unë do ta kuptoja vetëm në vitin 1999.

Ndërprerjen e bashkëpunimit të kësaj banke me *Mabetex*-in ata e justifikonin duke marrë si shkas ardhjen e Feninit në *Mabetex*. Sipas tyre Fenini dinte shumë gjëra për bankën (ai kishte punuar atje mbi 20 vjet) dhe ekzistonte rreziku, që sipas tyre, informatat sekrete të bankës mund t'i transmetonte në *Mabetex*, gjegjësisht tek unë. Arsyetimi i Mordasinit ishte qesharak dhe nuk ma mbushte mendjen. Lloji i biznesit tim nuk kishte të bënte me të dhënat e bankës për njerëzit e tjerë; me këtë bankë kisha vetëm marrëdhënie pagesash dhe nuk kisha investime apo obligime ndaj saj. Unë punoja me para të fituara me djersë.

Dy vjet më vonë, më saktë në dhjetor të vitit 1997, unë kërkoja nga Banka e Gotardi mbylljen e llogarisë së fundit DEAN. Një kohë të gjatë nuk e e kisha të qartë një ecejake pa fund formularësh nga zyra ime në Bankë dhe anasjelltas, për të mbyllur një konto krejt të zakonshme. Mbaj mend se kjo ecejake formularësh ndodhi deri ditën kur unë shënova emrin e bankës ku do të transferoheshin paratë e mbetura (Banka e Zvicrës Italiane - *Banca Svizzera Italiana*).

Diku në janar të vitit 1998 u bë mbyllja e kontos DEAN, me një mbetje për transferim në një llogari dhe bankë tjetër të një shume aspak më të madhe se 68,673 dollarë. Për lexuesin, kjo ka rëndësi të mbahet mend, sepse Karla del Ponte, Skuratovi dhe mediet që ja mbanin ison, duke u mbështetur në dëshmitë e rrejshme të Turoverit, thoshin se në këtë konto kishte një shumë prej 11 milionë dollarësh dhe se ato para ishin përdorur për zyrtarët e Kremlinit. Kjo shumë asnjëherë nuk kishte qarkulluar në këtë konto. Aty kishin qenë gjithsej rreth një milion e tetëqind mijë dollarë. Ku kishin shkuar ato para dhe për çfarë ishin përdorur? Shumë thjesht: ajo kishte qenë

Ilogari ndihmëse e *Mabetex*-it dhe prej saj ishin tërhequr para për shpenzime nga më të ndryshmet, duke filluar nga kartat e kreditit të personelit të ngushtë e deri te mëditjet dhe shpenzimet e udhëtimit. (Në të vërtetë, siç do të dalë më vonë në gazetën *Le Temps* të Gjenevës, ndaj meje që në ato muaj të fundit të vitit 1997 ishin zhvilluar hetime të fshehta, duke e hedhur dyshimin kryesor te kontoja DEAN. Sipas supozimeve të Karla del Pontes, dhe më vonë edhe të Skuratovit, (i cili atëherë ishte kryeprokuror i përgjithshëm i Rosisë dhe gjatë kësaj kohe kishte bashkëpunuar ngushtë dhe në mënyrë të fshehtë me Karla Del Ponten) kjo konto ishte hetuar, së pari nëse ishte imja ose jo, dhe, së dyti, nëse përmes saj bëheshin pagesa në emër të Jelcinit dhe të anëtarëve të familjes së tij, apo edhe të Borodinit. Kishte mundësi, sipas tyre, të ndodhte edhe ndryshe: që dikush nga Rusia të derdhte para në këtë konto! Prandaj edhe mbyllja e saj në *Banca del Gottardo* nuk u bë, derisa nuk u shënuar banka ku do të transferoheshin paratë prej saj, gjithnjë duke pasur dyshim se ku do të shkonin paratë e mbetura.)

Ndërkohë, po në janar të vitit 1998, *Banca del Gottardo* filloi të dyshonte më në fund se mos Turoveri ishte njeri i shërbimeve të huaja, ndoshta i dërguar nga Skuratovi dhe sakaq e largoi atë nga puna. Unë nuk e di arsyeën e këtij largimi dhe as nuk pati ndonjë variant zyrtar lidhur me këtë, por kështu flitej çdokund dhe këtu bazohej supozimi. Është traditë e punëve bankare në Zvicër që marrëdhëniet e brendshme të personelit, sikundër edhe raportet me klientët, të mos bëhen publike. Andaj, nuk është çudi që as sot e kësaj dite unë nuk e di se cila ka mundur të jetë arsyeja e përjashtimit të Turoverit nga *Banca del Gottardo*. Mund që banka ia kishte mbyllur dyert, por mund që ai vetë, pra Turoveri, ta kishte ndërprerë bashkëpunimin me të. Por më e mundshme është se udhëheqjes së *Banca del Gottardo* mund t'i ketë ardhur ndonjë pjesë e dosjes së mashtrimeve të Turoverit dhe detyrimisht ia ka mbyllur derën. Apo ishte fjala për diçka tjetër, akoma më e rëndë: flitej se Turoveri, me dhuratat e shtrenjta, me ryshfetet dhe me shpenzimet pa karar që bënte, mund të kishte krijuar një gropë të madhe financiare në *Banca del Gottardo*. Megjithatë, duke dalë nga banka ai kishte thënë me zë të lartë, që ta dëgjonin të gjithë: “Do të ma paguani shtrenjtë



*Një moment çlodhjeje në shtëpinë time në Montanjola, Zvicër*

këtë, shumë shtrenjtë!”

Gjatë punës në *Banca del Gottardo* në Lugano, duke qenë njeri kurioz dhe i prirë për lloj-lloj malverzimesh, Turoveri duhet të kishte parë mjaft dokumente të saj. Një numër syresh ai duket se i kishte nxjerrë nga banka ose i kishte fotokopjuar, sepse, nëse ka qenë njeri djallëzor dhe mashtrues, duhet ta kishte pasur parasysh faktin se ato dokumente mund t’i shërbenin për shantazh ose diçka të tillë. Ai gjithashtu duhet ta ketë ditur se çdo bankë e Zvicrës, më shumë se nga çdo gjë tjetër, ruhet nga skandalet publike. Prandaj, të nxjerrësh dokumente nga një bankë, përbën gjithmonë një rrezik për skandal. Duke qenë një vend me traditë bankare dhe me një funksionim specifik të tregut financiar, Zvicra ka bërë ligje që e pengojnë nxjerrjen e sekretit bankar, pra kush, kujt, çfarë i paguan,



*Me Presidentin e Sllovenisë, z. Milan Kuçan, 1994. në vilën presidenciale në Bled. Që atëherë ai më sugjeronte se Kosova duhet të ndiqte shembullin e shtetit të tij. Më ka impresionuar respekti që sllovenët i rezervuan Kuçanit, pa marrë parasysh të shkuarën e tij komuniste, duke vlerësuar kontributin për pavarësinë, drejtimin e urtë dhe ndershmërinë e tij proverbiale*

kush çfarë kontosh ka hapur e kështu me rradhë. Janë shumë të rralla rastet, kur mund të dalin jashtë bankës dokumentet e tilla.

Çfarë ndodhi më pas? Duke u bazuar në deklaratat e mëvonshme të vetë Turoverit, ai kishte një çështje të hapur me Feninin, sepse e akuzonte atë jo vetëm për 200 mijë dollarët që vetë ia kishte bërë dhuratë në Moskë, por edhe për një shumë prej 3 milionë dollarësh, e cila, sipas pretendimeve të Turoverit, i takonte atij dhe që Fenini ia kishte marrë në mënyrë të padrejtë. Por Turoveri nuk ishte aq naiv, sa të mos e dinte se gjëra kaq ordinere nuk përbënin ndonjë “greq” për Karla del Ponten. Ndërsa ai, siç e përshkruan *El Pais*, ishte shumë hakmarrës. Në këtë rast objekt i hakmarrjes së tij do të ishin Fenini, vetë unë që kisha pasur guxim ta merrja Feninin në punë dhe,



natyrisht, *Banca del Gottardo*, që e kishte nxjerrë në rrugë.

Por ka edhe një mundësi tjetër. Po ashtu flitej që Turover ishte futur në të gjitha këto marrëdhënie me porosi nga Moska me dijeninë e Bernës. Thjesht ai mund të ishte spiun i dyfishtë, pra edhe i policisë së fshehtë zvicerane, e cila, duke pasur në dorë dosjen e tij kriminale, e përdorte për marrjen e informatave rreth transaksioneve financiare në relacionin Rusi-Zvicër. Po që se ishte kështu, dërrasa në të cilën kishin shkelur organet zvicerane ishte e kalbur, sepse Turover ishte i gatshëm të dëshmonte rrejshëm, të gënjente, të falsifikonte, të bënte çdo gjë, mjaftonte që të arrinte atë që dëshironte. Siç do të shihet më vonë, pikërisht kështu kishte ndodhur: “fshehtësitë” e Bankës ai i kishte dërguar së pari te Karla del Ponte.

Nuk ishte e rastit prandaj, që pas largimit nga *Banca del Gottardo*, Turover shkoi në Bernë dhe trokiti në derën e Karla del Pontes. Ai e dinte se çështja e tij me Feninin nuk paraqiste asgjë për prokuroren e përgjithshme. Edhe nëse kishte marrë detyrë paraprakisht të hetonte ndonjë gjë, ajo që kishte në dorë, ishte diçka krejt e vogël dhe i përkiste vetëm atij. Prandaj, ai bëri një konstruksion lapidar: ofroi gjoja një histori korrupsioni të vetë kreut të shtetit rus, Boris Jelcinit. Kjo ia hapi atij dyert e Prokurorisë së Përgjithshme të Konfederatës Helvetike. Takimin me Karla del Ponten, siç do shihet nga dokumentet e mëvonshme që do t'i posedojmë, ai arriti ta siguronte përmes bashkëpunëtorëve të prokurores.

“Është një tip”, i thonë ata Del Pontes, “që pretendon se ka në dorë prova kompromentuese për Presidentin rus, Boris Jelcin. Flet për disa letra krediti, dokumente bankare, për llogari të fshehta në Lugano...”

Kaq iu desh Karla del Pontes, e cila nuk mund të linte që ky rast t'i shpëtonte nga dora. Madje, duket se ajo u entuziazhua aq shumë, sa që nuk e lodhi mendjen ta shihte nëse ky farë Turoveri ishte person që mund t'i besohej. Duket se askush nga Prokuroria e Përgjithshme nuk bëri as ekspertizën e dokumenteve që kishte në dispozicion Turoveri, nëse ato kishin ndonjë vlerë apo jo, mos ishin të falsifikuara, e kështu me radhë.

Përveç kësaj, sikur Karla del Ponte ta kryente punën e saj si duhej, po në atë çast do të duhej të jepte urdhër për arrestimin e

Turoverit, sepse ai kishte nxjerrë sekretin bankar, veprim që ndiqet penalisht në Zvicër. Kush e kishte autorizuar Turoverin për diçka të tillë? Por, duket se preokupimi i Del Pontes ishte në rradhë të parë diçka tjetër: si të siguronte pjesëmarrjen e palës ruse në këtë hetim ndërkombëtar? Ajo nuk mund të ishte e sigurt se prokurori i përgjithshëm rus do të që i gatshëm të hetonte kundër Presidentit të vendit të vet. Nga ana tjetër, paraprakisht duhej bërë edhe një marrëveshje ose protokoll bashkëpunimi midis dy shteteve, sepse, në të kundërtën, hetimi jo vetëm që nuk do të kishte sukses, por edhe mund të pengohej administrativisht dhe juridikisht.

Po kush ishte homologu i Karla del Pontes në Rusi? Jurij Skuratov, një njeri që kishte bërë emër në hierarkinë e gjyqësorit në ish-Bashkimin Sovjetik, kryesisht duke e vënë drejtësinë në shërbim të politikës dhe duke çuar shumë njerëz në burg për arsye ideologjike. Jelcini do të tentonte ta hiqte nga detyra tri herë radhazi, por nuk do t'ia dilte, për shkak të mbështetjes së fortë që gëzonte nga ish-komunistët. Në rreshtimet paraelektorale të vitit 1999, ai që herët ishte pozicionuar në anën e Luzhkovit, oponent i Jelcinit.

Pra, që plani të funksiononte si duhej, ishte e nevojshme që, së pari, ndërmjet prokurorive të përgjithshme të Zvicrës dhe Rusisë të nënshkruhej një protokoll bashkëpunimi, ku një pikë të veçantë do të përbënte lufta e përbashkët kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave. Edhe për këtë çështje me rëndësi shtetërore, përsëri hyri në lojë Turoveri, i cili njihej shumë mirë me Skuratovin. Me rekomandimet e Bernës, ai shkoi në Moskë dhe u prit me nderime në Prokurorinë e Përgjithshme të Federatës Ruse.

Që të nënshkruhej protokollin i bashkëpunimit me Bernën, Skuratovi u bind nga “faktet” që ia ofroi Turoveri. Bëhej fjalë për një çështje të madhe, për korrupsion të përmasave të mëdha, ku ishin përfshirë njerëzit e afërt të Jelcinit, siç ishte Borodini, madje edhe vetë Jelcini dhe familjarët e tij! Skuratovi doemos që fërkoj duart, i kënaqur që, më në fund, mund të godiste aty ku e kishte syrin prej kohësh, te Jelcini dhe bashkëpunëtorët e tij, të cilët me insistim kërkonin largimin nga posti i prokurorit të përgjithshëm.

Një çështje tjetër shtrohet tani: Përse Karla del Ponte, pas deponimeve të Turoverit, nuk nisi asnjë proces hetimor kundër



*Projekti i Mabetex-it në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe*

meje, ndonëse unë isha shtetas zviceran dhe *Mabetex*-i ishte firmë nën juridiksionin e Zvicrës? As prokuroria e përgjithshme, as ajo kantonale e Tiçinos, nuk do të nisin kurrë kundër meje, një hetim të tillë, siç do të deklarohet zyrtarisht. Arsyet janë dy: e para, se një çështje e këtillë hetimore, e hapur në Zvicër, haste në pengesa të mëdha ligjore dhe mund t'i vinte përpara drejtësisë vetë iniciuesit e hetimeve dhe, e dyta, që goditja të ishte e fortë për Jelcinin dhe të kishte efekt në fushatën parazgjedhore, ajo duhej të zhvillohej në Rusi.

Në anën tjetër, për çështjen *Mabetex* dhe kundër meje, Karla del Ponte e kishte filluar bashkëpunimin me Skuratovin përpara se

të nënshkruhej protokoll i zyrtar, që u bë më 24 prill 1998. Janë dy deklarata që e dëshmojnë këtë. E para është e Feliks Bancigerit (Felix Banziger), pasardhës i Del Pontes, pasi ajo kaloi në Gjykatën e Hagës. Në një intervistë dhënë Televizionit të Zvicrës Gjermane, DRS, në emisionin “Rundschau”, Bancigeri deklaroi: “Kam marrë pjesë në hedhjen e procesverbalit të një dëshmie të Filipe Turoverit në zyrën e Karla del Pontes në Bernë. Ishte prilli i vitit 1998”. Deklarata e dytë erdhi nga vetë Skuratovi, i cili gazetës *Le temps* të datës 3 qershor 1999 i deklaronte: “Kam dëgjuar të flitet për këto gjëra në prill të vitit të kaluar, kur Karla del Ponte më njoftoi se kishte zbuluar të dhëna e informata për korrupsion, që vinin nga policia zvicerane, gjermane dhe italiane, të cilat kanë të bëjnë me aktivitetin financiar të grupit tiçinez *Mabetex*, si dhe kompanive të tjera aktive në tregun rus.”

Pra, Karla del Ponte kishte bërë një shkelje tjetër të rëndë. Ajo nuk mund të kalonte te një shtet i huaj një çështje hetimore të juridiksionit të saj, ende pa u nënshkruar protokoll i bashkëpunimit, megjithëqë, ç’është e vërteta, me gjithë angazhimet e avokatëve të mi, ajo letër e nënshkruar në Bernë nga Del Ponte dhe Skuratovi nuk u gjet ndonjëherë dhe as nuk u ratifikua në ndonjë organ shtetëror, siç veprohet zakonisht në raste të këtilla.

Që të ndjekim më tej fillin e këtyre zhvillimeve, është e nevojshme të sqaroj këtu edhe një çështje tjetër: nga i kishte marrë Turoveri ato dokumente? Me *Mabetex*-in ai nuk kishte të bënte fare, përveç me disa procedura strikte, që kishin të bënin me kthimin e kredive, madje edhe ato jo me *Mabetex*-in, por me *Banca del Gottardo*. Rrjedhimisht, si i kishte shtënë në dorë disa nga dokumentet bankare që ia paraqiti Del Pontes? I kishte vjedhur nga *Banca del Gottardo*, apo ia kishte dhënë vetë banka?

Supozimet çojnë te njëra dhe tjetra mundësi, por, duke parë se gjatë gjithë kësaj historie Karla del Ponte tregojte tepër e kujdesshme ndaj kësaj banke, duke u përpjekur të mos e përziante atë në asnjë mënyrë në aferë, është shumë më e mundshme që *Banca del Gottardo* i kishte ofruar vetë dokumentet. Për krejt shërbimet e paligjshme që mund të ketë bërë në nxitjen e kësaj afere, banka mund të kishte kërkuar vetëm një kompensim: që emri i saj të mos përmendej në

medie, për ç'gjë Karla del Ponte dhe e gjithë prokuroria zvicerane u treguan jashtëzakonisht të kujdesshme.

Por, lidhur me këtë bankë, do sqaruar edhe një çështje tjetër. Turoveri, nëntë muaj pas largimit nga *Banca del Gottardo*, u kthye sërish aty, duket se kësaj radhe për t'i bërë bankës një shantazh, duke kërkuar prej saj shumën që tashmë e konsideronte se ia kishte rrëmbyer Fenini. Për këtë, sigurisht me sugjerimin e Karla del Pontes, Turoveri ngriti edhe një padi kundër Feninit në Lugano. Pse? Sepse prokurores së përgjithshme, siç do të shihet më vonë, i duhej një pretekst për të hyrë në zyrat e *Mabetex-it*, meqë vetë nuk kishte arritur të formulonte një akuzë të qartë ndaj meje dhe firmës sime. Tani, le t'i kthehemi përsëri çështjes së parë, që ka të bëjë me protokollin e bashkëpunimit ndërmjet prokurorive të përgjithshme të Zvicrës dhe Ruisë. Jemi ende në vitin 1998. Në nëntor të atij viti, nisin të vijnë shkresat e Prokurorisë së Përgjithshme të Ruisë në adresë të Prokurorisë së Përgjithshme të Konfederatës Helvetike. Në të vërtetë, janë gjithsej tri shkresa të dërguara nga Jurij Skuratovi për Karla Del Ponten, njëra në nëntor të vitit 1998 dhe dy të tjerat në janar të vitit 1999. Ato duhej të dëshmonin se midis Zvicrës dhe Ruisë mund të fillonte zbatimi i marrëveshjes së përbashkët hetimore. Këto shkresa gjithashtu dëshmojnë se Turoveri kishte një mendje djallëzore, e cila prodhonte “dëshmi” sipas porosisë, në mënyrë serike: kur nuk mjaftonte njëra, nxirrte tjetrën; kur nuk mjaftonte as e dyta, nxirrte të tretën, duke vënë në lojë organet e drejtësisë të të dy shteteve njëherësh.

Në shkresën e parë, të dërguar më 10 nëntor 1998, Skuratovi i kërkonte Del Pontes të përqendrohej në këto çështje: një e para, se pala ruse kishte informata se kontratat ndërmjet shoqërisë zvicerane *Mabetex Project Engineering SA* dhe Zyrës së Administrimit të Presidentit të Federatës Ruse, për rikonstruktimin e godinës nr. 1 të kompleksit të Kremlinit, të Dumës dhe të godinës së Qeverisë së Ruisë, të kryera gjatë viteve 1993-1994, ishin rritur 30-50%; dhe, e dyta, se pronari i *Mabetex-it*, Behgjet Pacolli kishte hapur në Zvicër një llogari të koduar DEAN pranë *Banca del Gottardo* në interes të shefit të Zyrës së Presidentit, zotit Pavel Borodin, me një vlerë prej 11 milionë dollarësh amerikanë. Me këtë rast, përveç që e njoftoi

Del Ponten se ndaj Borodinit tashmë kishte filluar ndjekja penale, Skuratovi i kërkoi asaj të qartësojnte nëse Borodini dhe funksionarët e tjerë rusë, Savçenko, Lulkin dhe Kozelko, kishin pasur llogaritë e tyre pranë *Banca del Gottardo*.

Që ta ndihmonte në hetimin e çështjes, Skuratovi i kërkoi Del Pontes dokumente bankare për hapjen, qarkullimin e parave dhe mbylljen e llogarive, pastaj dokumentet e mundshme për personat e autorizuar për t'i përdorur këto llogari, si dhe urdhëresa, pagesa, çeqe dhe dokumente të tjera të firmosura nga personat përkatës, të autorizuar për përdorimin e fondeve në këto llogari. Gjithashtu, në këtë shkresë kërkohet edhe “çdo informatë tjetër që posedonte Prokuroria Helvetike në lidhje me llogaritë bankare të funksionarëve rusë”, si dhe për lidhjet mes shoqërisë *Mabetex* dhe personave të mëposhtëm: Viktor Titov, Leonid Anourov, Andrej Anourov dhe Jevgeni Lenski.

Në fund të kësaj letre, sipas protokollit, Skuratovi zotohej se këto informata nuk do të përdroreshin “kundër Zvicrës dhe kundër shtetasve të saj”. Po le të ndalemi pak te kuptimi i kësaj “formule” krejt të zakonshme në korrespondencën juridike të kësaj natyre? Rezulton se, nëse këto të dhëna nuk mund të përdroreshin kundër meje në Rusi (si shtetas zviceran), ishte e pritshme që mua të më pritnin “befasi” të reja, nëse Skuratovi dhe Del Ponte kishin vendosur të më përgatitnin një kurth tjetër.

Në periudhën nga nëntori deri më 10 janar 1998, kur vjen shkresa e dytë e Skuratovit, duket se Karla del Ponte i kishte plotësuar të gjitha kërkesat e tij. Por disa gjëra kishin mbetur ende pezull dhe kërkonin sqarim të mëtejshëm, sepse ajo që ishte dërguar, duket se nuk ishte e mjaftueshme për të ngritur akuzë penale të qëndrueshme kundër “të implikuarve” rusë në këtë aferë, veçmas Borodinit. Por ka edhe diçka tjetër. Turoveri me Skuratovin, ndoshta edhe para Del Pontes, bëjnë një shpifje tjetër të rrezikshme, në mënyrë që të gjendet një shkas për të më penguar në Moskë, nëse gjatë asaj periudhe do të shfaqesha atje, sepse në këtë letër prokurori i përgjithshëm rus, ndër të tjera, shkruante: “ne kemi gjetur informacione, sipas të cilave pronari i shoqërisë ‘*Mabetex*’, zoti B. Pacolli, në vitet 1996-1998 ka futur në Rusi shuma të konsiderueshme parash në dorë”.

Çka do të thotë: nëse informacionet e mbledhura dhe dokumentet e dërguara nga Berna në Moskë nuk mund të përdroreshin kundër një qytetari zviceran, tani këtu kishte një tjetër akuzë, e cila kishte të bënte me sjelljen time gjatë qëndrimit në Rusi: futja e padeklaruar dhe e jashtëligjshme e parave të gatshme në shuma të mëdha, që ishte e dënueshme me ligjet ruse. Është e vërtetë se ne në mungesë të funksionimit të bankave në Rusinë e atëhershme në kaos, pagesat e pagave të punëtorëve dhe shpenzimet tjera në Rusi i kemi bërë gjithmonë me para të gatshme duke i tërhequr zyrtarisht nga Bankat e Zvicrës dhe duke lajmëruar autoritetet e doganave të Zvicrës në dalje, si dhe ato ruse në hyrje. Për çdo muaj ne kemi dërguar miliona e miliona për pagesën e mijëra punëtorëve, por gjithmonë në mënyrë legale. Për këtë, me gjithë ndonjë intrigë që mund të ndodhte, unë isha i qetë. Supozimi i Skuratovit në këtë rast ka qenë i saktë, por jo i plotë. Ai është dashur të thotë se në bazë të deklaratave të doganave ruse, *Mabetex*-i në mënyrë legale ka lajmëruar futjen e parave ashtu siç e parashihte ligji rus në atë kohë. Çdo tentativë e shtrembërimit të kësaj informate, ka qenë jokorrekte nga ana e Skuratovit.

Po “ndihma” e Zvicrës në çfarë mund të konsistonte në këtë mes? Të shihej nëse unë gjatë asaj periudhe kisha tërhequr para të gatshme nga banka, në mënyrë që pastaj shuma e tërhequr të “koordinohet” me një montim që u tentua të më bëhej pikërisht në Moskë.

Sigurisht që në këtë letër kishte edhe gjëra të tjera, që Skuratovi kërkonte të sqaroheshin. Nëse Turover kishte thënë se në llogarinë DEAN (e cila sipas supozimeve të tyre duhej të ishte e Borodinit) ka pasur 11 milionë dollarë, ku kanë shkuar ato para? Janë blerë prona? Apo çfarë ka ndodhur me to? Prandaj, Skuratovi kërkonte të dinte nëse unë kisha pasur autorizime të tilla, mbështetur në dokumente, që të mund të disponoja me ato para dhe t’i administroja ato sipas porosisë së Borodinit. Apo kam pasur autorizime të blej dhe të administroj prona në emër të tij? Përveç kësaj, letra dëshmon edhe një gjë tjetër: se ngatërresat që u shfaqën me rastin e mbylljes së llogarisë DEAN në *Banca del Gottardo*, kishin qenë të qëllimshme, jo vetëm për të kuptuar se ku do të paguhej shuma e mbetur, por edhe sa ishte ajo shumë. Prandaj Skuratovi kërkonte të dinte nëse Borodini kishte një konto në Bankën e Zvicrës Italiane, ku u dërguan

paratë e mbetura të llogarisë së përmendur. Pra, letra është një dëshmi se të gjitha prapaskenat ishin luajtur me kujdes të madh dhe se çdo gjë ishte përgatitur me kohë, grackë pas gracke, me idenë se ishte e pamundur të mos bija në ndonjërin sosh.

Ndërkaq, akuzat tani sikur kishin filluar të ravijëzoheshin më qartë. Pra, “unë kisha bërë” paralelisht dy veprime të paligjshme, një në Zvicër dhe një në Rusi. Në Zvicër, sipas tyre, kisha hapur konto të funksionarëve rusë, në të cilat depozitoja para, si kompensim për tenderët që fitoja konform vlerës së kontratave, të cilat, në marrëveshje me zyrtarët rusë, i rritja 30-50%, “kurse në Rusi kisha futur para të gatshme në shuma të mëdha”.

Por dukej se edhe kjo ishte pak. Tri ditë më vonë, më 13 janar 1999, në Prokurorinë e Përgjithshme të Zvicrës, në emër të Karla del Pontes, vjen shkresa e tretë nga Skuratovi, me akuzën e formuluar më qartë dhe me një kërkesë të prerë: të hulumtoheshin dokumentet e *Mabetex-it* në Lugano. Letra kësaj radhe ishte më e shkurtër dhe disa pjesë të saj mund t'i japim këtu, që t'i bëjmë të mundur lexuesit t'i kuptojë më mirë gjërat: “*Në bazë të informatave që kemi në zotërim për hetim*”, shkruante Skuratovi, “*Sekretaria e Presidentit dhe shoqëria zvicerane ‘Mabetex Project Engenering’ kanë rritur 30-50% vlerën e kontratave paraprake të punimeve për restaurim të godinave të Dumës së Shtetit dhe për pajisjet e mundshme të brendshme të godinës së Qeverisë. Këto kontrata janë lidhur më 1993-1994. Për këto rritje, pronari i shoqërisë, B. Pacolli, ka hapur për zotin P. P. Borodin, shef i Shërbimeve Administrative, një llogari personale të koduar në Banca del Gottardo. Zoti Pacolli ka deponuar në këtë llogari rreth 11 milionë dollarë amerikanë. Me qëllim që të përcaktohet vlera e saktë e kontratave, të dalë e vërteta (...) unë ju lutem të kryeni një kontroll në zyrat e shoqërisë Mabetex për të kërkuar kontratat paraprake për kryerjen e punimeve të restaurimit në ndërtesën nr. 1 të Kremlinit, të Dumës së Shtetit dhe pajisjet e brendshme të Pallatit të Qeverisë së Rusisë. Ne kërkojmë gjithashtu që të kërkojnë letrat e kompanisë dhe të Sekretarisë së Presidentit të Federatës Ruse (në veçanti, letrat e shkruara personalisht nga zoti Borodin) dhe dokumente të tjera që u përkasin shkeljeve dhe shpërdorimeve të kryera nga funksionarë të Sekretarisë dhe të aktiviteteve të kundërligjshme nga shoqëria Mabetex”.*



Kjo letër, e treta me radhë, nuk ka nevojë për ndonjë analizë të hollë. Për mua dy gjëra janë më se të qarta: e para, se Skuratovi, edhe përkundër kontrollit që kishte urdhëruar të bëhej në zyrat e Borodinit, nuk kishte gjetur ato që kërkonte dhe që i kishte sugjeruar Turoveri, prandaj kërkonte ndihmën e Karla Del Pontes; dhe, e dyta, skenari për të bërë kontroll në zyrat e *Mabetex*-it në Lugano ishte përpunuar nga Karla del Ponte, qëkur i qe sugjeruar Turoverit të ngrinte padi kundër Feninit, në mënyrë që të gjente pretekst të hynte në zyrat e *Mabetex*-it. Ndërkohë prokurorja e përgjithshme e Zvicrës e kishte menduar vetë kontrollin e *Mabetex*-it, por formalisht ishte e interesuar ta paraqiste si kërkesë ruse, në mënyrë që vetë të mos dukej e implikuar në këtë aferë. Por, kjo nuk është e tëra.

## Përballë Karla del Pontes

*Përvoja ime me Karla del Ponten, numrin një të hetimeve në Zvicër. Manovrat antiligjore për të më mposhtur. Dhunimi i Mabetex-it. E drejta vonon, por fiton, me gjithë peripecitë e kuptueshme për terrenin ku zhvillohej biznesi im. Parimet morale fitojnë mbi etjen për karrierë.*

**U**në kurrë nuk kam qenë ithtar i konspiracioneve dhe nuk më pëlqen të konstruktoj ngjarje nëpërmjet fantazisë. Duke u marrë një kohë të gjatë me biznes, kam krijuar prirjen e një pragmatizmi të skajshëm, kështu që gjërat e padukshme e kam të vështirë t'i imagjinoj. Përvoja më ka mësuar t'i përballoj vështirësitë e jetës, pavarësisht sa të mëdha janë ato, duke i parë gjërat në rrafshin e marrëdhënieve reale me njerëzit dhe rrethanat. Me këtë dua të them se nuk e kisha marrë me mend ndonjëherë se do të gjendesha në një situatë ndodhish e prapaskenash të ndryshme të cilat qëndronin në kufijtë e skajshëm të fikSIONIT.

Shkurt fjala, unë isha ngjitur shkallëve të suksesit duke kaluar nëpër të papritura e peripeci të shumta, kisha mësuar rregullat e lojës në fushën e biznesit, por kurrë nuk i kisha shkelur parimet e mia morale dhe njerëzore. Kurrë s'e kam parë veten si hero filmash a romanesh aventuristike. Rruga nëpër të cilën kisha ecur ishte krejtësisht e drejtë dhe e qartë, ndonjëherë me kthesa të papritura, por gjithmonë e mbështetur në tabanin dhe parimet e biznesit të ndershëm.

Po çfarë ndodhi? Papritmas u gjenda mes një loje të rrezikshme, i rrethuar me lloj-lloj grackash e prapaskenash. I shantazhuar, mbi të gjitha. Unë kam një edukatë tradicionale, të tillë çfarë ma ka dhënë familja ime gjithmonë e ndershme dhe krenare për vlerat e saj morale. Shkollimi im në Përrëndim më kishte përgatitur për një punë të vështirë, por gjithnjë brenda rregullave dhe normave të biznesit modern. Duke jetuar e vepruar një kohë të gjatë në Përrëndim, unë jam mësuar të respektoj normat e jetës dhe mbi të gjitha ligjin. Në anën tjetër, kam krijuar bindjen se kapitalizmi liberal i jep shansë

secilit, por ai ka parimet e tij, sikundër që kam bindjen se shteti ka ndërtuar sistem të tillë normash ligjore, të cilat e mbrojnë individin nga nëpërkëmbja e të drejtave të tij.

Nuk e kisha menduar ndonjëherë se një përfaqësues i rangut të lartë të shtetit të së drejtës, Zvicrës, çfarë proklamohet gjithnjë në botën perëndimore, kishte masa dhe kute të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Unë mund ta kuptoja, ta zëmë, që në Rusinë e sapo dalë nga sistemi komunist, një biznesmeni, edhe pa fajin e tij, mund t'i ndodhnin gjëra nga më të çuditshmet. Por kisha qenë i sigurt se në Zvicër, e cila mbahej kampione e respektimit të ligjit dhe të vlerave civilizuese, as njeriu i zakonshëm, as biznesmeni, pra askush, nuk mund të bëhej viktimë e kurdisjeve, e prapaskenave, e konspiracioneve dhe gjërave tjera si këto, të cilat prekin thellë normat elementare të shtetit ligjor dhe vënë në dyshim parimet mbi të cilat janë ndërtuar demokracitë perëndimore. Në rastin për të cilin flas, ishte Zvicra ajo që më zhgënjeu tej mase. Rusia nuk mund të më zhgënjente, sepse për të nuk kisha ushqyer iluzione. Po cila ishte rrjedha e ngjarjeve të mëtejshme?

Derisa zhvillohej korrespondenca e bashkëpunimit ndërmjet prokurorive të përgjithshme të Rosisë dhe të Zvicrës, pra në periudhën nëntor 1998 dhe janar 1999, më saktësisht natën ndërmjet 1 dhe 2 dhjetorit, në selinë e *Mabetex-it* në Lugano ndodhi një ngjarje e çuditshme. Persona të panjohur kishin hyrë në zyrën time në katin e pestë të selisë së firmës dhe, pa ndonjë hamendje të madhe, kishin shkuar drejt një ormani, i cili ndodhej në të djathtë të tavolinës sime të punës. Nuk kishin prekur asgjë tjetër, por ishin orientuar drejt sirtarëve, duke u përpjekur të hapnin kasafortën time personale. Meqë nuk kishin arritur ta hapnin, kishin vendosur ta merrnin të gjithën. Ishte e qartë se bëhej fjalë për një vjedhje, e cila nuk mund të kryhej për një kohë të shkurtër dhe as nga njerëz amatorë. Për më tepër, një vjedhje e këtillë ishte një gjë e rrallë në kantonin e qetë të Tiçinos, pak hapa larg qendrës së qytetit.

Çfarë e bënte këtë vjedhje të dyshimtë, që mos të mund ta quaja ordinere? Dukej sheshit se krye e këtij veprimi nuk kishin qenë hajna të zakonshëm, sepse për ta shkullur kasafortën nga muri dhe për ta nxjerrë jashtë godinës, duhej një mjeshtri e nivelit të lartë. Pastaj,

ata që kishin ndërmarrë një veprim të këtillë, dukej sheshit se kishin qenë të informuar edhe për disa detaje të tjera. E para, ata kishin pritur momentin e largimit tim, sepse atë ditë unë duhej të nisesh për Siberi, për një udhëtim pune. Kjo bënte të kuptohej se lëvizjet e mia tashmë kishin filluar të përgjoheshin. E dyta, dikush kishte dijeni se unë, disa orë përpara, në këtë kasafortë kisha vendosur një shumë të konsiderueshme parash të gatshme, sepse nuk kisha kohë t'i deponoja në bankë, për shkak të ngutjes për udhëtim. Dhe, e treta, gjithashtu disa orë para vjedhjes, në kasafortë kisha depozituar një "Promissory Note", një premtim pagese të firmosur nga një klient imi zviceran, një titull krediti për një shumë përkatëse prej 10 milionë e 250 mijë frangash.

Por më e çuditshme nga të gjitha ishte e dhëna se pas paraqitjes së rastit në Policinë Kantonale të Luganos, nuk u ndërmor asnjë veprim, as i zakonshëm, as i domosdoshëm në rrethana të këtilla. Askush nuk erdhi të hetojë rastin, askush nuk erdhi të shohë gjurmët, askush nuk u mor në pyetje, askujt nga policia nuk i interesoi se për se bëhej fjalë.

Vetëm më 6 prill të vitit 2000, pra plot shtatëmbëdhjetë muaj nga nata e vjedhjes, në dyert e *Mabetex*-it, në Lugano, u paraqit një inspektor i policisë dhe më pyeti për rastin e vjedhjes natën ndërmjet 1 e 2 dhjetorit 1998. Sado të jesh i prirur të mos i vësh gjërat në asnjë farë lidhjeje, një vonesë e këtillë do të krijonte dyshime edhe për policinë e ndonjë shteti të Afrikës, e jo më për policinë zvicerane, e cila mburret për efikasitetet dhe korrektësi.

Por, le ta lëmë këtë ngjarje vetëm si një dëshmi për prapaskenat rreth aferës, ose si një dëshmi, se intensiteti i ngjarjeve kishte marrë një dinamikë të përshpejtuar. Tani kronologjia e zhvillimeve çon te data 22 janar 1999.

Kronika e kësaj dite në Lugano do të mund të hapej me një pamje të pazakonshme: Franko Fenini, ish-nëndrejtor i *Banca del Gottardo*, tani nëpunës në *Mabetex*, ndërsa merr rrugën për të shkuar në zyrën e tij në selinë e firmës sime, bllokohet nga një makinë policie, e cila e parakalon dhe kthehet tërthor në mes të rrugës. Pra, çdo gjë ndodh si në një skenë filmi, ndërkohë që njerëz të shumtë dhe makina ndalen për të parë se çfarë po ndodhte. Pesë-gjashtë policë e shoqërojnë

Feninin në shtëpinë e tij, e lënë sa të marrë gjërat e domosdoshme, ia bastisin banesën dhe e çojnë në burg. Fenini merr vesh se akuzohej për grabitje të rëndë dhe se për këtë e kishte akuzuar Felipe Turover, për veprime që ishin kryer kur ai ishte i punësuar tek *Banca del Gottardo* (para se ai të vinte në Mabetex). Urdhrin e arrestit për të e kishte nënshkruar prokurori i Ticinos, Zhak Dykri (Jacques Ducry). Ndërkohë, atë ditë unë u nisa të shkoja në zyrë më vonë se zakonisht, sepse isha kthyer nga një udhëtim i gjatë dhe ndihesha i lodhur. Deri te zyrat e *Mabetex*-it më shoqëroi Ana Oksa, me të cilën jetoja i martuar një kohë të gjatë. U ndala në parking, u përshëndeta me Anën dhe aty u ndamë, secili duke shkuar në drejtimin e vet. Më vonë ajo më thoshte se pikërisht aty i kishte vënë re dy njerëz, që ishin afruar drejt meje, por unë, me sa duket i pamësuar me situata të këtilla, as që ua kisha vënë veshin.

Po këta dy persona u futën bashkë me mua edhe në godinën e *Mabetex*-it, duke shfrytëzuar hapjen e koduar të derës që bëra unë. Nuk u ktheva asnjëherë kah ata, madje as kur hynë në ashensor bashkë me mua. I pandehja punëtorë të firmës sime. As kur dola nga ashensori, në katin e pestë, nuk ua vura veshin. Hapa derën e blinduar të zyrës sime përballë ashensorit dhe, në çastin kur bëhesha gati që nga paradhoma të hyja në sallonin e pritjes, hetova se po ata dy veta i kisha prapa krahëve.

“Kush jeni ju?”, thashë dhe u ktheva drejt tyre.

Pra, ishte një situatë krejtësisht e zakonshme, sepse prej kaq vitesh pune dhe jete në Zvicër, nuk isha mësuar me asnjë kontakt të afërt me njerëz të rendit dhe të ligjit, e aq më pak me policë të veshur me rroba civile. Kështu që, edhe kur ata më thanë “Jemi nga policia”, sesi m’u duk, sikur ishin aty për një gjë krejt ordinere, më shkoi mendja te vjedhja e kasafortës.

“Karla (Carla) del Ponte dëshiron të bisedojë me ju”, tha njëri prej tyre. “Nëse jeni dakord, ne e marrim në telefon dhe ajo është e gatshme të vijë këtu.”

Dikujt nga lexuesit mund t’i duket e pabesueshme, por e them sinqerisht se atëbotë unë nuk e dija saktësisht se kush ishte Karla Del Ponte. Madje nuk e dija as si shqiptohej drejt emri i saj, Da Ponte, Di Ponte apo Del Ponte. Ç’është e vërteta, unë mund ta kisha dëgjuar

emrin e saj në ndonjë emision televiziv, ose mund ta kisha parë të shkruar në ndonjë gazetë, por meqë nuk përbënte ndonjë interes për mua, e kisha lënë të hynte e të dilte shlrshëm nga kujtesa.

Në zyrën time, ndërkohë, filluan të hynin edhe njerëz të tjerë. Disa ishin punëtorë të firmës sime, disa jo. Në fytyrat e punëtorëve të mi shihja shqetësim dhe brengë. As ata, as unë nuk e dinim saktësisht se çfarë po ndodhte. Të panjohurit linin përshtypjen e njerëzve të qetë, që janë aty për të kryer një shërbim të zakonshëm. “Po kush është kjo Karla del Ponte?”, pyeta njërin nga policët me rroba civile.

“Është prokurore e përgjithshme”, m’u përgjigj ai.

“A është bile ndonjë zonjë e bukur?”, thashë unë me shaka.

“Besoj se do të zhgënjeheni”, tha polici, me një shprehje pak tallëse në fytyrë.

“Ju rrimi këtu”, më tha polici tjetër. “Po”- i thashë, “në zyrën time do të jem” dhe hyra në zyrë.

Në këtë sipër, ndërsa pritja ardhjen e prokurores së përgjithshme, fillova t’i rendis “copat” e ngjarjeve të asaj mesdite. Kush ua kishte hapur derën këtyre njerëzve, që të hynin brenda, meqë sekretarja e recepsionit, Liljana, kishte kohën e pauzës së drekës, në një kohë që hyrjet në godinë ishin tepër të kontrolluara dhe bëheshin me kod. As më vonë, askush nuk do të ishte në gjendje të gjente një shpjegim për këtë.

Karla Del Ponte arriti më në fund, e shoqëruar nga dy truproja me pistoleta në brez dhe nga një numër personash të tjerë, që gjithashtu dukeshin policë me veshje civile. Sapo e pashë, e para gjë që mendova, ishin fjalët që m’i tha polici pak çaste më parë. Pamja e saj ishte vërtet zhgënjyese. Një grua me zë burri dhe fytyrë të vrazhdë, si e vrrarë lije.

Edhe përkundër faktit se ajo nuk u përshëndet me mua kur hyri në zyrën time, për shkak të funksionit që mbante dhe për shkak të respektit që kisha pasur gjithnjë për institucionet e shtetit zviceran, i priva në sallonin e pritjeve për mysafirë të veçantë, që ta nderoja. Por ajo u soll me shumë arrogancë, madje në një mënyrë të pakulturuar. Hodhi mbi tavolinë, duke bërë zhurmë, një grumbull letrash që i sollli me vete, i kryqëzoi duart dhe kaloi drejt e në çështje.

“Unë jam Karla del Ponte”, tha ajo. “Kam këtu dy kërkesa ndërkombëtare. Këto kërkesa nuk janë për ju, por ju jeni burimi, nga ku ne do të marrim informacionet që lidhen me këtë hetim”.

Nuk po kuptoja gjë prej gjëje. Nuk e dija as çfarë kuptimi kishin kërkesat ndërkombëtare, as për çfarë hetimi bëhej fjalë, as për çfarë informatash fliste ajo, asgjë. Duke mos pasur përvoja të këtilla, për mua vetëm një gjë ishte e çuditshme në këtë mes: që të më pyesnin për këto gjëra, nuk kishte qenë e nevojshme të dyndeshin në zyrat e *Mabetex*-it gjithë këta zyrtarë e gjithë këta policë!

“Miku im Skuratov, prokurori rus”, vazhdoi Del Ponte, “m’i ka dërguar këto kërkesa, mbi bazën e marrëveshjes protokollore për bashkëpunim që kemi nënshkruar unë dhe ai. Ne jemi këtu për të bashkëpunuar me të dhe të marrim dokumentet që na i ka kërkuar ai.”

Pikërisht këtu unë bëra gabimin më të madh, sigurisht i shtyrë nga fakti se nuk kisha asgjë për të fshehur, sepse po atë çast duhej t’i thosha Del Pontes: "Ndal! Këtu nuk mund të bëhet asgjë pa ardhur avokati im. Tani ta thërrasim avokatin, ta presim, ia jepni t’i shqyrtojë kërkesat tuaja, e dëgjojmë se çfarë ka për të thënë dhe pastaj shohim e bëjmë". Por, jo! Unë i Marecit, njeri me moral, që i besojnë atij dhe ai u beson të tjerëve, nuk mund të sillesha ashtu! Përveç kësaj, përpara kisha përfaqësuesen e lartë të një institucioni të lartë të Zvicrës. Nëse pamja e zonjës prokurore nuk më ngjallte respekt, ishte institucioni që ajo përfaqësonte, që më bënte të ndihesha jo vetëm si qytetar lojal, por edhe i bindur e i sjellshëm, madje deri në shkallën e cenimit të hapur të interesave të mia.

“Këtu janë zyrat e mia,” i thashë, gjithnjë duke u sjellë me respekt, “andej janë arkivat. Mund të merrni çfarë t’ju duhet dhe çfarë t’ju shërbejë. Edhe në zyrat e kateve të tjera ka dokumente...”

Më pas thirra drejtoreshën financiare të firmës, Lucina Maesani dhe i thashë që t’i vinte në dispozicion zonjës çfarëdo që të kërkonte. Vetëm atëherë Karla del Ponte filloi të ma bënte më të qartë se ku e kishte syrin, se ajo, në të vërtetë, synonte të instrumentalizonte dhe të interpretonte sipas dëshirës së saj atë që mund të gjente në *Mabetex*. Madje edhe më keq se kaq: ajo tashmë kishte përgatitur skenarin për një kurth, të cilin po e zbatonte pikë për pikë. Mënyra

tolerante e sjelljes sime, vetëm ia kishte lehtësuar “procedurat”.

“Zoti Pacolli”, tha ajo, “ato 11 milionë dollarët që ju i keni derdhur në llogarinë DEAN janë vetëm për Borodin, apo edhe për funksionarë të tjerë rusë, ndoshta edhe për mikun tënd, Jelcinin?”

Nuk po u besoja veshëve të mi! Çfarë ishin këto gjepura?! Si mund të ndodhte që një prokurore e përgjithshme të binte kaq poshtë, sa të merrej me shpifje dhe trillime. Ajo vazhdoi:

“Çfarë keni për të thënë për kartat e kreditit? Çfarë do të më thoni për derdhjen e një milion dollarëve në Budapest, në favor të Boris Jelcinit?”

“Nuk po e kuptoj se për çfarë e keni fjalën tamam”, i thashë dhe nga portofoli nxora kartat e mia të kreditit. “Ja ku i keni. Këto janë kartat e mia të kreditit, në to është emri im, sipër është edhe emri i firmës...”

“E njëmbëdhjetë milionë dollarët?”, insistoi ajo.

“Kjo është një çmenduri, një gënjeshtër, një falsitet”, thashë unë me zë të lartë.

“Po një milion dollarët e Budapestit?”

“Nga ta di unë se për çfarë pagese bëni fjalë ju”, foli jo pa rrëmbim. “Nuk përjashtohet mundësia që atje të kemi bërë ndonjë prentim në ndonjë hotel dhe pastaj kemi paguar llogarinë, por asesi një milion dollarë!”

Tashmë kisha vërejtur se, ndërkohë, në zyrat e *Mabetex*-it po ndodhte diçka e pazakontë. Punëtorët nuk ishin askund, madje as ndihmëset e mia nuk u përgjigjeshin thirrjeve me interfon. Unë u shqetësova dhe Karla del Pontes i kërkova një shpjegim:

“Çfarë po ndodh këtu? Ku janë njerëzit e mi?”

“Po bëjmë kontrolle”, m’u përgjigj ajo.

Atëherë u nxeha. Nuk kishte më asnjë mundësi të ruaja qetësinë.

“Dëgjo këtu”, i thashë Karla del Pontes. “Unë dua të di se çfarë po ndodh këtu. Nëse njerëzit e mi nuk lejohen të ngjiten nëpër zyrat e tyre dhe të vazhdojnë punën lirisht, më nevojiten shumë shpjegime, pa intriga. Këto metoda që po përdorni, nuk janë policore, janë staliniste!”

Më vonë mora vesh se të gjithë punëtorët e *Mabetex*-it i kishin ndaluar në zyrat e kateve të poshtme, derisa unë bisedoja me të në



katin e gjashtë të ndërtesës. Ndërkaq, ndërhyrja ime shumë e ashpër, e detyroi Del Ponten të jepte urdhër të zhvendoseshin punëtorët nëpër zyrat e tyre. E mbaj mend se këtë e bëri me shumë çartaqejf. Në fytyrat e njerëzve të mi shihja frikë dhe hutim. Të gjithë ishin të zbehtë dhe me shikimet e tyre sikur kërkonin mbrojtje prej meje. Unë nuk dija çka po ndodh poshtë.

“Nuk ka asgjë kundër *Mabetex*-it dhe Pacollit”, shpjegoi Karla del Ponte. “Jemi këtu për të zbatuar një kërkesë ndërkombëtare. Jua përsëris: nuk ka asgjë! Mund të shkoni në zyrat tuaja dhe të punoni të qetë.” Kaq m’u desh. Shikova orën dhe u kujtova se në orën 16, në aeroportin e Luganos, me aeroplanin tim arrinte nënkryetari i bashkisë së Moskës, z. Ardjenikidze. Dola pa u përshëndetur me Karla Del Ponten.

Por, para se ta mbyll këtë episod, më duhet të them se, në bisedë e sipër, prokurorja e përgjithshme më njoftoi për arrestimin e Feninit, për veprime të kryera gjatë kohës kur punonte në atë bankë, arrestim për të cilin nuk isha i informuar edhe pse kjo kishte ndodhur në orët e mëngjesit. Madje këtë ma tha me një ton kërcënues. Mbaj mend gjithashtu se unë i shpreha shqetësimin tim për atë që do të shkruanin mediet, sepse e parandieja se kjo “vizitë” e prokurores së përgjithshme në një qytet kantonal nuk mund të kalonte pa një jehonë. Ajo më premtoi se për këtë ngjarje nuk do të merrte vesh askush, bile u betua. Por këtë premtim që, sikundër mund të merret me mend, ajo nuk e mbajti aspak. Edhe një detaj: në një moment të bisedës, Del Ponte më tha tekstualisht:

-Dëgjoni këtu, zoti Pacolli. Është mirë që ju të m’i thoni të gjitha. Nëse e bëni këtë, nuk do të keni problem në Rusi dhe ju do t’i merrni kreditë tuaja. Gjithashtu nuk do të ketë probleme me mbrojtjen tuaj. E përsëris, nëse ju na thoni gjërat që na interesojnë, unë ju siguroj se kreditë në Rusi do t’ju paguhen”. Këtë shprehje Karla del Ponte e përdori edhe në intervistën e vetme që kisha unë me të, pas dy muajsh, pra në mars.

Këto fjalë të Karla del Pontes sikur ma bënë me dije se Prokurorja e Përgjithshme e Zvicrës nuk kishte ardhur nga Berna në Lugano për një gjë të vogël, siç mund të ishte rasti im. Ajo dukej qartë se kërkonte diçka më shumë se kaq. Dëshironte “kokën” e Jelcinit.

- Unë do t'ju them të vërtetën, zonjë, - iu përgjigja. - Nuk mund të ketë asnjë lloj interesi, që të më detyrojë të them gënjeshtër. Kreditë që më kanë rusët, nuk mjaftojnë që unë të them gënjeshtër kundër askujt.

Kurse ajo:

- Mirë, mirë! Do të vendosësh më vonë për këtë. Do të flasësh, që ç'ke me të!

Ashtu sikundër mund të pritej, Del Ponte nuk e mbajti premtimin për çështjen e medias. Të hënën, pra më 25 janar, zëdhënësi i Prokurorisë së Përgjithshme nxjerr një kumtesë, në të cilën bën publik lajmin për hulumtimin e dokumenteve të *Mabetex*-it. Meqë ky është një nga modelet “kryevepër” të manipulimit me opinionin, e shoh të nevojshme ta jap komunikatën në tërësi. Aty thuhej: “Në kuadër të një hetimi dhe në bazë të bashkëpunimit gjyqësor që kemi mes Zvicrës dhe Rusisë, të premtën më 22 janar në orën 8:45, policia kantonale e Luganos, me urdhër të prokurorit Zhak Dykri (Jacques Ducry), ka arrestuar nëpunësin e *Mabetex*-it, Franco Feninin, President i së cilës është Behgjet Pacolli. Pasditën e së njejtës ditë, u vizitua selia e shoqërisë *Mabetex*. Merrte pjesë edhe prokurorja e përgjithshme e Zvicrës, Karla del Ponte. Me këtë rast janë sekuestruar dokumente të shumta”.

Formalisht, kjo mënyrë e dhënies së lajmit mund të duket e saktë, por megjithatë aty nuk ishte cekur se veprimet për të cilat akuzohej ishin kryer në Bankë dhe jo kur ai punonte tek ne. Por nëse i shikon gjërat pak më afër, lexuesi mund të vërejë se komunikata kishte vënë një sërë grackash ndaj meje dhe *Mabetex*-it. Çfarë sugjeronte komunikata? Se ishte hapur një çështje hetimore. Tjetër? Se objekt i hetimit ishte *Mabetex*-i, se ajo është kompani e Behgjet Pacollit, se aty ka diçka, meqë janë sekuestruar dokumentet. Madje edhe më shumë se kaq: një punonjës i firmës së Pacollit ishte arrestuar, se bëhet fjalë për diçka të madhe, përderisa në këtë “vizitë” merrte pjesë vetë prokurorja e përgjithshme. Me një fjalë, komunikata për opinionin njëkohësisht njoftonte dhe formulonte akuzën. Askund nuk thuhej, ta zëmë, se arrestimi i Feninit nuk kishte të bënte asgjë me *Mabetex*-in. Kjo ishte pika esenciale, ku thyhej çdo gjë.

Pikërisht, pra, kjo ishte edhe mënyra si u intonua lajmi nëpër

mediet e ndryshme. Pozitiv ishte vetëm fakti se disa nga ato medie kërkonin të dëgjonin edhe palën tjetër. Kështu, një ditë pas dhënies së lajmit në Bernë, unë tashmë isha në Moskë, ku kisha shkuar për të marrë pjesë në inaugurimin e *Hotel Golden Rings*, një vepër për krenari e *Mabetex*-it. Më thirrën nga televizioni zviceran dhe unë, në një intervistë me telefon, ua dhashë versionin tim të ngjarjes, i cili thoshte të vërtetën për krejt atë që kishte ndodhur, duke shtuar se krejt kjo ishte një AFERË E MONTUAR, kushedi me çfarë prapavije. As Karla del Ponte, as Prokuroria e Përgjithshme kurrë nuk e demantuan atë që thashë.

Po në “frontin rus”, çfarë ndodhte në atë kohë?

Luzhkov, kryebashkiak i Moskës, njeri i fuqishëm i nomenklaturës ruse, tashmë ishte pozicionuar kundër Jelcinit dhe synonte të zinte vendin e tij. Përveç karrierës, sipas opinionit publik në Moskë dhe sipas disa shkrimeve të gazetave ruse, ai kishte një motiv shumë të fortë ta bënte këtë, sepse sipas një hetimi që kishte bërë CIA dhe Departamenti i Shtetit i SHBA-së, rezultonte se Luzhkov ishte me shumë gjasa, përzier në një dosje kriminale rreth vrasjes së biznesmenit amerikan Paul Tatum në vitin 1996, gjithmonë sipas këtyre gazetave. Ky Tatumi kishte qenë bashkëpronar i hotelit “Radisson Slavianskaja” në Moskë dhe, siç flitej në atë kohë hetimet e federalëve amerikanë, nën mbikëqyrjen e ambasadorit të SHBA-së, kishin nxjerrë si rezultat se edhe Luzhkov, nuk dihej përse, kishte qenë i përzier në atentatin kundër tij. E gjithë kjo që e thashë, nuk është mendim imi, por vetëm një pasqyrim i opinioneve publike e mediatike në Rusi për Luzhkovin. Nëse do të ishte kështu në një rrethanë të këtillë, Luzhkovi kishte vetëm një shans t’i shpëtonte hetimit dhe më pas akuzës së drejtpërdrejtë: vetëm nëse zgjidhej President i Ruisë, akuzat dhe çështjet hetimore do të pezulloheshin, sepse kështu ishte e përcaktuar me kushtetutën ruse. Prandaj Luzhkovi iu sul Borodinit, duke e ditur se ai ishte bashkëpunëtor i ngushtë i Jelcinit dhe se vetëm përmes tij mund të cenohej në publik figura e Presidentit. Kësaj radhe ishte Prokuroria e Moskës ajo që hyn në lojë. U bastis zyra e Borodinit, gjithnjë në marrëveshje me Skuratovin, me qëllim të hetimit me rastin e rindërtimit të Kremlinit. Duket se tani Luzhkovi dhe Skuratovi kishin edhe mbështetjen e

kryeministrit Primakov.

Por gjërat nuk shkuan ashtu, siç e kishte paraparë treshja Luzhkov, Skuratov dhe Primakov. Në njërën nga ato ditë, në orët e hershme të një mëngjesi të ftohtë të dimrit rus, mediet elektronike japin një video, në të cilën shihet prokurori i përgjithshëm në shoqëri të dy femrave. Lajmi bëri bujë të madhe në qarqet politike dhe në opinionin rus. Skuratovin e lë mendja, tërbohet, sëmuret, shtrohet gjoja në spital, por goditjes nuk e ka të lehtë t'i shpëtojë. Megjithatë, si i urryer që ishte, ai e gjen një zgjidhje: shpall se ky ishte komplot i Jelcinit kundër tij, për shkak të hetimeve që kishte iniciuar ai, për zyrtarët e afërt me të dhe për familjarët e tij. Dhe, nuk do mend, *Mabetex*-i dhe unë ishim të paevitueshëm në akuzat e Skuratovit.

Por le ta shpjegoj më detajisht këtë ndodhi. Jurij Skuratovin, Jelcini e largoi nga puna e prokurorit të përgjithshëm dhe ia mbylli dyert e zyrës së tij. Kjo ndodhi për shkak se në atë periudhë, Skuratovi ishte filmuar nga kamerat e fshehta në një motel afër Moskës me dy femra lakuriq. Në momentin kur u bë publik përjashtimi i tij, të gjitha televizionet ruse, dhe ato ndërkombëtare po ashtu, shfaqën atë incizim disaminutësh, ku shihej kryeprokurori nga çasti kur hyn në dhomë, kur zhvishet dhe pastaj ardhja e dy vajzave të zhveshura. Asgjë nuk ishte censuruar, por gjithçka ishte publikuar. Në mbrojtje të tij, dolën shumë veta duke thënë se në atë video nuk ishte Skuratovi dhe se ajo ishte një gjë e montuar. Por unë në bazë të informacioneve që kam, e di se në atë incizim është vetë Skuratovi dhe veprimi i Jelcinit në atë rast, për shkarkimin e tij, ka qenë shumë i drejtë për shkak të veprimeve të pamoralshme të njeriut i cili udhëhiqte organin kryesor të hetuesisë në Rusi.

Megjithatë, he për he loja kryesore zhvillohej në fushën e medias, të informacioneve të ndryshme, që fillonin si lajme ordinere dhe përfundonin me intriga dhe akuza gati fantastike. Shtypi tashmë nuk shënonte vetëm atë që ndodhte, por ishte bërë vetë promotor i prodhimit të lajmeve. Unë tashmë e dija se nga kishin buruar “informatat” themelore, por ato tani ishin zgjeruar dhe “pasuruar” aq shumë me “elemente” të reja, sa që edhe unë e kisha të vështirë ta ndiqja fillin e tyre.

E dija se deponimet e para të rrejshme i kishte bërë Felipe Turover,

se ato i kishte nxjerrë në medie vetë Karla Del Ponte, ndërkohë që pala ruse e kishte plotësuar dosjen time me shpifje të reja. Në sulmet dhe spekulimet e medias kishte dy qendra kryesore: Moskë dhe Berna. Por rreth tyre silleshin një numër i pakufishëm “prodhuesish” të tjerë të zellshëm të shpifjeve. Gazetarë nga vendet perëndimore vraponin në Moskë për të zbuluar skenat dhe prapaskenat e “aferës së shekullit”, sikundër që, në anën tjetër, gazetarë nga Moskë dhe vendet e tjera të lindjes ngarendnin në Perëndim për të gjetur të dhëna të reja për këto zhvillime sensacionale.

Nga letrat që Skuratovi i kishte dërguar Karla del Pontes dhe nga pyetësorët e prokurorisë së Bernës, kisha arritur të kuptoja se shpifjet e Turoverit kishin kaluar nëpër tri faza, gjithnjë duke “plotësuar” njëra-tjetrën. Por më vonë mora informacion se Turoverit në Moskë i qenkësh vënë përpara një letër e bardhë, të cilën ai e kishte nënshkruar me vullnetin e tij, apo i shantazhuar, kjo nuk mund të dihej saktësisht. Në atë letër të bardhë të Turoverit, Skuratovi shtonte çfarëdo që i nevojitej ose i binte ndër mend, veçmas nëse bëhej fjalë për Jelcinin.

Tani, akuzave dhe shpifjeve të para u qenë shtuar dokumente të falsifikuara, që prodhoheshin me aq lehtësi, sikur të bëhej fjalë për një lojë fëmijësh. Borodini tashmë nuk ishte interesant. “Jahtet” e bijave të Jelcinit, “kështjellave” në bregdetin francez u kishte ardhur radha. Lexuesit e gazetave fare lehtë mund ta përfytyronin Jelcinin, Presidentin e njërit prej shteteve më të fuqishme të botës, tek i thoshte shoferit, ndërsa kalonin nëpër ndonjë rrugë të Budapestit: “Ndalë këtu!” Dhe pastaj lexuesi ta përfytyronte Jelcinin të dilte nga vetura dhe fuste kartën e kreditit në ndonjë bankomat, për të tërhequr paratë, gjëra që njeriu e ka të vështirë t’i imagjinojë, e jo më t’i konsiderojë si të mundshme.

Në radhën e shpifjeve të tjera, ishte edhe njëra, të cilën e prodhoi Turoveri në fazën e fundit të kësaj afere. Ai kishte deponuar edhe këtë “dëshmi”: në vitin 1995, siç e kam rrëfyer tashmë, unë kisha çuar në Moskë përfaqësuesit e *Banca del Gottardo*, Generalin, drejtor i bankës, Feninin, zëvendësdrejtor dhe Mordasinin, zyrtar i lartë i po kësaj banke. Gjatë pritjes që na kishte bërë Borodini në zyrën e tij, unë, gjoja, i kisha dhënë këtij të fundit, pra Borodinit, një çantë me

para. Meqë vetë Turoveri nuk kishte qenë në takim, ishte e qartë se dëshminë e tij ai e kishte mbështetur te të pranishmit e tjerë. Te cili? Generali nuk ishte aq budalla, sa të binte në një grackë të tillë. Fenini kishte kohë që i kishte larë hesapet me Turoverin dhe tani dergjej në burg (pas 100 ditësh u lirua, për mungesë provash). Pra mbetej Mordasini. Ai më thirri në telefon, pas publikimit të këtij lajmi dhe më tha diçka që çuditërisht nuk m'u duk aq bindëse. Kjo është një marrëzi, thoshte, është një budallallëk. Ne ishim aty, ishim të pranishëm dhe cili budalla do ta bënte një veprim të tillë, të merrte ose të jepte ryshfet në prani të tre dëshmitarëve. Megjithatë, kishte diçka që nuk shkonte në sjelljen e tij. Mbi të gjitha, për mua ishte e paqartë, përse Mordasini të kishte dalë në krah të Turoverit. Bëhej fjalë për ndonjë shantazh? Dukej se po. Po nga kush? Nga Turoveri, nga Banka, apo dikush akoma më lart? Këtë nuk arrita ta marr vesh asnjëherë.

Megjithëse shpifjet dhe akuzat ndonjëherë tejkalonin çdo perceptim logjik, ato, përveç tjerash, më krijonin shqetësim që për burim kishin një institucion të rëndësishëm të shtetit zviceran. Nxjerrja e lajmeve të vazhdueshme nga këto burime dhe përhapja e tyre nëpër medie, ma bënte të vështirë punën dhe zhvillimin e biznesit. Prandaj, me sugjerimin e avokatit tim, vendosa ta qartësoja situatën pikërisht në raport me Prokurorinë e Përgjithshme në Bernë dhe me Prokurorinë e Ticinos. Pyetja që unë ua parashtrova këtyre institucioneve të shtetit ishte kjo: Unë, Behgjet Pacolli, dhe shoqëria ime *Mabetex* për çfarë po hetoheshim? A ishte hapur ndaj meje ndonjë çështje gjyqësore? Nëse po, në ç'prova dhe dëshmi ishte e bazuar ajo?

Letrën e parë ia drejtova prokurorit të Tiçinos, Jacques Ducry. Pak orë pas letrës sime, më 16 mars, flasim gjithnjë për vitin 1999, nga Dycry vjen përgjigja, në të cilën ishte e shkruar taksativisht: *"I nderuari zoti Pacolli, mora faksin tuaj, por ai nuk ka të bëjë fare me mua. Unë nuk kam filluar asnjë çështje hetimore që i përket Mabetex-it dhe në lidhje më këtë nuk kam dhënë kurrë asnjë njoftim zyrtar. Unë kam drejtuar një kontroll në zyrën e zotit Franco Fenini dhe asgjë më tepër se kaq. Prandaj ju them që ta drejtoni mosaprovimin dhe keqardhjen tuaj në vend tjetër. Me nderime, Prokurori Publik,*

Jacques Ducry.”

Tani mbetej edhe një vend tjetër ku gjërat duhej të qartësoheshin: Prokuroria e Përgjithshme në Bernë, sepse edhe në përgjigjen e Ducry-së sikur sugjerohej “një vend tjetër”. Letra ime afërsisht kishte të njëjtën përmbajtje. Përgjigja nga Berna erdh e nënshkruar nga zv.prokurori i përgjithshëm dr. Hans Jorg Stadler, gjithashtu brenda disa orësh pas shkresës sime. Në të ishte shkruar: *“Në përgjigje të faxit tuaj të sotëm, mund të vërtetohet se asnjë proces penal nuk është hapur nga ana jonë kundër Mabetex-it, apo kundër zotit B. Pacolli.”* Por, për ndryshim nga Prokuroria Kantonale e Ticinos, e cila thotë se nuk ka nxjerrë asnjë njoftim zyrtar lidhur me ndonjë hetim ose proces të mundshëm ndaj meje, Prokuroria e Përgjithshme nga Berna e hesht këtë fakt. Pra, ishte e qartë se burim i spekulimit medial ishte pikërisht ky institucion.

Megjithatë, qartësimi i situatës sime rreth hetimit ose procesit gjyqësor për mua kishte rëndësi të madhe, jo vetëm formale, por edhe faktike. Pavarësisht nga rrjedha e pafavorshme e zhvillimeve, veçmas në raport me mediet, unë kisha në dorë një argument të fuqishëm: Ndaj meje nuk kishte asnjë proces! Për një rrethanë normale, kjo nuk ishte pak!

Po, në të vërtetë, a ishte kështu? Jo, sepse letrat e institucioneve zvicerane vetëm krijonin një perde tymi. Ishte e vërtetë se ndaj meje në Zvicër nuk ishte duke u zhvilluar asnjë proces, këtë mund ta thoshte kushdo, por askush nuk e thoshte se ishin pikërisht institucionet zvicerane që çështjen tashmë e kishin zhvendosur në Moskë. Prokuroria e Përgjithshme e Konfederatës Helvetike kishte bërë aq shumë shkelje ligjore duke u marrë me çështjen time, sa që asnjë proces normal ligjor nuk mund të kalonte pa pasoja për institucionin dhe Karla del Ponten. Prandaj ishte e pritshme që skenat e ardhshme të kësaj drame të luheshin pikërisht në Moskë, atje ku Karla del Ponte nuk kishte juridiksion, por kishte ndikim të padiskutueshëm.

## Fundi i lojës

*Vallja në gojën e ujkut. Rreziqet që kalova në Rusi. Fitorja në të gjithë frontet mbi armiqtë e mi. Fundi i turpshëm i Skuratovit, që konceptoi gjithë operacionin. Njohja me Putinin në Saint Petersburg, njeriun i cili vendosi mbylljen e çdo eksperience biznesi të kompanisë sonë me Rusinë. Mbyllja e çdo lloj iniciative hetimore ndaj meje.*

**M**endoj se tani është radha të qartësoj edhe një gjë tjetër. Në fundin e dimrit dhe në pranverën e hershme të vitit 1999, ngjarjet në aferën “Russiagate” morën një dinamikë të përshpejtuar. Pra, ishin javët dhe ditët e fundit, para se të merrej vendimi për hedhjen e bombave të NATO-s mbi Serbinë, për shkak të kundërshtimit prej saj të marrëveshjes së Rambujesë rreth Kosovës. Unë tashmë kisha arritur të kuptoj se sa më shumë që afrohej çasti i vendimit për një përgjigje të merituar të bashkësisë ndërkombëtare ndaj Serbisë, zhvillimet rreth aferës bëheshin më dinamike dhe përshpejtoheshin jashtëzakonisht shumë. Ky tension dhe kjo tendosje nuk vërehej vetëm te aktorët kryesorë të prapaskenave të aferës, por edhe te mediet, të cilat sikur filluan t’i lidhnin në mënyrë të vetvetishme dy ngjarje, në dukje të parë pa ndonjë afri me njëra-tjetrën. Në të vërtetë, afria ishte krejtësisht e qartë: mbi Jelcinin, njërin nga lojtarët më të rëndësishëm të zhvillimeve politike botërore edhe rreth Kosovës, bashkëpunëtorin kryesor të SHBA-ve, thujse në të gjithë etapat e këtyre zhvillimeve, ishte intensifikuar trysnia në të gjitha planet. Kjo aferë, e tëra e ndërtuar mbi trillime e shpifje, ishte edhe një mjet, një instrument për të arritur efektet e caktuara edhe në vendimet rreth Kosovës.

I gjendur nën trysinë e madhe të shtypit, por në anën tjetër i sigurt se të gjitha provat që ishin deponuar kundër meje ishin false, vendosa të bëj një veprim, për atë rrethanë mjaft të guximshëm: të futesha në strofullin e ujërve, pikërisht atje, ku zhvillimet tani kishin marrë dinamikë të jashtëzakonshme. Pra, vendosa që vetë t’u kundërvihesha shpifjeve të shtypit, gjithnjë duke ndjekur parimin



se demanti më i mirë i gënjeshtreve dhe trillimeve ishte e vërteta e dëshmuar me fakte. Përveç kësaj, numri i gazetarëve që kërkonin prononcimin tim ishte shtuar ndjeshëm. Kërkesat më të shumta vinin nga Moska, jo vetëm nga gazetarët rusë, por edhe nga korrespondentët e medieve të huaja të akredituara në kryeqytetin e Rosisë. Sekush tashmë kërkonte të dëgjohej edhe pala tjetër.

Ishte 22 marsi i vitit 1999. Mora me vete një dosje me dokumente dhe u nisa nga Lugano për në Moskë. Konferenca e shtypit ishte aranzhuar nga drejtori i agjencisë së lajmeve të Rosisë, *Interfax* dhe ajo do të mbahej të nesërmen, pikërisht në orën 12. Së pari, vetë paralajmërimi për konferencën e shtypit mori publicitet të madh. Por unë këtu nuk mund të mos bëj një digresion dhe të them se në vijë paralele, siç ishte bërë zakon në të gjitha fazat e kësaj afere, zhvillohet edhe një ngjarje tjetër: po atë ditë që ishte aranzhuar konferenca ime e shtypit, Karla del Ponte, me nguti të madhe i bëri një vizitë të paparalajmëruar Moskës. Të ishte koincidence? Kujtoj që jo. Duke e ditur se vizita e saj ishte e paparalajmëruar dhe duke e ditur se udhëtimi i saj u bë me një aeroplan ushtarak zviceran, jam i prirur të besoj se Del Ponte e ndërmoi këtë udhëtim me dy qëllime kryesore: e para, që të gjendej po atë ditë në Moskë dhe me praninë e saj zyrtare të “baraspeshonte”, për të mos thënë mundësisht ta linte nën hije konferencën time me gazetarë, duke tërhequr vëmendjen e masmedias me vizitën e saj; dhe, e dyta, që kolegët rusë t’i ndihmonte në realizimin e ndonjë skenari të ri. Këtë skenar do ta marr vesh më vonë, natyrisht.

Ashtu siç ishte paraparë, konferenca për shtyp filloi në orën 12. Salla e *Interfax-it* ishte e mbushur përplot. Kishte mbi tridhjetë ekipe televizive dhe një numër të madh gazetarësh të medias së shkruar. Një pjesë e tyre silleshin nëpër korridore. Drejtori i *Interfax-it* më tha se kjo sallë asnjëherë nuk ka qenë kaq e mbushur, që nga konferenca e shtypit e gjeneralit Lebed, pasi e kishte shkarkuar Jelcini.

Edhe përkundër kësaj pranie të madhe të gazetarëve, isha jashtëzakonisht i qetë dhe i sigurt në vete. Fola rusisht, pa ndihmën e përkthyesve, jo vetëm pse e kisha të lehtë ta bëja këtë, por edhe për shkak se e dija që komunikimi i drejtpërdrejtë me gazetarë, pa ndërmjetësim krijonte efekte pozitive të opinionit, veçmas të

shikuesit televizivë. Thashë se krejt ajo që ishte ngritur si objekt i hetimit ndërkombëtar kundër meje, ishte një gënjeshtër. Gjithçka ishte një sajesë. Nuk ekziston asnjë provë, asnjë dokument, që mund të konfirmojë cilindo pretendim të akuzave që janë bërë kundër meje. Të gjithë tenderët e fituar nga *Mabetex*-i në Rusi për ristrukturimin e godinave qeveritare janë fryt i kontratave të rregullta. Ne kemi ofruar kushtet më të mira në raport me firmat e tjera në garë, siç ishte koha e dorëzimit, respektimi i kërkesave të shpallësit të tenderit etj. Unë e them këtu, para jush, ua thashë gazetarëve, se të vetmin gabim që kemi bërë, është se kemi pranuar të fillojmë punën pa u paguar fillimisht për një pjesë të shpenzimeve dhe pa përcaktuar afat pagesash. Lidhur me këtë, shtova unë, dua të denoncoj këtë fushatë të ndërmarrë nga shtypi, të përgatitur edhe nga ndërhyrës të ndryshëm në Rusi, të cilët duan të përfitojnë nga situata e krijuar dhe ta evitojnë pagesën e borxheve. Kreditë tona në Rusi kapin shuma mbi qindmilionëshe, të gjitha për vepra tashmë të realizuara dhe të dorëzuara. Sido që të jetë, ne do të vazhdojmë t'i përfundojmë punimet, kudo që ato kanë filluar dhe këtë do ta bëjmë duke respektuar afatet e caktuara, ashtu siç është paraparë me kontrata. Pohova edhe një gjë, që gazetarëve ju interesonte jashtë mase. Skuratovi më kishte akuzuar se prapa shpërndarjes së videos së aferës së tij me dy femrat, qëndroja unë. Këtë e mohova në mënyrë kategorike, jo vetëm pse nuk ishte e vërtetë dhe askush nuk mund ta dëshmonte një gjë të tillë, por edhe për faktin se një mënyrë e këtillë e implikimit në afëra çfarëdo qofshin ato, nuk përkonte me moralin tim.

U shtruan edhe shumë pyetje nga gazetarët. Interesimet e tyre sillleshin sa nga çështjet parësore që lidheshin me aferën, sa me detaje dhe hollësi në dukje të parë të papërfillshme, por që synonin hedhjen e sa më shumë dritë mbi zhvillimet që tashmë kishin marrë jehonë planetare. Nuk mund të gjendej asnjë stacion televiziv, asnjë gazetë serioze që nuk e kishte pasur aty përfaqësuesin e vet. Dhe, gjithashtu, nuk u gjend asnjë gazetë serioze dhe studio televizive, që nuk e dhanë lajmin nga salla e *Interfax-it* në Moskë. Rusët ishin më të interesuarit, por jo vetëm ata.

Dikush do të mendojë se kjo ishte e tëra. Jo. Sikundër e thamë,



SCHWEIZERISCHE BUNDESANWALTSCHAFT  
 MINISTÈRE PUBLIC DE LA CONFÉDÉRATION  
 MINISTERO PUBBLICO DELLA CONFEDERAZIONE  
 PROCURA FEDERALE

3003 Berna  
 Taubenstrasse 16

BA/090/98/RRH/LL

Bern, March 14, 2000

**Registered Mail**

MABETEX PROJECT ENGINEERING SA  
 Mr. Behgjet PACOLLI  
 Viale Cattori 7  
 6900 Lugano

**Mabetex Project Engineering SA & Behgjet Pacolli**

To whom it may concern

Confirmation

The Office of the Attorney General of Switzerland does not have any pending criminal case neither against Mabetex Project Engineering SA nor against Mr. Behgjet PACOLLI himself. Further we confirm that – according to our knowledge - this company does not have any restrictions in doing business.

Yours sincerely,



THE DEPUTY  
 ATTORNEY GENERAL

Felix Banziger

cc:

- Avv. Edy Grignola, Corso San Gottardo 25, Casella postale 249, 6830 Chiasso
- Advance copy Mabetex Project Engineering SA (fax : 091 / 993 06 36)

***Dokumenti me anën e të cilit Prokuroria federale e Zvicrës vërteton se nuk ka asnjë çështje penale, asnjë hetim në ngarkim timin apo të kompanisë Mabetex. Pra as kompania nuk kishte asnjë kufizim ligjor në biznesin e vet. Përgjigjja u firmos nga zëvendësprokurori i përgjithshëm Feliks Banziger dhe mban datën 14 mars 2000.***

për të errësuar sa të ishte e mundur të vërtetën që unë prezantova në konferencën për shtyp, prokuroria e Moskës po atë ditë kishte urdhëruar bastisjen e zyrave të Borodinit, me pretekstin e kërkimit të dokumenteve që duhej të dëshmonin korrupsionin e administratës presidenciale rreth meremetimit të godinave të Kremlinit. Doemos, edhe ky ishte lajm, madje një lajm që duhej të futej në garë me mua dhe me publicitetin që kisha arritur.

Tani në radhë vinte vizita e Karla del Pontes, e cila sapo kishte arritur në Moskë, për bashkëpunimin mbi hetime ndërkombëtare rreth krimit të organizuar, kështu që disa kanale televizive të Moskës ndërprejnë programet e tyre të rregullta për të dhënë transmetime të drejtpërdrejta nga aeroporti, ku Karla Del Ponten kishte dalë ta priste Prokurori i Përgjithshëm i Rosisë, Skuratov.

Por kjo nuk është e tëra. Strategjia e mbrojtjes së Skuratovit kishte paraparë edhe një konferencë tjetër për shtyp, kësaj radhe të kryetarit të një komisioni parlamentar, të deputetit të Dumas, Ilukin. Ai deklaroi para gazetarëve: “Në gushtin e kaluar, para rënies së rublës dhe krizës që përjetoj ekonomia ruse, shuma prej 235 milionë dollarësh, nisur nga fondi Monetar Ndërkombëtar, është derdhur në një llogari bankare të një firme australiane, 25% të vlerës të së cilës kontrollohet nga Tatjana Daçenko, e bija e Presidentit Jelcin”. Gazetarët i kërkuan Ilukinit prova dhe dokumente të asaj që pohon, por ai del nga salla e konferencës pa dhënë asnjë shpjegim. Ndërkohë, kryeministri Primakov, pasi u nis për në Uashington ku do të nënshkruante një marrëveshje me FMN-në, kur mori vesh se çfarë po ndodhte rreth Kosovës, vendosi ta anulonte vizitën në SHBA dhe u kthye prapë në Moskë.

E gjithë kjo zhurmë mediale në Moskë kishte për qëllim të fundit të arrinte disa efekte njëkohësisht: të errësonte skandalin e fundit të Skuratovit me femrat, të mënjanonte vëmendjen e opinionit nga argumentimet që kisha bërë unë në konferencën për shtyp dhe, e fundit dhe gjithsesi më e rëndësishmja, ishte beteja që duhej fituar me Jelcinin, para se të fillonte zyrtarisht fushata zgjedhore.

Këtë episod të Moskës do ta mbyll edhe me një detaj tjetër, për të cilin atë ditë nuk dija gjë, por që më vonë m’u qartësua plotësisht. Pas konferencës për shtyp, unë shkova drejt e në aeroportin

ndërkombëtar të Moskës, *Sheremetievo* dhe hyra në avionin e *Swissair-it* për të shkuar në Cyrih (Zurich). Avioni nuk u nis për një kohë, megjithëqë ishin kryer të gjitha veprimet për një gjë të tillë. Nuk pati ndonjë shpjegim për vonesën, derisa më në fund, u dha sinjali për nisje. Cila mund të ishte arsyeja për këtë vonesë? Më vonë, shumë më vonë do ta marr vesh se arsyeja e vonesës së nisjes së avionit kisha qenë unë. Me kërkesën e Karla del Pontes, Skuratovi kishte nxjerrë urdhrin e ndalesës sime, por kur duhej zbatuar ky urdher, ishte bërë tepër vonë.

Nga do ta merrja vesh unë këtë? Ndonjë muaj më vonë, më saktë me 19 prill 1999, unë do të kthehem serish në Moskë. Gjatë kontrollit të pasaportave, ndërsa shikonte kompjuterin, një polic do të më thotë:

“Mbase nuk duhet t’jua them, por këtu ka diçka për ju. Megjithatë, mund të kaloni. Ja pasaporta juaj.”

Nuk ia vura veshin policit. Të nesërmen mora një ftesë që të paraqitesha te zëvendësprokurori i përgjithshëm i Ruisë, Chuglasov. Ky ishte zëvendësi i Skuratovit. Kjo më la të kuptoj se Skuratovi, kishte dalë ose ishte duke dalë nga skena. Shkova dhe atij i dorëzova një numër dokumentesh që më ishin kërkuar, përsëri lidhur me kontratat e Kremlinit. Krijova përshtypjen se ky Chuglasovi ishte ndryshe nga të tjerët, sikur i kuptonte më mirë gjërat. Por nuk doli ashtu. Ai kërkoi prej meje të rrëfeja çdo gjë për tenderët në Rusi. M’i përsëriti, madje, edhe fjalët që më parë i kisha dëgjuar nga Karla del Ponte: nëse bashkëpunon me ne rreth kësaj historie, nuk do të keni problem me punët tuaja të ardhshme në Rusi.

Në bisedë e sipër vëreja se Chuglasovi, herë pas here, fliste në telefon me dikend. I thoshte diçka nën zë, që unë të mos e merrja vesh. Kjo më irritoi edhe më shumë. Iu hakërreva Chuglasovit:

“Pse po thoni të pavërteta në telefon?! Vetë i sajoni këto histori dhe vetë i interpretoni si ua ka ënda! Të gjitha këto nuk kanë asnjë lidhje me realitetin! Pse veproni kështu?”

Chuglasovi e ruajti qetësinë, si një njeri që tashmë kishte përvojë në punë dredhish.

“Edhe Karla del Ponte, në atë Zvicrën tuaj, vepron kështu!”, ma ktheu.

Atëherë u ngrita pa e zgjatur më. E kisha kohën të nisesha për në

aeroport, që të kapja avionin e linjës Moskë-Frankfurt dhe më tej në Nju-Jork. Këtë ia thashë edhe Chuglasovit, para se të dilja nga zyra e tij. Dhe, pak çaste më vonë, ndërsa udhëtoja me makinë për në Aeroportin *Sheremetievo*, dëgjoj Radio-Moskën të thotë: “Pak çaste më parë, pronari i *Mabetex*-it, Behgjet Pacolli, u takua gjatë me prokurorin Çuglasov. Biseda ka përfunduar pak çaste më parë dhe tani Pacolli është në rrugë për Nju-Jork”.

Vetëm Chuglasovi e dinte se nga Moska e kisha ndër mend të udhëtoja për Nju-Jork. Nuk ia vlente të merresha me këta njerëz. Sajimet dhe gënjeshttrat e tyre nuk mund të ndaleshin, edhe përkundër vullnetit tim të madh që e vërteta të dilte në shesh, sa më e qartë dhe sa më e plotë.

Por, befasia më e madhe më priti pikërisht në aeroport. Sapo lashë bagazhin dhe bëra kontrollin e pasaportës, e pashë veten të rrethuar nga një skuadër policie.

“Ju nuk mund të niseni”, më tha një polic.

“Pse?”

“Kemi urdhër nga Prokuroria e Përgjithshme e Rosisë.”

“Mos po talleni?! S’është e mundur! Dua të flas me komandantin”. Në këtë e sipër, mbërriti edhe komandanti dhe ai më tregoi një faks me urdhër ndalimi nga zëvendësprokurori Chuglasov. Atëherë m’u kujtuan edhe fjalët e policit, me rastin e hyrjes në Rusi. Pa e zgjatur më shumë, mora në telefon Chuglasovin, ndaj të cilit tashti isha i mbushur inat. Dhe i hakërrehem atij në telefon:

“Ju nuk jeni normal! Ju nuk më informuat për këtë intrigë! Më thatë se nuk do të flisnit me shtypin. Përveç kësaj, pse nuk më treguat se kishit firmosur një urdhër, për të më ndaluar të dal nga Rusia? Pse nuk u dashka të largohem? Mbi ç’prova më akuzoni? Të jeni të sigurt se kësaj radhe nuk do t’ia hidhni aq lehtë. Tani u mbush kupa!”

Nga ana tjetër e telefonit, Chuglasovi përpiquej të ruante qetësinë.

“Na falni, zoti Pacolli”, më thoshte ai. “Ka ndodhur një keqkuptim. Bëhet fjalë për një urdhëresë të vjetër, e cila tashmë nuk vlen. Do ta heq menjëherë atë ndalesë. Ma kaloni komandantin.”

Kaq ishte. M’u bë e qartë se ndalesa për dalje nga Rusia ishte e një muaji më parë, atëherë kur u ndodha përnjëherësh me Karla Del Ponten në Moskë dhe kur avioni me të cilin udhëtoja, qëndroi për

një kohë në pistë, pa mundur të merrte leje të nisej. Atëherë urdhri i ndalesës kishte arritur me vonesë, ndërsa tani ishte i vjetruar. Nuk kishte këtu asgjë për t'u çuditur. Kështu shkonin punët në Rusi dhe kështu ngatërroheshin me këmbët e tyre ata që bënë të pamundurën të më sajnin herë një grackë dhe herë një tjetër. Kësaj radhe pa asnjë vonesë unë bashkë me aeroplanin tim u nisa për në Frankfurt. Tani, çfarë është në radhë për të rrëfyer? Po, takimi i im me Karla del Ponten, siç e kam përmendur më herët në këtë libër, i cili ndodhi më 29 mars 1999, në zyrat e Prokurorisë së Përgjithshme në Bernë. Nga ana e Del Pontes ishte i pranishëm edhe asistenti i saj, zoti Stadler, ndërsa unë kisha marrë me vete avokatin tim, zotin Gringola, dhe drejtoreshën financiare të *Mabetex-it*, Lucina Mesani.

Përsëri Karla del Ponte nuk dukej në ditët e saj më të mira, ose së paku mua më krijoi këtë përshtypje. Dukej e egër, e sertë dhe sillej si një police e zakonshme, që ka harruar të veshë uniformën. Kjo pamje nuk i jepte siguri, madje e bënte qesharake, veçmas para meje, që e dija se ligjet e një shteti demokratik nuk i japin fuqi përfaqësuesit të institucioneve, por e bëjnë që të ndihet përgjegjës.

Që në fillim të bisedës, Karla Del Ponte përsëriti kërkesën e saj të njohur për bashkëpunim:

“Siç ju kam thënë edhe në Lugano janarin e shkuar, nëse ju tregoni gjithçka që na intereson, si qëndrojnë gjërat, nuk do të keni asnjë problem për të rikuperuar kreditë tuaja në Rusi. Madje do të keni edhe një lloj mbrojtje...”

Kësaj radhe përgjigja ime ishte e qartë dhe e shpejtë:

“Zonja Del Ponte, unë kam vendosur t'i them gjërat ashtu siç janë. Mund t'ju them ato gjëra që kanë ndodhur vërtet, por jo edhe ato që nuk i di... Ç'është e vërteta, unë nuk e di saktësisht se çfarë kërkoni ju prej meje... Lidhur me këtë, dua që ju ta kuptoni se jam shumë i indinjuar me këtë falsitet të gazetave, kur shkruajnë për mua. Do të doja ta dija, a jeni ju që i kaloni këto gjëra te gazetatat? Për mendimin tim keni marrë një rrugë të gabuar dhe nuk e di nëse do të ishte e drejtë për ju, si prokurore federale, t'u bëheni krah gënjeshtreve të Skuratovit...”

E pashë me vëmendje fytyrën e Del Pontes. Nuk u ndie mirë. Mbase nuk e kishte pritur që unë të flisja kaq hapur dhe ta akuzoja



*Një titull nga shtypi i kohës: Zvicëri që mund të rrëzojë Jelsinin!*

kaq drejtpërdrejtë.

“Ne nuk u themi asgjë gazetave”, u mbrojt ajo. “Janë rusët ata që flasin. Ne nuk mund të marrim përgjegjësinë për atë që thonë të tjerët.”

“Sigurisht, e kuptoj”, ia ktheva unë. “Por nuk janë vetëm gazetaret ruse ato që shkruajnë të pavërteta. Janë edhe ato zvicerane. Më sa duket është dikush, si në Zvicër, ashtu edhe në Rusi që s’mund ta mbajë gojën mbyllur, përderisa nuk ka asgjë të vërtetë për të thënë.” “Unë nuk di ç’të bëj”, tha dukshëm e bezdisur prokurorja e përgjithshme.

Pjesa tjetër e bisedës u zhvillua me tone më të qeta. Unë fola për punët që kisha bërë në Rusi, madje që më herët, që kur punoja në *Interplastica*, duke treguar për kontratat, për tenderët. Zonjës Del Ponte ia bëra të njohur se kontratat për godinat e Kremlinit së pari firmoseshin nga entet shtetërore ruse, nga përfaqësuesit e *Moebelintorg-ut* dhe *Technoproimport-it*, përpara se të vinin në duart e Borodinit. Ai ishte i fundit që i firmoste. Rrëfeva çdo gjë edhe për vlerën e punimeve. Nëse kishte pasur rritje të vlerës së



kontratave, ajo bëhej sipas normave të përfshira, po brenda këtyre kontratave, varësisht nga çmimet në treg të shërbimeve dhe të mallrave të furnizuesve të mi, diçka e shpjegueshme për dinamikën me të cilën operoja atëherë.

Tregova, gjithashtu, se gjatë kryerjes së punimeve, zoti Borodin, i shoqëruar nga specialistët, kishte ardhur disa herë në Lugano, në Gjermani dhe Itali, ku vepronin furnizuesit e mi, për të kontrolluar cilësinë e materialeve që do të përdroreshin në procesin e rinovimit. Me ardhjen e delegacioneve ruse lidheshin edhe kartat e kreditit dhe një sasi e shpenzimeve që ishin krijuar nga llogaria shumë e përfolur DEAN. Pika II e kontratave saktësonte se *Mabetex*-i kishte marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve të këtyre vizitave. Meqë numri i pjesëtarëve të këtyre delegacioneve ishte relativisht i madh, ne nuk kishim mundësi që ta shoqëronim secilin prej tyre, prandaj u linim në dispozicion nga një kartë krediti, me vlerë të kufizuar, që pjesëtarët e delegacioneve mund t'i përdornin, për të mbuluar shpenzimet e ditës.

Në bisedë me Karla del Ponten deponova edhe një vërejtje timen: po të ndodhte që unë t'i kisha paguar tangjente Borodinit, ashtu siç supozoni ju dhe Skuratovi, atëherë si është e mundur që unë ende mbetem kreditor i miliona dollarëve, që m'i kanë borxh rusët për punët e kryera tash e sa vjet? Nga ana tjetër, po ta kisha korruptuar Borodinin ashtu siç pretendoni ju, si mund të ndodhte që në mars të vitit 1998 po ky Borodin të urdhëronte pezullimin e punimeve për dekorimin e brendshëm të avionit presidencial "Ilushin" në Voronezh, duke e justifikuar këtë vendim se unë tashmë financiarisht kisha mbaruar...?

Del Ponte, sikundër mund të pritej, nuk më bëri asnjë pyetje që në ndonjë farë mënyre mund të lidhej me Felipe Turoverin. Madje nuk më pyeti nëse e njihja atë ose jo. Ajo dukej se ishte e vendosur t'i shfrytëzonte në maksimum "dëshmitë" e tij, duke i marrë ato si të mirëqena, por pa treguar se nga buronin ato.

Asaj i interesonte tani të dinte rreth një llogarie bankare në Budapest, në të cilën, sipas fjalëve të Turoverit, ishin deponuar një milion dollarë pikërisht në kohën kur Jelcini po vizitonte Hungarinë. Madje, Del Ponte pretendonte se gjatë qëndrimit të saj në ambientet

e *Mabetex*-it në Lugano, unë e kisha pohuar ekzistimin e kësaj llogarie dhe lidhjen e saj me Boris Jelcinin, gjë që nuk ishte e vërtetë. Unë kisha në dorë dy dëshmi, të cilat hidhnin poshtë çdo dyshim të mundshëm rreth kësaj llogarie: e para, kisha në dorë faturën e *Trinlo Investment Holding Ltd*, e cila ishte mbuluar me pagesën e *Mabetex*-it; dhe, e dyta, faktin se Boris Jelcini e kishte vizituar Hungarinë një vit përpara se të bëhej kjo derdhje parash në Budapest. Pra, thjesht, ishin dy gjëra që në asnjë mënyrë nuk mund të lidheshin me njëra-tjetrën.

Po kaq të paqëndrueshme dilnin edhe akuzat mbi llogarinë DEAN. Unë e provova me dokumente se nga kjo llogari nuk ishin tërhequr asnjëherë 11 milionë dollarë dhe se aty, sikundër e kam rrëfyer edhe më herët, kishte pasur saktësisht 1 milion e 850 mijë dollarë, nga të cilat për nevojat e *Mabetex*-it ishin shpenzuar 1 milion e 750 mijë dollarë, 68 mijë ishin transferuar në Bankën Italiane të Zvicrës, ndërsa 32 mijë dollarë kishin shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të delegacioneve ruse, përmes kartave të kreditit, për çka fola më herët.

Por, siç do të shihet më vonë, edhe pala ruse dëshironte të linte dëshmitë e saj të shkruara rreth kësaj historie. Pas pezullimit disamujor nga detyra, Skuratovi më në fund merr kartonin e kuq në parlamentin rus dhe shkarkohet nga funksioni. Parlamenti miratoi dekretin e Presidentit Jelcin për shkarkimin e Skuratovit, për shkak të skandalit të tij seksual. Kjo ndodhi në fillim të dhjetorit të vitit 1999. Ky fakt tani nuk ka ndonjë rëndësi, por janë dëshmitë e tij ato që kanë rëndësi retrospektive. Në mars të vitit 2000 ai botoi librin me titull *Varianti Dragon* ku gjithsesi do të zerë vend edhe “çështja *Mabetex*”. Skuratovi ishte i bindur në të tijën se insistimi i Jelcinit për ta hequr nga posti i Prokurorit të Përgjithshëm të Rusisë lidhej me pengimin e hetimeve për përfshirjen e vetë Jelcinit dhe të vajzave të tij në “afërën” me *Mabetex*-in.

Le t'i shohim një nga një dëshmitë që sjell ai.

“Herën e parë që dëgjova të flitej për *Mabetex*-in, shkruan Skuratovi në librin e tij, “ishte kur më foli Karla Del Ponte.” Dhe më tej: “Duke studiuar dokumentet, pashë që *Mabetex* kontrollohej nga policia zvicerane, bile edhe gjermane”, për të shtuar pak më poshtë:

“Materiallet e policisë mbi *Mabetex*-in, ranë në duart e Karla del Pontes dhe ajo vendosi të qartësonte rolin e rusëve që frekuentonin këtë firmë.” Skuratovi më tej bën sikur saktëson: “U gjetën edhe llogaritë rrjedhëse. U hap çështja hetuese se për cilën arsye ishin hapur këto llogari dhe nga vinin paratë”.

Pra, Skuratovi në tërësi ia ngarkon Del Pontes përgjegjësinë për aferën, madje edhe një veprim të saj të pabesueshëm, se ajo kishte pezulluar një çështje penale në Zvicër kundër Felipe Turoverit, në këmbim të “dëshmive” të tij për mua dhe *Mabetex*-in.

Ja çfarë thotë Skuratovi: “Turoveri, duke përdorur dokumente të falsifikuara, transferonte në llogaritë e tija paratë e shtetasve rusë të nxjerra në mënyrë të paligjshme jashtë vendit”. Më tutje: “Në hetimet e prokurorisë hyri një dëshmitar i rëndësishëm, Felipe Turover. Ai bënte pjesë në një çështje tjetër... Turoveri parashtroi një ide, e cila në pamje të parë dukej e pamundur: sikur funksionarë të lartë të Kremlinit futnin në xhep "zarfa" që ua jepte Behgjet Pacolli, të cilët ia shpërblenin duke i dhënë në shkëmbim punime të rëndësishme". Skuratovi shkon edhe më tej: “Institucionet e drejtësisë zvicerane hamendeshin se vlera e shumë punëve të *Mabetex*-it ishte një shumëfish i vlerës reale të objektit”, për të përfunduar aty ku Skuratovi realisht e kishte syrin: “Dolën në shesh edhe kartat e kreditit të familjes së Presidentit të Ruisë”. Mirëpo, Skuratovi nuk mund të mos e pranojë se “Karla më siguroi vetë, që Jelcini nuk e ka përdorur kartë krediti”. Por kjo, sipas Skuratovit, nuk vlente për vajzat e Jelcinit, prandaj ai shkruan në librin e tij: “Shpenzimet e vajzave të Jelcinit, ku shkonin paratë, nga vinin këto para, cilat ishin garancitë bankare, kush i hapte kartat e kreditit etj. etj., të gjitha këto ishin shkruar në letrat që erdhën nga Zvicra. Për të gjitha këto kam marrë një vandak me letra, që vërtetonin aktivitetin kriminal të krerëve të Kremlinit”.

Në librin e tij, Skuratovi nuk fsheh edhe hidhërimin e tij me mua. Ai në libër shkruan se si është e mundur që një shqiptar nga Kosova të hyjë dhe të rinovojë Kremlinin, kur ka pasur shumë firma të tjera të botës perëndimore? Më tutje, ai thotë se me këtë lëvizje, Rusia ka rënë shumë poshtë. Skuratovi thotë se tani nuk ka para, por një ditë, kur t'i ketë ato, do të më hakmerret mua.

Pra, Skuratovi, edhe përkundër faktit se e quan veten meritore për zbulimin e skandaleve të korrupsionit në Rusi, bëhet më i kujdesshëm ndaj vetes, kur vjen puna te dëshmitë dhe procedurat. Ai nuk dëshironte të merrte mbi vete përgjegjësinë për aferën “Russiagate”, por këtë përgjegjësi ia lë në tërësi Karla del Pontes. Përshtypja ime ka qenë dhe është se në këtë çështje që të dy palët kanë bashkëpunuar mirë, ndoshta secila për hesape të ndryshme, madje sikur ishin vendosur në një garë të paparim të se kush do të shpifte dhe do trillonte më shumë. Tani prej hedhjes në qarkullim të gjithë këtyre informatave kontradiktore në mes të këtyre dy prokurorive, kuptohet se njëra ia zbulon gënjeshttrat tjetrës. Duke i lexuar këto dëshmi, e shihja sa qesharake ishin. Këto mua më bënin më të fortë.

Me afrimin e verës, kur fushata e bombardimeve të NATO-s në Kosovë po i afrohej fundit, afera sikur u qetësua pak, por assesi nuk pushoi. Me gjithë njoftimet se Karla del Ponte ishte caktuar të zëvendësonte zonjën Luiz Arbur (Louise Arbour) në Gjykatën e Hagës, institucioni që ajo drejtonte vazhdonte një trajtim shumë specifik ndaj meje, ndonëse isha qytetar zviceran, i barabartë me të gjithë njerëzit e tjerë përpara ligjit. Ndoshta “goditjen” më të madhe aferës “Russiagate” ia dha skandali financiar me “Aeroflotin”, që kishte përmasat e një katastrofe financiare për Rusinë. Kjo e fundit nuk kishte të bënte as me mua e as me *Mabetex*-in.

Megjithatë, në fazën e fundit të kësaj afere, nga rusët e preokupuar me një mijë e një shqetësime të tjera dhe nga zviceranët e mbetur pa kryepolicin Karla del Ponte, flamurin e marrin italianët, më saktësisht gazeta *Corriere della sera*.

Kjo gazetë- për mendimin tim asokohe 100%, proserbe-, në gusht të vitit 1999 nisi një fushatë të paparë kundër meje, duke botuar një fejtton të gjatë për aferën “Russiagate”, dhe jo vetëm për atë.

Megjithatë, “fundin e lojës” në këtë aferë e shënojnë zgjedhjet në Rusi, të mbajtura në dhjetor të vitit 1999. Fitorja e Jelcinit mbi kampin e kundërshtarëve të tij, një taborr laraman faktorësh politikë, ushtarakë, biznesi, etj., ishte e padiskutueshme, megjithëse zhvillimet që pasuan ishin të paparashikueshme. Tërheqja e tij nga funksioni dhe caktimi i Putinit si trashëgimtar u dha fund disa

iluzioneve të kampit tjetër. Në të vërtetë, që në shtator, kur Putini caktohet kryeministër nga Jelcini, shihej qartë se në ç'drejtim do të shkonte rrjedha e ngjarjeve. Taborri anti Jelcin, u ndie i kompensuar prej këtij emërimi, anipse ky nuk ishte qëllimi i Jelcinit me emërimin e Putinit. Emërimi i Putinit si kryeministër e më tej si President i shtetit, u konceptua nga kundërshtarët e Jelcinit si kompromis, por ama Jelcini nuk kishte menduar dhe as nuk priste që Putini do ta ndërronte kursin properëndimor të Rusisë.

Lëvizjet e mëvonshme të tij sipas një kursi antiperëndimor, brenda një kohe të shpejtë e përforcuan më shumë këtë tabor në skenën publike ruse.

Po ç'përfaqësonte Putini në atë kohë në këtë skenë kaq të populluar? Unë e kam njohur për herë të parë në pranverën e vitit 1994 në Shën (Saint) Peterburg. Jelcini kishte shprehur dëshirën që mbretëresha Elizabeta e Britanisë së Madhe gjatë vizitës së saj në Shën Petërburg të qëndronte në një pallat të denjë për të. Borodinit, mua, Sasha Liulkinit, na u kërkuar pikërisht të gjenim një mjedis të tillë. Shkuam me një aeroplan ushtarak dhe më kujtohet se pikërisht atë ditë filloi lufta në Çeçeni, një fakt që e dëgjonim nga radiolidhjet e ekipazhit. Sapo mbërritëm, shkuam në bashkinë e qytetit për të takuar kryetarin Sobciak, i cili nuk gjendej aty, kështu që u detyruam të takonim një person që në pamje të parë më dukej krejt i parëndësishëm. Kemi dalë prej andej, kemi shëtitur, kemi këqyru vilat të vjetra të kohës së carit, të mbetura ashtu të braktisuara e të restauruara, të shoqëruar prej këtij njeriu dhe askush prej nesh nuk dinte kush ishte ai. Më vonë do të mernim vesh se ishte Vladimir Putini! Hetova se gjatë qëndrimit tonë në qytetin e famshëm rus, askush nuk e përmendi emrin e tij. Ne e kryem punën tonë dhe Borodini e informoi Presidentin Jelcin se kishte zgjedhur dy vila si dy vendet e mundshme që, mbasi të rinovoheshin mund të shërbenin për akomodimin e mbretëreshës britanike. Pak kohësh pas vizitës sonë në Shën Petërburg, pak para ardhjes së mbajtëses së Kurorës në këtë qytet, Borodini organizoi një udhëtim në mënyrë që Jelcinit t'i shihte këto vila dhe të përcaktohej se cila prej tyre do të zgjidhej. Me të mbërritur atje, pamë se Sobciaku kishte zgjedhur pikërisht Vladimir Putinin për t'u marrë me vilat. Në ngut e sipër udhëtuam për në

Moskë dhe kur mbërritëm Borodini mori një telefonatë që e njoftonte se dhëndri i tij ishte burgosur në Shën Petërburg. Me aeroplanin tim që gjendej në aeroport, u kthyem urgjentisht në atë që dikur quhej qyteti i Leninit dhe kësaj radhe Borodini u tregua më i sjellshëm me Putinin. Ai kishte marrë përsipër të zgjidhte problemin e dhëndrit të tij. Pas kryerjes së punimeve të *Mabetex*-it, në rindërtimin e vilës së zgjedhur për bujtjen e Mbretëreshës Elizabet gjatë qëndrimit të saj në Shën Petërburg në vjeshtën e 1994-ës, në kompensim të shërbimit të Putinit për dhëndrin e vet, Borodini e ftoi njeriun e ardhshëm nr. 1 të Rusisë të punonte si zëvendës i tij në administratën presidenciale në Kremlin. Ai e kreu këtë detyrë për 6 muaj dhe përsëri Borodin, që tashmë kishte mësuar për eksperiencën e tij si gjeneral i KGB-së në Rusi, e propozoi për drejtor të FSB-së, shërbimit sekret rus. E di që Borodini duhet të ketë qëndruar pas edhe mbrapa emërimit të tij kryeministër i Rusisë. Nuk më janë të njohura detajet e bisedave të mëvonshme, por ai shumë shpejt u ngjit lart, dhe arriti publicitet të jashtëzakonshëm. Ngritja e Putinit duhet të jetë mbështetur dhe nga lobi i shënpetërburgasve, që sapo ishte krijuar në Kremlin, siç ishte ministri i financave Kudrin, funksionari i lartë i administratës së Jelcinit, Volloshin, shefi i shërbimit informativ të administratës, Estrezimski etj.

Me krizën financiare ruse të vitit 1997 dhe më vonë me ardhjen e Putinit në krye të shtetit, për *Mabetex*-i u shfaqën sinjalet e para të vështirësive, që nisën me vonesat në pagesa. Kjo krizë e gjeti *Mabetex*-in me punë të kryera dhe të papaguara për një vlerë prej 370 milionë dollarësh, dëm që u bë akoma më i madh për shkak të zhvleftësimit të rublës, që do të asgjësonte dy të tretën e kësaj shifre. Kriza do të intensifikohej (ç'rastësi!) krahas me keqësimin e situatës në Kosovë.

Putini ishte njeriu që praktikisht i likuidoi nga skena politike të gjithë ata që kishin qenë afër tij, përfshirë dhe njerëzit që e kishin ndihmuar. Kjo shihet kudo në librin e tij autobiografik, të shkruar kohët e fundit, por dhe nga dëshmitë e njerëzve që janë ende gjallë. Borodini ishte gjithashtu viktimë e spastrimeve të tij, megjithëse ai qëndronte pas ngritjes së beftë të Putinit në karrierë. Siç do të shihej më vonë, menjëherë pas fillimit të bombardimeve në Kosovë,

Putini do të bëjë komentet e para kundër meje. Prej fjalëve kaloi në vepër, duke shmangur praktikisht çdo angazhim të *Mabetex*-it në Rusi. Mbas fillimit të bombardimeve, biznesi im në Rusi u ndal pothuajse dhe unë rrezikoja shumë duke qëndruar atje. Më binin në mend fjalët e Jelcinit se “duhet të ruhesh”. Nuk pata asnjë kontakt të mëtejshëm me Putinin dhe me lidhshimin e ri rreth tij, megjithëse për mua kjo nuk përfaqësonte kurrfarë humbjeje, ngaqë kishin filluar tashmë angazhimet e mia në Kazakistan, ku po ndërtoja qytetin e ri Astana. Presidenti Nazarabajev më kishte paralajmëruar se pas ardhjes së Jelcinit mund të rrezikoja shumë duke qëndruar në Rusi dhe parashikimi i tij doli i vërtetë.

Në një kuptim dhe unë isha viktimë e spastrimeve të Putinit, dhe e përpjekjeve të tij për të krijuar lidhje të reja me biznesin. Unë isha dikush që e njihja atë. Unë isha mik me njerëzit që dinin shumë rreth tij, që e kishin sjellë atë në Moskë. Me ardhjen e tij në krye të Kremlinit, mund të them me siguri se filloi periudha e humbjeve të mia në Rusi në forma të ndryshme, mes të cilave dhe mosrespektimi i pagesave sipas kontratave të nënshkruara me administratën ruse. Këto humbje, që arrijnë në qindra milionë dollarë, kanë mbetur të pashlyera dhe sot. I kam paditur në gjyq autoritetet ruse, por asnjë rezultat, pasi drejtësia ruse kontrollohet nga lart duke nxjerrë lloj-lloj pretekstesh.

Me ndryshimet e vitit 1999, ndryshoi radikalisht qasja e Rusisë ndaj Kosovës dhe automatikisht dhe ndaj meje. Po shtoheshin zërat në Dumë që kërkonin dërgimin e vullnetarëve rusë për të luftuar krahas vëllezërve serbë, që po vriteshin me armët e blera me paratë e Rusisë, dërguar nga unë. Në këtë atmosferë qëndrimi im në Rusi u vështirësua shumë. Jo rastësisht unë u ndala njëherë nga patrulla policore e Rusisë, edhe pse kisha një përcjellje të veçantë. Qëllimi i këtij ndalimi ishte diskreditues; për të më regjistruar në dokumente, duke lënë të hapur mundësinë “se më ishin gjetur sende apo materiale të dyshimta”, gjë që realisht nuk ndodhi.

Po le të kthehemi te çështja "Russiagate". Më shumë se dëmet e mëdha financiare që m'i shkaktoi kjo aferë, për mua më lënduese ishte pamundësia që në çfarëdo mënyre të angazhohesha rreth Kosovës, ku po zhvillohej drama më të madhe në historinë e popullit tim. Siç

e kam shpjeguar më parë, nuk mund të ishte rastësi intensifikimi i aferës kundër meje pikërisht në ditët kur Kosova u vendos në fokus të politikës dhe opinionit ndërkombëtar. Fillimi i bombardimeve të NATO-s, më 24 mars 1999, shënon edhe kulmimin e akuzave kundër meje. Në muajt pararendës, gjatë Konferencës së Rambujesë dhe menjëherë pas saj, dukej sikur çështja e Kosovës shkonte në hapa paralel me intensifikimin e aferës "Russiagate". Më dukej sikur një pjesë e medias botërore më vërsulej mua, një kosovari, vetëm për të krijuar një shembull negativ, karshi sensibilizimit pozitiv të mbarë opinionit botëror, i cili tashmë ishte pozicionuar qartë në mbështetje të Kosovës dhe të çështjes së saj të drejtë.

Përveç kësaj, ishte shumë e vështirë për mua që natë për natë të shihja në televizor krejt atë që ndodhte në Kosovë. Atje kisha familjen e gjerë, kisha njerëzit e mi të afërt, vëllezërit, motrat, megjithëqë, thënë të drejtën, në ato ditë të vështira të gjithë kosovarët më dukeshin sikur ishin njerëzit e mi. Unë isha tërësisht i preokupuar me këtë situatë të rëndë dhe doja që të krijoja ndonjë influencë të rëndësishme për Kosovën.

Por unë vetë nuk e kisha bërë këtë zgjedhje. Kësaj radhe, me ose pa dëshirën time, isha bërë cak i armiqve të Kosovës. Në njëfarë mënyre, tashmë isha bërë pararojë në këtë shënjestër.

Satisfaksioni për paqëndrueshmërinë e të gjitha akuzave erdhi më vonë, më saktë më 8 mars 2001, kur Prokuroria zvicerane lëshoi një dokument, me të cilin saktësohej se as unë dhe as *Mabetex*-i, as firmat e ndërlidhura me punën dhe veprimtarinë tonë, asnjëherë nuk kishin qenë objekt i ndjekjes penale dhe se nuk kishte pasur asnjë interferim shtetëror në biznesin tim. Kjo ishte fitorja ime më e madhe, edhe e *Mabetex*-it gjithashtu, në aferën "Russiagate".

Nëse tani reflektoj për gjithë këtë, duhet të përmend edhe disa fakte. "Russiagate" kaloi. As unë dhe as *Mabetex*-i, pos humbjeve ekonomike, nuk patëm ndonjë pasojë ligjore. Nuk u ngrit dhe nuk mund të ngrihej asnjë padi, qoftë civile apo penale. Përkundër tentativave për të ndërhyrë në llogaritë e firmave të mia, (kjo i interesonte shumë dikujt) ato nuk u bllokuan asnjëherë në mënyrë që biznesi im të kufizohej. Humbësit e "Russiagate" janë Skuratovi, ish-prokuror i përgjithshëm i Rusisë, i cili tani sillet rrugëve, por edhe



Primakovi, Del Ponte, Turoveri etj. Unë e kisha denoncuar Skuratovini për shpifje dhe për shpërndarje të informatave denigruese në Rusi dhe gjyqi i Moskës e dënoi atë me pagesë prej 1 milion rubla (diku rreth 300 mijë dollarë me kursin e atëhershëm). Këto para Skuratovini asnjëherë nuk m'i pagoi. Primakovi, i alkoolizuar, e që i takonte, pak a shumë, bllokut kundër Jelcinit, tani është njeri i së kaluarës; Karla Del Ponte jo më Prokurore e përgjithshme, por ish-prokurore e Zvicrës; Turoveri tashmë nuk është "hero" që shpërndante akuza, por i kërkuar nga drejtësia e shumë vendeve (edhe nga Rusia), njeri me fletarrest ndërkombëtar. *Banca del Gottardo* nuk është më banka ime që fitonte miliona nga biznesi i *Mabetex*-it, ajo është ish-banka ime. Gazetarët Oleg Lurie dhe Vladimir Ivanidze, tani janë në burg për shpifje (Oleg Lurie është i dënuar me 11 vjet burg), e shumë të tjerë që tani konsiderohen si "ishë". Fenini, nga ana tjetër, që i "hëngri" 100 ditë burg, nuk qëndroi duarkryq dhe fitoi gjyqin bile duke u dëmshpërblyer nga shteti zviceran për ditët që kaloi në burg. Fenini ka krijuar një firmë të vetën dhe tani punon në Zvicër si qytetar i lirë.

Në anën tjetër unë, Behgjet Pacolli, isha dhe jam edhe më i fortë. *Mabetex*-i ishte dhe është edhe më i fortë. Kthimi im në Kosovë, që aq shumë e luftonte Karla del Ponte, tani është realitet. Unë jam këtu tash sa vjet dhe po kontribuoj ekonomikisht e politikisht për zhvillimin e vendit tim. Madje jam edhe njëri nga nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, që rusët proserbë dhe Karla del Ponte nuk e dëshironin.

Pa marrë parasysh vërsuljet e atyre që nuk e donin Kosovën dhe donin gjithsesi që unë të isha larg saj, u them që gjatë tërë periudhës së bombardimeve, departamenti i transportit në *Mabetex*, u vu plotësisht në ndihmë të popullit shqiptar të Kosovës, i dëbuar me dhunë nga vendi i vet. Unë me zonjën Fanfani të Italisë, organizova një operacion të paparë të ndihmave për kampet në Kukës, e më tepër në Ivangrad. Kam ndihmuar në shumë forma UÇK-në, dëshmitarët janë gjallë, por sigurisht nuk kam qejf të mburrem hëpërhë për këtë për shumë arsye. Ndoshta në një kohë tjetër më të qetë.

Në anën tjetër, edhe Presidenti Jelcin, në mënyrë të befasishme i pat fituar zgjedhjet, duke u treguar armiqve të tij se ai ishte Jelcini i

vjetër. Por pas kësaj ai papritmas u tërhoq nga posti.


Borodini vazhdon të mbetet në skenën e politikës ruse. Ai është President i Unionit ruso-bjellorus dhe vazhdon misionin humanitar, duke u ndihmuar fëmijëve në nevojë. Janë të shumta çerdhet e fëmijëve që zonja Borodin sot i sponsorizon nëpër Moskë.

Frustrimin e vet për Kosovën, Karla del Ponte e shpreh edhe në librin e saj "Gjuetia", në të cilin flet për të ashtuquajturën "shtëpi e verdhë - shtëpinë e organeve njerëzore", që nuk është asgjë tjetër, veçse një spekulim i saj, sikurse ato për "Russiagate". Një mossukses i saj është edhe fakti që asnjëherë nuk mundi të më dërgojë në Hagë, ashtu siç sigurisht mendoj se është zotuar. Miqtë e afërt të saj në Zvicër ishin kundërshtuesit më të mëdhenj të njohjes së Kosovës si shtet nga ana e Zvicrës. Po këta njerëz janë edhe ata që tani duan të hetojnë për "Shtëpinë e verdhë". Dik Marti, për shembull. Ky i fundit erdhi në Kosovë me aeroplan privat dhe (erdhi ta gjente "Shtëpinë e verdhë" të Karla del Pontes), i përcjellë nga policia thua se Kosova ishte një xhungël dhe mezi prisnin që ta vrisnin atë. Kjo sjellje e Dik Martit në Kosovë ishte shumë qesharake e sidomos lëvizjet e tij nëpër rrugët e Prishtinës me tërë ata bodigardë. Sa çudi! Si nuk ishte në gjendje ta kuptonte se për kosovarët ishte shumë i parëndësishëm dhe prania e tij në Kosovë vërehej vetëm falë bodigardëve të shumtë dhe asgjë tjetër. Pra edhe njëherë Zvicra, sikur, në rastet e shumta të Karla del Pontes, paguante kot shpenzimet për këta njerëz me paratë e taksapaguesve të vet, e fatkeqësisht edhe me paratë e mia. Sjelljet e Martit në Kosovë nuk i përngjanin aspak një funksionari të lartë zviceran. I kundërt me të është shembulli i ministres Mishlë Kalmi Rej (Michelin Calmy-Rey) e cila vizitoi Kosovën, duke lënë përshtypje të veçantë me praninë e saj te njerëzit e Kosovës jo për numrin e bodiguardëve (ajo nuk kishte të tillë), por për shkak të kulturës së lartë, shpirtit, sinqeritetit, energjisë pozitive dhe afërsisë me njerëzit. Kjo është Zvicra e vërtetë dhe sigurisht as Dik Marty dhe as Karla del Ponte nuk janë ata që e përfaqësojnë këtë vend në mënyrë dinjitoze.

Si përfundim, rrëfimi i mësipërm na bën të kuptojmë se mundësitë që ligji të keqpërdoret prej oportunistëve politikë edhe në vendet me demokraci të hershme janë reale. Dukuritë e këtilla

janë shqetësuese sidomos në vendet me demokraci të re, siç është Kosova, ku keqpërdorimit me drejtësinë i bashkëngjitet pasinqeriteti dhe korruptimi i operuesve në gjyqësi.

RÉPUBLIQUE ET CANTON DE GENÈVE



POUVOIR JUDICIAIRE

**PROCURER GÉNÉRAL**  
Place du Bourg-de-Four 1  
Case postale 3565  
1211 Genève 3

Palais de justice, le 25 mars 2002  
Tél. : +4122 327 26 00  
Fax : +4122 327 01 11

Mabetex Project Engineering SA  
Via Cattori 7  
6902 Lugano

N/réf : PG/jor

Concerne : P 4880/99

Madame, Monsieur,

Votre courrier du 15 mars écoulé m'est bien parvenu.


Votre société n'a jamais fait l'objet d'une poursuite pénale à Genève et ne pourrait en faire l'objet, dès lors qu'en droit pénal suisse, les personnes morales ne peuvent être poursuivies.

S'agissant de votre président M. Behgjet PACOLLI, je confirme que la poursuite dirigée contre lui a été classée par ordonnance du 4 mars écoulé, pour les motifs indiqués dans cette décision.

Cela signifie que le précité n'est plus l'objet de la poursuite et que la cause est terminée en ce qui le concerne.

Je vous prie de croire, Madame, Monsieur, à mes sentiments distingués.

Le Procureur général  
Bernard BERTOSSA



*Përgjigja e Prokurorit të Përgjithshëm të Zvicrës, Bernard Bertossa, më 25 mars 2002, që dëshmon se kompania ime nuk ishte hetuar asnjëherë dhe se ka pshuar hetimi ndaj meje.*

## Unë njoh dhe dështime. Por kudo investoj besim.

*A kam dështuar? Po, dhe besoj se do dështoj prapë sepse unë besoj shumë. Rasti i një njeriu mbi të cilin unë investova shumë besim, e afrova pranë meje dhe u përfshi në manovra keqbërëse ndaj meje që lidhen dhe me Russiagate-n. Porosia e gjyshit Osman: "Shpinën ruaje nga ata që u ke bërë të mira". Njohja me Rezart Taçin dhe dëshira për të bashkëpunuar me një biznesmen shumë premtues dhe ambicioz.*

**G**jatë jetës sime të gjatë në biznes, brenda dhe jashtë vendit, kam njohur dhe dështime, madje edhe dështime të mëdha. Ndoshta jo aq në pikëpamje të vlerave monetare sesa të zhgënjimeve të thella që më kanë shkaktuar njerëzit në të cilët kam investuar edhe shpirtërisht. Janë dështime që vijnë prej besimit të tepërt që unë shfaq në njerëzit. Nuk harxhoj kohë e as energji mendore që t'i kuptoj hiletë e dikujt në artin e mbijetesës, por dhe nëse i kuptoj, përpiqem t'i justifikoj. *Comprendre pour justifier*, thonë francezët. "Të kuptosh, për të justifikuar", një porosi që e kam shpesh, qoftë edhe me kosto mbi kurrizin tim. Nuk arrij t'i kuptoj hiletë e shumta që sajojnë mendjet të vogla apo të mëdha njerëzore dhe më ka rënë shpesh vigjilenca në marrëdhënie me njerëzit, veçanërisht në Kosovë, në Shqipëri a gjetiu.

Për t'i ilustruar këto dështime të mia, po sjell para jush njërin prej rasteve më pasojësjellëse të paaftësisë sime për të dyshuar në njerëzit dhe për të rënë viktimë e manipulimeve të pista.

E ndiej si të pashmangshme të rrëfej për disa ngjarje që ndodhën në *Mabetex* në Lugano, që patën për protagonist një njeri që për shkak të respektit ndaj individit në përgjithësi, meqënëse unë nuk mbaj dot mllëf ndaj askujt, nuk po i përmend emrin e plotë. Nuk jam i frustruar për këtë që po rrëfej se në fund unë prapë kam mbetur ai Behgjet Pacolli i atëhershëm, me gjithë miqtë e mi që kisha dhe respektin që zotëroja. Me punë dhe me fuqi edhe më të madhe, si morale po ashtu edhe ekonomike. Në jetë ka njerëz që mbeten miq të besueshëm, por ka edhe të tillë që vijnë e shkojnë shpejt.

Dikush lë gjurmë për të mirë e dikush për të keq. Ky rrëfim i përket kësaj kategorisë së fundit. Është rrëfim për dikë që i është dhënë besimi i pakufishëm, i rregullohet çdo gjë në jetë, i plotësohet çdo nevojë si puna, banesa, makina, karta e kreditit, e krejt privilegjet e mundshme, jo vetëm atij, por edhe familjes së tij. Sipas normave morale përfituesit duhet të kenë respekt për mirëbërësin e tyre, por jo ta keqpërdorin besimin e tij, në mënyrë të paskrupullt. Gjithçka bëhet edhe më e vrazhdë, kur ai person është dikush që ti e ke konsideruar njeriun tënd.

Fjala është për njëfarë A. Gj. Në fillim të vitit 1993 më telefonoi një i njohur i imi, Vëllaznim Xhiha, që punonte në Locarno të Zvicrës. Kisha dëgjuar për këtë inxhinier të suksesshëm, që punonte në një firmë të invertomatëve. Ai kërkoi një takim me mua dhe më luti që të bëj çmos në mënyrë që të mundësonim ardhjen në Zvicër të një miku të tij, që jetonte në Prishtinë, e që ishte i papunë. Bëhej fjalë për A. Gj. Pa hezitim i thashë se unë kam dy kuota (leje pune për të huajt) të lira në firmën time. Edhe pse ato ishin rezervuar për vëllanë tim, Agimin, që punonte në Moskë dhe nuk posedonte leje pune në Zvicër dhe tjetra ishte për Fadil Nezirin, nipin tim, pranova ta sillja bashkëvendësin që më propozuan. Me fjalë të tjera në 1993 këtë person e solla në Zvicër bashkë me familjen e tij, i rregullova çdo formalitet për qëndrim dhe punë. Ia besova punën e koordinatorit kryesor për ndërtimet në Rusi. Kështu ai nisi të udhëtonte shpesh në Rusi. Ishte nën autoritetin e tij të bashkëpunonte me zyrën e *Mabetex*-it në Moskë, e udhëhequr në atë kohë nga njëfarë Viktor Stollpovski. Në verën e vitit 1995, rastësisht hetova se A. Gj. ishte duke vepruar diçka në konkurrencë me *Mabetex*-in. Si? Asokohe isha në Miami të SHBA-së dhe konfirmimin për këtë konkurrim të dyshimtë e realizova nga njëkohshmëria e dy telefonatave të rastit. E thirra A. Gj. dhe nga biseda me të e kuptova se ai ishte duke vepruar diçka të padinjitetshme kundër *Mabetex*-it. Ky ishte një dyshim që ai gjithnjë e linte te unë, por që në atë rast po më shndërrohej në bindje.

Vllaznim Xhiha, siç e thashë, ishte iniciator i ardhjes së A. Gj. në Zvicër. Në të njëjtën kohë edhe Vllaznimin e pata punësuar si zëvendësin tim në *Mabetex*. Paradoksale ishte se gjatë tërë kohës

kur Vllaznimi punonte në *Mabetex*, nuk mungonin pakënaqësitë e A. Gj. për të. Gjithnjë pas shpinës së Vllaznimit më thoshte se ai nuk është për *Mabetex*-in, se nuk e dinte çka bënte dhe çdo bisedë kishte qëllimin që Vllaznimi, mirëbërësi i tij i parë, të dëbohej nga puna. Pasi që unë isha pothuajse vazhdimisht në lëvizje - në udhëtime jashtë vendit dhe nuk kisha njohuri në detaje se çka po ndodhte në Lugano, A. Gj. ia arriti qëllimit të tij të ulët që Vllaznimit ta paraqiste si njeri të panevojshëm, bile edhe të dëmshëm për *Mabetex*-in. Ende më bren ndërgjegja që unë duke u bazuar në shpifjet e A. Gj. e pushova nga puna Vllaznimit. Nuk shkoi shumë kohë, dhe A. Gj. e tregoi fytyrën dhe qëllimin e tij të vërtetë. Ai kishte dashur që në Lugano të punonte i lirë dhe të çonte përpara paralelisht biznesin e tij duke shfrytëzuar *Mabetex*-in. Prezenca e Vllaznimit si një njeri shumë i sinqertë dhe lojal me punëdhësin e vet do t'i prishte punë për të arritur qëllimin. Fatkeqësisht këtë e kuptova vonë.

Pas sinjalit që mora gjatë qëndrimit në Miami, unë fillova të reflektoj për veprimtarinë e A. Gj. E kuptova shumë shpejt se ai e kishte shtyrë Viktor Stollpovskin, drejtorin e atëhershëm të *Mabetex*-it në Moskë, i cili deri atëherë kishte merita të mëdha për sukseset e *Mabetex*-it në Moskë, që të hapte një kompani me emrin "M.T", bile duke e regjistruar edhe në Lugano. Me urdhrin e A. Gj. një pjesë të madhe të projekteve që bëheshin nga inxhinierë tanë dhe zyra teknike e *Mabetex*-it, u ndërrohej vetëm faqja e parë dhe i prezentonin në Moskë, në emër të firmës së tyre duke u lënë të kuptojnë klientëve të Moskës, se "M.T" ishte vetëm një filial i *Mabetex*-it. Ata madje kishin arritur të nënshkruanin edhe një kontratë për renovimin e një ndërtese tjetër, më duket Pallatit të kontabilitetit. E gjithë kjo tërësisht pa dijeninë time, sepse për mua ishte e pamundur të kontrolloja tërë punët e *Mabetex*-it, që ishin të shtrira në tërë Rusinë dhe kisha besim te këta dy të fundit. Për këtë arsye ua hapa dyert në të gjitha institucionet në Moskë, duke u besuar plotësisht. Ishte në autoritetin e A. Gj. që të kontrollonte zyrën e *Mabetex*-it në Moskë dhe për këtë ai e pati lehtë që ta shtynte drejtorin e atëhershëm të kësaj zyre që të bëjnë këtë veprim.

Por le të kthehemi te zbulimi i kësaj pjese të shëmtuar. Siç thashë, unë mora një telefonatë nga një klient në Rusi, i cili donte

të më shprehte pakënaqësinë për një kontratë “që ia kishte besuar grupit *Mabetex*”. Duke u thelluar në bisedë telefonike me këtë klient e kuptova se A. Gj. kishte nënshkruar një kontratë disa milionëshe në emër të M.T, duke i lënë klientit të kuptonte se kjo firmë është e Grupit *Mabetex* dhe se kjo ishte një kërkesë imja! Mbeta pa fjalë. E informova klientin se M.T. është e panjohur për mua dhe se dy personat në fjalë ishin bashkëpunëtorët e mi, por se për një gjë të tillë unë nuk i kam autorizuar. I shqetësuar e telefonova A. Gj. Ai e kishte kuptuar se unë isha duke biseduar me klientin ndaj ishte larguar nga zyra. I telefonova në mbrëmje në banesën e tij, të cilën ia kisha siguruar unë, bile edhe mobiliet ia kisha blerë po unë. Ai u mundua të kundërshtonte çdo gjë dhe t’ia linte fajin Stollpovskit. Ky i fundit nga ana e tij, pohonte se faji ishte i A. Gj. Shihej qartë se në dëm të *Mabetex*-it ai shpejt donte të përfitonte, që një ditë të më imitonte mua. Të nesërmen e këtyre bisedave kontrollova edhe urdhëresat e pagesave që kishte firmuar A. Gj. dhe në to gjeta keqpërdorime të mëdha. Nga buxheti i *Mabetex*-it ai kishte paguar shuma të ndryshme në llogari të dhëndrrit të tij në San Francisko e gjetiu, mbi bazë të kontratave fiktive. Kaq mjaftoi që ta largoja nga puna menjëherë.

Kjo ishte një përvojë e hidhur për mua, që vinte nga njeriu për të cilin unë kisha bërë çdo gjë, madje duke lënë anash edhe lejen e vëllait tim, duke sakrifikuar një njeri korrekt si Vllaznim Xhihën etj. Xhiha tani punon në Lugano, ka firmën e vet për prodhimin e invertomatëve dhe unë kam raporte të mira me të. Më vonë mësova se A. Gj., në të njëjtën mënyrë, tentoi të mashtronte edhe partnerin e tij të ri, Stollpovskin, dhe karriera e të dyve mbaroi me pasojë ndarjen e tyre. A. Gj. e larguan nga M.T. Afera *Kremlingate*, që përshkruhet në këtë libër, ka të bëjë edhe me shpifjet e tij. Këtë e kuptova më vonë, pasi konsultova dokumentet që më ranë në dorë.

Kurrë më nuk e kam parë këtë person, edhe pse më duket se jeton në afërsi të firmës time, por kam dëgjuar për një skandal që ai ka provokuar me një kompani të Luganos dhe premtimet e tij për një “projekt” fantazmë në Shqipëri (këtë e kam lexuar në shtypin e Luganos dhe në shtypin kosovar).

Se kush ishte A.Gj. e kuptova edhe prej shumë intrigave

qesharake, që mundohej të m'i bënte mua gjatë largimit nga puna, sikur të mos mjaftonin ato që kishte bërë më parë. Kështu, p.sh. ai donte të më "hakmerrej", me veprime qesharake, siç ishte dërgimi i sekretarëshes së tij të veshur në mënyrë provokative në zyrën time për të kërkuar punë. Unë e hetova këtë menjëherë dhe bisedën me këtë vajzë e bëra në praninë e njerëzve të tjerë, duke i thënë në fund: ti e ke punën te A. Gj. Shko nga ke ardhë! Ose: i përcillte vëllezërit e mi nëpër Lugano ditë me radhë, mos po bënin diçka që ai do të mund ta përdorte për shantazh. Ose edhe deklarata që kishte dhënë shumë më vonë në prokurorinë e Gjenevës para një hetuesi që hetonte për Borodinin. Më është konfirmuar poashtu se ky njeri disa herë ka nxitur një gazetë ditore në Kosovë për të botuar shkrime të gazetave moskovite e serbe dhe të *Corriere della Sera-s*, që në atë kohë bënë fushatë kundër meje, por edhe një politikë antishqiptare, që e dëmtonin imazhin tim në Kosovë. E shumë gjëra të tjera. Këto ishin vërtet qesharake dhe primitive dhe nganjëherë edhe dëfrehesha me të, sepse lojërat e tij i kisha nën kontroll të plotë.

Rrëfimin për rastin A. Gj. e bëj me vetëdije të plotë, që lexuesit të mund të njohin karakterin tim, por edhe që t'u shërbejë si përvojë atyre. Duke rrëfyer historinë e A. Gj. më bien në mend fjalët e gjyshit tim, Osmanit, që thoshte. "I huaji rrallë të bën keq. Ruaje shpinën nga njerëzit që u ke bërë të mira në jetë". Nga gjyshi mbaj mend edhe një përrallë. "Një plak kinez, në pleqërinë e tij të thellë, pranonte njerëz që vinin të konsultoheshin me të, ose ta falenderonin. Para hyrjes në sallon, i biri i tregonte kush ishte në radhë. Të gjithë njerëzit që nuk i njihnte dhe nuk u kishte bërë mirë në jetë, i pranonte dhe u thoshte fjalë miradije. Në një rast, djali ia thotë emrin e vizitorit të radhës. Posa plaku dëgjoi emrin u ngrit në këmbë duke bërë titur i nervozuar: largoje menjëherë nga pallati! I habitur djali e pyeti: pse babë? Bir, u përgjigj plaku, unë këtij njeriu i kam bërë shumë të mira në jetë dhe ky tani ka ardhur për një të keqe. Kam frikë prej tij dhe nuk dua të flas me të!"

Gjatë përvojës sime të gjatë njerëzore e profesionale kam hasur shumë njerëz të tillë, të cilëve unë u kam bërë ndere, u kam shpëtuar jetën, madje më shumë se njëherë, por të mirat m'i kanë kthyer me të keq. Më se një herë. Unë nuk e mora parasysh mësimin e madh



të gjyshit në rastin e blerjes së televizionit ALSAT në Shqipëri, apo të hotel *Grand*-it në Prishtinë, e pse jo edhe në raste të tjera. Kam pësuar zhgënjimet më të mëdha në këto raste, prej njerëzve që i kisha ndihmuar. Kam marrë kërcënime, jam mashtruar rregullisht prej këtyre njerëzve, por mjerisht apo fatmirësisht zemra ime mbeti e madhe përsëri; për t'u gënjyer sërish prej të ligjve. Jam i prirur t'u besoj të tjerëve dhe të bëj mirë pa u matur dy herë. I mësuar me operacione të mëdha ku besimi është element kyç në të cilin mbështetet sukcesi, unë e ul vigjilencën përballë hileve të vogla që jo rrallë janë kryer prej bashkatdhetarëve të mi. Por hiç s'kam dert, gjithmonë do të ndihmoj, edhe me gjasë se dështoj në biznese të veçanta. Sigurisht nuk jam dështak: besimi që investoj në marrëdhënie me partnerët, me gjithë dështimet e pjesshme, në fund të fundit më nxjerr faqebadhë. Madje dhe dështimet e shndërruara në eksperiencë më vlejné në jetë.

Si dëshmi e besimit tim të madh në njerëzit, veçanërisht tek të ngjashmit e mi, në hapësirën shqiptare, jo në Kosovë, por në Shqipëri, do të kujtoj miqësinë me Rezart Taçin, Presidentin e *Taçi Oil*, një kompani e fuqishme në tregun e naftës në Shqipëri. Nuk e kisha mbajtur mend këtë djalë të ri, i cili ishte paraqitur tek unë ndoshta nja 13 vjet më parë në zyrat e mia në Lugano, së bashku me të atin e tij dhe disa sipërmarrës italianë për të diskutuar rreth një ideje biznesi derisa një ditë nuk u ritakuam. Kur e ritakova në fund të vitit 2009, me ndërmjetësimin e një mikut tim nga Tirana, më ndodhi diçka jo e rrallë në fakt! E rikujtova thujtë të plotë bisedën me të, figurën e tij djaloshare e cila tanimë ishte pjekur, edukatën e përpunuar dhe mprehtësinë që ndihej nga lehtësia me të cilën diskutonte për idetë e veta. Kur dikush më bën përshtypje të veçantë, bisedat me të regjistrohen diku në skedarët e kujtesës sime dhe duhet fare pak për t'i riprodhuar besnikërisht. Më duhet ta them pa modesti se kam një memorie fotografike, madje dhe për tekstet dhe kjo cilësi më ka ndihmuar shumë.

E pra, me zotin Taçi u ritakova për të bashkëpunuar në disa fusha të reja biznesi dhe në një rast të dytë për t'i kaluar atij pronësinë e Radiotelevizionit shqiptar ALSAT. Para se të ndodhnin këto takime unë e ndiqja me simpati punën e tij me naftën në Shqipëri,



*Ndërtesa historike e Mabetex-it në Lugano. Këtu kanë ndodhur ngjarje të mëdha nga të gjitha këndshikimet.*

mirëkuptoja vështirësitë që kishte në operimin e tij në një treg vërtet problematik të dominuar deri më atëherë nga kompanitë e huaja të vendeve fqinje, që, për më shumë, nuk ishin vende prodhuese të naftës. Ndiqja në përgjithësi gjithë ngjarjet e lidhura me të për të cilat raportonte media. Pra, simpatia ime për sipërmarrësin e ri, përveçse ishte njerëzore mbështetej edhe te elementi profesional e kombëtar: Rezart Taçi ishte një sipërmarrës vendor, i cili ruante flamurin e vendit në një treg të dominuar padrejtësisht nga operatorë të huaj. Disa miq të përbashkët, avokatë dhe njerëz biznesi, më kishin folur gjithashtu mirë për të. Edukata e tij, respekti që shfaqte në biseda me të gjithë, ishin gjithashtu mbresëlënëse, për më shumë si cilësi e dikujt që ishte në moshë relativisht të re, me pozitë aq të rëndësishme në tregun shqiptar. Në disa shfaqje publike dhe të bujshme të tij kisha shquar përpjekjen për të treguar se ai kishte miq, kishte fuqi që nuk i vinin thjesht prej vetes. Këto shfaqje me efekte imazhi ishin diçka e justifikueshme në një mjedis si ai ku vepronte Rezart Taçi, në tregun dhe shoqërinë shqiptare, jo aq miqësor ndaj një njeriu si ai që kishte arritur shumë falë aftësive të veta. Kisha ndjekur me një lloj mirëkuptimi dhe peripecitë e tij që i kishte kapërcyer. Por simpatia ime për këtë njeri u rrit akoma më shumë për shkak të thellimit të miqësisë me familjarët e tij. I gjendur në Tiranë, më ftuan në një ceremoni të ngushtë familjare për ditëlindjen e Rezartit. Veprovë me emocion dhe mora pjesë në këtë ceremoni në të cilën ishin ftuar vetëm familjarët e tij, gjë që më impresionoi shumë. U njoha me të afërmit e Rezartit dhe në veçanti me babanë e tij, një burrë energjik, i butë, por i vendosur, që Rezarti i kishte besuar administrimin e klubit sportiv *Gramozi* i Ersekës, zonë nga vinte familja Taçi, dikur e persekutuar nga regjimi komunist. Nga fjalët që Mustafa Taçi i rezervoi në atë ceremoni të ngushtë, modeste, mësova shumë për marrëdhënien midis tij dhe të birit. “Rezarti për mua, - tha ai, është një djalë, një vëlla, një shok, një mik dhe një bashkëpunor i mirë.” Më kanë mbetur në mendje fjalët e tij... Me Rezartin do të vazhdojmë të bashkëpunojmë në të ardhmen, në shumë fusha, edhe në politikë, nëse ai do ta shohë të arsyeshme të përfshihet në të një ditë...

## Misioni i pamundur

*Dështimi im i parë sapo tentova të merresha me "politikë". Në të vërtetë, u përpoqa të kontribuoj në ndalimin e gjakderdhjes në Kosovë si qytetar që mund të bënte diçka. Një mision vullnetmirë për ndërmjetësim midis shqiptarëve dhe serbëve duke i bërë presion Millosheviqit me një dosje sekrete që Jelcini kishte ndaj tij. Sulmet e gazetave serbe ndaj meje nisur nga përmbajtja e takimit. Me kasapin, u takuan dhe krerët e politikës kosovare.*

**N**jë pyetje mund të shtrohet pashmangshëm nga kushdo që e lexon këtë libër: duke njohur personalisht Presidentin e Rusisë, Boris Jelcinin; duke njohur Çernomirdinin, ish-kryeministër, më vonë i dërguar i Presidentit Jelcin për çështjen e Kosovës; duke njohur shumë njerëz nga kupola e administratës më të lartë ruse dhe duke pasur lidhje të forta me kreun politik dhe shtetëror të Rusisë, a kam mundur të kem ndikim në zhvillimet e atëhershme rreth Kosovës, veçanërisht në periudhën 1998-1999, kur ngjarjet morën zhvillime dramatike?

Realisht, po. A kam bërë diçka asokohe? Thashë se kam ndihmuar UÇK-në, dhe historia do të tregojë nesër se ç'kam bërë për ta ndihmuar. Kam asistuar popullsinë civile me ndihma humanitare në Mal të Zi dhe Shqipërinë amë që po bënte një kryevepër të humanizmit, si komb i denjë i Nënë Terezës. Kam qenë aktiv në betejat mediatike, vetëm apo bashkë me ish-gruan time Ana Oksa, dhe u kam shkruar letra kryetarëve të shteteve të vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit. Kam shkruar shumë artikuj në mediat e kohës, kryesisht ato italiane, pasi një pjesë e aktivitetit tim zhvillohej atje. Italianët mbështetnin në mënyrë të heshtur e nostalgjike serbët dhe këtu ndikonte sigurisht prania e komunistëve në qeveri, madje ata ishin kritikë edhe ndaj Jelcinit. Kabaretë televizive italiane talleshin me të. Unë isha irrituar me qëndrimet antikosovare që nuk ishin vetëm të së majtës. Një pjesë e së djathtës italiane e shihte pavarësimin e Kosovës si rrezik që ajo të shndërrohej në qendër të fundamentalizmit islamik, e trafikimit të drogës etj., siç dukej dhe nga diskutimet e asokohshme në parlamentin italian. Kurse opozita

e drejtuar nga Fini dhe Berlusconi ishin kundër qëndrimeve të tilla. Lega Lombarda (Lidhja Lombarde), parti e drejtuar nga Umberto Bossi, ishte proserbe. Huti në opinionin publik italian krijohet dhe nëpërmjet gazetave filoserbe si *Corriere della Sera*. Në vjeshtën e vitit 1998 dhe gjatë 199, unë dhe Ana Oksa e cila më ndihmoi shumë, arritëm të depërtonim te publiku i gjerë italian përmes studiove televizive. Vetë paraqitja e Anës ma lehtësonte punën.

Çfarë mendoja unë atëherë për zhvillimet, mund të pyesë dikush? Kjo është një pyetje e drejtë dhe pa dyshim kur shkruan kujtime duhet të jesh i sqartë. Duhet të tregosh mendimet e asaj kohe, e jo thjesht të sotmet, që të jesh plotësisht korrekt ndaj atyre që lexojnë për jetën tënde. Pavarësisht çfarë mund të mendojnë unë po e ripohoj se në jetëshkrimin tim, jo vetëm nuk retushoj jetën time, bëmat e mia, por sjell dhe mendimet e mia të kohës, pa drojën se dikush do të m'i keqpërdorë ato. Siç mund të imagjinohet, mendimet dhe mund t'i fshihja, por jo, preferoj të gjykohe me transparencë ashtu siç kam qenë dhe jam. Unë jam ky që shihni në këtë libër, me gjithë gabimet a punët e mia të mira! Besnik i asaj që kam thënë në fillim të librit për rëndësinë e sqartimit në një libër autobiografik, po ju sjell këtu një letër drejtuar kryetarëve të shteteve të vendeve anëtare të grupit të Kontaktit, që u përshtat në formën e një editoriali të botuar më 28 shtator 1998 në gazetën Bota Sot, që asokohe dilte në Zvicër. Më vjen mirë që sot jo vetëm jam koherent me çfarë kam thënë atëherë, por dhe kam qenë kritik i guximshëm dhe i pakompromis, madje dhe me qarqe të larta ruse, siç duket në artikull. E kam mbrojtur publikisht UÇK-në, kur shumë pak guxonin, kam kërkuar protektorat të NATO-s, kam kritikuar qarqet ruse për mbështetjen që i jepnin Serbisë, për interesat e tyre në tregtinë e armëve, për rikthimin e borxheve serbe etj. etj. Ideja për një protektorat të Kosovës, që asokohe dukej utopike, për mua ishte e mundur, madje unë isha eksplicit - protektorat me NATO-n në krye, sepse unë mendoja se Kosova s'rezistonte dot e vetme, për t'u mbrojtur nga Serbia. Papërgatitja e asaj që quhej klasa jonë politike, mospasja e një klase administrative - nuk kishim eksperiencë në qeverisjen e punëve tona - ishin problematike. Për më shumë njerëzit tanë ishin të painformuar, kishin hendikepin e mosdihetimit në botën e lirë, mungesa në formimin akademik prej

io vjetëve, mungesa kontaktesh të niveleve të larta, mungesa në ekspertizë. Këto dukeshin elemente të mjaftueshëm në analizën time të asaj kohe, pse Kosovës i nevojitej protektorati dhe kjo analizë rezultoi e vërtetë. Pra e shihja të pamundur që Kosova të ecte vetëm në këmbë për një farë kohe edhe nëse ajo e fitonte pavarësinë. Ajo mund të mbijetonte vetëm nëse do të mbështetej nga jashtë prej miqve të vet.

Letra e mëposhtme është një letër me pak mllef, por e sinqertë. Po e botoj ashtu siç ka dalë në gazetën "Bota Sot" 28.9.1998 me të njëjtin titull dhe nëntitull.

Teksti që vijon, pasqyron letrën që ja dërgova krerëve të shteteve anëtare të Grupit të Kontaktit në gjuhët përkatëse. Jam i bindur se kjo letër është lexuar prej tyre. Këtë e kam konfirmuar dhe prej Presidentit Jelcin, i cili më ka bërë disa pyetje rreth saj.

### **Tragjedia e Kosovës – vullneti i disa ministrave, anëtarë të Grupit të Kontaktit, për interpretimin e drejtë të situatës**

#### **Kosova kërkon zgjidhje urgjente**

*Duke iu përgjigjur një artikulli të Franko Venturinit në "Corriere della Sera", Ministri i Punëve të Jashtme z. Lamberto Dini, ankohet për mosinteresimin e opinionit për atë që është duke ndodhur në Kosovë, qysh prej muajit mars. Ministri italian, thotë se bëmave në rajonin në fjalë u kushtohet vetëm vëmendje sporadike, e cila "nuk i përgjigjet dot asaj që luhet atje". Ai është i bindur se kriza sjell me vete rreziqe të mëdha, prandaj kërkon nga qytetarët dhe nga shtypi që të kenë një vëmendje më të zgjuar, një lëvizshmëri me më pak ngecje dhe më pak shpërqendrim nga lëvizshmëria e kolektivitetit imagjinar. Ankimi do të ishte për t'u kuptuar dhe për t'u ndarë me bartësin e tij, nëse fjalori i Ministrit do të ishte mjaft i qartë dhe njëkohësisht i përshtatshëm për konfliktet aktuale. Mirëpo, nuk është kësaj dhe as nuk ka qenë qysh se prej kur filloi lufta e hapur e serbëve kundër myslimanëve të Kosovës. Të gjitha fjalët që i përdor Dini u rrinë bisht zhvillimit të bëmave krimprodhuese në zonën në fjalë. Vetë emërtimi luftë s'duket pothuajse kurrë në fjalimet e tij. Në të kundërtën, duket emri krizë që është eufemizëm i njohur, e i trilluar për ta fshehur dhe për ta minimizuar kërdrinë masive. Duket, ndërkaq, fjala "irredentizëm", që Dini e huazon nga sulmet diplomatike serbe kundër diplomacisë shqiptare. Mandej janë*

TRAGJEDIA E KOSOVËS - VULLNETI I DISA MINISTRAVE - ANTARË TË GRUPIT TË KONTAKTIT, PËR INTERPRETIMIN E DREJTË TË SITUATËS

# KOSOVA KËRKON ZGJEDHJE URGJENT

Duke iu përgjigjur një artikulli të Franko Venturini në „Corriere della Sera”, Ministri i Punëve të Jashtme z. Lamberto Dini, ankohet për mosinteresimin e opinionit për atë që është duke u bërë në Kosovë, qysh prej muajit mars. Ministri italian, thotë se të bëmave në rajonin në fjalë u kushtohet vetëm vëmendje sporadike e cila „nuk i përgjigjet dot asaj që është vënë në lojë”. Ai është i bindur se kriza sjell me vete rreziqe të mëdha, prandaj kërkon nga qytetarët dhe nga shtypi që të kenë një vëmendje më të zgjuar, një lëvizshmëri më në pak ngushtë dhe me pak shpërndim nga lëvizshmëria e kolektivitetit imaginar. Ankimi do të ishte për t'u kuptuar dhe për t'u ndarë - por të ishte mjaftë i qartë fjalori i Ministrit dhe, njëkohësisht, i përshatshëm për konfliktin aktual. Mirëpo, kësaj nuk është dhe u nuk ka qenë kurrëherë qysh se prej se filloi lufta e hapur e serbëve kundër myslimanëve të Kosovës. Të gjitha fjalët që i përdori Dini i rinë në bishë zhvillimit të të bëmave krimproduese në zonën në fjalë. Vetë emri luftë s'është përfundim sesë kërkë në fjalimë e tij. Në të kundërtin, ndërmjet emri krizë që është një eufemizëm notor, trilluar për ta fshesuar dhe për ta minimizuar këndishtë masovizëm. Duket, ndërkaq, fjala „irredencenzim”, që Dini e huazoi nga sulmet diplomatike serbe kundër diplomacisë shqiptare. Mandej janë edhe fjalë të montuara. Nuk ka edhe asnjë fjalë afundim për agresionet serbe, nuk ka asnjë ankese apostafat kundër Millosheviqit; nuk ka asnjë lidhje mendimë për etnocidit e bëra në Kroaci dhe Bosnjë me urdhër të vetë Millosheviqit.

S'ka kuptim, në këto kushte, të ankohesh për pandëshmerinë e opinionit a të gazetave. Pandëshmeria qëndron në vetë gjahën, në vetë veprimet e politikaneve tanë të përgjegjshëm. Gjithëka që flasin ata zbulojnë një vullnet prej fuqije të skajshme. Të gjitha kocklavitjet e tyre kanë për qëllim l'escamotage (mashtim prej prestigjidentori): fshihen e së vërtetës, fshihen e saj që duket sheshtit. Italianët lexojnë gazeta dhe shikojnë televizionin, ata dinë për masakrat e kryera në Kosovë. Sipas gjasave, nuk janë të mjegulluara dhe as mendimet që janë lindur për përgjegjësinë për këtë kush e di të satë pastrim etnik. Ata mbanjnë mendë Vukovarin e Dubrovnikun, Sarajevën e Srebrenicën. Pamjet të ngjashme kanë rishikuar nëpër qytetet e Kosovës, në Drenicë, Prekaz, Deçan, Rahovec. Ata madje i dinë edhe emrat e kriminelëve, ama



Bexhet Pacolli

Balkanike më 1991 dhe në të vërtetë i habitshëm s'është mosinteresi i opinionit, por serbesllëku me të cilin Dini, patrazuar, i rimerr argumentimet, të cilat e çonin Evropën në njërin prej propozimeve të saja më të hatashme diplomatike - politike dhe morale. Argumentimet e përmendura i rimerr me një fjalë të skukurit, në „Curierë”, duke theksuar se „në Ballkan është e vështirë të besh dallim midis padrejtësisë dhe rajuin”. Me fjalë të tjera qenka e paundur dhe dhe sht, t'i dallosh agresorit. Nuk ekzistua kja fjalë e merrfilltë serbe që t'i ketë pezmatuar shqiptarët myslimanë dhe t'i ketë shtyrë të organizoheshin ushtararakisht pas sa e sa vjetëve qëndresës shterpo paqësore kundër shtetit, luftarak që është instaluar në vitin 1989-90. Kanë kaluar shtatë vjet prej fillimit të luftërave gjahësore, kanë kaluar tre vjet prej të amerikantë dhe NATO-ja e morën në negociata Dejtinton, pasigje e kishin mposhtur Karahliqin, kanë kaluar dhjetë vjet shpallti që Serbia e paskësh fituar betejën e Kosovës”, gjë që e tita ende para se ta hijte statusin e autonomisë së akorduar nga Tito dhe para se t'ua lëshonte serbëve kushttrimin kundër islamit më 1989- ndërsa ministri italian i punëve të jashtme akoma nuk di të thotë emrat dhe adresat e agresorëve të parë.

Gjyqi për Krime kundër Krimit në ish-Jugosllavi është shprehur troç pa zbulikim duke e quajtur federatën serbo-malazeze „shtet kriminel” (28. mars 1996). Në Hagë është hapur një procedurë hetimore kundër Millosheviqit, sekretari i përgjithshëm i NATO-s Javier Solana, deklaroi në 6 mars në Bratislavë që Millosheviqi është përgjegjësi i parë për luftën në Kosovë, gjë më tani shumë janë thënë, kurse qeveritarët italianë vazhdojnë të jenë ortakët e Beogradit. Ende nuk janë në gjendje për të gjykuar mirë e për të menduar si duhet. Gjithëka qenka aq e ngatruar në Ballkanin aq të kocklavitur. Nuk qenka fjala të

je”. Sikur Shqipëria, Maqedonia, Greqia, Bullgaria, siç e saktëson Dini. Derisa nuk tregohet, gjithëka është në rregull. Millosheviqi mund të vrasë për shtatë pale qefje, përdërisa vret vetëm brenda kufijve, përdërisa nuk i kalon e shtetit të vetë, do të jetë i shpërlyer me minimizime, me referuim e pafytyrë për t'i dalluar sulmuesit dhe të sulmuarit. Kështu asnjë përgjegjësi italian nuk i zë me gojë kriminelët e Beligradit, të cilët qysh prej vitit 1986 kanë planifikuar dhe pastaj kanë ndëzuar katër luftëra pastrimesh etnike në Ballkan. Kuptohet, përgjegjësi italianë nuk janë të vetmit që i përzijejnë sulmuesit me të sulmuarit, pa kurrfarë duajjtje që mos t'ua plasent cipa. Në paafësinë e përditimit për ta palditur përgjegjësinë e Millosheviqit dhe për ta nxjerrë atë në gjyq në Hagë qëndron një patrupësi e vogullit. Kjo patrupësi mbretëron qyshkur janë arritur marrëveshjet e Dejtonit, të cilat e kanë ndërprerë etnocidin në Bosnjë, Ndërsa e kanë injoruar vullnetarisht zjarrin e cila është zanafilla e të keqijve dhjetëvjeçare halkanike: Zjarrin e Kosovës. Mu pas Dejtonit, indpendentistët myslimanë hoqën dorë nga strategjia pacifiste e Ibrahim Rugovës dhe u përcaktuan për ekstremizimin e armatosur. Qe një reagim ndaj harrësës, ndaj shkujdjes së politikaneve që flinin mbi dafinat e Dejtonit duke ndjekur strategjinë e përherëshme, strategjinë e cila i privilegjon bisedit me palën që parashitton me shumë të vdekur në tentativat, ndërsa i injoron sistematikisht forcat që luftojnë me rrugë demokratike - pa dërrhje gjaku. Si në Algjeri ashtu edhe në Kosovë, përditimet nuk dinë sa bëjnë dy me dy: i njëjtin viktimat dhe kriminelët, por e injorim betejën e gjatë dhe të Ibrahim Rugovës si dhe tentimin e tij për të krijuar një shoqëri paralele në fshhën e ekonomisë, të administratës - shoqëri kjo paralele që e bënte me pak rëndues aparteidin e imponuar nga serbit mbi ata 90 % të popullatës që është shqiptare. Udheheqësit italianë s'janë të vetmit që të kishin shpërfillur nisima para dhe pas Dejtonit.

Mirëpo, me siguri janë nga ata më serbofilët. Ishin filloserbe qysh prej 1990-91; pikerisht ministri i punëve të jashtme D. Mikelis, ishte ai që i mbronte gjërë e gjatë serbit, duke u ankuar për opinionin dhe për shtypin. Bombat po binin mbi Vukovar, serbit po e planifikonin shfarrosjen në Bosnjë, kur De Michelis i akuzonte „mjetet e informimit” që kishin trilluar një luftë të paqenë në Ballkan”. Në diplomacinë italiane nuk pati ndonjë rishqyrim sikur nati në Francë: kur Shiraku

anë nuk është ndryshuar gjë, atje, përtej adriatikut. As sot e kesaj dite De Michelis nuk luan vendit pa u përpunuar përpara me rusët që janë aleatit e Beligradit në këtë rajon, Sipas gjasave interesat ekonomike janë tepër teftora; nafesjells ENI, i cili duhet që prej derit kaspiq të dalë deri në Trieste, kalon nëpër Serbi. Investimet italiane në Republikën e Millosheviqit janë të shumta. Sipas gjasave, gjërat që harrohen, varrosen vullnetarisht.

### Tani në kohën e Dinit është???

Diplomatet, politikantë dhe disa antarë të grupit të kontaktit duket se e kanë harruar memorandumin e Akademisë së Shkencave të Beligradit, punjë mjaftë e volitshme për ta palditur përgjegjësinë e Millosheviqit dhe për ta nxjerrë atë në gjyq në Hagë qëndron një patrupësi e vogullit. Kjo patrupësi mbretëron qyshkur janë arritur marrëveshjet e Dejtonit, të cilat e kanë ndërprerë etnocidin në Bosnjë, Ndërsa e kanë injoruar vullnetarisht zjarrin e cila është zanafilla e të keqijve dhjetëvjeçare halkanike: Zjarrin e Kosovës. Mu pas Dejtonit, indpendentistët myslimanë hoqën dorë nga strategjia pacifiste e Ibrahim Rugovës dhe u përcaktuan për ekstremizimin e armatosur. Qe një reagim ndaj harrësës, ndaj shkujdjes së politikaneve që flinin mbi dafinat e Dejtonit duke ndjekur strategjinë e përherëshme, strategjinë e cila i privilegjon bisedit me palën që parashitton me shumë të vdekur në tentativat, ndërsa i injoron sistematikisht forcat që luftojnë me rrugë demokratike - pa dërrhje gjaku. Si në Algjeri ashtu edhe në Kosovë, përditimet nuk dinë sa bëjnë dy me dy: i njëjtin viktimat dhe kriminelët, por e injorim betejën e gjatë dhe të Ibrahim Rugovës si dhe tentimin e tij për të krijuar një shoqëri paralele në fshhën e ekonomisë, të administratës - shoqëri kjo paralele që e bënte me pak rëndues aparteidin e imponuar nga serbit mbi ata 90 % të popullatës që është shqiptare. Udheheqësit italianë s'janë të vetmit që të kishin shpërfillur nisima para dhe pas Dejtonit.

Mirëpo, me siguri janë nga ata më serbofilët. Ishin filloserbe qysh prej 1990-91; pikerisht ministri i punëve të jashtme D. Mikelis, ishte ai që i mbronte gjërë e gjatë serbit, duke u ankuar për opinionin dhe për shtypin. Bombat po binin mbi Vukovar, serbit po e planifikonin shfarrosjen në Bosnjë, kur De Michelis i akuzonte „mjetet e informimit” që kishin trilluar një luftë të paqenë në Ballkan”. Në diplomacinë italiane nuk pati ndonjë rishqyrim sikur nati në Francë: kur Shiraku

Shumë nga përgjegjësit italianë dhe grekë janë gjithnjë të bindur se nuk do të kishin ngjarë lufta në Ballkan sepse Gjermania dhe Vatikanit do të kishin kërkuar njohjen e Kroacisë dhe Bosnjës në prill të vitit 1992. Mirëpo, edhe këtu e fshihen të vërtetës e dhe ekzistimin e mëparshëm të planeve serbe për pastrim etnik. Qysh para asaj dite, Vukovar ishte bërë shikrums e hi dhe bombardohet Dubrovniku. Qysh para asaj dite ekzistonte dhe funksiononte kampi i përgjendimit i Omarskës, në të cilin myslimanët torturoheshin ose vriteshin. Prandaj në polemikën kundër mendimit ka diç të pamoralshme. Do të ishte shumë më

na që pothu ndëzuar flakë Rusisë, dhe Ilavrimin dhe tjetër dhe cdi drejtim duhet ste e jo serioz që vizitoi tv organizuar ng publikur qa Duhet të bëh në Rusi që t'i të folë dhe v dhe të lënë p shtijëve të an borxhëve se dinjitet dhe të të së drejtës tentative gre evropian) të i agresionit i Kosovës.

a) Kosova cila i përkëte bëve. Kosov Mesjeje) ësi moderne) dhe rregullim adri i imponohet) gjuke, të e dhe i eklud lluanc nga re prej vivese të vishë për në radhe të parë tjeëve.

b) UÇK-si karakteri i shpesh në B mediati evro prej terrori moment nuk beri masaktë dhe qytetarë e kosovarëve pavarësi.

c) Të instri (që bën grn Kosovën në që Kosovës dëshirës së nen një formë kufijve të se nomikisht më të dobishme.

d) T'i si rektorat e fuqitë (si N mos vijë der re mbasi që se Milloshe gjakderdhja menjëherë!

e) Në p biseditit i për ardhin Kosovës.

Realizim mendura i moral, sept të jeni për popullit tin

**Faksimilja e artikullit në Bota Sot, 28 Shtator 1998 (në titull gabimisht ka dalë fjala "zgjedhje" në vend të "zgjidhje"). Kritikova Italianë, Rusinë, Greqinë si protektore të Serbisë dhe mbështeta publikisht luftën çlirimtare të UÇK-së. Kërkova prani të NATO-s si garanci e së ardhmes**

edhe fjalë të montuara: nuk ka edhe asnjë fije aludimi për agresionet serbe, nuk ka asnjë ankesë apostafat kundër Milosheviqit; nuk ka asnjë lidhje mendimi për etnocidet e bëra në Kroaci dhe Bosnje me urdhër të vetë Milosheviqit.

S`ka kuptim, në këto kushte, të ankohesh për pandjeshmërinë e opinionit a të gazetave. Pandjeshmëria qëndron në vetë gjuhën, në vetë veprimet e politikanëve tanë të përgjegjshëm. Gjithçka që flasin ata zbulon një vullnet prej fuqie të skajshme. Të gjitha koklavitjet e tyre kanë për qëllim l`escamotage (mashttrim prej prestigjiatori); fshehjen e së vërtetës, fshehjen e saj që duket sheshit. Italianët lexojnë gazeta dhe shikojnë televizionin, ata dinë për masakrat e kryera në Kosovë. Sipas gjasave, nuk janë të mjegulluara dhe as mendimet që janë lindur për përgjegjësinë për këtë pastrim etnik kush e di të satin. Ata mbajnë mend Vukovarën e Dubrovnikun, Sarajevën e Srebrenicën. Pamje të ngajshme kanë rishikuar nëpër qytetet e Kosovës, në Drenicë, në Prekaz, Deçan, Rahovec. Ata madje i dinë edhe emrat e kriminelëve, ama çfarë u hyjnë në punë këta emra! Kështu ka qenë prej fillimit të Luftës Ballkanike më 1991 dhe në të vërtetë i habitshëm s`është mosinteresimi i opinionit, por serbesllëku me të cilin Dini, patrazuar, i rimerr argumentimet, të cilat e çojnë Evropën në një rrëz prej prapësive diplomatike, politike dhe morale të radhës.

Argumentet e përmendura ai i rimerr me një fjalë të shkurtër, në "Corriere", duke theksuar se, "në Ballkan është e vështirë të bësh dallim midis padrejtësisë dhe rajonit". Me fjalë të tjera qenka e pamundur dhe sot, t`i dallosh agresorët. Nuk ekzistua kurrë fjala e mirëfilltë serbe që t`i ketë pezmatuar shqiptarët myslimanë dhe t`i ketë shtyrë të organizoheshin ushtarakisht pas sa vjetëve qëndrese shterpo-paqësore kundër shtetit luftarak që është instaluar në vitin 1989-90. Kanë kaluar shtatë vjet prej fillimit të luftërave gjithëserbe, kanë kaluar tre vjet prej se amerikanët dhe NATO-ja e morën në negociatat e Dejtonit, pasi që e kishin mposhtur Karaxhiqin, kanë kaluar dhjetë vjet pasi Serbia shpalli që "e paskësh fituar betejën e Kosovës", gjë që u tha edhe para se ta hiqte statusin e autonomisë së akorduar nga Tito dhe se t`ua lëshonte serbëve kushtrimin kundër islamit më 1989 - ndërsa ministri italian i punëve të jashtme akoma nuk di t`i thotë emrat dhe adresat e agresorëve.

Gjyqi për krime kundër njerëzimit në ish-Jugosllavi është shprehur troç pa zbulime duke e quajtur federatën serbo-malazeze "shtet kriminel" (28 mars 1996). Në Hagë është hapur një procedurë hetimore kundër Milosheviqit; sekretari i përgjithshëm i NATO-s Javier Solana, deklaroi më 6 mars në Bratisllavë se Milosheviqi është përgjegjësi kryesor për luftën në Kosovë, gjer më tani shumë janë thënë, kurse qeveritarët italianë vazhdojnë të jenë ortakët e Beogradit. Ende nuk janë në gjendje të gjykojnë e të mendojnë drejt e si duhet. Gjithçka qenka aq e ngatërruar në Ballkanin aq të koklavitur. Nuk qenka fjala në të vërtetë për krime, as për luftë dhe as për pastrim etnik, po për krizë. Do të bëhet luftë





**Gjatë pilotimit. Kam mësuar të drejtoj shumëçka, mes tyre dhe avionin**

*në rast se "kriza do të arrinte t' i destabilizonte vendet fqinje", si Shqipëria, Maqedonia, Greqia, Bullgaria, siç saktëson Dini. Derisa kriza mbahet në kontroll, gjithçka është në rregull. Milosheviqi mund të vrasë për shtatë palë qejfë, për derisa vret vetëm brenda kufijve, për derisa nuk i kalon kufijtë e shtetit, do të jetë i shpërblyer me minimizime, me refuzimin e pafytyrë për t' i dalluar sulmuesit dhe të sulmuarit. Kështu asnjë zyrtar italian nuk i zë me gojë kriminelët e Beogradit, të cilët qysh prej vitit 1986 kanë planifikuar dhe pastaj kanë ndezur katër luftëra pastrimesh etnike në Ballkan. Kuptohet zyrtarët italianë nuk janë të vetmit që i përziejnë sulmuesit me të sulmuarit, pa kurrfarë druajtje që mos t' u plasë cipa. Në paaftësinë e perëndimit për ta paditur përgjegjësinë e Milosheviqit dhe për ta nxjerrë atë në gjyq në Hagë qëndron një paturpësi e vagullt. Kjo paturpësi mbretëron qyshkur u arrit marrëveshja e Dejtonit, e cilat ndërpreu etnocidin në Bosnjë, ndërsa u injorua vullnetarisht zjarri i cili është zanafilla e të këqijave dhjetëvjeçare ballkanike: zjarri i Kosovës. Mu pas Dejtonit, independentistët myslimanë hoqën dorë nga strategjia pacifiste e Ibrahim Rugovës dhe u përcaktuan për ekstremizmin e armatosur. Qe një reagim ndaj harresës, ndaj shkujdesjes së politikanëve që flinin mbi dafinat e Dejtonit duke ndjekur strategjinë e përhershme, strategjinë e cila i privilegjon bisedimet me palën që parashtron më shumë të vdekur në tentativat, ndërsa i injoron sistematikisht forcat që luftojnë me rrugë demokratike pa derdhje gjaku. Si në Algjeri ashtu edhe në Kosovë, perëndimorët nuk e dinë sa bëjnë dy me dy: i njohin viktimat dhe kriminelët, por e injorojnë betejën e gjatë*

dhe paqësore të Ibrahim Rugovës si dhe tentimin e tij për të krijuar një shoqëri paralele që e bënte më pak rëndues aparteidin e imponuar nga serbët mbi 90 % të popullatës shqiptare. Udhëheqësit italianë s`janë të vetmit që kishin shpërfillur nisma para dhe pas Dejtonit. Mirëpo, me siguri janë nga ata më serbofilët. Ishin filoserbë qysh prej 1990-91; pikërisht ministri i punëve të jashtme De Michelis (Mikelis), ishte ai që i mbronte gjerë e gjatë serbët, duke u ankuar për opinionin dhe për shtypin. Bombat po binin mbi Vukovar, serbët po planifikonin shfarosjen në Bosnjë, kur De Mikelis i akuzonte “mjetet e informimit që kishin trilluar një luftë të paqenë në Ballkan”. Në diplomacinë italiane nuk pati ndonjë rishqyrtim sikur pati në Francë, kur Shiraku (Chirac) e zëvendësoi Miteranin (Miterrand) ose në Angli kur Bleri (Blair) dhe Kuku (Cook) zunë vendin e konservatorëve. Për udhëheqësit italianë nuk është ndryshuar gjë, atje, përtej Adriatikut. As sot e kësaj dite De Mikelis nuk luan vendit pa u përputhur përpara me rusët që janë aleatët e Beogradit në këtë rajon. Sipas gjasave interesat ekonomike janë tepër të forta; naftësjellësi ENI, i cili duhet që prej detit Kaspik të dalë deri në Trieste, kalon nëpër Serbi; investimet italiane në Republikën e Milosheviqit janë të shumta. Me gjasë, gjërat që harrohen, varrosen vullnetarisht.

Diplomatët, politikanët dhe disa anëtarë të Grupit të Kontaktit duket se e kanë harruar memorandumën e Akademisë së Shkencave të Beogradit, punë mjaft e volitshme për panserbizmin e kohës prej 1986 e këndeje. Duket se i kanë harruar udhëtimet e shpeshita të njerëzve të Milosheviqit në Rusi mes viteve 1987-1990, si dhe strategjitë e përbashkëta të diskutuara në Moskë sidomos me puçistët antigorbaçovianë për t`iu kundërvënë “islamizimit” të botës sllave dhe për ta organizuar mbrojtjen e krishtëritimit ortodoks nga shtrirja demografike myslimane. Bosnja, Çeçenia dhe Kosova janë ndër amanetet e tyre, më tepër sesa pretendojnë qeveritarët italianë dhe evropianë. Vigjilenca është e vogël, mbase për shkak se nuk janë luftëra tradicionale, janë luftëra kundër civilëve që serbët i preferojnë në vend të ndeshjeve mes të armatosurve; 90 përqind e viktimave në Kosovë janë të pambrojtur. Përndryshe kjo është arsyeja pse në Bosnjë është folur për etnocid. Duhej të thyeshin shpirtrat, duhej të dhunoheshin femrat, duhej të shkatërroheshin xhamitë sepse serbët mund të pushtonin rajone të tëra të braktisura nga popullata e lemerisur. Në Kosovë, serbët tentojnë të marrin rrugë të ndryshme duke shpresuar se do të arrijnë ndarjen e Kosovës dhe se do të marrin për vete zonat simbolikisht dhe ekonomikisht më të dobishme.

Shumë nga vendimmarrësit italianë dhe grekë janë të bindur se lufta në Ballkan nuk do të kishte ngjarë nëse Gjermania dhe Vatikani nuk do të kishin kërkuar njohjen e Kroacisë dhe Bosnjës në prill të vitit 1992. Mirëpo edhe këtu e fshehin të vërtetën si dhe ekzistimin e mëparshëm të planeve serbe për pastrim etnik. Qysh para asaj date, Vukovari ishte bërë shkrumb e hi dhe bombardohej Dubrovniku. Qysh para asaj date ekzistonte dhe funksiononte kampi i përqendrimit i Omarskës, në të cilin myslimanët torturoheshin ose vriteshin. Prandaj

në polemikën kundër mendimit ka diç të pamoralshme. Do të ishte shumë me vend nëse diplomatët dhe politikanët do të shpjegonin pse e kanë aq të vështirë të tregojnë se ku e kanë shtëpinë e vet ata që pothuaj vetë e mbajnë të ndezur flakën e Ballkanit. Anëtarë i Rusisë dihet qartë se mbron pansllavizmin dhe nuk i intereson asgjë tjetër dhe çdo tentim i tyre në këtë drejtim duhet të merret si diçka egoiste e jo serioze. Grupi i gazetarëve që i vizitoi vendet e ngjarjeve (i organizuar nga autori i këtij shkrimi) ia bëri me dije publikut qartë situatën reale. Duhet të bëhet presion i vazhdueshëm në Rusi që ajo t'i kthehet realitetit dhe të flasë e të veprojë për të drejtën, duke i lënë pas dore profitet prej shitjes së armëve apo rikthimin e borxheve serbe. Të flasë me dinjitet dhe të aplikojë rregullat e të së drejtës së humanitetit. Çdo tentativë greke (në Komunitetin Europian) të merret si përkrahje e agresionit serb në trojet e Kosovës.

a) Kosova nuk është Bosnjë, e cila u përket edhe serbëve. Kosova ka qenë (si në Mesjetë, si në kohërat moderne) dhe do të jetë (në çdo rregullim administrativ që ndoshta i imponohet) e kosovarëve (e të gjithëve, të cilët tani aty jetojnë, duke i përjashtuar depërtuesit me dhunë nga regjimi i Milosheviqit, prej viseve të tjera të ish-Jugosllavisë për në Kosovë), d. m. th. në radhë të parë e shqiptarëve dhe e të tjerëve.

b) UÇK-së nuk mund t'i jepet karakteri "terroriste" si dëgjohet shpesh në Beograd dhe në masmediat evropiane. Ajo mbrohet prej terrorit serb dhe në asnjë moment nuk kemi dëgjuar që ajo bëri masakra, në fëmijë, gra, pleq dhe qytetarë. Ajo mbron dëshirën e kosovarëve dhe idealet e tyre për pavarësi.

c) Të instruktohet Ministri i juaj (që merr pjesë në Grupin e Kontaktit për Kosovën në periudhën kalimtare) që Kosovës t'i ofrohet ajo çka dëshirojnë kosovarët nën një formë protektorati (brenda kufijve të sotëm)

ç) T'i sigurohet Kosovës protektorat e ruajtja e vendit nga fuqitë (si NATO) në mënyrë që të mos mbërrijë deri te katastrofa njerëzore mbasi që ushtrisë dhe policisë së Milosheviqit i mungon vetëm gjakderdhja masive. Kjo duhet të ndodhë menjëherë!

d) Në periudhën kalimtare të bisedohet (paqësisht) me serbët për ardhmërinë definitive të Kosovës.

Realizimi i pikave të lartpërmendura është obligim juaji moral, sepse frikësohem që edhe ju do të jeni përgjegjës për tragjedinë e popullit tim të Kosovës.

\* Behgjet Pacolli, njohës i situatës reale në Kosovë dhe Ballkan.

Por le të kthehemi tek angazhimi im tërësor për Kosovën në atë

periudhë. Përpara se t'i jap përgjigje më të plotë çështjes së ndikimit të Rusisë tek unë, vendit ku punoja më shumë asokohe, duhet të qartësoj tri çështje të tjera.

*E para*, duhet ditur se pavarësia e Kosovës, veçmas para bombardimeve të NATO-s, nuk ka qenë opcion publik në tavolinat ndërkombëtare të bisedimeve. Pavarësisht se në Kosovë njerëz që, si dje ashtu edhe sot, thurin konspiracione dhe teori nga më fantastiket, synim kryesor i të gjithë faktorëve relevantë ndërkombëtarë ka qenë një zgjidhje kompromisi, e cila do ta evitonte gjakderdhjen dhe Kosovës t'i jepte një autonomi të gjerë, diçka të ngjashme me atë të vitit 1974. Të paktën për tre vjet, kjo ishte zgjidhja e propozuar në takimin e Rambujesë. Këtë nuk e them unë, por e thekson ish-sekretarja amerikane e shtetit Medlin Ollbrajt në librin e saj *Zonja Sekretare*. E pohon me forcë dhe ish Presidenti amerikan Bill Clinton. Siç e thashë dhe pak më parë, kam dashur modestisht atëherë dhe sot që t'i ballafaqoj gjykimet e mia për atë periudhë me qëndrimet e administratës së vendit që na shpëtoi, SHBA-ve, duke iu referuar materialeve që botoheshin atëherë dhe tani. Nga rishqyrtimi që u kam bërë pikëpamjeve të disa prej protagonistëve të politikës ndërkombëtare, veçanërisht asaj amerikane, më vjen mirë që gjykimet dhe qëndrimet e mia të asaj kohe, intuitivisht pajtoheshin me ta. Kështu, për shembull, në lidhje me zgjidhjen e përkohshme për Kosovën rezultoi se, parimisht, këtë zgjidhje e mbështeste edhe Rusia, e cila ishte pjesë e marrëveshjes së Rambujesë. Ollbrajt përsëriti vazhdimisht se në atë periudhë ne nuk donim pavarësinë, madje kërkonim të rivendosej autonomia, ndërsa Klintoni thotë se “SHBA dhe NATO donin që Kosova të kishte autonominë politike që kishte pasur sipas kushtetutës jugosllave nga viti 1974 deri në vitin 1989 derisa ja hoqi Milosheviqi”. Megjithatë, për negociatat në Rambuje Ollbrajt thotë se “ne nuk donim që ata, kosovarët, ta braktisnin ëndrrën e tyre”, por, hëpërhë “autonomia e garantuar nga një prani ndërkombëtare me NATO-n në krye ishte zgjidhja që siguronte konsensusin më të madh, përfshirë edhe rusët”.

Ishte hera e parë, pas një kohe shumë të gjatë, që Moskë zyrtare harmonizonte qëndrimet me bashkësinë ndërkombëtare, respektivisht me faktorët relevantë vendimmarrës, siç mund të

vërtetohet nga leximi i veprës së njërës prej protagonistëve kryesore të luftës së Kosovës, Medlin Ollbrajt. Zonja Ollbrajt kujton se me përjashtime të vogla, çdo hap i hedhur prej SHBA-ve, gëzonte edhe mbështetjen ruse. Detaji më interesant që jep ajo nga përpjekjet për ta pasur Rusinë në krah, në rastin e Kosovës, është ai i bisedimeve të saj pranë një shisheje shampanje me haviar, me ministrin Ivanov, gjatë pushimeve të një shfaqjeje në teatrin Balshoj. Në fund të bisedës Ivanovi pranon opcionin amerikan për kërcënimin e Milosheviqit edhe me anë të forcës, duke thënë se, fundja, zgjidhja politike mund të arrihet vetëm në këtë mënyrë. Poshtë një fotoje me Ivanovin, me të cilin kanë shkëmbyer kapele si dhuratë, zonja Ollbrajt thotë se “nëse nisemi nga dhuratat që i bënim njëri-tjetrit, atëherë duhet thënë se ishim ekip fantastik”. Bashkëpunimi i Ruisë me Perëndimin ishte arsyeja që, ky shtet i madh, fuqi bërthamore, mori pjesë në të gjitha fazat politike të këtij procesi. Rusia shpesh mori edhe rolin e ndërmjetësuesit (për shkaqe historike) ndërmjet Serbisë dhe Perëndimit, diçka që jo rrallë e bëri për shembull edhe Italia, ambasada e së cilës mbeti e hapur në Beograd edhe në kohën e bombardimeve.

Por ishte iluzionare të besohej se Rusia do të shkonte më larg se kaq, jo thjesht për shkak të lidhjeve historike a emocionale me Serbinë, por për shkak të interesave të veta jetike, sepse ajo ka shumë “cepa” si Kosova, që do të donin ta shfrytëzonin këtë rrethanë për shkëputje ose ndarje. Por edhe për arsye që lidhen me të kaluarën, apo edhe me të ardhmen e saj. Rusia frikësohej nga shkëputja eventuale e republikave të saj myslimane, Tatarstanit, Bashkortostanit, Çeçenisë, Ingushetisë, Ballkarisë etj. Në ato vite, në këto republika kishin filluar lëvizje me karakter seperatist, madje ato po krijonin një strukturë institucionale tipike të një shteti të pavarur, duke filluar që nga Presidenti, te ministria e jashtme etj.

Pra, politika zyrtare e Ruisë në këtë pikë ishte krejtësisht e qartë dhe nuk mund të gjendeshin njerëz nga establishmenti politik dhe qeverisës në Moskë që mund të pretendonin se bënë ndonjë ndryshim substancial në këtë plan. Megjithatë, qoftë te ne, qoftë në kuloaret e diplomacisë botërore janë mbivlerësuar dhe akoma vazhdojnë të mbivlerësohen lidhjet historike të Moskës me

Beogradin si përcaktuesi kryesor i qëndrimit të saj në lidhje me planin perëndimor. Qëndrimi i saj realisht përcaktohej atëherë dhe sot, nga një tërësi faktorësh, herë-herë edhe kundërthënës. Thjesht, Rusia duhej të mbronte (dhe vazhdon të mbrojë) qëndrimin e saj kundër pavarësisë së Kosovës, jo për interesa të Serbisë, por për shkak të interesave të veta. Në kohën e krizës së Kosovës, ajo e formuloi qartë këtë qëndrim të cilën vazhdon ta mbrojë edhe sot e kësaj dite. Prandaj, çdo përpjekje për ta tërhequr Rusinë në çështjen e Kosovës, nuk mund të supozonte në asnjë mënyrë ndryshimin e këtij qëndrimi. Së paku jo deklarativisht. Ndërkohë me shpalljen e pavarësisë së dy republikëve proruse, edhe ky qëndrim ka ndryshuar, dëshmi se politika nuk është e ngurtë dhe diçka e pandryshueshme dhe vlerësimet për Rusinë dhe politikanët e saj, nuk janë të përvetshme. Në Rusi po e kuptojnë që Kosova nuk paraqet një precedent me anë të të cilit SHBA-të do të imponojnë ndryshime në periferinë e Perandorisë ruse, ish-Bashkimit Sovjetik. Megjithatë, vetë rusët, në një farë mënyre, siç e treguan ndryshimet që ndodhën në Kaukaz, u përpoqën ta shfrytëzojnë për vete këtë lloj precedenti, për të legjitimuar ndarjen e këtyre dy republikëve, ndarje që në fakt ka një bazë historike. Ato zona i janë aneksuar Gjeorgjisë në kohën e Stalinit. Banorët e tyre kanë urrejtje të madhe për gjeorgjianët. Mendohet madje se rusët do ta përdorin edhe vendimin e GJND-së për Kosovën në favor të tyre.

*E dyta*, në kohën kur zhvillimet në Kosovë morën përmasa dramatike, situata politike brenda vetë Rusisë ishte jashtëzakonisht konfuze, me zhvillime të paparashikueshme për shkak të shumëllojshmërisë së aktorëve në lojë që prodhonin interesa, dhe për pasojë, edhe pozicione diemtralisht të kundërta. Në një anë, pozitat e Jelcinit ishin dobësuar dukshëm, ndërkohë që në anën e opozitës ishin rreshtuar forca nga më të ndryshmet, duke filluar nga nacionalistët, komunistët dhe neostalinistët, e deri te oligarkët e mëdhenj, të cilët, duke përfitur nga situata, përmes privatizimeve spekulative, plaçkitjeve të pasurisë shtetërore dhe formave të ndryshme të krimit të organizuar, kishin formuar klane të fuqishme, me ndikim të madh në kreun politik të vendit. Pastaj, aty ishte ushtria e pakënaqur me pozitën e saj brenda shtetit rus, me privilegjet e

humbura dhe me fuqinë e dobësuar, njësoj si edhe me pozitën dhe prestigjin e Rusisë në skenën ndërkombëtare. Po ashtu edhe policia dhe KGB-ja, njësoj të pakënaqura me gjendjen aktuale. Të gjithë së bashku, ose veç e veç, mund të rebeloheshin dhe një ditë të mos i bindeshin as qeverisë, as Presidentit. Pa harruar as grupet sociale, që kishin mbetur në rrugë, pa asnjë mbështetje nga shteti.

Fundja, këtu më nuk bëhej fjalë për ikjen ose mbetjen e Jelcinit. Më e rëndësishme ishte rruga që do të merrte Rusia. Si fuqi bërthamore, ajo duhet të ruhej me kujdes nga turbulencat e papritura. Prandaj, në rastin e Kosovës, Perëndimi zgjodhi taktikën e sjelljes së kujdesshme ndaj Rusisë, duke u përpjekur që trysnia të mos shkonte në drejtim të dobësimit të mëtejshëm të pozitave të Jelcinit dhe të mbështetësve të tij në Kremlin. Përkundrazi, SHBA-të, siç dëshmon Klintoni në librin e tij *Jeta ime*, investuan për forcimin e pozitave të tij. Klintoni flet edhe për dilemat e asokohshme për ta ndihmuar Rusinë politikisht e financiarisht në mënyrë që Jelcini të fitonte mbi neokomunistët, megjithëse, sipas sondazheve shumica e amerikanëve ishin kundër mbështetjes financiare të Rusisë. “Amerika kishte harxhuar trilionë dollarë për të fituar Luftën e ftohtë,- thotë Klinton, dhe ne nuk mund të rrezikonim një përmbysje të situatës për dy miliardë dollarë dhe një sondazh negativ”.

Megjithëkëtë, Jelcini u detyrua për shkak të trysnisë së vazhdueshme të Dumas, ta lironte nga detyra e kryeministrit Çernomirdinin, njeriun më të besuar dhe mbështetësin kryesor të tij (kinse, për shkak të ngadalësisë së reformave) dhe në vend të tij të emëronte kryeministër Primakovin, një neokomunist i përbetuar dhe lojtar i rrezikshëm i prapaskenave politike.

Duke mbetur tek Kosova, nuk ishte e rastësishme që Jelcini caktoi Çernomirdinin si ndërmjetës për Kosovën, siç e konfirmon dhe zonja Ollbrajt. Ishte vetë Jelcini, pohon ajo, që i telefonoi Presidentit Klinton ditën e fundit të takimit të NATO-s në Uashington në prill 1999, duke i kërkuar atij që ish kryeministri Çernomirdin të punonte bashkë me nënpresidentin Al Gore për një zgjidhje për Kosovën. Duke folur me Presidentin e një vendi që mori pjesë në takimin e zgjeruar të vendeve partnere të NATO-s, me rastin e 50 vjetorit të themelimit në 24 prill 1999, m'u kujtua një diskutim mjaft interesant

i Presidentit Klinton me kryeministrin italian D'Alema. Ky i fundit gjendej nën presionin e fortë të komunistëve proserbë, që ishin kundër bombardimeve dhe rolit italian në to, presion që madje e detyroi të dorëhiqej. Italia, ndërkaq, njihej si një vend që kishte luhajatet e veta midis Perëndimit dhe Rusisë. Kur Presidenti amerikan Klinton propozoi një sërë masash për ta detyruar Milosheviqin të kapitullonte, D'Alema e ndërpreu dhe tha se paraprakisht duhej folur me Rusinë për këto hapa. Presidenti Klinton nuk replikoi në mënyrë tradicionale, por i tha D'Alemës dhe të ftuarve në samit se e kishte filluar ditën e tij të punës, para se të vinte në takim, me një bisedë të gjatë telefonike me Jelcinin. Ishte një bisedë shumë konstruktive, - i tha Klintoni D'Alemës,- dhe u morëm vesh për të gjitha!

Megjithatë, në atë periudhë, krahas Jelcinit, edhe Primakovi arrinte të tërhiqte shumë fije nga prapaskena. Lidhur më këtë, më kujtohet rasti kur Çernomirdini arriti ta bindte Milosheviqin për t'i pranuar kushtet e Perëndimit dhe të NATO-s dhe, me ta kryer këtë mision, u nis për në Bon, për të njoftuar Shrëderin dhe anëtarët e tjerë të Grupit të Kontaktit. Në restorantin në katin e fundit të hotelit tim *Swiss Diamond Lugano*, Çernomirdini më tregonte detaje nga biseda e tij me Milosheviqin në Beograd, nga ku sapo ishte kthyer. "Ishim në këmbë,- tha ish kryeministri rus- dhe unë mbaja në dorë tekstin e marrëveshjes. Firmose,- i thashë, -përndryshe do të bëhesh rrafsh me tokën,- dhe ndërsa ngula gishtin mbi fletët e letrës ato ranë në dysheme, si për t'i treguar atij kuptimin real të rënies. Sytë e të dyve u drejtuan atje ku përfunduan fletët e letrës, që, nën presionin e gishtit tim pasionant, kishin rënë përdhe." Por çfarë ndodhi në të vërtetë? Me ta kuptuar dikush në Moskë se Milosheviqi kishte lëshuar pe, i kërkoi që ta kthejë mbrapsht vendimin. Natyrisht, Milosheviqi e bëri këtë dhe Çernomirdini në Bon u habit me gazetarët që e pyesnin për dështimin e misionit të tij në Beograd, sepse Milosheviqi i kishte ngrënë fjalët.

Situata të këtilla ka pasur shumë. Megjithatë, ishte pikërisht Jelcini ai që arriti ta ruante njëfarë drejtpeshimi, shpesh duke ecur nëpër tehtë të shpatës. Mjafton të kujtojmë disa zhvillime të ashtuquajtura suplementare, të cilat mund të kenë rëndësi vendimtare për Kosovën. Rusia fillimisht kërkoi të ketë zonën e saj



në Kosovë, pastaj u tërhoq nga ky pozicion nën presionin e fortë amerikan. Kontigjentet e trupave ruse u nisën nga Bosnja, kaluan nëpër Serbi dhe arritën të parat në aeroportin e Prishtinës, diçka që krijoi tension të madh, të ngjashëm me situatat e luftës së ftohtë. Vendimi për tërheqjen e tyre nga Aeroporti i Prishtinës, pavarësisht se mund të jetë bërë për arsye të tjera strategjike, duhet të jetë marrë në nivele të larta, por gjithsesi me miratimin e Jelcinit dhe të grupit të tij, i cili, edhe përkundër të gjitha vështirësive, arriti të ruante jo vetëm pozicionin e tij prej urdhërdhënësi që kontrollon situatën, por edhe njëfarë drejtpeshimi në raportet ndërkombëtare. Klintoni e tregon bukur këtë detaj, i cili mund të kishte bërë shkas për luftën e tretë botërore, dhe që Jelcini e improvizoi si një kockë të përkohshme për t'ua hedhur neokomunistëve dhe komunistëve të vjetër.

Fundja, po të mos ishte Jelcini në Kremlin, rezoluta e Këshillit të Sigurimit për ndërhyrjen e NATO-s në Kosovë, në formën e KFOR-it që kemi sot, do të ishte sigurisht shumë më vështirë të miratohej. Madje roli i tij ishte veçanërisht i rëndësishëm në përmbajtjen e rezolutës së këtij Këshilli, pas përfundimit të suksesshëm të fushatës së bombardimeve. Kjo rezolutë u miratua vetëm pas punës së madhe negociatore të dyshes Ahtisari-Çernomirdin, që e bëri Milosheviqin të kuptonte përfundimisht se Rusia ishte me NATO-n dhe se ai nuk mund të luante a të shpresonte më në një ndarje të tyre. Rezoluta 1244, e miratuar dhe me mbështetjen ruse, si zgjidhje e përkohshme për Kosovën, praktikisht legjitimoi situatën në terren, pra legjitimoi bombardimin e NATO-s, diçka unike në historinë e njerëzimit pas Luftës së Dytë Botërore. Edhe sot, ky precedent i bombardimit të një vendi sovran nga një organizatë ndërkombëtare e sigurisht po diskutohet me të madhe. Ky precedent ka ndryshuar rrënjësisht të drejtën ndërkombëtare. Sigurisht këtu kishte rol Jelcini, megjithëse nuk është reale të prisim që Presidenti rus të duartrokiste gjithçka kërkonte Perëndimi. Madje ai i është kundërvënë bukur shpesh Perëndimit. Vetëm në këtë mënyrë, pra duke u luhatur sa pro Perëndimit, edhe kundër tij, Jelcini, nën këshillat e një grupi pranë vetes, ka mundur të amortizojë në shkallë të mjaftueshme trysinë e madhe të opinionit publik, të medias, të politikanëve, të deputetëve, të aparatçikëve të të gjitha niveleve, të cilët, përmes demonstratave

ose formave të tjera të manifestimit, kërkonin me ngulm që Rusia të mos ishte kaq e butë dhe të mos lëshonte pe karshi NATO-s, sepse kështu nëpërkëmbej dinjiteti i saj, vihej në dyshim forca e saj. Nacionalistët rusë e shihnin madje çështjen e Kosovës si një rast të përshtatshëm për të kthyer në vend namin e humbur të superfuqisë së dikurshme. Nacionalistët e tipit të Zhirinovskit apo neokomunistët si Zjuganovi, e shihnin këtë si një rast të mirë për të kthyer sistemin e vjetër të lavdishëm në Rusi. Por Rusia, thotë Klinton, në mënyrë gati proverbiale, duhet ta tregonte madhësinë e saj lidhur me të ardhmen e jo me të shkuarën.

Mbi të gjitha, me këtë situatë të ndërlikuar të brendshme dhe të jashtme, lufta e brendshme politike gjente terren të përshtatshëm për veprime në skenë dhe në prapaskenë. Aq më tepër, kur Jelcinin shëndetlig dhe politikisht të drobitur, e prisnin zgjedhjet. Humbja e tij në ato zgjedhje do të ishte fatkeqësi për Rusinë dhe tronditje shkundulluese për mbarë botën, veçmas për botën demokratike.

*E treta*, afera “Russiagate”, mes synimeve të tjera, ishte përgatitur pikërisht për të dobësuar pozicionin e Boris Jelcinit në Kremlin. *Mabetex*-i ishte pretekst, unë gjithashtu. Edhe Kosova po për këtë qëllim ishte shfrytëzuar. Në një rrethanë të këtyllë të disfavorshme, kur krejt aparati i pushtetit qendror ishte përfshirë në vorbullën e luftës për pushtet, ishte shumë e vështirë të depërtoje në qarqet vendimmarrëse. Aq më pak në Ministrinë e Jashtme, e cila ende ruante brenda vetes struktura shumë konservatore të periudhës së shkuar. Ato mundoheshin të deformonin sadopak qëndrimet që formuloheshin në nivelin më të lartë.

Megjithëse kisha njohuri për situatën e krijuar brenda dhe jashtë Moskës, unë nuk mund të rrija i qetë dhe të shikoja me indiferencë atë që ndodhte në Kosovë. Fundja, diçka duhej të bëja, së paku të provoja gjetjen e një zgjidhjeje. As i nënçmoja, as i mbiçmoja mundësitë e mia. Thjesht, duhej të bëja atë që mundesha, duke u përpjekur të mos hyja atje prej nga nuk do të mund të dilja. Dhe më në fund t'i rikthehesha biznesit.

Siç mund ta dinë njohësit e historisë së diplomacisë, Jelcini kishte antipati për Milosheviqin. Ai thirri në Moskë Izetbegoviqin, Tugjmanin, bisedoi me ta dhe kur i erdhi radha Milosheviqit, refuzoi

ta takonte. Siç do të shihet më vonë, edhe fotot e masakrës së Prekazit, që ia solla Presidentit Jelcin, ndikuan tek ai që të bindej se Milosheviqi po abuzonte me Rusinë duke kryer krime të tmerrshme në terren. Çështja e Kosovës ndërkohë krijonte tension të madh në Kremlin midis Jelcinit dhe forcave konservatore, të cilat i bënin presion të vazhdueshëm që ai të mbështeste pa kushte Serbinë, andaj edhe të takohej me Milosheviqin. I vetmi takim që patën ata në Moskë, me ndërmjetësimin dhe insistimin e këtyre grupeve, më 15 qershor 1998, zgjati shkurt dhe solli, paradoksalisht, si rezultat diçka të favorshme për Kosovën. Milosheviqi nën presionin rus, nëpërmjet një deklarate të përbashkët, pranoi për herë të parë në Kosovë një mision vëzhguesish diplomatikë ndërkombëtarë, mision që ai e refuzonte me forcë deri më atëherë. Milosheviqi mbronte idenë se Kosova ishte çështje e brendshme e Serbisë, ndaj s'kishte arsye për angazhim ndërkombëtar. Ky pozicion i tij mbrohej madje dhe prej ministrit të jashtëm italian, Dini, i cili e krahasonte vendosjen e misionit të vëzhguesve diplomatikë në Kosovë, me vendosjen e vëzhguesve në Lombardi. Pikërisht si reagim ndaj këtij qëndrimi të pakuptueshëm italian, në vjeshtën e vitit 1998, në gazetën *Bota sot*, botova letrën e përmendur më lart drejtuar kryetarëve të shteteve të vendeve të Grupit të Kontaktit. Milosheviqi nga këndi i tij ndoshta për veten kishte të drejtë - prania ndërkombëtare në Kosovë paraqiste një dëshmitar të padëshirueshëm për krimet e ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë. Realisht vetëm me vendosjen e misionit të kryesuar prej Uiliam Uokerit (William Walker), bota e qytetëruar pati mundësi të dokumentonte krimet e tmerrshme që po kryheshin në Kosovë.

Versioni që ekzistonte në atë kohë për mostakimin mes Jelcinit dhe Milosheviqit ishte një dosje që autoritetet ruse kishin kundër këtij të fundit, sipas të cilës Milosheviqi kishte marrë një shumë të madhe parash (qindra milionë dollarë) nga një kompani naftë ruse, ndonëse jo drejtpërdrejt, por nëpërmjet Qipros, në llogari të një të afërmi të tij. Kjo kompani më parë kishte qenë shtetërore dhe ishte kthyer në shoqëri aksionare. Nuk e di nëse kjo shifër ishte plotësisht e saktë apo jo, pasi në këtë pagesë ishin të përfshirë edhe ndërmjetësit të cilët kishin përfituar një shumë të konsiderueshme.

Por le të kthehemi tani te roli im. Unë isha njeri i biznesit, nuk isha njeri i politikës. Prandaj, të gjitha veprimet e mia të asaj kohe silleshin në këtë kuadër: për Kosovën duhej gjetur një zgjidhje dhe, sa më shpejt që të ishte e mundur, të ndaleshin vuajtjet dhe pësimet e njerëzve tanë. Ky ishte shqetësim edhe i miqve tanë perëndimorë - *të mos përsëritej Bosnja në Kosovë*- siç thotë zonja Ollbrajt, Presidenti Klinton, si dhe miku tjetër i Kosovës, Toni Bler gjatë vizitës së tij të fundit në Kosovë më 2010. Këta njerëz me atë që bënë, i dhanë kahje zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Nga ana tjetër, edhe një gjë duhet pasur parasysh: unë në asnjë rrethanë nuk i dhashë të drejtë vetes që të thosha - kjo duhet bërë kështu dhe assesi ndryshe. Vendimet politike nuk ishin çështje imja. Ato i merrnin njerëz të tjerë. Puna ime ishte vetëm të ndihmoja, nëse për këtë kishte ndonjë mundësi. Së këndejmi, ecejaket e mia nëpër Moskë, veçanërisht në mars të vitit 1998, nuk kishin të ndalur. Kaloja orë të tëra nëpër korridoret e Ministrisë së Jashtme, nga një zyrë në tjetrën, duke u përpjekur të lëvizja ndonjë gur, të bëja ndonjë veprim që do të kishte sadopak efekt pozitive në zbutjen e tragjedisë së Kosovës. Nuk bëhej fjalë për zgjidhje politike, bëhej fjalë për ndaljen e gjakderdhjes, të reprezaljeve, të vuajtjeve të njerëzve. Isha shumë i tronditur, por njëkohësisht edhe i frustruar, sepse nuk po arrija të bëja ndonjë veprim, i cili do t'u jepte ngjarjeve një kahje të mbarë, që njerëzit në Kosovë të mos vuanin dhe të mos i priste një e keqe edhe më e madhe. Largësia prej mijëra kilometrash nga Kosova nuk ma zvogëlonte brengën dhe dëshpërimin. Përkundrazi. Ndihesha i lënduar moralisht dhe shpirtërisht që nuk po arrija të bëja gjë.

Në një gjendje të këtillë më gjeti edhe dita e 6 marsit të vitit 1998, dita e masakrës së Prekazit, kur familja martire e Jasharëve u zhduk thajse e tëra, nën predhat e tankeve serbe. Një zv/ministër i punëve të jashtme (unë renovoja në atë kohë ministrinë e punëve të jashtme, andaj drejtori i *Mabetex*-it në Rusi më organizonte takime me ministrin ose zëvendësministrat) më thërret në zyrë dhe shumë i hidhëruar më thotë se ka ndodhur një masakër e madhe dhe nuk mund të rrinim duarkryq as unë, as ai. Ai i takonte kontingjentit të Ministrisë së Jashtme, që nuk shquhej për qëndrim konservator dhe as për qëndrim antishqiptar. Ai thoshte se e ndiente tragjedinë

e kosovarëve. Ndërsa fliste më nxori disa foto të llahtarshme të ngjarjeve që kishin ndodhur, të cilat i kishte marrë nga një agjenci lajmesh në internet. Emocionet më pushtuan të tërin. Ato pamje do të më mbeten në kujtesë për tërë jetën. Tmerri që tregohej në ato foto, i kalonte përmasat e çdo imagjinate. Mezi i kalova të gjitha nëpër duart që më dridheshin. Në këtë e sipër, personit që kisha përpara i them:

- Si të bëjmë që ta ndalim këtë dorë gjakatare dhe kriminale?

Ai më shikoi me vëmendje dhe nuk reagoi aty për aty. Pastaj shtoi se ajo që po bënin serbët kundër shqiptarëve ishte një masakër e madhe dhe duhet t'ia prezentojmë që të gjitha Presidentit. Zëvendësministri kërkoi nga unë që të mos i tregoja se kush m'i kishte dhënë fotot. I mora në dorë sërish dhe i ripashë për herë të dytë dhe më besoni se në ato momente kam ndjerë angushti në shpirtin tim.

Isha i gatshëm të bëja çdo gjë që ishte në fuqitë e mia, vetëm e vetëm që pamjet e masakrës së Prekazit të mos përsëriteshin më. Siç e thashë më sipër, Presidenti Jelcin dhe institucioni që përfaqësonte ai, presidenca ruse, nuk ushqenin simpati ndaj Millosheviqit, pavarësisht nga fakti i kundërvënjes së iniciativave të SHBA-ve. Në këto qëndrime Rusia nuk ishte vetëm. Në pozita pak a shumë të njëjta apo të ngjashme ishin edhe disa shtete të tjera perëndimore si Italia apo Franca, që më pas u rreshtuan pro Kosovës. Kështu, për shembull, siç thotë zonja Ollbrajt, në mbledhjen e grupit të Kontaktit me rastin e ngjarjes së Prekazit, përballë propozimit amerikan për një paketë qëndrimesh të tipit “kulaç dhe kërbaç”, ministri i jashtëm francez kërkoi shtyrjen e sanksioneve, dënimin e fortë të UÇK-së dhe të idesë së pavarësisë. Ndërsa ministri i jashtëm italian, Lamberto Dini, shprehu frikën se mos shpallja e sanksioneve do ta bënte më pak bashkëpunues Milosheviqin. Po i referohem sërish librit të zonjës Ollbrajt, të cilin e kam konsultuar shpesh, sikurse edhe atë të Presidentit Klinton për pozicionet rreth Kosovës. Historia ime është paralele me një pjesë të jetës së tyre, dhe, shakanë mënjanë, në këtë rast paralelet takohen. Kosova përfaqëson një segment të rëndësishëm të aktivitetit diplomatik të këtyre kolosëve të politikës botërore. Unë si kosovar u mundova të zgjidhja diçka

nën ombrellën e tyre.

Dhimbja që më shkaktuan ato foto nga Prekazi, u bë edhe më e madhe nga bisedat që pata me bashkatdhetarë të mi. Të nesërmen në mëngjes u takova me Jelcinin dhe ia tregova ato fotografi. Ai pati një reagim të ashpër në atë moment duke u shprehur se “Milosheviqi duhet kapur për dy këmbësh dhe duhet shqyer!”. Si rezultat i atij takimi Jelcini po atë ditë në të gjithë mediat televizive u shpreh se: “Milosheviqi është duke spekuluar me marrëdhëniet mes serbëve dhe rusëve dhe ai duhet të ndalet”. Dhe më pas më sugjeroi që të shkoja të bisedoja me Millosheviqin nën mbrojtjen e rusëve, por duke ia bërë me dije në një farë mënyre ekzistencën e dosjes për të cilën fola më sipër. Nisma kishte këtë skenar: unë duhet të shkoja në Beograd, të takohesha direkt me Milosheviqin, pastaj të takoja edhe politikanët e Kosovës, në mënyrë që bashkërisht të mund të ndalnim gjakderdhjen. Formën se si, do të duhej ta gjenin ata. Në fund të fundit bisedimet midis palëve, paqësimin e situatës, e donte dhe Perëndimi dhe unë e dija këtë, pra unë po bëja diçka që miqtë tanë perëndimorë do ta vlerësonin. Rusët ma rikonfirmuan se opcioni i bisedimeve ishte ide edhe e partnerëve perëndimorë. Kjo kërkesë pra, ulja në bisedime mund të frenonte sadopak shkallëzimin e dhunës mbi bashkatdhetarët e mi. Për mua çdo jetë e humbur në Kosovë do të thoshte shumë, sepse populli im ishte i vogël në numër dhe nuk mund t`ia lejonte vetes humbjen e asnjërit. Pra, unë duhej të merrja përsipër barrën e kësaj nisme, e cila kishte lindur në Moskë, por mund të kishte lindur kudo, në çdo kancelari perëndimore, dhe ndoshta edhe në konsultime me to. Se cilat zyra, në cilat nivele, ende nuk isha i sigurt. Por duket se ata që kishin ndërmarrë këtë iniciativë, ishin në dijeni se unë i njihja dhe i dija të fshehtat dhe të palarat e Milosheviqit. Madje, ata e dinin se unë e njihja mirë edhe mentalitetin serb.

Kjo duket pak si konspiracion, por e vërteta është se lëvizjet, siç u pa, ishin llogaritur deri në nivelet më të larta të shtetit rus, nga njerëzit më të afërt të Presidentit Jelcin, pjesë e krahut properëndimor të politikës ruse. Ndryshe, agjenda e udhëtimit tim në Beograd as që mund të merrej me mend. Pra, dera ishte hapur nga një dorë e fortë, e cila e bënte të bindej edhe Milosheviqin. Së paku, kjo ishte një

provë e cila mbase mund të prodhonte efekte pozitive.

Dhe, vendosa të nisesha për në Beograd pa ndonjë parapërgatitje, pa ndonjë strategji të përcaktuar personale dhe pa ndonjë plan të detajuar. Unë e dija se në përballjen me Milosheviqin, në dorë kisha një argument të fuqishëm: nisma buronte nga Rusia dhe ai nuk mund ta refuzonte këtë aq lehtë. Për më shumë unë kisha në dorë një zar që do ta kompleksonte Milosheviqin. Por, megjithatë, iniciativa kishte shumë të panjohura dhe për këtë isha thellësisht i vetëdijshëm. Sido që të ndodhte, nismën nuk mund ta refuzoja, sepse, sa herë hamendesha, përpara më dilnin pamjet e masakrës së Prekazit dhe të tjera si ajo, që mund të ndodhnin në ditët vijuese. Prandaj, vendosa. Nëse do të arrija të shpëtoja qoftë edhe një jetë njeriu, ia vlente të provoja. Nëse dështoja, gjë që e parashihja si mundësi më të afërt, së paku, deri-diku, mund ta kisha ndërgjegjen të pastër: kisha provuar të bëja diçka!

Po atë ditë, pasi u kryen telefonatat me Beogradin, më thanë të nisesha, sepse me Milosheviqin do të takohesha po atë ditë, në Dedinje. Përgatita ekipazhin e avionit tim dhe në orën 12.30 sipas kohës së Moskës fluturova drejt Beogradit. Ishte tetë marsi, dhe unë fluturoja mbi Beograd me pamjet e masakrës së Drenicës, vazhdimin e së cilës në krejt Kosovën isha i vendosur ta ndaloja me iniciativën time. Më dukej sikur u futa në një tunel, ku nuk shihej asnjë dritë, asnjë shenjë e daljes. Madje, nuk e dija nëse do kthehesha gjallë ose jo. Milosheviqi jo vetëm që ishte i paparashikueshëm, por ishte edhe i paskrupullt. Këtë tashmë e dinin të gjithë. Mund të eliminohesha nga shërbimet sekrete serbe, nga avionët e ushtrisë, nga mbrojtja kundërajrore, ose në ndonjë formë tjetër, me pretekste nga më të ndryshmet dhe me shpjegime nga më bizaret. Në atë kohë, ishte në fuqi embargoja e fluturimeve mbi hapësirën e Serbisë. E vetmja garanci imja ishte fakti që unë në Beograd shkoja me sugjerimin e rusëve, ndaj të cilëve Milosheviqi nuk mund të sillej me arrogancë dhe në mënyrë të papërgjegjshme. Por, ku i dihej?

Me avionin tim *Challenger* "N 600 BP" arrita në aeroportin e Beogradit. Pamja ishte shumë refuzuese. Përpara m'u shfaq të thuash një aeroport fantazmë, pa njerëz, me një zbrazëti pa fund dhe një peizazh të zymtë.

Ende pa zbritur nga avioni, pashë dy vetura të zeza, që lëviznin nëpër pistë dhe po i afroreshin avionit tim. E gjithë kjo situatës i jepte një tension dhe dramaticitet. Ndihesha i shqetësuar; dilema pa fund më sillleshin nëpër mend. Mbi të gjitha, nuk e dija si do të përfundonte krejt kjo. Shqetësimin më të madh ma sillte fakti që kisha marrë mbi vete një përgjegjësi, të cilën nuk e kisha të lehtë ta përballoja. Ishte një përgjegjësi e një lloji tjetër, nga ato që merrja zakonisht. Dhe ishte hera e parë që provoja veten në këtë lloj përgjegjësie.

Nga dy veturat e zeza, me xhama të mbuluar me perde, të cilat kishin dalë të më pritnin në aeroport, mu duk se njëra ishte diplomatike dhe njëra qeveritare. E hetova menjëherë se me këtë mënyrë të pritjes, me gjasë ata synonin të më impresiononin dhe t'i krijonin avantazhet e tyre ndaj meje.

Por ky fakt nuk më bëri shumë përshtypje, sepse unë isha mësuar tashmë me simbole dhe me skenografi të këtillë. Njihja Kremlinin, hyrje-daljet dhe pritjet e tij, që Milosheviqi vetëm mund t'i imitonte në mënyrën dhe formën e tij. Gjithashtu, mund të supozoj se njerëzit që ishin angazhuar në këtë pritje, ishin pjesëtarë të shërbimit sekret serb. Edhe kjo duhej të kishte një domethënie. Por, përsëri, në krahasim me hienat e KGB-së dukeshin vetëm një kopje e zbehtë e tyre.

Megjithatë, nuk mund të mos e vëreja atmosferën e rëndë, e cila ishte e pranishme që në ballafaqimin e parë: pista e madhe e zbrazët e aeroportit prej embargos, me një avion të vogël në një cep të saj, pastaj vetë godina e aeroportit e heshtur dhe e braktisur, veturat e zeza dhe, natyrisht, njerëzit e policisë që të presin dhe të urojnë mirëseardhje! Kjo atmosferë e rëndë, dijenia se çfarë kishte ndodhur në Kosovë, pastaj dijenia përse isha unë aty dhe çfarë mendonim për njëri-tjetrin, të gjitha këto së bashku e bënë të pashmangshëm refuzimin reciprok. Rruga që nga Aeroporti i Beogradit e deri në Dedinje m'u duk tepër e gjatë. Më dukej sikur isha futur në një labirint, nga i cili nuk e kisha as idenë si do të dilja. Edhe pamjet e heshtura dhe të përhimta të marsit, të cilat lëviznin me shpejtësi matanë xhamave të veturës, dukej sikur ishin aty për të krijuar idenë e një teprie lodhëse dhe të një ngushtësie shpirtërore, e cila do të më shoqëronte gjatë tërë asaj dite.

Së pari më shpunë në një ndërtesë tjetër, në zyrën e Shainoviqit,





**Aeroplani im - N600-BP - zyrë fluturuese. Këtu janë ulur shumë burra të rëndësishëm shteti, por dhe njerëz të thjeshtë. në të kaloj një pjesë të rëndësishme të jetës sime...**

shefit të shërbimit sekret serb dhe jo tek Milosheviqi. Pos një përshëndetjeje kurtuazie, me të nuk ndërruam asnjë fjalë, as bardhë, as zi, si thuhet. Qëndruam për një kohë në heshtje, duke pritur të na lajmëronin se mund të shkoja te Milosheviqi. Isha i bindur se edhe ky qëndrim në heshtje në zyrën e shefit të shërbimit sekret, gjithashtu ishte pjesë e skenarit, të cilin pala serbe e kishte përgatitur me kujdes. Ishte pjesë e presionit psikologjik. Besoja se situata të këtilla do të përjetoja edhe më.

Më në fund njoftuan se Milosheviqi ishte gati të më priste. Bashkë me Shainoviqin, me një makinë tjetër, shkua në Dedinje, në një ndërtesë që serbët e quanin Pallati i Bardhë. Sapo u futa në atë ndërtesë, m'u rikujtuan ditët e shërbimit ushtarak, kur bëja pjesë në rojat speciale të mareshalit Tito. Ishin po ato ambiente, që unë ende i ruaja në kujtesë, tani disi të varfëruara pa hijeshinë dhe pa "misterin" e dikurshëm. Më prinë në zyrën e Milosheviqit. Para se të hyja në zyrën kryesore të tij, duhej të kaloja nëpër një paradhomë në të cilin ishte i vendosur detektori i metalit. Unë u futa aty, duke kujtuar se pas meje vinte edhe Shainoviqi, por jo. Ai kishte mbetur

në paradhomën e parë. Pas kontrollit, u futa në zyrën e Milosheviqit. Kisha qenë edhe më parë në atë zyrë, gjatë kohës së shërbimit ushtarak. Kur u futa, mbeta i shtangur. M'u duk shumë e shëmtuar dhe depressive. U ula aty ku shefi i tij i protokollit më dha shenjë. Ky i fundit u largua menjëherë. Milosheviqi vetëm u ngrit në këmbë dhe ma dha dorën. Ishte hera e parë që e takoja këtë njeri. Gjatë ceremonive të ndryshme në Kremlin kisha parë dy herë të vëllanë e tij, por jo edhe Milosheviqin. Ai rrinte ulur në krye të tavolinës, që ishte edhe tavolina e punës së tij. Në mur, përballë vendit që më kishin rezervuar dhe ku më urdhëruan të ulesha, ishte një kornizë e madhe me portretin e tij. Në atë pikturë, Milosheviqi ishte paraqitur me këmishë të shpërthekuar, që nuk shkonte me tonalitetin e rrobave të tij të cilat kishin ngjyrë gri irrituese. Edhe kravata ishte e shkurtër dhe e shtrembër, siç i mbante vazhdimisht Milosheviqi. Biseda filloi mu te qartësimi i pikturës. Milosheviqi përsëri u ngrit në këmbë dhe shkoi pikërisht aty ku ishte vendosur ajo dhe filloi të flasë rreth përmbajtjes së saj duke u përpjekur të vendoste një lloj familjariteti me mua. “Është bërë nga një piktor i famshëm që unë e adhuroj”, tha Milosheviqi. “Shiko çfarë kompozicioni të ngjyrave ka”, vazhdoi. Kur e pa se nuk më interesonte shumë diskutimi rreth pikturës dhe u kthye prapë në vendin e vet. Dua të them se kam vizituar shumë burrështetas, por te askush nuk kam parë portretin e tyre të varur në muret e zyrave personale.

Por, le të kthehemi te çështja kryesore. Pasi u kthye në vendin e tij, që ishte shumë afër krahut tim të majtë, Milosheviqi, u fut drejt në temë pa e zgjatur. Filloi duke përmendur Kinkelin, atëherë ministër i jashtëm i Gjermanisë. E quante karikaturë të gjallë. Këtu më qeshej paksa, në krahasim me vlerësimin që i jepte më herët portretit të tij. Ç'ishte e vërteta, tani që gjendesha ballë për ballë me Milosheviqin dhe pas fillimit të bisedës nga ai në atë mënyrë, u ndjeva disi i çliruar nga presioni psikologjik. Te Milosheviqi nuk më impresiononte më asgjë, megjithëse isha vigjilent ndaj kthesave që mund t'i jepte bisedës ai. Ai ishte njeri me fuqi të jashtëzakonshme taktike, megjithëse, siç e tregoi koha, nuk shikonte shumë larg. Zgjidhte me shpejtësi situata të pafavorshme, por si shumë politikanë ballkanikë, ai luante mirë një lojë, apo disa, por jo gjithë

luftën. Ai ishte takticien, por jo vizionar strategjik. Sjellja e tij ndaj negociatave të Rambujesë, apo ndaj dokumentit që ia solli për firmë Çernomirdini është dëshmia më e mirë për këtë. Ai dinte të llogariste shumë mirë situata momentale dhe këtu e ndihmonte eksperiencia e tij prej bankieri, por jo të shkonte shumë larg me llogaritë e tij. Unë kisha takuar shumë burrështetas të vendeve të rëndësishme të botës dhe për shumicën syresh kisha krijuar përshtypjet e para në bazë të mënyrës si dukeshin, çfarë qëndrimi mbanin, si flitnin, ç'gjeste bënëin etj. Ai kishte kontroll të mirë të emocioneve, por kjo ndodhi deri kur... unë hapa letrën që duhej të hapja. Përgjithësisht ai ishte njeri kokëfortë, por kjo ishte shpesh aparente, sepse prapa saj fshihej një pragmatizëm ekstrem. Por që nuk shihte larg, pra në planin afatgjatë. Duke e shikuar para vetes, vrisja mendjen sesi ky njeri ishte bërë shkaktar i të gjitha atyre tragjediave, atyre luftërave dhe gjakderdhjeve pa fund. Edhe piktura që kisha përballë, kishte një simbolikë primitive, e cila nuk i shkonte as atmosferës, as ambientit, as idesë së bisedimeve, që mund të mbaheshin në një zyrë presidenti. Për më shumë ai kuadër paraqiste vetëm arrogancë dhe primitivizëm, me të cilin zakonisht bashkëjetojnë njerëzit narcisoidë, naivë, por edhe pak skizofrenë, por jo burrështetasit bashkëkohorë.

-Çfarë kërkonte ju, kosovarët?,- më tha troç Milosheviqi, sikur donte të më provokonte dhe të më qiste prej taktit. -Nëse nuk jeni të kënaqur, shkoni prej Kosovës! Një shprehje e tillë e thënë nga ideatori i masakrës së Drenicës më shtyu të hidhja në tavolinë asin që kisha.

Siç tregova, dikush në Moskë më tregoi hollësitrat mbi derdhjen e dhjetëra milionave nga një kompani e naftës, në vend të buxhetit të Serbisë në një konto bankare në Qipro, në emër të një zonje ruse, e cila ishte e afërt me Milosheviqin dhe pothuajse e pandarë në udhëtimet e Markos, djalit të tij, jashtë shtetit. Bile kisha edhe një dëshmi të një pagese me shifra shumë të mëdha. Duke biseduar ndërsa ai po bënte arrogantin në një moment, tërthorazi i bëra me dije që posedoja detajet e kësaj transferte. Në atë moment ai uli kokën, por sytë i mbante vazhdimisht kah unë. I ndryshoi ngjyra e fytyrës dhe i mori një pamje ngjyrë hiri. Ishte ulur në krye të tavolinës së gjatë që ishte edhe tavolina e tij e punës dhe e bisedimeve dhe unë isha shumë afër tij! Pa bërë asnjë koment u çua nga karrigia dhe u drejtua kah dera e

shërbimit në krahun e tij të djathtë, pothuajse pas shpinës së tij. Doli jashtë. Unë ktheva kokën ta shikoja sepse dera mbeti pak e hapur... Në të kthyer ai mbylli derën dhe u ul prapë në tavolinë me një kuti të bardhë cigaresh *Davidoff*. Nxori një cigare dhe me çakmakun e tij të thjeshtë me të cilin luante, provoi ta ndizte. Duke luajtur ai kishte lëshuar gazin dhe kur provoi ta ndizte, flaka shkoi afër gjysmë metro lart. Ai mundohej që me dorën tjetër ta ndalte gazin pa e larguar çakmakun nga fytyra e tij. Gati u dogj. *Në atë moment unë zgjata dorën dhe ia tregova me gisht mekanizmin e gazit si për t'i thënë: mos luaj me zjarrin, gjë që ishte e vërtetë dhe politikisht.* Zjarri u ndal dhe në atë moment e pashë se ai ishte totalisht jashtë kontrollit. E ndezi cigaren dhe vazhdonte ta thithte edhe atë pa kontroll. Madje edhe shpuzën e cigares e shkundte në dysheme dhe jo në vendin e duhur. Më pas i thashë se "konstruktiviteti i tij i ardhshëm për Kosovën ishte shumë i rëndësishëm dhe dikush në një mënyrë ose tjetër do ta kompensonte". Këtu, tani ai i dha bisedës një kahje tjetër, duke folur për miqtë e tij që kishte në Kosovë, foli për vlerat e shqiptarëve e sidomos potencoi shumë besën. Foli për një rrugëtim që kishte bërë me një shqiptar nga Beogradi për në Itali gjatë kohës sa ishte drejtor i përgjithshëm i Bankës së Beogradit. E përfundoi komentin me fjalët se shqiptarëve mund t'u besohej, se ata janë besnikë. Nga ky moment takimi vazhdoi edhe për dy orë deri në errësirë. Ai filloi një rrëfim të gjerë duke lavdëruar vetveten shpeshherë, duke i sharë dhe fyer bashkëpunëtorët e tij, si dhe disa njerëz në Kosovë që nuk "ia donin të mirën popullit të vet". Unë nuk kundërshtoja, por dëgjoja kinse me vëmendje. Herë pas herë më pyeste: "A më kupton?" Thënë të drejtën unë e dëgjoja, por shumë gjëra që nuk më interesonin më kalonin pa i futur në trurin tim, por në pyetjet e tij se a po e kuptoja i përgjigjesha, "Po, po". Mua më interesonte qëllimi i misionit tim: hyrja sa më e shpejtë e procesit në kahjen e ndaljes së gjakderdhjes. Pastaj, Milosheviqi përmendi shumë emra, por më bëri përshtypje mënyra se si tentonte të minimizonte atë që po ndodhte në Kosovë. Me qetësi, unë fillova të elaboroja propozimin për bisedime sipas idesë që e kisha në mendje. Natyrisht, ishte një tentativë ndërmjetësimi, me pretendimin që të kishte sukses.

Pas një bisede të gjatë hyrëse, u vijua me shpjegimin e rrethanave,

dhe përshkrimin e gjerë të situatës aktuale në Kosovë. Një elaborim i gjatë nga ana e tij, për qëllimin e vizitës sime, në bazë të rrethanave të reja për të, shërbeu si rast për debat. Më pas u shfaq pragmatizmi i tij dhe dhe në një farë forme u fiksuan disa pika të cilat ishin:

*\*Atë ditë unë duhej të nisesha për Prishtinë, të mblihdhja politikanët e Kosovës dhe të ndërmjetësoja një takim të tyre me Milosheviqin, jo në rezidencën e tij, (siç do të ndodhte më vonë nga një iniciativë tjetër), por në hotelin Hyatt në Beograd. Pra, në një terren sadopak "neutral". Takimi do të duhej të mbahej ndërmjet 12 dhe 20 marsit 1998, me një fjalë, pas disa ditësh. Pas takimit, Milosheviqi insistonte që zoti Rugova t'u thoshte gazetarëve se takimi ishte i frytshëm dhe Milosheviqi ishte konstruktiv. Në këtë pikë, Milosheviqi insistonte. Unë këtë insistim të tij e mora si një dëshmi se kryetari i Serbisë e kishte kuptuar se po i ngushtohej horizonti dhe një "lëvdatë" nga goja e Rugovës në mediat ndërkombëtare do të kishte shumë rëndësi. Ndoshta këtu është fshehur intriga e Milosheviqit, por ju them, se për mua ishte vetëm një ndërmjetësim dhe të njëjtën gjë ua kam thënë atyre liderëve që më vonë erdhën në Hajvali për t'u takuar me mua.*

*\* Gjatë muajit mars, deri më 30 mars saktësisht, do të rihapeshin pesë fakultete dhe shkolla të mesme në gjuhën shqipe. Unë këtu komentova se Kosova ka pasur një Universitet të vetin, bile me mbi 50 mijë studentë dhe askush s'do të pranonte që asokohe të diskutohej për disa fakultete. Ai më tha se kështu do të jetë për fillim njëherë dhe nëse shkon puna mbarë nuk do të kishte problem të ketë edhe Prishtina një Universitet, me një bashkëpunim intensiv me atë të Beogradit. Unë i thashë se "me rëndësi është që Prishtina të ketë Universitetin ashtu siç e ka pasur dhe për bashkëpunimin e tij me Beogradin do të vendosë vetë Universiteti". Këtu ai shtoi se "në takimin e ardhshëm me liderët kosovarë mund të bisedohet dhe të gjendet zgjidhje". Milosheviqi më tha se "Shën Exhidio (Santo Egidio - komuniteti i njohur katolik italian, i famshëm për veprat e veta të ndërmjetësimit të krizave botërore me priftërinj diplomatë), po ashtu e kërkon këtë". Sa u përket shkollave të mesme, ai më tha se "asnjëherë nuk ishin ndalur, por është dashur që këto të kishin një planprogram sikurse në Serbi, duke i shtuar këtu edhe*

karakteristikat e gjuhës shqipe". Unë i thashë se "e dinte mirë se shkollat në Kosovë nuk e kanë ndërprerë punën dhe nëse nuk gjendet një zgjidhje që të legalizoheshin, ato do të vazhdonin edhe më tutje, në të njëjtën mënyrë. Sigurisht këtu paratë nuk mungojnë, se diaspora e Kosovës, ka qenë dhe është e gatshme që gjithmonë të garantojë punën e këtyre shkollave", i thashë unë. Duke dashur që të minimizonte këtë, Milosheviqi, ndërhyri: "Ato diploma kurrë nuk do të jenë legale". Unë i thashë se mu këtu ishte problemi. "Bash për këtë demonstrojnë studentët dhe nxënësit, të cilët policia e Serbisë është duke i maltretuar dhe në këtë mënyrë do të ketë edhe më tepër gjakderdhje. Që situata është jashtë kontrollit, e dëshmon edhe ky fakt", i thashë unë. Ai u shpreh se "të dy palët do të ulin tensionet dhe do të gjejnë një zgjidhje, dhe kjo temë do të jetë, temë e bisedave me delegacionin e Kosovës". Më tutje ai tha se "policia serbe nuk po ndërhynte në protestat e studentëve". E kundërshtova një gjë të tillë si të pavërtetë sepse policia kishte ushtruar dhunë të paparë më 1 tetor 1997. Tha se për këtë do të bënte verifikimet e veta. Në fakt pas një momenti ai u ngrit në këmbë dhe thirri dikë të cilit i tha: "nëse nuk ka huliganizëm, policia mos të intervenojë te demonstruesit".

*\*Menjëherë pas takimit me liderët kosovarë, ose më së largu më 30 mars, do të bëhej e mundshme rihapja e të përditshmes "Rilindja" dhe "TV Prishtinës" së atëhershmes. - ishte pika tjetër.*

Në këtë kontekst, ai më tha po ashtu se shumë shpejt në Kosovë do të hapen edhe të përditshme dhe televizione private. Bile, vazhdoi Milosheviqi, "ne jemi duke e shqyrtuar një kërkesë".

*\*Gjatë muajit maj të vitit 1998, çështja e rikthimit të "autonomisë së plotë të krahinës", siç ai e quante, "do të jetë temë e diskutimit në parlamentin e Serbisë dhe nga këtu do të fillonte debati". Ai do të mundësonte formimin e një komisioni parlamentar të posaçëm dhe krahina autonome e Kosovës, ashtu siç e quante ai, duhet ta bënte të njëjtën, duke vendosur kontakte mes tyre lidhur me propozimet eventuale. "Këto komisione duhet të vazhdojnë punën, deri në shtator të të njëjtit vit kur duhet të raportojnë me shkrim për atë që kanë arritur", vijoi me propozimet e veta. "Shqiptarët duhet të dinë se posedojnë standartet më të larta", mburrej Milosheviqi dhe shumë herë e përmendte Tirolin e Jugut në Itali. Në këtë pikë*

unë i thashë se "Kosova në vitin 1974 ka qenë pjesë konstitutive e Jugosllavisë dhe do të jetë shumë vështirë që dikush në Kosovë të mendojë që të bisedojë nga ndonjë pikë më e ulët nga ajo që i ishte garantuar atëherë". Duke iu referuar situatës aktuale në Kosovë shtova se 'gjendja e tanishme është e paakceptueshme dhe ajo nuk mund të kthehet më nën kontroll pos nëse bëhet diçka shumë shpejt dhe shumë më tepër se sa në atë të vitit 1974'. "Njerëzit e Kosovës nuk e njohin Tirolin e Jugut"- i thashë unë.

Ai insistonte se "do të merrej vesh me liderët e Kosovës për këtë dhe se unë, si Behgjet, nuk mund të bisedoja për këto çështje". Këtu unë i kam thënë se "një komision i përbashkët mund të ishte zgjidhje e mirë dhe mund ta ndalte gjakderdhjen. Por ky komision në shtator, është dashur t'i sillte një dokument shumë të fortë". "Si e mendon ti?" më pyeti Milosheviqi. I thashë se "Kosova, pas shpërbërjes së Jugosllavisë, synon të trajtohet në të njëjtën mënyrë si subjektet e tjera të ish-federatës". "Po,"- më tha Milosheviqi, "për një gjë të tillë në kushte shumë specifike do të mund të bisedohet. Por prapë", vazhdoi ai, për këtë do të jenë komisionet bilaterale". Ama këtë pikë ai nuk preferonte që Presidenti Rugova - nëse do të vinte - ta deklaronte para gazetarëve. Sipas tij, ai do të gjente një moment më vonë kur do të takohej me Presidentin Rugova dhe të bisedonte me të rreth kësaj çështjeje.

Deri në këtë pikë, kisha bindjen se gjërat do të shkonin pa vështirësi, pa pësuar ndryshime, ashtu siç thoshte. Atëherë, Milosheviqit ia nxora propozimin e fundit:

*\*Pas shtatorit çka do të ndodhë? A do të jetë Kosova subjekt i plotë i Federatës së vogël Jugosllave e barazuar me Serbinë dhe Malin e Zi?\**

"E pamundur!", u hodh Milosheviqi. "Ti dëshiron Republikë. Këtë e vendos dhe e zgjidh Federata" dhe vazhdoi: "E pamundur! Këtë nuk mund ta zgjidh unë. Ky është problem për t'u zgjidhur me referendum prej Serbisë. Nëse populli i Serbisë lejon ndarjen, atëherë do të ndodhë. Unë këtu i thashë se "personalisht nuk mund t'i imponohem askujt." Por vazhdova: "Kjo kishte me qenë zgjidhja më e mirë që në moment do të kishte efektin e vet që gjërat të fillonin dhe të funksiononin kah normalja." Ndërhyri: "E çka bëhet

me grupet terroriste që janë duke e terrorizuar popullin serb me presionin për largimin e tyre, duke shkatërruar kishat, varret etj.?” Nga toni i tij i lartë, fytyra e skuqur, kuptova se shumë shpejt do të më largonte. Ai madje doli nga kontrolli, bile kisha përshtypjen se kur fliste “për disa grupe terroriste”, kishte ndërmend gjithë shqiptarët. Unë me shumë durim vetëm dëgjoja dhe për një moment, kur ai u ndal, i thashë se “nëse nuk do të ishin forcat e policisë serbe në Kosovë, ato “grupe” nuk do të kishin kundër kujt të luftonin”!

Milosheviqi i ngacmuar nga kjo fjalë, kërceu dhe tha: “Policia serbe do të jetë në Kosovë deri sa të dominojë rendi e qetësia dhe derisa serbët atje të ndihen të sigurt”. Reagova duke thënë se “është shumë e mundur që juve nuk ju informojnë si duhet. Serbët në Kosovë nuk i prek askush, por dalja jashtë kontrollit e situatës në Kosovë është provokuar nga ardhja masive e forcave të policisë dhe e incidenteve që ato i provokonin.”

”Ata vetëm përgjigjen dhe janë në mbrojtje të qytetarit të tyre!” - tha.

“Edhe të shqiptarëve?”, e pyeta unë.

“Të qytetarëve të Serbisë” - përgjigj.

Nuk ia vlente të diskutohej më tutje, por këmbëngula se “zbatimi i pikave që biseduam, për mua do të thoshte edhe tërheqje e forcave të policisë nga Kosova”. Pas një shikimi drejt në sy, ai më tha:

“Edhe për këtë do të vendosin grupet bilaterale”.

Pas asaj që ai tha se ishte shumë i interesuar që procesi në Kosovë të fuqizohej me bisedime të drejtpërdrejta mes Prishtinës dhe Beogradit, kreu i Serbisë tentoi të më bindte se ndërhyrjet e të huajve, e sidomos të amerikanëve, e pengojnë këtë dhe se ai do të ishte shumë më konstruktiv po qe se do të merrte “bajrakun” e procesit. M’u duk se biseda u relaksua kur ai bëri disa premtime, ndërsa thoshte se menjëherë do të pasojë takimi në një prej sallave të hotelit, ajo që unë e dëshiroja. Duke u nisur nga praktikiteti im, mendoja herë pas here, kur nuk më kapnin dyshimet, se gjërat do të fillonin të ecnin për të mirë, duke përjashtuar dhunën. Për mua, siç e thashë më sipër, çdo viktimitë për një popull të vogël si ne shqiptarët në Kosovë ishte humbje e madhe. Besoja shumë, ndoshta naivisht, se nuk ishte as keq nëse angazhohesha në mënyrë paqësore të zgjidhja



disa probleme nëpërmjet këtij takimi. Frymëzues i madh për këtë për mua ishte, përveç Gandit të madh, edhe Ibrahim Rugova. Për të dhënë më mirë atmosferën e takimit do të flas edhe për momentin kyç të bisedës me Millosheviqin që për mua ishte çelësi i suksesit të saj. Te ky moment siç ju thashë, e mbështesja besimin tim se Milosheviqi, pas bisedës sonë, do t'i jepte procesit një kahje pozitive për Kosovën. Për kushtet e kohës, lista e kushteve që përshkrova më sipër përcaktonte drejtimin që duhej ndjekur.

Kaq ishte. Duhet ta pranoj, unë nuk kisha përvojë politike dhe, deri atëherë, siç e kam thënë sa e sa herë, ecejaket e mia nëpër botë kishin të bënin më së shumti me biznes. Madje, nuk e kisha imagjinuar ndonjëherë, se do të viheshja në pozitë të tillë, që të bëja negociata për gjëra kaq të mëdha dhe kaq të vështira. Veçmas jo negociata, në të cilat do të vendosej për fatin e popullit tim. Unë e dija se për diçka të tillë nuk kisha as mandat. Isha nisur në këtë aventurë, i shtyrë nga ndjenjat njerëzore, si dikush që ndiente dhembje dhe vuante shpirtërisht për atë që ndodhte në Kosovë.

Biseda mbaroi me një marrëveshje gojore: unë t'i bindja liderët e Kosovës që të vinin dhe të takoheshin sa më shpejt në vendin që u morëm vesh, në *Hyatt*. Po ashtu u dakorduam që ne të kontaktojmë drejtpërdrejt në funksion të atij takimi, pa marrë parasysh se unë nuk do isha pjesë e grupit që do të takohej me Milosheviqin. Po ashtu i kërkova që atë ditë në çfarëdo kohe, aeroporti i Prishtinës të ishte i hapur për mua që të ateroja dhe të mos kishte askund patrulla të policisë prej aeroportit deri në Hajvali. Unë po rrezikoja. Kisha frikë, natyrisht, ndaj duke marrë parasysh edhe reagimin e tij, isha zhytur thellë në mendime.

Ndaj, sapo u largova nga Dedinje, thirra vëllanë tim, Ismetin, që të gjenin dhe të lajmëronin Presidentin Ibrahim Rugova, Fehmi Aganin, Rexhep Qosjen dhe Mahmut Bakallin, që të vinin në shtëpinë time në Hajvali, në mënyrë që aty të diskutonim kokë më kokë për një çështje shumë të rëndësishme. Vëllai i kishte thirrur të gjithë, mirëpo, Qosja dhe Rugova nuk erdhën. Erdhën vetëm Mahmut Bakalli, Fehmi Agani, Ferid Agani dhe një tjetër, emrin e të cilit nuk e mbaj mend.

Fehmi Agani kërkoi që në takimin e mundshëm me Milosheviqin

të ishte e pranishme edhe një palë e tretë, mundësisht ndonjë diplomat amerikan. Mahmut Bakalli insistonte se do të takohej me Milosheviqin vetëm nëse ky do pranonte të bisedohej për formimin e Republikës së Kosovës në kuadër të Federatës Jugosllave. Ai thoshte se kjo ishte me rëndësi për ne dhe se pas statusit si Republikë ne mund të bëjmë çka duam. Dua të them se edhe në takimet e mëhershme me Bakallin, ai gjithmonë e theksonte këtë kusht. Prita me orë të tëra, me shpresë se megjithatë diçka do të bëhej. Të nesërmen, Fehmi Agani më informoi se Presidenti Rugova nuk do të shkojë në Beograd. Rugova i kishte thënë atij se premtimet e pambajtura të Milosheviqit, ishin baraz me një varrezë masive, ashtu siç e kishte cilësuar edhe zonja Ollbrajt.

U largova nga Kosova dhe njoftova kabinetin e Milosheviqit në Beograd se politikanët e Kosovës nuk pranonin të takoheshin me të, prandaj unë tërhiqesha nga kjo iniciativë.

Më vonë, më datën 10 mars 1998 mua më erdhi një telefonatë në Lugano. Në ekranin e telefonit tim dukeshin shumë numra 33333. (E kuptova se ishte një telefonatë satelitore e rezervuar). Kur hapja telefonin, e dëgjova zërin e Milosheviqit i cili më komunikoi veç të tjerash: “Holbruku më tha se Rugova nuk do të vijë në takim siç u morëm vesh bashkë dhe se ai kërkon që unë t’i pranoj ata në një datë tjetër”. Kjo më la të kuptoj se Holbruku dëshironte të ishte ndërlidhës. Ai shtoi më tutje, duke më thënë se “do të flas me ta në një datë kur kam kohë, por në rezidencën time, e jo në hotelin *Hyatt*, pa pjesëmarrjen e gazetarëve ndërkombëtarë dhe Holbruku nuk do të jetë pjesë e bisedave... Çka kemi biseduar bashkë, bie në ujë. Por kështu nuk zgjidhen problemet”, më tha Milosheviqi.

Unë i thashë: “Ju vendoseni vetë, por një gjë është e sigurt: Kosova nuk mund të jetojë në këto kushte dhe ky problem kërkon zgjidhje të menjëhershme”. Këtu u mbyll telefonata dhe çdo kontakt i mëtejshëm me Milosheviqin. Më kujtohet se i pyetur nga gjykatësi në Hagë, nëse ka ndërmarrë diçka për ta qetësuar situatën në Kosovë në mënyrë paqësore, Milosheviqi, pranë dëshmitarit Veton Surroi, u përgjigj: “Pyeteni një biznesmen të shquar tuajin të Kosovës”.

Kështu përfundoi çdo kontakt dhe iniciativë e imja në drejtimin e zgjidhjeve me negociata.

Liderët e Kosovës, pas vizitës time, shkuan te Milosheviqi. Biseduan me të, jo në hotelin ku unë kisha propozuar, por në rezidencën e tij. Në këtë takim, që u bë më 15 maj 1998, morën pjesë: Ibrahim Rugova, Mahmut Bakalli, Veton Surroi, Fehmi Agani dhe Pajazit Nushi. Në fotografitë dhe xhirimet televizive ndërkombëtare nuk e kam parë Holbrukun në takim. Më kujtohen fare mirë pamjet dhe aty e ndjeva veten shumë keq. Pse nuk më besuan mua? Pse nuk erdhën me mua, por pranuan një ofertë më të ulët nga ajo imja, të bisedojnë në rezidencën e tij e jo në një vend neutral? U fitua ndonjë gjë duke refuzuar rolin tim? Këtu më ra ndër mend një fjalë e gjyshit, një lloj autokritike për mënyrën si e trajtojmë ne dikë që përpiqet për mirë. “Për ne shqiptarët, njeriu yt që është në gjendje të sakrifikojë për ty, nuk ka vlerë sa të tjerët”.

Edhe tani përsias pse oponentët e mi të tanishëm politikë spekulojnë për vizitën time te Milosheviqi. Te po ai Milosheviq shkoi kreu i Kosovës pas meje dhe kjo konsiderohej krejt normale, kurse vizita ime demonizohet! Demonizimin e kësaj vizite e bëjnë pikërisht një pjesë e njerëzve që ishin në delegacionin që u takua me Milosheviqin, pas meje. Kujtoj se arsyeja kryesore është kjo: ata duan të largojnë prej vetes atë pjesë të kritikave bërë mbi ta dhe për t’i hedhur ato tërësisht mbi mua, që isha një individ i thjeshtë, pa përgjegjësi politike si ato të tyre. Unë nga ana ime nuk kam bërë të njëjtën gjë, pra nuk kam demonizuar askënd, as atëherë e as tani, duke pasur parasysh kontekstin kohor në të cilin u zhvilluan ngjarjet. Në fund të fundit mendoja se ishte e rëndësishme që shqiptarët t’i tregonin botës se i kishin provuar të gjithë rrugët për zgjidhje, para se të shkonim tek shkëputja përfundimtare. Qoftë me rrugë paqësore, si bisedimet, qoftë me luftë të armatosur, si ajo që ndoqi UÇK-ja.

Ky takim në "shtëpinë" e tij dhe me ofertë më të ulët, u perceptua praktikisht si marketing medial për Milosheviqin, i cili u shfaq para botës si njeri që është i gatshëm të dëgjojë hallet e “shtetasve të vet” në zyrë, ndërsa takimi në hotelin ndërkombëtar *Hyatt*, u jepte palëve karakterin e bashkëbiseduesve të barabartë. Nga ana tjetër, dihej se këtë takim e kishte aranzhuar Holbruku, të cilit Milosheviqi i kishte thënë se ishte i gatshëm t’i pranonte në takim liderët kosovarë. E kujtoj plotësisht dhe pozicionin amerikan që nuk merakosej shumë

për hollësira të tilla si vendi i takimit. Amerikanët që udhëhiqnin një front laraman, siç ishte ai i vendeve europiane të NATO-s, donin të tregonin se u kishin bërë të gjithë shërbimin rrugëve paqësore. Normalisht duhej të kishte dhe njëlloj rivalizimi në inisiativa mes fuqive të mëdha, njëlloj protagonizmi të shpallur dhe pashpallur, për supremaci në skakierën globale. Unë isha kosovar, unë vija prej popullit që rrezikonte të zhdukej dhe i painformuar ndaj këtyre lojërave politike, më interesonte rezultati - shpëtimi i popullit tim - ndaj faktori kohë ishte jetik.

Unë isha i vetëdijshëm se inisiativa ime, për shkak se kishte në prapavijë mbështetjen ruse, kishte gjasa të mëdha të dështonte, sepse kosovarët, çfarëdo që të ofrohej nga ajo palë, nuk do ta miratonin, jo për shkak të dijës politike, apo analizave të holla, por kryekëput për shkak të paragjytimeve. Ata e paragjykonin Rusinë, për pasojë ata më paragjykonin edhe mua. Por kushdo që ka kujtesë historike, përveç "detajit" të vendtakimit, le të krahasojë përmbajtjen e bisedës që bëra unë, e që do të diskutohej me liderët kosovarë, dhe Marrëveshjen për arsimin e negociuar me ndërmjetësimin e Komunitetit të Shën Exhidios. Është fare e qartë diferenca në favor të tekstit që negociova unë. Për mua kaq kishte rëndësi, cilësia e ofertës.

Kritikët e mi të sotëm dhe të djeshëm nuk e kuptonin se unë kisha shkuar një hap më larg se skemat e vjetra politike, historike e diplomatike. Ata është dashur ta dinin se unë vija nga bota e biznesit dhe se me këtë logjikë kisha vepruar edhe në këtë rast. Unë kisha propozuar dhe kisha marrë miratimin për një "marrëveshje kompenzuese", kuptimi i së cilës, siç e kam shpjeguar më sipër, ishte shumë i thjeshtë dhe shumë i qartë: prano një marrëveshje, ose do të publikohen materialet kompromentuese! Për mua kishte rëndësi rezultati dhe jo se nga vinte zgjidhja: a do të ndalohej gjakderdhja apo jo? Mund t'i kuptoj kritikët e djeshëm, por e kam të vështirë t'i kuptoj kritikët e sotëm. Po më vonë, cili do të ishte rezultati? - mund të pyesë dikush. Natyrisht, unë nuk kam qenë as atëherë, e nuk jam as sot magjistar apo fallxhor, por për të kuptuar sa e rëndësishme ishte ajo marrëveshje nëse respektohej, duhet të vendosemi në atë kohë, të arsyetojmë me rrethanat e kohës dhe jo me ato të sotmet. Por gjithsesi edhe njëherë e përsëris: ashtu si unë edhe udhëheqësia

e Kosovës arsyetonim sipas një qasje të momentit. E tillë ishte Marrëveshja për arsimin, që tentonte të zgjidhte një situatë të caktuar, por që zhvillimet e mëpastajme e zhvleftësuan me shpejtësi. Unë i kuptoj kritikët e mi dhe të presidentit Rugova për takimet me Milosheviqin, por ne kemi bërë thjesht çfarë mund të bënim, çfarë na impononin rrethanat e kohës, faktorët relevantë ndërkombëtarë, dhe askush s'mund të na qortojë për mungesë vizioni. Aq më shumë mua, që s'isha politikan.

Diskutimet rreth Kosovës ishin bërë tashmë planetare. Kuptoja se ishte interes jetik për Milosheviqin që të mos humbte mbështetjen e Ruisisë. Kur ai u bind se ajo e kishte shitur përfundimisht, u dorëzua. Edhe gjasa se Milosheviqi nuk do të respektonte premtimet eventuale do shërbente për ta goditur përfundimisht imazhin e tij ndërkombëtar para fuqive të mëdha, që do shtyheshin të merreshin vesh për reagime të reja. Përveç kësaj, Rusia e Jelcinit nuk ishte as Rusia e Carit, as Rusia e Stalinit, as Rusia e Brezhnjevrit dhe as Rusia e sotme e Putinit. Ai ishte një udhëheqës që ishte gati të bënte kthesa të mëdha, me shkëmbime interesash, në politikën e saj, përfshirë edhe Kosovën dhe shqiptarët. Për shumë arsye që i kam shpjeguar më lart. E pastaj? Nuk e them dot se çfarë do të ndodhte pastaj, por unë asokohe besoja se në Kosovë, do të kishte më pak varre. Ky kishte qenë motivi i vetëm i angazhimit tim dhe jo karriera. Asokohe kisha prioritete të tjera - shpëtimi i popullit tim të vogël!

Se sa e vështirë dhe e pamiradijshme ka qenë kjo iniciativë imja, e dëshmon edhe një fakt tjetër. Me të arritur nga Beogradi në Hajvali, i tregova tim eti dhe familjarëve të mi se për çfarë bëhej fjalë, se unë nuk kisha marrë rolin e ndërmjetësuesit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por vetëm një iniciativë me nismën e Ruisisë me shpresë se do të ndalej gjakderdhja në Kosovë. Im atë një herë më shikoi idhshëm dhe pastaj m'u kthye me një mijë e një të shara. "Milosheviqi është gënjeshtar. Ai mund të të mashtrojë edhe ty, ashtu siç mashtrojnë të tjerët. A e ke menduar se ai nuk e mban fjalën? Ai është gjakpirës", e shumë e shumë gjëra të tjera, që filluan ta rëndojnë takimin që kisha aranzhuar në Hajvali. As atëherë, e as sot, nuk kisha dhe nuk kam ndonjë kundërargument të vlefshëm karshi mllefrit të tij, përveç se të them se politikanët e kohëve moderne nuk janë dhe nuk mund të

jenë baballarë emocionalë.

Më pastaj, ngjarjet morën rrjedhë tjetër, natyrisht pa mua, pa pjesëmarrjen time. Ishte bërë publike...*Nedelnji Telegraf* filloi shkrimet e tij maratonike dhe shumëçka që shkruhej aty ishte pjesë e bisedës sime me Milosheviqin. Biseda e bërë në atë rast midis meje dhe Milosheviqit, kishte dalë jashtë “rrethit të mbyllur”, pra ishte bërë publike ndoshta nga vetë diktatori serb, ose kishte mundësi që ambientet ku u zhvillua biseda, të ishin përgjuar. Sipas meje kjo e fundit është më reale. Të gjitha variantet ishin të mundshme, sepse këto regjime kanë një të përbashkët: ndërtohen mbi intriga, prapaska, komplete, tradhti.

Kjo gazetë e Beogradit, filloi shkrimet me tituj ofendues për mua: *Si e korruptova Jelcinin dhe në Kremlin e bleva Kosovën*; ose një tjetër titull: *në Lugano takuam armikun më të madh të Serbisë*; ose: *në Kremlin e kreu punën dhe erdhi e i tregoi Milosheviqit, ose Si Behgjet Pacolli, me miliardat e tij të fituara prej narkobiznesit, e bleu Kosovën*. Ose, më vonë: *Shefi i mafies shqiptare me Milosheviqin e kreu problemin e Kosovës - tani ai miliardat e tij i shpenzon në Washington për të lobuar për pavarësinë e Kosovës!* e shumë tituj të tjerë. *Nedelnji telegraf* u interferua bile edhe në Lugano. Shkrimet tani ishin më morbide. Nga krejt përmbajtja e shkrimeve, e kam të lehtë të kuptoj se bisedat janë përgjuar dhe i kanë kaluar *Nedelnji Telegraf*-it. Pas këtyre publikimeve si duket Milosheviqi e shkarkoi shefin e shërbimit të tij sekret.

Këto sulme në një farë mënyre ishin konfirmim i drejtësisë së asaj që bëra nën efektin e masakrës së Drenicës, një ditë më vonë asaj masakre: qarqet nacionaliste serbe nuk e mirëprisnin uljen e tensionit dhe bisedimet, të kapur nga ethet e zhdukjes “fizike” të problemit kosovar nëpërmjet gjenocidit. Por nëse i kuptoj këto qarqe, nuk arrij të kuptoj pse kritikët e mi në vendin tim, po më kundërviheshin apo m’u kundërvunë me egërsi të njëjtë? Nëse bisedimet me Milosheviqin ishin gabim, njëlloj gabonin si ata që shkuan në grup, si unë që shkova vetëm!

E njëjta gazetë, disa vite më vonë spekuloi me një intervistë timen, duke i vendosur një titull që s’kishte lidhje me ato që kisha thënë unë dhe që e kisha kontrolluar me imtësi. Dikush në Kosovë tentoi ta

përdorte kundër meje, pasi unë hyra në politikë. Për të më sulmuar mua, nuk u ndalën as nga përdorimi i një gazete të pabesueshme serbe. Unë vetëm kisha thënë se "këto shtete të vogla, do ta kenë të vështirë të mbijetojnë në të ardhmen pa bashkëpunim". Titulli i gazetës ishte "Kosova nuk mundet t'ja dalë pa Serbinë", titull që u përdor jo korrektësisht nga oponentët e mi. Kjo ishte fatura që unë duhet të paguaja për qëllimet e mia të mira, ashtu si dhe në raste të tjera. Ndoshta dhe sot....

Çfarë mbaj mend tjetër nga takimi? Si dëshmi e vullnetit të "mirë", sigurisht pas episodit të ndezjes traumatike të cigares, Milosheviqi kreu disa veprime operative. Mbaj mend se gjatë takimit ai në praninë time, ish-drejtorit të përgjithshëm të policisë serbe, ia bëri të ditur se prej asaj dite, pra nga 8 marsi 1998, të mos pengoheshin protestat e mesditës të kosovarëve (lexuesit e mbajnë mend se për çfarë bëhet fjalë). Në fakt, më datë 9 mars, QIK-u i Kosovës, informonte se "për herë të parë, gjatë protestave në Kosovë ku marrin pjesë mbi 200 mijë qytetarë, nuk është vërejtur prania e policisë serbe". Natyrisht këtë premtim Milosheviqi e mbajti vetëm për pak ditë.

Unë personalisht, a isha i zhgënjyer me këtë zhvillim dhe me këtë iniciativë timen? Në planin afatshkurtër, po; në planin afatgjatë, jo.

Nga e gjithë kjo ngjarje dhe komentet rreth saj, ne duhet të nxjerrim një mësim. Ne duhet tani të jemi më mbështetës të njëri-tjetrit në raport me interesat madhore të popullit dhe shtetit tonë të cilat janë dhe duhet të jenë të parat. Vështirësi të mëdha na kanë përcjellë në të kaluarën nga veprime që kanë pasur për qëllim primar vetëm përfitimet personale politike, xhelozinë, smirën, paaftësinë për të parë më larg. Unë i vuajta të gjitha këto dhe nuk e pata as më vonë mbështetjen që më duhej, siç do ta shihni në këtë libër, në lobimin tim në Uashington për pavarësinë e Kosovës, por as për lobimin për njohjen e saj. Shumë liderë politikë të Kosovës, në atë periudhë, mjerisht dhe sot, ishin pa vizion, pa informacione dhe pa strategji të mjaftueshme, për të zhvilluar një diplomaci aktive, me të gjithë faktorët globalë, e cila në asnjë rrethanë nuk do të binte ndesh me luftën e armatosur, por do të bëhej krah i saj i fuqishëm në skenën ndërkombëtare.

Unë u përpoqa të lëviz një gur në këtë drejtim dhe - dështova, jo për shkak të vizionit të gabuar, por kryekëput për shkak të konfuzitetit që mbretëronte te lidhshipi kosovar i atyre viteve.

Për fund, dua të shpreh edhe diçka, që ka mbetur pezull rreth kësaj çështjeje: hapur ose fshehtas, unë jam përfolur shumë lidhur me takimin që kam pasur me Milosheviqin, një takim për të cilin unë kam treguar shumë më shumë elemente se të tjerë që e kanë takuar gjithashtu. E kam bërë gjithçka publike. Në disa raste më duket se edhe "thashethemexhinjtë" e Kosovës, me ose pa dashje, u bënë pjesë e një kori antishqiptar, me përmasa planetare, i cili, pikërisht atëherë kur ndodhnin këto ngjarje dhe kur Kosova ecte nëpër tëh të shpatës, ose edhe më vonë, por gjithnjë ndërsa Kosova ishte në rrethana të mjegullta, kurdisën komplete ndërkombëtare nga më të shëmtuarat, vetëm e vetëm që nga kjo lojë e madhe shqiptarët e Kosovës të dilnin të humbur. Unë i hyra kësaj inisiative politike pa eksperiencë, pa i njohur rrethanat. Kam mirëkuptim për vendimin e Rugovës kundër ndërmarrjes sime: mosbesimi te Milosheviqi. Kjo më bën të reflektoj sot pse ky mision dështoi dhe se është më mirë që ndodhi kështu. Nëse kasapi serb do të jepte fjalën dhe pastaj nuk do ta mbante, mbase do të më kishin shpallur përgjegjës mua për këtë. Në të gjitha rastet ai nuk do ta mbante fjalën për gjithçka premtonte në bisedime. Ai kishte bërë dëme të mëdha, imazhi i tij te të huajt ishte dëmtuar shumë, por me mosmbajtjen e fjalës para rusëve mund të kishte pasoja - ky ishte i vetmi mekanizëm presioni i momentit mbi të.

Grupi i liderëve që u takuan me Milosheviqin pas meje, u ndienë më komodë me ndërmjetsimin e Hollbrukut. Ajo ishte një zgjidhje e drejtë nga pikëpamja strategjike, pra Kosova po ndiqte një rrugë paqësore të sugjeruar nga perëndimi, me gjithë pasojat tragjike që erdhën në ditët menjëherë pas takimit. Shkuarja me ndërmjetësimin e Hollbrukut, ishte e domosdoshme prej nevojës së rreshtimit me perëndimin, me amerikanët. Por ama, pa rezultat.

Unë edhe tani e them: me Milosheviqin nuk u takova vetëm unë. Pas meje u takuan edhe liderët shqiptarë të Kosovës, që kishin përgjegjësi dhe përfaqësonin popullin e Kosovës ose pretendonin se e përfaqësonin. Unë në atë takim nuk përfaqësova askënd, sepse



nuk e kisha atë mandat. Fundja, unë isha një individ i vullnetit të mirë, që një ditë më pas masakrës së Prekazit u përpoqa të kryeja një shërbim në të mirë të paqes dhe humanitetit, misione të cilat njihen në historinë botërore. Unë personalisht nuk përfitoja asgjë nga kjo situatë. Përkundrazi, e njihja shumë mirë rrezikun që më kanosej. Por e bëra, sepse ia vlente. Të njëjtën gjë, pa mandat, e bëra dhe jam duke e bërë dhe tani kur lloj për Kosovën.

Kosova, atëbotë, kishte nevojë për ndihmën e secilit. Pra Kosova kishte nevojë edhe për ndihmën time, sado e vogël të ishte ajo. Dhe për ta konfirmuar këtë postulat të tij po sjell një thënie të Nënë Terezës, të cilën e pata takuar në vitin e largët 1979 : *E dimë mirë se punët që bëjmë janë një pikë ujë në oqean. Por e dimë gjithashtu shumë mirë se nëse ajo pikë nuk është atje, oqeanit i mungon diçka!*

## Si e shoh unë historinë tonë të afërt?

*Jeta ime larg vendit nuk ishte një jetë në boshllëk idesh e gjykimesh mbi atë që ndodhte. Unë kam mendimet e mia mbi protagonistët e historisë sonë të afërt, që solli çlirimin e vendit. Mbi rolin e rezistencës së gjysmës së dytë të shekullit të 20-të. Mbi Shqipërinë. Lëvizjet klandestine, protestat e 68-s dhe 81-shit. Rolin e Rugovës, personalitetet që e ndihmuan në krye të LDK-së dhe rolin e madh i UÇK-së. Fazat historike që ata shenjuan me kontributin e tyre.*

**N**ë periudhën vijuese Kosova u ballafaqua me masakra e viktima të shumta dhe me eksodin e gjysmës së popullatës së saj. Kjo ployë e madhe mbi popullin tonë, u ndal nga bashkësia ndërkombëtare (perëndimore), që nuk mund të toleronte përsëritjen e një Bosnje të re në mes të Europës. Këtë nuk arrinte ta kuptonte personi për të cilin folëm më lart. Ai nuk i kishte kuptuar mirë as mesazhet e Bushit të vjetër për "vijën e kuqe" që s'duhej shkelur në Kosovë, as vendosmërinë e Presidentit Klinton, që e shpëtoi Bosnjën nga gjenocidi serb, pasojë e mëdyshjeve evropiane. Vendosmëria e faktorit perëndimor të udhëhequr nga SHBA-të, e mbështetur në terren nga UÇK-ja, solli lirinë që lindi mbi gjakun e rinisë kosovare dhe sakrificat e atyre nënave, baballarëve, motrave, vëllezërve nga të gjitha anët e Kosovës që u vranë, u zhdukën nga makina e egër e luftës, pothuajse e paparë në Europën e pas Luftës së Dytë Botërore. Por le të përqëndrohemi te Kosova. Kujt i takojnë meritat e këtij hapi të madh të kryer prej UÇK-së - lirisë, që çoi më pastaj edhe në pavarësi?

Në këtë fazë të rrëfimit tim, më saktë të gjykimeve të mia, i lejoj vetes një lloj digresioni historik, sepse unë nuk mund të analizoj këtë pjesë të historisë sonë të afërt, pa u kthyer tek rrënjët e rezistencës shqiptare. Dua të shpjegoj si e shoh unë atë që bënë shqiptarët për t'iu shkëputur fatit të tyre të keq historik! Çfarë bënë për të ndrequr një padrejtësi historike, siç ishte ajo e copëtimit dhe e aneksimit së territorit të tyre Serbisë. Sepse ajo që ndodhi në fund të shekullit të 20-të sigurisht kishte në themel një histori lufte të pashtershme

rezistence, gjaku dhe therrorësh. Shqiptarët, kudo qofshin, kurrë nuk janë pajtuar me pushtimin e Kosovës dhe të viseve me shumicë shqiptare në Maqedoni prej Serbisë në luftërat ballkanike, ashtu siç nuk janë pajtuar as me pushtimin e viseve me shumicë shqiptare në Mal të Zi dhe në Greqi – vise këto që shtrihen përgjatë kufirit me Shqipërinë. Edhe qeveritë e kohës, pra ato që i kanë lënë vendin njëra-tjetrës pas Luftës së Parë Botërore, kanë dëshmuar këtë mospranim. Mes tyre duhet shquar sigurisht qeveria e mbretit Zog, i cili megjithëse erdhi në pushtet në mënyrë thellësisht pragmatike me ndihmën e serbëve, u shkëput shumë shpejt prej tyre dhe bëri mjaft vepra me sfond kombëtar. Zogu si monark e quante veten Mbret të Shqipërisë dhe shqiptarëve; në parlamentin e tij kishte përfaqësues që konsideroheshin si deputetë të Kosovës.

Dëshmi për pohimin se shqiptarët e Kosovës kurrë nuk janë pajtuar me pushtimin e Serbisë janë faktet historike. Prej Konferencës së Ambasadorëve në Londër, që fillon në fund të vitit 1912 dhe mbaron në gusht të vitit 1913, burgjet serbe dhe, mandej, serbe dhe jugosllave, kurrë nuk ishin pa të burgosur politikë shqiptarë, të gjykuar dhe të dënuar pse nuk e pranonin atë pushtim. Kosovarët organizuan një lëvizje rezistence që s'u ndal kurrë dhe Azem e Shotë Galica janë simbolet e asaj lufte. Duhet shënuar se më tej gjatë Luftës së Dytë Botërore, megjithëse populli i Kosovës pati mëdyshjet e veta, organizata e Partisë Komuniste të Kosovës, si organizatë e Partisë Komuniste të Jugosllavisë, në Konferencën e Bujanit, më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, përmes Rezolutës së saj, u deklarua për “bashkimin e Kosovës me Nënë Shqipëri”. Po më vonë ç'ndodhi? Kam folur për periudhën e pasluftës; për shpërnguljet e mëdha të popullsisë shqiptare në Turqi; për aksionet e shumta masive policore për gjoja grumbullimin e armëve; ekzekutimet e shumta me dhe pa gjyq. Të gjitha këto tregonin se Serbia asnjëherë nuk e fitoi Kosovën si territor.

Unë u rrita në një atmosferë të ngarkuar me ngjarje si këto. Ajo moshë që kam kaluar në Kosovë prej lindjes deri sa u shkëputa prej saj është shenjuar nga ngjarje të tilla. Deri në vitin 1968, vit kur unë gjendesha në Prishtinë dhe merrja pjesë në protestat e atij viti, shqiptarët, të cilët individualisht apo si pjesëtarë të

organizatave ilegale ngriheshin kundër regjimit serb dhe jugosllav në Kosovë, mbronin idenë e bashkimit me Shqipërinë. Prej asaj kohe kemi dhe përdorimin e emërtimit *enverist*, për gjithë ata që në veprën e tyre ilegale, i referoheshin Enver Hoxhës, me të cilin identifikonin Shqipërinë amë. Sigurisht mes tyre kishte dhe njerëz që e kundërshtonin Serbinë dhe ishin pro bashkimit, nga pozita të tjera, siç ishte Adem Demaçi, figura jonë emblematike, Mandela i shqiptarëve me 28 vitet e tij burg dhe me veçantësinë e luftës dhe të rezistencës së tij.

Në vitin 1968, për herë të parë, në mendimin politik të disa intelektualëve dhe veprimtarëve politikë, do të zërë vend ideja e Kosovës Republikë në kuadrin e Federatës Jugosllave. Derisa këta intelektualë dhe veprimtarë politikë idenë e Kosovës Republikë në kuadrin e Federatës Jugosllave, nën trysninë e fuqishme të pushtetit jugosllav, e zëvendësojnë shpejt me idenë e autonomisë së Kosovës, grupet ilegale të Kosovës, midis të cilave do të dallohet Grupi Revolucionar i Kosovës, i formuar në vitin 1973, do ta vazhdojnë veprimtarinë e tyre ilegale politike me idenë e bashkimit kombëtar, domethënë të bashkimit të Kosovës me Shqipërinë.

Është për t'u habitur në fakt se në leximet e mia në lidhje me qëndrimin e Shqipërisë, më rezulton se ajo në vitet '70 mbështeste plotësisht Jugosllavinë kundër krijimit të një republike të Kosovës. E kam përmendur pak më parë procesverbalin e bisedës së Enver Hoxhës me ambasadorin e Shqipërisë në Jugosllavi, në vitet '70, Lik Seiti. Në atë bisedë Enveri mbështet madje pozitën e komunistëve kosovarë që ishin kundër “një republike të re shqiptare”, pasi duhet të kishte vetëm një - Republika e Shqipërisë. Me siguri kjo preferencë ishte pragmatike në rastin më të mirë, por tregon shumë për qasjen e luhatur të vendit amë nën udhëheqjen e komunistëve, ndërsa në Kosovë kishte njerëz që vdisnin për Kosovën Republikë, apo dhe për bashkimin me Shqipërinë. Kam reflektuar më vonë për qasjen time të asaj kohe ndaj figurës së Enver Hoxhës: aq sa e doja, aq dhe e urreja.

Kjo ishte shkurtimisht një lloj “prehistorie” e Lëvizjes së rezistencës shqiptare në Kosovë, që realisht u ushqye me brumë kombëtar falë një lloj rilindjeje kulturore në vitet '70. Ishin vite kur

unë kryva ushtrinë pranë Titos dhe kur Kosova gëzoi një lloj lirie relative, një lloj lulëzimi, shtim të shkëmbimeve të gjithanshme me vendin amë etj. etj. Ky lulëzim ishte në themel të procesit të tranzicionit të Kosovës drejt pavarësisimit që duhet thënë se zë fill me protestat e vitit 1981. Siç na mëson historia, të gjithë popujt e pushtuar dhe të kolonizuar më parë janë çliruar në kulturën e tyre: me shkrime letrare, publicistike, shkencore, me këngë popullore e me krijime të tjera shpirtërore. Ashtu edhe Kosova më së pari do të bëhej e pavarur në krijimtarinë tonë mendore e, pastaj, do të vinte ideja që rinia studentore dhe shkollë e brohorisin zëshëm në demonstratat e tyre të filluara më 1981: Kosova Republikë! Pavarësisht se këto protesta në një farë mënyre e ndalën atë proces të lulëzimit kulturor të Kosovës, ato i treguan megjithatë botës se shqiptarët në ish-Jugosllavi nuk pajtoheshin me statusin e tyre dhe reagimi i egër serb krijoi si reaktion zinxhir, një ndërgjegjësim më të madh kombëtar mes shqiptarëve. Demonstratat e rinisë studentore dhe shkollë, të filluara në mars 1981, shënojnë kështu *Preludin e Lëvizjes sonë Kombëtare* për pavarësinë e Kosovës, që zgjati deri në vitet nëntëdhjetë. Lufta politike për pavarësinë e Kosovës në këtë etapë bëhet në mënyrë legale – përmes shkrimeve publicistike, shkencore, letrare dhe në mënyrë klandestine – përmes grupeve ilegale, numri më i madh i pjesëtarëve të të cilave ose bien në burgje ose shtrëngohen të arratisen në botën e jashtme.

Në fund të vitit 1989 dhe në fillim të vitit 1990, sikurse viset e tjera të ish-Jugosllavisë, nis formimi i partive të reja politike që unë e kam quajtur *etapa e parë e shkëputjes së Kosovës prej Serbisë*. Etapa e parë e historisë së Kosovës së re, shenjuar prej personalitetit të intelektualit Ibrahim Rugova. Dhuna me të cilën Serbia dhe Jugosllavia do të bëjnë përpjekje (të kota) për shuarjen e idesë së pavarësisë së Kosovës do të ndikojë që partitë e para politike, që formohen në Kosovë pas shpërbërjes së Lidhjes së Komunistëve, të paraqiten për regjistrim në Ministrinë e Drejtësisë në Beograd me programe në të cilat ideja e pavarësisë ishte zëvendësuar me idenë e autonomisë së Kosovës në kuadrin e Jugosllavisë, por kjo s'ndalte dot procesin historik të shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, që kishte nisur në Kosovë dhe atje duhej të përfundonte.

Formimi i partive të reja politike, që fillon në fund të vitit 1989 dhe në fillim të vitit 1990, shënon pra etapën e parë të Lëvizjes sonë Kombëtare, tani të kthyer në veprimtari legale më pak a më shumë të organizuar politike, në të cilën ideja e pavarësisë së Kosovës u nënshtrohet pothuaj plotësisht opsioneve të faktorëve ndërkombëtarë për zgjidhjen e çështjes së Kosovës. E këta faktorë ndërkombëtarë, edhe disa vjet pas Konferencës për Kosovën në Rambuje, ishin kundër idesë së pavarësisë së Kosovës. Përjashtim këtu bënte LPK, baza ideologjike për të gjitha celulatat e UÇK-së, mbi themelet e së cilës pastaj u ngritën partitë që vinin nga formacionet luftarake të saj si PDK-ja, apo AAK-ja.

Lidhja Demokratike e Kosovës ishte subjekti i parë më i rëndësishëm i pluralizmit shqiptar në vendin tonë, i cili përfshiu në radhët e veta disa nga intelektualët dhe akademikët më të rëndësishëm të jetës sonë publike si Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Zekeria Cana, Anton Çetta, Zenun Çelaj, Ibrahim Berisha, Milazim Krasniqi, Ali Aliu, Ramiz Kelmendi, Nekibe Kelmendi, e shumë të tjerë që për arsye vendi s'po ua përmendi emrat. LDK, e drejtuar nga stili i qetë i Presidentit Rugova, me kahje ndërtimin e një sistemi paralel me atë diktatorial të Serbisë, e formësuar nga dituria dhe aktiviteti i pabujë, por thelbësor i Fehmi Aganit dhe i shumë të tjerëve, ishte pa dyshim dëshmi e aftësive të shqiptarëve për shtetformim. Për të arritur tek shtetformimi, por dhe për ta ndërtuar atë siç u tregua më vonë. Ndaj mendoj se për startin e këtij tranzicioni të Kosovës prej 1989-s, nga Jugosllavia e Milosheviqit në një shtet të ri tonin, do të duhet t'i bëjmë në krye të herës homazh Ibrahim Rugovës. Ai ishte bartësi i parë institucional i idesë së shtetësisë së Kosovës që zu fill me lëvizjet e 1968-s, demonstratat e 1981-shit, dhe te fryma e lirisë që gjendej kudo në zemrat e kosovarëve brenda dhe jashtë Kosovës. Ngritja dhe frymëzimi prej tij i një sistemi paralel shoqëror apo parashtetëror brenda diktaturës serbe ishin prova e parë e aftësive shtetformuese të shqiptarëve. Ai shenjoi fazën apo ciklin historik që koha do ta identifikojë me emrin e tij. *Faza e Rugovës*. Ai e ndërkombëtarizoi çështjen e Kosovës me një stil të veçantë, ku detajet simbolike dhe pistat për t'u ndjekur ishin të përzgjedhura plot përkujdes prej këtij intelektual që kishte si profesion kritikën

letrare dhe teorinë e filozofisë. Shalli rreth qafës, modestia e shpallur, gurët - të rëndë, por dhe dëshmi e asaj për çka luftohej realisht në Kosovë, thjeshtësia në të folur, argumentat e kursyera, por efektive, paralelet e tij me figura të tjera botërore të lëvizjeve kombëtare apo të rezistencës, si Gandi, privilegjimi i kontakteve me botën katolike, ishin që të gjitha elemente të llogaritura mirë në filozofinë e tij politike. Edhe sot politikanët e mëdhenj botërorë që kanë folur me të, i mbajnë mend simbolet e Rugovës. Sigurisht në këtë që po them ka pak personalizim dhe nderim për një njeri që tashmë nuk rron. Rugova nuk ishte vetëm. Ai kishte afër tij personalitete të mëdha që e ndihmuan, e korrigjuan, e këshilluan, por përgjegjësia e njeriut që është i pari në rrethanat e shtypjes dhe të apartheidit që pllakosi Kosovën, duhet të vlerësohet me notë të lartë. Fara e ideve të tij, e mësimëve të tij, të grupit afër tij, që ishin të gjithë intelektualë që kapërcenin me përmasat e tyre Kosovën, u përhap në të gjithë shoqërinë tonë, te të gjitha partitë e reja që u krijuan. Aq e vërtetë është kjo, sa shumë mëtojnë për to, por askush s'mund të pretendojë në mënyrë vetjake meritat, pronësinë e këtyre ideve dhe mësimëve. Ata druaj se e kanë gabim - rugovizmi u shndërrua edhe pa lejen e bartësit të tij, në frymë: fryma është diçka e pakapshme. Ajo nuk shihet, nuk preket, por bartet në mënyrë mistike. Ndoshta s'e shpjegoj mirë, por besoj se po them diçka të vërtetë, diçka që e ndiej, ani pse paksa të idealizuar. Jemi një shoqëri që ka nevojë për simbole dhe Rugova megjithë gabimet e veta, është një simbol që na duhet. Unë nuk po pretendoj të shkruaj një libër shkencor, unë po përcjell veç fakteve historike, dhe mendimet e mia, dhe dijenitë e mia, dhe emocionet e mia, ku ndoshta gabo. Emocionet nuk janë baraz me të vërtetën, por janë njerëzore.

Përballë një diktature të egër si ajo e regjimit të Beogradit, rezistenca paqësore ishte megjithatë e pamjaftueshme. Ne nuk kishim kohë për të humbur më në robërinë serbe, sepse për ta mundur atë duhej përdorur edhe forca. Duhej lufta e armatosur dhe rugovizmi s'mundej ta zhvillonte atë. Djemtë dhe vajzat e UÇK-së, që u bënë theror, përshpejtuan historinë tonë dhe i dhanë jetë një faze të re, që zuri fill me sakrificën unike të Jasharëve. Kjo fazë sakrificash të përgjakshme u ndërtua rreth simbolit të tyre, të Jasharajve,

Pajazitëve, Haradinajve, Agim Ramadanit etj. Heronjtë e UÇK-së e afruan Kosovën dhe më tej me SHBA dhe Europën e qytetëruar, duke iu shmangur joshjeve të sirenavë të luftërave me bazë fetare si gjetkë në Ballkan, dhe duke përqaftuar vlerat perëndimore. Kjo ishte fitorja më e madhe strategjike e shqiptarëve - Aleanca me perëndimin. Udhëheqësia e UÇK-së, ashtu si dhe Rugova mund të kenë bërë dhe gabime dje në luftë, apo sot në qeverisje, ku gjenden në një mënyrë ose në një tjetër prej dhjetë vjetësh. Por në fazën historike që mban emrin e saj, *Faza e UÇK-së*, kjo udhëheqësi solli bashkë me perëndimorët njëherësh Lirinë dhe Pavarësinë. Mu për këtë ne duhet t'i nderojmë ata!

Sot që ne kemi arritur dhe lirinë dhe pavarësinë, unë mund të them: UÇK-ja dhe lufta e saj nuk u mbështet sa duhet me lëvizje dhe veprime politike e diplomatike të atyre që e kishin mundësi dhe që e kishin obligim ta bënin këtë dhe kjo vlen për LDK-në, ndërsa partitë e tjera më të vogla, si ajo Republikane apo Lëvizja e Bashkuar Demokratike e Kosovës (LBD) e mbështetën. Adem Demaçi ishte një lloj lideri shpirtëror i saj. Kryesorja është megjithatë se këto dy alternativa për zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare nuk shkuan në ballafaqim të ashpër me njëra-tjetrën, siç ka ndodhur gjetiu, ndërsa sa për fërkimet midis tyre, mungesën e mbështetjes, këto janë dukuri që e kanë përcjellë Kosovën vazhdimisht.



## Kthimi im në Kosovë dhe kontaktet e para me politikën

*Kontributet e mia të para politike nëpërmjet aktivitetit kombëtar. Kontaktet me Presidentin Rugova dhe admirimi i thellë për idetë e tij politike, kontaktet me familjen e tij, me familjen Jashari, etj. Kontributet e para në jetën ekonomike dhe sociale të vendit me biznesin tim që punësonte, prej viteve 90, mijëra njerëz, apo dhe me forma të tjera për të cilat po flas apo do t'ia lë kohës të flasë drejtësisht.*

**N**ë këtë rrëfim, më shumë se një herë e kam theksuar se vokacioni im nuk ka qenë politika. Mundësitë për të hyrë në politikë m'u kanë ofruar që herët, që kur pata filluar punë në Gjilan, këtu e afro tridhjetë e pesë vjet më parë, por gjithnjë e konsideroja veten të huaj në këtë fushë, për mua krejt të panjohur dhe në njëfarë dore edhe refuzuese. Puna e gjatë në ekonomi-biznes më mësoi të isha pragmatik dhe i drejtpërdrejtë. Kisha përshtypjen se në politikë njeriu duhej të ishte i mbaruar nga një "lëndë" tjetër, të ishte më shumë evaziv, të fliste shumë dhe të bënte pak dhe, mbi të gjitha, të kishte një kod tjetër moral, i cili nuk i përshtatej edukatës sime. Përveç kësaj, kisha përshtypjen se njerëzit merreshin me politikë për të kompensuar mungesat e ndryshme, që mund t'i kishin në fushën profesionale. Ndërsa mua më dukej se nuk kisha mungesa të tilla. Mbi të gjitha, fusha në të cilën unë kisha vepruar për një kohë të gjatë, shumë shpesh gjendej nën trysninë e politikës dhe po kaq shpesh vuante pasojat e saj. Ky fakt më shkaktonte refuzim ndaj politikës dhe ndaj njerëzve që merreshin me këtë aktivitet.

Pra, me një fjalë, për mua politika ishte një veprimtari, në të cilën nuk kisha menduar se do të përfshihesha ndonjëherë. Kjo nuk përjashtonte mundësinë që unë, herë pas here, të kisha konceptet e mia politike dhe të ndërtoja vizionin tim politik, varësisht nga situata dhe rrethanat, por ishte vizion që do ta mbaja përbrenda dhe jo të përpiqesha ta jetësoja me instrumente të tilla si partitë. Përvoja jetësore dhe përvoja e gjatë në fushën e biznesit, për shkak

të ndërlihdhjeve biznes- politikë, ma kishin bërë të domosdoshme ndjekjen thujse të vazhdueshme të zhvillimeve politike në përmasa globale. Pa një sens politik do ta kisha shumë të vështirë t'i kapja trendet ekonomike, qoftë në Lindje, qoftë në Perëndim. Dinamika e zhvillimeve përgjatë tridhjetë-dyzet viteve të fundit ka qenë e tillë, saqë ishte e pamundur të mos i kuptoje gjërat në varshmëri me ngjarjet politike dhe të zhvillimeve sipas logjikës së saj.

Por, me gjasë, më shumë se çdo rrethanë tjetër, nevojën për të menduar politikisht dhe për të njohur zhvillimet në këtë fushë, si shumicën e njerëzve të tjerë te ne, ma ka imponuar çështja e pazgjidhur e Kosovës, në një periudhë më të hershme, gjatë viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, dhe situata pezull e po kësaj Kosove në periudhën e mëvonshme, pra në dekadën e parë të shekullit XXI. Gjatë viteve nëntëdhjetë askush nuk mund të ishte indiferent se çfarë do të ndodhte me Kosovën e mbetur në udhëkryq dhe të kërcënuar në një shkallë të lartë. Për atë që ndodhte në Kosovë dhe rreth Kosovës në atë periudhë, të gjithë, në njëfarë mënyre, mund të ishim përgjegjës. Ata që tashmë kishin marrë mbi vete rol politik, përgjegjësinë e kishin më të madhe, por as ne të tjerët nuk mund të rrinim të patrazuar. Gjatë viteve nëntëdhjetë, e shihja gjendjen e rëndë të njerëzve dhe nuk mund të rrija indiferent. Shihja si rrugët e Perëndimit mbusheshin me djem të rinj të ikur nga Kosova dhe nuk mund të isha i qetë. Dëgjoja për ndodhi të ndryshme, që kishin të bënin me fatin e njerëzve tanë dhe, sado larg që isha, nuk mund të mos ndieja trazim në shpirt. Këtyre njerëzve u duhej dhënë një atdhe mikpritës, një vatër ku të ktheheshin, një shtet i dinjitetshëm. Gjatë viteve nëntëdhjetë, unë e dija, fjala vjen, se gjendja sociale në Kosovë ishte tepër e rëndë dhe se varfëria e madhe rrezikonte të na çonte në situata edhe më të vështira. Më e këqja mund të ndodhte, që vendimet e rëndësishme politike të njerëzve të Kosovës mund të merreshin nën tryshninë e gjendjes së rëndë sociale. Ky kishte qenë edhe synimi afatgjatë i Serbisë: ta detyronte Kosovën të gjunjëzohej, të nënshtrohej politikisht, duke e mbajtur në prapambeturi e varfëri. Çfarë mund të bëja unë ndërsa merresha me biznes? Bëra më së pari atë që kisha në dorë: mora punëtorë nga Kosova dhe i çova në vendpunishte të ndryshme, duke u gjetur punë tre mijë njerëzve njëkohësisht, numër

që u rrit shumë më pas, rrogat e të cilëve vinin direkt në Kosovë, te familjet e tyre, pa të drejtë që ata t'i "shpërdoronin" në çfarëdo mënyre. Me vetëm 10% të atyre parave, unë mund të paguaja fuqinë punëtore në vendet ku kisha kantieret e ndërtimit. Por këtë nuk e bëja, sepse e dija se sa nevojë kishte Kosova për ato tre mijë rroga në muaj. Këtu është bash vendi të tregoj diçka për mënyrën sesi i paguaj unë punëtorët që vijnë nga Kosova apo nga Shqipëria. Thjesht vetëm përgatitjet për vizat, gjetja e biletave fluturuese dy herë në vit, veshmbathja e punës, kujdesi shëndetësor, ushqimi, fjetja, transporti i brendshëm, e përkujdesjet e tjera, pos pagave, kushtojnë shumë para dhe krejt këto shpenzime do të ishin në favor të firmës nëse unë do të zgjidhja punëtorë vendorë. Ndërsa përsa u përket rrogave, një punëtor i zakonshëm përveç beneficioneve merr mesatarisht 1800 franga zvicerane, ndërsa stafi teknik diku rreth 3500 franga. Stafi i inxhinierëve nis nga 4000 frangat, shkon te 6000, 8000 franga apo pa kufizim për profesionistët e nivelit më të lartë. Rrogat e tyre thuajse nuk shpenzohen përveç një avance të vogël që ne u japim punonjësve. Ato shkojnë neto në favor të familjeve në Kosovë, sepse ne ua paguajmë çdo tre muaj drejtpërdrejt. Mund të ketë ndonjëherë ndonjë vonesë të parashikueshme, kur pagesat mbi bazë projekti prej kontraktuesit bëhen jo sipas planifikimit, diçka që nxit dhe spekulime, por në përmasa të tilla pune janë normale. Ky është një moment tjetër që nxit punonjësit tanë të kursejnë dhe paratë destinohen posaçërisht për ekonominë familjare dhe vendore në Kosovë. Kontributi i *Mabetex-it*, kuptohet më mirë po të mbahet parasysh se gjithë të angazhuarit janë në role profesionale të cilët mund të gjenden në tregun lokal të punës, me pagesa 60% më të ulta, pa folur për mungesën e shpenzimeve të tjera ndihmëse, si strehimi, udhëtimi, etj. Por ne nuk e bëjmë këtë me ndonjë pishman, sepse jemi shumë të lumtur që punonjësit tanë janë më së shumti shqiptarë, përveç arsyes kombëtare, pra dëshirës për të ndihmuar vendin tonë, kombin tonë. Ne jemi mësuar të punojmë me ta, ata janë fleksibël, ne jemi krenarë që punojmë me ta. Punonjësit e *Mabetex-it* janë shumë të vlerësuar nga ndërmarrjet e tjera nëse kthehen në atdhe për të punuar, për cilësinë e lartë të punës së tyre.

Po çfarë kam bërë tjetër për Kosovën? Nga fundi i viteve nëntëdhjetë, atëherë kur tragjedia e njerëzve në Kosovë mori përmasa të frikshme,



*Me Presidentin e Kosovës, z. Ibrahim Rugova*

një tragjedi, e cila tashmë shihej qartë në horizont. Unë nuk kisha ambicie politike dhe as synoja të bëhesha faktor vendimmarrës për fatin e Kosovës. Kisha vullnetin e mirë dhe një mundësi që m'u hap përpara. Isha i gatshëm të rrezikoja, madje edhe të keqkuptohesha nga bashkëkombësit e mi, vetëm e vetëm të shpëtoja jetë njerëzish.

Pra, afrimi im me politikën në Kosovë në atë moment ishte rezultat i këtyre rrethanave dhe jo i ndonjë vokacioni ose i dëshirës sime për të bërë karrierë në këtë fushë. Madje, mund të them se nuk e dua politikën dhe karrierën brenda saj si qëllim në vetvete. Atë e shoh më shumë si një instrument për të realizuar një qëllim të rëndësishëm: zhvillimin ekonomik dhe prosperitetin e përgjithshëm të Kosovës, që është ideali im i vetëm në politikë.

Nëse politika dikujt i shërben për të bërë mirëqenie personale dhe familjare, atë nuk e dua, sepse një të tillë e kam prej kohësh. Më duhet mirëqenie për popullin tim.

Nëse politika dikujt i duhet për të bërë emër, as kjo nuk më duhet, sepse tashmë edhe atë e kam.

Mua politika më duhet që Kosovën ta nxjerrim nga kjo prapambeturi dhe t'i hapim asaj perspektivë, duke e bërë kampione të

ashtu sikundër e kam shpjeguar, ndërmora veprimin politik më të rrezikshëm dhe më të pamiradijshëm në jetën time: pranova të takohesha me Milosheviqin, të ulesha ballë për ballë me të, duke tejkualuar urrejtjen që e kisha përbrenda, vetëm për një arsye - të shpëtoja sa më shumë jetë njerëzish dhe t'i zvogëloja sadopak vuajtjet e tyre, duke synuar të parandaloja

rajonit në zhvillim ekonomik dhe prosperitet. Ky është ideali im dhe kjo ka qenë arsyeja e përfshirjes sime në politikë. Në këtë objektiv s'mund të arrija asgjë, nëse do të isha i vetmuar, megjithë fuqinë time ekonomike, kështu që duhet të gjeja miq rrugës, për të ecur përpara. E dija që isha i papërshtatshëm për politikën me sinqeritetin tim që mund të lexohet si naivitet. E dija që ata që konsideroheshin si politikisht korrektë, do të keqpërdornin mendimet e mia të çiltra, siç ndodhi shpesh me mua, por isha i pajisur me durim. Unë kisha një model të tolerancës nga politika kosovare që ishte Rugova. Pa përmendur që nga jeta e gjatë në Perëndim kisha mësuar disa principe të të bërit politikë, që nëse nuk do të më shërbenin për të patur suksese politike, do të më nderonin, do të ma ruanin fytyrën. Unë kisha mbi të gjitha parime morale të shëndosha, që vinin prej edukatës së thjeshtë, por të pastër të të parëve të mi, që nuk i kisha zbehur edhe në betejat e zhvilluara në biznesin tim, ndaj s'kisha kohë *me u korit* në politikë. Me gjithë këtë bazament parimesh, pasi u mendova gjatë me veten, thashë se mbase në një politikë të re, në një vend të ri si Kosova, do të kishte vend për një politikan atipik si unë. Do ta shpjegoj më tej pse unë isha dhe mbetem politikan atipik, por këtu doja të kujtoja një maksimë të dikujt që thoshte se *politika është një çështje shumë serioze për t'ja lënë vetëm politikanëve*. Dhe me këtë maksimë, apo me të tjera, me idetë e mia në mendje, thashë se ndoshta ja vlen t'i futem politikës. Si protagonist i dorës së parë! Sido që të jetë, për arsyet që i përmenda më sipër, gjatë këtyre njëzet viteve të fundit kam mundur të jem i shpeshtë në qarqet politike të Kosovës dhe njerëzit e këtij profili t'i njoh nga afër. Nga të gjithë politikanët e Kosovës, me Rugovën e kam pasur njohjen më të hershme. Me të kam pasur rast të takohem disa herë në Lugano, diku në fillim të viteve nëntëdhjetë. E mbaj mend se me Rugovën, atëbotë, kemi kaluar disa ditë të bukura së bashkë me disa aktivistë të LDK-së të degës në Zvicër. Kemi biseduar për gjëra të shumta, por kryesisht për agjendën e udhëtimeve dhe takimeve të tij në vende të ndryshme. Natyrisht, zhvillimet në Kosovë kanë qenë temë e pakalueshme e bisedës. Shtetbërja e Kosovës ka qenë preokupimi i Rugovës, sepse ishte koha pas Deklaratës për Republikën e Kosovës. E kam takuar edhe në vitin 1994, këtu në Kosovë, në selinë e Shoqatës



*Në hapjen solemne të Universitetit Amerikan në Kosovë. Ndihmova për ndërtimin e këtij institucioni, në një moment kyç të vendit, duke treguar vizionin tim për llojin e arsimit të lartë që i duhej Kosovës. Ndjeva dhe nostalgji: aty pranë ishte shkolla ime e rinisë.*

shkrimtarëve. E kam takuar edhe në vitin 1997, përsëri në Lidhjen e Shkrimtarëve, pas një aksioni që ndërmorën bashkëpunëtorët e tij për të mbledhur donacione për shtëpinë e tij. Këtij aksioni iu kam bashkëngjitur edhe unë, bile fuqishëm. Jam i bindur se për këtë aksion Presidenti Rugova nuk ka ditur dhe dikush ndoshta e ka shfrytëzuar për vete.

Por njohjen më të mirë dhe takimet më intensive me Rugovën i kam pasur pas luftës. E kam takuar në vjeshtën e vitit 1999, pas kthimit nga Italia. Atëbotë, Rugova kalonte një periudhë të rëndë, sepse kishte vështirësi në marrëdhëniet me Hashim Thaçin dhe nuk njihej botërisht si President dhe as ishte konfirmuar si President nga autoritetet e qeverisjes së përkohshme. Shihej qartë se ishte shumë

i lënduar, gjë që nuk e meritonte ai njeri që edhe nëse mund të kishte gabuar diku, kishte punuar, investuar dhe sakrifikuar shumë për pavarësinë. Edhe në vitet vijuese e kam takuar herë pas here. E mbaj mend se në njërin nga ato takime është shprehur shumë i brengosur për vrasjet politike që po ndodhnin në Kosovë, veçmas të disa bashkëpunëtorëve të tij. Këto takime të miat me Rugovën lidheshin kryesisht me një dëshirë timen shumë të madhe: që të kthehesha në Kosovë. Por nismat e mia, për të cilat unë kërkoja mbështetjen e Rugovës, kanë mbaruar aty, në kabinetin e tij, për arsye se njerëzit që kanë qenë afër tij, nuk kanë funksionuar si duhet. Ata kishin krijuar një lloj kordoni sanitar rreth tij, që e kishte izoluar, thellësisht xhelozë për të tjerët si unë, që ishin jashtë skemave të tyre ekzistenciale. Ata e informonin keq, i përkëdhelnin sedrën, i përdornin autoritetin, i manipulonin gjykimet, apo ia deformonin ato. Ndoshta diçka normale mes politikës tipike.

Unë e vlerësoja shumë Rugovën jo thjesht në ndikimin e prindërve të mi, të lidhur politikisht me të. Unë që vija nga biznesi, e çmoja shumë qartësinë e ideve politike, e ideve ekonomike, e ideve për bujqësinë, që artikulonte ai dhe grupi i intelektualëve afër tij, ku sigurisht dua të shquaj Fehmi Aganin, një lloj truri politik i LDK-së, autorin e shumë dokumenteve politike të kësaj partie nënë të disa partive. Vlerësoja shumë sesi ai intelektual i sofistikuari operonte me shprehje të thjeshta kur vinte koha për t'iu drejtuar popullit. Ai ishte një dikush që nuk shau kurrë asnjeri, por që i luftonte kundërshtarët dhe rivalët e tij me anë të heshtjes, d.m.th injorimit publik. Askush nuk mund të gjente në shprehjet e tij publike diçka të keqe për kundërshtarët, kritikët apo drejtuesit e alternativave të ndryshme politike në raport me të tijën. Për mua që jetoja në Perëndim ishte motiv krenarie të kisha si pikë referimi për vendin tim, një personalitet të tillë të gjithëpranuar në shtetet europiane dhe SHBA për filozofinë e tij të veprimit politik, që ishte unikale për viset tona ballkanike. Për mua që vija nga biznesi, që kisha reflektime të thella për modelin e zhvillimit të Kosovës, do të ishte ideale të punoja me një njeri si ai. Ishte pikërisht ky afinitet ideor dhe programor, që tërhoqi dhe tërheq dhe sot votuesit tipikë të LDK-së, në partinë tonë AKR.

Në këtë vazhdë të njohjes me Rugovën, dua të them se takimin e fundit me të e kam pasur në vitin 2005, atëherë kur ia dorëzova projektin e godinës së Presidencës, pra të “Shtëpisë së Bardhë” siç kishte dëshirë ta quante ai. Rreth këtij projekti, më duhet të shpjegoj se pas kësaj, dikujt nga bashkëpunëtorët e tij i shkrepni në mendje që të hapej një tender dhe që tenderi t’i jepej një firme italiane, të cilës i është dashur t’i paguhen një milion e tetëqind mijë euro vetëm për projekt (nuk e di nëse i janë paguar ose jo), në një kohë që unë ua ofrova falas. Kjo ishte një çmenduri tjetër e këtyre njerëzve: i jepeshin para një firme italiane dhe nuk lejoheshin unë që ta ndërtoja, unë që kisha ndërtuar një kompleks ndërtesash administrative politike si Kremlini apo diçka tjetër në Kazakistan etj. Por unë e di se projekti që i ofrova Rugovës për rezidencë ka qenë shumë i bukur dhe i përshtatshëm në të gjithë parametrat. Ishte dëshirë e flaktë imja, që ta përkryeja projektin dhe atë ndërtesë ta ndërtoja me një donacion timin dhe ta shihja si banorin e parë të saj, Presidentin Rugova të ndjerë, që ishte munduar shumë për këtë që ne gëzojmë sot në Kosovë. Edhe përkundër kostos së madhe që kishte ndërtimi i saj, unë për Presidentin Rugova do ta bëja. Këtë projekt e kam futur në librat e mia, që së paku aty të kem një kujtim të merituar, pasi dëshira ime ishte shumë e madhe për të realizuar këtë projekt. Ky është një nga projektet për të cilin marr lëvdata gjithandej kur e shohin në letër.

Më kujtohet biseda me të kur u inaugurua një projekt urbanistik në një zonë ku mendohej se gjendeshin themele të Ulpianës antike, diku gjatë rrugës Prishtinë-Shkup. U gëzua shumë dhe shihte me sy të mendjes sesi nëpërmjet jetësimit të atij projekti, vendbanimet shqiptare fitonin vazhdimësi në atë zonë.

Pas vdekjes së të ndjerit President Rugova, respekti mbetet te familja e tij, te zonja Rugova, te vajza dhe djemtë e tij. Kohët e fundit, isha edhe në një vizitë familjare dhe prej tyre u prita në mënyrën më fisnike. Mbeta shumë i nderuar. Zoti e bekoftë këtë familje. Jam takuar shpesh dhe me fëmijët, Ukën veçanërisht, të cilit i uroj suksese të mëdha në politikë, megjithëse parashoh vështirësi të mëdha për të.

Respekt shumë të madh kam për familjen Jashari. Kjo familje ka dhënë çdo gjë për Kosovën. Shumë herë mendoj dhe kam një drojë



se Kosova asnjëherë nuk do të jetë në gjendje t'ia kthejë atë që kjo familje bëri për ne. Baca Rifat, është gjithmonë po ai i njëjti, mikpritës i madh dhe njeri me zemër të hapur. Sa herë e kam vizituar, jam ndier thellësisht mirë. Gjithmonë jam munduar që të ndaj dhimbjen me këtë familje, por gjithmonë e më shumë krenohem me këtë familje. Inteligjenca, mirësjellja dhe thjeshtësia e Muratit, si përfaqësues i denjë i kësaj familjeje të madhe kombëtare, tregon qartë nivelin e lartë të edukatës, mirësisë, që mbretëron mes Jasharajve. Kosova ua shpërbleftë për të mirë!

Dhe pas vlerësimeve mbi dy simbole të Kosovës moderne, dua të tregoj diçka përmbledhurazi rreth asaj që nisa të bëja pas çlirimit. Angazhimi im praktik në jetën sociale dhe ekonomike filloi me financimin në formë donacioni të ndërtimit të qendrës së TMK-së, që më vonë u bë si ambulancë e TMK-së, aty ku tani është vendosur Gjykata Kushtetuese. Këtë e bëra me shumë dëshirë, sepse së pari duhet ditur se ajo godinë dikur ka qenë një ambulancë ushtarake e Jugosllavisë dhe ta shndërrojë atë në ambulancë të TMK-së, ishte një fitore jona simbolike mbi atë të shkuar të errët. Së dyti, TMK-ja për mua ka qenë dhe mbetet simbol i pavarësisë dhe i shtetit të Kosovës. Ajo për shumë vjet ka qenë krenaria e jonë, me të cilën mburrshim të gjithë. Ky ka qenë edhe motivi, që, po ashtu në formë donacioni, kam bërë uniformën e TMK-së jo vetëm një herë, por disa herë. Uniformat i kemi bërë në Gjakovë, në Fabrikën e Konfeksionit, duke u dhënë punë edhe punëtorëve të saj, ndërsa materialin e kemi porositur jashtë. Me këtë rast jam njohur me Agim Çekun, por kjo njohje nuk ka qenë aq intensive. Më vjen keq sidomos që nuk jemi njohur më mirë para zgjedhjeve. Sot para zgjedhjeve të 2010, e që ai është bashkë me ne në listat tona, jam shumë i lumtur që mund të bashkëpunoj me të në favor të Kosovës dhe t'i sjell parlamentit të Kosovës një figurë kaq popullore!

Afërsisht, këto kanë qenë rrethanat e kontakteve të mia të para me politikanët e Kosovës, diku shumë të mira, diku më pak të mira, ndonjëherë edhe zhgënjyese. Me këtë dua të konfirmoj atë që thashë pak më sipër se botën e politikës në Kosovë fillova ta njoh për së afërmi shumë kohë përpara se të vendosja që edhe vetë të bëhesha pjesë e saj. Gjatë kontributeve të para për ngritjen e jetës së shtetit të

ri, ndihmave për familjet e varfëra, familjet e dëshmorëve, ngritjen e Universitetit Amerikan të Kosovës, pajisjes së TMK-së etj. etj. pata rastin të vendosja kontaktet e para dhe të njihja shumë prej protagonistëve të kësaj bote.

\*\*\*

Ka diçka që nuk ka mbarim dhe këto janë sakrificat dhe vuajtjet e njeriut. Shpeshherë këto fillojnë dhe nuk kanë fund, pasi që fundi i tyre nuk varet vetëm prej personit që i përjeton ato. Në të shumtën e rasteve, të tjerët ia imponojnë vuajtjen dikujt. Një e padrejtë e madhe! Falë edukatës sime familjare dhe mjedisit në të cilin jam sjellë gjatë jetës time, jam munduar gjithmonë që nëse dikujt nuk kam mundur t'i ndihmoj, bile të keqen mos t'ia bëj. Gjyshi im i ndjerë thoshte: bir, nëse ke mundësi, ndihmo. Bile edhe pjesën më të madhe të një diçkaje, mos e mbaj për vete, por jepja dikujt. Ai shpesh më thoshte: një dorë e mbyllur nuk është në gjendje as të japë e as të marrë. Në jetën time kam mësuar gjithmonë që sa më tepër të japësh, aq më tepër ke për të marrë. Ndoshta kështu janë ligjet e natyrës!

Falënderoj zotin, por dhe mësuesit e parë në familje që unë gjatë jetës time kam mundur të ndihmoj. Në jetën studentore, isha iniciator i shumë organizimeve për të mbledhur fonde simbolike, për njerëzit në nevojë. Gjatë viteve '80, pothuajse çdo vit organizoja, ekskursione nga e tërë bota, për në Zvicër, për grupet e fëmijëve që nuk kishin mundësi ekonomike për të parë Zvicrën. Këta fëmijë ishin nga familje shumë të varfra dhe me të meta fizike. Qëllimi i ardhjes së tyre në Zvicër, ishte që atyre t'u ofrohej, sado shkurt, një mjedis tjetër dhe shërbime intensive nga mjekët. Këto grupe përbëheshin nga 160 fëmijë, rrinin tri javë dhe ktheheshin dhe zëvendësoheshin me grupin tjetër. Në fillim të viteve '90, kur filluan edhe ndryshimet sociale nëpër botë, u paraqit një fenomen i ri, ku nënat, lindnin dhe për shkak të kushteve të rënda ekonomike, nëse fëmija ishte me të meta, ato e braktisnin. Në Jakutsk, me një rast të tillë edhe u ballafaqova personalisht. E pashë nga makina një vajzë të re që hodhi diçka në kontenier. U kuptua se bëhej fjalë për një fëmijë të vogël. Nga ky moment, vendosa që të ndër marr një iniciativë që

këta fëmijë që braktiseshin të grumbulloheshin, gjegjësisht nënat që dëshironin t'i braktisnin, t'i sillnin në një vend të caktuar. Në një periudhë prej 5 muajsh, ndërtova një spital, me mjetet e mia, me një kapacitet prej 102 vendesh, me gjithë infrastrukturën, që të shërbente si vend grumbullimi për këta fëmijë. Shumë shpejt, u mbush ky spital. Fëmijët janë të gjithë me aftësi të kufizuara dhe, pjesërisht, këtyre u garantohet shërimi nëpër spitalet e perëndimit. Ky vend është edhe qendër për shumë njerëz nga bota, që dëshirojnë të adaptojnë fëmijë. Ky nuk ishte investim i vogël, por kushtoi mbi 6 milionë dollarë. Ky institucion funksionon edhe tani. Në Budianovsk të Kaukazit, ku pjesa më e madhe e popullatës është myslimane, në vitin 1999 u sulmua një spital i fëmijëve. Vdiqën shumë nëna dhe fëmijë. Fondacioni im edhe këtu kontribuoi me miliona për familjet që ishin pjesë e këtyre viktimave.

Në Kosovë veprimtaria humanitare për t'u ndihmuar njerëzve që kanë nevojë, ka funksionuar gjithmonë. Edhe gjatë viteve të '80, '90 e tëhu. Fondacioni im ka mundësuar shërimin e mijëra e mijëra pacientëve që kishin nevojë dhe kjo më bën shumë të lumtur. Një gjë të tillë vazhdojmë ta bëjmë edhe sot e kësaj dite edhe pse kjo ndihmë është shumë simbolike për përmasat kosovare. Më bën shumë të lumtur fakti që qindra mijëra njerëzve të Kosovës, mijëra familjeve, mund t'u garantoj burime të ardhurash, gjegjësisht punësim për ta. Që nga fillimi i viteve '90, me mijëra punëtorë nga Kosova punojnë nëpër firmat e grupit *Mabetex* nëpër botë. Kur i paramendoj sakrificat e mia për ta mundësuar këtë, kushtet e vështira të punës, si dhe sakrificat e punëmarrësve kosovarë, duhet të them se janë të poshtra kritikrat dhe polemikat e disa njerëzve që për qëllime të tyre personale dëshirojnë të politizojnë për vendin në të cilin punohet dhe sigurohen këto të ardhura. Këtyre njerëzve u shtroj një pyetje të thjeshtë: nëse nuk u pëlqen vendi ku unë i çoj për të punuar bashkëkombësit e mi, pse ata nuk kanë bërë asgjë që ata të punësohen këtu? Opinioni publik i Kosovës i njuh mirë kush janë këta njerëz dhe i njuh mirë qëllimet e tyre. Është fisnikëri e madhe të punosh me dinjitet e sinqeritet, pa marrë parasysh ku punon. Puna nuk duhet asnjëherë të politizohet apo të përqeshet. Ajo nuk ka të bëjë me politikë dhe nuk duhet të politizohet.

### Statehood Resolution Opens Potential for Economic Development

“The western Balkans have a realistic prospect of moving beyond the political uncertainty and the intercommunal tensions that have held back the region for so many years,” according to an expert on the region, Janusz Bugajski, speaking in Washington October 5. Mr. Bugajski is Director of the New European Democracies Project at the Center for Strategic and International Studies (CSIS) in Washington D.C. He presided at the Conference on Economic Cooperation and Investment Opportunities in Southeastern Europe, held October 5 and 6.

“The region does have significant potential for economic development, for regional cooperation, for foreign investment and eventually for European Union integration . . . now that the remaining statehood questions are being resolved,” Mr. Bugajski said.

In his remarks to open the two-day conference, Mr. Bugajski said, “our conference is based on both optimism and realism” to consider economic prospects for Southeast Europe. “Unlike in previous years when we used to gather together to discuss instability, conflict, war in Southeast Europe, in the former Yugoslavia, we are here now to discuss



The founder of Southeastern European Economic Development Foundation Behgjet Pacolli speaks to conference sponsored by him in behalf of economic development for the Balkans. Seated beside Mr. Pacolli is Michael Mozur; his comments on a CEFTA expansion are reported on Page 2.

the future, which is the unleashing the human potential for progress and development in the region.”

He said that the “human potential” is strong among the peoples of the Balkans: “It is instructive how many Albanians, Bulgarians, Serbs and others excel when they emigrate, which demonstrates that what is missing in the region are the conditions and structures that can enable individuals

to flourish and economics to grow.”

He cited the career of Behgjet Pacolli, sponsor of the conference and a native Kosovar, as evidence. Mr. Pacolli is president of a Switzerland based general contractor, engineering and real estate development company with offices in 16 nations. “Behgjet,” he said, “is a living example of how entrepreneurial, hardworking and successful people from the Balkans really are.” Mr. Pacolli is the founder of the Southeast Europe Economic Development Foundation and of the Alliance for a New Kosovo. ■

#### Balkans Economies Need Kosovo Resolution

Continued from Page 1

in the region. But if these challenges are met, the Western Balkans’ future seems brighter than at any time in recent history,” she said.

For this to occur, there must be economic cooperation: “Trade is the key for this region. Small economies can succeed, but they must be open, competitive, and integrated with larger markets. This is not just theory. These features characterize all of the small economy success stories in Europe itself, from Ireland to the Baltics,” the Treasury official observed.

However, presently, intra-regional trade is limited, she said. “In 1993, intra-regional exports in

the Balkans accounted for only six percent of total exports. A decade later in 2003, intra-regional exports still accounted for only six percent of exports. Compare that with Southeast Asia where intra-regional exports account for nearly 25 percent of total exports.”

Intra-regional trade should be attainable, she said, stating, “Theory suggests that countries tend to trade more if the size of their economies is similar, if distances are short, if they share borders, and if common languages facilitate business transactions. Countries in close proximity should have more similar spending habits than those that are far apart. All of these conditions apply to the Balkans.” ■



New European Democracies Project Director Janusz Bugajski introduces Behgjet Pacolli at opening of Conference on Southeastern Europe. See Mr. Bugajski’s comments above.

**Faqe e buletinit mbi punimet e Forumit Ekonomik për Kosovën në tetor 2006, organizuar nga Aleanca Kosova e Re dhe Qendra e Studimeve Ndërkombëtare Strategjike në Uashington. Unë e shihja ekonominë si ilaç plotësues për problemet e rajonit**



*Nga punimet e konferencës së Aleancës Kosova e Re në Uashington, mars 2009. Me mua janë prof. dr. Ibrahim Gashi dhe Avni Spahiu, ambasador i Republikës së Kosovës në SHBA.*

Angazhimet e mia humanitare nuk janë ndalur vetëm këtu. Duke parë nevojën shumë të madhe të Kosovës për njerëz me shkollim dinjitoz kam financuar tërësisht ngritjen e Universitetit Amerikan, sot institucioni më i suksesshëm arsimor në Kosovë dhe ky tani ka filluar t'i japë frytet e para. Kam bërë zgjerimin e Fakultetit Filozofik, ku është mundësuar rritja e kapacitetit për pranimin e më tepër se 1000 studentëve në vit. Kam ndërtuar, rindërtuar, ndërtoj dhe rindërtoj shtëpi për skamnorët. Kam rindërtuar disa objekte të kultit, që njëkohësisht janë edhe trashëgimi kulturore.

Fondacioni "Behgjet Pacolli" vazhdon aktivitetin e vet, mirëpo edhe ky ka limitet e veta dhe sigurisht nuk mund t'i përballojë të gjitha kërkesat. Dikujt i shtyhet afati për këto ndihma e dikujt i refuzohet gjithmonë me besim që këta të fundit të kuptojnë se nuk mund të përballohen të gjitha. Kohët e fundit, në Zvicër kam hapur

edhe muzeun “Ibrahim Kodra”, për piktorin më të madh dhe njeriun që bashkë me Nënë Terezën, e ngre lart emrin e shqiptarëve. E njihja prej kohësh Ibrahimin, që e donte shumë Kosovën, ku mendonte se mund dhe të varrosej, e kam ndihmuar, vlerësuar dhe besoj shumë se koha një ditë do të flasë shumë mirë dhe shumë gjatë për të.

Këto fjalë për aktivitetin tim humanitar në shërbim të njeriut dhe paqes do të doja t'i mbyllja me diçka që thashë në ceremoninë e dekorimit tim me medaljen e Kalorësit të Paqes për Mijëvjeçarin, krahas figurave të tjera të shquara si Nënë Tereza, Koli, Gorbaçovi etj. “Ndërsa po dëgjoja motivacionin që shoqëronte titullin e Kalorësit të Paqes, u vura në mendime: çfarë kisha bërë unë që ta meritoja atë? Në mendje më erdhën fjalët e një burri të urtë, që ka qenë Presidenti më i ri i Shteteve të Bashkuara, më i suksesshmi, Teodor Ruzvelt: Bëj çfarë të mundësh, me çfarë të kesh, kudo që të jesh! Kjo ishte maksima e tij për paqen. Mendoj se kam bërë gjithçka kam mundur. Me çfarë kam pasur mundësi. Kudo që kam qenë.

Këtë titull që ju më dhatë, mund ta merrte shumëkush në Kosovë. E them këtë pa modesti të rrejshme. Në Kosovë ka shumë njerëz si unë. Ndaj unë jam ky që jam, sepse jam lindur dhe rritur në mes të këtij populli. Kush më njeh mirë, e di se unë shqetësohem shumë për popullin tim. Për njerëzit e mi. Për nënën time. Për vendlindjen time. Për qytetin tim. Për shtetin tim. Për gjithë njerëzit. Kudo që janë. Kjo vjen pse unë kam lindur në një familje të thjeshtë, por jam edukuar me parime të shëndosha. Të thjeshta, por që të çonin larg. Dhe mua më çuan larg, por asnjëherë nuk i ika Kosovës. Ndaj jam ky që jam! Kudo u kam shërbyer njerëzve, nga Jugu në Veri anembanë botës. Nga Lindja në Perëndim. Në Afganistan, në Ukrainë, në Zvicër, në Kosovë, në Bosnjë. Në Kosovë veçanërisht dhe më së shumti. Kudo. Nuk kam vrarë mendjen për kombësinë e tyre. Kam harruar dallimet. Kam parë vetëm njeriun. Unë jam pjesë e një populli që e do paqen. I një kombi që i dha botës Nënë Terezën, ndoshta kalorësen më të madhe të paqes dhe humanizmit në botë...”

## Një forum i vërtetë për Kosovën

*Pas studimit të thellë të realitetit ekonomik në Kosovë, menjëherë pas luftës unë mbledha në Zvicër, shumë ekspertë, vendimmarrës dhe njerëz të ekonomisë në Kosovë. Krijova FORK-un, organizimin që do të realizonte shndërrimet ekonomike në vendin tonë. Kisha studiuar modelet e tyre në vendet e Europës Lindore dhe modeli polak dukej më i përshtatshëm sesa ai gjerman. Disa ide për bujqësinë: si e mendoja unë atë në rrethanat e reja?*

**S**ic mund të kuptohej, Kosova në periudhën e pasluftës kishte nevojë për një hop cilësor, çka do të realizonte kthesë që në krye të herës në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Ata ishin të lodhur dhe të traumatizuar nga vuajtjet e okupimit dhe nga lufta, ndërsa ekonomikisht kishin humbur pothuajse çdo gjë.

Traumat e tyre, e dija se do të shëroheshin mbi të gjitha vetëm me mirëqenie ekonomike. Tërë ekonomia e Kosovës ishte jashtë funksionimit dhe përjetonte kolaps të vërtetë. Reformat ekonomike duhet të ndodhnin sa më shpejt. Fillimi i tyre ishte i kushtëzuar nga pronari, mbasi që ekonomia e Kosovës tani nuk kishte pronar. Para se të kërkohej pronari i ri, e dija se duhej të definohej objekti i cili duhej trajtuar. Pra kjo do të arrihej vetëm duke filluar evidentimin e të gjitha subjekteve ekonomike, duke definuar çka ato paraqesin, çka duhej të bëhej në mënyrë që ato të futeshin në funksion, cili do të ishte afati për këto veprime dhe sa do të kushtonin ato.

Ideja ime ishte se Kosova mund të ndihmohej në shumë plane njëkohësisht dhe ndihma do kishte efekt nëse njerëzit kudo që ishin, duhet të bënin punën e tyre më së miri. Unë me kohë, e kisha ndarë mendjen: zhvillimi ekonomik ishte fusha që më përkiste mua. Por nëse për të kontribuar në këtë zhvillim me statusin e ndërmarrësit isha i bllokuar, me statusin e politikanit, kisha një çelës më shumë.

Në kokën time sillleshin shumë mendime dhe kujtoja përparësitë dhe dështimet që kishin ndodhur në vendet e ndryshme të lindjes në këtë drejtim. Më kujtohej dështimi total i agjensisë së mirëbesimit të privatizimeve në Gjermaninë Lindore dhe po ashtu më kujtohej

rritja e mirëqenies ekonomike prej privatizimit në Poloni. Në rastin e Gjermanisë, çdo gjë ishte në shitje ndaj çdokujt, pa marrë parasysh kush ishte blerësi dhe çka do të bëhej me objektin që trajtohej. Këtu kishte një përparësi tjetër (që do t'i mungonte Kosovës në të ardhmen) se transaksionet financoheshin nga vëllai i madh, Gjermania Perëndimore (gjegjesisht nga shteti). 80% e këtyre privatizimeve ishin të dështuara dhe i sollën një humbje mbi 60 miliardë marka shtetit gjerman, ndërsa mirëqenia qytetare dhe punësimi nuk përfituan. Këto subjekte u trajtuan për herë të dytë dhe iu dhanë ndërmarrjeve të Gjermanisë Perëndimore. Shumica e tyre në Gjermaninë Lindore u mbyllën dhe krahët e lirë u punësuan nëpër ndërmarrjet e Gjermanisë Perëndimore. Investimet e mëdha të privatëve dhe të shtetit nga perëndimi e bënë të mundur që në njëfarë mënyre ekonomia e Gjermanisë Lindore të ringjallej. E dija, se një gjë e tillë në Kosovë nuk do ndodhte mbasi që Kosovës i mungonte vëllai i madh me investimet e tij - Shqipëria ishte e varfër dhe as që mund të mendohej se do lejohej ta bënte këtë edhe sikur të ishte e pasur. Shqipëria madje ishte e papërgatitur, për mundësitë e bashkëpunimit siç duket nga vëllimi i ulët aktual i shkëmbimeve ekonomike dhe mungesa e projekteve të përbashkëta. Nga ana tjetër studioja fenomenet e privatizimit në Poloni, të cilët e morën të mbarën. Në Poloni procesi nuk filloi me shitje, por u bë një parapërgatitje e shkëlqyeshme, u bë ligji adekuat për privatizim e posaçërisht për ndërmarrjet publike. Krahas hartimit të ligjit jo vetëm nga juristët, por edhe nga ekonomistët, u bë evidentimi i të gjitha ndërmarrjeve, dikur shtetërore, ku ishte e përshkruar çdo gjë; çka paraqet objekti - gjegjesisht subjekti ekonomik, cilat ishin mundësitë për t'i lëshuar, për t'u rivitalizuar, sa mjete dhe sa kohë do të nevojitej. Këto ndërmarrje iu besuan një agjensioni parashtetëror, të udhëhequr nga shoqëria civile me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverisë. Këtu punonin grupet profesionale, që veç e veç kishin formuluar kriteret e privatizimit të çdo ndërmarrjeje. Synimi kryesor ishte që blerësi i ardhshëm të ndihmohej me gjithë logjistikën që kishte ky agjension dhe çmimi të ishte solidar, çmimi i cili në të shumtën e rasteve do të kreditohej në mënyrë që blerësi i ardhshëm të mbetej më solid dhe paratë e tij t'i angazhonte në



zhvillimin e mëtejshëm të subjektit që përfitonte. Çmimi blerës do të paguhej pa interes bankar, atëherë kur blerësi i ri do të përfitonte nga subjekti që kishte privatizuar. Kështu Polonia arriti që 90% të strukturës ekonomike ta transformonte nga shtetërore në private duke ruajtur kapacitetin prodhues dhe duke shmangur humbjen e vendeve të punës. Procesin në Poloni e studioja nga afër dhe më intrigonte shumë. Doja që një gjë e tillë të ndodhte edhe në Kosovë. Ky kishte qenë edhe motivi, përse menjëherë pas luftës, në shtator 1999 kisha themeluar Fondacionin për Organizimin dhe Ristrukturimin e Kosovës, FORK, me të cilin synoja të jepja kontributin tim në ndërtimin dhe rindërtimin e Kosovës. Ftova dhe qeverinë e atëhershme, me ç`rast ftesës time ju përgjigjën pozitivisht Jakup Krasniqi, Ahmet Shala, Mazllum Komoni, Bujar Spahiu etj. Në Prishtinë dërgova aeroplanin tim, i cili i solli në Lugano. Pata ftuar dhe shumë ekspertë të tjerë nga diaspora. Ky fondacion u prezantua para mediave dhe u prit shumë mirë, gjë që ndikoi dukshëm në mbështetjen e tij. FORK-u merrte përsipër, sipas statutit të vet, që të shërbente si bashkëbiseduesi kryesor i bashkësisë ndërkombëtare për shpërndarjen e ndihmave, për deshtetëzimin e kompanive publike në shërbime, ekonomi, infrastrukturë etj., të ndihmonte në rindërtimin, në kapitalizimin dhe privatizimin e tyre. FORK-u mori përsipër gjithashtu të hartonte projekte në fusha të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë. Boshti i punës së tij, sipas statutit, ishte rindërtimi dhe fuqizimi i kompanive publike, menaxhimi i tyre sipas parimeve të efektivitetit dhe rentabilitetit dhe pastaj marrja e kontakteve me investitorët e huaj për të siguruar kapitalizimin dhe privatizimin më të mirë. FORK-u kishte dhe objektiva të tjerë si mbrojtja e mjedisit, miratimi i ligjeve të drejta etj. etj. Organizimi ishte modern, në formën e një fondacioni që drejtohej nga një bord me qendër në Prishtinë.

Ideja ime ishte që me ndërmarrjet shoqërore të Kosovës të mos ndodhte ajo që pikërisht ndodhi, çka praktikisht e shkatërroi ekonominë e Kosovës, kapacitetet e saj industriale duke prodhuar vetëm varfëri dhe asgjë tjetër.

Pse ndodhi kjo që unë e kisha parashikuar nisur nga eksperiencia ime? Në dokumentin statutor të Fondacionit FORK ishte e

përshkruar shumë qartë se si do të duhej të zhvillohej ky proces në Kosovë. Së pari duhej të rritej vlera e secilit objekt ekonomik, para se të hyhej në procesin e privatizimit. Po ashtu, fabrikat që kanë qenë gjysmë të shkatërruara, është dashur të bllokoheshin në atë gjendje dhe t'i besoheshin një organizate gjysmëqeveritare, pra as krejt qeveritare dhe as paraqeveritare, e cila do të përbëhej nga një staf ekonomistësh dhe inxhinierësh. Ata do të ishin të autorizuar të shkonin fabrikë më fabrikë, për ta marrë situatën në dorë, duke bërë një analizë ekzakte. Ta zëmë, fabrika e tullave në Prishtinë. Ekspertët do ta analizonin gjendjen e saj dhe do të propozonin masat. Që kjo fabrikë të rivitalizohet, ishin të nevojshme 300 mijë marka. Natyrisht që Kosova në atë kohë nuk i kishte ato para, prandaj do të ftonte privatët që të investonin dhe atyre do t'u jepej fabrika në dispozicion deri në momentin kur të ktheheshin paratë e investuara, përfshirë kamatat, fitimin etj. Po me këtë rast, nga ekspertët do të vlerësohej nëse ata që e kanë pasur në dispozicion fabrikën, kanë qenë në gjendje ose jo të punojnë si duhet. Nëse po, atëherë do t'u thuhej: ju mund të jeni kandidatë potencialë për ta blerë këtë fabrikë dhe paratë e blerjes nuk duhet t'i jepen askujt, por nën kontrollin e ekspertëve, do të investohen në fabrikë. Ky ka qenë modeli më i mirë, i cili është dashur të aplikohet. Por në Kosovë s'ndodhi asgjë nga këto.

Unë nuk u mora thjesht me teorira dhe diskutime doktrinare modelesh. Për të jetësuar konkluzionet e forumit ekonomik për Kosovën në Lugano, ashtu siç u parashikua në forum, me mjetet e mia financiare, dërgova në Kosovë një grup prej 30 inxhinierësh të lëmive të ndryshme, për 3 muaj. Këta vizituan çdo cep të Kosovës dhe çdo subjekt ekonomik. Në të kthyer, ky grup inxhinierësh bëri raportet për çdo subjekt ekonomik që e kishin vizituar. Nga këto raporte ishte e qartë: çka paraqet subjekti ekonomik, çka, si, kur dhe sa nevojitej për t'u rivitalizuar. Hapi i parë ishte përmbushur dhe duhej që hapi i dytë të bëhej në Kosovë me jetësimin e këtij fondacioni dhe fillimin e procesit. Ideja ime ishte që njëherë subjektet të rivitalizoheshin dhe të futeshin në punë, më tutje të gjendej blerësi potencial (adekuat profesionalisht), t'i jepeshin ato me kusht që puna të vazhdonte, të ruhej punësimi dhe të garantohej efektshmëria ekonomike, bile edhe

blerësi të kreditohej në mënyrë që paratë që ai zotëronte mos t'i harxhonte në blerjen e subjektit, por t'i investonte në zhvillimin e tij. Çmimi blerës mund të paguhej pa interes bankar mbasi që përfituesi do të kishte jetësuar subjektin e tij dhe prej tij do të kishte përfituar. Mua më interesonte që të gjeneronim sa më shumë njerëz të pasur në mënyrë që ata t'u ndihmonin të tjerëve.

Në vitin 2000 unë kam pasur rreth 40 milionë marka të garantuara për Kosovën, plus 20 milionë para të mia të gatshme. Futja e këtyre parave në punë, për vitet e ardhshme do të organizonte hyrje të kapitalit tjetër deri në 350 milionë. Atëbotë, e bëra projektin për Prishtinën e re, i cili besoj se edhe sot është diku në bodrumet e Komunës së Prishtinës. Qytetin e ri të Prishtinës, ose Prishtinën e re, e kisha planifikuar të ndërtohej në anën e djathtë të Veternikut, në atë shpatin që shkonte nga komanda e TMK-së e deri mbi kodrinë. Aty kisha planifikuar të bëhej një qendër afariste, qendër administrative dhe e biznesit, me një hotel luksoz, me garazhe, me tërë infrastrukturën, pra një qytet i ri me nja 30 mijë banorë. Jam përpjekur për realizimin e këtij projekti me tërë qenien time, por askush nuk deshë ta merrte në konsiderim. Sot, po të ishte përfillur ky projekt, e tërë administrata qeveritare do të kishte kaluar atje, me tërë infrastrukturën e saj dhe Prishtina nuk do të vuante këtë kaos që e ka aktualisht. Por jam sabotuar sistematikisht nga njerëz të klasës sonë politike, që e kanë parë me shqetësim këtë lloj hyrjeje apo rikthimi timin në Kosovë.

Modeli për të cilin unë dhe miqtë tanë punuam, nuk u pranua sepse me siguri ai nuk ofronte mundësi për përfitime për askënd, por ai do të siguronte një zhvillim të shpejtë të Kosovës. Unë ndërkohë isha i pajisur me tërë maturinë e nevojshme ndërsa i qasesha vendit tim. Nuk kisha as synimin më të vogël të kontrolloja jetën ekonomike të Kosovës, por doja t'i jepja një vrull të ri zhvillimit të saj. Doja që themelet e shtetit, e shtëpisë sonë të re, të ngriheshin në mënyrë të shëndetshme. Kur ngre një shtëpi duhet të kesh shumë kujdes me themelet: nuk mund të kthehesh më mbrapsht të korrigjosh gabimet. Unë këto i dija, prandaj u angazhova aq shumë. Ndërkohë me angazhimin tim ekonomik në Kosovë unë doja të shlyeja ato që i konsideroja si mungesa të mëparshme. Kush më mirë se unë, mund

të ndihmonte Kosovën në ato momente?

Por ndodhi si ndodhi, dhe u zgjodh mënyra dhe modeli më i keq i privatizimit, të cilin unë e kam urreyer, sepse kam qenë i bindur se do të ndodhte pikërisht ajo që ndodhi: u degraduan objektet, u ra vlera, u shpenzuan paratë e privatëve për blerje dhe tani as ka aktivitet prodhues, as ka investime në objekte. Për këtë çështje shumë herë kam biseduar me përfaqësues të UNMIK-ut, sidomos me Rykerin, (Joakim Ruecker, ish kryeadministrator i Kosovës), të cilin e kam pasur mik, por ia kam thënë se ai mban përgjegjësi shumë të madhe për mënyrën e keqe se si është bërë privatizimi në Kosovë. Pa folur për problemet që krijohen me përdorimin e fondeve të krijuara prej privatizimit, që mund të bëhet vetëm me kushte shumë të forta të parashikuara në planin Ahtisari, sa kohë që disponohen në funksion të kreditorëve. Me këtë sy kritik po shoh gjithë procesin e pritshëm të kompanive publike të mëdha për të cilin po flitet sot në Kosovë. Jam shprehur kundër këtij lloj privatizimi (PTK, KEK, Aeroport) apo koncesionimi jo transparent, që do të kryhet në vitin e fundit të mandatit të një qeverie, që shpreson se paratë do të përdoren për ndërtimin e rrugës Vërmicë-Merdare, për të cilën gjithashtu ka pasur mungesë transparence, projekti, paralogarish etj. etj. Jam shprehur gjithashtu kundër kthimit të parave nga privatizimi dhe atyre të Trustit pensional në arkat e qeverisë: ato para duhet të përdoren nëpërmjet një Agjencie të Ardhmërisë së Kosovës, apo të Brezave të kontrolluar nga parlamenti, shoqëria civile dhe prania e huaj në Kosovë dhe duhet të destinohen vetëm në projekte për të ardhmen. Thjesht për të treguar se jam koherent në idetë e mia, jo thjesht teorike, ditët e fundit të gushtit, me gjithë hallin e madh që më pllakosi me sëmundjen e nënës, kontaktova një grup financiar britanik. Ky ishte i gatshëm që t'i jepte kredi të favorshme prej 400 milionë eurosh PTK-së, në këmbim të manaxhimit të kësaj kompanie publike. Pas 6 vjetësh do të diskutohej me qeverinë. Kjo ishte një alternativë më e mirë se privatizimi i përfolur në periudhë krize globale dhe pa asnjë lloj plani.

E bëra këtë parantezë rreth privatizimit dhe fondeve të krijuara prej tij, për të thënë se politikat ekonomike në Kosovë, pavarësisht se prej kujt janë fuqizuar ato, kanë qenë dhe mbeten shumë të gabuara.

Këtë e them pa asnjë ekuivok, sepse në këtë fushë ndihem kompetent dhe i sigurt në konstatimet e mia. Unë arrij të kuptoj shumë qartë dhe thjesht sesa realiste janë ofertat për këtë ose atë privatizim apo koncesionim, sepse unë e njoh mirë tregun ndërkombëtar, njoh parimet e biznesit. Kjo situatë më ka shkaktuar vazhdimisht pakënaqësi, e cila shpesh është kthyer në brengë për të ardhmen e vendit tim.

AKR gjatë viteve 2007-2009 si në parlament e ashtu në debatet e veta publike u mundua që ta luftojë këtë fenomen, por këtu mbeti e vetmuar dhe nuk pati fuqi që të ndryshojë, gjegjësisht t`i parandalojë gjërat.

E pra, të nderuar miq, që në vitet e para të lirisë, unë nuk mund të isha indiferent dhe ta shikojta i patrazuar atë që ndodhte. Në ato rrethana, nuk kisha ndonjë zgjidhje tjetër, përveç se të bëja projekte, t`i ofroja ato, pavarësisht se refuzimi ka qenë pothuajse i ditur që më parë. Nuk kam mundur asnjëherë të pajtohem me faktin, që unë të ndërtoj e të rindërtoj objekte madhështore në anë të ndryshme të botës, kurse në vendin tim të mos arrij të bëj asgjë për shkak të pengesave të të tjerëve. Ky ka qenë dhe vazhdon të jetë një absurditet, me të cilin nuk jam pajtuar asnjëherë.

\*\*\*

Ndoshta pas këtyre arsytimeve mbi privatizimin, mund të mendohet se unë e kam harruar bujqësinë, angazhimin tim kryesor derisa dola në rrugët e mëdha të jetës. E vërteta është krejt ndryshe. Kush më ka parë në udhëtimet e mia në mbarë Kosovën, e ka vërejtur se me sa pasion e lehtësi zhytem unë në bisedat për bujqësinë dhe të ardhmen e saj.

Ashtu siç thuhet në Bibël se “e para ishte fjala”, ashtu thuhet dhe se “njeriu i parë, fisniku i parë, ishte bujk”. Ne shpesh e harrojmë këtë të vërtetë të madhe, megjithëse vijmë nga paraardhës që ishin apo janë bujq. Unë kam bredhur shumë nëpër botë dhe kam bërë shumë profesione, por me dëshirë dua të mbetem i lidhur me bujqësinë, me bujqit. Mendoj shumë për fëmijërinë time, për të parët e mi, bujq edhe ata. E dua fshatin dhe me shumë dëshirë jetoj në Kosovë në një zonë bujqësore. E kam vlerësuar gjithnjë Presidentin Rugova veçanërisht për mesazhet e tij të thjeshta për zhvillimin e

bujqësisë, blegtorisë, pyjeve, traditës së prodhimeve tona dhe si një lloj amaneti prej tij, dua të punoj vazhdimisht për këto sektorë, ku është mbështetur mbijetesa jonë kombëtare në shekuj e mijëvjeçarë. Jemi një vend i bekuar nga perëndia. Kemi shumë fushë dhe pak bjeshkë në territorin e shtetit tonë të ri, por kjo s'do të thotë se duhet të tolerojmë uzurpimin e tokës bujqësore. Ne kemi shumë ujëra, por duhet t'i sistemojmë ato në të gjithë funksionet, për ujitje, pirje etj. dhe të mos i lejojmë ujërat të derdhen kot. Jam tronditur gjithnjë nga indiferenca që karakterizon shtetin ndaj burimeve të Istogut, ku mund të silleshin fabrika të ujërave me renome ndërkombëtare, të ngriheshin fabrika të përpunimit të frutave etj. Ne kemi gjithashtu një traditë të shkëlqyer të kultivimit të produkteve të ndryshme bujqësore, por sot që ne po flasim në mes të 2010, ne e punojmë tokën 3 herë më pak se Maqedonia. Ne kemi qenë një lloj hambari i gjithë ish-Jugosllavisë me disa prej produkteve tona, por sot shumicën e produkteve bujqësore e sjellim nga Maqedonia dhe Serbia. Pse, pra, ne sot nuk mund të jemi përsëri një vend i zhvilluar bujqësor? Pse ne nuk mund ta risjellim traditën e mrekullueshme të prindërve tanë, të etërve tanë? Pse kur një pjesë bukur e madhe e popullsisë sonë jeton në fshat, ne nuk mendojmë për të? A do të vazhdojmë të jemi peng i importeve nga një vend armiqësor me ne si Serbia? A do të vazhdojmë të kushtëzohemi nga interesat e importuesve që fitojnë miliona në kurriz të bujqve tanë, fermerëve tanë, anembanë Kosovës?

Unë e kam ftuar vazhdimisht qeveritë e Kosovës, klasën tonë politike, të mendojë me kokë, por shumë gjatë ama. Të mendojmë gjatë, domethënë të mendojmë në mënyrë afatgjatë. T'i rikthehemi tokës. Të investojmë në bujqësi më shumë burime sot dhe do të fitojmë shumë nesër. Është miopi të mendohet se kjo do të thotë të shpenzojmë para të buxhetit tonë pa kthim. Toka është bujare, ajo ta kthen shumëfish investimin në të. Kosova duhet të shfrytëzojë traditën, burimet e veta natyrore dhe njerëzore. I kam vlerësuar dhe i vlerësoj mesazhet e kreut të Vetëvendosjes Albin Kurti, më parë me artikuj në media, por dhe gjatë protestave të tij, se shteti ynë duhet t'u shërbejë prodhuesve vendorë dhe jo tregtarëve, atyre që shesin produktet e ardhura nga jashtë. Këto kërkesa të bujqve, të

## INTRODUKSION

## INTRODUCTION

Me datën 25 korrik 1999, në qytetin e Luganos, me miratimin e përfaqësuesve të Qeverisë së Përkohshme të Kosovës, të personaliteteve të shquara të biznesit kosovarë dhe ndërkombëtarë, intelektualë, përfaqësues të shoqatave humanitare nga diaspora etj, u mboldh Asamblea Themeluese, duke miratuar krijimin e Fondacionit për Organizimin dhe Rindërtimin e Kosovës FORK. Ky akt themelimi që u ideua nga personalitete të biznesit dhe të humanizmit, intelektualë të shquar nga Kosova, veprimtarë të çështjes së ndihmës së rindërtimit të Kosovës gjënë mbështetjen edhe të institucioneve ndërkombëtare, dashamirës të Kosovarëve dhe të gjithë ata që e kanë përkrahur dhe ndihmuar në ditë më të vështira, të përzënë me dhunë, duke i strehuar, ushqyer dhe shpëtuar nga vdekja. Duke qenë mirënjohës ndaj Institucioneve Ndërkombëtare, Natos, në aleancë me të gjithë dashamirësit e lirë Kosova u çlirua. Refugjatët kosovarë që kaluan të 800 mijë vetët, po kthehen në Kosovë. Por lufta atje ka shkatërruar gjithshka. Mijra familje janë pa strehë, u dogj gjithshka, deri tek burimet minimale jetesore. Qytetet e Kosovës dhe fshatrat janë shkatërruar e kthyer në gërmadhe, ato shtëpi që i kanë shpëtuar djegies janë bosh vetëm me katër muret. Shkollat, spitalët, objektet qytetare, objektet e shërbimit, zyrat administrative janë aktualisht jashtë përdorimit pa asnjë kujdestari dhe këtyre u mungon një interlocutor. Për këtë arsye dhe nevojë jetike, lindi dhe idea që të formohet ky fondacion. FORK de këtë qendrën në Prishtinë (me përfaqsi brenda dhe jashtë Kosovës). Organizatorët dhe ideatorët e këtij fondacioni, kanë operuar prej ditëve të para të fillimit të konfliktit në Kosovë dhe krahas kontributit që kanë dhënë institucionet ndërkombëtare, janë dalluar në organizimin e ndihmave dhe të mbështetjes ndaj popullit duke qenë shumë aktive. Vlen të përmendet kontributi i ideatorëve dhe organizatorëve e veçanërisht, apo „Les enfants du SAKHA“, që bashkërisht kanë shpërndarë mbi 2 mijë tonelata ndihma emergjente, medikamente dhe ushqime për të përzënë nga Kosova me fondet e tyre private. Kur Komuniteti Ndërkombëtar solli paqen dhe lirinë në Kosovë, ky vend ku u aplikua „toka e djegur“ ku mungon organizimi dhe nuk ka interlocutor, ky fondacion i ka vënë vehtes detyrë:

- A.-Të marrë mbi vehte përgjegjësinë e organizimit të shpërndarjes së drejtë të ndihmave sipas emergjencës në vendin dhe në kohën e duhur atje ku duhet.
- B.-Të jetë interlocutor i donatorëve, financuesëve, ndihmave humanitare, kreditorëve në Kosovë.
- C.-Të aktivizohet në procesin e deshtetëzimit të subjekteve ekonomike, sociale, të shërbimit dhe të infrastrukturës civile.
- D.-Të jetë aktiv në procesin e rindërtimit të subjekteve të sipërpërmenduar.
- E.-Të kontribuoj në procesin e kapitalizimit dhe të privatizimit të objekteve ekonomike, financiare, sociale, shërbimeve dhe infrastrukturës civile etj. duke vënë kontrollin dhe menazhimin sipas normave të ekonomisë së tregut. Me gjërë bën fjalë statuti i këtij fondacioni që është fondacion publik dhe jo privat i të gjithë Kosovarëve që nuk bën dallim fetar, nacional apo racor. FORK do të bëjë gjithshka që në mënyrë efektive, nacionale, organizative, përkrah organizmave të tjera botrore të mndihmojë popullin në Kosovë, sidomos në ato drejtime që janë më emergjente për rindërtimin e atij vendi dhe futjen në jetë të bazave ekonomike moderne duke rritur standartin e jetës së popullatës kosovare. FORK ka strukturat e veta profesionale dhe me kompetencë e përgjegjësi do kryej detyrat e veta. APELOJME para opinionit publik të vendit dhe ndërkombëtar, para donatorë, financuesëve, kreditorëve që të marrin sa më parë kontakt me FORK, se vetëm kështu çdo hap që do bëni do ketë siguri dhe garanci, do ketë efektivitet duke mos lejuar asnjë lloj shpërdorimi. FORK vihet në dispozicion tuajin, duke ju siguruar dhe mbrojtjen e investimeve tuaja.

Nga Bordi Drejtues Themelues

Board of managers of founders

*With the admiration of the provisory government of Kosovo, in Lugano on July 25th, 1999, with many Kosovar businessmen, international personalities and representatives from diaspora united in a meeting, the Foundation for organization and reengineering of Kosovo (FORK) was created.*

*The constitution of the foundation shall have international support from those who helped refugees in the worst days, saving them from death. Thanks to many international institutions like NATO who, allied with other institutions, fought to free Kosovo. The war destroyed everytbing; essential structures to permit life, all cities of the province, thousands of homeless people, houses which were not burned bad only the walls left standing, hospitals, schools, even buildings and government buildings are out of use without management and there is no interlocutor. For this reason and for these needs the idea to create the foundation was born.*

*FORK shall have head offices in Pristina (with branches spread in Kosovo and outside the province). Organizers of the foundation have worked for a long time, with a lot of experience, since the beginning of the conflict in Kosovo.*

*With the help of international institutions, they were active in organizing humanitarian aid to support the people of Kosovo.*

*We should emphasize the great help and should thank first of all the foundation "Les enfants du Sakba" that sent more than 2000 tons of humanitarian aid to refugees due to their personal contributions. For this country where the scorched earth theory applied, FORK had the goal (commitment and duty).*

- A) To take on its behalf the responsibility to organize the shipments of aid respecting the priority (right place, right time)*
- B) To be the interlocutor in front of the donors and financiers, etc...*
- C) Will be active in the process of privatization of economics, social and civil objects*
- D) To be active in the process of reconstruction of the objects below referred*
- E) To contribute in the process of capitalizing, privatization of the infrastructures below referred.*

*In detail everything is described in the statutes of the foundation which belongs to all Kosovars, without distinctions of race or religion. FORK will do everything to work in real, effective action alongside international institutions to rebuild the country on the basis of a modern system to improve the Kosovars' welfare.*

*FORK shall have competent personnel to carry out its commitments. To appeal to the public opinion, donors, financiers and creditors are kindly asked to get in contact with FORK. Only in this way, step by step, you shall have a guarantee to avoid any abuse of this.*

*FORK shall be at your disposal, assuring you of the defense of your aid and financing.*

# statuti themelues i fondacionit të organizimit dhe rindërtimit të Kosovës

Komisioni nismëtar për themelimin e këtij fondacioni, mbasi diskutojt për qëllimin dhe detyrat që duhet të ndërmerret e të zgjidhë ky organizim kombëtar, në kushtet e reja të rjedhave kombëtare, vendosi

1. - Të miratohet themelimin e këtij FONDACIONI, sot me datën 25 korrik 1999, në Mbledhjen e grupit nismëtar, të përbërë nga anëtarët prezent. ( shif listën bashkangjitur )
2. - Ky FONDACIONI PËR ORGANIZIMIN DHE RINDËRTIMIN E KOSOVËS, prej këtej e tutje do të quhet konvencionalisht FORK.
3. - FORK-ja, ka SIMBOLET E VETA si vullë, letrat me kokë dalluese, distingtivat, librezën e anëtarisë me të cilat paiset çdo vullnetar që dëshiron të marrë pjesë në këtë organizim, mbasi ka pranuar statutin.

Këto simbole miratohen në mbledhjen e parë themeluese.

## QËLLIMI:

1. -FORK është organizatë e pavarur, publike e Kosovës, jo qeveritare, në esencë mirëbërëse, shoqërore-shkencore, pa përkatësi fetare, që zhvillon veprimtarinë e vet në bazë të legjislacionit dhe ka për qëllim:
2. - që të mbledhë në thesarin e vet çdo subjekt juridik dhe fizik, financiar, ekonomik, teknik, të shërbimit publik, të infrastrukturës civile etj. me qëllim që të bëhet HAPI I PARË I DESHTETËZIMIT!
3. - që të gjitha subjektet e thesarit të vet, fondacioni ti vërë në dispozicion të gjithë shërbimit e vet, që këto subjekte të rindërtohen dhe ndërtohen, të menazhohen mbi baza dhe kritere të përfitimit duke zhvilluar cilësinë. Të ringjallë dhe të ngrejë këto subjekte me anë të kriterëve të përfitimit në nivele të SUBJEKTEVE PROFITABLE (PËRFTITUESE).
4. - që për të gjitha subjektet e veta, fondacioni të aplikoj normat rigorozë të menazhimit, për hirë të cilësisë dhe përfitimit, në mënyrë që ti ofrojë publikut shitje parciale ose totale duke kaluar në fazën vendimtare të KAPITALIZIMIT DHE PRIVATIZIMIT.



# excerpt of statute of the foundation for reengineering of Kosova

## Article 1

The Foundation for the Organization and Reconstruction of Kosova (herein FORK) is an independent public organization of Kosova, non-governmental scientific and professional organization, whose goals to gather the means to work out the projects and programs and other services, for the reconstruction of Kosova.

## Article 2

FORK has status of the juridical person and represents an independent subject founded by the free will of the members, according to its Statute and to its leading elected organs.

## Article 3

FORK has its symbol, its stamp, its communicating distinguished paper, its badges and its membership paper. These symbols are approved by the first founding meeting.

## Article 4

The Foundation has its bank account,

## Article 5

FORK has the task to transform the social property, in three phases.

The first phase consists in the identification of the economical subjects and their access in the treasure of the Foundation.

The second phase comprises the treatment of the subject increasing its capital and preparing it for business according to the laws of the market economy.

The third phase consists in the start of the process of the gradual privatization, taking into consideration the economical efficiency.

FORK will orientate its activity to the rigorous application of the legislation and international conventions ratified in order to obtain the objectives of the Foundation, to the compilation and the implementation of the developing plants and the projects for the direct financing or by other resources just for the following goals:

- In accordance with central, local and municipal organs, to work out the projects for the reconstruction of the economical, technical, social and public service's objects of the civil infrastructure, taking care of the processes of the production, construction and organization, in respect of the rigorous rules of quality and business.
- To search for and verify local and foreign investors and in accordance with their way of proceeding, to offer them adequate projects and taking care even of the binding of contracts between partners.
- To identify the donors and the creditors and, in accordance with their criteria, to offer them elaborated projects and other services concerned until the start of the work.
- To collaborate with private companies and



5. - Të gjitha vendimet e marra me votim nga asamblea, KRYESIA i ndjek deri në ekzekutim, duke bashkërenduar punët me Institucionet vendase dhe ato të huaja.
6. - Për çdo mungesë të ndonji anëtarë të KRYESISË, apo mosardhje të tij, në ushtrimin e aktivitetit, bëhet zëvendësimi me votim në asamble.
7. - Kryesia prej 7 anëtarësh, ka kryetarin, nënkryetarin dhe një sekretar i cili kryen detyrat tekniko-financiare me personelin që do ketë në dispozicion.
8. - Zgjedhja e kryetarit bëhet nga 7 anëtarët e kryesisë me votim të fshehtë. Kryetari mban vulën dhe ka të drejtën e firmosjes në emër të vendimeve të marra, të përfaqsojë FONDACIONIN.
9. - Selia legale e FONDACIONIT ngrihet në Prishtinë, dhe të gjitha shpenzimet për personelin e miratuar përballohen nga angazhimi i donatorëve qofshin anëtarë, qofshin organizma të huaja humanitare.
10. - FONDACIONI ka dhe përfaqësuesit e vet në të gjitha qytetet e Kosovës dhe përfaqsi apo përfaqësues në jashtë saj, të cilët përfaqsojnë dhe menazhojnë në emër të fondacionit çdo aktivitet që parashikohet në vendimet e marra me shkrim dhe të ngarkuara nga kryesia
11. - I gjithë dokumentacioni mbahet nën përkujdesjen dhe përgjegjësinë e sekretarit të FONDACIONIT sipas të gjitha rregullave të sekretimit.
12. - Anëtarësia në FORK është e hapur për këdo që njeh dhe respekton statutin e fondacionit.
13. - Pranimi bëhet me kërkesën e vetë personit. Ai/Ajo, regjistrohet në Librin Regjistr të FORK dhe paiset me kartën e anëtarimit.
14. - Anëtarët kanë të drejtë të informohen për punët e FORK-së, të propozojnë dhe të shprehin mendimet e tyre lirshëm, të zgjedhin dhe të zgjidhen në organin drejtues të fondacionit.



15. - Anëtarët duhet të ndihmojnë në mbarëvajtjen e veprimtarisë të organizatës, të marrin pjesë aktivisht në jetën e saj dhe të zbatojnë të gjitha detyrat që u caktohen ose që i marrin përsipër.
16. - Çdo anëtar mund të paguaj një kuotë vjetore pre të ardhurave të tij sipas dëshirës personale.
17. - Çdo anëtar është i lirë të heqë dorë nga anëtarësia në FORK, duke ia shprehur vullnetin e vet organit drejtues të paktën një javë para largimit. Kjo sjell automatikisht çregjistrimin nga Libri Regjistr të FORK dhe tërheqjen e kartës së anëtarimit.



**Article 16**

*The annual General Assembly is the supreme organ of the Foundation. This meeting is called by the leading organ once a year, in the beginning of the calendar year, as well as when the 1/5 of the members demand this meeting, or in case of exceptional events according to the decision of the leading organ. The General annual assembly takes place when at least 50% + 1 member participate in it.*

**Article 17**

*The General annual Assembly approves the Statute of the Foundation, analyzes its activity during the period between two meetings, checks the financing balance-sheet, defines the most important objectives for the current year and elects the leading board and the supervising council.*

**Article 18**

*The leading board is composed of 8 members and the general manager (the chairman). The Board manages the activity of the Foundation during the period between two meetings, according to the Statute and to the decisions of the General Annual Assembly.*

**Article 19**

*The leading board is called once every three months. The Board manages and approves the activity of the Foundation in the period between two meetings and takes and gives orientations for the further period. The meeting of the Board takes place when at least 4 members and the chairman take part in it.*

**Article 20**

*The chairman (general manager) leads the daily activity of the Foundation according to the decisions of the leading board. He is responsible for the financial and administrative problems and in collaboration with the leading board executes the policy of the Foundation. The general manager suggests to the leading board the needs of the Foundation organizational and functional ones, and according to the financial possibilities employs the people for needed works.*

5. - Të sigurojë fitime të cilat do shkojnë në ngritjen e subjekteve të reja, linjave, fabrikave të organizuara mbi bazat e ekonomisë së tregut.
6. - Të ndërtojë një shoqërije civile sipas parimeve bashkëkohore të zhvillimit harmonik e të qëndrueshëm dhe në përputhje me Konventat Ndërkombëtare.
7. - Të realizimin dhe zbatojë një strategji kombëtare të zhvillimit, në bashkëpunim me organizmat qeveritare, ato ndërkombëtare dhe organizatat e tjera jo qeveritare.
8. - Të harmonizojë funksionimin dhe perfeksionimin e pjesmarrjes publike në të gjitha nivelet e shoqërisë.
9. - Të edukojë e popullsinë me parimet e zhvillimit harmonik e të qëndrueshëm si dhe lidhur me mjetet dhe metodat që duhen përdorur.
10. - Të njohë, të respektojë dhe të mbrojë të drejtat e grupeve shoqërore, racave dhe kombësive, në përputhje me Konventën europiane të të Drejtave të Njeriut.
11. - Të mbrojë e mjedisin dhe trashëgiminë kulturore kombëtare.
12. - Të kryejë realizimin e veprimtarive, studimeve dhe botimeve praktike për të arritur në nivelet e një shoqërije civile të emancipuar.
13. - Të përcaktojë, studjojë, projektojë, parapjektojë mbi baza të efektshmërisë ekonomike të të gjithë gamës së projekteve qofshin të natyrës ekonomike, teknike, të shërbimeve sociale, të infrastrukturave civile, duke përfshirur krahas kriterëve dhe kushtet e realizimit dhe instalimit të projektit.
14. - Të shërbejë për rritjen e standartit dhe nivelit të kulturës, duke rritur treguesit ekonomikë, financiarë në mbarë Kosovën.
15. - Të përcaktojë studimet paraprake ekonomike, teknike, financiare dhe kushtet për rindërtimin dhe ngritjen e objekteve ekonomikë.
16. - Të mbajë kontakte të përhershme e të vazhdueshme me investitorët, donatorët etj, për thithjen e tyre qofshin Institucione Bankare Ndërkombëtare, Fonde Monctare, sisteme të tjera financuese, duke bërë identifikimin e tyre dhe përgatitjen e informacionit për çdo investim që do u duhet investitorëve.
17. - Të kontaktojë me investitorë të huaj duke ju ofruar programe sipas natyrës dhe profilit të aktivitetit që ushtrojnë.
18. - Sipas metodologjisë profesionale të përgatitjes deri në detaje projekte dhe parapjekte të objekteve ekonomikë, ekonomiko-financiarë, social-kulturorë, të shërbimeve publike, infrastrukturave civile etj.

#### DETYRAT:

Për realizimin e qëllimeve të mësipërme, FRK-ja, ka për detyra:

1. - Të punojë për zbatimin rigoroz të legjislacionit dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara, për arritjen e synimeve të fondacionit.
2. - Të hartojë dhe të zbatojë plane zhvillimi dhe projekte, që do të ndërmerren me financim të drejtëpërdrejtë, ose nepërmjet burimeve të tjera.
3. - Në pajtueshmëri me organet qeverisëse qëndrore, lokale, komunë apo bashki e prefekturë, të hartojë projektet e rindërtimit të objekteve ekonomiko-teknikë, sociale, të shërbimeve publike dhe infrastrukturës civile, duke përfshirur proceset e prodhimit, të ndërtimit ose të organizimit sipas normave rigorozë fitim-prurëse dhe të cilësive duke bërë analizën e detajuar të efektshmërisë (visibility study)
4. - Të hulumtojë dhe të verifikojë investitorët e

governmental bodies, international and non-governmental organizations in order to assure the necessary expertise made by qualified specialists.

- To manage its own funds and the funds given by other juridical persons, donors and other helpers, in order to assure their efficient use.
- To make use of the possibilities offered by media in order to propagate the civil society and for its constant and harmonious development.
- To respect and to cultivate the national sentiments for defending the national programs for the schools (education).
- To organize training sessions for the transformation of the knowledge, in order to help the civil communities and other non-governmental organizations.

#### Membership and organization

##### Article 6

The Foundation is an independent juridical person founded by the free will of the members, exercising its activity according to the existent legislation, to this Statute and to other legal documents.

##### Article 7

The leading organ of FORK is the Chairmanship (board) composed by 9 members, elected by the vote of the founding Assembly, for a period of one year.

##### Article 8

The chairmanship (board) executes the decisions taken by the Assembly of the Foundation.

##### Article 9

The Chairmanship (board) composed by 9 members elects, from its composition, the chairman, two vice chairman and its secretary.

##### Article 10

The offices of the Foundation will be in Pristina in Dardania street. The Foundation will open its representative offices in all the cities of Kosova and, abroad wich will represent and manage in the name of the Foundation every activity foreseen by the decisions taken by written consent and entrusted by the chairmanship.



**Faksimili i programit dhe statutit të FORK-ut, iniciativa e parë dhe më cilësore për t'iu qasur zhvillimit ekonomik të Kosovës, pas luftës. Por daultet bien për ata që kanë veshë.**

mbështetur nga zoti Kurti, kanë qenë dhe mbeten pjesë e programit tonë politik si AKR, shtyllë e këtij programi. Gjatë gjithë takimeve tona me elektoratin, në të gjitha fushatat tona zgjedhore, ne e kemi vënë theksin te bujqësia. Ne kemi kërkuar që të kthejmë interesin e të rinjve tanë te bujqësia nëpërmjet krijimit të një rrjeti të shkollave të arsimit profesional në përgjithësi dhe atij bujqësor në veçanti. Ne asnjëherë nuk e kemi harruar bujqësinë.

E bëj këtë pohim, për t'ju përgjigjur atyre që sot mund të thonë: me shumë vonesë, zoti Pacolli. Jo! Të vonuar janë ata që kujtohen për bujqësinë kur ka protesta apo që thonë se “buxheti ynë i ka mundësitë e kufizuara në raport me nevojat e bujqësisë.” Kam shumë prova të këtij vetëdijësimi tonë për bujqësinë, që zë fill me programin tonë politik, apo me ndërhyrjet e shumta në parlament, nëpër ndeja publike, oda etj.

Më duhet të them se unë mendoj çdo ditë për rrënjët e mia, për rrënjët tona, për tokën. “Toka është e mirë, e butë, e durueshme dhe shërbyese e vazhdueshme për kërkesat e vdekatarëve. Sa gjëra prodhon ajo, dhe sa të tjera i shkatërron, sa aroma, shije, ngjyra na ofron! Me sa ndershmëri na i rikthen thesaret që i besojmë! Sa gjëra të dobishme ushqen ajo për ne! Toka është nënë. Prej saj vijmë dhe te ajo do të kthehemi. Në të do të na varrosin kur gjithçka të mbarojë. Ajo është fillimi dhe fundi, gjithçka tjetër është përrallë”, thoshte një mendimtar latin dje dhe sot fjalët e tij tingëllojnë të përjetshme. Edhe për ne, në Kosovë.

Kam menduar gjithashtu për zhvillimin e blegtorisë, veçanërisht kur në mëngjeset e mia në Kosovë duhet të konsumoj qumështin e ardhur nga larg, nga Sllovenia, për të cilin ne harxhojmë shumë. Ne paguajmë me paratë tona punëtorët e shtrenjtë sllovenë, transportin e stërzgatur nëpër rrugët e Ballkanit, paketimin artificial, para që po të përdoshin ndryshe, do të kishin mundësuar krijimin e një sistemi blegtoral që zë fill nga familja e blegtorit deri te një fabrikë e madhe e qumështit për gjithë Kosovën. Do të duhej të mbështetej familja e blegtorit me kredi për lopë të mira, do të ngriheshin laboratorë, tregje, pika grumbullimi deri në ndërtimin e fabrikës së madhe.

Ashtu si pa menduar u zhyta në idetë e mia për ekonominë, bujqësinë dhe blegtorinë në veçanti, për të cilat flas gjithnjë me

*nga Sfida në SFIDË ...*

*BP*

pasion. Dhe s'do të lodhem kurrë deri sa të vdes.

## Lobimi për pavarësinë e Kosovës dhe për njohjen e saj si shtet në botë

*Si arritëm që të fusnim në fjalimin e Presidentit Bush në Tiranë, në qershor 2007, fjalinë: "Kosova duhet të jetë e pavarur. Tani!". Angazhimi im lobues me personalitete të mëdha amerikane që SHBA, si vend i parë në botë të vendoste sa më shpejt që Kosova të shpallej si shtet i pavarur. Pasi siguroam pavarësimin, filluam lobimin për njohjen e shtetit të Kosovës. Takimet e shumta në të gjithë kontinentet. Lobimi në Nju-Jork në 2010, shtegtimi në Karaibe dhe marrja në dorëzim e notës së njohjes prej Presidentit honduren.*

**S**i çdo shqiptar që kishte dëgjuar për Presidentin Uilson (Wilson) dhe parimet e tij mbi vetëvendosjen e popujve, të cilat shërbyen për të ruajtur integritetin territorial të Shqipërisë si shtet, e kisha adhuruar dhe dashur Amerikën që në fëmijëri. Edhe më shumë do ta doja pas asaj që bëri për të ndaluar gjenocidin mbi popullin tim në Kosovë. Kështu, angazhimi që SHBA-të kërkonin përfundimisht (publikisht) pavarësinë e Kosovës, për mua ishte një sfidë plot emocion. Ishte vijim i një vepre të lënë përgjysmë.

Siç kam lënë të kuptoj, asnjëherë në punën time nuk kënaqem me çfarë kam bërë dhe nëse më jepet rasti ta bëj sërish një punë, do të përpiqem ta bëj edhe më mirë atë. Kështu e kam parë dhe kontributin tim për Kosovën: unë asnjëherë s'kam qenë i kënaqur me çfarë kisha bërë dhe sapo më jepej rasti vendosja të angazhohesha për të bërë më shumë. Në të gjithë çështjet, ku unë mund të ndihmoja mbase më shumë se të tjerët. Çfarë mund të kontribuoj unë sipas analizës që bëja herë pas here lidhur me ngjarjet në Kosovë dhe përfshirjen e faktorëve ndërkombëtarë në to? Cila ishte analiza që bëja në vitet e para të mijëvjeçarit të ri? Menjëherë pas asaj që ndodhi me sulmin burracak të 11 shtatorit 2001 në SHBA, mjerisht edhe në opinionin publik amerikan apo dhe më gjerë, Kosova humbi rëndësinë e vet të mëparshme në planin ndërkombëtar, veçanërisht sa i takonte zgjidhjes përfundimtare të statusit të saj. Ngjarjet e marsit të vitit 2004, kur në Kosovë pati trazira e incidente të natyrës ndëretnike me humbje jetësh njerëzore,



*Me Ana Oksën (Oxa-Hoxha) dhe senatorin amerikan Bob Doll (Dole). Ana rigjeti gjakun e vet shqiptar, ndërsa Doll është një mik i madh yni, që akoma nuk e kemi vlerësuar sa duhet.*

ndikuan negativisht në imazhin e Kosovës në botë, duke inkurajuar kundërshtarët e pavarësisë sonë. Ajo që ndodhi pas çlirimit të saj më 1999, kur rolin kryesor e morën jo vendorët, por ndërkombëtarët, që nuk donin të merreshin me problemet e saj reale, bënë që Kosova të humbte pak nga pak shanset e prosperitetit të vet politik etj. Dukej sikur çështja e statusit po shtyhej vazhdimisht. Kosovarët ishin të hendikepuar për shkak të mungesës së dokumenteve të udhëtimit, që nevojiteshin për t'i dhënë frymëmarrje një shoqërie të izoluar dhe post-traumatike. Serbia po bënte presion të madh diplomatik për frenimin apo kthimin pas të rrotës së historisë. Lobi serb po rriste këtë presion sidomos në SHBA, ku shquhej një zyrtar i lartë amerikan me origjinë serbe, guvernatori i Illinoisit, Blagojeviçi, i lidhur me Kishën serbe. Serbia po intensifikonte vizitat e emisarëve të vet në vendin që kishte udhëhequr procesin për një Kosovë të re, SHBA. Më kujtohet se asokohe në një televizion lokal amerikan kam parë kreun e kishës ortodokse serbe të Kosovës, Artemije, i

cili thoshte se Kosova asnjëherë s'do të jetë në gjendje të ndërtojë shtet, se shqiptarët s'janë të aftë të ndërtojnë shtet e as të ruajnë familjet e tyre. Është ky Artemija famëkeq që përfundoi me akuzat për korrupsion. Një firmë amerikane ligjore si *Venable* vendosi përkundrejt një pagese të mirë të përfaqësojë interesat e Këshillit Amerikano-Serb, duke mundësuar shumë vizita të zyrtarëve të lartë serbë me synim lobimin kundër pavarësisë së Kosovës.

E kuptova asokohe, por edhe miqtë më sugjeruan, se fati i Kosovës vendosej në Uashington. Kisha udhëtuar shpesh atje, por tani po kthehesha me një mision të madh. Shkova në SHBA dhe fillova me disa miq të mi, të punoja; intensifikova kontaktet me senatorë e kongresmenë, por kjo nuk mjaftonte. SHBA ishin shumë të angazhuara në problemet e veta në Afganistan, Irak më pas, andaj për Kosovën nuk flitej thuajse fare publikisht - ne ishim zhvendosur nga prioritetet e politikës së jashtme. Kështu mendova të bëja diçka në këtë plan. Pas ngjarjeve të vitit 2004, kur Kosovës iu cenua imazhi, shkova në SHBA ku kontaktova një kompani lobuese që ma prezantoi Presidenti kroat Mesiq, e cila u kishte ndihmuar kroatëve më parë. Kompania *Jeferson, Waterman, International Group* mori përsipër të lobonte në SHBA dhe BE, dy faktorët vendimtarë që duhej të mbështesnin pavarësinë e Kosovës. Pra objektivi ishte i qartë: PAVARËSIA. Brenda një kohe të shkurtër grupi ynë lobues vendosi në mjediset e veta një qendër për Kosovën, e cila filloi të frekuentohej nga miqtë që punonin për kauzën tonë. Ata hapën një departament të tërë, si një miniambasadë, për t'ua pasur zili. Këtu u themelua *Aleanca për Kosovën e Re*, me statutin e vet, planin e veprimit etj. Ajo filloi të ringjallte temën e Kosovës, të motivonte njerëzit kyç në Shtëpinë e Bardhë, në Departamentin e Shtetit, në Kongres, në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, për një problem që pothuajse ishte harruar në opinionin publik amerikan: Kosovën. Kjo ringjallje do të duhej t'i konvenonte politikës së Bushit, e cila më vonë do ta quante Kosovën histori të suksesit. Qendra për Kosovën përfshinte Uiliam Uokerin e njohur (William Walker), Janush Bugajskin, zyrtar për Europën Juglindore në Këshillin për Studime Ndërkombëtare Strategjike të drejtuar nga Kisinxheri, Sem Haçkinsënin (Sam Huchkinson), një ish-zyrtar të lartë amerikan,

Frenk Karluçin (Frank Carluci), ish-sekretarin amerikan të mbrojtjes, Morton Abramoviçin (Morton Abramovitz), ish-ambasadorin amerikan etj. Që të gjithë personalitete me ndikim të madh në të dy krahët e politikës amerikane, dhe sidomos në administratën Bush. Arritëm maksimumin e përqendrimit të figurave: disa ish-sekretarë të mbrojtjes, disa të jashtëm, disa këshilltarë të sigurisë kombëtare për presidentë të ndryshëm, praktikisht vendimmarrës të nivelit të lartë në administratat e tyre që punonin për pavarësinë e Kosovës. *Waterman...*, u përplas me qeverinë serbe, e cila, siç thashë, lobonte gjithashtu në Uashington. Grupi ynë futi në lojë çiftin Clinton, Hillarin dhe Billin, Holbrukun, etj., duke i informuar për atë që ndodhte në terren, duke debatuar rreth ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës etj. Miqtë tanë lobistë u jepnin bashkëbiseduesve argumente të forta nga pikëpamja ligjore dhe e sigurisë pro pavarësisë së Kosovës. Kur nevojitej, unë lija biznesin duke udhëtuar sa në Europë, në SHBA, në Azi etj., duke i takuar vetë vendimmarrësit. Lobistët e thirrur prej meje, bënë diçka dhe në Bruksel, Paris, Berlin, gjithashtu, megjithëse fokusi ishte Uashingtoni. Çdo njeri me peshë në këtë qendër të rëndësishme të vendimmarrjes globale e dinte se çfarë bënte grupi ynë. U kontaktuan zyrat përgjegjëse të Serbisë, të Kroacisë, në Departamentin e Shtetit, u takuan ambasadorë të vendeve fqinje me Kosovën, organizoheshin seanca dëgjimi në institucionet amerikane, në OJQ-të apo qendrat e mendimit me peshë. Të gjithë të tjerët flisnin për autonominë, vetëm miqtë tanë për pavarësinë, si zgjidhje e vetme. Madje jo për pavarësinë e kushtëzuar, por për pavarësinë e plotë. Ata morën përsipër që të botonin artikuj në mediat më të rëndësishme amerikane, të plasonin intervista të figurave pro pavarësisë së Kosovës. Ata vendosën kontakte të qëndrueshme me Shtëpinë e Bardhë, me Kongresin, me komitetet e ndryshme të tij, me Departamentin e Shtetit dhe me Këshillin Kombëtar të Sigurisë, por punuan shumë dhe në planin ekonomik. Ky fokusim te ekonomia vinte nga bindja ime personale mbi forcën e ekonomisë në amortizimin e problemeve apo ndarjeve etnike dhe kombëtare. Unë mendoja se ky lobim pro pavarësisë duhej të shoqërohej, krahas aktiviteteve politike e propagandistike, edhe me lobim për zhvillimin ekonomik të rajonit si një i tërë. Ndaj





*Me stafin elektorale të Presidentit të SHBA-ve,  
Barak Obama, 2009*

unë mbështeta fuqimisht krijimin e SEED, *South Eastern Economic Initiative* (Inisiativës për Zhvillimin e Europës Juglindore), e cila organizoi konferenca të ndryshme në Uashington me pjesëmarrjen e biznesit të nivelit të lartë amerikan, por dhe jashtë SHBA-ve, për t'u njohur me zhvillimet ekonomike në rajon. U prodhuan dokumente të ndryshme politike, programore, që u vunë përpara kongresmenëve të të dy krahëve për t'i informuar ata për zhvillimet në terren.

Në ndikimin e këtij grupi, u zhvilluan seanca pyetjeje në Kongres, ku pa dyshim më e rëndësishmja ishte seanca e 8 nëntorit 2005 në të cilën u përfshi ish-senatori, sot zëvendëspresidenti amerikan Xhozef Bajden (Joseph Biden), nënsekretari amerikan i shtetit Bërns (Burns), dhe ish-ndihmës Sekretari i shtetit Holbruk. Bajdeni, ky mik i madh e i sprovuar i kombit shqiptar, djali i të cilit, Beau, kishte punuar në Kosovë për Departamentin e drejtësisë në një program për të mbështetur sistemin e drejtësisë në vendin tonë, tha në atë takim se situata e krijuar në terren nuk mund të tolerohej, se shqiptarët

meritonin të shpërbleheshin etj. Po ashtu Holbruku dhe Bërnsi u shprehën pro asaj forme statusi që nuk lejonte kthimin në gjendjen e para 1999, apo ndarjen e Kosovës. Sigurisht Holbruku ishte më i drejtpërdrejtë, pasi ai asokohe nuk ishte pjesë e administratës si sot. Sot këto propozime duken si kufizuese, por duhet të kuptojmë atmosferën e kohës dhe evoluimin e pozicioneve të administratës që kishte sigurisht një bazament, qoftë te politika e administratës demokrate me Bill Klintonin President, qoftë dhe te Presidenti Bush i vjetër, i cili kishte folur i pari për vijën e kuqe të Beogradit në Kosovë. Bajden shkroi artikuj të ndryshëm, madje dhe në *Wall Street Journal*. Shumica e anëtarëve të grupit tonë kishin qasje në media të tilla të rëndësishme si kjo gazetë, apo në *Washington Post*, *Washington Times* etj. ku ata botuan artikuj të shumtë. Bugajski shkroi për shembull dhe kundër rolit rus në Ballkan, pikërisht në *WSJ*.

Konferenca që mbajtëm më 2006, organizuar prej *Aleancës Kosova e Re*, pati një ndikim të madh në SHBA. Në gazetatat dhe mediat më të mëdha amerikane, Karluçi, Abramoviçi, Bugajski kërkonin drejtpërsëdrejti nga çdo dashamirës i lirisë në Amerikë që të përmbylej puna e nisur me bombardimet e vitit 1999. Kjo u bë si një lloj detyrimi për miqtë tanë që e shndërruan gati në çështje elektorale Kosovën. Kur shkoje në institucionet amerikane dhe prezantoheshe si nga Kosova, ata pyesnin: aha, po loboni për pavarësinë e Kosovës! Kompania u bë simbol i këtij objekti. Mes arritjeve të lobimit kah media amerikane dua të kujtoj edhe një paraqitje në Qendrën e Mediave ndërkombëtare në Uashington, me një prani shumë të madhe të gazetarëve.

Me këtë lobim të vazhdueshëm mund të them pa modesti se ne ia arritëm ta rikthenim Kosovën në vëmendjen maksimale amerikane. Në këtë kuadër edhe vetë jam takuar vazhdimisht me krerë institucionesh të rëndësishme në Departamentin e Shtetit, në Senat, në Shtëpinë e Bardhë. Filloi kështu të flitej, edhe pse jo zyrtarisht, se Kosova duhej të pavarësohej - ky ishte objekti ynë. Asokohe ne përplaseshim me lobin serb, andaj miqtë e mi me ndikim në Uashington më thanë se duhet të mendoja më shumë për sigurinë time, pse jo dhe në Lugano.



*Me z. Khan Hemr (John J. Hamre), President i CSIS (Center for Strategic & International Studies) dhe z. Janush Bugajski*

Por pa dyshim momenti më kulmor i lobimit tonë ishte futja e frazës “KOSOVA DUHET TË JETË NJË SHTET I PAVARUR, TANI” në fjalimin e Bushit gjatë vizitës në Shqipëri në qershor të vitit 2007. Ishte praktikisht kurorëzimi i punës sonë të madhe me miqtë që përmenda dhe miqtë e miqve. Si punuam për këtë objektiv? Kur u vendos që Bushi të vizitonte Shqipërinë, unë dhe miqtë e mi patëm rastin që me njerëzit më të afërt të Presidentit të njihnim dhe diskutonim për axhendën që po diskutohej dhe me ambasadën shqiptare. Mbaj mend se punuam shumë deri në orën 4 të mëngjesit, pra u desh shumë kohë që ajo fjalë të vendosej në gojën e tij. Gjithçka u bë në bashkëpunim me një mik tonin në Administratën e lartë të Presidentit Bush dhe që dikur vinte prej Zvicrës.

Unë e dija, sado që nuk e kam thënë kurrë më parë, se Bushi



*Me Henri Kisinxherin (Henry Kissinger), 2009*

Presidenti Bush vizitoi Zagrebin dhe miku im, Presidenti Mesiq, më ftoi që të merrja pjesë në disa prej aktiviteteve të tij. Kështu arrita ta takoja në hotelin ku ishte vendosur kreu amerikan i shtetit dhe t'i dhuroja një pikturë që riprodhonte një foto familjare të Bushit, me gruan dhe të bijat. Ishte një pikturë e jashtëzakonshme e piktorit nga Shqipëria, të famshmit Zef Shoshi, e cila e la pa fjalë Presidentin Bush. I thashë se "ju keni bërë shumë për Kosovën, ju jeni i pari që keni folur për këtë pavarësi dhe unë dua t'ju dhurojë këtë pikturë si kujtim!" Zoti Bush më tha se kishte marrë shumë dhurata, por kjo sigurisht ishte diçka e paharruar që "do ta marr me vete në shtëpinë time." Dhurata ishte zgjedhur në mënyrë të tillë që Presidenti Bush të mos e harronte Kosovën - një portret familjar, që ai mund ta çonte në shtëpinë e vet, ku do ta sodiste më shpesh se çfarëdo dhurate tjetër.


Me këtë fjalë të Bushit në Shqipëri, me vizitën e suksesshme në vendin amë, me pritjen që iu rezervua, lobimit iu hap një horizont i ri. Gjithçka u bë më e lehtë. Lobistët tanë realizuan takime me qendrat kryesore amerikane të mendimit dhe opinionit. Më 2005 dhe 2006 ne arritëm të vendosnim kontakte me CSIS-in (*Center for Strategic and International Studies*- Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare), ndoshta organizatën më të madhe studimore

do të përmendte në Tiranë fjalën magjike - PAVARËSIA dhe se kjo ishte fryt i lobimit tonë. Ardhja e tij në Shqipëri, pritja madhështore që iu rezervua, ia nxori këtë fjalë jo vetëm nga goja, por dhe nga shpirti. Unë pata rastin që ta falënderoja personalisht Presidentin Bush për këtë nder të madh që i bëri Kosovës. Më 4-5 prill të vitit 2008,

dhe me ndikim në politikën e jashtme amerikane, që u shndërruan në marrëdhënie shumë intensive, duke i përfshirë edhe ata në lobim. CSIS kishte brenda vetes tre prej këshilltarëve aktualë të Presidentit Obama dhe disa ish-sekretarë të mbrojtjes, ish-këshilltarë të sigurisë kombëtare, figura kyçe në formulimin e politikës së SHBA-ve. Për rëndësinë e vet jo vetëm në nivel amerikan, por dhe global, CSIS vizitohej nga burështetas europianë, që vinin dhe mbanin fjalime në konferenca apo në mjediset e kësaj organizate të drejtuar, siç thashë, nga Kisinxheri. Kjo mundësonte që lobimi të orientohej drejt ndikimit tek vendet anëtare të BE-së.

Më kujtohet, p.sh., ardhja e krerëve të shteteve

europiane në CSIS, mes të cilëve Presidenti francez Zhak Shirak. I pyetur se çfarë mendonte për Kosovën, menjëherë pas vizitës së zotit Bush në Tiranë, ai tha: "siç e dini, Presidenti Bush ka menduar për këtë gjë". Organizoheshin konferenca dhe gjatë drekës, njerëzit që punonin, që lobonin, diskutonin me të ftuarit e tjerë. Në vitin 2006, mua më propozuan që të jem këshilltar i përhershëm ndër-



*Në ceremoninë e inaugurimit të Presidentit Obama, 2009*

kombëtar i Komitetit të udhëhequr nga Kisinxheri, komiteti më me rëndësi i CSIS. Ne mblidhemi në çdo tre muaj dhe komiteti është një urë ndërlidhëse me shtete të tjera. Për mua është lehtësi shumë e madhe që të lidhem me burrështetasit e botës, sidomos ata që më interesojnë mua - ata që duhet ta njohin Kosovën.

Me Kisinxherin, këtë burrë të jashtëzakonshëm që është shprehur shumë herët për pavarësinë e Kosovës në *Foreign Politics* jam gjithnjë në të njëjtën tavolinë në të gjithë aktivitetet ku marr pjesë. Duke iu referuar Kosovës ai thoshte mes të tjerash se “duhet harruar dhuna, duhet shikuar përpara. Merruni me zhvillimin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, mos u ndalni në problemet banale. Ju duhet të arrini qëllimet tuaja, duke angazhuar tërë potencialin tuaj. Të radhiteni si shtet i dëshmuar pozitivisht. S’ka rëndësi mënyra, ajo u mbetet juve. Shfrytëzoni çdo energji. Duhet të jeni unikë, pavarësisht se cilës palë i përkisni, opozitës apo qeverisë, duhet të jeni unikë”.

Gjatë këtyre takimeve në CSIS, unë jam njohur dhe me gjeneralin Xhejms Xhons, këshilltar për Sigurinë Kombëtare i Presidentit Obama, si dhe me atë që më pas u bë këshilltari i Obamës për ekonomi, Pol Uoker (Pol Wolker). Jemi takuar dhe kemi bashkëbiseduar disa herë jo thjesht për Kosovën, por dhe për çështje të ndryshme të rajonit apo më gjerë. Më kujtohet një episod interesant gjatë takimeve me këto personalitete të rëndësishme të skenës politike amerikane. Gjatë një konference për krizën ekonomike, të gjithë flisnin për humbjen e parave dhe skemat financiare. Unë pyeta: - Ku shkuan paratë? Ku shkoi *cash*-i? Pol Uokeri u përgjigj: - Ju, zoti Pacolli, mund ta dini më mirë se çdo njeri tjetër! Unë e dija se ai njihte diçka aktivitetin tim biznesor dhe që unë harxhoja mjete të shumta për çështjen e Kosovës. Duke ndjekur këtë moment, Kisinxheri më shkroi një mesazh në stilin e vet në copa letre: - Ju bëtë pyetjen më të mirë!

Gjatë pjesëmarrjeve të mia në CSIS, kam patur kontakte me zotin Zbignju Bzhezinski (Zbignew Brzezinski), një figurë autoritare e studimeve strategjike, diplomatike amerikane, përveç se vendim-marrës në cilësinë e këshilltarit për çështje të sigurisë kombëtare të një Presidenti amerikan. Ai ka premtuar të vijë në Kosovë dhe

ndërsa flisnim për sfidat ndërkombëtare të Kosovës më ka thënë se “ju duhet të keni rrjet të zhvilluar diplomatik. Ju nuk mund të dominoni me para dhe me politikë. Kosova s’mund të jetë një qendër ku zhvillohet politikë me rëndësi për Europën dhe botën. Ju duhet të aktivizoni gjithë kontaktet tuaja nëpër botë. Ju duhet të përkujdeseni për minoritetet, të bashkëjetoni me ta. Kufijtë tuaj s’duhet të lëvizin asnjëherë. Nuk duhet të bashkoheni sepse bashkësia ndërkombëtare do të demoralizohet nëse do të dilni nga ai format i përcaktuar më parë prej saj”.

Ky aktivitet në SHBA do të thoshte angazhim i madh financiar imi për gjashtë vite me radhë, shifër që arriti disa milionë dollarë, të cilat unë i kam dhënë pa ngurrim për vendin tim. Ia arritëm qëllimit ama: në vitin 2007 grupi lobues e përmbylli punën e tij, sepse konsideroi se Departamenti i Shtetit dhe Shtëpia e Bardhë tashmë ishin përcaktuar për pavarësinë e Kosovës. Ardhja e Bushit në Shqipëri dhe deklarata e tij e prerë se *Kosova do të bëhet e pavarur*, ishte epilogu që përmbylli qëndrimin zyrtar të Uashingtonit. Që atëherë, pavarësia e Kosovës për mua ka qenë çështje e përfunduar sa i përket miratimit të saj nga faktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë. Pas shpalljes së pavarësisë vendosa që puna të mos ndalej, por prioriteti kishte ndryshuar - njohja e saj nga shtetet e ndryshme të botës. Unë e dija se për konsolidimin ndërkombëtar të shtetësisë së Kosovës, një shteti të porsalindur nevojitej shumë punë. E dija sa e vështirë ishte të ngrije në këmbë nga hiçi një ministri të jashtë, të gjeje diplomatë, të gjeje seli për ambasada, të mundësoje udhëtimin e tyre nëpër botë, diçka e kushtueshme. I mirëkuptoja këto vështirësi që vinin qoftë për shkak të së kaluarës, kur populli ynë s’pati mundësi të kishte diplomaci e diplomatë, qoftë për shkak të buxhetit të varfër të Kosovës, që nuk mund të përballonte njëherësh shpenzimet për shtëpitë e djegura, spitalet, kopshtet e fëmijëve dhe shkollat, rrugët dhe administratën. Ndaj i përvështa mëngët personalisht dhe në heshtje, pa publicitet, vendosa të bëja diçka. Kam bërë shumë vepra të mira humanizmi për të cilat askush nuk di dhe as nuk pres të marr merita. Para se të hyja në politikë, kam në bilancin tim disa vepra të mëdha të arritura me punë, të cilat më kanë bërë të njohur në mbarë botën dhe që i kam bërë pa prituri të bëhem deputet, kryetar partie,



*Kjo pikturë, e Zef Shoshi ku shihet Presidenti Bush, me bashkëshorten Laurën, dhe të bijat, Barbarën dhe Jennën, ishte dhuratë për të nga ana ime. E varur në muret e shtëpisë, ajo do t'ia kujtonte shpesh Kosovën.*

ngritur fabrika, spitale, shkolla, qytete të rrëzuara nga tërmeti, qendra administrative, ta vë në shërbim të Kosovës. Duhet të pyesja dikënd para se ta bëja këtë? Jo!

Zgjedha partnerë të tjerë. Fillova të lloboj sërish me ndihmën e CSIS dhe jo vetëm të saj. Në aktivitetet e organizuara në CSIS kam takuar krerët e Salvadorit, mbretin e Jordanisë, shumë liderë të vendeve islamike, kryesuesen e UNICEF-it, nënsekretarin e OKB, Shaiban Shaban, shumë zyrtarë afrikanë me të cilët jam dakorduar t'i vizitoj ata në vendet përkatëse, gjë që e kam bërë disa herë madje. Në CSIS kemi pasur Presidentin e Bregut të Fildishtë, i cili më ftoi për vizitë në vendin e tij. Krerët e Ganës, gjithashtu. Direkt ose indirekt, një pjesë e madhe e lidhjeve të mia ndërkombëtare në funksion të njohjes vijnë prej atje, prej CSIS. Por nuk kanë qenë vetëm kontakte të nivelit të lartë politik: kam hapur horizonte të reja jo thjesht gjeografike, por dhe mediatike etj. Kam kontaktuar me shumë organizata, me universitete anembanë globit etj.

Aktualisht, *lobimin për njohje* e kam parë si një prioritet të ri të cilit i kushtoj shumë kohë dhe burime të miat financiare, njerëzore etj. Duhet ta them menjëherë se të qenit në Parlamentin e Kosovës më ka krijuar disa avantazhe në krahasim me periudhën e kaluar,



sepse tani jam pjesë e një përfaqësimi legal dhe të dëshmuar me votën e elektoratit. Unë kam të drejtë t'u premtoj zgjedhësve të mi se do të angazhohem maksimalisht në procesin e njohjes së Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Këtë nuk mund të ma ndalojë askush, sikundër që një angazhim i këtillë nuk mund të interpretohet



*Me gjeneralin Xhejms Xhons (James Jones), këshilltar i Sigurimit Kombëtar të Presidentit amerikan Barak Obama, 2009*

si injorim i institucioneve legale të Kosovës, sepse edhe unë jam pjesë e këtyre institucioneve, madje jam ligjvënës. Prandaj, refuzoj me indinjatë çdo spekulim që është bërë rreth angazhimeve të mia për ta çuar përpara procesin e njohjes, i cili, siç mund ta vërejnë të gjithë, ka pasur dhe vazhdon të ketë ngecje.

“Teknologjia” e punës sime është e thjeshtë dhe këtu nuk ka asnjë fshehtësi. Kështu Londra, fjala vjen, është një pikë jashtëzakonisht e rëndësishme prej nga tani e bëjmë lobimin për njohje të reja, sepse siç ju thashë për njohjet nuk nisem vetëm nga CSIS. Që të jem më i qartë, të them se në Londër, në Akademinë Diplomatike Mbretërore, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë frekuentues shumë kuadro diplomatike dhe qeveritare të shteteve të “botës së tretë”, të cilat janë shkolluar aty dhe më pas janë bërë ministra, kryeministra, diplomatë të karrierës, etj. Rasti e ka dashur që unë ta njoh dhe të krijoj lidhje miqësie me rektorin e kësaj Akademie, me të cilin kam bashkëpunuar, duke përfshirë në këtë proces edhe disa njerëz të parlamentit britanik. Këtë grup me dëshirën më të mirë për bashkëpunim dhe jo në mënyrë përjashtuese, ia kam prezantuar ambasadës sonë në Londër, që ata të bashkëpunojnë vetë në të ardhmen. Me grupin e Akademisë jemi fokusuar në dy pika kryesore: në Karaibe dhe në vendet e Lindjes së Mesme. Vendet e Karaibeve, 15 shtete, kanë qenë



*Me Presidentin e Republikës Dominikane,  
z. Leonel Fernandes Reyna, 2010*

nën ndikimin e politikës britanike dhe për të depërtuar në nivelet më të larta të vendimmarrjes në këto vende, ne kemi krijuar një ekip në Londër, të përbërë nga njerëzit që kanë miqësi dhe kontakte me ato vende. Kemi zgjedhur një emër shumë të njohur të bejzbollit amerikan, Sammuell Susa (Soussa), që gëzon reputacion të jashtëzakonshëm në këto vende dhe që ka, mes të tjerash, lidhje personale me Presidentin e Ekuadorit. Susa arrin të sigurojë kontakte të shpejta, sepse sporti dhe popullariteti i krijuar prej tij krijojnë mundësi për depërtim më efektiv në botën e njerëzve të politikës. Sot kur flitet për pajtimin nga ana e shtetit të një kompanie lobimi, më duket një mënyrë e gabuar për të harxhuar paratë e qytetarit të Kosovës. Kjo kompani do kërkojë para për të gjitha fazat e procesit, ndërkohë që katër kompanitë që unë tashmë kam pajtuar e kanë bërë gjysmën e punës. Shteti duhet të më kërkojë që të kontaktojë këto kompani dhe të vazhdojë me to punën e kryer. Si dëshmi që në punë të lobimit unë kam dashur dhe jam munduar të bashkëpunoj me institucionet, po përmend një fakt tjetër. Ne arritëm të organizonim një takim me të gjithë ministrat e jashtëm të këtyre vendeve karaibike, një lloj minisamiti, me ç'rast atyre do t'u drejtohej Presidenti ose kryeministri i Kosovës me një fjalim, në të cilin theksi kryesor do të vihej te njohja e Kosovës. Letrën ua kam dërguar Presidentit Sejdiu dhe kryeministrit Thaçi, por sot e kësaj dite nuk kam marrë ndonjë përgjigje ashtu njëjtë sikur letrat e tjera për ta, publike dhe jopublike. Përveç kësaj, caktuam Uiliam Uokerin për lobim në Salvador, sepse ai për një kohë të gjatë ka qenë ambasador në këtë vend dhe i njihnte mirë rrethanat e atjeshme. Por ndodhi që atje të bëhej një kalim revolu-

cionar i pushtetit dhe vonesa e njohjes erdh si pasojë e një ndërrimi në krye të shtetit. Presidenti i ri i Salvadorit nuk kishte njohuri për Kosovën dhe problemin e saj. Unë pata rastin të takohesha me të, një episod mjaft interesant, por s'po e tregoj këtu.

Vendet e Lindjes së Mesme kishin tjetër referencë lobimi. Ishin grupe të ndryshme që kryenin punë, varësisht se në cilin shtet duhej aranzhuar takimi. Për pjesën arabe duheshin të tjerë njerëz. Për Egjiptin dhe vendet më liberale duheshin prapë të tjera mënyra dhe të tjera grupe, kurse për Libinë ishte një shtytje tjetër dhe angazhim më i veçantë. Kontributi i zonjës Suha Arafat, në lobim në këto vende është i pakontestueshëm. Këtë proces e ndihmuan disa qeveritarë dhe disa miq të mi në Maltë. Kontributi i Michael Frenodos, ish-ministër i punëve të jashtme të Maltës, tani kryetar i parlamentit maltez, ka qenë i jashtëzakonshëm.

Theksova se punoj qoftë duke u vënë në lëvizje individualisht, qoftë duke përdorur stafin tim. Po ju tregoj nëpërmjet një shembulli konkret se si angazhohem në personalisht. Në konferencën e *Human Rights Watch* të mbajtur në Gjenevë më datë 4 mars 2010, unë dhe lobuesit e mi, pothuajse vendosëm zyrat dhe punuam fuqishëm aty ku ishte e mundur: te Suazilendi (Swaziland), Mozambiku, Botswana, Kenia, Nepali, Bangladeshi, Timori Lindor etj. U takuam, biseduam dhe prezantuam çështjen e Kosovës në mënyrë të detajuar. Efekti i këtij lobimi u pa (rasti i Suazilendit) dhe do të shihet në të ardhmen e afërt. Për këtë duhet të falënderoj pa masë shtetin mik të Kosovës, Republikën e Maldiveve, gjegjësisht mikun tim, ministrin e punëve të jashtme, Ahmed Shahid (Shaheed), i cili ka dhënë dhe është duke dhënë një kontribut të madh për promovimin e çështjes së Kosovës. Ahmed Shahid (Ahmed Shaheed) është ministri i jashtëm i Republikës së Maldiveve, shtetit ishullor më të vogël të Azisë. Shahid është një figurë e shquar e këtij shteti, me një emër të mirë si aktivist i shoqërisë së hapur në vendin e vet dhe me vlerësime ndërkombëtare nga organizata të ndryshme. Dr. Shahid, i martuar dhe me katër fëmijë, ka kryer studime në Britaninë e Madhe dhe në Australi. Ai është i njohur si mik i Kosovës dhe kontribues kryesor jo vetëm në njohjen e saj prej Maldiveve, por dhe më gjerë. Ka udhëtuar personalisht në Nju-Jork që të mbrojë Kosovën në Asamblenë e Për-



**Me liderin e Libisë, Muammar al Gadafi, 2010. Me të jam takuar disa herë, herën e fundit në tetor 2010.**

gjithshme të OKB-së disa herë; në kontaktet e tij me homologët e vet, kërkon vazhdimisht njohjen e Kosovës. Me kontributin tij kemi takuar rreth 100 kryetarë shtetesh dhe qeverish, mbretër, etj dhe shpesh ai ka vënë në dispozicion ambasadën e shtetit të tij për ndihmë. Më erdhi mirë veçanërisht në fillim të nëntorit 2010 kur vendi amë, Shqipëria

i rezervoi një pritje prej kryetari shteti dhe i akordoi një dekoratë të lartë. U prit nga Presidenti, kryeministri, zëvendëskryeministri, ministri i jashtëm i Shqipërisë dhe qyteti i Lezhës e nderoi me një Mirënjohje gjithashtu.

Ky nderim për mikun tim, është nderim për mua, jo vetëm sipas asaj fjalës së urtë se kush nderon mikun tënd, të ka nderuar dhe ty. Duke vlersuar kontributin e tij në njohjet e Kosovës, Shqipëria, por dhe Kosova, realisht kanë vlersuar kontributin tim. Pse? Sepse isha unë që e aktivizova Shahidin, isha unë që bashkë me të takuam shumë shtetarë në Njujork apo gjetkë dhe luftuam për njohje të reja, për rezolutën pro Kosovës, etj. Indirekt, diplomatët më të lartë të Kuintit që e takuan Shahidin në Prishtinë, praktikisht mirënjohën kontributin e tij dhe kërkuan të kuptojnë më shumë prej angazhimit tonë të përbashkët në funksion të njohjeve. Ishte kënaqësi që miku im Shahid së bashku me mua mori duartrokitjet e qendrave universitare më të mira në Kosovë, si AUK, apo dhe AAB Riinvest, universitet i cili i dha dhe titullin *Honoris Causa*.

Unë nuk kam marrë asnjë nderim për këtë aktivitet të madh, me përjashtim të titullit "Qytetar Nderi i Lezhës", të cilin e tërhoqa vetë në këtë qytet të jashtëzakonshëm në historinë e Shqipërisë, i njohur për besëlidhjen e Skënderbeut me princat dhe feudalët e kohës,



*Duke lobuar për Kosovën në Amerikë të Jugut, 2010*

kundër Turqisë. Ishte një nderim i madh për mua dhe ja thashë me zë pjesëmarrësve të shumtë në ceremoni, sesa i prekur ndihesha kur merrja atë nderim të miratuar unanimisht nga të gjithë këshilltarët e qytetit, pavarësisht përkatësisë së tyre politike. Lezha e kishte kuptuar se ajo që unë kisha bërë për njohjet, kishte vetëm frymëzim kombëtar, ndaj kjo vepër duhej nderuar si e tillë, si vepër kombëtare.

Nga 4-8 maj 2010, mora pjesë në forumin botëror të Dar Es Salamit, i organizuar nga Forumi i Davosit, ku pata mundësi të takoj jo vetëm Presidentin e Tanzanisë, të Zambias, Mozambikut, Kenias, Ugandës, Kongos, dhe të Afrikës së Jugut, por dhe të Namibisë apo të vendeve të tjera afrikane. Ndërsa ulesha në sallën *Julius Nierere*, atëherë në aeroportin *Julius Nierere*, më kujtohej ai burrë që kisha pasur rastin ta njihja kur isha ushtar dhe më kapën emocionet. M'u kujtua dhe gjyshi im profetik me parashikimet e tij për udhëtimin me "ballanë" dhe takimet me burrështetas. Isha i vetmi i bardhë dhe i vetmi njeri që nuk isha President i një shteti dhe takimet me këta



*Me Nabil Ayad dhe zëvendëssekretarin e përgjithshëm të OKB-së, Shabaan M. Shabaan*

burra vazhduan dhe më 29 maj në Nisë, në Konferencën e Organizatës Botërore të Frankofonisë.

Ishte pasditja e 19 majit 2010 kur mbërriti informacioni për njohjen e Kosovës nga Somalia. Ishte telefonata e një mikut tim që lobon fuqishëm për Kosovën, zyrtar i lartë i një shteti, i cili ka organizuar pjesën më të madhe të kontakteve të mia me krerët e shteteve të ndryshme, një njeri me shpirt të madh që e ka shndërruar lobimin për Kosovën në angazhimin e madh të jetës së vet. Më mbërritën njëkohësisht përgëzimet e ambasadorit të një shteti të madh, mik i madh i Kosovës, i cili ishte i informuar për detajet e punës sime për Somalinë, njohja e 69-të. Pos përgëzimeve të shumta nga shumë qytetarë, mora përgëzime dhe falënderime edhe nga Vlora Çitaku, zv.ministre e jashtme e Kosovës, gjë që ajo e bën rregullisht për të gjitha njohjet për të cilat ajo e di se janë meritë imja. Menjëherë pas këtij lajmi, pata takime të tjera gjatë konferencës së liderëve të shteteve afrikane në Nisë më 29 maj 2010, me Presidentët e Kongos, Namibisë, Angolës, Zimbabvesë, Mozambikut, Tanzanisë,

Çadit, me kryeministrin e Kenias.

*Por le të bëj një përmbledhje të shkurtër të këtij suksesi.* Si pasojë e lobimit tim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, deri në nëntor 2010 janë siguruar rreth 26 njohje. Peruja, Maldivet, Portugalia, Komoret, Malta, Republika Dominikane, e shumë shtete të tjera të Afrikës, Amerikës së mesme dhe Arqipelagut që njohën Kosovën, janë rezul-

tat edhe të lobimit tim dhe të njerëzve të mi. Lidhur me këtë kam patur takime të drejtpërdrejta me Presidentin e Republikës Dominikane, të Salvadorit, mbretin e Jordanisë, Presidentin e Maldiveve, ish-kryeministrin e Maltës, mbretin e Katarit, si dhe me Presidentin e Maltës, që tërhoqi dhe Portugalinë etj. Këto njohje nuk kanë ardhur lehtësisht, pa kundërvënien e palës serbe. Në Maltë, fjala vjen, unë isha në të njëjtën hotel me ekipin serb që vinte të bënte presion në parlamentin maltez, ku debatohej për njohjen e pavarësisë së Kosovës, pra jam përplasur me ta.

Në Doha, në një mbledhje të Konferencës Isla-



*Me kongresmenin Eliot Engëll (Eliot Engel) dhe ambasadorin Uoker*



*Me Zbignju Bzhezinski (Zbigniew Brzezinski) Këshilltar për sigurinë kombëtare i presidentit Karter (Carter)*



*Me ambasadorin Uoker në Salvador*

vlerësim institucional, natyrisht se ishte një satisfaksion për ne.

Ngjashëm kam vepruar edhe në vende të tjera. Kam lobuar me një mik bullgar në ishujt Komore, nga ku udhëtua duke sjellë me vete no-



*Me zonjën Suha Arafat si dhe dr. Michael Frendon, kryetar i parlamentit maltez*

mike, unë isha mysafir i Sekretarit të Ligës Arabe, Abu Musa. Ne lobuam shumë për Bahreinin dhe për njohjen nga ky vend merita ekskluzive na takon mua dhe stafit tim.

Meritë të posaçme unë dhe stafi im kemi për Perunë, gjë që u pranua publikisht nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi. Ai më ka përgëzuar në parlament dhe ky

tën verbale të njohjes nga ky shtet. Presidenti i këtij vendi e njihte Kosovën prej kohës së gjenocidit, kur në krye të opozitës kishte organizuar protesta të universiteteve kundër regjimit serb.

Jam duke lobuar në ish-vendet e BS që Rusia praktikisht i kushtëzon me rrjetin e vet të lidhjeve ekonomike e të tjera. Pas asaj që ndodhi në Gjeorgji, Rusia u ka vënë kusht atyre se nëse e njohin Kosovën, duhet të njohin edhe dy krahinat rebele të



Gjeorgjisë. Megjithatë ka shenja të përmirësimit të situatës në Azinë qendrore.

Jam duke lobuar edhe në Libi dhe me liderin e saj kam vendosur marrëdhënie respekti reciprok aq sa kam arritur të kem sukses në zgjidhjen e çështjes së pengjeve zvicerane. Jam takuar disa herë me liderin sugjektiv të Libisë, Muamer el



*Me Mbretin Abdullah II të Jordanisë, 2009*

Gadafin, të cilin e mbaj

mend që nga koha e ish-Jugosllavisë. Megjithëse lobimi në Libi has në vështirësi specifike për shkak të marrëdhënieve që ky vend ka me Serbinë, kemi arritur disa përparime. Libia ka njohur pasaportat e Kosovës dhe në fillim të tetorit ne organizuam një udhëtim të 120 qytetarëve tanë, studentë, profesorë, kosovarë që kanë punuar në Libi në kohën e ish-Jugosllavisë. Një ndryshim strategjie lobimi nëpërmjet kontakteve njerëzore, një përpjekje që dhe Kosova të marrë hisen e vet të miqësisë - njohjen nga ky vend i rëndësishëm. Libia është

vend që i ka restauruar të gjithë marrëdhëniet me perëndimin, ka pritur kryeministra të fuqive kryesore perëndimore, ka qenë anëtare e Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ndërsa Presidenti i Asamblesë së OKB-së aktualisht është libian. Libia drejton dhe Unionin Afrikan dhe ka autoritet kudo.



*Me zv. Presidentin e Salvadorit, z. Sançez Serez (Sanchez Cerez) dhe ambasadorin Uoker, 2009*



*Me fituesin e çmimit Nobel për Paqe,  
Presidentin e Izraelit, z. Shimon Perez*



*Me ish Presidentin e Kroacisë, z. Stipe Mesiq, mik  
i madh imi dhe i shqiptarëve, 2008. Ai ma bëri të  
mundur ta takoja Bushin në Zagreb*

Dy fjalë për stafin tim. Brenda tij ka njerëz nga Arabia Saudite, nga Maldivet, nga Jordania, nga SHBA etj. Një falënderim të madh i detyroj zotit Esat Puskar, një amerikan i ri me origjinë boshnjake i cili menaxhon me shumë profesionalizëm tërë axhendën time ndërkombëtare. Ai ka një arsimim të shkëlqyer, por edhe eksperiencë profesionale në Kosovë.

Kam udhëtuar në mbi 100 shtete të botës jo vetëm për shkak të profesionit, por edhe në funksion të njohjes së Kosovës. Udhëtimet janë shndërruar në pasion të jetës sime. Në njërin nga udhëtimet e mia në Nju-Jork, në një konferencë organizuar nga CSIS, pata rastin të takohesha dhe me ambasadorin rus, Vitali Çurkin, me të cilin pata një diskutim interesant, gjatë të cilit edhe ai u detyrua ta quante Kosovën një histori të vogël suksesi. Në po atë udhëtim, për të cilin kanë folur dhe mediat kosovare, kam takuar

Ban Ki Munin, sekretarin e përgjithshëm të OKB-së dhe ambasadorin e Pakistanit në OKB Abdullah Hussain Haroon. Ban Ki Muni më falënderoi për lirimimin e pengjeve të Koresë në Afganistan. Ai më tha se e ndiqte situatën në Kosovë me vëmendje të madhe dhe do të kishte dashur shumë që zhvillimet më të rëndësishme për Kosovën të ndodhnin në mandatin e tij. Ai tha gjithashtu se ishte i bindur se e vetmja zgjidhje për Veriun e Kosovës ishte ajo e përmirësimit të gjendjes ekonomike. Unë i fola për një zonë të lirë ekonomike atje, një ide që e përsëris shpesh dhe jam i bindur në dobinë e saj.

Jam optimist se udhëtimet e fundit do të sjellin njohje të reja, edhe falë mendimit këshillimor të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë dhe rezolutës së re të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që mirëpret këtë mendim. Nuk besoj se e teproj nëse them se gjatë gjithë procesit të GJND-së kam qenë jashtëzakonisht aktiv, dhe jo rastësisht mediat beogradase më quajnë



*Presidenti i Somalisë, Sheekh-Sharif Ahmed. Jam takuar me të në Asmara dhe kam kujtime të bukura nga një hotel ku mësova shumë nga ora biologjike e zogjve...*



*Presidenti i Perusë, z. Alan Garcia. Një personazh mjaft dashamirës. Më uroi i pari pavarësinë me telefonatë dhe e mbajti fjalën për njohjen*



*Me mikun, Presidentin e Tanzanisë,  
z. Jakaya Kikwete gjatë Forumit Botëror të  
Ekonomisë në Dar es Salaam, 2010*

takte me njerëz me ndikim nëpër botë, kontakte të cilat i kam krijuar nga aktiviteti biznesor, e kam parë të arsyeshme që të vazhdoj rrugën e nisur më herët. Dhe rezultatet janë evidente. Qytetari i Kosovës ka mundur t'i shohë vetëm ato që janë bërë publike, por pjesa më e madhe



*Me z. Ban Ki Mun (Moon), sekretari i përgjithshëm  
i OKB. Unë kisha ndihmuar në shpëlimin e kore-  
anëve dhe ai ishte mirënjohës për këtë.*

një prej "faktorëve" kryesorë të deklaratës prokoso-vare të Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës. Fundja, të gjithë e dimë rëndësinë e sa më shumë njohjeve për vendin tonë ndaj këto akte janë themelore. Rrugët integrale drejt avancimit të mirëqenies ekonomike të një Kosove të ndërlidhur ekonomikisht me botën varen shumë nga njohjet ndërkombëtare. Për këtë arsye, duke pasur kontakte me njerëz me ndikim nëpër botë, kontakte të cilat i kam krijuar nga aktiviteti biznesor, e kam parë të arsyeshme që të vazhdoj rrugën e nisur më herët. Dhe rezultatet janë evidente. Qytetari i Kosovës ka mundur t'i shohë vetëm ato që janë bërë publike, por pjesa më e madhe e punës, për shkaqe të njohura mbetet ende e papublikuar, por me kalimin e kohës edhe kjo do të mësohet.

Për punë të lobimit, si para, ashtu edhe pas shpalljes së pavarësisë, rregullisht kam informuar institucionet e Kosovës dhe u kam bërë thirrje që t'i bashkohen kësaj iniciative, sepse së bashku do të ishim më të fortë dhe më të suksesshëm. Kam kërkuar

miratimin e një strategjie të përbashkët me role të përcaktuara qartë për të shmangur dublimet, me kalendar të përcaktuar, me nderime institucionale për lo-buesit etj. por nuk kam marrë përgjegje institucionale. Kam hasur në heshtje dhe bojkotim. Një gjë është e sigurt: pa marrë parasysh a jemi në pozitë apo opozitë, promovimi i Kosovës në arenën ndërkombëtare është çështje madhore dhe obligim i çdo politikani a qytetari.

Lobimi kushton shumë dhe është i vështirë. Unë i bëj, megjithatë, me dëshirë këto shpenzime si qytetar i lirë dhe jam i lumtur që kontaktet e mia nuk vijnë duke shfrytëzuar beneficet e shtetit, apo fondet e varfra të tij. Gjatë punës sime për njohje, mjerisht, në vend të vlerësimit jam rrethuar shpesh nga një mur i lartë mosmirënjohjeje, ndjenjë bezdie nga zyrtarë të lartë të Kosovës, të cilët ndihen të rivalizuar në punën e tyre. Puna e tyre, fatkeqësisht, nuk ka mundësi mbase të ketë rendiment të lartë, shkak i disa kufizimeve të kuptueshme, por kjo s'duhet të jetë shkak që ata ta shohin me xheloz



*Me përfaqësuesin për Ballkanin të partisë qeverisëse të Barzanit në Irak, z. Ali Al-Baldawi, 2010*



*Me ministrin e punëve të jashtme të Ganës, z. Alhaji Mohammed Mumuni në Nicë, maj 2010*



*Me ministrin e punëve të jashtme të Suazilendit,  
z. Lufto Dlamini në Londër, shkurt 2010*

diçka thellësisht e paqenë kur dihet që Irani prej vitit 1979 e këndej nuk ka ambasadë në SHBA! Mediat u morën gjatë me atë rast, por kryesorja ishte se publiku, qytetarët e Kosovës, e vlerësuan dhe e vlerësojnë drejtë atë që kam bërë për njohjen e Kosovës dhe më dhanë mua të drejtë. Kjo u duk dhe nga qindra apo mijëra komente në faqen online të *Express*,



*Me ministrin e punëve të jashtme të Tanzanisë, z.  
Bernard Membe në Nicë, maj 2010*

madje edhe ta pengojnë punën time. Disa prej tyre edhe janë përpjekur të më fyejnë, siç ishte rasti i fundit me Presidentin e Kosovës (tani një ish) në të ashtuquajturën *çështje të Iranit*. Si viktimë e thashethemeve të stafit të tij, zoti Sejdiu më kishte telefonuar dhe më kishte qortuar se pse “ki-sa folur në emrin e tij në ambasadën iraniane në Uashington”! Kjo ishte

të mediave të tjera, apo në facebook, të shkruara shumica me një shqipe korrekte. Kishte shumë njerëz me shkollim të lartë dhe intelektualë mes lexuesve që më vlerësojnë. Pata shumë komplimente edhe prej njerëzve të rëndomtë, te të cilët gjeta nderim dhe mirënjohje për punën time. Ndaj përfitoj nga rasti t'i falënderoj përzemërsisht që të gjithë.

Do të doja ta sqaroj

edhe më çështjen e marrëdhënieve me institucionet, duke nënvizuar se kjo qasje e tyre ndaj meje, mund të dëmtojë kauzën e njohjeve të mëtutjeshme.

Unë jam përpjekur vazhdimisht të bashkëpunoj me institucionet e Kosovës për njohjet.

Kam komunikuar me to me shkrim, por s'kam marrë asnjë përgjigje, asnjë mirënjohje. Asgjë.

I kam ftuar të jenë pjesë e udhëtimeve të mia, por asnjëherë s'kam marrë përgjigje.

Mjerisht ndonjëherë kam pasur rastin të shoh sesi kanë shkuar të marrin merita për raste thuajse të konfirmuara njohjeje si këto që priten së shpejti, ndërkohë që ky libër do të shohë dritën e botimit.

S'kam folur fare për meritat që kam në rastin e Somalisë, për të cilat kam prova të pamohueshme të përpjekjes për përvetësimin e tyre. Nga miqtë tanë më të mëdhenj m'u rekomandua të prisja,



*Pas marrjes së titullit "Ambasador i Paqes" në Tiranë, 2009. Me ish-rektorin e Universitetit të Tiranës, profesor Shezai Rrokajn.*



*Me ministrin e jashtëm të Republikës së Zambias z. Jacus Pande, maj 2010*



*Me ministrin e punëve të jashtme të ishujve Maldive, z. Ahmed Shaheed dhe ambasadorën e këtij shteti në OKB. Ministri Shaheed mbetet figura më e ndritshme që lloboi për njohjen e Kosovës. E falënderoj nga zemra këtë burrë, që më hapi rrugë tek shumë shtete. Besoj se njerëzit e vullnetit të mirë të Kosovës do t'i jenë mirënjohës.*

t'u jepja rastin institucioneve tona ta bënin hapin e parë të sjelljes së tyre kalorësiake të mirënjohjes. Sigurisht si qenie njerëzore, si njeri aktiv në politikë, do të më pëlqente mirënjohja për punën që bëj, edhe nga politikanët, ndonëse vlerësimi i qytetarëve është parësor për mua. Por dhe nëse nuk ma njohin punën, të paktën të mos dublojnë gjërat. Kam përshtypjen se mungesa e koordinimit të punëve, një lloj dublimi apo markimi i aktivitetit tim për të më grabitur suksesin, prodhoi efekte negative në rastin e Tanzanisë. Ndërsa unë isha takuar dy herë me kreun e shtetit të këtij vendi, zoti Hyseni takohej me ambasadorin tanzanian në OKB. Ndoshta zgjedhjet në Tanzani, apo edhe vizita e Presidentit të Kosovës në Malawi, një vend me probleme kufitare me Tanzaninë, shtynë njohjen e premtuar publikisht nga ky vend.

Për fat të mirë, kam marrë vlerësime nga ministri i jashtëm i



Shqipërisë, Ilir Meta, i cili ka pasur rastin ta shohë nga afër punën time, veçanërisht nga fjalët e mira në adresë time të shqiptuara nga homologët e tij. Më kanë falënderuar dhe autoritete të tjera të larta të vendit amë, etj.

Viti 2010 ka qenë vërtet vit i veçantë për Kosovën, aq sa më është dashur të ndërhyj sërish në këtë libër për të reflektuar mbi ngjarjet e tij. Kështu, për shembull u publikua mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë, e cila e shpalli të ligjshme pavarësinë e Kosovës, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare. Ishte një gëzim i jashtëzakonshëm, megjithëse prej disa javësh po merresha me nënën e sëmurë, sa në spitalin e Prishtinës ku kreu një ndërhyrje delikate, sa në Zvicër, ku u kurua në vazhdim, për t'u larguar, megjithatë, nga jeta. Pikëpamjet e mia rreth kësaj ngjarjeje i shpreha në një editorial të botuar në pothuajse të gjithë gazetat e Kosovës, ku tentoja të hapja



*Me dr. Michael Frendo, ish ministër i punëve të jashtme e tani kryetar i parlamentit të Maltës, kontribues i madh për njohjen e Kosovës jo vetëm nga vendi i tij.*



*Ministri i Punëve të Jashtme të Vanuatusë, z. Xho (Joe) Natuman*



**Presidenti i Ishujve Komore, Ahmed Abdullah Mohamed Sambi. Gjatë takimit në Moroni, më tregoi se si lider i opozitës kishte udhëhequr protesta të universiteteve kundër genocidit serb. Si president, ma dha në dorë notën verbale të njohjes së Kosovës**



**Me Princin e Kentit, Michael. Dhoma Britanike e Tregtisë kërkoi që ai të strehohej në shtëpinë time në Prishtinë, por dikush nga qeveria e ndaloj! U mirëkuptuam shpejt në planin njerëzor ndërsa shëtisim në mes të Prishtinës dhe në disa takime vendosëm për bashkëpunimet e ardhshme në biznes për të mirën e Kosovës**

disa pista të reja në veprimtarinë e diplomacisë sonë dhe të shtetit të ri të Kosovës. Thëksosva se ky vendim, ky sukses nuk është vetëm i qeverisë dhe i institucioneve të Kosovës, por i mbarë klasës politike, popullit të saj, i miqve të mëdhenj të Kosovës, ku sigurisht shquhen Shtetet e Bashkuara, që zgjodhën të prisnin në takim pikërisht atë ditë kryeministrin e Kosovës. Por po e shtjelloj më hollësisht se çfarë mendoj unë për vendimin e GJND-së, institucion mjaft i njohur në Kosovë thjesht me inicialet e emrit.

Mendimi këshillimor i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në Hagë pro ligjshmërisë së pavarësisë së Kosovës është pagëzimi juridik i Kosovës së pavarur prej bashkësisë ndërkombëtare. Populli shqiptar i Kosovës, mbarë Kosova e meritonte një vendim të tillë, që u prit me gëzim në Prishtinë dhe në mbarë Kosovën, sikundër edhe në

Shqipëri, në Maqedoni dhe në viset tjera shqiptare.

Ky vendim është rezultati i ligjshëm i betejës sonë të parë juridike me Serbinë. Ne e fituam këtë betejë. Ne e mundëm Serbinë. Fushëbeteja jonë ishte në qendër të botës. Ne u përplasëm me Serbinë jo si më parë, por në mes të Europës, një ndeshje që u shndërrua në ndeshje globale për shkak të rreshtimeve të miqve tanë pranë nesh dhe miqve të Serbisë, kundër nesh. Bota u bë me ne dhe ne shtuam miqtë tanë. Me njohjet e reja, ata do të jenë më shumë. Si një njeri që kam kontribuar për njohjet, unë e ndiej lehtësinë që do të sjellë ky vendim në punën time të ardhshme dhe të institucioneve të Kosovës.

Ai ishte një vendim i jashtëzakonshëm, sepse u arrit me vësh-tirësi të mëdha, me një luftë të vendosur të të gjithë neve, por dhe të miqve tanë. Ky vendim nuk ishte meritë ekskluzive e një institucioni të vetëm, as vetëm e institucioneve, por e gjithë klasës politike ko-sovare, e gjithë popullit shqiptar, që kanë treguar pjekuri, vetëpërm-bajtje, dhe lidhje të fortë me vlerat perëndimore, që kur ka filluar lëvizja për pavarësi. Të parët që duhet t'u bëjmë homazh sot janë heronjtë e pavarësisë!

Ne duhet t'u jemi mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Ameri-kës, që kryesojnë frontin e miqve të Kosovës. Ata na ndihmuan gjatë Luftës së 1999 dhe më pas, ata besuan në pavarësinë tonë, ata besuan se Kosova do të jetë histori suksesi. Ata donin që të ishin bashkë me ne, pikërisht ditën e shpalljes së vendimit të Gjykatës. Ne e vlerë-suam shumë faktin që zëvendëspresidenti i SHBA-ve, Bajdeni, njëri nga miqtë më të mëdhenj të Kosovës dhe të popullit shqiptar e takoi kryeministrin tonë pikërisht ditët e shpalljes së mendimit të GJND-së.

Ne vlerësojmë shumë Bashkimin Europian i cili ka punuar dhe do të punojë me siguri që të garantojë perspektivën europiane të Kosovës. Ne duhet patjetër t'u jemi mirënjohës shteteve të mëdha europiane, si Britanisë së Madhe, Francës (Presidenti francez Sar-kozy i shkroi menjëherë zotit Sejdiu), Gjermanisë, Italisë etj., që gji-thashtu na mbështetën fuqimisht. Ne e vlerësuan faktin që Bashkimi Europian i imponoi Serbisë një rezolutë ku respektohet mendimi i GJND-së, diçka që zhvleftësoi që në start përpjekjen e radhës të Ser-bisë për të penguar Kosovën.

Serbia tani duhet të heshtë në lidhje me këtë çështje. Ajo duhet të harxhojë energji në drejtim tjetër, në drejtim të paqësimit të marrëdhënieve me Kosovën. Në drejtim të zgjidhjes së gjithë atyre problemeve që kanë mbetur pa u zgjidhur dhe për këtë ne presim të trajtohem me respekt dhe në paritet të plotë. Edhe inisiativa e re e saj për një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, do të dështojë me siguri.

Mendimi këshillues i GJND hap një perspektivë të re për Kosovën, për rajonin dhe faktorin shqiptar në përgjithësi.

Pas vendimit të fundit të saj ne presim që brenda pak kohësh OKB-ja të ndryshojë qëndrim ndaj Kosovës. Ne presim që brenda pak kohësh Këshilli i Sigurimit, me këtë dokument juridik të ri, i cili e zhvlerëson përfundimisht edhe *de jure* Rezolutën 1244, të miratojë një rekomandim të ri për Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së dhe kjo nga ana e vet, një rezolutë të re që ta pranojë Kosovën në familjen e kombeve, si anëtare me të drejta të plota. Duke u mbështetur tek Karta e OKB-së në lidhje me anëtarësimet e reja, unë mendoj se lufta për pranimin e Kosovës në OKB zhvillohet në Këshillin e Sigurimit në fillim dhe pastaj në Asamblenë e Përgjithshme ku kandidatura jonë duhet të marrë dy të tretat e votave të 192 shteteve anëtare të OKB-së. Ne shpresojmë se me klimën e re të marrëdhënieve që ekzistojnë midis anëtarëve të këtij Këshilli, me të drejtë vetoje, përkatësisht midis SHBA-ve dhe Rosisë, apo Kinës, një rezolutë e re që zë fill prej Këshillit të Sigurimit është objektiv i mundshëm në muajt që do vijjnë. Fitorja e Kosovës në Asamblenë e OKB-së, do të krijojë një forcë tjetër presioni mbi Këshill.

Mendimi Këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë konfirmon sovranitetin territorial të Kosovës, paprekshmërinë e kufijve të saj. Ndaj ne rikonfirmojmë me forcë kundërshtimin ndaj çdo imponimi, ndaj çdo skenari për territorin e Kosovës.

Ne presim që pas vendimit të GJND -së, energjitë tona, të klasës politike, të shoqërisë sonë, të përqëndrohen në drejtim të:

- a) një strategjie të re për njohjet, që patjetër duhet të përfshijë dhe punën për rezolutën e re të OKB-së dhe
- b) ne duhet ta bëjmë funksional shtetin tonë të ri me institucione të reja, të forta, të besueshme, garanci e shtetit ligjor. AKR-ja zotohet se

në përputhje me stadin e ri ku ka arritur Kosova, do të zhvillojë një opozitë reale, të drejtë dhe që mbron interesat e popullit të Kosovës. Kjo arritje e madhe e popullit shqiptar të Kosovës nuk duhet t'i dehtë institucionet në fuqi. Ato duhet ta kuptojnë këtë moment si marrje përgjegjësish më të mëdha, si moment reflektimi për kritikën që i janë bërë nga ana e opozitës dhe të kuptojnë se Kosova është e të gjithëve.

Sot shqiptarët janë më të fortë. Më të qetë. Dhe kur shqiptarët janë më të fortë dhe më të qetë, ata nuk abuzojnë me forcën e tyre, por i japin qetësi rajonit. Por ata duhet të respektohen më shumë. Ky ishte reflektimi im në formën e një editoriali për mendimin këshillimor të GJND-së. Pas tij unë nuk e ndiej veten komod të rri duarkryq. Nga përvoja di që dashamirësi i vërtetë nuk pret ditë tjetër që të tregojë qasjen miqësore ndaj teje (bëhet fjalë për vendet dashamirëse të Kosovës), ndërsa ai që ka qasje destruktive gjithmonë kërkon arsye ta shtyjë gjestin bamirës!

Me këtë rast besoj se vendimi i GJND-së, megjithëse hapi pista të reja nuk do të jetë i mjaftueshëm, por ne duhet të bëjmë procesin e njohjes, në mënyrë të koordinuar dhe sofistikuar!

Unë jam duke e bërë pjesën time të punës! Përforcova grupin tim lobues me njerëz me ndikim të madh nga mediat ndërkombëtare si CNN dhe BBC. Jam në bashkëpunim e sipër me z. Peter Hargaty për shtetet e Karaibeve dhe organizatat sportive, me z. Daniel De Magalhães për Venezuelën, Brazilin dhe Bolivinë, si dhe me znj. Daphne Barak për shtetet e Afrikës.

\*\*\*

Në kuadër të diskutimit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së të një rezolute të re për Kosovën, në shtator 2010, unë zhvendosa në Nju-Jork shtabin tim dhe mora kontakte me mbi 30 delegacione për të bllokuar votimin e një rezolute serbe negative për Kosovën. Kur rezoluta u modifikua tërësisht nën presionin e BE-së dhe SHBA-ve, atëherë kahu i angazhimit tonë ndryshoi. Ne u kërkuam bashkëbiseduesve në dhjetëra biseda me ta - ministra të jashtëm, kryeministra, presidentë, ambasadorë, që pas kësaj rezolute të vendosnin sa më shpejt për njohjen. Në gati tri javë së bashku me ekipet e mia lobue-

se ne zhvilluam një inkursion të vërtetë diplomatik. Unë shkova nga Nju-Jorku në të gjithë shtetet e Karaibeve, madje në disa prej tyre dy herë. Solla njohjen e Hondurasit, për të cilën kisha punuar gjatë së bashku me ekipin tim. Presidenti honduren, e shkroi në praninë time notën diplomatike. Morëm premtime të sigurta nga disa vende. Biseduam me Timorin Lindor, një vend me histori të ngjashme me Kosovën. Kishin pasur një referendum të pezulluar pro pavarësisë, një mision të OKB-së, dhe kishin Bill Klintonin si tutor të pavarësisë së tyre, të fituar pas një periudhe të gjatë koloniale, prej një shteti të madh me një fe tjetër. Ja përmenda ngjashmëritë ministrit të jashtëm timorez i cili e njihte mirë Kosovën. Aq e rëndësishme simbolikisht është njohja prej Timorit, sa për ta bllokuar në drejtim të atij vendi të largët kishte shkuar ministri serb i mbrojtjes Dragan Shutanovac. Dhe ministri timorez na premtoi se njohja ishte vetëm çështje procedurash. U takuam me drejtuesit e shtetit të Kiribatit që e mbajtën fjalën dhe e dërguan njohjen në tetor 2010. E pasoi Tuvalu-ja si shteti i 72-të që njeh Kosovën.

Po e mbyll këtë kapitull me diçka apolitike për udhëtimet anembanë botës për Kosovën. Jeta vazhdon dhe unë shtegtoj vazhdimisht. Jam në kërkim të horizonteve të reja jo thjesht gjeografike. Kontaktoj regjime të ndryshme, gjuhë të ndryshme, raca të ndryshme. Dëshira për liri dhe për një jetë më të mirë është e njëjtë kudo. Si në Kosovë. Sfidat jetësore janë të intensitetit të lartë dhe gjithmonë mbetem me shpresën se një ditë unë dhe stafi im gjithë këtë eksperiencë do ta jetësojmë në qeverinë e Kosovës që do të jetë e një stili krejt tjetër. Puna vazhdon...

## Angazhimi im partiak në AKR dhe klasa politike e Kosovës

*Përfshirja ime e plotë në politikë. Shndërrimi i AKR-së në parti. Suksesi i saj si forca e tretë e Kosovës. Shpresa që krijoi kjo parti me program të qartë, me zgjidhje për të gjitha problemet e Kosovës, veçanërisht ato ekonomike. Por mbi të gjitha si parti intelektualësh, nga e gjithë Kosova, e cila nuk ishte përluter në qeverisjet që pasuan njëra-tjetrën pas çlirimit të Kosovës. Vizioni i AKR-së për të ardhmen. Gjykime për protagonistët e klasës politike kosovare.*

**M**e të përfunduar misionin e lobimit në Uashington, në vitin 2006, unë u ktheva në Prishtinë, me idenë që të hapja një zyrë kontaktuese të AKR-së. Tashmë ideja fillestare për AKR-në, ishte modifikuar: unë dhe miqtë e mi në SHBA e shihnim si lëvizje në terrenin kosovar dhe më pas si parti politike.

Në ceremoninë e rastit erdhën shumë njerëz, pushtetarë, njerëz të politikës dhe intelektualë. Kjo ceremoni më bëri të kuptoj se kishte ardhur koha të ndryshoja diçka në punën time rreth Kosovës. Isha duke menduar se duhej të futesha në politikë, ndonëse shumë gjëra rreth politikës ende nuk i kisha të qarta. Nuk i dija rregullat e lojës në këtë fushë, e cila për mua shumë kohë kishte qenë e huaj, madje ndaj të cilës në të shkuarën shpesh isha sjellë me mosbesim. Por Kosova s'kishte kohë për të humbur dhe asaj i duheshin të gjithë, pra dhe unë. Edhe unë s'kisha kohë për të humbur. Më kujtohej jo vetëm thënia e De Golit mbi seriozitetin e politikës që s'u duhej lënë politikanëve, por dhe një thënie tjetër e një autori anonim. *Kush e ndien veten shumë të mençur për t'u marrë me politikë, do të qeveriset nga budallenj* - thoshte ai.

Në një rrethanë të këtyllë, duke mos pasur përvojë me organizime partiake, vendosa të kërkoj ndihmë e këshilla nga të njohur të mi. Ndër të parët që kontaktova ishte Ibrahim Makolli, ndërsa mes analistëve ishte Baton Haxhiu, të cilët më inkurajuan shumë. Batoni më tha se momenti ishte shumë i volitshëm, se kishte shans për një



*Mes mbështetësve të mi në kongresin e AKR-së*

forcë të re, se në zgjedhjet e afërta që do të mbaheshin, ne mund të bëheshim forca e tretë politike në vend, duke fituar 11-12% të votave. Edhe Agim Zatriqi, ish-drejtor i RTK-së, në një bisedë private, më foli gjatë për nevojën e një fryme të re në spektrin politik të Kosovës. Për këtë bisedova edhe me ish-shokun tim të klasës, mikun tim të ndjerë Mustafë Sopin, i cili pat deklaruar se nuk do të kursente asgjë që të fillonte punën në një parti politike që do ta udhëhiqja unë. Vendimin përfundimtar për formimin e partisë politike e mora pas një bisede të gjatë me Makollin, njeri që njëjtte shumë mirë rrethanat e asaj kohe në Kosovë. T'ju them të drejtën, prej tij për herë të parë kam dëgjuar për mundësitë dhe vështirësitë që mund t'i ketë një parti





*Duke uruar Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi, për shtetësinë e Kosovës*

politike, gjegjësisht një politikan në Kosovë. Pra nuk vendosa vetë për themelimin e AKR-së, por miratimin e mora nga shumë njerëz. Unë atyre ua besova komplet skemën e organizimit partiak, të cilin nuk e njihja. Mbi të gjitha, ata ma bënë të njohur se si funksiononte një parti politike, cilat do të ishin sfidat e ardhshme, të mirat dhe të këqijat e mundshme, por gjithnjë duke më sugjeruar që të bëhesha i duruar, i kujdesshëm etj. Bashkë me një grup miqsh morëm vendim për themelimin e partisë dhe në tetor të vitit 2006 mbajtëm Kuvendin themelues. U befasova për të mirë nga numri i madh i njerëzve që u afruan, veçanërisht i intelektualëve, individëve me reputacion të lartë moral e kombëtar, të cilët nuk ndiheshin të përfaqësuar në



*Gjatë nënshkrimit të Deklaratës për Pavarësinë e Kosovës*

partitë e ashtuquajtura të mëdha. Emrat e disa individëve si profesor Hajzer Hajzeri, gjenerali Ramadan Qehaja, Arif Krasniqi, i cili u nda nga jeta në kohë të fundit, profesorë dhe doktorë shkencash etj., ishin surprizë e veçantë.

Kuvendi ishte organizuar në mënyrë moderne prej Baton Haxhiut, dhe organizimi tërhoqi një vëmendje të jashtëzakonshme. Menjëherë filloi puna dhe vetëm pas 10 muajve na u desh të ballafaqoheshim me zgjedhjet. Kishim krijuar ndërkaq 300 degë dhe nëndegë. Bëmë një fushatë moderne, e cila i habiti të gjithë. Rezultati doli çuditërisht pozitiv, madje pak më i lartë sesa kishte paraparë Batoni: në zgjedhje fituam 13% të votave dhe u bëmë forca e tretë politike në vend. Ishte fitorja më spektakolare dhe më befasuese në zgjedhjet e vitit 2007 në Kosovë. Mora ngado informacione për vjedhje votash, por me



*Duke i uruar shtetësinë e Kosovës Presidentit z.Fatmir Sejdiu*

vetëdije i injorova ato. Nuk doja që zgjedhjet e para parlamentare të Kosovës së lirë, që përgatitej të pavarësohej, të përbalteshin dhe aq më pak që unë të isha një nga ata që të gjuanin baltë mbi atë proces. Nuk kisha asnjë padurim për pushtetin.

Me angazhimin tim politik në Kosovë, fillova t'i njoh njerëzit në një dritë të re. Duke mos jetuar në Kosovë kisha sigurisht në mënyrë të vazhdueshme probleme në përzgjedhjen e njerëzve. Në përpjekje për të pasur një përfaqësim sa më të balancuar moshash, krahinash, formimesh në grupin tim parlamentar, mund të kem bërë dhe ndonjë gabim. Nuk njihja shumë njerëz në partitë e tjera dhe në përgjithësi. Kishte rrjedhur shumë ujë që nga koha kur unë udhëtoja shumë në Kosovë dhe njerëzit mbase kishin ndryshuar.

Ndër momentet më të rëndësishme të jetës sime, që më duhet



*Me grupin parlamentar të AKR-së para Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës*

ta evokoj në mbyllje të këtij rrëfimi, është pa dyshim *shpallja e pavarësisë së Kosovës*. Kjo është ndoshta ngjarja më madhështore dhe më mbresëlënëse që ma dhuroi politika. Nuk e kisha menduar ndonjëherë se do të vija nënshkrimin tim në deklaratën për pavarësinë e asaj Kosove, e cila gjatë jetës më kishte shkaktuar shumë dhembje, por që gjithmonë më kishte bërë të ndihesha krenar, kudo që kam qenë. Kisha aq shumë emocione, sa që mezi e mbaja lapsin në dorë. Unë tashmë isha bërë qytetar i botës, por tërë jetën kisha udhëtuar nga një vend në tjetrin me identitet të huaj, me dokumente të shteteve të tjera. Tani unë kisha shtetin tim, kisha identitetin tim. Ky ishte momenti më domethënës dhe më i rëndësishëm i jetës sime. Pastaj më erdhën shumë urime, nga njerëz që më njihnin, anekënd botës, përfshirë edhe kryetarin e Kazakistanit, i cili e kishte ndjekur në CNN aktin e shpalljes së pavarësisë. Më thirri në telefon

dhe, bashkë me urimin, m'i tha edhe këto fjalë: "Të jesh krenar për shtetin tënd!" Një urim të ngjashëm e kam marrë edhe nga kryetari i Perusë. Por befasi e madhe për mua ka qenë një urim në gjuhën ruse, një sms, të cilin e ruaj ende në telefonin tim. Bëhet fjalë për njërin nga personalitetet më të rëndësishme të politikës ruse, të niveleve më të larta, i cili, përpos urimit, shpalljen e pavarësisë së Kosovës e quante "një punë e mirë".

Ajo që gjithashtu më ka impresionuar me rastin e shpalljes së pavarësisë, ka qenë edhe shkalla e lartë e unitetit manifestuar prej faktorit politik të Kosovës dhe mënyra e mrekullueshme si festuan bashkëkombësit e mi. Kurrë kosovarët nuk kanë qenë më të bashkuar, pavarësisht nga dallimet, pavarësisht nga përkatësitë e ndryshme politike. Ishte një unitet shembullor - jo vetëm i partive, i cili, do të doja të zgjaste më shumë. Mund të dukem naiv politikisht, por sipas meje Kosova nuk duhet të jetë, së paku, për një farë kohe fushëbetejë e përplasjeve të ashpra politike. Kjo është Kosova e të gjithëve. Ne mund të kemi pikëpamje dhe interesa të ndryshme, por interes yni sipëror do të duhej të ishte prosperiteti dhe ardhmëria e shtetit tonë, të cilin e bëmë me aq mund e sakrificë. Por sigurisht brenda këtij uniteti kishte dhe ka dallime për të cilat do doja të flisja pak nëpërmjet disa gjykimeve të personalizuar.

Dua t'i them disa gjëra, ashtu shkarazi dhe jo në mënyrë shteruese për *Hashim Thaçin*, për të cilin kam fituar përshtypjen më të mirë gjatë Konferencës së Rambujesë, me ç'rast kam vërejtur se ai dinte të mbronte vendosmërisht kauzën tonë të drejtë. Por deri në vitin 2005, nuk kisha pasur rast ta takoj personalisht. Kjo ndodhi vetëm në një promovim të *Mabetex-it*. Herën tjetër e kam takuar kur promovuam *Aleancën Kosova e Re*, jo si parti politike, por si lëvizje. Më kujtohet se ai erdhi në atë promovim bashkë me Fatmir Limajn dhe aty kemi biseduar gjatë. Më pas kanë vazhduar kontaktet më të shpeshta, megjithëqë në promovimin e AKR-së si parti politike, ndonëse ishte i ftuar, nuk erdhi. Ishte ajo kohë kur qarkullonin shumë thashetheme për ardhjen time në Kosovë dhe duket se Thaçi kishte rënë, pak a shumë nën ndikimin e këtyre spekulimeve. Ndërkaq, gjatë viteve 2006-2007, takimet e mia me Hashim Thaçin u intensifikuan, sidomos pas zgjedhjeve. Ç'është e vërteta, pas zgjedhjeve të 2007-s,

Thaçi më bëri ofertë për koalicion, por unë kam refuzuar. I kam thënë decidivisht: - Harroje AKR-në, harroje Behgjet Pacollin, ti duhet të bësh koalicion të tillë për Kosovën, i cili favorizon stabilitetin dhe konsensusin sa më të madh rreth proceseve në Kosovë. Në këtë kuadër, më është përmendur edhe oferta që unë të bëhesha kryetar i Kosovës, por për mua kjo ishte diçka e papranueshme, sepse me 13% të votave nuk mund të bëhesha njeriu i parë në Kosovë. Po t'i kisha fituar, ta zëmë 30%, atëherë do të kisha biseduar ndryshe. Këtë ia kam thënë kryeministrit Hashim Thaçi asokohe. Por një gjë duhet thënë me siguri: unë nuk kam pasur asnjëherë interesa të përbashkëta politike me Hashim Thaçin. Megjithatë, duhet të shtoj se po të mos ishte partia ime, AKR-ja, që ia mori elektoratin LDK-së, Hashim Thaçi nuk do të bëhej kryeministër.

Edhe pse rrugët e AKR-së dhe të PDK-në janë të ndryshme si për nga vizioni e programi, ashtu edhe për nga mënyra e punës, unë ushqej respekt për udhëheqësit e PDK-së, për kryetarin e kësaj partie dhe strukturat e saj. Ky respekt mbështetet mbi një bazament të shëndoshë si edukata ime familjare. Respekti duhet të kthehet me respekt, pa marrë parasysh vizionin dhe interesat e veçanta. Vlerësimi i PDK-së për ne nuk ka munguar. Asnjëherë nuk është përfolur, as sharë padrejtësisht askush nga AKR-ja dhe kjo më ngjall respekt. Shumë njerëz këtë e shohin si afërsi politike, por gabohen. Unë i garantoj se programi im dhe i AKR-së, që për mua është i shenjtë, ndryshon nga ai i PDK-së dhe çdo afërsi politike me PDK-në apo me ndonjë subjekt tjetër në të ardhmen, do të duhej të shprehte programin dhe vizionin tonë qeverisës për Kosovën. Ky respekt nuk ka prodhuar servilizëm, por qasje konstruktive. Pa marrë parasysh interesin tim apo të AKR-së, unë kam vlerësuar punën e qeverisë kur kam konsideruar se është punuar mirë, dhe do ta bëj këtë edhe në të ardhmen. Dhe e kundërta. U kam thënë dhe do t'u them haptas se nuk do ta kenë mbështetjen time kur nuk e kanë mirë, dhe do të më kenë kundërshtar. Shpeshherë, veçanërisht kohët e fundit, pas hapjes së hetimeve për korrupsion, unë jam pozicionuar si opozitë e fortë kritike, por dhe propozuese. Jam kundër privatizimeve të mëdha, me këto mënyra dhe në këtë kohë, që nuk i sjellin asgjë në afat të shkurtër Kosovës. Kam qenë kritik ndaj qasjes ekonomike

të qeverisë Thaçi, për klimën ndaj biznesit etj. Kam ofruar zgjidhje alternative për privatizimet, për koncesionimet, etj, veçanërisht për PTK-në dhe aeroportin e Prishtinës, për të cilin kam bërë opionencë të fortë.

Unë nuk di tjetër se përse mund ta kundërshtojë opozita qeverinë në një vend normal! I bëj këto reflektime pasi sot (26 nëntor 2010) Kosova ka hyrë në zgjedhje të parakohshme sepse kjo qeveri ra. Gjykata Kushtetuese mori një vendim që konsideronte se zoti Fatmir Sejdiu kishte shkelur kushtetutën duke mbajtur dy mandate, atë të presidentit dhe atë të kryetarit të shtetit, dhe dorëheqja e tij nga meraku i shkarkimit e futi vendin në krizë institucionale. Zinxhiri i shkeljeve të kushtetutës vijoi me emërimin e zotit Krasniqi si ushtrues i detyrës së Presidentit, pa kaluar në zgjedhjen e pasuesit të Sejdiut nga parlamenti. U vijua me emërimin antikushtetues prej zotit Krasniqi të 149 gjyqtarëve në një ditë. U vijua akoma dhe më me largimin e 6 ministrave me urdhër të kryetarit të tyre, zotit Sejdiu. Ata as nuk u zëvendësuan prej PDK dhe vendi u zhyt në një krizë institucionale të paprecedent. Në këto kushte, pasi thirrëm një tryezë të partive të opozitës, vendosëm të formulonim një mocion mosbesimi për qeverinë dhe ta dërgonim për votim në parlament. Donim të frenonim abuzimet që po bëheshin me pronën publike deri në zgjedhje, t'i jepnim vendit sa më shpejt institucione, ndaj zgjodhëm mocionin si rrugë për të shkuar tek vota. Disa parti na akuzuan në mënyrë absurde për mocionin, duke na akuzuar si satelitë të PDK-së. LDK-ja kishte qenë deri para një jave në qeveri me PDK-në dhe guxonte të na akuzonte kështu! Edhe AAK-ja vetë na sulmonte megjithëse kishte hyrë në negociata të fshehta me PDK-në, dhe ndoshta donte që atë mocion, të parin në historinë kushtetuese të Kosovës ta paraqiste vetë. Të akuzoheshë prej saj se bënim lojën e PDK-së, ishte diçka absurde nga goja e tyre. Me rastin e votimit të mocionit, unë mbajta një fjalim të fortë akuzues për qeverinë në parlament dhe pak a shumë pohova se "ju kisha thënë se koalicioni juaj ishte i panatyrshëm... Ne ju votuam si qeveri, për të realizuar disa reforma të shtetësisë, megjithëse vota jonë s'ju duhej... Sot ju duhet të ikni, pasi keni dështuar në të gjithë premtimet tuaja, për autostrada, drita 24 orë, rend dhe siguri për të gjithë, etj, etj...".

Në skenën politike të Kosovës, nuk është vetëm PDK-ja. Në këtë kontekst dua të them se po të kisha (para zgjedhjeve 2007 dhe para se dikush prej tyre të provonte të më fyente) një ofertë dinjitoze nga LDK-ja, e në përkim me programin tim, për hir të së kaluarës, unë do t' i isha bashkuar LDK-së. Këtu ka edhe një faktor, që nuk ka qenë pa ndikim tek unë: familja ime ka qenë mbështetëse e flaktë e Rugovës, sidomos babai im. Tani më duhet të them se LDK-së i mungonte strategjia, se shumë njerëz të saj nuk shohin larg dhe gjithnjë e më shumë ngatërrohen me këmbët e veta. Ka një lloj shprese se me ardhjen në krye të saj të *Isa Mustafës*, LDK do të bëhet më e fortë, por le të shohim sesi do të votohen nga elektorati.

Unë nuk mund të harroj se gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare të 2007 dhe ato lokale të 2009 më së shumti kam qenë i atakuar pikërisht nga LDK-ja. Siç ju thashë edhe në vigjilje të këtyre zgjedhjeve, jam akuzuar prej tyre. Kurrë nuk arrita t'ia shpjegoj vetes përse ndodhte diçka e tillë. Përse më veshën atributet e kundërshtarit politik të LDK-së? Platforma ime politike nuk ishte kundër LDK-së, siç nuk ishte kundër asnjë partie tjetër. Unë vetëm ofroja një alternativë, një projekt për Kosovën e re, për Kosovën shtet, të cilën ata, të preokupuar asokohe me pushtetin dhe me përfitimet e veta, e kishin harruar se ekzistonte. As atëherë, as sot, unë nuk jam fajtor pse LDK-ja hyri në krizë pa shtegdalje. Fajtorët le t' i kërkojnë brenda radhëve të veta.

E shoh të udhës të ndalem pak te mosdurimi i disa krerëve të LDK-së ndaj meje.

Mediat me tituj sensacionalë kanë shkruar për sulmet që m'i bënin disa drejtues të lartë të LDK-së. Derisa disa prej tyre nuk kanë pasur asnjë të mirë, as të keqe nga unë, dikush-i ka parë vetëm të mira. Ai ka qenë edhe në mjediset e firmës time, kurse unë kam qenë nikoqir i tij. Rebelimin e tij kundër meje, e lidh me tregimin e gjyshit tim për kinezin e vjetër. Derisa frustrimet e disa liderëve të LDK-së, mund t' i kuptoj, nuk mund assesi t' i kuptoja fyerjet e ish-Presidentit të Kosovës, zotit Fatmir Sejdiu dhe të një ish-ministri. Gjatë fushatës së zgjedhjeve parlamentare të 2007, dhe më vonë ata kanë prezantuar institucionet e Kosovës dhe u është dashur të jenë neutralë, pasi që këto insitucione ishin edhe të miat, të elektoratit tim. Komentet e ish-Presidentit



Fatmir Sejdiu për Kazakistanin gjatë fushatës zgjedhore të 2007, e që u transmetuan edhe nga mediat kazake, ishin një hap i pamenduar politik. Ish-Presidenti Sejdiu, sot i larguar dhe nga kryetar i LDK-së, mbase nuk e dinte se Kazakistani është shtet i cili ndaj Kosovës kishte gjithmonë qasje pozitive, duke pranuar pasaportat e UNMIK-ut dikur e tani edhe të shtetit të Kosovës, pa kurrfarë komplikimi për marrjen e vizave. Kosovarët, ndërkaq, detyroheshin të shkonin të punonin në Kazakistan, sepse qeveria, institucionet e Kosovës nuk u kishin dhënë shanse në vendin e tyre. Unë i punësoja ata për t'i ndihmuar e jo për të shtuar fitimet e mia, siç e kam shpjeguar më sipër. Dikushi tjetër nga LDK-ja, pos që u mundua të më fyente mua, ofendoi gjashtë mijë punëtorët kosovarë të *Mabetex-it*, që punonin në disa vende të huaja.

Unë kam një përgjigje për ata që përflasin ardhjen time nga biznesi, qofshin të LDK-së, apo jashtë saj: unë vij nga familja ime e madhe kozmopolite e *Mabetex-it*, ku punonin dhe punojnë mijëra njerëz nga Kosova dhe nga e gjithë bota. A është Rusia apo Carteguai vendi ku punojmë, kjo nuk ka rëndësi.

E rëndësishme është që ne vijmë nga punishtet ku kryhen punë dinjitoze (e jo nga zyrat ku fliten fjalë boshe dhe ku nuk bëhet asgjë); ne punojmë me njerëz të ndershëm e dinjitozë (jo me ata që në vend se të rrezatojnë respekt e dashuri për njeriun, prodhojnë frustrime); ne arrijmë rezultate dinjitoze me kosovarë që paguhen në mënyrë të denjë, paga që kanë shërbyer si burim i ekzistencës për qindra mijëra njerëz dhe mijëra familje.

Edhe diçka. Nëse këta njerëz nuk e dinë, unë do të doja t'u tregoj se biznesi dhe politika i kanë rrugët të ndara. Unë dhe firma ime kemi bërë biznes sipas rregullave të biznesit dhe jo sipas formateve politike. *Mabetex-i* ka bërë biznes në vendet e Lindjes, por edhe të Perëndimit, pa marrë parasysh dallimin ndërmjet ideologjive. Edhe kur dy shtete dallojnë ideologjikisht dhe nuk kanë kurrfarë marrëdhëniesh, është biznesi ai që në një mënyrë i ruan lidhjet. Unë asnjëherë më parë nuk kam qenë i interesuar të merrem me politikë, deri në momentin kur mora vendim të kontribuoj për vendin tim duke krijuar një parti politike. Pas kësaj gradualisht jam tërhequr nga biznesi.

Gjykimet e mia për LDK-në janë në suazat e parimit të shpallur

publikisht në fushatën e zgjedhjeve lokale të 2009 se ne në AKR nuk kemi lista të bardha apo të zeza partish për koalicione. Ne jemi për bashkëpunim me njerëzit e vullnetit të mirë të të gjitha partive dhe këtu unë dua të veçoj vlerësimin tim për kryetarin aktual të komunës së Prishtinës, zotin Isa Mustafa, i cili u zgjodh kryetar i LDK-së. Megjithatë mosmarrëveshjet e LDK-së me zotin Ukë Rugova duan të thonë diçka. Si zoti Mustafa ka edhe individë të tjerë në LDK dhe në partitë e tjera, me të cilët jemi të gatshëm të bashkëpunojmë për të mirën e Kosovës.

Në pikëpamjet e mia për figurat e ndryshme publike të Kosovës, dua të them disa fjalë edhe për *Rexhep Qosen*, këtë ideolog të çështjes kombëtare. E kam admiruar gjithnjë këtë njeri, me librat e të cilit janë mbujtur kombëtarisht gjenerata të tëra të rinjsh dhe të rejash. Kam vlerësuar veçanërisht tek ai insistimin për të mos sakrifikuar bindjet e tij për hir të karrierës politike. Përkundrazi. Rexhep Qosja e ka sakrifikuar karrierën e vet politike, por nuk ka hequr dorë nga bindjet. Profesor Qosja është dhe mbetet ideologu dhe kritiku i çështjes sonë kombëtare.

Në vazhden e këtij rrëfimi për njerëzit jo vetëm të politikës në Kosovë, nuk mund të kaloj pa përmendur *Nexhat Dacin*, i cili ka qenë i vetmi pushtetar i Kosovës, që e ka mbështetur kthimin tim në Kosovë. Që herët, gjatë një takimi në zyrën e tij si kryetar i parlamentit, më pat thënë se "ata që pengojnë ardhjen tënde në Kosovë, e kanë gabim".

Si rezultat i marrëdhënieve të mira me Dacin, u kapërcyen pengesat për rinovimin e sallës së Kuvendit të Kosovës. Për atë rinovim kanë qenë të parapara një milion e diçka euro, që në realitet, nuk kanë përbërë më shumë se 40% të shpenzimeve të asaj që u realizua në praktikë. Nuk kanë qenë të parapara as fasada e jashtme me xhama, as dekorimet e brendshme etj. Të gjitha i kam bërë falas, përfshirë edhe aklimatizimin, instalimet etj. Kjo erdhi nga dëshira ime e madhe që t'i falja diçka të bukur Kosovës. Sot, sidomos pas rinovimit të fundit, të cilin gjithashtu e kam bërë falas, Kosova ka një sallë të shkëlqyer të parlamentit, besoj më të mirën në rajon.

E shoh të nevojshme me këtë rast t'i them dy-tri fjalë edhe për *Ramush Haradinajn*, të cilin e kam njohur para se të bëhet

kryeministër, sado që nuk mund të flitej për një njohje të thellë. Pas ekstradimit në Hagë, unë fillova të interesohesha për të. Ramushin e kam përkrahur jashtëzakonisht shumë, aq sa ndoshta është individ i që kam përkrahur më së shumti në botë. Nëse diku vërtet i kam ndihmuar, ai gjithsesi ka qenë Ramush Haradinaj. Kam qenë dhe vazhdoj të jem krenar që kam pasur mundësi t'i ndihmoj, sepse ka qenë luftëtar, njeri që ka kontribuar jashtëzakonisht shumë në luftën për çlirimin e Kosovës. Përveç kësaj, gjatë kohës që ka qëndruar në Hagë, unë kam shkuar rregullisht te familja e tij. Natyrisht, unë nuk kam pritur që ai të ma kthejë në ndonjë formë ndihmën që i kam ofruar, por, kam pritur që së paku të sillej më me respekt ndaj meje. Sidomos sulmet e ndonjë të afërmi të tij, gjatë fushatës zgjedhore i kam konsideruar një gjë të keqe, por megjithatë jam përpjekur t'i tejkaloj, duke konsideruar se bëhet fjalë për një djalë të ri, të papjekur ende.

Sjelljet e pamenduara të disa pjesëtarëve të AAK-së, vijat e kuqe të Ramush Haradinajt ndaj AKR-së, konspiracioni që Ramushi e potenconte etj., kanë ftohur edhe më shumë marrëdhëniet tona. Edhe përkundër kësaj, unë kam respekt për Ramushin dhe ruaj marrëdhënie të mira me babain e tij. Krahas familjes Jasharaj, Haradinajt janë familje që ka dhënë më së tepërmi për Kosovën dhe këtë e theksoj gjithmonë. Për këtë arsye kam respekt të përjetshëm ndaj saj. Po të më ofrohen mundësitë ndonjëherë, kisha dashur që këto dy familje të ishin të përfaqësuara institucionalisht në Prishtinë. Thënë troç, që këto dy familje të kenë vazhdimisht një vend nderi të rezervuar në parlament në mënyrë permanente, pse jo edhe një ambient reprezentativ këtu në Prishtinë, ku do të takoheshin me mysafirët e tyre.

Gjatë zgjedhjeve të 2007-s ka qenë e pakuptueshme për mua që *Veton Surroi* me partinë e tij ORA filluan një fushatë të ashpër kundër meje. Bile më kujtohet që pak para mbylljes së fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 2007-s, zoti Surroi, në një emision në ALSAT, atëherë televizionin tim, më quajti mua njeri i cili ka dashur ta shesë Kosovën! Çfarë absurditeti! Akuza e Vetonit kishte të bënte me një kohë në të cilën unë s'kisha kurrfarë interesi për politikën dhe nuk isha absolutisht i involvuar në të. Mediat e tij madje mundoheshin

të më vinin në relacion me rastin e policit të ndjerë, Triumf Riza. Të gjithë e panë më vonë se si e demantoi këtë veprim drejtësia. Njerëzit e ORA-s përdorën edhe një mënyrë tjetër për të më atakuar mua, akoma nuk e di përse, duke shkëputur nga konteksti titullin e një interviste dhënë gazetës *Nedelnji Telegraph* të Beogradit. Ky titull nuk pasqyrore atë që e kisha thënë unë në tekst, çka ndodh shumë shpesh te mediat, të cilat me qëllim të shitjes venë tituj bombastikë të cilët i nxjerrin nga konteksti, madje shumë herë pa pasur lidhje me mendimet të cilat i shpreh i intervistuari. Dhe çka bënin njerëzit e ORA-s? Në vend që të propagandonin për partinë a subjektin e vet, shpërndanin nëpër redaksitë e gazetave dhe në mijëra e mijëra adresa të internetit të votuesve të Kosovës, titullin e gazetës beogradase. Pra vetëm titullin e gazetës serbe dhe jo intervistën time të plotë.

Mendoj se kjo e dëmtoi në një masë AKR-në sigurisht.

Unë as sot e kësaj dite nuk i di arsytet e atyre sulmeve të Veton Surroit. Është shumë e çuditshme, sepse unë për Veton Surroin gjithmonë kam pasur mendim të mirë, e kam njohur si njeri të mençur e të qytetëruar, që i nevojitej Kosovës. Madje në atë kohë unë në disa intervista kam shprehur simpatinë time edhe për ORA-n dhe për vizionin e saj reformist. Për nga programi, partia ime ishte më e afërta me të. Një marrëveshje në mes këtyre dy partive me siguri do të kishte pasur sukses. Është e çuditshme, po ashtu, se edhe në periudhën kur s'kam qenë i angazhuar në politikë dhe s'kam pasur kurrfarë interesi të merrem me të, gazeta *Koha Ditore*, ka qenë ndër të vetmet gazeta në Kosovë që përkthente artikuj kundër meje nga gazetatat beogradase, moskovite dhe gazeta italiane *Corriere Della Sera*. Kjo edhe mund të ishte normale sikur, krahas akuzave të këtyre mediave, të botoheshin edhe reagimet e mia. Unë isha kosovar, nuk isha i huaj, që t'u jepej kredi këtyre gazetave, pa respektuar kanunet e gazetarisë për balancën. Megjithatë, unë vazhdoj të kem respekt ndaj njerëzve që me merita, pa marrë parasysh qëndrimin e tyre ndaj meje. Vazhdoj të kem respekt edhe për Veton Surroin. Një prononcim i qetë imi gjatë fushatës zgjedhore të 2007-s, si reagim ndaj sulmeve të Vetonit, se “ai ishte një djalë i mirë i Kosovës dhe që i duhej shumë asaj”, bëri shumë efekt në Kosovë.

Kam respekt të thellë për *Lëvizjen Vetëvendosje* dhe *Albin*

*Kurtin*, të cilin në një artikull e kam quajtur ndërgjegjja kritike e Kosovës. Ai më impresionon me thellësinë e kritikës së vet, me ndjeshmërinë e vet patriotike, anipse s'jam shumë dakord me qasjen e tij refuzuese ndaj ndërkombëtarëve. Gjithmonë kam besuar dhe besoj se ndërkombëtarët nuk i dhanë Kosovës vetëm mbrojtje, garanci shtetformimi, por dhe një shkollë administrative që nuk e kishim. Mendoj se Kosovës i duhet shumë Albini, ky djalë i urtë e trim, që ka sakrifikuar aq shumë për vendin e tij dhe pavarësisht nëse do të pajtohem apo jo me të, edhe në të ardhmen do të vazhdoj ta çmoj dhe respektoj. Më pëlqejnë shumë ide ekonomike të tij, veçanërisht ajo për fuqizimin e ekonomisë vendore, e shkëputjes së saj prej varësive të tepruara ndaj fqinjëve për produkte të caktuara, kundërshtitë për shndërrimin e Kosovës në një vend importues etj. Por Albinin e vlerësoj dhe për idetë e tij për bashkimin kombëtar. Ndryshe nga pjesa tjetër e klasës sonë politike ai ka kurajën t'i artikulojë zëshëm këto ide, pa asnjë kompleks, pa frikën e shantazheve të ndërkombëtarëve. Edhe unë e vlerësoj bashkimin, por mendoj se ai duhet të fillojë më së pari nga ekonomia. Rruga që është ndërtuar në Shqipëri dhe po vijon në Kosovë duhet të mbushet me mall, me kapital, me ide për biznes të përbashkët shqiptar, për projekte të përbashkëta energjetike etj., që do t'i bënin ekonomitë tona komplementare dhe do t'i afronin edhe më tej njerëzit në të dy anët e kufirit. Por askush në politikën zyrtare në Kosovë nuk mendon për këto ide të tipit afatgjatë. Duke u nisur nga këto arsye, kam qenë ndër të parët që i kam uruar sukses Albinit për partinë e tij të re.

Kam marrëdhënie të mira dhe ushqej respekt edhe për doktor *Ferid Aganin*, i cili për mua mbetet një njeri human, i fjalës, punëtor dhe profesionist i aftë. Kontaktet e mia me Ferid Aganin i kapërcejnë caqet profesionale; ato janë edhe të natyrës familjare. Ky njeri, në cilësinë e mjekut, ishte kujdesur dhe u kishte ndenjur pranë deri në vdekje prindërve të mi. Diçka që nuk do ta harroj. Në mes të AKR-së dhe PD-së së zotit Agani do të ketë bashkëpunim të ngushtë në të ardhmen, madje Feridi është i dyti në listat e koalicionit tonë.

Marrëveshja me ta, ishte e para që AKR firmosi bashkë dhe me 6 parti të tjera si pjesë të Koalicionit për Fitore.



*me z. Jakup Krasniqi gjatë krijimit të FORK-ut në Lugano, 1999*

Tani t'i kthehemi AKR-së. AKR-ja, e dalë nga zgjedhjet e vitit 2007 si partia e tretë, tashmë ka një grup parlamentar të konsoliduar në Kuvendin e Kosovës. Unë mburrem me grupin parlamentar të AKR-së, i cili edhe pse pa përvojë, arriti që gjatë kësaj periudhe të bëhet zëdhënës i fuqishëm i qytetarëve për ato gjëra për të cilat kemi menduar se e dëmtojnë Kosovën dhe janë larg nga kërkesat e qytetarëve dhe synimet e tyre.

Në kryesinë e Kuvendit të Kosovës, AKR-ja përfaqësohej me profesor Ibrahim Gashin, i cili e kreu me dinjitet punën në atë pozitë të rëndësishme. Shef i grupit tonë parlamentar ishte Ibrahim Makolli, një njeri me përvojë të gjatë në mbrojtjen të të drejtave të njeriut, vazhdimisht në koherencë me zhvillimet dhe opinionin publik. Por, nuk mund të vlerësoj vetëm këta të dy nënkryetarë të partisë, por

dhe deputetë të veçantë.

AKR-në si parti për një kohë të shkurtër e kemi shtrirë në gjithë Kosovën. AKR-ja nuk është parti regjionale, por është e shtrirë në çdo kënd të Kosovës, në fshat e në qytet. AKR-ja arriti të dilte e para dhe e dyta në disa prej komunave kryesore të Kosovës. Diaspora është mbështetëse e AKR-së pasi që themelet e saj vijnë nga diaspora. *AKR internacional* në Zvicër është shumë aktive në promovimin e idesë gjithëkosovare të AKR-së.

Pas zgjedhjeve lokale të 2009-2010, AKR-ja u fuqizua edhe me një personalitet tjetër. Është kjo Zëvendëspresidentja, Mimoza Kusari Lila, e cila më zëvendëson në mënyrën më të denjë dhe është shembull i një gruaje politike. Madje mund të them lirisht se ajo është gruaja politike më popullore në Kosovë. Ajo nuk arriti të fitonte në Gjakovë për kryetare të komunës, edhe pas një fushate moderne të stilit amerikan, sepse pati manipulime serioze të votimeve, por ama iu shtua si vlerë Kosovës. E vendosur dhe me vizion të qartë, Mimoza si politikanja femër më e votuar në Kosovë i ka sjellë energji të re AKR-së. Ajo ka motivuar edhe më shumë të gjithë që me punë të përkushtuar mund të ecet përpara. Me Mimosën, e cila nuk është thjesht politike e një stili komunikativ të zhdërvjellët, flasim shpesh për ekonominë. Ajo ka një shkollim të shkëlqyer ekonomik jashtë vendit dhe unë e shoh atë shumë lart, si afirmim i femrës profesioniste që gjithçka e ka arritur me aftësitë e veta. Mimosën e duan ngado nëpër Kosovë, të vjetrit dhe të rinjtë, madje dhe kundërshtarët e vet politikë falen para karizmës së saj, kompetencës së saj.

Po ashtu i gëzohemi faktit që edhe Vegim Gashi, pas aksidentit që pësoi, është rikthyer në gjirin e familjes së madhe të AKR-së. Edhe me të AKR-ja dëshmon se është parti e vlerave, e njerëzve punëtorë e profesionistë. Risitë e AKR-së në zgjedhjet lokale të 2009-tës ishin sigurisht Naim Ferati, Afrim Loku, Ramadan Basha, Omer Daku e shumë të tjerë. Nexhmedin Spahi ishte po ashtu një befasi, pasi që vetëm për pak vota nuk arriti të vihej në krye të komunës së Mitrovicës. I lexoj vazhdimisht shkrimet dhe analizat e tij dhe mund të them se në të shumtën e rasteve jam dakord me vizionin që ai shpreh në to.

Mbas zgjedhjeve lokale të vitit 2009, në prill-maj 2010, janë shtuar ardhjet në AKR, nga Mitrovica, Gjilani etj. kryesisht profesorë me tituj në shkencat përkatëse, magjistra, mësime dhënë, njerëz të cilët kanë zgjedhur AKR-në si parti të parë. Erdhën edhe nga parti të tjera, por nuk ju gëzova publikisht këtij fakti. Nuk më intereson të të merresha me diversione ndaj partive të tjera, siç bëjnë disa parti zakonisht. Vazhdimisht më vijnë mesazhe inkurajuese nga votues të LDK-së, dhe një pjesë e madhe e tyre, me mijëra janë të publikuar në faqet e internetit të gazetave të ndryshme. Nëse do të votohej në një anëtarësi të bashkuar të AKR-së dhe LDK-së, besoj se do të zgjidhesha kryetar.

*Dëshiroj të falënderoj, bashkëpunëtorët më të afërt, si Avdi Smajlin, Rejhan Vuniqin, Gëzim Mehmetin, Shpend Kallabën, Arbër Gecin, vëllanë tim, Selimin, Muhamet Kelmendin, gjithë udhëheqësinë dhe gjithë strukturën e AKR-së, që me dëshirë do t'ua përmendja emrat po të ishte e mundur, duke i inkurajuar që të mos humbin motivin, por të ndërtojnë më tutje AKR-ë, sepse ndërtimi i AKR-së do të thotë ndërtim i vlerave dhe i Kosovës ndryshe. Mesazhi im për elektoratin e AKR-së është që të mbetet i përqendruar tek AKR-ja sepse vetëm së bashku mundemi ta ndërtojmë një Kosovë ndryshe.*

*Jam i hapur ndaj medias, pavarësisht nga përvoja jo e këndshme që kam pasur në jo pak raste. Me shumë prej protagonistëve të saj kam marrëdhënie miqësore. Kjo qasje është mesa duket pjesë e kalitjes sime ndaj presionit të mediave, kalitje për të cilën Ana Oksa, më kishte dhënë leksionet e para.*

*Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë opinionistët dhe gazetarët e spikatur të Kosovës, të cilët gjatë takimeve të ndryshme me ta më ndihmuan me këshilla të vlefshme që unë si i sapokthyer të përshtatesha me rrethanat e këtushme. Falënderoj gazetarin Baton Haxhiu, i cili pat organizuar fushatën e AKR-së në zgjedhjet e 2007-s, ku AKR me numrin e votave rezultoi si partia e tretë në vend. Ai më këshilloi dhe më ofroi informata për shumë gjëra që kishin ndodhur në Kosovë gjatë kohës së emigrimit tim.*

*Berat Buzhala dhe Petrit Selimi janë dy opinionistë të njohur, të cilët në mënyrë shumë korrekte trajtuan aktivitetin e AKR-së. Edhe takimet me ta për mua ishin të frytshme dhe të vyera.*

*Për sa kam arritur të përcjellë te publiku i Kosovës si politikan, dua të falënderoj të gjithë gazetarët, botuesit, kameramanët etj.*



*Ish-drejtori i televizionit publik te Kosovës - RTK, Agim Zatriqi, mbetet për mua një ndër parashikuesit më të mirë të skenës politike në Kosovë.*

*Dua të falënderoj Mentor Nazarkon, këshilltarin tim politik nga Shqipëria. Ai vjen me një eksperiencë të nivelit të lartë si këshilltar i kryetarit të Shqipërisë, Rexhep Meidani. Meidani është një figurë për të cilin ruaj respekt shumë të lartë për ndershmërinë dhe patriotizmin e tij ashtu si dhe për Presidentin Alfred Moisiu dhe Presidentin aktual Bamir Topi.*

*Ka dhe shumë personalitete të shquara, emrat e të cilëve për arsye të ndryshme mbeten anonimë, e që kontribuan në përfshirjen dhe ngritjen time politike në Kosovë. Të gjithë i falënderoj nga zemra!*

\*\*\*

Fola për njerëzit e AKR-së, miqtë dhe kritikët e saj dashamirës, por njerëzit kontribuojnë në politikë me idetë e tyre, me prurjet e tyre të cilat formësojnë një vizion të përbashkët.

Cili është vizioni i AKR-së, për të cilin kam punuar që ta jetësoj me miqtë e mi politikë? E ndiej të nevojshme të hap një parantezë të shkurtër historike, për të kuptuar themelin në të cilin mbështetet ky vizion. Siç e theksova më parë, unë për vete kam bërë një lloj ndarje të historisë më të re të Kosovës, natyrisht pa pretendime shkencore. Pas *fazës së parë* të shenjuar nga *Ibrahim Rugova*, njeriu i rezistenës paqësore dhe babai themelues i pavarësisë sonë, dhe *fazës së dytë* shenjuar nga gjaku dhe sakrificat e *UÇK-së*, unë mendoj se kemi hyrë në një fazë të tretë. Çfarë nënkupton, sipas meje, sipas AKR-së, kjo *fazë e tretë historike*?

*Faza e tretë e historisë sonë* më të re kërkon që t'ia nisim nga realizimi i *vetëmjaftueshmërisë ekonomike* të Kosovës. Nuk mund të mbijetojë një vend që importon 95% dhe eksporton vetëm 5% mallra. Si mund të rrojë një shtëpi që vetëm merr borxh? Nuk mund të mbijetojë një vend që braktis tokën dhe e lë djerrë atë. Kjo ndodh dhe në Shqipëri, pak më pak te ne, por ama jemi shumë më keq se fqinji ynë Maqedonia, që na shet produktet e veta bujqësore. Ne dimë të arrijmë te vetëmjaftueshmëria, ne duhet ta ndërtojmë Kosovën me projekte të reja zhvillimore të mbështetura te rinia e mrekullueshme e saj, aq e dëshiruar për kulturën, dijet, internetin dhe teknologjinë e re. Kështu do luftojmë papunësinë dhe moshën e

re të popullsisë sonë do ta shndërrojmë në vlerë strategjike.

Ne e dimë se që të forcohet shteti i ri i Kosovës duhet nisur nga ekonomia, që do të prodhojë mirëqenie. Ky ka qenë ideali i themeluesit të pavarësisë dhe i heronjve të lirisë; *kjo është Harta e Rrugës së Kosovës së Re*.

Ekonomia vetvetiu megjithatë, s'mjafton: ajo do njerëz të ditur. Vetëmjaftueshmërisë mund t'ja mbërrijmë duke u mbështetur te lloji i udhëheqësve menaxherë dhe teknokratë. Ata s'duhet të jenë domosdoshmërisht karizmatikë. Ata s'duhet të jenë mburravecë me të kaluarën e tyre politike, me oratorinë, dhëlpëritë politike, por krenarë për aftësitë e tyre profesionale dhe vlerat njerëzore. Vendet që i kanë punët mirë kudo në rajon, janë mbështetur dhe udhëhequr prej kësaj kategorie liderësh.

Ne duhet të ngremë në Kosovë shkollat e së ardhmes - një arsim profesional modern, universitete të vërteta dhe jo fabrika diplomash. Ekonomia do njerëz të ditur, kurse sistemi aktual arsimor që ka Kosova në të gjithë nivelet po prodhon efekte të dëmshme, thujtë të pariparueshme, prandaj ne do ta reformojmë plotësisht. Faza e tretë e zhvillimit për të cilën flas është faza e dijes dhe e mendjes dhe jo e forcës dhe e muskujeve...

Ne kemi mësuar nga historia e shtetformimit në vende të tjera. Prandaj ne kemi folur të parët për Kosovën e re. Ne kemi folur të parët për kosovarët. Ne e dimë se kombi shqiptar është një, por një trung i shëndoshë kombëtar mund të rritet dhe të forcohet më mirë nga dy degë të forta të tij. Ne e dimë se shteti i ri i Kosovës do të krijojë një identitet të ri politik. Jo identitet të ri kombëtar, por identitet të ri të bashkësisë së kosovarëve të rinj. Ç'do të thotë kjo në përfytyrimin tim? Po e sqaroj që të mos krijohen keqkuptime.

A ju duket e arsyeshme që një vend i vogël si yni, që është sa një lagje e një kryeqyteti të madh perëndimor, të funksionojë mbi baza regjionale? Kështu funksiononte feudalizmi, principatat e mesjetës, por ne jetojmë në shekullin e 21-të. Ne nuk duam që dhe fëmijët tanë të vazhdojnë t'i drejtohen njëri-tjetrit varësisht nga fshati a qyteza e babait dhe nënës së vet. Ne duam që ata të ndihen krenarë si kosovarë, si banorë të shtetit më të ri të botës, që i ka themelet e shëndosha dhe që s'guxon të gabojë në ndërtimin e së ardhmes. Ky

është identiteti i ri kosovar për të cilin luftoj. Dy degët e kombit do të bashkëjetojnë me njëra-tjetrën, do të konkurrojnë njëra-tjetrën, do të përfitojnë nga njëra-tjetra sot brenda Europës së bashkuar.

Ne duam një patriotizëm të ri modern! Ne duhet të punojmë për krijimin e një tregu të madh kombëtar, që rruga e madhe e Kombit të mbushet me lëvizje mallrash, kapitalesh, njerëzish; ne duhet të punojmë për krijimin e një tregu të madh rajonal, ku shqiptarët do të jenë të bashkuar mes tyre. Europa nuk na do ne brenda për problemet tona, por për potencialin tonë ekonomik, kulturor e njerëzor të bashkuar!

Kosova e re ka nevojë, pra, për një klasë të re politike. Të reformuar. Kosova e re ka nevojë për burra shteti! Burrat e shtetit vendosin interesin shtetëror mbi interesat e tyre vetjake dhe pushtetin.

Ne e dimë ç'do të thotë të ndërtohet, duke futur shpirtin tënd në veprën që ngre dhe lartëson përditë. E keni provuar kënaqësinë e ndërtimit të një shtëpie të re? Kur ajo rrit shtatin tullë pas tulle, mur pas muri, kat pas kati? *Faza e tretë është faza e krijimtarisë*, faza e njerëzve krijues. Kjo është kënaqësia e krijimit, që ne e kemi provuar në përvojat tona të mëparshme profesionale dhe njerëzore. E kemi provuar këtë kënaqësi tërë jetën tonë. Prandaj jemi të bindur se ka ardhur koha për ndërtimin e Kosovës së re. Ne e dimë mirë se faza e Kosovës së re sapo ka nisur. E shoh këtë dhe në sytë e atyre djemve të rinj dhe vajzave të reja në tubimet tona të djeshme dhe do ta shoh dhe në të ardhmen.

## Forca e jetës, forca e familjes

*Familja e sotme. Vdekja e nënës, si shkëputje vetëm fizike nga e kaluara. Filizat e rinj që ripërtërijnë emrin e të parëve dhe do të çojnë më lart emrin e mirë të familjes. Arbëresha, Selena, Hana, Isa dhe një tjetër krijesë që pritet të vijë në jetë. Disa rastësi të çuditshme në disa data të jetës sime. Ana Oksa, bashkëjetesa me të si pjesë e rëndësishme e jetës sime.*

**D**uke qenë njeri i biznesit, i karrierës profesionale, ka qenë e pritshme se unë nuk do të kisha një jetë të qetë e të rehatshme familjare. Nuk është se nuk e dëshiroja, nuk është se nuk isha i gatuar për këtë, por thjesht e kisha pothuajse të pamundur. Puna e pandërprerë, udhëtimet e shumta, ndërrimet e shpeshta të vendbanimit, të gjitha këto krijojnë rrethana që të mos mund t'i kushtohesh sa duhet familjes, asaj që quhet familje e ngushtë. Pastaj, kisha një familje të gjerë, të cilën duhej ta hiqja nga Mareci, ku kushtet për jetë ishin të papërshtatshme dhe ta sistemoja në Hajvali, në një vend ku mund të jetohej më mirë. Të gjitha këto më preokuponin dhe më merrnin kohë, kështu që për një periudhë relativisht të gjatë nuk i kushtova kujdes asaj që quhet stabilitet i jetës familjare.

Natyrisht, bashkë me moshën kalojnë edhe aventurat e rinisë. Pastaj, në bredhjet e tij pa fund, njeriut i ndodh të takojë personin e duhur, atë që mund ta bëjë shok të jetës, siç thuhet ndryshe. Kështu që unë sot, pavarësisht nga jeta e trazuar që kam pasur, jam burrë i martuar dhe kam një familje jashtëzakonisht të lumtur: kam gruan me prejardhje burjate, Mashën, me të cilën kam dy fëmijë, Hanën dhe Isën, me të cilët kaloj çaste të bukura që i japin kuptim dhe harmoni jetës sime. Madje sot që po shkruaj këto fjalë, në nëntor 2010, ime shoqe është shtatzënë dhe ne presim të na lindë edhe një fëmijë tjetër, për të cilin ende nuk dimë se ç'gjini do të ketë. Duam të ruajmë kënaqësinë e surprizës, që vjen nga e fshehta e jetës që prodhon mëmësia. Ndërkohë Hana është pesëvjeçare, Isa trevjeçar.

Dua t'i lidh shumë fëmijët e mi me Kosovën dhe popullin tonë dhe deri diku i'a kam arritur. Flasin shqip shumë mirë, vijnë shpesh në Kosovë ku kënaqen shumë dhe më çlodhin me lodrimet e tyre. Hana ka pasion pikturimin dhe shquaj shumë fantazi të pazakontë në vizatimet e saj fëminore. Këtë jetë të qetë familjare krijuar me fëmijët e mi, tani unë nuk e ndërroj me asgjë. Ky, në njëfarë mënyre, është "misioni" im përfundimtar familjar.

Unë rrjedh nga një familje e madhe me shumë anëtarë. Shumë prej tyre kanë vdekur, e shumë të tjerë jetojnë. Duke qenë se në familjen tonë ka mbretëruar paqja e dashuria, jemi munduar që t'i përtërijmë emrat e atyre familjarëve që kanë vdekur, në lindjet e reja, që kanë ndodhur në familjen tonë. Me lindjen e Hanës u desh që të gjendej një emër nga gjiri i familjes. Kishte mbetur i fundit "i lirë" emri i hallës sime më të madhe, hallës Mihane, e cila ka vdekur në fundin e viteve '50 nga sëmundja e rëndë e tuberkulozit. Edhe pse isha shumë i ri, e kujtoj me shumë mall atë, sepse më ka dashur shumë. Më kujtohet edhe kur vdiq. Ekonomikisht, aty ku ishte martuar qëndronin shumë keq dhe prandaj më dhimbset edhe sot e kësaj dite. Pas kaq vitesh unë vendosa që vajzën time ta pagëzoj me emrin e saj, Hana, dhe jam shumë i lumtur për këtë. Isa, ndërkaq është djali im i vetëm. Para se të lindte Isa, babai dhe nëna ime, e donin shumë një nip nga unë. Sidomos babai, i cili ishte i sëmurë në fund të jetës së tij, dëshironte shumë një nip nga unë. Ai e luste perëndinë që të mos vdiste pa ma parë një djalë. Më 22 maj 2006 më lindi djali dhe megjithëse babai im ishte ende gjallë, vendosa që ta quaja Isë. E bëra këtë edhe pse një pjesë e anëtarëve të familjes e, veçanërisht miqtë e mi, kishin renditur qindra emra modernë. Ta lidhja djalin tim, pos të tjerash, edhe me emrin e babait ishte një dëshirë e madhe, por edhe krenari dhe kështu u bë. E quajta Isa. Të njëjtën ditë kur lindi Isa, nga Prishtina më erdhi lajmi se babai im ishte shumë i sëmurë. Mu në mes të gëzimit për shkak të lindjes së djalit, ne familjarëve të tjerë që ishim në Lugano, na u desh që të njëjtën ditë në mbrëmje të udhëtonim me aeroplan për në Kosovë. Në mëngjes herët arritëm në shtëpi, në Hajvali. Në dhomën ku lëngonte babai im ishte edhe mjeku i tij, Ferid Agani, të cilin im atë e donte dhe e respektonte shumë. Doktor Feridi ishte kujdesur për prindërit e mi, për më se 25



*Me këngëtarin e famshëm italian Albano Karizi (Carrisi.) Ai, bashkë me ish-gruan e tij, Rominën, janë miq të mëdhenj të mië.*

vjet. Babai im i besonte vetëm atij, bile para se të vinte në Zvicër, ku bënte kontrollet mjekësore e donte gjithmonë afër Feridin. Shumë herë ishte dashur ta thërrisnim në Zvicër që të komunikonte me mjekët e tjerë këtu. As neve nuk na besonte kur i përkthenim se çka thoshin mjekët e Zvicrës. Feridin e donte shumë, madje bashkë kishin bërë edhe haxhillëkun.

Pra, Feridi ishte aty dhe posa arritëm më informoi për gjendjen e babës. “Behgjet, - më tha -, bëtë mirë që erdhët. Kësaj radhe më duket se do të ndahemi me haxhi Isën”. Me mua kishin udhëtuar Afrimi, djali im i axhës dhe Emini me familje. Doktorin më njoftoi se shtypja e gjakut i kishte rënë nën minimalen dhe pulsi mezi hetohej. Në një moment, babai ishte i shtrirë me sytë mbyllur dhe dukej se ishte duke pritur çastin e mbramë. Feridi i tha: “Haxhi Isë, hapi sytë, se kanë ardhur Behgjeti, Afrimi, Emini dhe fëmijët nga Zvicra. Bëjau hallall!” Doktorin vazhdoi më tej: “Haxhi Isë, Behgjetit i ka lindur një djalë dhe emrin ia ka lënë Isë!” Në këtë çast, ndodhi mrekullia. Babai im lëshoi një zë: *hëëë, mirë!* Dhe tentoi t’i hapte sytë. Nga ky çast, rifilluan shenjat e jetës. Brenda një ore edhe shtypja e gjakut iu normalizua dhe pulsi vazhdoi rrahjen normale. Në fund të asaj dite, madje, komunikoni me të. E kuptoi shumë mirë se tani i kishte lindur nipi dhe donte ta shihte. Kur Isa i vogël bëri gjashtë muaj, erdhi për herë të parë në Kosovë dhe babai im Haxhi Isa u kënaq me të. Ai pati kënaqësinë që edhe për dy vite të tjera të luante me atë që i kishte marrë emrin, pasardhësin e tij. Vetëm dy javë para vdekjes së tij, ai e tha një fjalë që lidhej me vijimin e jetës pas tij: *Tani edhe nëse vdes, nuk më mbetet merak!* Kështu që në verën e 2008-s, babai im vdiq, dhe vendi i tij ku kaloi 30 vjetët e fundit mbeti bosh. Por atij,

iu plotësuan dëshirat e fundit. Emri i tij u bart tek krijesa ime.

Është për t'u habitur, por në të njëjtën kohë, dy vjet më pas, në korrikun e 2010-s m'u sëmur nëna. Bëri një ndërhyrje të rëndë në spitalin e Prishtinës dhe në ecejaket e gjata dhe të shpeshta në spital, në reanimacionin e tij, pata rastin sërish të kuptoj më mirë gjendjen



*Me Demis Ruso (Roussos) dhe pop këngëtare italiane, Ivana Spanja (Spagna)*

e strukturave tona shëndetsore. Kam reflektuar sërish mbi shkaqet dhe pa më të voglin dyshim kjo gjendje është pasojë e skizofrenisë politike dhe primitivizmit të disave prej drejtuesve tanë. Nuk ka shpjegim tjetër: një klasë politike normale nuk mund ta lejojë një gjendje të tillë për një kohë të gjatë. Nuk është patriotizëm të abuzosh me atdheun, pa menduar për njerëzit e tij. Rrugët janë të rëndësishme, vendi ka boll prioritete, por kujdesi për njeriun duhet të jetë prioriteti më i madh. Vëreja me trishtim, derisa nuk durova më dhe kulturën tonë të sjelljes me të sëmurin. Njerëzit vizitorë vinin në reanimacion, ku duhet të kishte shkallë të lartë steriliteti, me rrobat e rrugës, njësoj dhe sanitarët. Atje pata rastin të vihesha në një lloj “gare” solidariteti për të ndihmuar jo vetëm nënën time, por dhe një djalë 17 vjeç i cili dergjej pranë saj, por për fat një biznesmen i njohur, e ndihmoi për ta çuar në një spital jashtë vendit. Unë e mora nënën time dhe e dërgova me avion spital në Zvicër. Ishin mjekët zviceranë që më treguan problemet e mëdha të shëndetit të saj prej kushteve ku gjendej në Prishtinë. Ata i dhanë megjithatë disa javë ymër më shumë dhe duke ndjekur luhatjet e gjendjes shëndetsore të nënës m'u desh të provoja dhe unë luhatje të mëdha emocionale. Kam kuptuar falë luftës së saj për të mbijetuar, rëndësinë e jetës dhe forcën e saj. Kur shihja që nëna ime e sëmurë rëndë gjendej në koma, në një



*Me Mashën, Isën dhe Hanën*

spital afër Luganos, e kisha shumë të vështirë të pranoja ikjen e saj nga jeta, këputjen e lidhjes së vetme që më kishte mbetur me paraardhësit e mi. Të gjithë, motra e vëllezër, që e ruanim nënën në një stafetë 24 orëshe, kapeshim pas shenjave të jetës që jepte herë pas here ajo, duke menduar se mund të kapërceheshin limitet e shkencës. Një natë që mjeku, na paralajmëroi se nëna kishte vetëm një ditë jetë, vëllai, Emini u lut gjatë dhe i çoi nënës hoxhën për

momentin e fundit të jetës. Ishte e çuditshme, por jeta u tregua e fortë: ajo hapi pak sytë dhe luftoi me vdekjen dhe disa ditë. Ky rikthim bëri që mua të më rritej shpresa dhe të kthehesha gjatë atyre ditëve në Prishtinë, ku kisha lënë fëmijët dhe shumë angazhime. Por jeta s'mund të ishte kaq bujare duke shkuar kundër fatit. Ndërsa gdhinte e enjte 12 gusht, 2010 ajo iu fal vullnetit të perëndisë dhe na la. Të paktën vdiq në një mënyrë të denjë për qeniet njerëzore, në Mendrizio, një nga spitalet më të mirë të Zvicrës. Vdekja e saj koincidoi dhe me muajin e madhnueshëm të ramazanit dhe ndërsa sollëm trupin e saj në Hajvali, vendosëm ta varrosnim po atë natë.





*Në zyrën e Luganos pranë pikturës së Arbëreshës*

E morëm këtë vendim, duke përmbushur një amanet të saj, për të mos lodhur dhe munduar njerëzit, për të mos i ndarë ata duke marrë pjesë në varrimin që do të kryhej pas faljes së taravive në orën 23.30. Një amanet i ngjashëm me atë të gjyshit, për të cilin fola në fillim të rrëfimit tim. Ishte një varrim dinjitoz, ku u mbledhëm të gjithë, vëllazëri, të afërm dhe shumë miq. Ndërsa po shikoja trupin e saj me qefin të zbriste për në banesën e fundit, nuk i mbajta dot lotët. Më qetësuan paksa lutjet e ceremonisë fetare drejtuar nga kryemyftiu i Kosovës Naim Tërnavë dhe nevoja për të nderuar miqtë e shumë ardhur nga të gjitha anët. Pashë se kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, gjendej mes atyre që donin të na ishin afër në atë moment të rëndë. Mendova për vazhdimësinë e jetës dhe forcën e miqësisë. Zoti nuk na ka lënë pa miq, thosha ndërsa në shtëpinë e vëllait, Selimit,



*Me Selenën. Ajo e do shumë Shqipërinë, ku ka dhe shumë miq.*

ku nëna kishte jetuar derisa vdiq, prisja vizitat e dashmirëve. M'u desh të përcillja në banesën e fundit edhe njërin nga veprimtarët themelues të AKR-së, profesor Arif Krasniqin, që u nda nga jeta pikërisht gjatë atyre ditëve kur unë prisja dhe përcillja njerëz për nënën time.


Por le t'i kthehemi jetës. Unë kam edhe dy vajza të rritura, të cilat nuk erdhën nga ndonjë martesë, por në kohën e rinisë së hershme. Kam Arbëreshën që jeton në Austri, lindur më 1977, nga një lidhje që kisha me një austriake. Rrethanat ishin asisoji që unë nuk dija për ardhjen në jetë të Arbëreshës, por këtë e mësova pas lindjes. Nëna e saj e kishte fshehur prej meje, nga frika se unë mund ta shtyja të abortonte. Por unë nuk do ta kisha bërë kurrë këtë. Vajza lindi dhe e ëma emrin ia kishte lënë Arbëresha. Pak e çuditshme, por e vërtetë, sepse unë i kisha shpjeguar asaj se arbëreshët, pra arbëreshët e

Italisë, për ne shqiptarët ishin sinonim i shpërnguljes dhe mallit për atdhe. Ky fakt duket se i kishte pëlqyer shumë shoqes sime të atëhershme, që ia kishte lënë së bijës emrin Arbëreshë. Ajo jeton në Austri, ka karrierën e saj, ka studiuar në SHBA, është kthyer dhe punon për një bankë të madhe austriake. Është ngjitur shumë shpejt në karrierë. Ka banesën e saj, ka jetën e saj të pavarur dhe mund t'ju them se kemi marrëdhënie shumë të mira.

Pastaj, kam edhe vajzën tjetër, Selenën, emri i së cilës i përkthyer nga greqishtja, do të thotë Hana. Është 24 vjeçe dhe ka lindur nga marrëdhënia me një sllovene. Ajo jeton në gjirin familjar, diku pranë meje, në Lugano. Jam i lidhur shumë me të. Është një vajzë fantastike. Ka studiuar dhe studion në Lugano, Cyrih dhe Londër. Ka banesën e saj afër meje dhe nuk i mungon asgjë. Udhëton shumë, ka qenë shumë herë edhe në Shqipëri, ku ka miq të mirë. E ka pasion kalërimin dhe ka kuajt e saj të racës së rrallë, me të cilët edhe garon. Do të doja shumë që të martohej me ndonjë shqiptar, megjithëqë fatit që do të zgjedhë ajo, nuk i dihet. Është piktores e mirë, por edhe ekonomiste shumë e mirë.

Natyrisht, për lexuesin dhe për njerëzit në përgjithësi, më interesante ka qenë lidhja ime me Ana Oksën (Iliriana Hoxhën). Lidhja jonë ka zgjatur shumë vjet, ndonëse periudha e jetës martesore ka qenë më e shkurtër. Me Anën jam njohur diku në fillim të viteve '90, dhe dikur kam filluar të bashkëjetoj me të. Jemi ndarë më 27 maj të vitit 2001. 27 maji për mua do të mbesë një datë shumë e rëndësishme. Më 27 maj 2001 u ndava me Anën. Më 27 maj 2003 u njoha me Mashën, dhe më 27 maj 2004 lindi Hana. Një fill lidhës i jetës sime kalon nëpër 27 maj dhe si duket, mua do të më sjellë shumë gjëra 27 maji në vitet që do vijë.

Dua të them menjëherë se për mua Ana ka qenë një grua e jashtëzakonshme, e cila në mënyrë fantastike ka ditur që, nga jeta aventuroze, ta themi kështu, t'i përshtatet pa asnjë vërejtje jetës familjare. Një karakter i fortë, tip i vendosur, parimore, e çiltër, shoqe e mirë dhe grua e mrekullueshme. Mbi të gjitha, një grua e bukur, një zanë e vërtetë, plot temperament, që nuk kishte komplekse dhe që nuk hezitonte të ekspozonte vlerat e saj, qofshin fizike, qofshin të karakterit. Ana nuk ishte këngëtare e zakonshme, e tillë siç



*Me Ana Oksën, ditën e martesës, shtator 1998*

perceptohen zakonisht femrat e kësaj kategorie. Ajo ishte artiste në kuptimin e plotë të fjalës. Kuptimi i saj për jetën ishte pikërisht ai i një artisteje, e cila vë në funksion të vokacionit krejt qenien e saj. Për të arti ishte çdo gjë. Gjakimi i saj për të bukurën në jetë dhe në art i jepte energji, e bënte plot vullnet, të paepur.

Kishte edhe një pamje fizike të mrekullueshme: e gjatë, me trup të gdhendur si në mermer. Ishte e ndjeshme dhe senzitive. I dinte përparësitë dhe avantazhet e saj, por nuk i theksonte ato. Në jetën e zakonshme ishte e shtruar, kurse në skenë, në koncerte, në festivale, shpërthente me një fuqi uragani. Kishte sharm dhe fuqi tërheqëse, të thuash magnetike. Sapo shfaqej në skenë, publikun e bënte për vete, e bënte të ndiente emocione të forta, njësoj siç i përjetonte edhe vetë ajo. Kënga e saj ishte shpirti i saj. Ana ishte mishërim i të bukurës në art dhe në jetë.

Por para se të rrëfej detajet si jam njohur me Anën, e shoh të nevojshme t'i them disa fjalë për biografinë e saj, megjithëqë ajo ka qenë dhe mbetet person publik dhe shumë njerëz, edhe ndër shqiptarët, dinë mjaft për jetën e saj. Ajo është e bija e Qazim Hoxhës, i lindur në Krujë, me origjinë nga Prizreni. Qazimi kishte kryer Akademinë Ushtarake në Itali, në prag të Luftës së Dytë Botërore. Kishte marrë pjesë aktive në luftën kundër fashizmit dhe më pas kishte shërbyer në strukturat ushtarake të shtetit italian. U vendos në Puglia, në qytetin e Barit. Aty krijoi familjen e tij, duke u martuar me një italiane, e cila i lindi tetë fëmijë, midis tyre edhe Ilirianën (me emrin artistik Ana Oksa).

Ana shumë shpejt u bë yll i muzikës italiane. Korri sukses të jashtëzakonshëm në festivalet e Sanremos dhe shkëlqeu në të gjitha prezantimet publike, në koncerte, në radio, në televizion. Nuk e mohoi asnjëherë origjinën e saj shqiptare, madje e theksoi atë me shumë krenari e mburrje edhe falë ndikimit tim të vazhdueshëm, siç thashë më herët. Provoi emocione të reja ripërtëritëse të gjakut të saj që i rridhte në deje, kur jo thjesht gjeti të afërmit e vet, por luftoi për kombin e vet si patriote e vërtetë. Ky fakt nuk i solli gjithmonë avantazhe.

Kulminacionin e karrierës së saj, Ana e arriti mu në periudhën kur jetonte me mua, atëherë ajo u lirua edhe nga “veset” e rinisë. Tani ishte një zonjë e pjekur. Shkëlqente si në jetën private po ashtu edhe në skenë. Madje fitoi “Sanremo-n”, dy herë dhe me këngën e saj “Caminando”, fitoi dashurinë edhe të publikut jugamerikan. Në këtë periudhë ajo si divë e vërtetë arriti që të udhëhiqte edhe disa formate televizive të RAI-t, që mbeten gjithmonë në kujtesën e publikut.

Por, gjithsesi një kapitull më vete përbëjnë angazhimet e saj publike, në media dhe gjithkund tjetër, rreth çështjes së Kosovës, veçmas në periudhën e bombardimeve të NATO-s. Të kujtojmë këtu se Italia nuk kishte një qëndrim të prerë rreth Kosovës. Politika zyrtare ishte hezituese të ndiqte rrugën e përcaktuar nga SHBA, për shkak të ndikimit të fuqishëm të komunistëve dhe majtistëve, kurse opinioni ishte nën ndikimin e fuqishëm të lidhjeve tradicionale me ish-Jugosllavinë. Në debatet televizive në RAI, dukej sikur opinioni dominohej nga proserbët. Në këto debate dhe emisione ftoheshin

futbollistë serbë që luanin për ekipet italiane, diplomatë, intelektualë etj. Kurse nga pala shqiptare shpesh shihje disa të rinj anonimë, të shumtën punëtorë krahu dhe emigrantë, që as italishten nuk e flitnin si duhet.

Në këtë situatë të turbullt mediale për Kosovën në Itali, futemi në lojë Ana dhe unë, duke arritur të ushtrojmë ndikim fantastik te opinioni vendës. Ajo kishte disa avantazhe: ishte me origjinë shqiptare, këtë e dinin të gjithë italianët, por ishte italiane, madje ikonë e muzikës italiane; ishte e furnizuar me informacione të mjaftueshme dhe e njihte problemin në thelbin e tij; kishte elokuencë dhe i argumentonte mendimet në mënyrë të shkëlqyer. Përmes këtyre debateve, përfshirë edhe emisionin *Porta a porta* të Bruno Vespës, në të cilin ishim disa herë, Ana Oksa arriti të nxirrte “jashtë loje” figurat më eminente të politikanëve komunistë italianë, si Bertinoti, Kosuta (Cossuta), Oketo (Ochetto) etj.

Por le t'i kthehemi tani njohjes së hershme me Anën. Rrethanat e njohjes, fillimisht kanë qenë të lidhura me shëndetin e saj. Ajo vuante nga boshti i kurrizit, nga një shkarje unazash, nga mjedisi, nga *përmjeti*, siç themi ne kosovarët. Kishte kërkuar ndihmë gjithandej, por pa dobi. Menaxheri i saj e dinte që unë udhëtoja shpesh për në Rusi, ndërkohë që asaj i kishin thënë se atje kishte mjekë të mirë. Një mjek të tillë unë e solla në Lugano. Vetë Anën atëherë nuk e njihja. Nuk kisha pasur rast ta takoja ndonjëherë. Natyrisht, kisha dëgjuar për të.

Me të sjellë nga Rusia mjekun që asaj i duhej, ajo tani vinte në shtëpinë time dhe i bënte ato masazhet dhe terapitë fizike me mjekun rus. Më pas, i solla në Lugano edhe një mjeke-natyaliste nga Tivari i Malit të Zi, e cila ishte bërë e njohur për rezultatet e mira që kishte arritur në mënjanimin e këtyre problemeve shëndetësore. Me trajtimin që i bënë këta dy mjekë, Ana e hoqi brengën se mund të kishte ndonjë defekt të lindur, siç i kishte thënë ndonjë mjek dhe siç kishte pandehur shpesh edhe ajo vetë. Në të vërtetë, nuk kishte pasur asgjë, një *ishijas* të zakonshëm, i cili ishte dashur të shërohej me një gjimnastikë të lehtë intensive.

Dhe, kështu filloi lidhja jonë, gati si papandehur, pa sforcime e teprime.

Në fillim të viteve '90 ajo tërhiqet për pak kohë nga jeta publike. Më vonë filloi të udhëhiqte një emision në RAI, ndërkohë që ne bashkëjetuam për një kohë të gjatë në Monza të Milanos. Gjatë atyre viteve bëmë një jetë shumë intensive. Kemi vizituar shumë qytete dhe shtete. Nuk kemi lënë gjë pa provuar. Shumë herë na ka ndodhur të kthehemi në shtëpi nga ora një ose dy e natës dhe pastaj, thoshim, hajt të shkojmë të hamë nga një kifle me kapuçino në Londër. Thirrnim pilotët, përgatisnim avionin tim dhe shkoni në Londër, në kafenenë tonë të preferuar.

Kështu kemi jetuar. Kemi udhëtuar shumë, nga një cep i botës në tjetrin, në Moskë, nëpër Kinë, në Hong-Kong, në Meksikë, në Venezuelë, në Havanë te Fidel Kastro, gjithkund. Unë, gjithashtu, e ndiqja nëpër koncerte, kurse ajo ndonjëherë më shoqëronte edhe në udhëtimet e punës.

Më 1996 e solla Anën edhe në Kosovë. Por gjërat nuk shkuan siç e kishim menduar. Për shkak të mjegullës, nuk na lanë të ateronim në aeroportin e Prishtinës, por na çuan në aeroportin e Nishit. U nisëm me makinë drejt Prishtinës dhe, diku afër Podujevës, na ndalli në postbllok policia serbe. Ana u xhindos. Nuk la gjë pa u thënë policëve, ndërsa unë mundohesha ta qetësoja, sepse kisha frikë mos ndodhte diçka e keqe. Pastaj bashkë me Anën shkuam në vende të ndryshme. Ana dha një sërë deklaratash e intervistash. Njëra prej tyre ishte intervista ekskluzive me Baton Haxhiun.

Dhe, kështu, erdhi çasti i martesës. Ishte data 26 gusht 1999. Gazeta italiane *Corriere della sera* filloi në faqen e parë një tekst shumë të gjatë për mua, lidhur me "Russiagate", siç e kam bërë të ditur më herët. Shkruanin gjëra bizare, krejtësisht të pavërteta. Kur i lexoja nevríkosesha pa masë dhe Ana, me qenë se kishte përvojat e saj me gazetatat, përpiquej të më qetësonte në mënyrën e saj. Më thoshte: "Bëhesh superior mbi mediat, atëherë kur e di se gazetatat shkruajnë për ty, kurse ti kalon pranë kioskut, e sheh fotografinë tënde në faqet e para dhe ua kthen shpinën, pa blerë asnjërën prej tyre. Ose, e di se ke një emision në TV, një intervistë ose diçka të tillë, kurse ti e fik televizorin dhe bën ndonjë gjë krejt tjetër. Ose shikon ndonjë emision për kafshët në savanat e Afrikës".

Natyrisht, edhe përkundër faktit se tashmë kisha kaluar një fazë të

rëndë të aferës me rusët, unë nuk e kisha përvojën e saj me median dhe ende nuk e kisha arritur atë indiferencë. Përkundrazi. Isha tepër i ndjeshëm ndaj gënjeshtreve nga më monstruozet rreth meje. Gati po çmendesha. Kurse Ana ngulte këmbë: “Edhe ty do të të sjell në këtë pikë,” më thoshte, “që të lirohesh nga ndikimi i medias.”

Ajo kishte pasur të drejtë. Ndodhi që, një ditë, gati si me magji, unë u ktheva në njeriun më indiferent ndaj asaj që thoshin për mua gazetatat ose mediat në përgjithësi. Filluan të mos më bënë përshtypje jo vetëm shpifjet dhe intrigat, por as lëvdatat. Për këtë Anës ia di shumë për nder.

Por fjalën e kisha për diçka tjetër. Një ditë, përdërisa po bisedonim për këto çështje, Ana më thotë krejt papritmas: -Thirre avokatin, se dua të martohem!

Unë u befasova. Ishte hera e parë që Ana e përmendte martesën. Nuk ishte ky një trill i çastit. Ana vërtet ishte e vendosur. Bëra siç më tha ajo. Thirrëm avokatin, përgatitëm dokumentet dhe një muaj më vonë, saktësisht më 26 shtator 1999, bëmë celebrimin. Bëmë edhe një dasmë madhështore, të jashtëzakonshme, të tillë që nuk ishte parë ndonjëherë në Lugano. Thirrëm shumë njerëz nga Kosova, nga Shqipëria, nga Italia, familjarë, personalitete të njohura të kulturës dhe të artit, pastaj grupe muzikantësh, solistë, ansamble valltarësh, madje një të tillë edhe nga arbëreshët e Italisë. Për disa orë u bllokua sheshi kryesor i Luganos, për herë të parë në histori. Asnjëherë ky shesh nuk ishte bllokuar për një ceremoni kurorëzimi. Mua ma lejuan këtë gjë.

Mediat, natyrisht, i bënë shumë jehonë kësaj dasme, jo vetëm ato lokale, por dhe më gjerë. Aty-këtu kishte ndonjë “ngacmim”, por në përgjithësi lajmet dhe shkrimet ishin të natyrës sensacionale.

Pra, ishte një martesë e lumtur, në kuptimin e plotë të fjalës. Jetuam gati dy vjet në martesë, pa asnjë konflikt, pa asnjë mosmarrëveshje. Ana ishte një bashkëshorte e mrekullueshme.

Dua të shtoj këtu, se Ana ishte e lidhur së tepërmi me familjen e saj. Ata erdhën të jetonin në Lugano, madje në shtëpinë time, në katin e parë, sepse kishte hapësirë të mjaftueshme. Unë i punësova, dikë kujdestare fëmijësh (Ana kishte dy fëmijë, vajzën Françeskën dhe djalin Qazimin), dikë shofer, dikë në ndonjë punë tjetër. Nuk



ishte me rëndësi sa punonin. Ana donte t'i kishte pranë vetes dhe unë ia plotësova këtë dëshirë. Në lidhje me fëmijët dua t'u tregoj një fakt interesant, një ko incidencë të rrallë. Më vonë edhe mua, siç e dini, njësoj si Anës, më lindën dy fëmijë. E para ishte vajzë sikurse dhe Ana që kishte Françeskën dhe në një dallim të njëjtë moshe sikur fëmijët e saj, mua më lind Isa. Vërtet një ko incidencë interesante. Pra dashurinë ndaj fëmijëve të Anës, që nuk i kisha më vonë, perëndia e kompensoi me Hanën dhe Isën tim.

Sot unë mund të them se ajo ra viktimë pikërisht e familjes së saj. Ajo, në këtë rreth të vetin familjar që e mbante me vete, kishte edhe dy motra të pamartuara dhe një tjetër të martuar. Megjithëqë ajo kujdesej për to në mënyrën më të mirë të mundshme, unë hetoja se ato kishin një lloj xhelozie ndaj saj. Ishin motra, por megjithatë, herë pas here shpërthente ndonjë gjest ose veprim i tyre, që nuk ishte krejtësisht i sinqertë dhe pa prapavijë. Por Ana ishte shumë shpirtgjerë dhe i tejkalonte këto imtësi pa ua vënë veshin.

Ndarja ndodhi befas. Ndodhi me një shpejtësi marramendëse, gati të pabesueshme. Ishte 27 maji i vitit 2001. Ana atë ditë duhej të udhëtonte për në Kroaci, sepse në "Arenën" e Pulës ishte aranzhuar një koncert i saj. Unë nuk mund të udhëtoja me të, pasi po atë ditë në Bolonjë kisha caktuar një takim me një mjek amerikan, sepse kisha një problem me nofullën, që më kishte mbetur që nga koha e aksidentit. Ishte rritur njëra anë e nofullës, për shkak të kafshimit të vazhdueshëm vetëm në atë anë. Bëhej fjalë për një kontroll ambulator, jo për operacion, sepse mjeku amerikan nuk kishte të drejtë operimi jashtë vendit të tij. Vetë Ana e kishte bërë rezervimin në klinikë, e kishte caktuar takimin dhe ishte marrë vesh për detajet e tjera. Pas koncertit, Ana do të vinte edhe vetë në Bolonjë.

Në mëngjes u çuam dhe shoqëruam në shkollë Qazimin dhe Françeskën, fëmijët e Anës. Në kthim, u ndalëm dhe pimë kafe në një nga ato lokalet e mrekullueshme të Luganos, buzë liqenit. Folëm për gjëra të zakonshme. Më pas u kthyem në shtëpi dhe pritëm derisa të vinte shoferi i Anës, i cili atë ditë u vonua pak. Përsëri pimë kafe në kuzhinë, në shtëpi. Ndërkohë, erdhi shoferi i Anës, dhe unë e përcolla deri te dera. Ajo u nis dhe unë u ktheva përsëri në kuzhinë, që të merrja valixhen time të bërë gati, në mënyrë që të nisesha për Bolonjë.

Në këtë çast ra telefoni i shtëpisë. Ishte vëllai i Anës. Familjarët e Anës që jetonin larg, e dinin që unë do të shkoja në klinikë. Ishin shumë të kujdesshëm dhe për çdo gjë thërrisnin në telefon, pyesnin, interesoheshin. Pra, ishin jashtëzakonisht korrektë. Po në këtë moment, motra e madhe e Anës, -Xhemile(Gemma) e kishte emrin-, kaloi nëpër kuzhinë, e kuptoi se unë isha duke folur me vëllanë e saj dhe më bëri me shenjë diçka. Unë siç isha i përqëndruar në bisedë në telefon, nuk e mora vesh se çfarë më thoshte, kështu që e mbylla telefonin. Ajo m'u afrua dhe më fyu shumë keq.

“Pse e mbylle telefonin, budalla!”, më tha ajo. *Scemo* është një fjalë që italianët e përdorin shpesh, edhe kur e kanë me shaka. Por mua këtë fjalë ma tha me njëllonj nervozizmi, kështu që shfryrja e saj mbi mua kishte këtë kuptim: pse e mbylle telefonin, budalla! Unë ia ktheva në të njëjtën masë: Budallaçkë je ti! - i thashë dhe shtova:

-Nëse je këtu për punë (ajo merrte rrogë prej meje, sepse kujdesej për fëmijët e Anës), bëj punën tënde ashtu si duhet. Në të kundërtën, në këtë shtëpi je mysafire dhe sillu si mysafire. Nëse kështu nuk të pëlqen, atëherë përjashta!

Dhe e shtyra pak, në kuptimin – ja ku e ke derën! Por ajo, aty për aty, bëri sikur u rrëzua dhe nisi të bërtiste me zë të lartë. Ishte një inskenim i qartë. Nga britmat e saj ushtoi shtëpia. E thirri të shoqin: -Ndihmë, se ky më mbyti!- bërtiti.

Burri i saj gjithashtu punonte për mua, si shofer, me rrogë të mirë, biles edhe kravatat e mia ia falja. E mbaj mend se atë ditë mbante pikërisht një nga ato kravatat që ia kisha lidhur unë, sepse ai nuk dinte t'i lidhte ato. Ai hyri në kuzhinë dhe ia nisi të bërtiste: “Si sillësh ti me gruan time kështu” e gjëra të tjera. Nuk e di si ndodhi, por, pa një pa dy, i thashë:

-Ti, dil jashtë! Lëri makinat dhe mos të t'i shoh sytë! Mos eja më kurrë!

U bë hallakamë e madhe. Dolën edhe dy motrat e tjera të Anës, edhe ato duke bërtitur. Kanë qenë aty edhe mbesat e saj. Edhe ato u ngjitën nga kati i poshtëm, duke u çjerrë. Pastaj dolën në oborr, të gjithë sa ishin, dikush duke folur me zë të lartë, dikush duke bërtitur. Si italianët e jugut! Mentalitetin e kishin të tillë. Dera e jashtme kishte qenë e hapur, kështu që njerëzit kishin filluar të mblidheshin

në rrugë. Nuk dinin se çfarë po ndodhte.

Ndërkohë, që të mos dilja nga shtëpia ashtu i nervozuar, shkova në dhomën time, piva pak ujë, i freskova sytë dhe u nisa të dal. Sakaq Anën e kishin njoftuar me telefon dhe ajo u kthye nga rruga për në aeroport. Kur dola te dera, e pashë duke hyrë dhe u tërhoqa në sallon, me idenë që atje mund të sqarohemi, nëse ajo kërkonte një sqarim të tillë. Nëse edhe ajo do t'ia niste me britma, së paku le të mos dëgjoheshim jashtë. Tani edhe Ana erdhi duke bërëtitur. Nuk la gjë pa më thënë në italisht. Me fyerje, me sharje, me fjalët më të rënda. Unë u përpoqa ta qetësoja dhe të sqaroheshim pa tension.

-Prit të të shpjegoj!-, i them. -Durim pak!

Por ajo nuk ndalej. Shkova në fund të sallonit, u mbështeta në mur dhe prita që ajo të shfryhej, pa ia kthyer asnjë fjalë. Dikur, përsëri jam përpjekur të shpjgohem. I thashë edhe një herë:

-Ndalu pak! Ti nuk po më lë të të sqaroj se çfarë ka ndodhur!

Ajo vazhdoi me të sajën:

-Nuk ke çfarë më sqaron ti!

Dhe prapë sharje, fyerje nga ana e saj. Atëherë i thashë:

-Mbylle! Ose më dëgjo, ose jashtë prej këtu, edhe ti menjëherë!

-Edhe unë?!, thotë ajo e habitur.

-Po, po, edhe ti!

Pa e zgjatur më, e mora valixhen te dera, u futa në makinë dhe u largova, pa e kthyer kokën prapa. U nisa për në Bolonjë, atje ku e kisha caktuar terminin për kontroll mjekësor. Rrugës bisedova pak me shoferin tim, Valentinin, një djalë i shkëlqyer. Ai kishte qenë dëshmitar i krejt situatës, që nga fillimi e deri në fund.

“Nuk kam parë njerëz më të pakulturuar,” më tha duke ju referuar disa prej familjarëve të Anës. “Këta nuk ishin normalë.”

Nga ky moment, unë nuk dija më se çfarë kishte ndodhur në shtëpinë time. Zhvillimet e mëvonshme i ndoqa përmes televizioneve italiane. Po ikën Ana! Jo, nuk po ikën! Ende është në shtëpi të Pacollit! Jo, nuk është. Gjëra të këtilla! Thashetheme bulevardeske. Por e vërteta ishte se ajo kishte qëndruar edhe një javë në shtëpinë time. Atëherë unë këtë nuk e dija, sepse nga Bolonja shkova në Romë, e më vonë në Toskana, në një shtëpi të vogël që e kam buzë detit.

Katër muaj kam qëndruar atje, ndërsa shumë pak njerëz e dinin se

ku isha. Edhe punët e biznesit i kryeja që andej, përmes sekretares, e cila më lidhte nga një telefon në tjetrin. Telefonin tim personal, gjatë asaj gjurulldie, e kisha hedhur diku në sallonin e shtëpisë sime në Lugano, në kanape, dhe atje më kishte mbetur, kështu që aktivizova kartën rezervë, të cilën gjithnjë e mbaja me vete.

Me të arritur në Romë, thirra avokatin tim dhe e informova se Ana mund ta kontaktonte. Ia shpjegova në detaje si ishin zhvilluar ngjarjet, por, kryesorja, i them, - shko merru vesh me Anën. Nëse është për divorc, fillo procedurën.

Po të donte avokati, siç ndodh zakonisht në raste të këtilla, mund të ndërhynte dhe ta qetësonte situatën. Mirëpo, atij më shumë i leverdiste divorci, sesa një kthim në normalitet. Pra, avokati ndiqte leverdinë e tij. Kjo është e kuptueshme, sepse të bëje një shkurorëzim të tillë, të këtij niveli, për secilin avokat ishte privilegj i madh. E them këtë, për shkak se më vonë, gjatë një bisede me Anën, pas shkurorëzimit, kuptova se ajo më kishte thirrur disa herë në telefonin tim personal. Por telefoni kishte mbetur në sallon, ku nuk kishin lënë të hynte njeri, madje as pastrueset. Në anën tjetër edhe Ana kishte krenarinë dhe dinjitetin e saj, që me forcë nuk mund të thyhej. E njihja Anën. Në çdo bisedë, ajo insistonte që kishte të drejtë. Çdokush që përkrahte qëndrimet e saj, mund të bëhej i besueshëm i saj. Kjo “bashkëfajësi”, në raste të tilla e bënte atë që të besonte edhe më tepër në atë që e rrëfente. Bile edhe për të formuar një ide të re. Me shumë gjasa në kontaktet që kishte pasur avokati im, por edhe i saj, i kishte thënë se “sigurisht që kishte të drejtë”, kështu që ideja e saj për divorc, indirekt është mbështetur edhe nga ata. Edhe ky element, e kishte fuqizuar idenë e saj për ndarje. Ndarja edhe *de jure*, ndodhi në tetor të 2001-shit.

Thënë me pak fjalë, shkurorëzimi me Anën nuk erdhi si pasojë e mospajtimeve apo mosmarrëveshjeve të vazhdueshme, që realisht e bëjnë jetën bashkëshortore të pamundur. Bëhej fjalë për një ngatërrësë, për një incident, madje ndoshta më shumë për një keqkuptim, i cili, me pak durim dhe mirëkuptim, do të mund të sqarohet. Ishte diçka e krijuar, e prodhuar, fryt i stilit tim të jetesës allashqiptare, i bashkëjetesës me shumë njerëz, i gjerësisë sime shpirtërore, që ndikoi pastaj edhe në jetën time bashkëshortore. Por,

ajo që ndodhi, ndodhi, dhe tani ishte sikur puna e perit, që këputet dhe nuk ngjitet më.

Në të vërtetë, kur jam kthyer në Lugano dhe e kam parë shtëpinë e paprekur, se Ana kishte marrë vetëm gjërat personale dhe asgjë tjetër, unë mund ta thirrja e t'i thosha të kthehej. Ajo kishte lënë edhe kartat e mia të kreditit dhe çdo gjë tjetër. Pra, ishte treguar shumë e kujdesshme dhe fisnike. Dhe unë e dija se, po t'i thosha të kthehej, ajo do ta bënte këtë. Mirëpo, edhe për mua tani ishte vonë. Edhe unë tashmë e kisha vendosur dhe nuk kishte kthim prapa. Kjo situatë u përsërit edhe në tetor, përpara gjykatësit, i cili kishte marrë në shqyrtim divorcin tonë. Ai na e bëri të ditur se nuk ishte një konflikt i patejkalueshëm dhe tha:

-Me sa shoh unë, ju që tani mund të ngriheni dhe ta përqaftoni njëri-tjetrin. Edhe përkundër asaj që ka ndodhur mes jush, ju dukeni një çift shembullor.

-Jo, -thashë unë. -Ka marrë fund kjo punë.

-Epo, -tha Ana, -meqë për të paska marrë fund, edhe për mua ka marrë fund.

Pas nënshkrimit të aktit të divorcit, i thashë Anës:

-A jemi tani të shkurorëzuar?

-Po,- përgjigjet ajo.

-Eja tani të pimë një kafe dhe ta sqarojmë se ku ngeci puna jonë. Zbritëm në bar, u ulëm në kënd dhe porositëm kafe. Ana nuk ishte e qetë. Shihej një tension në mënyrën e saj të sjelljes. Unë e njihja mirë dhe e shihja se aktin e divorcit e kishte përjetuar rëndë. As unë nuk isha indiferent, por mbahesha, gjithsesi më mirë se ajo.

A të kam thënë,- i thashë Anës, ndërsa u ulëm përballë njëri-tjetrit, -se mund të vijë një çast, kur gjërat mund të marrin rrugë të këtyllë, pikërisht siç morën...?

-Po, por ti...,- ndërhyri ajo.

Prit, i thashë. -Tani jemi të ndarë. Së paku tani mund të bëhesh e duruar dhe të më dëgjosh. A kemi pasur një jetë të bukur? Po. A të kam thënë se, kur të vijë deri te fyerjet dhe sharjet, më mirë është që secili të shkojë rrugës së vet...?

-Po...

Dhe pastaj ia shpjegova fill e për pe si kishte ndodhur ngjarja, pashtuar



foto:Darko Mihalić

*Me Hanën dhe Isën, nëntor 2010*

dhe pa munguar asgjë. I tregova si kishte vepruar motra e saj, si kishte ndodhur krejt incidenti. Fytyra e saj mori një përskuqje të lehtë dhe nga sytë filluan t'i rridhnin lotët. Unë vazhdova shpjegimet e mia, kurse ajo vazhdonte të qante, ashtu në heshtje, pa dënesje, sikur lotët i rridhnin vetvetiu. Nuk i fshinte fare. Lotët i shkonin rrëke, i piknin mbi tryezë. Kurrë nuk kisha parë një grua të qante me aq shumë lot, si shiu. Dikur u kthye dhe më tha:

-Vetëm një gjë nuk ta fal kurrë. Që ti ike dhe nuk patëm rastin të bisedojmë.

Në këtë moment edhe unë u preka dhe mund të them lirisht se Ana ka qenë një zonjë në kuptimin e plotë të fjalës. Edhe në momentin e fundit. Gjithmonë dëshiroj të dëgjoj mirë për të.

Kaq. U përshëndetëm, tani si miq, dhe secili shkua rrugës së vet. Më kujtohet, aty jashtë silleshin gazetarë, paparacë, që kishin vrapuar të shihnin si do të zhvilloheshin gjërat, mos do të kishte konflikt, fjalosje, ose, eventualisht, ripajtim. Duke e ditur se çfarë pritnin, besoj se kanë shkuar të zhgënjyer.

Një pyetje që zakonisht bëhet në raste të këtilla, ka të bëjë me mënyrën e ndarjes, respektivisht me prishjen e kontratës, sepse

martesa, në pikëpamje ligjore, është kontratë midis dy personave. Ana nuk mori asgjë, përveç gjësendeve të saj personale. E kam shpjeguar më herët, se edhe kartelat e bankës i kishte lënë. Edhe kartelën e telefonit që ka pasur, e ka lënë. I ka pasur dy vetura, të cilat ia kisha blerë unë. Njërën e kishte marrë, ndërsa tjetrën e kishte lënë aty ku kishte qenë, në garazhin e shtëpisë.

Pavarësisht nga ky përfundim, e kam borxh ndaj Anës të them se me të kam kaluar çaste të paharrueshme dhe se ajo më ka lënë kujtime shumë të bukura. Unë i dua këto kujtime dhe nuk i ndërroj me asgjë. Por rrugët jetësore të njerëzve, ashtu siç dinë të bashkohen, dinë edhe të ndahen. Tani, secili ka jetën e vet. Sigurisht ajo e di se tani unë me Mashën kam krijuar familje dhe se jam shumë i lumtur. Nga ana tjetër Masha 30 vjeçare, merret me art dhe është grua që di t'i vlerësojë normat familjare, dhe kjo për mua është shumë me rëndësi. Aktualisht Masha udhëheq fondacionin tim, "Ibrahim Kodra", organizon ekspozita dhe vernisazhe të ndryshme. Udhëheq edhe galerinë e përhershme të arteve në hotelin tim, "Diamond gallery". Flet rrjedhshëm pesë gjuhë, përfshirë edhe shqipen.

## Misioni im në Afganistan

*Sprova e re: një mision humanitar në një vatër krize të rrezikshme ndërkombëtare, si Afganistani. Lirimi i një punonjëse kosovare të OKB-së, bashkë me kolegët e saj, rënë në duart e talebanëve. Kontaktet me politikën afgane dhe atë të Kosovës. Suksesi dhe përfshirja dhe në sprova të ngjashme me koreanë, italianë, në Afganistan dhe dy zviceranë në Libi.*

**K**am bërë shumë udhëtime nëpër botë dhe kam përjetuar shumë gjëra. Kam njohur aq shumë njerëz, kam parë aq shumë situata, sa që e kam të vështirë t'i kujtoj të gjitha. Disa përjetime do të mbesin vetëm në kujtesën time, disa do të lënë vrragë te unë, disa të tjera do të zbehen me kohë dhe do të zhduken përgjithmonë. Asnjë jetëshkrim nuk mund t'i përfshijë të gjitha, pavarësisht sesa i gjerë e vëllimshëm mund të jetë ai.

Gjithmonë mbetet diçka e pathënë. Siç ka mundur ta vërejë besoj lexuesi, unë nuk kam përfshirë në këtë rrëfim shumë përjetime “anësore”, krejtësisht personale dhe intime. Kam konsideruar se ajo që është ngushtësisht private, nuk është me interes për lexuesin, i cili, ç’është e vërteta, gjithmonë kërkon të dijë më shumë nga ç’ofron një njohje publike në distancë e një personi. Ndërkohë gjithnjë ekziston rreziku që ai të bezdiset me cikërrima dhe detaje që i përkasin vetëm individit në fjalë dhe që nuk kanë asnjë domethënie për një mjedis a për një rreth më të gjerë njerëzish. Prandaj, në këtë rrëfim jam përpjekur të shmang maksimalisht ato ngjarje dhe bëma që janë tepër personale, i prirë nga ideja se ato më përkasin vetëm mua dhe, si të tilla, nuk kanë pasur dhe as nuk mund të kenë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve të tjerë, as në rrethanat me të cilat përballen ata pothuajse çdo ditë.

I prirë nga kjo ide, jam përpjekur që nga ky rrëfim për jetën time të lë pas, sa ka qenë e mundur, shkarjet emocionale, duke e ditur se përjetimet që përzihen me ndjenja sjellin subjektivizëm. E pse të mos jem subjektiv? Sepse, thonë, emocionet e mjegullojnë të vërtetën,



kurse unë jam përpjekur që asaj t'i përmbahem që nga fillimi e deri në fund. Megjithatë, në këtë objektivitet ka diçka që quhet e pamundur dhe ky është këndvështrimi personal i ngjarjeve dhe ndodhive. Ndryshe as që mund të ndodhte, sepse në këtë rrëfim kam përfshirë zhvillime që lidhen me personin tim, por të objektivizuara në shkallë maksimale dhe të papërziera me emocione, çfarëdoqofshin ato. Kur kam folur për emocione, i kam ndarë ato nga rrëfimi i ngjarjeve dhe fakteve. Qartësisht.

Këtij parimi u përpoqa t'i përmbahem edhe me këtë rast, kur vendosa të bëj të ditur disa detaje nga një udhëtim imi i pazakontë në Afganistan, atje ku prej shumë vitesh është përqendruar vëmendja e opinionit botëror, për shkak të politikës dhe të fateve njerëzore që pleksen në një tërësi tragjike. Duke e ditur se sa rëndë peshon fatkeqësia mbi shpirtin e secilit individ, që nuk arrin të gëzojë jetën me të mirat e saj, nuk kam mundur të jem asnjëherë indiferent ndaj fatkeqësive të të tjerëve, qofshin ato individuale ose kolektive.

Po çfarë ndodhi në të vërtetë që më bëri dhe mua protagonist? Më 28 tetor të vitit 2004, në kryeqytetin e Afganistanit, në Kabul, u rrëmbyen tre shtetas të huaj, punëtorë të Kombeve të Bashkuara, të cilët po ndihmonin për përgatitjen e zgjedhjeve presidenciale në atë vend të përfshirë nga lufta dhe kryengritjet. Kosovarja Shqipe Hebibi, irlandezja Aneta Flamingan dhe filipinasi Angjilito Najan u rrëmbyen në qendër të Kabulit nga një grup njerëzish të armatosur, të cilët pas pak kohe u identifikuan si "Ushtria myslimane". Ky grup i armatosur, në këmbim të lirisë së tre punonjësve të OKB-së, kërkoi si fillim lirim të 26 të burgosurve talebanë në Guantanamo Bay në Kubë. Më pas, militantët që mbanin tre të rrëmbyerit vendosën një afat treditore për largimin e trupave të huaja nga Afganistani, ndërsa Filipineve prej nga ishte njëri nga tre të rrëmbyerit, iu kërkua që të dënonte ndërhyrjen ushtarake në Afganistan. Në të kundërtën, qeveritë e vendeve nga ishin pengjet, do të bëheshin dëshmitare të ekzekutimit të shtetasve të tyre pas tri ditësh, "nëse nuk plotësohen kërkesat tona", pat thënë mulla Muhamed Ishaq, duke u prezantuar si zëdhënës i grupit "Ushtria myslimane", një fraksion i talebanëve.

Duke njohur praktikën e mëhershme të rrëmbimeve të këtilla në Afganistan, secili e kuptonte se as në mënyrën e rrëmbimit dhe as në



*Me kryebashkiakun e Kabul-it, z. Nayad Sahebi, 2004*

kushtet e parashtruara, rasti nuk paraqiste ndonjë befasi dhe diçka të panjohur, që nuk ishte hasur më parë. E veçanta qëndronte në faktin se në mesin e të rrëmbyerve ishte edhe një qytetare e Kosovës, e Kosova nuk ishte shtet i njohur ndërkombëtarisht, nuk ishte anëtare e OKB-së dhe me asgjë nuk kishte marrë pjesë në luftën në Afganistan, përveç me disa punonjës në organizata humanitare ose të tilla që drejtoheshin nga OKB-ja. Nuk ishte diçka që nuk dihej: ata kishin shkuar në Afganistan për kafshatën e gojës, pra për të siguruar një rrogë dhe asgjë tjetër. Fjalët e Muhamed Ishaqit se qeveritë e vendeve përkatëse prej nga ishin pengjet do të ishin dëshmitare të ekzekutimit të tyre pas tri ditësh, linin të kuptohej se rrëmbyesit nuk kishin bërë ndonjë “përzgjedhje” aq të mençur dhe të sofistikuar. Cila qeveri? E



*Gjatë misionit në Kabul, 2004*

Kosovës? Po çfarë roli mund të kishte ajo në punët rreth Afganistanit?! Mirëpo, kjo rrethanë nuk e zbehte aspak rrezikun, madje e bënte edhe më të madh, sepse tashmë ishte punë e njohur se grupet e talebanëve, ose ata që identifikoheshin si të tillë, kërkonin që dikush “t’i kompensonte” pengjet. Kush do ta bënte këtë nga Kosova? Askush. As nga OKB-ja jo, natyrisht...

Rrjedhimisht, kosovarja Shqipe Hebibi ishte seriozisht e rrezikuar, sepse nuk kishte asnjë institucion “shtetëror” që do të interesohej për fatin e saj. Derisa ta merrnin vesh grupet e talebanëve se Kosova administrohej nga ky a ai mision, se shtetësia e saj nuk funksiononte, se nuk kishte qeveri e institucione që mund t’i dilnin zot qytetarit të saj; kur të merreshin vesh të gjitha këto, për çdokënd që ishte




*Me ish-mbretin e Afganistanit, Zahir Shah, 2004; një burrë shumë i kulturuar, që meriton respekt*

vënë përpara tytës së pushkës, mund të bëhej vonë. Kishte edhe dy motive të tjera që më nxitën të ndërhyja: e para, kishim të bënim me dy gra të reja, mbase pa ndonjë eksperiencë të madhe në përballje të këtilla dhe, e dyta, tradita shqiptare nuk e njeh marrjen peng, aq më pak të femrës. Kjo nuk është traditë jona për të arritur ndonjë qëllim.

Në të vërtetë, unë prita tri-katër ditë ndonjë reagim nga institucionet e Kosovës, së paku të dilnin e të thoshin diçka, t'i shpjegonin botës dhe rrëmbyesve se Shqipja vërtet ishte qytetare e Kosovës, por ajo ishte shtetase pa shtet. Ose të thoshin se Kosova nuk ka kapacitet për të ushtruar çfarëdo ndikimi mbi zhvillimet në Afganistan. Apo, fundja, të shprehnin keqardhje për atë që kishte ndodhur dhe të kërkonin prej rrëmbyesve që Shqipe Hebibi të mos ekzekutohej. Asgjë nga të gjitha këto. Asnjë reagim publik dhe asnjë tratativë diplomatike. Ishte një situatë dramatike. Unë kam bredhur shumë nëpër botë dhe e di se është një ndjenjë shumë e keqe, kur je i vetëdijshëm se nuk ke askënd të të dalë zot. Sado i dobët të jetë shteti që i përket, kur e di se ai, qoftë edhe si zë i bjerrë, qëndron prapa teje,

ndihesh më mirë sesa të jesh krejtësisht i braktisur. Ne për shumë kohë e kemi provuar se çfarë do të thotë të mos kesh shtet. E edhe më keq është kur e ke shtetin, por ai nuk funksionon dot.

Këto ishin motivet që më nxitën të merrja rrugën përnjë Afganistan. Udhëtova me avionin e linjës nga Stambolli në Kabul, ku arrita në orën gjashtë të mëngjesit të datës 6 nëntor. Nuk kisha qenë ndonjëherë



*Në rrugët e Kabulit të varfër dhe të rrënuar më shumë se në parashikimet e mia*

në këtë vend fatkeq. Ndonëse kisha një përfytyrim, kryesisht nga ajo që kisha parë në televizor, pamja që m'u shfaq para sysh me të arritur në Aeroportin e Kabulit, i tejkalonte të gjitha parashikimet. Kabuli ishte praktikisht një qytet-rrënojë, një si grumbull gurësh e dheu, mbuluar me pluhur. Njerëzit ngjanin me hije të përhimta, gati si fantazma. Ngado që sillje sytë, shihje vetëm godina gjysmë të rrënuara dhe varfëri të madhe. Thjesht, e kisha të vështirë ta kuptoja si jetonin ata njerëz. Pothuajse asgjë nuk funksiononte.

Pas njëzet kilometrash rrugë, arrita në hotelin *Interkontinental*, ku kisha bërë rezervimin. Ai hotel, në krahasim me atë që shihej përreth, mund të thuhet se mbahej disi. Aty fillova menjëherë aktivitetin tim, falë një lidhjeje që kisha me kryebashkiakun e Kabulit, zotin Nayad. Ai ishte njeri që e njihte mirë situatën në Afganistan, kishte informacione dhe dinte se çfarë duhej bërë, nga duhej filluar. Ishte njeri me autoritet në rrethin e tij, ishte i durueshëm dhe dinte si duhej t'i qaseshim një operacioni si ky. Gjatë 17 ditëve vijuese unë isha vazhdimisht me të dhe ai nuk u ankua as edhe një herë. E kishte pranuar realitetin të tillë çfarë ishte dhe përpiquej të ndihmonte me

krejt qenien. Kurrë nuk ankohej e as nuk shprehte ndonjë pakënaqësi. Tridhjetë vitet e luftës në Afganistan kishin krijuar një filozofi të veçantë jetësore, që nuk e kam hasur pothuajse askund tjetër. Njerëzit ishin bërë disi indiferentë e të pandjeshëm ndaj fatkeqësisë së tyre. Por në heshtjen dhe durimin e tyre kishte shumë dhembje e shumë vuajtje.

Dhe kështu, me kryeplakun e Kabulit, zotin Nayad, bëmë përpjekjet e para për të vënë kontakt me rrëmbyesit. Nuk ishte e lehtë, sepse çdo gjë duhej të zhvillohej në konspiracion të thellë, duke pasur kujdes maksimal që të mos e prishnim operacionin dhe të venim në rrezik jetën e pengjeve. Një veprim i pamatur mund ta shkaktonte edhe njëërën edhe tjetrën. Prandaj duheshin gjetur njerëzit e përshtatshëm për ndërmjetësim, të tillë që duhej të ishin të pranueshëm për të dy palët, që mund të gëzonin njëfarë besimi edhe te ne, por edhe për pengmarrësit. Njerëzit e tillë nuk gjenden lehtë në një vend ku të gjithë kanë shumë arsye jo vetëm të të mashtrojnë, por edhe të jenë kundër njëri-tjetrit, për arsye shpesh të pakuptueshme për ne. Pra, njeriu i parë me të cilin zhvilluam bisedime ishte një gjeneral i talebanëve, që po e kodojmë me emrin Gjenerali X, i cili kishte kaluar dy vjet në burg, i ishte konfiskuar pasuria dhe, për pasojë, kishte një gjendje të keqe ekonomike. U takuam me të dhe i treguam si qëndronte puna. Ai e mori përsipër të na përvijonte rrugën drejt pengjeve, duke na vënë në kontakt me pengmarrësit. Këtë ai arriti ta bënte brenda 12 orësh, kur unë mësova se Shqipja ishte gjallë, gjë që ishte me shumë rëndësi.

Dua të bëj këtu një digresion dhe të rrëfej një ndodhi të çuditshme, e cila kufizon me një lloj bestytnie. Që në fillim të operacionit, më dërguan te një njeri që konsiderohej filozof e matematikan, i cili, nëpërmjet kombinimit të numrave të ndryshëm, bënte parashikimin e gjërave. Më duhet të them menjëherë se ai nuk kishte ndonjë informacion paraprak për pengjet dhe as dijeni për vendndodhjen e tyre. Pra, ishte shumë larg nga këto zhvillime. Ma kërkoi numrin e pasaportës së Shqipës. Unë nuk e kisha atë, por i tregova vitin e saj të lindjes, 1968. Pas disa kombinimeve që bëri, më tha se ishte herët të flitej për lirimin e saj. Sipas tij, ajo do të lirohej mes datës 19 dhe 29 të muajit në vijim. Unë nuk kisha vullnet të besoja gjëra të tilla,



*Me Bexhat Bajramin dhe Domenik Medlej (Medley). Pa ata s'do kisha bërë shumë.*

sepse nga natyra nuk jam bestyt. Por kur ndodhi lirimi mu në mes të atyre datave, më ra ndër mend parashikimi i tij. Shkova e vizitova dhe ia pagova hakun, sepse e kishte merituar. Duke menduar më vonë për këtë ndodhi dhe mbi bazë të leximeve të shumta, erdha në përfundim se në atë pjesë të botës, nën atë rrënojë të frikshme që ka shkaktuar lufta e tmerrshme, fle një kulturë e lashtë, për të cilën ne perëndimorët e zakonshëm nuk kemi as njohuritë elementare.

Me ndihmën e Gjeneralit X, vumë kontaktet e para me talebanët, që fillimisht ishin të nivelit të ulët. Por nuk kishim zgjidhje tjetër. Duhej filluar nga diçka. Një ditë udhëtuam, me dy makina, disa kilometra jashtë Kabulit me shpresë se do të mësonim diç për Shqipen. Atje takuam dy njerëz të maskuar, të cilët u sollën mirë me ne dhe biseduam për mënyrën si do të binim në kontakt me Shqipen. Ata më thanë se një kontakt i drejtpërdrejtë ishte i pamundur, por më siguruan se Shqipja ishte mirë dhe se nuk i kishte ndodhur asgjë e keqe. Atëherë unë kërkova një shenjë prej saj, që të sigurohesha

se pohimet e tyre ishin të vërteta. U thashë ta pyesnin se sa është larg Prishtina nga Peja dhe cila ishte ditëlindja e vëllait të saj, edhe pse këtë nuk e dija as vetë, ngaqë vëllanë e saj nuk e kisha parë e as takuar ndonjëherë. Të nesërmen, Gjenerali më tha se Prishtina dhe Peja ishin larg 83 kilometra, ma tha edhe ditëlindjen e vëllait të Shqipes, por unë, para tyre, e quajta të pasaktë këtë informacion, sepse doja të dija më shumë. Për mua kjo ishte parësore, sepse isha i vetëdijshëm për rrezikun e vazhdueshëm të mashtrimit në një operacion si ky.

Me të parë se unë isha i vendosur të kërkoja garanci që nga fillimi se ishim në gjurmë të çështjes e jo në lajthitje, më thanë se Shqipja do të thërriste në telefon. Ua dhashë dy numrat e mi të telefonit. Por unë u tregova pak naiv, sepse prita më kot që telefonata të më bëhej mua në Kabul, kur dihej se një veprim i tillë do të dekonspironte operacionin e tyre, që zhvillohej në një fshehtësi të jashtëzakonshme. Ndodhi që Shqipja po ato ditë telefonoi në Pejë. Unë mendova se ajo kishte telefonuar në shtëpi, por ajo kishte folur me një shoqe të saj. Kishte qenë një bisedë e shkurtër, me ç'rast Shqipja kishte treguar se ishte mirë, se nuk duhej të bëheshin merak për të dhe se një ditë do të kthehej në mesin e tyre. Informatën se Shqipja kishte telefonuar në Pejë unë e mora nga Leme Xhema, asokohe drejtoreshë e Postë-Telekomit, e cila ishte kontakti im gjatë gjithë kësaj kohe me Kosovën dhe me familjen e Shqipes në Pejë. Ky sukses i vogël më bëri të shpresoj se Gjenerali ishte njeri me rëndësi dhe ishte në rrjedhë të ngjarjes. Ai më premtoi se do të ndodhte telefonata dhe fjala e tij doli.

Ç'është e vërteta, në krejt këtë operacion, një vëzhgues i jashtëm mund të mendojë se gjenerali i talebanëve ishte dështimi më i madh. Por, në të vërtetë, ishte e kundërta, sepse në historinë e pengjeve në Afganistan nuk ka ndonjë rast tjetër kur pengu të thërrasë me telefon dhe të thotë se është mirë. Pra, ishte një fillim inkurajues, që nuk duhej nënvlerësuar. Gjenerali më pat premtuar se para festës së Bajramit nëse jo të tre pengjet, Shqipja, për shkak të festës së myslimanëve, do të lirohej.

Më 13 nëntor, Gjenerali më mori në telefon për të më thënë se pengjet do të liroheshin të nesërmen. Ishim në prag të Bajramit dhe





*Gazetari anglez Piter Juvenal dhe gruaja e tij afgane Hasina*

ideja se Shqipja mund të lirohej pikërisht në një ditë feste, nxiste kurajë dhe shpresa të mëdha. Telefonatën e dëgjuam bashkë me Bexhatin, Anitën (një vajzë nga Gjakova, që shërbente në OKB) dhe me Afrim Muhaxhirin në shtëpinë e këtij të fundit.

Mirëpo, kjo nuk ndodhi. Dhe nuk ndodhi për shkak të disa rrethanave, në të cilat u implikua Presidenti i Afganistanit. Ai kishte paralajmëruar amnistinë e një numri të burgosurish, me rastin e festës së Bajramit. Por kjo amnisti nuk u realizua, sepse zyrtari i lartë i Departamentit të Mbrojtjes i SHBA, Xhon Ashkroft (Ashcroft), bëri një vizitë të shkurtër në Kabul dhe, me të arritur në aeroport, dha një deklaratë të shkurtër rreth pengjeve, duke i mëshuar fort faktit se askush nuk kishte të drejtë të negocionte me terroristët rreth tyre. Kjo deklaratë bëri që akti i lirimit të të marrurve peng të mbyllej

hëpërhë. Prandaj premtimi i Gjeneralit për lirim e Shqipëria para Bajramit nuk u realizua.

Pas kësaj isha praktikisht në bllokadë. Dukej sikur çdo gjë kishte marrë fund. Isha shumë i dëshpëruar dhe i mërzhitur. Meqë ishte Bajram, njerëzit qëndronin pranë familjeve të tyre, kurse unë rrija mbyllur në hotel krejt vetëm, pa pasur mundësi që të kontaktoja me familjen, në kohën kur Hana ime ishte katër muajshe. Nuk kisha askë me të cilin mund të këmbëja qoftë edhe një fjalë. Por nga natyra unë jam njeri këmbëngulës, që nuk tërhiqet lehtë para vështirësive dhe nuk i humb shpresat.

Mjerisht, as Gjenerali nuk u duk më. Dështuan të tri takimet e planifikuara. Një herë e prita në hyrjen e kompleksit të hotelit, ndërsa herën e dytë në xhaminë e madhe të Kabulit, i veshur me rroba të afganëve (sipas porosisë së tij). Në xhami unë u fala vetëm, ndërsa ai nuk erdhi. Kurse herën e tretë, duhej ta takoja në hyrje, pranë hotelit, por makina me të cilën ai duhej të vinte e të më merrte, nuk u duk fare. Gjenerali humbi krejtësisht dhe nuk e pashë më. Ka mundësi që dikush e ka izoluar për të mos kontaktuar me mua. Ose e tillë ishte mbase strategjia e rrëmbyesve, të cilët më përcillnin gjatë tërë kohës me kë kontaktoja dhe, për të mos rrezikuar, e kanë shmangur Gjeneralin. Ndjenja se dikush është duke më përcjellë më ka ndjekur prej fillimi, sepse vazhdimisht ndodhte diçka që nuk mund t'ia lija rastësisë. Tani më duhej të gjeja rrugë të tjera, gjithnjë duke u konsultuar me kryeplakun e Kabulit, zotin Ayad. Nisëm kontaktet me ministra të qeverisë afgane, me ministrin e drejtësisë, të kulturës, të komunikacionit e shumë të tjerë. Më vonë vura kontakt me ish-Presidentin e muxhahidinëve të Afganistanit, zotin Burhanuddin Rabbani (një kohë President i Afganistanit), me plakun Muxha Didin etj. Prej tyre dëgjoja gjithnjë të njëjtën histori: populli afgan nuk e miraton pengmarrjen dhe është kundër kësaj dukurie, që nuk do të duhej të ndodhte fare! (Megjithatë, gjatë gjithë kohës, unë me vete mbaja një thikë të vjetër, të cilën ma kishte dhënë Bexhat Bajrami, duke më porositur që ta mbaja me vete kudo!)

U takova po ashtu, në rezidencën e tij në Kabul, me mbretin e Afganistanit, Muhamed Zahir Shah. Rezidenca e tij ishte pranë asaj të Presidentit Karzai, me të cilin kisha caktuar takim, pak më vonë.

Me mbretin kalova një pasdite të tërë duke biseduar për gjetjen e mundësive për të kontaktuar me pengmarrësit. Ishte një njeri shumë i kulturuar, që fliste rrjedhshëm italisht, pasi në Romë kishte jetuar për më se 30 vjet. Kishte dëshirë të qëndroja sa më gjatë me të. Për takimin me Karzain nuk i fola, sigurisht për shkak të respektit ndaj hierarkisë dhe figurës së tij. Ngaqë nuk doja ta ndërprisja bisedën me të, takimi i caktuar me Presidentin Karzai dështoi. Një përpjekje e dytë për t'u parë me Karzain që e pasuksesshme dhe nuk tentova më. Isha i vetëdijshtë se takimi me të nuk do të më ndihmonte, përkundrazi, mund të më dëmtonte, nëse dikush do të më shihte duke hyrë në objekte shtetërore.

Gjatë këtyre bisedave, më lindi ideja që të udhëtoja vetë në Kandahar, për të takuar dikë që nuk donte të thoshte asgjë me ndërmjetësi, për shkak se nuk i besonte përkthyesit. Këtë person ma kishte rekomanduar ish-Presidenti i Afganistanit, Rabani. Rruga për në Kandahar ishte shumë e gjatë dhe e vështirë, një mijë e njëqind kilometra në të dy drejtimet. Ishte një udhëtim si në një planet tjetër: pamje të jashtëzakonshme, male të zhveshura, kanione, lugina, ngjitje e zbritje pa fund. Dhe, mbi të gjitha, u kthyem pa asnjë rezultat. Isha i zhgënjyer tej mase, madje i dëshpëruar. U ktheva në Kabul shumë i lodhur, me një përjetim interesant, por pa arritur të bëja ndonjë hap përpara drejt pengjeve.

Është me rëndësi të theksoj këtu se, me të arritur në kryeqytet, dërgova një mesazh përmes televizionit qendror të Kabulit, i cili është transmetuar edhe përmes agjencisë *Reuters*. Ky komunikim televiziv ka pasur shumë rëndësi në procesin e lirim të pengjeve, sepse mesazhi është dëgjuar dhe është parë prej një numri të madh të afganëve. Pata shkuar edhe në kompaninë telefonike *Afgan-Mobile*, pronë e Aga Khanit, e udhëhequr nga një grup ekspertësh të Indisë. Edhe ata u sollën shumë mirë me mua, duke më mundësuar të dërgoja përmes telefonit një mesazh për katër milionë parapagues. Mesazhi u përsërit vazhdimisht, kështu që ishte e pamundur që abonentët të mos e shihnin atë. Caktova një vajzë që t'i regjistronte përgjigjet ndaj mesazhit tim, kështu që edhe në këtë mënyrë kemi marrë informata të rëndësishme. Edhe ky ka qenë një hap i rëndësishëm për vendosjen e kontakteve. Së fundi fillova kontaktet me gazetarë

të huaj, përmes të cilëve arrita të gjeja ndërmjetësues, pa të cilët as që mund të merrej me mend lirimi i pengjeve.

Meqë ra fjala te gazetarët, dua të them këtu se roli i tyre, i fotoreporterëve dhe i kameramanëve ishte i pazëvendësueshëm në këtë proces. Disa prej tyre ishin njerëz që kishin qëndruar në Afganistan dhjetë, njëzet, madje edhe tridhjetë vjet, kështu që kishin krijuar njohje të gjera me njerëz të të gjitha kategorive dhe qeverive, prej asaj komuniste e deri më tani. Ndodhi kështu, që më rekomanduan pikërisht një të tillë, një kameraman të BBC-së, Peter Juvenal, i cili kishte plot tridhjetë vjet që punonte në Afganistan, duke intervistuar njerëz të të gjitha regjimeve, të kohës së komunizmit, pastaj nga radhët e muxhahidinëve, të talebanëve etj. Ai ishte nga Londra, ish-ushtarak më duket, me gjasë i konvertuar në mysliman dhe në Afganistan ishte martuar me një grua afgane, Hasinën. Jetonte dhe punonte në një shtëpi, ku më herët kishte jetuar vetë Bin Ladeni. Se cili ishte Piter Juvenali, nga largësia ma tregoi Domenik Medleji (Medley). Në një ekspozitë pikturash, Domenik Medleji më dha hollësira rreth Juvenalit. Pas kësaj mua m'u shtua kureshtja për këtë njeri. Gjatë gjithë kohës sa ishim në atë ekspozitë, e përcillja nga distanca se si lëvizte, çfarë gjestesh bënte, me kë fliste etj. Sa më tepër që e përcillja, aq më shumë rritej misterioziteti i tij. E kisha një parandjenjë, gjithnjë e më të fuqishme, se ky njeri dinte shumë gjëra. Dhe se ai do të ishte çelësi i suksesit të këtij misioni.

## Detajet e lirimt

*Kërkesat e çuditshme të talebanëve për para dhe për të bërë të mundur udhëtimin e disa prej tyre në Mekë. Roli i jashtëzakonshëm i kameramanit të BBC-së Piter Juvenal në vendosjen e kontakteve me ta. Udhëtimi im i lodhshëm, por interesant në Peshavar, ku gjendeshin pikat e kontaktit me grupin e talebanëve. Si u arrit sukcesi dhe çfarë kuptova nga organizimi i ndërkombëtarëve në Afganistan?*

**P**arandjenja ime doli e saktë: lirimi i Shqipe Hebibit u bë ekskluzivisht falë kameramanit të BBC-së Piter Juvenal, me të cilin edhe sot e kësaj dite na lidh një miqësi shumë e madhe. Më datë 14 nëntor, unë u takova me këtë njeri për herë të parë në një ekspozitë të një piktoreje kroate, por aty nuk arrita as t'ia zgjatja dorën. Për të më kishte folur, siç thashë, Domenik Medlej, i cili udhëhiqte televizionin e Kabulit - *Kabul TV*. Domenikun e njihja që nga kthimi im prej Kandaharit, ku unë dhashë një mesazh prej 20 minutave për lirimt e Shqipe Hebibit, transmetuar nga të gjitha televizionet e mëdha botërore, e sidomos *Al Jazeera*, që e dha disa herë. Domeniku më foli gjatë për Piterin, duke ma bërë me dije se për nga karakteri ishte tip i mbyllur, njeri që nuk flet shumë. Më tha se ishte vështirë të merrej ndonjë informatë prej tij edhe pse ai njeh shumë njerëz, përfshirë edhe Bin Ladenin dhe talebanët që i kishte intervistuar disa herë. Duke dalë nga ekspozita e dëgjova kalimthi Piterin tek e ftonte dikë në hotelin e tij *Gandamack* dhe kjo ftesë më bëri përshtypje. Më 14 nëntor, pra të njëjtën ditë në mbrëmje, unë vendosa të shkoj në *Gandamack*, si mysafir i rastit. *Gandamack*-u ishte shtëpia ku kishte jetuar Osama Bin Ladeni. Fasada e shtëpisë dhe enterieri kishin mbetur të njëjtit. Krevati i Osamas dhe banjoja që ishte e adaptuar edhe për “abdes” ishin po ashtu të pandryshuara. Në momentin e parë Piteri, i cili bëhej gati të udhëtonte diku për të xhiruar me kamerën e tij, nuk më dha shumë shpresë. Vetëm arriti të më tregonte që kishte qenë në Bosnjë e në Kosovë dhe se ishte anëtar i përhershëm i Organizatës “Front

Line” me seli në Londër. Më tregoi po ashtu se sekretare e klubit të Londrës ishte Pranvera Shema, vajza e profesor Isak Shemës. Kjo njohje me Piterin ma lehtësoi mundësinë që pas largimit të tij të thellohesha në bisedë me gruan e tij, e cila ishte shtatzënë. I tregoja se unë kisha një vajzë të posalindur, se vija nga Kosova, një vend musliman dhe se jetoja në Lugano. Ajo më qante hallin se së shpejti do të lindte dhe në Afganistan nuk kishte kushte, kurse të merrte një vizë për në Perëndim ishte e pamundur, edhe pse ishte e martuar me një shtetas anglez. Nuk më dukej problem i pazgjidhur ky, andaj e ftova që para lindjes të vinte në Zvicër. I premtova t'ia rregulloja vizën dhe t'ia hiqja harxhimet. Oferta i bëri shumë përshtypje Hasinës dhe kjo ishte arsyeja që ne vazhduam bisedën në mjediset çlodhëse të lounge-t të *Gandamack*-ut. Kështu, m'u dha mundësia që t'i tregoja se përse isha aty. E sigurova gjithashtu se për atë bisedë nuk do të dinte askush. Edhe Hasina, sikurse Domeniku, më tha se ishte e vështirë të bisedohej me Piterin rreth një teme si kjo, por më dha të kuptoja se Piteri dinte gjithçka dhe se ajo do të bisedonte me të. Hasina filloi të më quante *vëlla* gjatë bisedës - dhe ky dukej një fillim i mbarë.

*Gandamack*-un e vizitova prapë po atë ditë në mbrëmje, duke darkuar aty, ndërsa Hasina nuk harroi që disa herë të kthente te tavolina ime. U morëm vesh që të nesërmen, më 13 nëntor, në ora 15, të gjendeshim në të njëjtin vend. Unë shkova fiks në kohë në vendin e caktuar, ku pashë se bashkë me Hasinën ishte edhe Piteri. Orë të tëra u deshën që ta bindja të më ndihmonte. Më në fund ia dola. Më premtoi se po atë natë do të nisej për në Peshauar (Peshawar). Peshauari gjendet në kufi me Afganistanin, në rrugën që lidh Kabulën dhe Islamabadin. E kuptova se atje ndodhte çdo gjë dhe se në atë vend ndodheshin kokat e organizatës që kishte rrëmbyer Shqipen. Ia dhashë 4000 dollarë për shpenzime dhe ramë dakord të më informonte për çdo gjë nëpërmjet gruas së tij, Hasinës. Ma dha dhe një telefon nëpërmjet të cilit Hasina do të komunikonte me mua. Për shkak të sigurisë, unë ndërroja çdo natë hotelet dhe telefoni ishte mjeti im i kontaktit. Sa i përket cilësisë së këtyre hoteleve, ato janë si bujtinat e dikurshme në Kosovë, me kushte jashtëzakonisht të vështira. Të nesërmen, më 14 nëntor, rreth orës 11, Hasina më

telefonoi dhe më tha se duhet të takoheshim. I gëzuar se mund të kishte ndonjë lajm, shkova menjëherë në takim. Hasina më bëri me dije se Piteri kishte pasur një takim interesant në Peshauar dhe se lirimi i pengjeve mund të ndodhte me kusht që të jepeshin 500 mijë dollarë për secilin. Kështu kostoja do të ishte ekzakt 1 milion e 500 mijë dollarë! Hasina më tha gjithashtu se më jepej mundësia të zgjidhja personin që dëshiroja ta liroja. Çfarë oferte cinike për jetën njerëzore!

Por unë nuk mund ta zgjidhja vetëm Shqipen dhe t'i lija dy kolegët e saj të vriteshin. Karakteri im nuk ma lejonte një gjë të tillë. Ia bëra me dije këtë Piterit, i cili filloi të më telefononte direkt në numrin që më kishte dhënë. Më këshillonte, mes të tjerash, t'i kufizoja lëvizjet e mia jashtë hotelit.

Duhet të mbaja llogari, pos për vete, edhe për shoqëruesit e mi. Me mua pothuajse gjatë tërë kohës ishin dy djem nga Kosova: Bexhat Bajrami nga Zhupa e Prizrenit, që punonte për OKB-në dhe Afrim Muhaxhiri, që udhëhiqte një firmë të vogël gjermane të ndërimit, e cila pas luftës kishte vepruar edhe në Kosovë. Këta të dy i njoha atje. Më shoqëronin ditë e natë dhe ishin njerëzit e vetëm që bashkëpërjetonin përpjekjet e mia për lirimimin e Shqipe Hebibit. Duhet të mendoja, pra, dhe për sigurinë e tyre!

Negociatat e ndërmjetësuar nga Piteri ecnin shumë ngadalë. Rrëmbyesit jepnin informata të përgjysmuara, nga vende të ndryshme dhe kjo e ngadalësonte procesin. Piteri më premtoi se do të organizonte takimin tim me krerët e organizatës. Më 22 nëntor, pas shumë shtyerjeve e anulimeve, m'u bë e qartë përfundimisht se duhet të udhëtoja për në Peshauar. Miqtë e mi kosovarë nuk mund të vinin me mua, kështu që mbetej të udhëtoja vetëm. Që në fillim m'u desh të tregoja orën dhe vendin e nisjes nga Kabuli, gjë që më bënte të kuptoja se isha nën kontrollin e tyre. Ma kishin ndaluar të merrja me vete telefon e valixhe dhe të mos ndalesha askund gjatë rrugës prej 4 orë e gjysmë. Kërkuan po ashtu nga unë të vishesha thjesht dhe të mos vija kravatë. As shoferi nuk duhej të kishte ndonjë mjet komunikimi. Ma caktuan edhe makinën të cilën duhet ta merrja. Kështu filloi rruga e vështirë për në Peshauar. Edhe sot e kësaj dite nuk e kam të qartë përse në dalje të Kabulit, ku kishte postblloqe

të shumta policore, e as në dalje prej Afganistanit dhe në hyrje të Pakistanit, askush nuk na kërkoi pasaportat. Kjo për mua mbetet enigmë dhe më shtyn të supozoj se rrëmbyesit kishin lidhje me strukturat shtetërore të Afganistanit, të cilat, në njëfarë forme, edhe i kontrollonin ato.

Gjatë katër orë e gjysmë udhëtimi asnjëherë nuk e dëgjova zërin e shoferit, edhe pse shumë herë tentova të hyja në bisedë me të, duke i bërë pyetje të ndryshme. E tëra që bënte ai ishte ndonjë shenjë me kokë, pa më shikuar fare në sy. Kjo më bënte të shqetësohesha edhe më shumë, por kisha besim në misionin tim dhe në perëndinë që më jepte vullnet e shpresë. Rrugës këndoja këngë shqip, pasi që makina nuk kishte radio. Kaluam kufirin dhe shpejt arritëm te një ndërtesë solide, që ishte hoteli *Continental Peshawar*. Sipas marrëveshjes, aty duhej të më priste Piteri, por atë nuk e gjeta. Në vendtakimin në *Lobby Bar* saora u shfaq një grua, e cila, me një anglishte të rrjedhshme, më tha: “Miku juaj është duke ju pritur jashtë”. Unë mendoja se ishte Piteri, por në dalje pashë një person që u prezantua si taksist dhe më tha: “Behgjet, eja pas meje!” Hapi derën e taksisë, një makinë e vjetër japoneze dhe hyra brenda: ai mori një rrugë anësore dhe diku e ndali makinën. Me t’u ndalur më tha: “Në atë makinë - ishte një xhip me ngjyrë të bardhë - është miku juaj”. Unë dola nga makina, desha të paguaj, por ai më la të kuptoja se s’kishte nevojë. Shkova te makina përballë, pashë të hapej dera dhe u ula mbrapa, ku rrinte ulur një njeri, ndërsa një tjetër, bashkë me shoferin, përpara. Makina u nis me zhurmë e nervozizëm, shprehje e gjendjes së njerëzve që ishin brenda saj. Në momentin e nisjes ma bënë me dije se duhet ta mbuloja kokën, por duke ndjerë shqetësimin tim më thanë të mos frikësohesha. Edhe sot e kësaj dite e ndiej erën e rëndë si prej djerse të asaj mbuloje. Përmbi të më është vënë edhe një pëlhurë, e cila duhet të ketë qenë mbulesa e grave, që të dukesh si femër. Makina bëri nja 20 minuta rrugë, por nga dielli që binte në të kuptova se po silleshim rrugëve brenda në qytet. Makina u ndal diku. E lamë atë dhe hipëm në një tjetër. Pas 3 ose 4 minutash, ashtu të mbuluar, më zbritën nga makina duke më mbajtur për krahu. Pasi ngjita tri shkallë, hymë në një shtëpi. Më ulën dhe ma hoqën mbulojën nga koka. Sakaq pashë para meje dy persona me një kompjuter përpara.



Më pyetën kush jam dhe unë fillova të flas. U tregova se vija nga Kosova dhe se isha mysliman. Më pyetën se çka e kisha Shqipen dhe u thashë se "Shqipja ishte vajza e hallës time". Më pyetën nëse kisha qenë ndonjë herë në Haxh, por unë fillimisht nuk e kuptova se për çka ishite fjala. Ma nxorën një fotografi timen, të cilën asistentja ime e kishte publikuar në internet gjatë kohës kur unë kisha qenë në Mekë. Pastaj i paraqitën kërkesat e tyre. Kërkuan një milion e gjysmë dollarë dhe dërgimin e II vetave në Mekë për haxhillëk. Në kërkesën e tyre të fundit përfshihej rregullimi i vizave dhe gjithçka tjetër. Natyrisht unë pranova; miratova gjithçka, edhe pse nuk e dija se si do të përfundonte puna e dërgimit në Haxh.

Paratë i pagova brenda 60 ditëve, sipas instruksioneve nga Afganistani, pas kthimit në Lugano. Mund të them se në një hark kohor prej 2 vitesh, të II vetët i kam dërguar në Haxh, diçka që m'u kërkua sërish nga Piter Juvenali gjatë vizitës së tij në Lugano. Por kjo nuk doli punë e lehtë: për dërgimin e tyre në Haxh hasa në vështirësi të jashtëzakonshme. Marrja e vizave u bë vetëm në sajë të garancionit tim se ata do të ktheheshin prapë në Pakistan, gjë që edhe ndodhi.

Pasi përfundoi biseda, më morën dhe më lanë në një vend që s'mund ta përcaktoja kurrsesi. Tani edhe taksinë për t'u kthyer në Kabul duhet ta gjeja vetë. E pagova një taksì dhe mora rrugën për në kryeqytetin afgan. Ndryshe nga ç'ndodhi në ardhje, tani në kthim, në kufirin mes Afganistanit dhe Pakistanit, na i kërkuan pasaportat dhe vetëm pas një pritjeje të gjatë arritëm ta kalonim atë.

Në fund të këtij udhëtimit të lodhshëm e të rrezikshëm, kur po hyja në hotel, natën e 22 nëntorit, rreth orës 21 (sipas kohës së Afganistanit), ndodhi mrekullia. Më telefonuan nga celulari satelitor dhe më thanë se *nesër, më 23 nëntor 2004, në ora 6 të mëngjesit, pengjet do të ishin të lira!*

I emocionuar nga sa mësova, desha menjëherë që këtë lajm t'ia bëja të ditur familjes së Shqipës në Pejë, por nuk pata kurajë, sepse m'u kujtua premtimi i parë i rrëmbyesve, i cili nuk u mbajt. Po të dështonte edhe herën e dytë, gjasat për të bërë diçka do të ishin minimale. Prandaj u përmbajta. Telefonova në televizionin ALSAT (rreth 10 orë para se të pasonte lirimi i pengjeve) duke i porositur: "Jepeni informatën e lirimit të pritshëm, por mos thoni

se e keni marrë nga unë!" Atë natë (22 nëntor 2004) ALSAT-i, siç m'u bë me dije nga njerëzit e mi, e dha vazhdimisht këtë informatë shpresëdhënëse për opinionin publik. E thirra edhe ministrin e punëve të brendshme të Afganistanit, Jalalin, dhe shefin e shërbimit sekret afgan. Ky i fundit gjatë dhjetë ditëve ishte në kontakt me mua, natyrisht fshehtazi. Kontaktova me ta nga frika se mos po ndodhte ndonjë incident. Meqenëse lirimi i pengjeve do të bëhej në qytet, në Kabul, policia mund të ndërhynte duke e komplikuar situatën, përfshirë edhe rrezikimin e jetës së pengjeve. Organeve të pushtetit, nuk u thashë asgjë më shumë nga ajo që kisha marrë vesh përmes telefonatës.

Të nesërmen, më 23 nëntor 2004, saktësisht në orën 6 e 9 minuta, sipas kohës lokale, më mbërriti një telefonatë tjetër prej rrëmbyesve. Ata më thanë se pengjet ishin liruar tashmë, se ishin shoqëruar me dy makina deri në njëfarë vendi, se pastaj u ishte dhënë një makinë dhe se ata kishin shkuar drejt e në selinë e OKB-së në Kabul. Në fund të telefonatës më dhanë ultimatumin: "Tash fjalën e ke ti!". Sipas kësaj informate, në orën 6 të mëngjesit pengjet ishin kthyer në zyrat e OKB-së, gjë që kishte ndodhur në mënyrë të qetë dhe pa kurrfarë luftimesh. Me një fjalë, çdo gjë kishte shkuar qetë dhe pa ndërhyrjen e askujt. Misioni ishte kryer me sukses!

Kur e mora vesh lajmin, e thirra menjëherë ministrin e punëve të brendshme, Jalalin, dhe e njoftova me të. Çuditërisht ai nuk dinte asgjë për lirimin e pengjeve, por më porositi që të mos lëvizja nga dhoma!

Nuk kaloi shumë kohë dhe në derë të dhomës dëgjova trokitje. E hapa, kur ç'të shoh: korridori i hotelit ishte i mbushur përplot policë! Kishte ardhur edhe vetë ministri i brendshëm, i cili ma komunikoi se duhej ta braktisja hotelin sa më shpejt që ishte e mundur, sepse jeta ime ishte në rrezik. Më ndihmuan t'i mblidhja plaçkat, hipëm në ashensor dhe, pa më lënë kohë që ta paguaja fjetjen, më futën në një blind. Njerëzit që prisnin për të paguar, mbetën të habitur dhe as nuk kërkuan pagesë për natën e fundit, duke menduar sigurisht se bëhej fjalë për arrestimin tim. Pagesën prej 62 dollarësh për natën e fundit të qëndrimit në hotel e bëra më vonë nga Zvicra. Por le të merremi pak me largimin tim. I shoqëruar me mbi 20 makina

të policisë, u dërgova në zyrën e ministrit të punëve të brendshme. Aty më mbajtën tërë paraditen, fillimisht në zyrë, e pastaj në një sallon të madh aty pranë. Edhe kur kërkova të shkoja në selitë e *Reuters*-it dhe të *Associated Press*-it, që t'i njoftoja me ngjarjen, policia më shoqëroi me një përcjellje shumë të fortë. Siç mund të kuptohet, ata kishin informata se pengmarrësit ose ndonjë organizatë tjetër e këtij lloji mund të më sulmonin, sepse Afganistani është përplot grupe e organizata të tilla, që mund të bëjnë veprime të paparashikuara. Po atë ditë lejuan aterimin e avionit tim privat nga Baku në Kabul dhe pastaj largimin tim nga kryeqyteti i Afganistanit drejt Europës.

Ndërsa qëndroja pranë zyrës së ministrit, ia behën përfaqësuesit e ISAF-it dhe të ushtrisë së përbashkët kombëtare të Afganistanit, përfshirë edhe zëdhënësin e OKB-së, që ishte një brazilian. Filluan të debatonin për një komunikatë në gjuhën angleze, të cilën do ta lexonin në konferencën e shtypit për pengjet, që do të fillonte në orën 10. Dikush thoshte se në komunikatë duhet të thuhet se lirimi i pengjeve ishte bërë me përdorimin e forcës; se kishte pasur luftime; se ishte vrarë një pengmarrës e të tjera të ngjashme. Unë rrija mënjanë, i dëgjoja ato që flisnin dhe nuk u durova pa qeshur. Një ushtarak (më duket kanadez) më pa dhe me mirësjellje më pyeti përse qeshja. Iu përgjigja se mua nuk më dukej me vend ky dokument, kur dihet se pengjet ishin liruar pa përdorimin e kurrfarë force. Në atë moment të gjithë u ndalën dhe shikuan kah unë. Njëri prej tyre, më duket një tjetër kanadez, tha në anglisht: “Zotëria ka të drejtë. Duhet përgatitur një dokument i ri”. Në zyrën ku ndodhesha, rastisa të isha pranë printerit. Kur pashë se po shtypej një dokument, e mora një kopje, e palosa dhe e futa në xhep, gjë që ata nuk e hetuan. Po në atë çast, hyri ministri i cili më thirri në zyrën e tij dhe kështu dokumenti mbeti tek unë. Në atë tekst, të cilin e ruaj ende, ishte paraqitur varianti për vrasjen e pengjeve, që do t'u servohej mediave. Krejt kjo më bëri të besoj se askush nga këto forca nuk ishte marrë me lirimin e pengjeve dhe se njoftimi për mediat ishte i parapërgatitur, sa për t'i hedhur hi syve opinionit. Në Kabul mbretëronte një konfuzion i madh. Veprimet që bënin OKB-ja dhe ISAF-i, ishin sa për të mbrojtur e justifikuar veten dhe

jo dikë tjetër. Ky ishte Afganistani, ky ishte realiteti i atjeshëm.

Duke analizuar më vonë ngjarjen, kuptova edhe diçka që mund të më kishte shërbyer shumë dhe ndoshta mund të ma kursente kohën. Pengjet asnjëherë nuk kishin dalë jashtë Kabulit, por ishin mbajtur gjatë tërë kohës brenda në qytet, madje shumë afër qendrës. Sa për dijeni, pengjet ishin rrëmbyer në një pjesë shumë të frekuentuar të qytetit të Kabulit, e cila nuk ishte larg hotelit *Interkontinental*, më prestigjiozi në kryeqytetin e Afganistanit. Aty ishte një kryqëzim rrugësh, njëra që çonte në aeroport, tjetra që çonte në qendër të qytetit dhe rruga për në Kandahar dhe malet më të afërta. Ishte e qartë se pengmarrësit nuk do të kishin mundur të dilnin nga qyteti në orën 12 të ditës dhe të iknin në male. Sigurisht që ata ishin futur në ndonjë bazë të tyre aty afër dhe po aty i kishin mbajtur pengjet për aq ditë.

Qysh kur i mora informatat e para për rrëmbimin, si ishte zhvilluar ngjarja dhe kush qëndronte prapa saj, m'u krijua bindja se nuk bëhej fjalë për ndonjë organizatë të fortë e me përvojë në punën e pengmarrjes. Vetë kushtëzimet e tyre linin për të dyshuar, sepse të rrëmbesh tre punonjës të zakonshëm të OKB-së dhe të vësh kusht lirimin e të burgosurve të Guantanamos, kjo flet për një grup diletantësh pa ndonjë organizim kushedi çfarë. Kjo u konfirmua edhe më vonë, sepse ata disa herë bënë ndryshimin e kërkesave. Një herë, sikundër e thashë, kërkuan lirimin e të burgosurve në Guantanamo, pastaj kërkesa e tyre "degeneroi" në dy-tre të burgosur. Por kjo s'do të thotë se ata nuk ishin militantë të rrezikshëm, sepse rrëmbimin e pengjeve, sikundër edhe likuidimin e tyre eventual, mund ta shfrytëzonin për t'u legjitimuar si grup, si fraksion, që gradualisht mund të bëhej faktor me rëndësi. E gjithë kjo mund t'i bënte të paparashikueshëm, mirëpo, për fat nuk ndodhi kështu.

Të them në fund se ndërhyrja për të liruar Shqipe Hebibin, pavarësisht nga vështirësitë dhe peripecitë e tjera me të cilat u përballa, pavarësisht nga rreziku që më ndiqte hap pas hapi, më dha një kënaqësi të vërtetë, ndjenjë kjo të cilën e njohin vetëm ata që solidarizohen me vështirësitë dhe fatkeqësitë e të tjerëve. Unë bëra një veprim njerëzor në rend të parë, pastaj edhe prindëror, të cilin e konsideroj si obligim ndaj vendit, Kosovës, e cila nuk ishte në

gjendje t'i dilte zot një bije të vet, të degdisur në botën e largët. Atë që nuk mund ta bënte ajo, pra Kosova, u përpoqa ta bëja unë. Asgjë më shumë se kaq.

Për lirimimin e pengjeve falënderimi i shkon së pari Piter Juvenalit dhe Hasinës, pastaj Domenik Medlejit, kryeplakut të Kabulit, Nayad, ministrit të punëve të brendshme, Jalali, mbretit të Afganistanit, Muhamed Zahir Shah, udhëheqësit të zyrës së OKB-së në Shqipëri, Wahid Wahidulla, ambasadorit të Afganistanit në Romë, Mustafa Zahir (nipi i mbretit të Afganistanit), Bexhat Bajramit, që nuk kurseu asgjë që të më qëndronte vazhdimisht pranë kudo që isha, Afrim Muhaxhirit, gjeneralit X, ish-Presidentit të Afganistanit, Rabbanit, drejtorit të hotelit *Mustafa*, zotit Mustafa Mustafai (të cilin e vranë vetëm dy javë pasi që më vizitoi këtu në Zvicër, gjegjësisht në muajin mars 2005).

Hasina dhe Piter Juvenali mbetën miq të mi dhe kanë qenë mysafirë të mitë në Lugano dy herë. Fillimisht erdhën, siç kishim rënë dakord, kur u lindi vajza e parë. Ata banonin në hotelin tim, qoftë gjatë lindjes së parë, qoftë gjatë lindjes së vajzës së dytë më 2006, që u kryen në spitalin qendror të Luganos. Kështu unë e përmbusha premtimin që i kisha dhënë Hasinës, e cila ma mundësoi lidhjen me burrin e saj.

Me t'u kthyer nga Afganistani mora falënderime nga mbarë bota. Kryetari i Shqipërisë, Alfred Moisiu, më dekoroi me mirënjohje. Mungoi dikush që ishte dashur të vinte nga krerët e atëhershëm qeveritarë të Kosovës. Askush nuk u brengos për këtë, ashtu siç nuk u brengosën as për Shqipe Hebibin gjatë kohës që mbahej peng në Kabul. E kisha dërguar zonjën Xhema te kryeministri, sepse dëshiroja ta dija nëse mund të flisja në emër të qeverisë së Kosovës në Afganistan, në misionin për lirimimin e pengjeve. Ata nuk ma dhanë asnjëherë këtë konfirmim. Znj. Leme Xhema, një kërkesë të tillë ia kishte bërë edhe Presidentit të atëhershëm, të ndjerit Ibrahim Rugova, i cili, në stilin e tij, paskësh thënë: "Ne kosovarët nuk kemi asgjë në dorë dhe nuk mund të lëshojmë një dokument të tillë". Çka ishte edhe më keq, prej këtij momenti më bllokonte edhe OKB-ja në Kabul, çka më linte të kuptoja se një instruksion i tillë kishte ardhur nga Kosova. A ishte instruksion nga OKB-ja në Kosovë apo nga qeveria e atëhershme, nuk mund të them asgjë me siguri, mirëpo

tërë kohën më kanë bllokuar në vend që të më ndihmonin. Aty kam parë sa indiferentë janë dhe sa pak brengosen për punëtorët e vet burokratët e OKB-së!

Sa për ilustrim, për të kuptuar rëndësinë e asaj që bëra gjatë tërë qëndrimit tim në Afganistan, të them se atje qëndruan edhe njësi marramendëse të shërbimeve të inteligjencës nga Irlanda dhe Filipinet, pengjet e të cilëve ishin me Shqipe Hebibin. Unë isha i vetmuar dhe mua m'u refuzua edhe gjëja më e vogël, një letër nga Kosova që nuk kishte kurrfarë kostoje. Por një gjë më jepte forcë dhe ma mbante moralin lart: isha i vendosur në misionin tim sa njerëzor aq edhe patriotik, një, pse ishin në pyetje jetët e njerëzve dhe, e dyta, ngaqë nuk doja që Kosova mos të ishte e pranishme atje, ku ishte fjala për qytetarët e saj. Gjithmonë më sillet në kokë ideja që i besoj dhe për të cilën përpiqem vazhdimisht: populli i Kosovës është shumë i vogël në numër që të lejojë humbjen e kotë dhe pa shkak të shpirtrave të tij.

Pos misionit tim për lirimin e Shqipe Hebibit në Afganistan, unë jam angazhuar sërish në drejtim të liritimit të pengjeve nëpër botë. Më 2006 arrita që të liroj gazetarin italian, po ashtu të rrëmbyer prej shumë javësh në Afganistan, Gabriele Torsielo (Torsiello). Vetë pengmarrësit më kontaktuan me telefon, ndërsa unë isha në Kazakistan. Më ofruan lirimin e tij pa kurrfarë kushtesh në shenjë mirënjohjeje për kryerjen e detyrimeve në të kaluarën. Menjëherë u lidha me qarqet qeveritare italiane, u morëm vesh me pengmarrësit dhe, siç më premtuan nëpërmjet telefonit, të nesërmen e liruan Torsielon në vendin ku më kishin thënë, diku jashtë Kabulit. Prej telefonatës së parë që mora dhe deri te lirimi i plotë, çdo hap e bashkërendita me policinë italiane, duke u mbështetur nga ata. Ishin të panumërta falënderimet që mora prej familjarëve të gazetarit dhe qytetarëve të shumtë italianë.

Po në Kabul, një vit më vonë, më 19 korrik 2007, ndodhi diçka tjetër. Rrëmbyesit talebanë kidnapuan 22 turistë koreanë jashtë Kabulit. Në këmbim kërkuan lirimin e të burgosurve talebanë dhe tërheqjen e trupave koreane nga Afganistani. Gjatë këtij rrëmbimi, dy pengje humbën jetën. Më kontaktuan nga Nju-Jorku; vetë përfaqësuesi i Sekretarit Gjeneral të OKB-së, Ban Ki Mun. Përfshirja ime në këtë çështje u bë në pajtim me autoritetet koreane, duke filluar nga data



*Gjatë ceremonisë për Urdhrin "Kalorësi i paqes së Mijëvjeçarit" në Prishtinë, 2010*

23 gusht 2007. U desh vetëm një javë punë e përqendruar që pengjet të liroheshin të gjithë, përveç dy sish që ishin ekzekutuar në fillimit të operacionit. Kështu, lirimi i pengjeve u bë në natën mes 1 dhe 2 shtatorit 2007. Për këtë mision vazhdoj të marr shumë mirënjohje prej familjarëve, miqve dhe autoriteteve koreane. Në Kore, madje është shkruar dhe një libër në nderimin tim.

Në fillim të vitit 2010, një sfidë tjetër e ngjashme. U angazhova për lirimin e dy qytetarëve zviceranë, të cilët me muaj të tërë ishin mbyllur në ambasadën zvicerane në Tripoli dhe frikësoheshin të dilnin prej aty shkakut i arrestimit. Ata kishin rënë në kundërshtim me ligjin në Libi dhe nuk donin të përballeshin me të.

Ndihmova që njëri prej tyre të lirohej në javën e fundit të shkurtit 2010 dhe të kthehet në Zvicër, kurse tjetri u dënua me një dënim të lehtë, por edhe ky shumë shpejt do të kthehet. Kjo përfshirje imja nuk mbeti pa zhurmë dhe pati një jehonë mediatike ndërkombëtare. U duk sikur u specializova për lirime pengjesh, por thjesht kapitalizova atë eksperiencë që krijova me rastin e Shqipërisë dhe tregova humanizmin tim dhe të popullit të cilit i takoj. Humanizmi im në këto raste preku nivele të larta rreziku, që s'mund të kalonin

pa vëmendje ndërkombëtare, ndryshe nga aktet e përditshme të tij, që unë i konsumoj përditë në Kosovën time.

Ndaj ishte diçka e kuptueshme, ndonëse e papritur, mirënjohja që më erdhi për këtë aktivitet: Urdhëri “Kalorësi i Paqes së Mijëvjecarit” (çmim i dhënë humanistëve të shquar botërorë). Ky vlerësim i lartë m'u bë në shenjë nderimi për veprimtarinë time gjatë dy dekadave, dhe në mënyrë të veçantë për angazhimin tim në Afganistan për lirin e pengjeve në vitin 2004 - Shqipe Habibit me 2 kolegë, më 2006 - për lirin e gazetarit italian Gabriele Torsiello dhe më 2007 për lirin e misionarëve koreanë. Çmimi m'u dorëzua më 3 korrik 2010 në Prishtinë nga personaliteti i njohur si dhe themelues i Unionit Ndërkombëtar për Paqe, z. Xhanfranko Kosta (Gianfranco Costa)<sup>1</sup>.

1. Zoti Kosta shoqërohej nga Merita Profka, drejtuese e Urdhrit për Shqipërinë, Kosovën, Maqedoninë, e cila u nda nga jeta tragjikisht, si dhe nga Erion Muça, Tatjana Nuri, Afërdita Eltaku, Enrico Pigliatile, Pietro Sampaoli, Fiandra Fosco, Mario Gallini, Leonardo Cenci, Giovanni Crocelli, Karla Marchetti, Tiziana Casadei, Olia Serbini, të cilët i falënderoj që më nderuan me ardhjen e tyre në Prishtinë.



## Shqipëria, si vend ku marr fuqi para sfidave të reja

*Takimi me Berishën dhe diskutimet me të për problemet e plasimit të produkteve tona në tregun e Shqipërisë. Kontaktet e tjera të nivelit të lartë me Presidentin, zëvendëskryeministrin Meta dhe ministrin e jashtëm Haxhinasto. Dekorimi i ministrit të jashtëm të Maldiveve për një aktivitet që e kryenim bashkë.. Ceremonia e nderimit tim në Lezhë me titullin "Qytetar Nderi". Nderimi i parë i këtij lloji në hapësirën e shqiptarëve. Nema propheta in casa sua, - askush s'të shpall profet në fshatin tënd, të tjerët po!*

**V**etëm një ditë para se të paraqitesha në parlament, për të mbrojtur mocionin e mosbesimit të 2 nëntorit 2010 isha në Shqipëri, për disa aktivitete të rëndësishme.

Së pari, do shoqëroja ministrin e jashtëm të Maldiveve Shahid gjatë qëndrimit të tij në Tiranë, me ftesë të zëvendëskryeministrit dhe ministrit të ekonomisë Ilir Meta. Ata ishin njohur gjatë aktiviteteve të ndryshme ndërkombëtare, veçanërisht gjatë Konferencës së Organizatës Islamike në Dushanbe në fillim të 2010, ku zoti Meta pati rastin të vlersonte kontributin e mikut Shahid në favor të Kosovës. Zoti Meta e ftoi në Tiranë homologun e vet dhe i rezervoi atij një pritje të denjë për një kryetar shteti siç do kishim rast ta vlerësonim. E prita ministrin Shahid në aeroportin e Rinasit, ku munda të ritakoja një njohje të vjetër, ish Presidentin e Shqipërisë gjatë krizës së Kosovës, zotin Rexhep Meidani.

Të nesërmen na priste një ditë plot takime, ndonjëherë bashkë, por përgjithësisht në axhenda të veçanta. Zoti Shahid u takua me Kryeministrin e Shqipërisë, zotin Sali Berisha, me Presidentin Bamir Topi, me ministrin e jashtëm Edmond Haxhinasto dhe me zotin Meta, i cili tanimë ishte zhvendosur nga ministria e jashtme në atë të ekonomisë. Zoti Topi e dekoroi me propozim të zotit Meta, ministrin

Shahid për kontributin e tij të shquar në favor të Kosovës.

Edhe unë, së bashku me zonjën Mimoza Kusari-Lila, pata një axhendë takimesh ku padyshim më prekësi ishte ai në Lezhë. U takova në fillim me Presidentin e Republikës dhe mora pjesë në ceremoninë e dekorimit të zotit Shahid. Pastaj u takuam me zotin Berisha. E kisha takuar disa herë atë politikan të rëndësishëm të Shqipërisë, duke filluar nga vitet 90, dhe më pas në Kosovë gjatë vizitës së tij zyrtare atje, apo në Tiranë, me cilësinë e kryeministrit. Në takimin e ngrohtë dhe vllazëror që ai na rezervoi mua dhe zv/presidentes Mimoza Kusari-Lila, u diskutua për një mori çështjesh të rëndësishme për bashkëpunimin midis Kosovës dhe Shqipërisë.

Z. Berisha foli për angazhimin e tij dhe të kabinetit që ai përfaqëson, për të promovuar shtetin e ri të Kosovës, përfshirë këtu edhe lënien në dispozicion të infrastrukturës diplomatike të Republikës së Shqipërisë në favor të interesave të Republikës së Kosovës. Me atë rast e çmoi lart punën lobuese timen si dhe përpjekjet e mia për rritjen e numrit të njohjeve për Kosovën. Inkurajimi i tij ashtu si dhe i Presidentit Topi ishin të jashtëzakonshme sepse nuk kisha marrë kesi inkurajimesh prej institucioneve të shtetit tim. Në këtë takim u diskutuan mundësitë e ngritjes së bashkëpunimit ekonomik në mes të dy vendeve. Këtu nga kryeministri Berisha ne kërkua që ai dhe kabineti i tij të krijonin kushte të barabarta për plasimin e produkteve kosovare në tregun e Shqipërisë. Ne përmendëm edhe rastin e mosplasimit të patates, si dhe të rrushit të Rahovecit në tregun shqiptar. Këto dy raste ishin dëshmi se diçka kishte filluar të mos funksiononte në bashkëpunimin midis dy vendeve, në arritjen e atij që ne duhet ta quanim treg të përbashkët shqiptar. Shqiptarët në forume dhe biseda të lira shprehen hapur bashkimit kombëtar, por çuditërisht kanë filluar problemet me projektet, apo produktet e njëri tjetrit në tregjet tona, si p.sh rasti i hidrocentralit të Zhurit, porti i Shëngjinit, produktet bujqësore, etj. Kryeministri Berisha u shpreh i brengosur kur dëgjoji për pengesat



*Takimi me Berishën, një ditë para mocionit të datës 2 nëntor 2010. Gjithmonë në formë, diskutuam për problemet reale të qytetarit të Kosovës së bashku me Mimoza Kusari-Lilën.*

e plasimit të rrushit në tregun e Shqipërisë dhe premtoi se do t`a shqyrtonte për së afërmi mundësinë e heqjes së barrierave në mes të tregut të Kosovës dhe Shqipërisë. Sigurisht kjo kërkonte kohën e vet, pasi ne jemi të dy vende ku të ardhurat doganore janë shumë të rëndësishme për financat publike.

Pas interesimit tonë për integrimin e mëtejshëm të zonës kufitare të Malsisë së Gjakovës, kryeministri Berisha na tha në vitin 2011 do të fillonte ndërtimi i rrugës së Fierzës, rrugë kjo e cila do ta afrojë më shumë këtë zonë. Kryeministri shqiptar, na tha gjithashtu se projekti i hekurudhës mes Kosovës dhe Shqipërisë, është një projekt për të cilin do të bëhet studimi i fizibilitetit, i cili padyshim do të realizohet në një të ardhme të afërt.

Unë e informova kryeministrin Berisha me dinamikën e proceseve politike duke e siguruar se zgjidhja e situatës aktuale në Kosovë po bëhej në kuadër të Kushtetutës së Republikës. Biseda me zotin Berisha ishte e veçantë si gjithnjë. Ai tregoi se kishte



*Me Viktor Tushën, kryetarin e bashkisë së Lezhës, që tani është dhe qyteti im. U nderova me titullin "Qytetar Nderi", nga të gjithë partitë dhe u ndieva i prekur.*

ndjekur me vëmendje fushatën e zonjës Kusari Lila në Gjakovë dhe i kishte bërë përshtypje. Madje shprehu dëshirën për të vizituar atë zonë në të ardhmen.

Sipas një tradite të vjetër të zonës së vet, kryeministri Berisha zbriti deri poshtë në katin e parë të godinës së qeverisë për të na përcjellë.

Ndërsa gjatë bisedës me z. Ilir Meta, ne diskutuam për krizën institucionale në Kosovë, rrugët e zgjidhjes së saj si dhe rolin e AKR-së në këtë proces. Z.Meta vlerësoi rolin tim në drejtim të njohjeve të reja të Kosovës, ndërsa unë e vlerësova mbështetjen e z. Meta në cilësinë e ministrit të jashtëm në këtë proces. Gjatë takimit u diskutua edhe për forcimin e bashkëpunimit dhe integritimit ekonomik të hapësirës shqiptare.

Në orën 16 të asaj dite unë isha në Lezhë, që po shndërrohej në qytetin tim të dytë të lindjes. Një grup këshilltarësh të gjitha krahëve politikë unanimisht, kishte propozuar dekorimin tim me medaljen e



*Duke dëgjuar ciceronin në Muzeun e Besëlidhjes së Lezhës. Na foli për përçarjen që ekzistonte midis feudalëve të kohës dhe rolin përbashkues të Skënderbeut.*

Qytetarit të Nderit, dhe unë po shkoja ta tërhiqja atë nderim.

Më bëri përshtypje mikpritja e jashtëzakonshme e lezhjanëve, e kësaj komune në Veri të Shqipërisë, të njohur për besëlidhjen historike të krerëve të krahinave shqiptare nën udhëheqjen e Skënderbeut. Lezha ishte një qytet me tre fe, dhe shumë parti dhe të gjithë këshilltarët kishin votuar pro meje. Pata një bashkëbisedim të ngrohtë me kryetarin e bashkisë, zotin Viktor Tusha, ashtu dhe me kryetarin e këshillit Frano Kulli, dy intelektualë të qetë në prani të të gjithë këshilltarëve pa asnjë përjashtim. Pastaj në sallën e komunës ju drejtova të gjithë të ftuarve nga politika, biznesi dhe shoqëria civile. Fjala që përgatita atje ishte vërtet e ndjerë dhe dua të përcjell disa prej mesazheve të saj. Ishtë një kënaqësi e rrallë që merrja këtë nderim të veçantë prej një qyteti unik në historinë e Kombit tonë. Lezha, është Qyteti i beslidhjes së burrave më të mëdhenj shqiptarë që nën udhëheqjen e Skënderbeut morën vendime për t'i rezistuar pushtuesit. Beslidhjet janë fjalë e rrallë në politikën tonë, po duhen



*Me mbretin Leka Zogu I, në vitet 90. I ati i tij, Ahmet Zogu ka qenë një shtetar i madh.*

akoma.

Isha i nderuar disa fish prej këtij gjesti fisnik të këshilltarëve lezhianë.

Isha i nderuar së pari sepse ky ishte vlerësimi i parë që më vjen prej vendit amë, apo dhe prej shtetit të Kosovës. Pra prej bashkëkombasve të mi. Është nderimi i parë prej autoriteteve sepse bashkëkombasit e mi më kanë nderuar me votën e tyre, apo me mirënjohjen

e tyre në forma të ndryshme. Kam marrë nderime nga shtete të tjera, por jo nga vendi im apo nga Shqipëria. Nuk më vjen keq për këtë, sepse unë nuk kam punuar për ndonjë dekoratë, dhe ndihem i prekur nga vlerësimi i këshilltarëve të Lezhës.

*Nemo propheta in patria (sua).* Nuk bëhesh dot profet në fshatin tënd. Dikush që bën vepra të mira e ka të vështirë që t'ja pranojnë të vetët. Kjo është një thënie e biblës, por lezhjanët treguan se kjo nuk është e vërtetë.

Së dyti, u ndjeva i vlerësuar sepse ky nderim është votuar unanimisht nga të gjithë këshilltarët, pavarësisht partive politike që përfaqësojnë. Unë i prita në zyrë një delegacion të Lezhës dhe vërtet u ndieva mirë me ta. Vendimi unanim për të më shpallur qytetar nderi i Lezhës, është dëshmi se këshilltarët lezhjanë e kishin kuptuar se atë çka kam bërë unë për Kosovën, për bashkëkombasit e mi, nuk e bëja për ndonjë ideologji partiake, apo për interesa të ngushta, por për kombin. Ne jemi një komb dhe Lezha si qendër e mendimit intelektual, si qytet historik më ka nderuar veçanërisht, duke kuptuar

më para se qytetet e tjera shqiptare se ç'kam bërë unë.

Së treti, bashkë me mua, këshilltarët kishin vendosur të nderonin dhe një mik timin, një qytetar të botës që një pjesë bukur të mirë të kohës së vet ja kushton Kosovës, pra kombit



*Me Presidentin Bamir Topi, gjatë qëndrimit të tij në parlamentin e Kosovës, në 2009. Jam takuar shpesh me të dhe vlersoj shumë pozitivitetin e tij.*

shqiptar. Ai ka merita të veçanta në shumë prej njohjeve të shtetit tonë në botë dhe këtë kontribut të ministrit Shahid e vlerësoi dhe presidenti i Shqipërisë. Zoti Shahid u nderua dhe nga Presidenti Topi me Medaljen e Mirënjohjes. Pas tij, Lezha ishte qyteti i parë i shtetit amë, që e nderoi atë, pra nderoi mikun tim, mikun e kombit tonë dhe kështu më nderoi mua.

Unë do u jem përjetë mirënjohës Lezhës dhe lezhjanëve. Si qytetari më i ri i Lezhës do të punoj, do të angazhohem që ta ndihmoj këtë qytet. Pres që dhe Lezha të më ndihmojë në të ardhmen. Do keni një derë të hapur në Prishtinë, apo kudo ku unë punoj.

Edhe unë besoj se tash e tutje me këtë çelës që më keni dhënë në dorë, do kem të drejtë të vij sa herë të më bjerë rruga dhe sa herë ju të më ftoni", i thashë unë të zgjedhurve lokalë të Lezhës që më vizituan sërish në Prishtinë ku organizuam me kërkesë



*Me ish kryeministrin Ilir Meta, me të cilin na lidh një njohje e hershme. Jemi ritakuar suksesshëm në aulat e diplomacisë më të lartë ndërkombëtare.*

të tyre një ceremoni të ngjashme.

Atë ditë në Lezhë pata rastin që i shoqëruar nga kryetari i bashkisë të shikoja dhe njëherë tjetër Muzeun e Skënderbeut. Ishte një surprizë e jashtëzakonshme ta mbyllja vizitën time në atdhe, ku u prita nga krerët më të lartë të shtetit shqiptar në muzeun e Skënderbeut, ku mesazhi i besëlidhjes vinte i fortë dhe aktual para politikanëve të sotëm shqiptarë që konsumojnë mes vetes konflikte të shpeshta. Po kthehesha në Prishtinë ku të nesërmen në 2 nëntor 2010 më priste beteja e mocionit. Ndihesha më i fortë....



## Manifesti im personal si politikan

*Jam politikan atipik, sepse jam jokonfliktual, i sinqertë, që vazhdon të punojë akoma dhe që s'i ka borxh ndokujt, veç Kosovës. Dua të arrij suksese për Kosovën, si dikur në biznesin tim. Nuk kam lakmi për pushtet, për televizione, nuk i ngaj askujt, por dua t'i shërbej thjesht qytetarit të Kosovës. T'i kthej borxhin që i kam vendit tim.*

**D**he meqë po mbyllim gjithçka, dua të ofroj njëlloj përfundimi për stilin tim të të bërit politikë. E thashë që në fillim se kam patur shumë rezerva për t'u përfshirë në të, *në vetë të parë*, duke krijuar partinë time. Por më në fund e bëra: mendova se kontributi im duhej edhe në këtë fushë, dhe nuk e kemi luksin për më shumë në Kosovë që politikën, këtë zanat serioz, t'ja lemë të paaftëve, dhe të papërgjegjshmëve.

Ju thashë se jam *politikan atipik*. Dhe dua t'a shpjegoj këtë para se t'ju lë të mbyllni përfundimisht faqet e këtij libri të jetës së Behgjet Pacollit.

Unë jam *politikan modest*, sepse jam njeri modest. Nuk jam mburrur kurrë për fuqinë time ekonomike. Nuk mburrem kurrë me të madhe për gjithçka bëj në politikë, për njohjet, për pavarësinë. Ju vetë po e shikoni se shumëçka thuhet në këtë libër për këto angazhime ju rezultojnë të panjohura.

*Unë jam politikan jokonfliktual* sepse jam njeri jokonfliktual që nuk i ka borxh askujt. Eci rrugës krejt i qetë dhe nuk kam frikë, pavarësisht se dhe mund të kufizohesha më shumë në stilin tim të lëvizjes. Si politikan jokonfliktual nuk shaj kurrë askënd, përpiqem të gjej anët e mira të gjithësecilit, veprat e mira të rivalëve apo kundërshtarëve të mi politikë, pavarësisht se kjo mund të duket se nuk më bën mirë mua dhe partisë sime. Kërkoj të pajtoj palët politike dhe ndoshta në këtë qasje, më duket se jam mbi palët. Unë nuk i shërbej ndarjes, por pajtimit. Unë nuk jam politikan i një regjioni kundër një tjetri, për mua Kosova është shumë e vogël që të ndahet.

*Unë jam i papërllyer nga politika* jo thjesht pse nuk kam qeverisur, por dhe se në biznes askush nuk ka mundur të njollosë veprën time. Janë përpjekur, por asgjë nuk kanë arritur siç e shpjegoja. Për një njeri si unë që ka ndërtuar shumë nëpër botë, për një themelues qytetesh, që nuk janë thjesht ngrehina të bukura, por që ndryshojnë thellësisht mënyrën e jetesës së kombeve, për një njeri që ka qarkulluar miliarda, ky është një motiv krenarie.

Në fund të fundit unë nuk kam qeverisur, pra nuk jam bërë me baltën e Kosovës që njollos ata politikanë të zhytur në hajni monstruoze, gjigante për vendin më të varfër të Europës. Jam përfolur për rindërtimin e godinës qeveritare, ish-Pallatit Rilindja, një vepër që e fitoi kompania ime. Ishte një vepër që vetëm ne mund ta bënim në Kosovë, ne punësuam kosovarë. Ne garantuam cilësi, ne bëmë diçka për të cilën Kosova mund të jetë krenare nesër. Ne nuk fituam asgjë nga ajo kontratë, për të cilën dua të them diçka specifike, që ngjan si mburrje, por në fakt është burim transparence. Vlera e asaj kontrate është disa përqind e vlerës së kontratave të mia nëpër botë. Ajo është më e vogël se vlera e shtëpisë që unë kam ngritur para se të hyja në politikë, si dëshmi e vendimit tim për ta mbyllur jetën time publike, atje ku e nisa, jetën time fizike, në Kosovë. Atje ku do të jetojnë fëmijët e mi që duan shumë vendin e babait të tyre, që flasin shumë bukur shqip dhe nuk duan të shkëputen prej tij sa herë që vijnë dhe qëndrojnë atje.

*Unë jam opozitar atipik*, pasi me bindje dhe krenari e mbështeta qeverinë në disa hapa të parë të shtetndërtimit. Askush nuk ma kërkoi, qeverisë nuk i duhej ndihma ime sepse kishte në themel të vet, një koalicion që dihet si përfundoi. Pra, duke votuar disa herë për qeverinë, kur ajo e kishte shumicën, unë nuk ofrova favore, që të merrja diçka në këmbim. Dikush thotë se Pacolli u soll kështu pse u ble. A besoni se gjendet dikush që mund të më blejë në Kosovë? A gjenden aq para sa të më blejnë dinjitetin dhe shpirtin? Pse rindërtova *Rilindjen*? Po kush më mirë se kompania jonë që ka ndërtuar botën, me mirënjohje të mbarë botës, do të përkryente selinë e qeverisë së Kosovës? A e dini se puna jonë ka kushtuar më shumë sesa vlera e tenderit, diçka e paimagjinueshme për ndërtuesit popullorë që më akuzojnë sot? E kam fjalën për ata që ndërtojnë me baltën e shpifjes

që u bie në fytyrë. Më vjen mirë që edhe sot vazhdojnë me shpifjen e Rilindjes- kjo do të thotë se s'kanë asnjë akuzë tjetër. Epo Rilindja është pak për të më blerë mua.

*Unë jam politikan atipik* sepse unë vazhdoj të punoj krahas politikës. Më vjen keq që ju zhgënjej, por nuk e quaj dot politikën si profesionin e vetëm me të cilin mund të jetoj. Shikoni - dikush që nuk i ka thënë punës mirëmëngjes, mund të ketë folur me përçmim duke më quajtur ndërtimtar. PO, unë e kam për nder të jem ndërtimtar. Por kujdes! Unë kam themeluar qytete nga e para. Unë kam ndihmuar në shndërrimin e qytetërimit në pjesë të caktuara të botës. Kam bashkëbiseduar mijëra orë pune me arkitektë, urbanistë, sociologë, artistë, punëtorë, që më kanë bërë më të ditur. Edhe sikur të isha i paditur më parë, anipse kam studiuar në universitete serioze të Gjermanisë dhe Zvicrës që nuk janë fabrika diplomash, sot jam më i pasur në kulturë!

Unë jam shkëputur nga kënaqësia e menaxhimit të kompanive të mia, siç sugjerojnë disa kritikë të mi. Jua kam lënë të afërmve të mi. Por unë s'jam shkëputur nga kënaqësia e krijimit të një qyteti, të një teatri apo kompleksi sportiv. Unë vazhdoj të kaloj plot pasion orë të tjera me arkitektë, urbanistë, sociologë, artistë. Unë i nxis njerëzit e mi të punojnë plot pasion në ato që një diplomat i lartë europian i cituar nga Beqë Cufaj, një gazetar i shquar, shpeshherë kritik i fortë imi, i ka quajtur *kantieret dhe punishtet e Behgjet Pacollit, i vetmi vend ku punohet në Kosovë*. Vërtet duhet të besoni se një njeri si unë mund të mbushë mushkëritë dhe trurin vetëm e vetëm me ajrin e prishur të politikës? Vërtet doni të më lini pa oksigjenin e krijimit të një veprë, të disa veprave? Të revolucioneve urbane në qytete anëmbanë botës?

Paratë e mia janë të pastra. Ato janë fryt i angazhimit 35 vjeçar në biznes që ka njohur vetëm ngritje.

Unë jam i papërlyer nga politika, por dhe AKR-ja gjithashtu. Ne nuk përdorim para publike, mjete publike në fushatë, megjithëse kemi deputetë që kanë disa të drejta. Gjithçka është prej kontributeve tona të mbërritura me punë.

Unë jam politikan atipik, sepse *unë jam i sinqertë*. Kjo është diçka jo normale për një politikan kudoqoftë, ndoshta përjashtim mund

të bëjnë vendet skandinave. Unë nuk kam frikë të shpreh hapur mendimet e mia. Më tërheqin prognozatat, mendimet e sinqerta, edhe pse ato mund të më krijojnë telashe, pasi kundërshtarët e mi do të bëjnë lojra fjalësh me to.

Prapë do të flas sinqerisht dhe gëzohem se populli i Kosovës më kupton dhe më çmon. Kam shumë prova për këtë.

Unë jam politikan atipik, pra jonormal sepse *unë nuk premtoj kot dhe se i mbaj premtimet e mia*. Pikërisht pse dinë këtë, pse dinë fuqinë time, rivalët e mi, mundohen të më sabotojnë. Por unë buzëqesh, dhe prapë punoj për to. Askush të mos mendojë se unë gënjej për diçka. Unë jam politikan atipik, pse jam i ndarë akoma midis biznesit dhe politikës. Më tërheqin akoma sfidat biznesore, jo aq për rezultatin e tyre financiar, sesa si ndërmarje që sfidojnë gjithashtu dhe inteligjencën njerëzore. Nuk kam hyrë në politikë për të bërë biznes, apo në biznes, pasi hyra në politikë, një kurs normal karriere në viset tona. Nuk dua të fitoj prej politikës, por dua që të tjerët të fitojnë prej politikës sime.

Dhe në këtë pikë më lejoni t'u përgjigjem kritikëve të mi që vijnë nga mediat perëndimore. Dikush pa te hyrja ime në politikë, një dukuri të ngjashme me Berluskonin. Jo zotërinj, unë jam shumë i ndryshëm, megjithë respektin që kam për suksesin e atij njeriu dhe popullaritetin e madh që ka mes italianëve.

Unë nuk hyra në politikë, pasi pata ndonjë telash në bizneset e mia, as me gjyqësinë dhe as me shtetet ku punoj. Pra unë *nuk hyra në politikë për të mbyllur ndonjë proces*. Unë s'kisha asgjë të hapur. Unë nuk e kam bërë pasurinë time në Kosovë.

*Unë nuk e kam bërë pasurinë time në Kosovë*, pra as dhe me ndihmën e politikës, apo qeverive të Kosovës. Përkundrazi, unë jam luftuar prej qeverive të Kosovës. Unë e kam bërë pasurinë time jashtë vendit, duke u mbështetur te pasionet e mia krijuese, te puna e jashtëzakonshme, te aftësitë e shqiptarit, te respekti për njeriun. Përndryshe një shqiptar i thjeshtë nga Kosova si unë nuk do të çante aq lart.

Unë nuk pata ngut për të fituar gjithçka në politikë. Unë hyra në zgjedhje dhe nuk protestova pse më kishin vjedhur votat, dje dhe sot. *Nuk u bëra me zgjedhjet e para, as kryeministër, as President*.

Askush nuk mund të thotë se Behgjet Pacolli vjedh apo blen vota. Askush nuk mund të thotë se Behgjet Pacolli blen deputetë apo i shet ato, megjithëse fuqia ime është e madhe dhe kapërcen Kosovën. Unë pra nuk u nguta për të marrë pushtetin ekzekutiv, as dje dhe as sot.

Unë nuk pata aspiratë *për të shtënë në dorë televizione*, madje dhe një të vetëm që bleva në Shqipëri, ma morën në mënyrë të pandershme.

Unë nuk jam në Kosovë *për të ngritur ndonjë monopol*, megjithëse i kam mundësitë. Unë dua të ndihmoj të gjithë të ngrënë bizneset e tyre. Edhe të konkurrojnë bizneset prej nga ku unë po tërhiqem avash avash për t'ju përkushtuar tërësisht kauzës së Kosovës.

*Nuk jam diktator*, dhe s'kam prirje diktatoriale, diçka atipike për një politikan të viseve tona, që i pëlqen vetja sapo ngjitet lart. Jo, shikoni partinë time, lirinë e shprehjes brenda saj, demokracinë e kësaj partie. Kështu do të kuptoni se çfarë shteti dua të bëj unë.

Pra unë nuk i ngaj askujt prej politikanëve në botë që vijnë nga biznesi, megjithë respektin për ta, qoftë Michael Bloomberg, (Majkëll Blumbergut), kryebashkiaku i New Yorkut, apo Presidentit të Kilit, etj. Prandaj unë jam politikan atipik. Sigurisht më bëri përshtypje dhe ndoshta ngaj me Presidentin e Kilit, biznesmenin dhe filantropistin Sebastian Pinera, i cili financoi plotësisht operacionin e shpëtimit të minatorëve të bllokuar disa muaj në galeri në vitin 2010...

Unë jam politikan atipik, ashtu si *jam njëlloj patrioti atipik*. E shoh atdheun te prona, te shtëpia, te varret e të parëve, te rrugët e përbashkëta, te tregu kombëtar, te qarkullimi pa pengesa i mallrave, njerëzve, ideve, te këngët, muzika, interneti. Patriotizmi im sendërtohet në një atdhe të fortë ekonomikisht, dhe jo domosdoshmërisht me ushtri të fortë. Jam për hapjen e kufijve, që do mundësojnë bashkimin e shqiptarëve, diçka që do t'i detyrojë më në fund armiqtë tanë historikë të na kërkojnë ndjesë për krimet e tmerrshme që na kanë bërë në shekuj, dhe të na shohin si të barabartë. *Jam kozmopolit*, dhe kam folur që herët, që në shkollimet e mia universitare për globalizmin. Jam për hapjen e kufijve, ku duhet të lëvizë lirshëm interesi njerëzor. Unë e shoh globalizmin si respekt për vendin tënd, për origjinën tënde. Nuk e kam harruar kurrë këtë

origjinë, dhe u ktheva pa frikë te rrënjët e të parëve të mi.

Unë jam atipik dhe për arsye të tjera. *Ndihem i ri në shpirt, në energji*, por respektoj traditën, fenë e të parëve, zakonet e tyre.

Unë megjithëse atipik, pra dikushi që nuk i ngjan të tjerëve, vazhdoj të mbijetoj në mënyrë të drejtë në botën e egër të politikës. *Jam këtu mes jush*. Nëse më shihni tamam siç jam, më thërrisni që t'ju prij. Dua shumë të ndihmoj popullin tim. Ta drejtoj atë me një shpirt tjetër. Me një mendje krejt tjetër. Pa burokraci, pa korrupsion, pa hajni. Ekonomia në plan të parë, Mirëqenia e qytetarit, Dinjiteti i shtetit, do të ishin prioritetet e mia.

Për të arritur deri në këtë detyrë, të denjë për një njeri si unë, në moshën time, për suksesin tim, për emrin tim, unë s'do të heq dorë nga parimet e mia. Nga mësimet e të parëve të mi. Jeta me sfidat e saj vazhdon! Dëshira për një të nesërme më të mirë, te njeriu, duhet të ekzistojë gjithmonë dhe kjo të përcillet nga vullneti i pakufishëm për të ndërruar jetën për të mirë. Këtë ecje përpara skajshëm e fisnikëron korrektësia, respekti, sinqeriteti, dhe dashuria për njeriun. Sa më e mirë është sinteza e këtyre synimeve, aq më i madh është sukcesi në veprimet tona.

Dikush do ta vlerësojë këtë, populli im më në fund do ta kuptojë këtë gjerësisht, nga Jugu në Veri. Të gjithë kosovarët e mi, do të kuptojnë se pavarësisht rrugëtimit të gjatë nëpër botë, *me ballan* apo *pa ballan* siç më thoshte gjyshi im i ndjerë, pavarësisht jetës sime mes apo pranë burrështetasve, unë jam njeri nga ata.

## Epilog: lobimi dhe punë të tjera të pakryera

**K**y libër flet vetëm për një pjesë të jetës sime. Shumë momente të saj nuk janë përshkruar, sepse në atë rast do të ishte një libër shumë i vëllimshëm dhe me shumë detaje. Rrethanat kanë bërë që jeta ime, të jetë dinamike, aq sa pothuajse secila ditë ofron ngjarje interesante, të denja për të qenë pjesë e librit të jetës sime.

Besoj se në këtë libër kam arritur ta shpalos natyrën time të çiltër, herë-herë, madje, deri në naivitet. Kam shpjeguar rrethanat dhe motivet e suksesit tim në biznes dhe në jetë, që zënë fill nga këshillat e urta të prindërve të mi, në veçanti të gjyshit tim Osmanit, që më pajisi me një filozofi jetësore të urtë e të shëndoshë, e cila u ka bërë ballë dallgëve të jetës.

\*\*

Ky libër nuk do të ishte i përkryer sigurisht po qe se në të nuk do të flitej edhe për aktivitetet e mia, jashtëpartiake dhe jashtëprofesionale (biznesore).

Në mes viteve 2003-2007, fuqishëm kam lobuar për pavarësinë e Kosovës, si në Uashington, Bruksel e gjetiu. Edhe pas 17 shkurtit 2008, kam vazhduar të llojoj fuqishëm për njohjen e Kosovës si shtet i pavarur nëpër botë. Për shkak të volumit të madh të informacioneve, është e pamundshme që gjithçka të përfshihet në këtë libër. Me siguri do të shkruaj akoma dhe do bëj transparent gjithçka kam kryer për Kosovën, dhe gjithçka është thënë për mua. Këto janë projektet e së ardhmes dhe ndërsa punoj për këtë libër e kuptoj se një jetë dinamike si imja, kërkon që libri të modifikohet shpesh, që ai të mbetet i hapur deri në sekondën e fundit, diçka që ndonjëherë ma heq dëshirën për ta mbyllur përfundimisht librin. Kështu ndërsa po mendoja ta mbyllja kapitullin për lobimin, erdhi

mendimi këshillimor i GJND dhe pritej Asambleja e radhës e OKB-së në shtator 2010, ku serbët paraqitën një rezolutë që synonte të zhvleftësontr opinionin e Gjykatës. U fol shumë nga autoritete shtetërore për shtim të njohjeve të reja, por ende në fund të gushtit, një muaj prej *Mendimit* nuk kishim arritur asnjë, hiq Hondurasin dhe Kiribatin për të cilin unë kisha punuar gjatë. Është me rëndësi, që Kosova sa më shpejt të njihet nga sa më shumë shtete, së paku deri sa numri i njohjeve të krijojë një nivel presioni mbi Këshillin e Sigurimit për ta shtyrë që ai të vendosë se Kosova duhet të bëhet anëtare e OKB-së. Siç e kam thënë kjo duket ende e parakohshme të paktën për 2010. Lidhur me njohjet, unë tashmë kam vërejtur se ndër ne është ngulitur një si vetëdije pak e deformuar, se bota duhet të vijë këtu, shtetet të bëhen radhë një pas një dhe të na e kumtojnë njohjen. Natyrisht që kjo nuk mund të ndodhë, sepse nuk bëhet fjalë këtu vetëm për kundërshtimet e forta të Serbisë dhe të aleatëve të saj, por për mungesë të theksuar informacioni. Shumë shtete në botë kanë prioritete të tjera dhe Kosovën nuk e vendosin në orbitën e interesimit të tyre, për shkak të problemeve të tjera lokale dhe rajonale, me të cilat ato përballen vazhdimisht.

Puna e bërë për lobim në Njujork filloi të japë frytet e veta ndërsa po punoj akoma mbi librin në tetor 2010. Shteti i vogël i Kiribatit e njohu Kosovën falë lobimit tonë atje dhe mbrritti një njohje e re, ajo e Tuvalu-së. Ndërkohë unë eksperimentova një strategji lobimi të re përkundrejt një vendi si Libia. Udhëhoqa siç thashë në fillim të tetorit 2010 një delegacion me 120 vetë. Ata patën rastin të vizitonin këtë vend të madh dhe të takoheshin me udhëheqësin historik të Libisë, vendit të katërt në Afrikë për nga zhvillimi ekonomik. Lideri libian Muamar Al Gadaffi, është një lider i veçantë me rolin e tij unik në zhvillimin me hapa të shpejtë të vendit të vet, me protagonizmin e tij në historinë e Afrikës dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi. Ai ka arritur të normalizojë marrëdhëniet me shtetet perëndimore në veçanti me SHBA-të, ka pritur në vendin e tij katër kryeministra të shteteve më të mëdha perëndimore, dhe është integruar plotësisht në bashkësinë ndërkombëtare. Libia ishte vend anëtar i Këshillit të Sigurimit një vit më parë dhe Presidenti i Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, është gjithashtu një libian.



Duke kapërcyer këto paragjykime, unë vazhdoj të insistoj në lobimin tim tek ky vend me autoritet të madh në Afrikë, themelues i organizatave panafrikane dhe drejtues i Unionit Jugafrikan. Unë synoja të restauroja apo të krijoja miqësinë midis popullit të Kosovës dhe atij të Libisë. Në këtë synim unë kam vërtet një qasje pragmatike. Nëse Serbia, apo ish-republikat e ish-Jugosllavisë prej ndarjes së Federatës kanë trashëguar prej lidhjeve të dikurshme të saj me Libinë, marrëdhënie ekonomike dhe njerëzore, edhe Kosova duhet të ketë hisen e saj nga kjo trashëgimi.

Ishte një pritje e mrekullueshme ajo që na u rezervua neve, delegacionit nga Kosova, nga autoritetet libiane. Ne kosovarët ndërkohe po vizitonim një shtet që ende nuk na ka njohur pavarësinë, me pasaporta pa viza. Madje na u dha në shfrytëzim edhe një avion shtetëror, për të udhëtuar në qytetin Sirte, aty ku zhvillohej samiti i 30 kryetarëve të shteteve afrikane. Atje gjendej edhe lideri i Libisë, Muhamar al Gadaffi dhe ishte i paraparë një takim i delegacionit tonë me të. Takimi u zhvillua në shkretëtirë, aty ku rëndom ai pret mysafirët specialë nga tërë bota. Gadaffi, ishte shumë miqësor me ne. Që në përshëndetjen e parë, atij iu kujtua takimi ynë që kishim zhvilluar një vit më herët. Madje më pyeti nëse i kisha ndjekur këshillat e tij, për të lobuar në vendet e Afrikës, për shtetin e Kosovës. “I nderuari lider, ashtu siç kanë qenë këshillat tua, unë kam vizituar këto shtete të Afrikës, dhe rezultatet nuk kanë munguar. Disa shtete tashmë kanë marrë vendimin për njohjen e Kosovës”,-iu përgjigja unë.

Në vazhdim, ia bëra një prezantim të shkurtër, liderit të Libisë, për zhvillimet në Kosovë, për të arriturat gjatë kësaj kohe, për njohjet, për nevojën e zhvillimit ekonomik dhe për synimet integruese. Gjatë kësaj kohe, reagimi i Gadafit ishte shumë pozitiv. Tregonte një interes të madh për atë se çfarë i shpjegoja unë. Këtë interesim e tregoi veçanërisht atëherë kur na u drejtua me fjalë.

“Me serbët ne jemi shokë, por me ju kosovarët jemi vëllezër. Forcojeni sovranitetin dhe integrohuni në BE. Unë ju premtoj se do të bëj çdo gjë që është e mundur për të ju ndihmuar që të zhvilloheni ekonomikisht”, ishte premtimi dhe inkurajimi i Gadafit. Kjo ishte shumë e rëndësishme. Një vend i madh dhe i fuqishëm si Libia, bëri

një hap shumë të madh në drejtim të njohjes së shtetit tonë. Gadafin me një fjalë e përshëndeti edhe zëvendëspresidentja e AKR-së, Mimoza Kusari dhe një përfaqësuese e studentëve, me emrin Fjolla. Pas takimit, me liderin, ne vazhduam për në Tripoli ku do të zhvilloja edhe disa takime, që kishin për qëllim, kryesisht kërkesën për investime ekonomike në Kosovë. Aq më tepër kur tani edhe lideri libian kishte treguar shenja të qarta se Libia nuk është kundër shtetit të Kosovës. Në aeroportin e Sirtes, së bashku me Mimosën, u takuam me kryeministrin dhe 6 ministra të kabinetit qeveritar libian. Edhe në këtë takim, premtimet për ndihmë ekonomike nuk munguan. Ata ishin të gatshëm për një gjë të tillë. Ne vetëm duhet ta bënim hapin tonë... Të gjithë pjesëtarët e delegacionit, veçanërisht të rinjtë ishin shumë të gëzuar me vizitën. Ndërsa shtypi serb reagoi me xhelozë. Edhe tani vazhdoj aktivitetet e mia jashtë kufijve të Kosovës. Jam anëtar permanent i grupit të udhëhequr nga Henri Kissinxher në CSIS, në Uashington, që më krijon privilegje të mëdha në takimet me njerëz të shquar. Aty takoj rregullisht Presidentë dhe kryeministra të shteteve të ndryshme të botës. Jam qytetar nderi i Republikës së Kazakistanit, ambasador nderi i Liberisë dhe konsull nderi i shtetit të Maldiveve për Ballkanin, pra edhe për Kosovën. Dy shtete të tjera të Ballkanit e kanë bërë prej kohësh.

\*\*\*

Kohët e fundit, biznesin dalëngadalë jam duke e përcjellë te pjesëtarët tjerë të familjes time në mënyrë që t`i krijoj vetes kohë të duhur për tu marrë me kauzën e Kosovës.

Edhe kontratat në jetën time biznese kanë një fillim dhe mbarim. Nëse gjatë procesit të zbatimit të këtyre kontratave ka ekzistuar respekti për të tjerët, dashuria dhe pasioni shumë i madh për ta implementuar atë, edhe punët janë përkryer me sukses. Edhe pavarësia e Kosovës është përkryer. Pra çdo fillim e ka edhe fundin e vet. Në rastin tim, fundi i çdo nisjeje është kryer me sukses. Edhe lobimet e mia, ashtu si edhe jeta politike njëherë do të kenë fundin e vet.

Po hyjmë në zgjedhje dhe së bashku me AKR-në, nisur nga ajo,

arritëm të formonim një koalicion të madh. Ndërsa e prezantoja para medias thashë:

Koalicioni që po firmosim sot është një etapë e re në formimin e një subjekti të madh politik, i një poli të ri politik që do të udhëheqë Kosovën në fazën e tretë të zhvillimit të saj, në atë të begatisë ekonomike.

AKR-ja është në qendër të këtij koalicioni, lokomotiva e këtij koalicioni.

Unë ju kisha thënë në zgjedhjet e fundit lokale se Kosova ka hyrë në një fazë të re historike. Kjo fazë kërkon AKR-në në drejtim.

AKR-ja ka qenë deri më sot e vetmja forcë politike e papërlyer me qeverisjen e dhjetë vjetëve të fundit. Por AKR-ja, kam thënë është e hapur që në këtë fazë të re të Kosovës, të bashkëpunojë me më të mirët e dy fazave të tjera.

Me ata individë të lidhur me luftën e ndritshme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ata të lidhur me rugovizmin. Të lidhur vërtet, jo të kacavjerrur pas fotove të liderit tanë historik.

Më duket se sot të nderuar gazetarë, përreth AKR-së, me AKR-në, në qendër, me AKR-në si bartëse po rilind një subjekt politik..... Me ne erdhi Partia e Drejtësisë, e drejtuar nga Ferid Agani, një intelektual i shquar, i betuar për ringjalljen morale të shoqërisë kosovare mbështetur mbi traditën.

Me ne erdhi Partia Social Demokrate e udhëhequr nga gjeneral Agim Çeku, shefi i shtabit të UÇK-së, kryeministër mjaft popullor dhe figurë e papërlyer e qeverisjeve të pasluftës. U bashkua një parti e dedikuar interesave të klasave të varfëra të Kosovës.

Me ne erdhi E15, e udhëhequr nga Profesor Doktor Muhamet Mustafa, në krye të një grupi ekspertësh, më të mirët e Kosovës. Këta ekspertë i kanë ofruar studimet më të shkëlqyera qeverive të Kosovës, megjithëse këto qeveri i kanë injoruar këto studime dhe kanë vepruar në mënyrë ad hoc. Pa programe, pa ide, pa vizion. Është një krenari e madhe që ky grup ekspertësh, zgjodhi AKR-në.

Me ne erdhën Partitë e pensionistëve, Ekologjikja, dhe dy parti të tjera.

Më duket se janë të gjithë pjesët e një mozaiku themelues të qendrës politiko-kulturore të Kosovës. Pjesët e një poli të ri politik,

i përgjegjshëm për ta nxjerrë Kosovën nga kriza e gjithanshme politike, ekonomike, institucionale.

Alternativa jonë i ka njëlloj si ylberi të gjitha ngjyrat që i nevojiten një koalicioni të denjë për të qeverisur.

Kosovarët sot kanë kë të votojnë.

Bashkimi ynë përfaqson një alternativë të re politike. Kjo alternativë është një alternativë perëndimore.

E besueshme.

E aftë të qeverisë.

E dëshmuar në vlera morale.

E dëshmuar në menaxhim.

Alternativa jonë e formalizuar këto ditë, në fakt është pjekur dhe diskutuar gjatë në kontaktet tona të mëhershme.

Ajo nuk është produkt i ndonjë improvizimi pragmatik.

Ajo nuk do të prishë marrëdhëniet me miqtë tanë perëndimorë, por do t'i forcojë ato.

Alternativa jonë do të fillojë nga liberalizimi i vizave me BE-në për Kosovën deri tek integrimi i saj ndërkombëtar.

Ajo nuk do të përsërisë sherret e vjetra të partive që kanë qeverisur Kosovën.

Ndihem i nderuar që bashkë me Mimosën, me dy nënkryetarët e AKR-së, me gjithë udhëheqësinë e AKR-së, kemi përgatitur kushtet për lindjen e këtij subjekti të ri.

Që këtu i bëj thirrje të gjithë drejtuesve të subjekteve që përbëjnë koalicionin, të diskutojmë për t'i dhënë jetë institucionale këtij subjekti të ri, megjithëse koha është e shkurtër deri në zgjedhje.

Ne duhet të gjejmë formën që të jemi bashkë të gjithë në qeverisjen e ardhshme të Kosovës.

Ajo do të jetë qeverisje euroatlantike. Dinjitoze. Me duar të pastra. Me ndërgjegje të pastër.

## Falënderime për librin

**K**y libër është një pjesë e mirë e librit real të jetës sime. Ky që gjeni këtu jam unë, me forcën dhe dobësitë e mia, me njerëzit dhe miqtë e mi, madje dhe me armiqtë e mi. Jam me veprat e mia, dështimet e mia. Me idetë dhe vizionin tim.

Unë nuk jam shkrimtar, nuk jam gazetar, megjithëse di të flas shumë mirë me gjuhën e shpirtit dhe ata që më kanë dëgjuar thonë se rrëfej shumë mirë.

Libri është ndërtuar mbi bazën e bisedave të gjata e të shpeshta me disa gazetarë dhe publicistë të shkëlqyer. Ata kanë ditur të mundin përtacinë për këso punësh apo mungesën time të kohës dhe të disponimit, duke rrëmuar në shumë anë të jetës sime, në shumë kthina të shpirtit tim. Ndaj ata kanë një meritë të veçantë. Në bisedat intensive me ta, provova dobinë publike të rrëfimeve të jetës sime.

Dua të falënderoj së pari publicistin dhe poetin e shquar *Agim Doçi*, me të cilin i filluam bashkëbisedimet rreth këtij libri që nga viti 1993. Pa evidencimet dhe punën e tij të shkëlqyer nuk do të bëhej i mundur realizimi i këtij libri.

Falënderoj gjithashtu gazetarin e shquar, aktualisht drejtor i Radio Televizionit Italian-RAI 2, *Xhixhi Monkalvo* (Gigi Moncalvo), i cili më intervistoi rregullisht, gjatë fundit të viteve '90 dhe fillimit të viteve 2000, në funksion të realizimit të këtij libri.

Dua të falënderoj sërish opinionistin *Baton Haxhiu*, i cili është dhe iniciatori kryesor që ky libër të publikohet.

Në këtë rast dua të falënderoj edhe gazetarin e ri me moshë - *Jetlir Zyberajn*, tek i cili kam gjetur jo vetëm pasionin e një të riu për jetën dhe dëshirën për një objektivitet profesional e jetësor, por mbi të gjitha, tek energjia e tij prej të riu kam gjetur një lloj inkurajimi

jetësor që më bënte, në një farë forme, të ndihesha edhe unë i ri..

Më në fund falënderoj dhe gazetarin *Mentor Nazarko*, i cili më nxiti fuqimisht që ta mbyllja si duhet këtë libër, që e shfletonim e rishfletonim bashkë dhe nuk vendosnim dot ta hidhnim hapin e fundit. Ai u përkujdes veçanërisht për pjesën politike të këtij jetëshkrimi, por dhe për të harmonizuar rrëfimet dhënë gazetareve të ndryshëm në kohë të ndryshme.

Dua të falënderoj në mënyrë të veçantë Presidentin e Shqipërisë, *Rexhep Meidani* (1997-2002), i cili ndërsa lexonte librin tim, kuptoi shumë mirë shpirtin tim, sinqeritetin tim, atë që unë ndieja dhe bëja për vendin tim. Të kesh vlerësime të tilla si ato që ai ka shkruar për mua në parathënien e këtij libri, është vërtet prekëse për mua. Sepse ato vijnë prej një personaliteti të shquar të kombit shqiptar, njeri ndër themeluesit e fakultetit të shkencave në Universitetin e Prishtinës në vitet '70, kryetarit të shtetit shqiptar që bëri mrekullinë e përbotshme me mikpritjen për kosovarët në vitin 1999, dhe vendimarrësit nr 1 në momentet historike të krizës së Kosovës.

Falënderim të ndierë dhe për ambasadorin *Uilliam Uoker* (William Walker. Fjalët e tij, fjalët e njeriut që e ka emrin me gërma të arta në historinë e afërt të Kosovës, njeriut që denoncoi qartësisht genocidin serb duke ftuar ndërhyrjen e NATO-s, për mua janë një nderim i madh. Me të do vazhdojmë të punojmë për Kosovën.

Së fundi, por jo të fundit për nga rëndësia, dua të falënderoj së pari, lexuesin e parë të kualifikuar të librit tim, Akademikun e shquar *Rexhep Qosja*. Ai më sugjeroi shumë saktësime historike që më nevojiteshin dhe më shtoi besimin se ky jetëshkrim i sinqertë do t'i mbijetonte provës së publikut, që do ta lexonte me interes.

Falënderime të ndiera dhe Profesorit *Agim Vinca*, i cili e krasiti tekstin nga gabimet sintaksore e të tjera, të kuptueshme për një njeri si unë, duke i dhënë tekstit saktësi dhe bukuri në gjuhën letrare shqipe.

Falënderoj të gjithë ata që në cilësi të ndryshme kontribuan në këtë libër. Punën tuaj do ta shpërblejë lexuesi!

Sa herë që i kthehem këtij libri, më vjen në mend një thënie e Mithat Frashërit, njërit nga burrat më të shquar të kombit tonë dhe pasardhës i rilindësve të mëdhenj. *Shumë herë jeta mbetet si një skicë*

*e pambaruar. Kur shohim zbrazëtinë e saj, duam të kompletojmë tablonë, të vëmë ngjyrat e duhura, atje ku mungojnë. Por zëmë të shohim se vilari i jetës nuk duron qortime.*


Pra dhe unë disa herë pas çdo kapitulli të përfunduar kam patur dyshime, se mos dikush po krijon përshtypje tjetër për mua, apo dikush ndihet keq për këtë, por në vazhdimësi i kam mbyllur mendimet se në këtë libër, asgjë nuk duhet ndryshuar. Në fund të fundit kjo ishte jeta ime, e mbushur përplot mundime e sfida, por dhe kënaqësi, që prodhonin motive për t'ja filluar një sfide të re. Pra, prej sfide në sfidë! Edhe tani ndihem më i motivuar për sfida të tjera, pa u hidhëruar me askënd, pa paragjykime, me plot shpirt dhe energji pozitive! Kjo është jeta ime... Ky jam unë!

Shtypur në tipografinë *Evropa92*, Koçan - Maqedonia.

Shtëpia botuese *Albanica*, Prishtinë - Kosovë.

Prishtinë, 28 nëntor 2010.

ISBN 978-9951-8735-5-0



9 789951 873550